

Doc. Prof. Dr. Hfz. Hajredin Hoxha



DOKTRINAT E TEFSIRIT NË TROJET SHQIPTARE



Prof. Dr. Hfz. HAJREDIN HOXHA

**TEFSIRI DHE MUFESSIRËT SHQIPTARË
NË KOHËN BASHKËKOHORE
(SHEK 19-20)**

Tetovë, 2008

E përktheu nga arabishtja:
Prof. Muhamed Mustafa

Redaktor dhe korrektor:
Hamdi Iljazi

Redaktor gjuhësor:
Ahmed R. Ramadan

APROVIM

Teza e doktoraturës e Hajredin Hoxhës është kontrolluar dhe aprovuar nga:

1. Prof.Dr.Abdul Kahhar Al'Any (mentor); Irak
2. Prof.Dr.Fikret Karçiq (mentor); Bosnje
3. Prof.Dr.Xhamal Ahmed Beshir Badi; (kontrollor i brendshëm); Libi
4. Prof.Dr.Muhamed Beha'uddin Husejn; (kontrollor i brendshëm); Kurdistan - Irak
5. Prof.Dr.Suat Yildirim (kontrollor i jashtëm); Turqi, dhe:
6. Prof.Dr.Muhamed Ibrahim Zein (kryetar i komisionit). Sudan

Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim!

(Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!)

Falënderimi i takon Allahut, ndërsa salavatet dhe selami Pejgamberit tonë Muhammedit, Familjes së tij të Pastër dhe të gjithë ndjekësve të tij!

Ky studim i dalluar kur'anor, i ndërmarrë nga vëllai im i nderuar dr. Hajredin Hoxha, merret me çështje mjaft të rëndësishme që kanë të bëjnë me popullin shqiptar musliman nga aspekti historik, aspekti i zhvillimit dhe nga aspekti i ndikimit intelektual në çështjet më të rëndësishme fetare dhe aplikimeve shkencore që kanë të bëjnë me studimet e ndryshme kur'anore, dhe atë duke nisur nga drejtimi doktrinor sunnit social, drejtimi filozofik, aspekti shkencor empirik dhe nga aspekti doktrinor akaidologjik.

Studiuesi Hoxha ka ecur rrugës së metodës së selefrit të devotshëm dhe me këtë vepër ai ka plotësuar një boshllëk të rëndësishëm, ngase ka qëndruar larg epsheve dhe ekstremizmit, vetëm e vetëm për të arritur të vërtetën.

Lus Zotin e Madhërishëm që ta shpërblejë për këtë punë të dobishme dhe ta bekojë vëllain tim, gjegjësisht hulumtuesin e nderuar Hoxha me shpërblime dhe sevape të mëdha për gjithë atë që kanë shkruar duart e tij të çmuara!

Vetëm Zoti i Madhërishëm i di qëllimet!

Prof. Dr. Imâd ibn Zuhejr Hafidh

profesor i tefsirit dhe shkencave të Kur'anit në Fakultetin e Kur'anit Fisnik dhe përgjegjës i çështjeve të bibliotekave në Universitetin Islamik në Medinën e Ndryshme - Arabia Saudite.

Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim!

(Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!)

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, ndërsa salavatet dhe selami Pejgamberit tonë Muhammedit, Familjes së tij të Pastër dhe të gjithë sahabëve!

Kur përzihen rrugët, kur mbizotërojnë epsheet dhe dëfrimet e ndryshme, atëherë ndihet nevoja për paraqitjen e dikujt që do t'ua zbulojë të vërtetën njerëzore, t'ua zbardhojë errësirën dhe t'ua ndriçojë rrugën.

Kundërshtarët dhe ithtarët e epsheve e të risive akoma vazhdojnë t'i gjuajnë/hudhin idetë dhe dyshimet e tyre në rrugë kundër të së vërtetës, por Zoti i Madhërishëm me Mëshirën e Tij, përgatiti ata që iu përballojnë dyshimeve të tyre, që i pastrojnë pengesat e tyre dhe që na ndriçojnë rrugën derisa të zhduket e verbëra dhe të vërehet e qarta.

Në kohërat e kaluara shumë heretikë u orvatën që të trillojnë/shpifin hadithe të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) me qëllim që ta mbulojnë të vërtetën para njerëzve, por dijetarët e hadithit i zbuluan dhe i ndriçuan trillimet dhe intrigat e tyre.

Kur Harun Rashidi (Zoti e mëshiroftë!) vendosi që të mbys një heretik, ai i tha: “Ç’do të bësh me dyzetë mijë hadithet që i kam trilluar e në të cilat e ndaloj të lejuarën pa thënë asnjë fjalë Pejgamberi për gjërat e tilla a?!?” Haruni i thotë: “Çka do të bësh ti o armik i Zotit me Is’hak El-Fizariun dhe me Abdullah ibn Mubarekun të cilët gjurmë pas gjurme e fjalë për fjalë i pastrojnë hadithet e tilla?”¹

Pra, në këtë mënyrë vepronin dijetarët e spikatur për ta pastruar tefsirin nga transmetimet e kota izraelite (israilijatet), nga hadithet e falsifikuara, nga intrigat e këqija ose nga dyshimet e neveritshme.

Në kohën bashkëkohore epsheet dhe drejtimit janë bërë të shumta e të lloj-llojshme dhe po thuaj se në çdo vend dolën dijetarë që flasin ndryshe dhe që lanë vepra, të cilat të tjerët nuk i njohin fare, dhe për këtë shkak, ndihej nevoja që dijetarët t’u kundërvihen dyshimeve të tilla, t’i zbulonin metodat e tyre dhe t’i ndanin të mirat e ndritshme prej ideve të trilluara e të falsifikuara. Dijetarët e tillë të spikatur iu kundërvunë atyre me vepra shkencore e punime të ndryshme islame si në Indi, Afganistan, Pakistan, Malajzi, Afrikë e në vende të tjera. Studimet e tyre ishin të shkëlqyeshme, shkencore, të sakta, të përpikta e precize, sqaronin të

¹ Xhelaludin Es-Sujuti “**Tarihul-Hulefair-Rashidin**”; fq. 194. dhe Mulla Ali El-Kariu “**El-Esrâr El-Merfia**”; fq. 62.

vërtetat dhe i zbulonin trillimet, dhe kështu, në këtë mënyrë dilnin në pah shkencat dhe njohuritë e dobishme, urdhërimet dhe rrëfyesit e ndritshëm.

Vëllai i respektuar, dijetari i spikatur dhe profesori i shkathët dr. Hajredin Hoxha, studioi një vend të rëndësishëm nga vendet myslimane, gjegjësisht vendin e shqiptarëve. Studimi i tij, me të cilin e ka mbrojtur doktoraturën në Shkencat e Shpalljes dhe Trashëgimisë (Studimet kur'anore dhe të Hadithit) në Fakultetin e Shkencave të Shpalljes dhe Shkencave Humane në Universitetin Ndërkombëtar Islamik në Malajzi në vitin 2003, e që titullohet: **“Drejtimit intelektuale dhe fetare në studimet kur'anore të dijetarët shqiptarë në kohën bashkëkohore”**, i hulumton shqiptarët e Gadishullit ballkanik.

Po të merret parasysh fakti se dëshira megjithatë i tejkalon të gjitha barrierat, nga përvoja ime e mëhershme e di se studimi i drejtimeve ka nevojë për punë të lodhshme e të vështirë, ngase vetë u ballafaqova me to, kur shkrova disertacionin tim të magistraturës **“Metoda e shkollës racionale bashkëkohore në tefsir”** e më vonë edhe disertacionin e doktoraturës **“Drejtimit e tefsirit në shekullin XIV”**. Pra nisur nga ky fakt, fare mirë jam i vetëdijshëm dhe e kuptoj lodhjen e madhe që ka përjetuar dhe vështirësitë nëpër të cilat ka kaluar hulumtuesi Hoxha gjatë studimit të drejtimeve intelektuale.

Gjithashtu jam i bindur se hulumtuesi nuk ka kursyer asgjë për të arritur synimin e tij. Ai nuk është përqendruar vetëm në aspektin e tefsirit por e ka trajtuar edhe aspektin historik, gjegjësisht situatën e shqiptarëve gjatë pushtetit osman si dhe gjurmët e tyre para dhe pas pushtimit nga osmanët. Ai poashtu ka zbuluar edhe shumë ngjarje të njohura e të panjohura, të dukshme e të padukshme të Perëndimit në Shqipëri. Shqiptarët dhe ata që jetojnë për rreth tyre ende vazhdojnë t'i përjetojnë konsekuencat e tilla...

Mundi i hulumtuesit meriton çdo lëvdatë, ngase dallohet me besnikëri e sinqeritet, dy cilësi këto që janë cilësi të dijetarëve të këtij Ummeti.

Lus Zotin që studiuesin Hoxha ta shpërblejë për punën e tillë dhe që kjo punë e tij të jetë dobishme dhe në favor të Islamit e muslimanëve në trojet shqiptare në veçanti, si dhe në trojet e mbarë muslimanëve në përgjithësi!

Unë poashtu u bëj apel dijetarëve të Ummetit të të gjitha vendeve që të vazhdojnë këtë rrugë dhe lirisht të merren me studime të përpikta rreth drejtimeve intelektuale në çdo vend, me qëllim që të pastrojnë ambientin e ndotur të muslimanëve dhe të mbarë botës nga trillimet dhe intrigat që janë duke i përjetuar.

Salavatet dhe selami i Zotit gjithnjë qoftë mbi Pejgamberit tonë Muhammedin, Familjen e tij të Pastër dhe të gjithë sahabët e tij!

Prof. Dr. Fehd Abdurrahman Er-Rumi

profesor i Fakultetit të Studimeve Kur'anore
Universiteti i Mbretit Saud
Rijad - Arabia Saudite

Lexues te nderuar !

Kam nderin dhe ndihem i privilegjuar nga Allahun xh.sh. i Cili me mëshirën e Tij te pakufishme me ndihmoi qe ky disertacion i doktoraturës ta sheh dritën e përkthimit dhe te botimit, Atij i takojnë te gjitha falënderimet dhe meritat. Po ju prezantohem me një mund dhe angazhim te pakëputur disa vjeçar, i cili ne fakt ishte inspirim nga Allahu xh.sh. dhe udhëzim nga Ai për t'i shpalosur arkivat e librarive dhe te bibliotekave te ndryshme, për te hasur ne hulumtimet, studimet dhe gjurmimet e dijetareve tanë shqiptare, dhe për t'u njohur për se afërmi me krijimtarinë e tyre letrare dhe fetare, e sidomos me shërbimin e tyre ne mësimin interpretimin, dhe komentimin e Kuranit. Para duarve tuaja kenë disa monografi te disa kokave dhe dijetareve me eminent shqiptare, ku krahas aktiviteteteve te tyre ne fusha te ndryshme; ata ishin edhe komentues dhe interpretues te denje te Kuranit, me drejtime dhe doktrina te ndryshme.

Lexues te nderuar !

Vepra qe po ju prezantohet, krahas tematikes se Tefsirit dhe doktrinave te tij qe është shtjelluar shkencërisht dhe ne detaje, ne kapitullin e pare te kësaj vepre është analizuar edhe historia e jone shqiptare, ajo antike dhe moderne, nga një këndvështrim islam, dhe me sa jam i informuar deri ne momentin kur po shkruhen këto vargje, është një studim i pare i këtij lloji. Me këtë vështrim shkencor te historiografisë sonë shqiptare nga prizma dhe këndvështrimi objektiv fetar islam, nuk kemi pas, e as qe kemi qëllime tendencioze dhe ofenduese ndaj dikujt apo ndaj ndonjë institucioni fetar apo shkencor. Synimi ynë ka qene dhe është qe e vërteta shkencore, fetare dhe ajo historike te del ne shesh, dhe te jete e qarte para publikut shqiptar. Me këtë studim kemi synuar qe t'i kontribuojmë trashëgimisë letrare dhe fetare te shtetit tone te shtrenjte, sovran, tolerant dhe te pavarur, Kosovës. Jemi angazhuar maksimalisht dhe intensivisht te bëjmë një vështrim kritik rrethanave sociale, politike dhe religjioze te trojeve tona shqiptare ne Ballkan, duke u bazuar dhe shfrytëzuar një sere literature dhe referenca ne gjuhe te ndryshme, e ne radhe te pare ato shqipe. Prandaj, o lexues i nderuar te jesh i bindur se çdo shënim historik ne këtë vepër, e ka burimin e shënuar ne fusnota, dhe asgjë nga hamendja jone nuk është shënuar apo e ilustruar.

Lexues te nderuar !

Kjo hyrje e rëndësishme me tematike dhe karakter historik, konsiderohet si baze për ta kuptuar realitetin dhe historikun e doktrinave dhe rrymave te Tefsirit ne trojet tona, sepse ato rryma dhe ato doktrina janë te lidhura ngushte me historinë tone, prandaj kjo qasje historike e nuk është dalje nga tema e disertacionit tone. Jam optimist dhe shpresoj bindshëm ne Allahun xh.sh. qe këto

monografi te jene dhe te shërbejnë si udhëzues dhe planprogram shkollor fetar, te nivelit mesëm dhe atij universitar, për shokët e mi, imamët neper xhamia, profesorët ne medrese apo ne fakultet, te cilët merren me komentimin e Kuranit, metodologjinë dhe historikun e tefsirit dhe te mufesireve ne trojet tona shqiptare.

Ne fund lus Allahun Fuqiplote qe kjo vepër te jetë për hir te Tij, dhe shpërblimi i kësaj vepre te jetë i ruajtur për atë dite kur nuk do te këtë dobi as nga pasuria e as nga familja, përpos nga sinqeriteti dhe devotshmëria jone. Ndërsa atyre vëllezërve, kolegeve dhe shokëve te mi te ndershëm dhe te sinqerte, qe flijuan kohen dhe mundin e tyre shkencërisht dhe financiarisht, ne radhe te pare; Haxhi Dato Tengku Uzir nga Malajzia, Haxhi Adem Kallkani nga Stambolli (me prejardhje nga Tetova), Shejh, prof.Dr.Zekerija Bajrami, dhe përkthyesin e veprës prof.Muhamed Mustafa...atyre u jam mirënjohës dhe falënderues me zemër dhe Allahu xh.sh. me xhenetin Firdeus i shpërbleftë...Amin

Prof.Dr.Hfz.Hajredin Hoxha,

Taibah University, Medine, Arabia Saudite.

E Mërkurë, me 11.03.2009 – 14 Rebiul Evel 1430

الباب الأول

الأراضي الألبانية سياسياً و دينياً في العصر الحديث

PJESA E PARË

**TOKAT SHQIPTARE NGA ASPEKTI POLITIK
DHE FETAR NË KOHËN BASHKËKOHORE**

KAPITULLI I PARË

ARSYET E ZGJEDHJES SË HULUMTIMIT, PROBLEMATIKAT, ÇËSHTJET, RËNDËSIA, STUDIMET E MËHERSHME DHE METODAT E PUNËS

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Parathënje:

Bismil-lahir-Rahmanir-Rahim!

(Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!)

Falënderojmë Zotin e Madhërishëm, në Të mbështetemi, prej Tij kërkojmë udhëzim dhe prej Tij kërkojmë të na mbrojmë nga veset dhe veprat tona të këqija. Atë që e udhëzon Zoti askush s'mund ta devijojë, dhe atë që e devijon askush s'mund ta udhëzojë e as ta orientojë përveç Tij. Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Tij dhe Ai është Një i pashoq, si dhe dëshmoj se Muhammedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është robi, i afërmi, i zgjedhuri dhe i dashuri i Tij. Salavatet më të përzemërta ia dërgoj krijesës më të vlefshme pejgamberit tonë, Muhammedit, gjithashtu salavat dërgoj edhe mbi Familjen e tij të ndershme, mbi shokët e tij të pastër e të mirë dhe mbi pasardhësit e tyre deri në Ditën e Gjykimit. Ai ua sqaronte shokëve të vet (sahabëve) Kur'anin Fisnik dhe çdokush që e ka respektuar është udhëzuar e në të kundërtën, është shkatërruar.

Të nderuar lexues!

Përpunimi i lëndës së tefsirit të Librit të Zotit të Madhërishëm konsiderohet në përgjithësi si një ndër lëndët më të respektuara. Dijetarët kanë dhënë kontribut tejet të madh në të shkuarën dhe në të tashmen, si dhe akoma vazhdojnë të kontribuojnë në sqarimin e kuptimeve të Kur'anit Fisnik, qëllimeve dhe të fjalëve të tij, ngase Kur'ani ngërthen në vete mrekulli të pakufishme dhe të përhershme, derisa të ketë jetë në sipërfaqe të tokës, meqë konsiderohet si deti i pafund...

Kur'ani, si asnjë libër tjetër, ngaherë ka qenë në qendër të vëmendjes dhe vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite, ndaj dhe për këtë shkak është edhe mrekulli. Askush nuk mund të shtojë e as të pakësojë në

të diçka, ngase ka zbritur nga Zoti i botëve përmes Shpirtit Fisnik (Xhibrilit) në zemrën e robit dhe Pejgamberit të Tij, në gjuhën e pastër arabe.

Të gjitha përpjekjet për nxënien e tij përmendësh, për komentimet, për sqarimet terminologjike dhe për zbulimin e kuptimeve të Kur'anit, për ta shkruar e për ta mësuar si dhe premtimi i Zotit për mbrojtjen e tij, mjaft qartë e argumentojnë mrekullinë e tij në çdo vend dhe çdo kohë. Në këtë kontekst Zoti i Madhërishëm thotë:

([الحجر : 9] ﴿ حَافِظُونَ لَهُ، وَإِنَّا الذِّكْرَ نَزَّلْنَا حُنًى ۖ إِنَّا ﴾)

"Ne e zbritëm Kur'anin dhe Ne e mbrojmë atë." ²

Shumë dijetarë dhe ekspertë të mëdhenj janë dalluar në këtë lëmi, si në të shkruarën ashtu edhe sot,³ duke e kaluar tërë jetën në shërbim të Kur'anit Fisnik nga aspekti i hulumtimit, sqarimit, leximit dhe formimit të shkollave në viset e ndryshme të botës islame e gjetiu, gjithë kjo e nxitur nga imani (besimi) në Zotin e Madhërishëm dhe nga dashuria ndaj Librit të Tij që e ka dërguar si mëshirë, udhërrëfyes dhe dritë për mbarë botën, si dhe për mbrojtjen e trashëgimisë dhe qytetërimit islam, dhe kështu, në këtë mënyrë deri diku ta kryejnë borxhin ndaj mesazhit hyjnor dhe ndaj njerëzimit në përgjithësi. Në këtë kontekst orientalisti J. J. G. Jansen thotë: "*Madje edhe kaligrafët dhe mjeshtrit e dizajnit e kanë kaluar tërë jetën e tyre në shërbim të këtij Kur'ani...*"⁴

Duke marrë parasysh faktin se dijetarët shqiptarë në këtë lëmë kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm anembanë tokave etnike shqiptare⁵, e ndjeva për obligim që njerëz si unë të hulumtojnë, të studiojnë e të shpalosin përpjekjet e tyre të tilla nëpër libra e dorëshkrime në të gjitha fushat e ndryshme fetare islame,⁶ të cilat ende edhe sot e kësaj

² El-Hixhr: 9.

³ Ky është realitet, sepse nëse hyn në çdo bibliotekë të botës do të gjelesh qindra libra, punime e traktate mbi të vërtetat e Kur'anit, fshehtësitë dhe mrekullitë e tij, qoftë nga autorë muslimanë apo jomuslimanë.

⁴ J. J. Jansen "**The Qoran interpretation in Modern Egypt**"; E.J.Brill Leiden, 1980.

⁵ Shih librin e rëndësishëm në këtë lëmi të shkruar nga orientalisti i njohur shqiptar prof. dr. Hasan Kaleshi, "**Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame**"; Nexhat Ibrahim dhe Miftar Ajdini, International Organization of Student Federation, 1st- ed., 1992, Riyad, Saudi Arabia.

⁶ Shih studimet e historianit shqiptar prof. dr. Muhamed Mufaku-Arnauti në veprat e tij: "**Kultura shqiptare në alfabetin arab**" dhe "**Pasqyrime arabo-islame në letërsinë shqiptare**" si dhe veprat e tjera që do t'i theksojmë më tej në këtë libër.

dite, bibliotekat osmane në Turqi dhe në vendet tjera janë të përmbushura me veprat e tyre.

Kjo çështje kërkon që t'i ndriçojmë punimet e tyre shkencore të përpiluara në ato rrethana historike, shoqërore e fetare kur edhe vepruan. Një hulumtim i tillë s'do mend që na ofron me ta, na ndriçon të kuptojmë se si ata jetuan sipas parimeve të fesë së pastër, sipas Litarit të fortë të Zotit, duke mos rënë prë dhe viktimë e drejtimeve shkatërruese që ekzistonin në terrene të tilla, duke filluar që nga kolonializmi, ateizmi, komunizmi dhe fuqitë e mëdha botërore joislame, vetëm e vetëm për ta mbrojtur pasurinë dhe kulturën e tyre të shëndoshë fetare.⁷

Dijetarët e tillë qëndruan stoikë dhe fare pa u lëkundur e mbrojtën fenë dhe Kur'anin, duke e mësuar atë përmendësh, duke mësuar leximin, sqarimin dhe tefsirin e tij, kuptohet aq sa kishin mundësi për nxënien e këtyre dijeve, kur kihet parasysh fakti se ata, megjithatë ishin njerëz që jetonin në rrethana tejet të vështira dhe të ashpra, duke u përballur me vështirësi të mëdha që lirisht mund të krahasohen me vështirësitë e disa dijetarëve reformistë në kohën bashkëkohore në disa vende arabe.⁸

Këta dijetarë shqiptarë ishin shembull tipik i durimit, qëndresës dhe mbrojtjes së identitetit fetar me këmbëngulje, përkundër përjetimit të mynxyrave nga më të ndryshmet dhe presionit politik, si dhe tiranisë së vazhdueshme që i ekspozoheshin në vendet ku ata jetonin në Ballkan.

Falënderimi i qoftë Zotit të Madhërishëm pambarim, meqë historia e popullit shqiptarë, qysh nga periudhat e mëhershme ka qenë përplot ngjarje, zhvillime e ndryshime politike dhe fetare,⁹ duke filluar nga periudha romake, bizantine, osmane e deri në periudhën komuniste, ndaj

⁷ Muhamed Mufaku-Arnauti, **“Çështja fetare në Shqipëri”**; Kuvajt, revista **El-Arabij**, 1978, f. 78; dhe **“Kultura shqiptare në alfabetin arab”**, f. 75.

⁸ Në studimin tonë të lëvizjes dhe të drejtimeve të tefsirit në botën arabe gjejmë se të njëjtat ballafaqime dhe kushte i kanë përjetuar edhe Muslimanet e Ballkanit, posaçërisht shqiptarët e Shqipërisë. Rrethanat e tyre, gjegjësisht ballafaqimet e tyre kishin të bënin me muslimanët e Gadishullit të Ballkanit rreth grindjes me të huajt, çështjes së sistemit pushtetar, qëndrimit ndaj halifatit osman, emigrimit të tyre në shtetet fqinje për shkaqe sigurie dhe fetare etj. Shih më hollësisht dy punimet e profesorëve të nderuar:

A- Fikret Karçiç, **“The Bosniaks and the challenges of modernity-Late Ottoman and Habsburg times”**; El-Kalem, f. 15, 97-98, Sarajevë 1999.

B- If-fet Muhamed Sherkavi, **“Mendimi fetar përballë sfidës moderne, studim analitik i drejtimeve të tefsirit në kohën bashkëkohore”**; Darul-Arabij, botim i dytë, f. 191, Bejrut 1979.

⁹ Prof. dr. Muhamed Mufaku-Arnauti, historian dhe letrar, është me origjinë shqiptare i cili jeton dhe vepron në botën arabe, thotë: "Shqiptarët janë populli i vetëm evropian që e pranuan Islamin me shumicë". Shih: **“Kultura shqiptare në alfabetin arab”**; Kuvajt, vëll. 1, 1983, f. 7, (revistë kombëtare, artistike dhe letrare).

nisur nga kjo, e pamë të rëndësishme që ta studiojmë historinë e tefsirit të Kur'anit Fisnik në këto treva, lëvizjet dhe zhvillimet e kësaj shkence, t'i njohim qëndrimet e dijetarëve shqiptarë në ballafaqimet e tilla si dhe t'i kuptojmë drejtimit intelektuale që vërehen nëpër studimet e tyre kur'anore.

Ata vërtetë kishin përfituar dobi nga teksti kur'anor: *"i bujshëm, ripërtëritës dhe i pasur, por drejtimit e ndryshme që u formuan nuk ishin nga teksti kur'anor"*,¹⁰ përkundrazi, ata ishin rezultat i kooperimit të tyre me Kur'anin Fisnik konform rrethanave në të cilat jetonin dhe kulturave shkencore që i kishin përfituar nga trashëgimia arabe, osmane dhe ajo perse.

Në mesin e shqiptarëve të tillë u formuan dijetarë të singertë dhe kontribues në rrugën e Zotit, që flijonin çdo gjë në emër të mbrojtjes së identitetit fetar islam dhe atij kombëtar, ngase çështja kishte të bëjë me ekzistimin e identitetit islam përballë kolonializmit të huaj ose zhbërja e tij në çdo aspekt. Kjo karakteristikë, gjegjësisht kjo specifikë e lidhjes dhe unifikimit të çështjeve fetare dhe kombëtare konsiderohet një ndër karakteristikat dhe tiparet më të mëdha në studimet e hershme e të sotshme fetare shqiptare. Nuk mund të hulumtohen dijetarët e tillë të mëdhenj pa mos e diskutuar ose theksuar edhe lidhjen e pandashme në mes të fesë dhe vatanit. Lexuesite huaj nuk duhet të habiten e as të mohojnë karakteristikën e tillë të tyre, ngase ata janë njerëz që janë rritur e zhvilluar në një botëkuptim që ishte rezultat i rrethanave të atëhershme fetare, politike, shoqërore dhe ekonomike. Kjo rrymë ishte rezultat i kundërveprimit ndaj politikave botërore që vepronin në dëm të tyre. Dijetarët shqiptarë-muslimanë kishin rënë aq shumë nën ndikimin e këtyre rrethanave, saqë nuk mund të bënin dallimin në mes rëndësisë së mbrojtjes së fesë dhe mbrojtjes së vatanit.

Lus Zotin e Madhërishëm që të më bëjë të qëndrueshëm në fjalë e vepra, që të jem larg fjalëve të këqija si dhe të më mundësojë një ekspozë dhe analizë të suksesshme të këtij studimi sa të vështirë aq edhe të ndjeshëm. Duke pasur parasysh mungesën e literaturës së duhur në bibliotekën tonë të Universitetit Ndërkombëtar Islamik në Malajzi, s'do mend se do ta kem vështirë që të shkruaj me një precizitet të plotë, pa mos udhëtuar në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Turqi, madje edhe në Bosnjë e Hercegovinë, për të hulumtuar literaturën e nevojshme, që të jem sa më i

¹⁰ Kështu thotë If-fet Muhamed Sherhavi në veprën e tij, **"Mendimi fetar përballë kohës bashkëkohore"**, f. 13.

suksesshëm në këtë disertacion, si dhe për të kontribuar në aspektin shkencor, fetar, shoqëror e kombëtar.

Ky studim për momentin është i pari që ka të bëjë me hulumtime nga aspekti dhe këndvështrimi islam, dhe padyshim një gjë e tillë nuk ka për t'ju pëlqyer komunistëve, ateistëve dhe marksistëve shqiptarë apo edhe bashkëmendimtarëve të tyre të tjerë.

Lus Zotin e Madhërishtëm që të më ndihmojë në këtë detyrë fetare e akademike, ngase padyshim Ai është Ndihmuesi dhe Përkrahësi më i mirë!

PROBLEMATIKA E HULUMTIMIT

Problematika e këtij studimi ka të bëjë me faktin se zhvillimet kulturore dhe ideologjike të dijetarëve muslimanë në Shqipëri akoma vazhdojnë të studiohen nga shumë dijetarë të shkencave të ndryshme, qofshin ata muslimanë apo jomuslimanë, posaçërisht mbi rrymat ideologjike dhe fetare që u paraqitën në studimet e dijetarëve shqiptarë. Disa studime të tilla kishin të bënin me lëndët e sufizmit, shiizmit dhe të orientalizmit, veçanërisht nga ana e disa dijetarëve bashkëkohorë. Studiuesit e tillë nuk janë marrë me hulumtimin e studimeve kur'anore, konkretisht me shkencën e tefsirit, ngase atë e trajtonin nga një aspekt tjetër të trashëgimisë shqiptare.

Ky hulumtim ka të bëjë me studimin e rrymave dhe doktrinaeve më të rëndësishme intelektuale e fetare që janë shfaqur gjatë studimeve kur'anore të pahulumtuara. Ky hulumtim po ashtu ka për qëllim që të ndriçojë jetën fetare dhe kulturën islame shqiptare që ka ekzistuar shekuj me radhë, gjithnjë duke u mbështetur në librat dhe veprat e ndryshme, ligjëratat dhe hutbet e dijetarëve shqiptarëve bashkëkohorë.

Në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, konkretisht në kohën e Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912, u formuan drejtime të reja në fushën e studimeve kur'anore për shkak të simbiozës së diturive që i kishin përfituar dijetarët shqiptarë muslimanë nëpër vendet e ndryshme islame dhe arabe. Ata jetuan me popuj që kishin kultura dhe vlera të ndryshme, dhe ishte më se normale të bien nën ndikimin e tyre, ashtu sikur edhe vetë ata më pas do të ndikojnë tek të tjerët. Shoqëria shqiptare muslimane, nën ndikime të tilla, filloi të reflektojë gjurmët e qytetërimeve dhe kulturave që ekzistonin në shtetet e Lindjes së Mesme¹¹

¹¹ Shtetet e tilla ishin Egjipti, Siria, Algjeri dhe Gadishulli Indian.

përballë sfidave me të cilat ballafaqohet shoqëria shqiptare muslimane¹² në kohën bashkëkohore.

Ky hulumtim, po ashtu do të përqëndrohet në drejtimit dhe rrymat më të rëndësishme që ekzistojnë, duke u mbështetur në shembuj konkretë si dhe do të vlerësojë disa çështje me rëndësi të madhe në veçanti, ngase nuk kemi mundësi të merremi me të gjitha çështjet në përgjithësi.

Cilat janë pikat kryesore të këtij hulumtimi?

Hulumtuesi do të përpiqet që të japë përgjigje në pikat vijuese:

1. Cilat ishin sfidat më të rëndësishme me të cilat u ballafaquan dijetarët shqiptarë në kohën bashkëkohore?;
2. Cili ishte kontributi i dijetarëve muslimanë në shërbim të Kur'anit?;
3. Sa kishin rënë në ndikimin e shkollave doktrinale dhe fetare që ekzistojnë në Lindjen e Mesme?;
4. Cilat janë drejtimit më të rëndësishme intelektuale dhe fetare që vëreheshin në studimet kur'anore të dijetarëve shqiptarë?; dhe:
5. Sa e kuptonin komentuesit shqiptarë thesarin e teksteve kur'anore dhe horizontet e tyre që ekzistojnë në duart e tyre?

RËNDËSIA E STUDIMIT

Sa i përket rëndësisë së këtij studimi, mund të them se konsiderohet fillimi i një koncepti më të gjërë dhe më të plotë të drejtimeve, lëvizjeve dhe zhvillimeve të tefsirit në tokat mbarëshqiptare. Po ashtu vlen të theksohet se një studim i tillë nuk ekziston as në bibliotekat arabe e as në ato joarabe,¹³ përpos botimit të disa punimeve bashkëkohore të shkurtra që kanë të bëjnë me raportet politike e shoqërore mbi lëvizjet e fesë dhe teologëve në territoret shqiptare si dhe mbi çështjen se shqiptarët muslimanë a paraqisnin rrezik në këto vende. Po ashtu, ndihet nevoja e studimit të faktorëve të brendshëm dhe atyre të jashtëm që ndihmonin në formimin dhe në zhvillimin e drejtimeve të tilla

¹² Në ballafaqimet e tyre ishin: Çështja e emigrimit dhe braktisja e vatanit në favor të kolonizatorit, çështja e largimit nga përdorimi i alfabetit arab në gjuhën shqipe për ta zëvendësuar atë me alfabetin latin, çështja e pushtetarëve të huaj, çështja e bashkimit të shqiptarëve muslimanë dhe jomuslimanë përballë armikut të përbashkët dhe çështje tjera që insha'Allah do t'i shohim më vonë gjatë këtij hulumtimi!

¹³ Kam për qëllim; studimi i drejtimeve të tefsirit, studimet kur'anore dhe intelekti fetar kur'anor të shqiptarët, ndërsa studimet politike e historike nga aspekti perëndimor orientalist dhe ai shqiptar ateist marksisto-komunist janë të shumta.

në territorin e Shqipërisë, që dallon për shumëçka nga shtetet e tjera të Ballkanit,¹⁴ posaçërisht kur dihet fakti që halifati osman ka dominuar një kohë bukur të gjatë në këtë vend ballkanik, duke lënë gjurmë të dukshme islame deri në ditët e sotshme, edhe pse mjaft gjurmë, fatkeqësisht u shkatërruan nga komunistët laikë gjatë gjysmës së dytë të shek. XX.

Këtu ekziston edhe një pikë e rëndësishme që ka të bëjë me faktin se shumë vëllezër, studentë apo profesorë të respektuar nuk kanë ndonjë studim të tillë, ashtu siç nuk kanë edhe literaturë të nevojshme që mund t'ju ndihmojë dhe t'ju vryejë në studimin, hulumtimin dhe kuptimin e drejtimeve të tefsirit të dijetarët tanë shqiptarë.

Përveç kësaj, jam i bindur se një studim i tillë shkencor, s'do mend se do ta pasurojë kulturën e studiuesit mysliman në përgjithësi, kulturën e atyre studentëve dhe profesorëve që mirren me shkencën dhe studimin e tefsirit në veçanti, si dhe do t'ua ngritë nivelin e tyre shkencor dhe akademik.

STUDIMET E MËHERSHME

Në bazë të njohurive që disponoj, dhe në bazë të kontrollimit të literaturës së përdorur nëpër punime të ndryshme universitare vendore dhe ndërkombëtare, nuk kam hasur në ndonjë studim që ka të bëjë me shkollat e tefsirit të dijetarët shqiptarë, dhe në këtë kontekst mund të thuhet se ky studim është i pari i këtij lloji që përmbledh në vete në tërësi lëmin e tefsirit.

Edhe sot e kësaj dite me vëmendje të plotë kujdesem dhe ndjek çdo vepër të re që botohet në vendin tim dhe në vendet e tjera, qoftë nëpërmjet vëllezërve tonë që udhëtojnë në vendin tim, qoftë nëpërmjet lidhjeve telefonike e letrave elektronike me shokët e mi shkrimtarë dhe hoxhallarë që vazhdojnë t'i mbajë në kontinuitet.

¹⁴ Ndër arsyet kryesore janë dy: **1):** Përqindja e muslimanëve aty është më e madhe dhe arrin në shifrën mbi 70%; dhe **2):** Shteti shqiptar komunist ka deklaruar haptazi edhe zyrtarisht ateizmin dhe laicizmin nga viti 1967 deri në vitin 1991, ndaj dhe për këtë konsiderohet edhe shteti i parë ateist në botë, duke mos u dalluar nga shteti kinez ku ishin ndaluar aktivitetet fetare gjatë viteve 1955-1977. Më gjerësisht shih: Nathalie Clayer, **“Islam State and Society in post-communist Albania”**, at: **“Muslim Identity and the Balkan State”**; 115-138; Hugh Pullton, Taji Suha Faruki, **“Muslim identity and the Balkan State”**; editors, Hurst & Company London, 1997, f. 115.

Ç'është e vërteta, studimet e mëhershme që i kam hasur ishin të mangëta dhe margjinale, dhe kishin të bënin vetëm me disa personalitete shqiptare që merreshin me shkencën e tefsirit, por edhe studimet e tilla të pjesshme, megjithatë ishin të rëndësishme për mua, ngase kishin të bënin pikërisht me temën e hulumtimit tim. Edhe pse studimet e tilla ishin të pakta, ato për mua kishin rëndësi të madhe nga aspekti bibliografik. Atë që e kam lexuar gjer më tani, mund të klasifikohet në këto aspekte:

1. Studime historike-aspekti historik:

Falënderoj Zotin e Madhërishëm që pata mundësi të gjej disa studime tejet të rëndësishme, të cilat u bënë ndihmesa ime më e madhe për hulumtimin tim dhe kësisoji më trasuan rrugën për studime tjera. Në krye të studimeve të tilla, sipas mendimit tim, janë studimet e prof. dr. Muhamed Mufakut-Arnautit,¹⁵ i cili ka dhënë kontribut të madh në mënyrë të vazhdueshme pa ndërprerë për t'i shërbyer fesë islame, vatanit, letërsisë dhe trashëgimisë shqiptare, Zoti e shpërbleftë për kontributin e tij të jashtëzakonshëm dhe jam mirënjohës i denjë për punën që bën!

Në hyrjen e studimit të tij historik "Kultura shqiptare në alfabetin arab"; ai thekson marrëdhëniet e forta historike në mes të shqiptarëve dhe arabëve përgjatë shekujve, si dhe ndikimin e madh të shqiptarëve në halifatin osman, kjo, ngase ata (shqiptarët) kishin marrëdhënie të afërta me sulltanët e familjes osmane dhe gëzonin pozita të larta udhëheqëse në strukturat e tyre shtetërore për shkak të trimërive të rralla që shqiptarët i posedonin. Nga studimi i profesorit të sipërpërmendur vërejmë se ndikimi

¹⁵ Prof. dr. Muhamed Mufaku-Arnauti u lind në Damask në një familje që kishte emigruar nga ish-Jugosllavia, përkatësisht Kosova. Diplomoi për Gjuhë dhe Letërsi Arabe në Universitetin e Damaskut-Siri. Po aty mori titullin magjistër i historisë, kurse doktoroi për Letërsinë Komparative në Universitetin e Prishtinës në Kosovë, ish-Jugosllavi në vitin 1980, ku edhe punoi në Fakultetin e Orientalistikës. Ai ka shkruar dhjetëra studime dhe hulumtime rreth çështjeve arabo-jugosllave, si p.sh. **"Pjesë nga poezia shqiptare bashkëkohore"**; botuar në Damask në vitin 1981; **"Studime mbi Islamin në Ballkan"**; botuar në Bejrut në vitin 1983. Ai përktheu prozë dhe poezi të qindra poetëve dhe shkrimtarëve arabë, nga gjuha arabe në gjuhën shqipe dhe serbokroate. Ai përpiloi librin **"Kultura shqiptare në alfabetin arab"**; botuar në Kuvajt në vitin 1983; **"Islami në Jugosllavi nga Beogradi në Sarajevë"**; botuar në Aman-Jordani, "Darul-Beshir", bot. 1, 1991; **"Pasqyrime arabo-islame në letërsinë shqiptare"**; botuar në Kuvajt. Ai po ashtu ka një artikull me titull **"Çështja fetare në Shqipëri"**; (revista El-Arabij), Kuvajt 1978 etj. Profesori i nderuar aktualisht punon si ligjërues i historisë në Universitetin **"Alul-Bejt"** në Jordani, Zoti e shpërbleftë për kontributin që jep!

shqiptar islam kishte arritur deri në vendet arabe, si p.sh. në Egjipt, Siri, Palestinë, Jemen, Algjeri, Tunizi etj. duke lënë pas vetes gjurmë të mira dhe vepra humane të përhershme që akoma vazhdojnë të ekzistojnë edhe sot e kësaj dite.¹⁶

Autori po ashtu thekson luftën e shqiptarëve në mbrojtje të identitetit islam, përkatësisht kundër kolonializmit të huaj në Shqipëri, si dhe e trajton edhe çështjen e alfabetit arab, përkatësisht qëndrimet e dijetarëve shqiptarë muslimanë që mbronin opinionin kundër fenomenit të braktisjes së shkronjave arabe dhe zëvendësimit të tyre me shkronjat latine.¹⁷

"Çështja e ndryshimit të shkronjave ishte hapi i parë i shteteve të mëdha kolonialiste për t'i shkëputur lidhjet e shqiptarëve me Perandorinë Osmane dhe vërtetë, më 22 nëntor 1913 Shteti Shqiptar (ligji i përkohshëm i administratës civile në Shqipëri) proklamoi ndarjen e çështjeve civile nga Sheriati islam dhe ndarjen e autoriteteve islame në Shqipëri nga Shejhul- Islami".¹⁸

Dhe nuk ka asnjë fije dyshimi se kjo çështje shkaktoi mjaft jehonë dhe ndikoi që dijetarët e atëhershëm të reagojnë. Ne, insha'Allah më tej, në këtë libër, përkatësisht hulumtim timin, do t'i theksojmë edhe këto reagime të tyre.

Një nga studimet e tjera historike të prof. dr. Muhamed Mufakut-Arnautit është edhe vepra mbi historinë islame të Beogradit me titull: "Islami në Jugosllavi nga Beogradi në Sarajevë";¹⁹ ku përpiket që të ndriçoj aspektet e ndritshme të historisë islame të qytetit të Beogradit, i cili akoma zë një vend të rëndësishëm, falë pozitës gjeostrategjike, përkatësisht për shkak të pozitës si portë e Ballkanit, ngase gjendet në mes të Ballkanit dhe Perëndimit, gjegjësisht nga Lindja në Perëndim dhe anasjelltas, si dhe fakti se në kohërat e kaluara ishte vend ku u zhvilluan konfrontime në mes fuqive të mëdha, gjegjësisht në mes Perandorisë Romake dhe asaj Bizantine. Rëndësia gjeostrategjike e Beogradit u vërejt qartë, qysh kur ra në duart e osmanlinjve në vitin 1521 dhe kur u shndërrua nga fortifikatë e krishterë, në qendër të xhihadit, nga ku osmanlinjtë vazhduan depërtimin e tyre në vendet e tjera evropiane.²⁰

¹⁶ Shih: **"Kultura shqiptare në alfabetin arab"**; f. 11-37.

¹⁷ Po aty, f. 73.

¹⁸ Po aty, f. 73-75.

¹⁹ Dr. Muhamed Mufaku-Arnauti, **"Islami në Jugosllavi nga Beogradi në Sarajevë"**; Aman, "Darul-Beshir", bot. I, f. 11.

²⁰ Po aty, f. 11.

Ashtu siç theksuam edhe më sipër, ne këtu nuk kemi ndërmend t'i vlerësojmë qëndrimet e autorit, por ai, megjithatë, ka të drejtë kur flet për një çështje shumë të rëndësishme në lidhje me arabët, të cilët nuk i kushtojnë rëndësi në mediat e tyre rrëth këtij aspekt të ndritshëm qytetërues islam të Beogradit gjatë viteve të fundit, ashtu sikundër që informonin gjatë viteve të pesëdhjeta e gjashtëdhjeta mbi ngjarjet dhe ndodhitë e ndryshme që ndodhnin në Jugosllavinë e atëhershme nëpër gazeta, revista e libra arabe. Sipas autorit, arsyet e mungesës së informimit të tillë arab rreth këtij aspekti qytetërues janë të panjohura.²¹

Ai thekson se gjatë pushtetit osman në Beograd ka pasur 270 xhami, mesxhide e mihrabe, gjithnjë duke u bazuar në informatat e historianit osman, përkatësisht udhëpërshkruesit Evlija Çelebiut.²² Autori kritikon disa autorë arabë që shkruajnë për ish-Jugosllavinë, duke mos e vënë në pah këtë aspekt islam të Beogradit, por duke theksuar vetëm një xhami pa i dhënë një vështrim trashëgimisë së tij lindore, qoftë madje kjo edhe në disa rreshta.²³

Nga studimet e vlefshme historike mbi Ballkanin dhe muslimanët në Jugosllavinë e hershme në përgjithësi dhe mbi Kosovën e Bosnjën në veçanti, është edhe studimi i prof. Abdullah Smajiçit me titull: "Përleshja në Jugosllavi dhe ardhmëria e muslimanëve".²⁴ Autori e shkroi këtë vepër gjatë luftës në Bosnjë, duke u mbështetur në zhvillimet dhe përjetimet e tij të drejtpërdrejta të kurtheve perëndimore për shfarosjen e muslimanëve nga ky vend evropian. Në këtë kontekst ai thotë: *"Kriza politike dhe fetare në Bosnjë ka krijuar dy vizione të kundërta: Vizionin perëndimor dhe vizionin islam. Sipas evropianëve tragjedia boshnjake konsiderohet tragjedi njerëzore, ndërsa sipas vizionit islam që dallon tërësisht nga ai evropian e që ta rrënoqeth trupin, konsiderohet përleshje e pastër fetare kundër Islamit dhe muslimanëve në Evropë"*.²⁵

Në këtë studim mjaft të rëndësishëm historik mbi Jugosllavinë, autori zbulon disa projekte serbe dhe dokumenta të fshehta që argumentojnë planin serb për t'i shfarosur muslimanët shqiptarë nga Kosova dhe Bosnja, si dhe pakicat e tjera muslimane, që datojnë qysh nga

²¹ Po aty f. 12.

²² Po aty, f. 34.

²³ Po aty f. 12.

²⁴ Abdullah Smajiç, *"As Sira'u fi Jugoslafia ve mustakbalul muslimijne"*; Pakistan, Instituti i Studimeve Politike; përktheu Saib Alavi, bot.1,1992.

²⁵ Po aty, f. 14 (në përkthim të lirë).

koha e presidentit të vdekur Tito,²⁶ në mes viteve 1945-1980 dhe viteve pas vdekjes së presidentit, pra, nga viti 1980 deri më 1992.²⁷ Nëse e kemi parasysh gjendjen e tillë historike të muslimanëve shqiptarë dhe boshnjakë në Jugosllavi, në këtë rast do të kemi një pasqyrim më të plotë dhe do ta vërejmë mjaft qartë konfrontimin e tyre të ashpër me armiqët e tyre, për ta mbrojtur identitetin e tyre të shenjtë islam. Për ta sqaruar më tepër këtë çështje dhe për të zbuluar edhe një të vërtetë tjetër, këtu do të theksojmë një kurth prej shumë kurtheve serbe²⁸ që përgatitnin kundër muslimanëve qysh nga lashtësia e deri në ditët e sotshme:

Revista "El-Bejan" që ka tematikë islame, thekson fjalën e ish presidentit të burgosur serb, Slobodan Millosheviq që në fjalimin e tij të famshëm të mbajtur në Fushë-Kosovë, në manifestimin e 600 vjetorit të Betejës së njohur të Kosovës (Betejë kjo, ku serbët pësuan disfatë nga ushtria osmane) kur u drejtohet serbëve duke thënë, se: *"Beteja e Kosovës filloi para gjashtë shekujsh dhe përfundoi sot, e ne jemi gati të flijojmë treqind mijë luftëtarë serbë për ta shkukur Islamin nga Sarajeva deri në Mekë"*.²⁹

Autori i sipërpërmendur Abdullah Smajiç thekson edhe një pikë të rëndësishme në studimin e tij, dhe që ka të bëjë me përpjekjen për të zbuluar rrënjët e vërteta të problemit të përleshjeve në mes të muslimanëve shqiptarë e boshnjakë dhe serbëve, duke u munduar që t'i jep të gjitha opsionet dhe arsyet e konfliktit të tillë, duke u nisur nga rrënjët historike deri në zhvillimet aktuale. Shqiptarët dhe boshnjakët ishin krejtësisht të izoluar nga bota islame për shkak të pozitës së tyre gjeografike në mes të Evropës laike dhe kjo është një pengesë e madhe

²⁶Atë, presidenti i Egjiptit Xhemal Abdul-Naser e ka pyetur se a është e vërtetë se ti i mundon dhe torturon muslimanët, kurse ai i është përgjigjur: "S'ka muslimanë në Jugosllavi, ata nuk janë komb"; dhe të dy pajtohen e bien dakord se feja s'mund të jetë komb në vete! "Muslimanët tanë janë serbë të konvertuar në islam gjatë pushtetit osman"-i përgjigjet Tito!! Shih: **"Bosnja dhe Hercegovina, të vërteta dhe numra"**; f. 32. Në kategorikisht refuzojmë fjalët e Titos, ngase kjo në asnjë mënyrë nuk është e vërtetë. Historia shqiptare i përgënjeshtroi thëniet e tij, ngase shqiptarët muslimanë në Jugosllavi nuk janë serbë, por kanë prejardhje Ilire. Nuk dua të hyj më thellë në këtë kritikë, por vetëm e theksova me qëllim që t'ia tërheq vërejtjen lexuesit.

²⁷Po aty f. 14.

²⁸Mbi rolin e orientalistëve serbë për arsyetimin e vrasjeve dhe masakrimin e muslimanëve të Ballkanit, shih: Norman Cigar, **"The role of Serbian orientalists in justification of genocide against Muslims of the Balkans"**; Logos-A, Prishtinë 2003, 61-100.

²⁹Safvet Vasfi, **"Mjerimi i muslimanëve të Kosovës dhe obligimi ynë ndaj tyre"**; (Revista "El-Bejan"; revistë islame mujore, nr. 138, qershor 1994, London, f. 72).

dhe e rrezikshme për të ndërmarrë ndonjë proces shpëtimi në të tashmen apo edhe në të ardhmen në territoret e tyre.³⁰

Nga studimet fetare dhe historike mbi zhvillimin e kulturës islame tek shqiptarët gjatë shekullit XX është edhe vepra e Dr. Ramiz Zekajt me titull: "Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX"; vepër kjo, ku autori jep një pasqyrë dhe analizë të përgjithshme mbi lëvizjen e kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX, dhe nuk ka asnjë fije dyshimi se vepra e tij ka plotësuar një zbrazëti të madhe në bibliotekën tonë islame, dhe i ka bërë një shërbim të madh lexuesit dhe intelektualit shqiptar dhe atij arab. Mund të themi se studimi i Dr. Ramiz Zekajt konsiderohet një enciklopedi e shkurtër për shumë studiuesë shqiptarë dhe udhërrëfyes islam, për të fituar njohuri të shpejta mbi gjurmët islame historike në territoret mbarëshqiptare. Siç kuptohet nga vetë titulli i librit, autori në këtë vepër flet për kulturën islame shqiptare dhe zhvillimin e saj në periudha, pa u përqëndruar në lëvizjen e tefsirit dhe drejtimeve të tij. Në këtë vepër mbizotëron natyra historike analitike introductive. Ashtu siç thashë edhe më parë, dobia e këtij studimi mund të përqëndrohet në literaturën e përdorur, në bibliografi, në dokumenta dhe në dorëshkrime që i ka përdorur autori gjatë hulumtimit dhe përpilimit të librit. Në studimin tonë mbi lëvizjen dhe drejtimit e tefsirit do të mbështetemi në disa vepra nga literatura e përdorur në të, ngase padyshim na ofrojnë ndihmesë të madhe për hulumtimin tonë.

Nga studimet historike po ashtu mjaft me vlerë është edhe studimi i profesorit të njohur shqiptar, orientalistit Dr. Hasan Kaleshi, mbi aktivitetet e dijetarëve shqiptarë në shkencat islame me titull: "Kontributi i shqiptarëve në dituritë islame".

Në këtë studim historik hulumtuesi, Dr. Hasan Kaleshi, i ka përmbledhur emrat e dijetarëve shqiptarë që kanë jetuar në periudhën osmane në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, në bazë të kontributit të tyre në shkencat konkrete. Ai i thekson emrat e poetëve dhe letrarëve që kanë shkruar në gjuhën shqipe me alfabet arab, pers dhe turk. Nga kjo vërehet se ata kanë qenë njohës të mirë të këtyre gjuhëve orientale. Pastaj ai i thekson ata që kanë shkruar në historinë islame, gjuhën arabe dhe në shkencat tjera islame, si p.sh. në tefsir, hadith, shariat, filozofi, astronomi, psikologji, gramatikë arabe dhe lëmi tjera.

Nga studimet që më ndihmuan në hulumtimin tim mbi Islamin në tokat shqiptare gjatë shekujve në gjuhën shqipe është edhe libri i

³⁰ "Al Sira'u fi Jugosllafia ve mustakbalul muslimijne"; f. 15 dhe 79.

hulumtuesit Nexhat Ibrahimit³¹ me titull: "Islami në tokat ilire-shqiptare gjatë shekujve". Libri përmban në vete ligjëratat që i ka ligjëruar studiuesi në raste të ndryshme dhe pastaj i ka tubuar në libër, duke u mbështetur kryesisht në literaturën boshnjake. Sdo mend se libri është dhe paraqet një studim tejet të dobishëm dhe të vlefshëm që ka të bëjë me historinë islame në tokat shqiptare përgjatë shekujve, dhe insha'Allah ashtu edhe siç do të shohim më vonë, kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe ka lidhje të nushtë me studimin tone, posaçërisht titujt e literaturës që i ka përdorur autori.

Nga studimet historike bashkëkohore që kanë lidhje me disertacionin tim mbi zgjimin islam në territorin e Ballkanit, posaçërisht mbi zgjimin e muslimanëve në Bosnjë dhe Kosovë është libri i prof. dr. Fikret Karçiqit me titull: "Islami në Ballkan".³² Në këtë libër profesori thekson zgjimin islam në territorin e Ballkanit, si p.sh. arsyet dhe shkaqet e zgjimit islam, fenomenet dhe natyrën e zgjimit islam, si dhe çështje tjera të rëndësishme. Kjo vepër ka rëndësi të madhe, ngase pasqyron situatën e jetës fetare në territorin e ballkanit ku jetonin muslimanët.

Nga studimet historike që kanë të bëjnë me hulumtimin tim është edhe vepra: "Në kujtim të brezave",³³ e shkruar nga tre autorë, Faik Luli, Islam Dizdari dhe Nexhmi Bushati. Kjo vepër përmban biografitë dhe aktivitetet e dyzet personaliteteve shqiptare islame nga qyteti i Shkodrës, që nga fillimi i shek. XX deri më sot. Në realitet, kjo vepër konsiderohet enciklopedi e rëndësishme shqiptare islame që ka vlerë të madhe për studiuesit e historisë shqiptare. Mirëpo, ç'është e vërteta, unë këtë vepër nuk kam mundur ta gjej, ngase kur vajta në Shqipëri për tubimin e literaturës, ekzemplarët e tij veçmë kishin përfunduar.

Një nga dijetarët e njohur shqiptarë nga Kosova e që merret me letërsinë dhe trashëgiminë shqiptare islame e ka përgatitur këtë vepër për botim.³⁴ Autori shqyrton disa tematika të rëndësishme, si p.sh. kontributi i dyzet dijetarëve në përhapjen e fesë islame, njohja e gjuhëve të ndryshme, mbrojtja e tyre e vatanit dhe fesë dhe qëllimi i përbashkët kundër okupatorit fashist italian dhe sistemit komunist shqiptar si dhe torturat dhe mynxyrat që i kanë përjetuar gjatë jetës së tyre përplot me peripeci.

³¹ Prishtinë, bot. 1, Organizata e Ftesës Islame, Kartum, Sudan 2000.

³² Dr. Fikret Karçiq, **"Islamic Studies-Islam in the Balkans"**; Islamic Research Institute, Pakistan, International Islamic University, 1997.

³³ Shkodër 1997.

³⁴ Dr. Mahmud Hysa, **"Alamiada shqiptare"**; vëll. 2, 161-207, Logos-A, Shkup, 2000.

2. Studime me karakter intelektual dhe fetar:

Studimi kryesor fetar që më ndihmoi në disertacionin tim është vepra e prof. dr. If-fet Muhammed Sharkavit: "Mendimi fetar përballë kohës bashkëkohore";³⁵ edhe pse ky studim ka të bëjë me një vend të posaçëm dhe me njerëz konkretë, gjegjësisht me reformistët e kohës bashkëkohore, megjithatë ka një përputhshmëri të plotë me përmbajtjen dhe metodën e punës sime. Autori thekson historinë dhe zhvillimin e tefsirit.

Tefsiri ka kaluar në disa periudha që nga koha e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) deri më sot, dhe gjatë këtyre periudhave të ndryshme kohore janë formuar disa drejtime dhe doktrina, varësisht nga mënyra e hulumtimit të ajeteve të Librit të Zotit të Madhërishëm, si p.sh. doktrina e mu'tezilitëve e cila vërehet qartë në tefsirin e Zemahsheriut me titull: "El-Kesh-shaf"; pastaj doktrina kelamiste sunnite që përdoret në tefsirin e Fahrudin Raziut me titull: "Mefatihul-Gajbi"; dhe në fund doktrina shoqërore reformiste që është formuar nga reformistët racionalistë në Egjipt.

Është e rëndomtë që çdo hulumtues të përfitojë dobi nga paraardhësit e tij, dhe këtë e vërejmë edhe në deklaratën e tij, ku thotë se në hulumtimin e tij ka përfutur shumë nga disa orientalistë perëndimorë, si p.sh. vepra e Gold Ziherit me titull: "Doktrina e tefsirit islam"; vepra e orientalistit francez J.Jomier: "Komenti kur'anor i Menarit"; vepra: "Shejh Tantavi dhe komenti i tij kur'anor" nga po i njëjti autor. Më pas, vepra e orientalistit Baljon: "Komentimi i Kur'anit në kohën bashkëkohore"; si dhe vepra "Tefsiri dhe mufessirët (Komenti dhe komentuesit e Kur'anit)" nga Shejh prof.dr. Muhammed Husejn Edh-dhehebij, Zoti e mëshiroftë!

Thënë shkurt, ky hulumtim i prof. dr. If-fet Muhamed Sharkavit ka rëndësi të madhe për disertacionin tim, përkundër asaj se për të, kam disa vërejtje, megjithatë, përsëri ka vlerë të madhe dhe do të përpiqem t'i klasifikoj mendimet më të rëndësishme që autori i ka përmendur në hulumtimin e tij.

Nga veprat bashkëkohore studimore që kanë të bëjnë me tematikën time është edhe studimi i këshilltarit dr. Ali Xhurejshi me titull: "Doktrinat ideologjike bashkëkohore".³⁶ Në këtë vepër autori bën një

³⁵ Në fakt, kjo është vepër magjistrature dhe titulli paraprak i saj ka qenë **"Doktrinat e tefsirit në Egjipt në kohën bashkëkohore"**; ndërsa në botimin e dytë në vitin 1979 i është ndryshuar titulli.

³⁶ Dr. Ali Xhurejsh, **"Doktrinat ideologjike bashkëkohore"**; El-Mensura, botim i Al Vefa, bot. III, 1990.

analizë psikologjike, e cila mjaft më ka ndihmuar në punimin tim. Autori thekson doktrinat që janë përhapur në Perëndim dhe në Lindje e pastaj janë infiltruar në botën tonë islame si drejtime e doktrina. Kjo temë ka rëndësi të madhe, por në të njëjtën kohë është edhe e rrezikshme. Nuk është ideologji e as përkryerje racionale, por thjeshtë është nevojë, fundja:

A): Ai që nuk e njeh xhahilijetin, nuk mund ta njohë Islamin, si dhe ai që nuk e njeh të keqen, nuk mund ta njohë të vërtetën; dhe:

B): Nuk mund t'i ndihmojë Islamit ai që nuk i njeh kundërshtarët dhe armiqët e tij, sikundër ai që nuk e njeh mënyrën e tyre të kundërshtimit nuk di as të zhvillojë betejë.³⁷

Autori po ashtu thekson se në këtë vepër i ka studiuar edhe rrymat intelektuale në Perëndim, siç janë p.sh. masoneria dhe format e luftërave ideologjike, që ilustrohen me demokracinë si lëvizje politike, me kapitalizmin si simbol ekonomik dhe me ekzistencializmin ose liberalizmin si simbole shoqërore.³⁸ Më duhet të theksoj se shumë prej këtyre ideve janë përhapur edhe në mesin e intelektualëve shqiptarë, duke u konfrontuar ashpër me dijetarët muslimanë në territorin e Ballkanit, dhe pikërisht kjo pikë ndikoi shumë që të përqëndrohem rreth kësaj çështjeje në disertacionin tim. Nëse e kuptojmë rrezikun dhe të vërtetat e ideologjive të tilla, atëherë mund të arrijmë rezultat pozitiv e të saktë, dhe konkretisht prof. Ali Xhurejshi është njohësi më i mirë i rrezikut nga ideologjitë dhe doktrinat e tilla. Shkurt thënë, njerëzit duhet ta lexojnë këtë libër me vëmendje dhe të kuptojnë me precizitet domethënien e lëvizjeve të tilla.

Po ashtu, vepër e rëndësishme në këtë lëmi është dhe ajo e prof. dr. Fehd ibn Abdurrahman ibn Sulejman Er-Rumit me titull: "Doktrinat e tefsirit në shek. XIV".³⁹ Vlen të potencohet se ky libër ka mbuluar një zbrazëti të madhe në bibliotekën islame, si dhe tani e tutje, u ofron një shërbim të madh studiuesve të shkencave të Kur'anit dhe tefsirit në veçanti.

³⁷ Po aty, f. 6.

³⁸ Po aty.

³⁹ Fehd ibn Abdurrahman ibn Sulejman Er-Rumi, "Doktrinat e tefsirit në shek. XIV"; bot I, 1986, botim i Qendrës për Hulumtime Shkencore, Fetva e Da've dhe Irshad në Arabinë Saudite. Autori po ashtu ka theksuar titujt: "Doktrinat e ripërtëritjes në tefsirin e Kur'anit në Egjipt"; nga Muhamed Ibrahim Sherif. "Doktrinat e Tefsirit në kohën bashkëkohore që nga koha e Muhamed Abduhusë deri në përpilimin e tefsirit El-Vesijt"; nga Shejh Mustafa Muhamed Hadid Et-Tajr, dhe "Doktrinat e tefsirit sot"; nga Abdulmexhid Abdusselam El-Muhtesib.

Në këtë vepër autori flet për formimin, zhvillimin, metodën dhe doktrinat e komentuesve klasikë dhe disa të kohës më të re, gjë që ka lidhje të ngushtë me disertacionin tim. Dobi më të madhe në këtë libër kemi literaturën e shumtë që është përdorur në të. Nga vështrimet që mund t'ia bëjmë këtij libri, nuk është theksuar ndonjë vepër e orientalistëve që është marrë me studime kur'anore, qofshin muslimanë apo jomuslimanë.

Mendoj se profesori Fehd, së paku është dashur t'i përmend, edhe pse në tërësi vështirë është të pranohen punimet e tyre, por mund të ketë dobi tematike. Unë mendoj se ndoshta profesori është ruajtur nga dyshimet që i nxisin shkrimet e tyre dhe për këtë shkak ka preferuar që të mos përmend asnjë prej tyre. Unë gjithashtu mendoj se ai s'ka pasur arsye ta bëjë këtë lëshim, ngase ka përmendur mufesirë që u takojnë lëvizjeve dhe frakcioneve më të rrezikshme se fjalët dhe shkrimet e orientalistëve, të cilat janë shkruar në gjuhën arabe, si p.sh. studimi i disa doktrinave të devijuara dhe ateiste në tefsir. Po ashtu titulli i librit është i gjerë dhe i përmbledh të gjitha shtetet dhe të gjithë komentuesit, ndërsa në libër ka theksuar vetëm komentuesit e njohur arabë. Në realitet, sot, ka komentues joarabë që jetojnë në shtetet joarabe dhe kjo është e vërtetë dhe realitet të cilit nuk mund t'i shmangemi dot, ndaj për profesorin Fehd do të ishte më mirë sikur hulumtimin e tij ta përkufizonte, si nga aspekti horizontal, ashtu edhe nga ai vertikal.

Nga studimet fetare dhe intelektuale që kanë të bëjnë me njërin nga personalitetet e tefsirit, të cilin do ta studiojmë në këtë disertacion është edhe libri i hulumtuesit Dr. Ismail Bardhit mbi Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu me titull: "Hafiz Ibrahim Dalliu dhe ekzegjeza e tij kur'anore", i shkruar në gjuhën turke, por më pas i përkthyer në shqip nga vetë autori. Siç shihet edhe nga vetë titulli, autori ka studiuar vetëm një personalitet të shquar në shkencën e tefsirit, duke dhënë një pasqyrë të gjerë mbi disa rrethana historike të Shqipërisë. Kjo vepër ka rëndësi ekskluzive, sepse konsiderohet një ndër të parat që janë përqëndruar në tefsir dhe në të, mbizotëron metoda filosofike-dialektike gjatë zbërthimit të çështjeve të fesë dhe tefsirit. Autori nuk i ka potencuar drejtimet e tjera të tefsirit që ekzistojnë në shoqërinë shqiptare e as komentuesit bashkëkohorë tjerë, por është përqëndruar vetëm në një personalitet të tefsirit dhe s'ka dyshim se një studim i tillë nuk na jep një pasqyrë të qartë dhe të plotë mbi tefsirin dhe drejtimet e tij në territoret shqiptare. Vlen të përmendet se autori i nderuar e ka trajtuar këtë temë nga prizma e botëkuptimeve të tij personale, dhe se metoda e tij e përdorur dallon nga metoda ime gjatë studimit të personaliteteve dhe metodave të tyre në tefsir. Ajo që vlen të

potencohet rreth vlerës së këtij libri, padyshim është literatura e pasur e përdorur gjatë hulumtimit të tij, e cila më ka ndihmuar shumë në pasurimin e informatave të mia. I falënderohem Allahut, Zotit të botëve, e autorin Zoti e shpërbleftë për mundin që ka dhënë!

Nga veprat që kanë lidhje të pjesshme me punimin tim është studimi kritik i prof. Emin Behramit mbi katër përkthimet e Kur'anit Fisnik në gjuhën shqipe, që titullohet: "Qasje studimore rreth katër përkthimeve të Kur'anit".

S'ka dyshim se ky studim është i dobishëm dhe i vlefshëm. Sipas autorit, përpilimi i tij ka pasur për qëllim korrigjimin dhe korrektimin e disa gabimeve të bëra gjatë përkthimeve shqipe në dy dekadat e fundit si dhe t'ua tërheq vërejtjen që të kenë kujdes studiuesit dhe lexuesit muslimanë në të ardhmen. Ky studim është i pari i këtij lloji që merret me problemet gjuhësore dhe tematike, të cilat i kanë bërë përkthyesit e Kur'anit Fisnik në gjuhën shqipe.

Nga hulumtimet orientale që kanë të bëjnë me hulumtimin në mënyrë relative është vepra e prof. dr. Enes Kariqit me titullin: "Semantika e Kur'anit".⁴⁰ Në këtë vepër autori i ka tubuar punimet më të rëndësishme të orientalistëve perëndimorë dhe mendimtarëve tjerë të njohur, si p.sh.: mendimtarit malajzian Se'id Muhamed Nekib El-Attas, orientalistit japonez Toshihiko Izutsu dhe shumë të tjerëve. Kjo vepër përmbledh hulumtime të ndryshme shkencore të përkthyer nga vetë autori nga gjuha arabe dhe angleze. Libri ka vëllim të madh dhe në fillim janë temat më të rëndësishme që kanë shkruar dijetarët e stilistikës, semantikës dhe poetikës mbi mrekullinë e Kur'anit Fisnik. Autori po ashtu i përmend mendimet reformiste të mendimtarit të shquar boshnjak prof. Husein Gjozo mbi mënyrën e komentimit të Kur'anit Fisnik në kohën bashkëkohore dhe mbi metodologjinë reformiste në tefsir. Nuk ka dyshim se ky hulumtim ka rëndësi për mua dhe për disertacionin tim, ngase në të theksohen disa drejtime të reja që janë formuar në tefsir në kohën bashkëkohore e që kanë të bëjnë me përpjekjet serioze të dijetarëve dhe mendimtarëve të Bosnjës mbi të kuptuarit dhe komentimin e Kur'anit Fisnik. Profesor Enes Kariqi është i njohur me hulumtimet e tij rreth Kur'anit Fisnik dhe jam i informuar se kohëve të fundit ka botuar një përkthim të Kur'anit Fisnik me komentim të shkurtër në gjuhën boshnjake. Lus Zotin e Madhërishëm që t'i ndihmojë dhe të jetë i suksesshëm në punën e tij!

⁴⁰ Enes Kariq, "Semantika Kur'ana"; Bunust, Sarajevo, 1998.

Nga studimet e tjera që kanë raport të ngushtë me disertacionin tim është edhe vepra e orientalistit anglez H. T. Norris me titull: “Islami në Ballkan-Feja dhe shoqëria në mes Evropës dhe botës arabe”.⁴¹

Çështjet që ndërlidhen me hulumtimin tim janë të shumta dhe kanë të bëjnë me aspektin historik dhe fetar, si p.sh. ai flet për raportet mes arabëve dhe shoqërive të ndryshme në Ballkan: Shoqërive shqiptare, sllave, hungareze dhe bullgare. Ai, po ashtu flet për ndikimin oriental në jetën, studimet dhe trashëgiminë boshnjake, shqiptare dhe maqedonase. Në këtë vepër po ashtu studion edhe fenomenet islame që ekzistojnë në këto shoqëri, si p.sh. ekzistimi i xhamive, teqeve, bibliotekave islame, poetëve muslimanë etj. Autori më tej përshkruan historinë e lëvizjeve sufiste në Ballkan dhe marrëdhëniet e tyre fetare me metodat sufiste në Azinë Qendrore, siç janë p.sh. tarikati bektashi, kadiri, mevlevi, halveti, nakshibendi, melami, etj. Aty theksohen edhe marrëdhëniet historike të arabëve dhe shqiptarëve në Marok, Algjer, Tunizi, Siri dhe Egjipt ku theks të posaçëm zë periudha e Muhamed Ali Pashës, i cili ka qenë guvernator i Egjiptit. Autori po ashtu i ka shqyrtuar edhe raportet në mes muslimanëve dhe popujve tjerë në Ballkan si dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ardhmëria e përbashkët e këtyre popujve. Kjo ishte një përmbledhje e shkurtër e asaj që shqyrtohet në këtë libër nga aspekti historik dhe fetar në Ballkan.

Dhe, siç vërehet nga këto të dhëna nuk ka pasur ndonjë studim serioz mbi komentimet, doktrinat, lëvizjet, historinë dhe zhvillimin e tefsirit, dhe për këtë shkak hulumtimi im dallohet nga hulumtimet e mëparshme. Raporti në mes punimit tim dhe punimeve të mëparshme ka natyrë historike dhe parciaisë, ngase punimi im është një kontribut me të dhëna të reja në fushën e studimeve të Kur'anit në Ballkan dhe veçanërisht në territoret etnike shqiptare.

METODA E HULUMTIMIT

Metodën që, insha'Allah do ta përdori në këtë disertacion, është metodë induktive, historike, analitike dhe kritike, dhe kjo nënkupton studim, vështrim preciz, analizë dhe vështrim kritik aq sa ka mundësi të ofrohet literaturë përkatëse. Pastaj do t'i përkthej tekstet e duhura në gjuhën arabe në mënyrë precize dhe të saktë, duke respektuar çdo fjalë e

⁴¹ H. T. Norris, “Islam in the Balkans- Religion and society between Europe and the Arab world”; Hurst Company, London 1993.

mendim dhe pastaj do t'i analizoj mendimet, rrymat dhe metodat në bazë të parimeve të Kur'anit Fisnik, të Sunnetit profetik autentik dhe të Ehli-Sunnetit dhe Xhematit, dhe do të mundohem t'i nxjerr vlerat nga fjalët e dijetarëve që kanë të bëjnë me këtë lëmi.

I mbështetem Zotit të Madhërishëm, prej Tij kërkoj ndihmë dhe vetëm Zoti i Gjithëfuqishëm është më i Fuqishmi, më i Madhërishëmi dhe më i Lartësuari!

KAPITULLI I DYTË

SITUATA POLITIKE NË TOKAT SHQIPTARE GJATË PERIUdhës OSMANE

I: NATYRA E SHTETIT OSMAN NË TERRITORET SHQIPTARE

Hyrje kritike mbi historinë e shqiptarëve

Studimi dhe analiza e historisë së shqiptarëve në territoret e sotme shqiptare, dhe në territoret e tyre etnike të uzurpuara në fillim të shek. XX, konsiderohet padyshim një çështje e vështirë dhe shumë e ndjeshme. Studiuesi për të qenë sa më i drejtë dhe objektiv ka nevojë t'i përvishet punës një kohë bukur të gjatë, për të bërë një studim të tillë historik, si dhe duhet të jetë i informuar mirë me njohuri që kanë të bëjnë me historinë e shqiptarëve dhe të Shqipërisë.

Përveç kësaj, ai duhet të kontrollojë literaturën e historisë antike shqiptare dhe asaj bashkëkohore, për të shqyrtuar në mënyrë krahasuese zhvillimin historik dhe gjërat e tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me shqiptarët, ngase vetëm në këtë mënyrë do ta kuptojmë pozitën e vërtetë të shqiptarëve, kurse në të kundërtën, nëse shkruhet nga distanca, atëherë do të përfitohen rezultate të gabuara dhe të deformuara.

Çështja e dytë që është gjithashtu shumë e rëndësishme dhe e cila patjetër duhet të merret parasysh kur studiojmë historinë e shqiptarëve, është fakti se këtë histori që ekziston para nesh dhe që studion çështjet e hershme dhe bashkëkohore të shqiptarëve e kanë shkruar dhe formuluar dijetarët dhe historianët që mësuan dhe u përgatitën profesionalisht në kohën e marksizëm-leninizmit, komunizmit, sllavizmit dhe ortodoksisë, ndaj dhe për rrjedhojë edhe burimet historike janë përpiluar sipas metodës marksiste-leniniste, ateiste etj. Në këtë kontekst, njëri prej tyre thotë: *"Me lindjen e materializmit dialektik, historia është shndërruar në një shkencë të vërtetë..."*⁴² Njohja e rrethanave historike, politike, shoqërore e fetare që mbizotëronin në ato vende nga njëra anë, dhe rezistenca e dijetarëve shqiptarë kundër ballafaqimeve të tilla nga ana tjetër, do të na mundësojë që të kuptojmë më mirë dhe më saktë drejtimet dhe doktrinat intelektuale

⁴² **"Historia e Popullit Shqiptar"**; Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Gjuhësisë dhe i Historisë, bot. III, vëll. I, f. 10.

e fetare që ekzistonin në studimin kur'anor, për të cilat insha'Allah do të flasim më vonë, dhe *"Rileximi i trashëgimisë historike në një mënyrë tjetër të re është obligim i historianit"*,⁴³ dhe ne shtojmë e themi se ky obligim i takon edhe hulumtuesit e mendimtarit të vërtetë musliman që është i interesuar për fenë dhe vatanin.

Shqiptarët që jetuan para nesh dhe ushtruan detyra të ndryshme, *"u helmuan në zemra e tru nga gënjeshttrat dhe teoritë mashtruese marksiste-leniniste..., të cilat ekzistonin në këtë histori"*.⁴⁴

"Historia jonë ende shkruhet për t'u shërbyer qëllimeve dhe synimeve komuniste sovjetike dhe legjendave sllavo-ruse".⁴⁵

Një botëkuptim i tillë vërehet qartë në burimet e historisë së shqiptarëve, ku redaksia botuese shpreh mirnjohjet e saja të singerta dijetarëve sovjetikë dhe atyre bullgarë për rolin e tyre të madh e të dukshëm në përpilimin dhe përgatitjen e teksteve historike.⁴⁶

Nga kjo thënie, qartë vërejmë se një e vërtetë ogurzezë veçmë kishte depërtuar në burimet historike.

Në këtë kontekst mund të theksojmë edhe shembuj tjerë:

1. Në librin *"Historia e Shqipërisë"*, gjegjësisht në hyrjen e tij thuhet: *"Nisur nga teoria marksiste-leniniste se s'mund të kuptohen e as të analizohen në mënyrë të shëndoshë zhvillimet politike dhe kulturore, përpos nëse mbështetemi në zhvillimet ekonomike e sociale të asaj kohe, edhe historia e re shqiptare i ka dhënë rëndësi të madhe kësaj teorie dhe është mbështetur fuqishëm në të"*.⁴⁷
2. Në hyrjen e librit *"Historia e Popullit Shqiptar"*, thuhet: *"Historia është bërë shkencë e vërtetë me plotë kuptimin e fjalës, kur lindi metoda materialiste-dialektike"*.⁴⁸

Pra, siç shihet nga fjalët e mësipërme të konceptit marksist shqiptar, vetëm pas formimit të metodës materialiste dialektike të të kuptuarit dhe të studiuarit e historisë, historia është shndërruar në shkencë të vërtetë me plotë kuptimin e fjalës, e në të kundërtën, historia nuk do të mundej të kuptohet. Vërtet ç'mendim i çuditshëm!!!

⁴³ Justin MacCarthy, *"Death and Exile-the ethnic cleansing of Ottoman Muslims"*; 1821-1922, 3-rd ed. USA, 1999, f. 3.

⁴⁴ Tajar Zavalani, *"Historia e Shqipërisë"*; Londër 1957, f. 9-11.

⁴⁵ Tajar Zavalani, *"Historia e Shqipërisë"*; f. 9.

⁴⁶ *"Historia e Shqipërisë"*; Universiteti Shtetëror i Tiranës 1959, vëll.1.

⁴⁷ *"Historia e Shqipërisë"*, Akademia e R.P.S. të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë, Tiranë, 1984, 19; *"Historia e Popullit Shqiptar"*; vëll. 1, 10.

⁴⁸ *"Historia e Popullit Shqiptar"*; vëll. 1, 10.

Këshilltari dhe hulumtuesi prof. Ali Xhurejshi, përpiket të na sqarojë mendimin e tyre dhe thotë: *"Dialektika mbështetet në parimin e kundërshtimeve, përkatësisht në parimin e kundërshtimeve të pjesëve të materies në mes vete, të pjesëve të gjithësisë dhe pastaj në mes të klasave..."*⁴⁹

Mirëpo, kjo ide nuk është e vërtetë, dhe këtë e ka vërtetuar edhe vetë shkenca, ashtu siç thekson edhe prof. Ali Xhurejshi: *"Materializmi dialektik nuk mund të qëndronte përpara analizave të vërteta shkencore. Ajo që është zbuluar përbën vetëm 7% , ndërsa e pazbuluara është 93% dhe nëse pranojnë atë që thotë Marksi se ne dimë vetëm anën e dukshme të materies, vërehet qartë se kjo ide është mbështetur në shtatë përqindëshin dhe shkencërisht, kjo është nonsens"*.⁵⁰

Për sa i përket qëndrimit kur'anor ndaj marksizmit, veçmë e dimë se Kur'ani Fisnik tërësisht e refuzon filosofinë marksiste. Zoti në esencë ka krijuar dy çifte, dhe në këtë kontekst në Kur'anin Fisnik thuhet:

([الذاریات : 49] ﴿ تَذَكَّرُونَ لَعَلَّكُمْ رُوحَيْنِ خَلَقْنَا شَيْءَ كُلِّ وَمِنْ ﴾)

"Prej çdo gjëje krijuam çifte, ndoshta kujtoni (Zotin)".⁵¹ Në një ajet tjetër thuhet:

لَا وَمِمَّا أَنْفُسِهِمْ وَمِنْ الْأَرْضِ تُنْبِتُ مِمَّا كَلَّهَا الْأَزْوَاجَ خَلَقَ الَّذِي سُبْحَنَ

([يس: 36] ﴿ يَعْلَمُونَ ﴾)

"I Madhërishëm qoftë Ai që ka krijuar në çifte çdo gjë që rritet në tokë, në vetveten e tyre dhe në atë që ju nuk e dini".⁵²

Nga këto dy ajetet e sipërpërmendura, vërehet qartë se çdo gjë është krijuar në çifte, si p.sh. njeriu, kafsha, bima dhe bota që nuk e dimë, dhe kjo argumenton fuqinë e Zotit të Madhërishëm dhe rregullat që Ai i ka krijuar për jetën e cila nuk mund të ekzistojë pa Të. Kështu, teoria se çdo gjë është krijuar në bazë të materializmit-dialektik bie poshtë dhe është e paqëndrueshme. Pra, komentimi i historisë në bazë të kësaj

⁴⁹ Dr. Ali Xhurejsh, **"Drejtimit intelektuale bashkëkohore"**; f. 182.

⁵⁰ Po aty, f. 162.

⁵¹ Edh-Dharijatë, 49.

⁵² Jasin, 36.

metode nuk pranohet fare, madje dhe vetë Karl Marksi⁵³ është larguar nga kjo teori, qëndrimin e të cilit e vërteton vetë Engelsi.⁵⁴

Sipas disa hulumtuesve, pa kurrfarë dyshimi ekziston edhe ndikimi i madh orientalist evropian në formulimin e teksteve historike shqiptare.⁵⁵ Sipas teorisë së Marksit, shpirti i njeriut mohohet, ngase ai as nuk shihet dhe as nuk mund të preket.⁵⁶

Nëse e kuptojmë dhe bindemi në pavlefshmërinë e metodës marksiste-ateiste mbi të kuptuarit e historisë, atëherë cilën metodë duhet ta pranojmë për ta kuptuar ashtu siç duhet historinë?

Sipas disa hulumtuesve, me fjalët e të cilëve ne jemi dakord, se pas shkatërrimit të metodës marksiste në të kuptuarit e drejtë të historisë, shtojmë se edhe metodat e tjera të formuara nuk mund ta kuptojnë historinë ashtu siç e kupton metoda e pastër objektive islame, qofshin këto metoda gjeografike, biologjike, ekonomike, shoqërore, psikologjike apo politike, ngase nuk mund ta komentojnë historinë në mënyrë të plotë dhe të përkryer. Nëse e kuptojmë këtë të vërtetë, atëherë para nesh mbetet vetëm metoda islame, ngase mbështetet në parimin e dëshirës absolute të Zotit të Madhërishëm, në parimin e relacionit në mes të jetës së kësaj bote dhe botës tjetër, dhe në parimin e dëshirës njerëzore. Të gjithë faktorët e sipërpërmendur kanë rol suplementar të këtyre tri parimeve që i përmendëm në fund, dhe këtë e nënkuptojmë kur flasim për metodën islame.⁵⁷

Nga ajo që u tha më sipër, mund të bëjmë një konkluzion të shkurtër:

Historia jonë shqiptare e shkruar nga historianët e periudhës së sistemit komunist dhe sipas metodës marksiste, është e helmuar dhe e devijuar, ndaj dhe për këtë shkak, ajo nuk jep pasqyrë të qartë-objektive

⁵³ Më gjerësisht mbi jetën dhe veprën e Karl Marksit shih: William Simpson and Martin Toma, **“Europe, 1783-1914”**; Routledge-Taylor and Francis Group, London and New York, 1st pub. 2000, 253-255.

⁵⁴ Më gjerësisht për këtë çështje lexoni librin e dr. Seid Ramadan Butit, **“Nakdul-Euham El-Maddijetti El-Xhedelijjeti”**; Darul-Fikri, Damask, bot. II, 1986.

⁵⁵ Shih: Enver El-Xhundi, **“Tas’hihu Ekberi Hata'in Fit-tarihil-Islami”**; **“Es-Sultan Abdulhamid Eth-Thâni vel-Hilafetul-Islamijjeti”**; Kajro, Darul-Kutubis-Selefijjeti, bot. 1, 1407, f. 7.

⁵⁶ Po aty, f. 21.

⁵⁷ Po aty 38-39; Po ashtu shih Halil Imadud-din, **“Med-hal ila Islamijjetil Ma'rifeti mea Iktirahi Islamijjetit-Tarih”**; Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam, I.I.U. Malaysia, bot. 1, 1990, f. 50-90.

mbi Islamin dhe myslimanët në Ballkan, sidomos për shqiptarët, si dhe as që pranohet fare ndonjë rezultat i tillë.⁵⁸

Me të drejtë shtrohet pyetja: Nëse e kuptojmë këtë, atëherë çfarë rrugëdalje tjetër kemi?

Unë them se këtë histori laike, ateiste, të devijuar, e që kundërshton fetë në përgjithësi dhe Islamin në veçanti, që është e shkruar në bazë të metodave ateiste, marksiste dhe leniniste, duhet refuzuar në tërësi, dhe kërkoj që të rishkruhet dhe të riformulohet përsëri në një formë të re nga historianë shqiptarë objektivë dhe myslimanë.

Historia e Mesjetës shqiptare dhe historia e saj e re, ngusht janë të lidhura me historinë osmane, ndaj dhe gjendja e shqiptarëve nuk mund të kuptohet në mënyrë të saktë e precize, përpos nëse krahasohet me historinë e shtetit osman, por për fat të keq, në mesin e shqiptarëve ekziston një averzion, që ka marrë përmasat e fenomenit, dhe një qëndrim negativ ndaj historisë dhe studimit të periudhës osmane. Një fenomen i tillë është rrënjësor shumë keq në mesin e shqiptarëve, me qëllim që ata t'i largojnë njerëzit nga Islami dhe muslimanët. Ky fenomen i ka njollësuar dhe fëlliqur edhe idetë e mendimet e autorëve objektiv perëndimorë ndaj historisë osmane.

Këtë fenomen e ka vërejtur qartë historiani turk prof. Mehmet Maksudoglu, ndaj në këtë kontekst thotë: *"Hulumtuesit perëndimorë i kanë përdorur shumë pak burimet origjinale historike". (Madje edhe hulumtuesit shqiptarë i kanë përdorur fare pak, H. Hoxha). "E vërteta osmane ka qenë në një anë, kurse ajo që është shkruar dhe botuar ka qenë në anën tjetër. Në asnjë mënyrë nuk mund të kuptohet historia e një vendi apo populli, nëse ajo shkruhet nga të huajt joprofesionistë dhe joobjektivë".*⁵⁹

Kjo metodë kontradiktore ka ekzistuar te pjesa dërrmuese e historianëve shqiptarë gjatë shkrimit, studimit dhe analizimit të historisë osmane, përpos atyre që i ka ruajtur Zoti nga ky devijim, por ata janë të paktë dhe jo të popullarizuar.

⁵⁸ Krahaso cilindo libër historik shqiptar që është shkruar gjatë viteve 1954, 1965 dhe 1984 me librat e shkruar gjatë viteve 1989-2000 dhe do të vëresh të njëjtën metodë marksiste-leniniste ateiste në formulimin e historisë shqiptare. Karakteristikë e kësaj metode marksiste-leniniste ateiste është sulmi ndaj Islamit dhe osmanlinjve në mënyrë të ashpër dhe sipas tyre, osmanlinjtë kanë okupuar territoret shqiptare e jo çliruar dhe se kanë sjellë fenë e arabëve e jo Islamin. Nga kjo kuptohet se ata historinë akoma janë duke e shkruar sipas avazit të vjetër dhe se fatkeqësisht, ende e mësojnë sipas metodës marksiste.

⁵⁹ Mehmet Maksudoglu, **"Ottoman history based mainly on Ottoman sources"**; International Islamic University, Malaysia, 1993, f. 4-9.

Historianët laikë dhe ateistë shqiptarë kanë bërë gabim të madh kur përdorën në fjalorin e tyre fjalë të rënda, të ashpra dhe joshkencore ndaj perandorisë osmane në çdo aspekt, duke mos vërejtur asnjë dobi për shqiptarët nga kjo perandori. S'ka dyshim se një gjë e tillë refuzohet si nga aspekti metodologjik e shkencor ashtu edhe nga aspekti historik. Ky fenomen ka për qëllim shtrembërimin e Islamit, dhe krijon urrejtje në mesin e gjeneratave të ardhshme shqiptare ndaj Islamit dhe muslimanëve.

Nga akuzat e tilla që krijojnë urrejtje ndaj osmanlinjve janë nocionet: Okupim ose okupatorët turq, turqit barbarë, rrjedha destruktive turke, presioni nacionalist turk, zgjedhë turke, i Sëmuri i Bosforit, si ta varrosim këtë të sëmurë, ky i sëmuri ka marrë grusht të fortë nga shtetet evropiane, qeveria e kalbur turke, etj.!!!⁶⁰ Natyrisht të gjitha këto thënie janë të pavërteta dhe përgënjeshtrike të të vërtetave historike. Disa historianë objektivë janë përpjekur t'i theksojnë disa të vërteta nëpërmes të cilave mund të kuptojmë natyrën e pushtetit osman mbi shqiptarët.

1. *"Ardhja e shtetit osman gjeti pjesën dërmuese të shqiptarëve nën dominimin e serbëve, bullgarëve, grekëve dhe bizantinëve"*,⁶¹ ndërsa këta dominues rrezikonin shqiptarët më shumë se sa shteti osman.
2. Ekzistimi i shtetit osman ka mbrojtur shkrirjen kombëtare dhe të gjakut të shqiptarëve që u kërcënohej nga sllavët, grekët, bullgarët dhe bizantinët. Shteti osman i ka mbrojtur shqiptarët përmes shkatërrimit të principatave serbe, bullgare e greke,⁶² dhe kështu i ka mbrojtur shqiptarët nga serbizimi, bullgarizimi, greqizimi, sepse në të kundërtën ata-shqiptarët do të shndërroheshin në grekë, serbë apo bullgarë.
3. Shteti osman siguronte tolerancë fetare dhe etnike, dhe nuk ishte vetëm institucion turk, po ishte institucion që përbëhej nga turqit, arabët, kurdët, shqiptarët, grekët, boshnjakët, serbët, kroatët e hebrenjtë, dhe ekonomia ishte madje në duart e tyre.⁶³
4. Shteti osman nuk ka ushtruar dhunë në fëmijë dhe nuk i ka detyruar asnjëherë njerëzit që ta pranojnë Islamin me forcë, përkundrazi.

⁶⁰ Bedrush Shehu, *"Çështja shqiptare në vitet 30 të shek. XX"*; Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1990, f. 35.

⁶¹ Po aty, f. 51.

⁶² Më gjerësisht shih librin e Nesim P. Alpan Kaci, *"Shqiptarët në Perandorinë Osmane"*; Albin, Tiranë 1997, 35, 41, 125; Sami Frashëri, *"Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e çdo të bëhetë"*; f. 36.

⁶³ Skender Rizaj, *"Kosova gjatë shekujve XV-XVI-XVII, administrata, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore"*; f. 283-284.

Kurse serbët kanë ushtruar dhunë dhe presion të madh për t'i detyruar shqiptarët ta pranojnë krishterimin. Shqiptarët vullnetarisht e pranonin Islamin pa kurrfarë dhune dhe ky konvertim kryhej në prezencën e dy dëshmitarëve para gjykatësit, këtë e konfirmojnë dokumentet e gjykatave të Sheriatit, në të cilat regjistrohej konvertimi i tyre pa dhunë e pa presion.⁶⁴

Në anën tjetër, intelektualët dhe hulumtuesit shqiptarë akoma vazhdojnë të mësojnë studentët nëpër universitetet shqiptare se Islami është përhapur me shpatë dhe se shqiptarët vullnetarisht kurrë nuk do të bëheshin muslimanë! Nuk ka dyshim se kjo ide buron nga ideja e kahmotshme kryqtare katolike shqiptare, dhe se tani për fat të keq, ekzistojnë disa intelektualë që tentojnë ta ringjallin përsëri këtë ide kryqtare në mesin e shqiptarëve myslimanë dhe ta turbullojnë koekzistencën dhe tolerancën fetare shekullore dhe të mbjellin armiqësi në mes tyre, madje të ndihmuar edhe nga disa qarqe evropiane misionare, me qëllim që t'i largojnë shqiptarët nga Islami e t'i kthejnë ata, gjoja në fenë e lashtë katolike.

5. Konvertimi i shqiptarëve në Islam nuk nënkuptonte edhe shndërrimin e tyre automatikisht në turq, osmanlinjë ose arabë, ashtu siç mendon shumica e hulumtuesve shqiptarë, por ishte e kundërta e kësaj, ngase jetesa e shqiptarëve nën pushtetin serb dhe bizantin shoqërohej me procesin e ndryshimit të identitetit kombëtar dhe shpirtëror. Gjuha e sllavëve serbë dhe grekëve, ishte e njëjta gjuhë që përdorej zyrtarisht në kishë, ndërsa me Islamin situata ishte krejt ndryshe, ngase gjuha e Islamit ishte gjuha arabe, ndërsa gjuha e shtetit osman ishte gjuhë tjetër dhe kështu ajo nuk i kërcënonte shqiptarët me zhdukjen e gjuhës dhe gjakut të tyre.⁶⁵
6. Disa punë administrative osmane ishin në duart e shqiptarëve, ndërsa në kohërat e lashta të pushtetit serb, si dhe para dy dekadave në Kosovë (ish-Jugosllavi), e tërë administrata ishte në duart e serbëve dhe aty shqiptarët fare nuk merrnin as erë.
7. Elita intelektuale e hulumtuesve shqiptarë duhet të turpërohet nga gënjeshttrat e kulluara dhe intrigat e tilla që i kanë shkruar në literaturën historike mbi shtetin osman. Osmanlinjtë

⁶⁴ Po aty, f. 471-472.

⁶⁵ Hysamedin Feraj, “Skicë e mendimit politik shqiptar”; f. 53; Shefqet Dibrani, “Feja në shërbim të kombit”-në: [www.yahoogroups.com/feja në shërbim të kombit](http://www.yahoogroups.com/feja_në_shërbim_të_kombit); Ali M. Basha, “Islami në Shqipëri gjatë shekujve”; f. 19.

asnjëherë nuk i kanë deportuar shqiptarët dhe muslimanët nga tokat e tyre në grupe, ashtu siç kanë vepruar grekët dhe serbët në të kaluarën dhe siç vepruan serbët edhe sot në Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë dhe në Maqedoni.⁶⁶

8. Historikisht pa kurrfarë dyshimi, është vërtetuar nga vetë kundërshtarët më të mëdhenj të Islamit dhe muslimanëve, gjegjësisht nga disa hulumtues priftërinjë katolikë, se osmanlinjtë nuk kanë hyrë si uzurpatorë në territoret shqiptare, por ata kanë ardhur me ftesë të udhëheqësve shqiptarë që quheshin “arbërorë” për ti ndaluar konfliktet dhe rivalitetet për pushtet që ekzistonin në mes tyre.⁶⁷

Kjo është një e vërtetë shumë e rëndësishme historike që historianët shqiptarë nuk mund ta anashkalojnë si në të shkuarën ashtu edhe sot. Them dhe bindshëm besoj se nëse rilexohet historia në mënyrë objektive, atëherë do të pastrohet nga thashethemet e tilla, dhe gjeneratat e ardhshme do të lexojnë histori më të saktë dhe më të pastër nga gafe të tilla, do ta kuptojnë se osmanlinjtë ishin çlirimtarë të vendit të tyre dhe jo uzurpatorë, do ta kuptojnë të vërtetën e Islamit pa kurrfarë dezinformime e falsifikime, dhe do ta kuptojnë rolin e madh të shtetit osman për shqiptarët në të gjitha aspektet e jetës së tyre.⁶⁸

Shkrimtarët dhe hulumtuesit shqiptarë e injoronin dhe anashkallonin faktin dominues fetar në historinë e shqiptarëve⁶⁹ dhe të popujve

⁶⁶ Po aty, f. 56. Po ashtu shih më gjerësisht në: **“The truth on Kosova”**; the Academy of Sciences of the Republic of Albania, Institute of History, Encyclopedia publishing house, Tirana 1993; Milan Suflay, **“The Illyrians, the Albanians and the Slavs, problems of continuity and symbiosis”**, 71; E. Pllana, **“The Deportation of Albanians from the territory of Sancjak, of Nish, of Kosova”**; 73; Z. Shtylla, **“The Deportation of Albanians in Yugoslavia after the Second World War 1950-1966”**; 222; Vaso Çubriloqi, **“The Problem of minorities in the new Yugoslavia”**; 30; Poullton Hough and Farouki; Suha Taji, **“Muslim identity on the Balkan state”**; 168-169.

⁶⁷ Gjergj Gashi, **“Arbëria dhe Vatikani”**; 9; Nicollas Costa, **“Albania an European Enigma”**; 8; Stavro Skendi, **“Zgjimi Kombëtar Shqiptar”**; Phoenix, Tiranë, 1967, 17.

⁶⁸ Apeli ynë për një rilexim të ri dhe rianalizë të re të historisë shqiptare është vazhdim dhe konfirmim i apelit të historianit dhe dijetarit tonë të respektur prof. dr. Muhamet Pirraku, i cili qëmoti ka bërë thirrje për rileximin e historisë dhe rishkrimin e saj në një frymë të re, në veprën e tij që është disertacion doktore, të shkruar në vitin 1989 me titull: **“Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit”**; f. 32.

⁶⁹ Kjo hyrje historike e këtij disertacioni është një studim i yni nga këndvështrimi dhe pikëpamja islame, e që është i pari deri në momentin kur po shkruhen këto rreshta (**viti 2000-2003**) i mbështetur në burime të njohura historike autentike shqiptare në radhë të parë e pastaj edhe në gjuhë tjera. Ky studim historik është hap i parë në të kuptuarit e

të Ballkanit në përgjithësi, e përpiqeshin që në bazë të botëkuptimeve e perceptimeve marksiste, ta privonin historinë tonë nga horizonti fetar, metodë hulumtuese kjo shumë e gabuar dhe e refuzuar shkencërisht.

Faktori fetar ka qenë arsye kryesore në cytjen e luftërave ballkanike, ashtu siç është edhe në disa vende aziatike në kohën bashkëkohore.

Edhe hulumtuesit perëndimorë janë përpjekur që ta mënjanojnë këtë faktor nga jeta e popujve, dhe këtu, në këtë kontekst vlen të theksohet fjala e dijetarit dhe hulumtuesit Justin McCarthy, i cili në studimin e çështjeve të tilla, thotë: *"Në vitin 1880 ka pasur një tokë të gjerë ku jetonin muslimanët e Ballkanit, Anadollit dhe ata të Rusisë Jugore. Muslimanët e Ballkanit u zhdukën në mënyrë kolektive me vdekje ose me deportim në grupe të vogla në Greqi, Bullgari e Jugosllavi. Shkurt thënë, muslimanët e tillë humbën dhe u zhdukën. Miliona muslimanë, pjesa dërrmuese e tyre turq, vdiqën, ndërsa miliona të tjerë emigruan nga territoret turke. Prej vitit 1821 deri në vitin 1922 më shumë se pesë milionë muslimanë janë dëbuar nga shtëpitë e tyre dhe janë deportuar në vende të ndryshme e të panjohura. Disa prej tyre u shkatërruan nëpër luftëra, disa të tjerë vdiqën nga uria dhe disa prej tyre fituan sëmundje dhe epidemi gjatë endjes së tyre për të gjetur strehim e vatër. Historia e Anadollit, Ballkanit dhe Kaukazit nuk mund të studiohet e as të kuptohet në mënyrë të saktë nëse nuk merret parasysh fakti i muslimanëve refugjatë dhe atyre që kanë vdekur. Njohja e çështjes së zhdukjes së muslimanëve ka rëndësi të madhe në historinë e shtetit osman,⁷⁰ ngase muslimanët e tillë kanë qenë viktimë e nacionalizmit dhe imperializmit. Sidoqoftë në historinë perëndimore (edhe në historinë shqiptare - H. Hoxha) asnjëherë nuk është shkruar për gjendjen e muslimanëve të Ballkanit, Anadollit dhe*

drejtë të çështjeve që do t'i shqyrtojmë në këtë disertacion. Unë do të përpiqem që t'i shpjegoj të vërtetat historike sipas këndvështrimit islam, dhe vetëm Zoti e di se sa vështirë e kisha që ta rilexoj historinë tonë të lashtë dhe atë bashkëkohore dhe ta rianalizojë për të kuptuar të vërtetën. Unë përfitova rezultate të jashtëzakonshme dhe pozitive, dhe e kuptova dorën e zezë që ndikoi në privimin e historisë sonë shqiptare nga shqyrtimi i faktorit fetar islam që nga Mesjeta e deri më sot. Faktori fetar islam është neglizhuar dhe marginalizuar në tërësi, ndërsa historianët të tjerë qofshin ata kinez, japonez, rus, serb, gjerman, anglez, madje dhe qka është me karakteristike edhe historianët shqiptarët katolik, nuk e kanë neglizhuar faktorin e tyre fetar gjatë studimeve të historisë shqiptare. Unë mbroj qëndrimin se sikur të studiohej historia e shqiptarëve nga ky aspekt i ri, do të përfitonim rezultate të reja të ndritshme e të vlefshme për gjeneratat tona të ardhshme, dhe kjo metodë e re kishte me ndikuar pozitivisht në përmirësimin e botëkuptimeve të devijuara shqiptare rreth Islamit dhe muslimaneve!

⁷⁰ Fjalët në kllapa janë koment i im dhe kisha për qëllim konfirmimin e kësaj dukurie që vërehet te shqiptarët.

Kaukazit. Historia e territoreve të tilla është shkruar pa u theksuar fare elementi fetar që ka të bëjë me muslimanët.⁷¹

Nuk e kam aspak të qartë se si historianët dhe hulumtuesit shqiptarë e harruan këtë fenomen të rëndësishëm fetar islam, posaçërisht kur dihet fakti se kisha serbe historikisht ka luajtur rol negativ dhe të rëndësishëm, madje edhe sot e kësaj dite, vazhdon ta luaj po të njëjtin rol kur bisedohet për çështjet politike, gjeografike e kulturore si dhe për mbrojtjen e trashëgimisë dhe fesë së krishterë, dhe atë bile në mënyrë të studiuar fort mirë. Kjo vërehet qartë dhe publikisht nga ndërtimi i kishave dhe manastireve në vitin 1314 dhe qysh nga kjo kohë, kisha serbe i ka dëbuar shqiptarët që ishin katolikë dhe i ka penguar në kryerjen e riteve të tyre fetare katolike.⁷²

Për këtë që u tha më sipër, profesori dhe hulumtuesi objektiv, Hysamedin Feraj, kur flet për kontinuitetin e këtij fenomeni edhe gjatë pushtetit osman, thotë: *"Zbulimet historike deri më sot vërtetuan se revolucionet shqiptare, mbrojtja qytetare shqiptare dhe lëvizjet shqiptare kundër shtetit osman kanë ndodhur nga cytja e faktorit fetar dhe nga nxitjet e shteteve të vogla evropiane kundër osmanlinjve. Lëvizjet e hershme për t'u shkëputur nga shteti osman filluan të duken në fund të shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX."*⁷³

Nuk është e vërtetë thënia se luftërat fetare kundër shtetit osman nuk kanë ekzistuar te shqiptarët, por e kundërta është e vërtetë.⁷⁴ Historikisht është vërtetuar se prijësit dhe elita shqiptare katolike e atëhershme e pranonin drejtimin ortodoks, gjegjësisht konvertoheshin në ortodoksë, madje një numër i madh prej tyre lidhnin miqësi me serbët, grekët, romakët dhe bullgarët,⁷⁵ vetëm e vetëm për t'u bashkuar e përforcuar kundër shtetit osman dhe muslimanëve.

Ekzistojnë njerëz që dëshirojnë ta fshehin këtë të vërtetë historike përmes tolerancës dhe jetesës së përbashkët fetare e paqësore në mes të shqiptarëve muslimanë dhe feve tjera. Toleranca e tillë fetare në mes shqiptarëve muslimanë dhe të tjerëve ishte një lloj hipokrizie dhe nuk ishte e vërtetë, përkundër asaj që deklaroheshin se simboli i shqiptarëve

⁷¹ Justin McCarthy, **"Death and Exile-the ethnic cleansing of Ottoman Muslims"**; 1821-1922, USA, 3rd Printing 1999, 1-10.

⁷² Po aty, f. 43.

⁷³ Hysamedin Feraj, **"Skicë e mendimit politik"**; 46.

⁷⁴ Bedrush Shehu, **"Çështje kombëtare shqiptare në vitet 30 të shek. XIX"**; 5.

⁷⁵ Muhamet Pirraku, **"Kultura kombëtare"**; 49.

është simbol ateist, dhe parimi “feja e shqiptarit është shqiptaria”,⁷⁶ vazhdoi të mbijetojë deri në ditët e sotshme, gjë që linte të nënkuptohej se gjoja shqiptarëve çështja e fesë nuk u intereson aq sa u intereson çështja kombëtare...

Pastaj armiqësia e fshehur në zemrat e shqiptarëve katolikë kundër shqiptarëve muslimanë akoma vazhdonte të ekzistonte dhe nuk ishte harruar apo braktisur.⁷⁷

Nuk ka dyshim se kjo legjendë historike është mbjellë dhe kultivuar në zemrat e shqiptarëve gjatë periudhës komuniste për qëllime partiake komuniste marksiste, dhe natyrisht të tillët i konsideronin osmanlinjtë kundërshtarë të denjë të tyre, duke thënë se gjendja e shqiptarëve është përkeqësuar më shumë në të gjitha sferat e jetës me depërtimin e osmanlinjve në vatrat e tyre. S'ka kurfare dyshimi se kjo është edhe një gënjeshtër tjetër komuniste që fare s'ka të bëjë me të vërtetën.

Nga ajo që kam lexuar, shfletuar, studiuar e analizuar nga historia e shqiptarëve, vërehet qartë se urrejtja dhe fanatizmi fetar katolik shqiptar kaherë ka ekzistuar në zemrat e tyre kundër vëllezërve të tyre muslimanë shqiptarë. Në këtë kontekst, historiani Georges Castellan thotë: *"Vlen të theksohet se Islami sunnit është ballafaquar me sektin sufist bektashian"⁷⁸ dhe me ata që pranuan sipërfaqësisht Islamin (d.t.th. katolikët dhe ortodokosët) dhe që mbanin dy emra në të njëjtën kohë, një emër musliman dhe një emër të krishterë përpara administratorëve të shtetit osman. Kjo tolerancë fetare nuk ka mjaftuar për zhdukjen e urrejtjes dhe fanatizmit fetar që nxiste grindje e përleshje në mes tyre e që nxitej nga njerëzit e fesë dhe nga shtetet që i përkrahnin, si p.sh., nga Greqia ortodokse, Austria dhe Italia katolike".⁷⁹*

⁷⁶ Kjo thënie nuk është e vërtetë, dhe natyrisht ne nuk e pranojmë këtë thënie, dhe ajo s'ka as bazë logjike dhe as fetare, por përkundrazi e denoncojmë fuqishëm këtë shprehje kriminal ndaj religjionve hyjnore në përgjithësi.

⁷⁷ John Swire, **"Albania-the rise of a Kingdom:"**; f. 34-40; Mehdi Polisi, **"Sami Frashëri"**; vepra 9-**"Personalitetet shqiptare në Kamusul-A'lam"**; Logos-A, Shkup 1994, 33.

⁷⁸ Bektashizmi është sekt (tarikati) sufist i devijuar. Hulumtuesi ka një punim shkencor rreth këtij tarikati dhe primeve të tij në gjuhën angleze me titull: **"The bektashi Sufi Order - General Survey of its History and Doctrines "**.

⁷⁹ Georges Castellan, **"Histori e Ballkanit, shek. XIV-XX"**; Çabej, Libra për një shoqëri të hapur, Tiranë 1991; f.128.

II: ARSYET E SHKATËRRIMIT TË SHTETIT OSMAN, SISTEMI ADMINISTRATIV DHE NDIKIMI TE SHQIPTARËT

Kjo pjesë e hulumtimit ka një rëndësi shumë të madhe, dhe siç theksuam edhe më parë, historia apo çështja e shqiptarëve ka lidhje të ngushtë me historinë e shtetit osman. Historia jonë ka vërtetuar se një numër i personaliteteve shqiptare ka ushtruar poste të larta dhe profesione të rëndësishme në shtetin osman: Disa prej tyre kanë qenë vezirë, sadriazemë (kryeministra)⁸⁰ dhe Shejhul-Islamë në shtetin osman. Sipas studimeve dhe statistikave të disa dijetarëve të mëdhenj, gjatë pushtetit osman, afër dyzetë personalitete të njohura shqiptare kanë ushtruar detyra dhe pozita të larta në hierarkinë e shtetit osman, dhe për këtë shkak, çdo zhvillim apo ndryshim që ndodhte në shtetin osman, qoftë ai pozitiv apo negativ, reflektohej dukshëm tek shqiptarët si në aspektin politik ashtu edhe në atë ekonomik, shoqëror e fetarë. Ndaj, nisur nga kjo, do të përqëndrohemi plotësisht në këtë pikë, me qëllim që t'i studiojmë rrethanat politike e shoqërore që mbizotëronin në atë kohë.

Aspekti tjetër dhe më i rëndësishëm në këtë hulumtim është revolta dhe kryengritja kundër shtetit osman nën udhëheqjen e disa personaliteteve fetare islame, që kishte arritur kulmin në periudhën e dobësimit dhe shkatërrimit të Perandorisë. Dobësimi i shtetit osman sa vinte e rritej dita- ditës dhe në të njëjtën kohë dobësoheshin edhe shqiptarët dhe Shqipëria. Shtetet fqinje katolike dhe ortodokse, si p.sh. Greqia, Serbia dhe Mali i Zi, orvateshin për t'u bërë shtete të pavarura me ndihmën e shteteve fqinje si dhe dëshironin që t'i zgjeronin territoret e tyre në dëm të tokave shqiptare si nga Veriu ashtu edhe nga Jugu e Lindja. Kjo periudhë po ashtu dallohet me lëvizjet e ndryshme evropiane kundër shtetit osman, për shkak të dobësimit të tij, ndaj, nisur nga kjo ai (shteti osman) pranonte çdo marrëveshje e kontratë që kërkohej prej tij, si p.sh.: Tanzimatet dhe reformat administrative që i kishin futur brenda shtetit. Përveç situatës politike, aty ekzistonte edhe rrezik nga aspekti gjeografik, politik dhe kombëtar ndaj shqiptarëve.

Pasi e kuptuam këtë të vërtetë, vlen të thellohem edhe pak më tepër që ta kuptojmë më mirë këtë problematikë, përkatësisht arsyet dhe faktorët që ndikuan në shndërrimin e shtetit të madh, të fortë e gjigant

⁸⁰ **Sadriazem (Sadri Azam)** është personalitet që mund të krahasohet me postin e sotshëm të kryeministrit dhe ka pasur edhe disa emra të ndryshëm, si p.sh. "**Sadru-Ali**", "**Sahibud-Deuleti**", etj. Shih: Suhejl Shaban, "**El-Mu'xhem el-Meusu'ij lil Mustalahat el-Uthmanije et-Tarihije**"; Rijad, Biblioteka El-Melik Fehd-el-Vatanijje, bot. I, 2000, f. 143.

osman në shtet të dobët e të shkatërruar, pas një periudhe të gjatë gjashtë shekulle.

Mendoj se është e rëndësishme që të fillojmë me fjalët historianit të famshëm irakian, prof. Dr. Imaduddin Halilit, i cili në këtë kontekst thotë: *"Dobësimi nuk nënkupton rënie përfundimtare dhe tërheqje nga mejdani, dobësimi nuk vjen menjëherë ose pas një periudhe të shkurtër kohore, por ai vjen si rezultat i faktorëve të ndryshëm përgjatë shekujve. Në këtë fenomen nuk ndikon vetëm një faktor, por shumë faktorë që kanë raporte të ndërlidhura, të cilat duhet të analizohen veçmas, nëse dëshirohet të kuptohet e vërteta. Fenomeni i shkatërrimit të qytetërimit formohet ngadalë dhe qetë për shkak të ndikimit të faktorëve të ndryshëm fetarë, politikë, administrativë, ekonomikë, socialë, gjeografikë dhe etikë".*⁸¹

Në bazë të studimeve dhe hulumtimeve të mia të burimeve të literaturës përkatëse, faktorët e tillë mund t'i reduktojmë në pikat vijuese:

- Sipas disa mendimeve, regresi shkencor industrial dhe ushtarak ishte faktori më i madh i dobësimit të shtetit osman.⁸²
- Sipas disa të tjerëve, krenaria dhe ndjenjat kombëtare që lindën në mesin e popujve të lashtë që jetonin në shtetin osman ishin faktorë më me ndikim, ngase e ndienin veten më superiorë se muslimanët. Kjo lëvizje kombëtare ka filluar me revolucionin grek në vitin 1821.⁸³
- Sipas një mendimi tjetër, zgjerimi ushtarak, politik e fetar rus apo lëvizja ruse fetare ortodokse-pansllaviste, ka luajtur rol goxha të madh në shkatërrimin e shtetit osman për t'i çliruar të krishterët e Ballkanit, përkatësisht të krishterët që jetonin nën ombrellën e shtetit osman.⁸⁴
- Përhapja e ryshfetit dhe korrupsionit të disa guvernatorë lokalë,⁸⁵ ishte po ashtu faktor që ndikoi në këtë çështje. Në periudhën e sulltanëve të fundit, morali fetar kishte rënë, nuk aplikoheshin rregullat e Sheriatit, dhe për rrjedhojë këto faktorë

⁸¹ Imaduddin Halil, **"Haule Avamili Tedehvuril-Hadaretil-Islamijjeti"**; në jurnalshkencor **"El-Texhdid"**, që botohet në Universitetin Ndërkombëtar Islamik, Malajzi, viti VIII, 2000, f. 9-49.

⁸² Justin McCarthy, **"Death and Exile"**; 5-6; Hough Poullton, **"Muslim Identity and the Balkan State"**; 15.

⁸³ Shiko në dy titujt e mëparshëm dhe në të njëjtat faqe.

⁸⁴ Shiko në dy titujt e mëparshëm në f. 13, 14, 18.

⁸⁵ John Swire, **"Albania the rise of a Kingdom"**; 17; Elez Biberaj, **"Albania a socialist maverick"**; 13.

dukshëm ndikuan në shkatërrimin e shtetit osman, posaçërisht kur dihet se vetëm dhjetë sulltanët e parë ishin sulltanë të drejtë me plotë kuptimin e fjalës, të cilët aplikonin dhe i praktikonin ligjet e Sheriatit.⁸⁶

- Humbja e kontrollit të plotë për shkak të luftërave të vazhdueshme, zgjerimit politik e ushtarak të shtetit osman në tri kontinentet e botës, gjegjësisht në Azi, Evropë dhe Afrikë, ngase një zgjerim i tillë e kishte koston mjaft të shtrenjtë, në individë dhe mjete. Historia e shtetit osman është përplot luftëra e çlirime, përveç 28 vjetëve që kishin kaluar pa luftë, në tërë periudhën e gjatë pesëshekullore.⁸⁷
- Imitimi i jetës perëndimore nga ana e disa sulltanëve, si p.sh. ndërtimi i fortifikatave, jetesa luksoze dhe harxhimet e mëdha, gjithashtu dukshëm ndikuan në dobësimin e shtetit, ngase këta individë me sjelljet e tyre grykësore, e futën shtetin në borxhe të mëdha, gjersa edhe bankrotoi në kohën e Sulltan Abdulmexhidit.⁸⁸
- Largimi nga obligimet fetare dhe administrative, si dhe mospërfillja e këshillave të dijetarëve dhe ulemave nga ana e disa sulltanëve konsiderohen⁸⁹ po ashtu faktorë që dukshëm ndikuan në dobësimin e shtetit osman.
- Sipas disa dijetarëve, qysh me vdekjen e Sulltan Sulejman Kanunit të famshëm, në vitin 1566, fillon periudha e dobësimit dhe shkatërrimit të pushtetit osman.⁹⁰
- Sipas disa dijetarëve, shteti osman, gjatë periudhës së fundit, ngërthen idenë kombëtare dhe politikën e turqizmit, ide kjo e lansuar dhe përkrahur nga hebrenjtë e Ballkanit, që jetonin brenda shtetit osman dhe që kishin emra muslimanë. Kjo ide shpërtheu si bombë me sahat, brenda trupit të shtetit osman dhe shkaktoi ndarjen e tij në pjesë më të vogla. Muslimanët akoma sot e kësaj dite janë duke i vuajtur pasojat e një ideje të këtillë.⁹¹

⁸⁶ Mehmet Maksudoglu, “**Ottoman history based mainly on Ottoman sources**”; 340-346.

⁸⁷ Hysamedin Feraj, “**Skicë e mendimit politik shqiptar**”; 68-77.

⁸⁸ Po aty, f. 95.

⁸⁹ Georges Castellan, “**Histori e Ballkanit, shek. XIV-XX, 217-218**”; Nexhip P. Alban-Nesim Koci, “**Shqiptarët në Perandorinë Osmane**”; 22-23.

⁹⁰ Po aty, f. 176.

⁹¹ Ky mendim ishte i mentorit dhe profesorit tim (Allahu i Madhërishëm e mëshiroftë) prof.dr. Muhamed Behaud-din Husejn, nga Duhuku- Kurdistan i Irakut, profesor në

- Dhe në fund sipas mendimit tonë, mund të shtojmë se proklamimi zyrtar i reformave administrative dhe tanzimateve kushtetutare, konsiderohet një ndër faktorët më me ndikim që dobësuan dhe shkatërruan shtetin osman, dhe që nga fillimi i kësaj periudhe, shteti osman veçmë filloi të rrënohet.

Këto ishin ca faktorë të brendshëm dhe të jashtëm që ndikuan në dobësinë dhe shkatërrimin e Perandorisë Osmane. Të vërtetën absolute rreth kësaj tragjedie fetare dhe humane e di vetëm Zoti i Madhërishëm!

S'do mend se ligji më i rëndë dhe më i vështirë për shqiptarët ishte ai i shërbimit ushtarak të obliguar, të cilin ata e refuzonin në çdo mënyrë. Ky ligj po ashtu shoqërohej me nënligje dhe taksa për mbrojtjen e strukturës së ushtrisë së re.⁹² Idetë mbi fillimin e reformave administrative lindën nga disa osmanlinj të shkolluar në shtetet evropiane.⁹³

Koncepti i reformave në shtetin osman në sferën politike nënkuptonte formimin e pushtetit qendror, ndërsa në sferën ekonomike nënkuptonte depërtimin e industrisë në shtetin osman.⁹⁴

Mund të thuhet se reformat e tilla politike shoqërore ndihmuan që të depërtojë mendimi evropian perëndimor në shtetin osman në përgjithësi dhe në mesin e muslimanëve në veçanti. Përveç kësaj, komploti, projektet cioniste-hebraike dhe ato të krishtera-kryqtare ishin faktorë fshumë të rëndësishëm që ndikuan në rënien e shtetit osman.

Reformat e tilla shtetërore ndikuan edhe te shqiptarët, por në aspektin negativ, ngase sipas mendimit të disa dijetarëve, reformat e tilla i dëmtuan shumë shqiptarët... P.sh. administrata civile dhe ushtarake para reformave administrative ishin pothuaj tërësisht në duart e shqiptarëve, kurse pas aplikimit të reformave, nëpunësit vinin nga pushteti qendror

departamentin e studimeve kur'anore dhe të hadithit në Universitetin Ndërkombëtar Islamik në Malajzi. Zoti i Madhërishëm më nderoi kur ai u caktua anëtar i komisionit shkencor për mbrojtjen e doktoratës sime, dhe s'mund ta përshkruaj me fjalë ndihmën dhe përkrahjen e tij të madhe që ma ofroi me anë të udhëzimeve e këshillave shkencore. Unë e çmoj shumë kontributin e tij dhe lus Allahun e Madhërishëm që ta mëshirojë si dhe ta shpërblejë me shkallën më të lartë në Xhen-net, dhe mua të më bëjë si ai!

⁹² Tajar Zavalani, **“Histori e Shqipnisë”**; 170.

⁹³ Skender Rizaj, **“Lidhja Shqiptare e Prizrenit”**; 51; Georges Castellan, **“Histori e Ballkanit...”**; 219; Mehmet Maksudoglu, **“Ottoman history based mainly on Ottoman sources”**; 328-329.

⁹⁴ Hysamedin Feraj, **“Skicë e mendimit politik shqiptar”**; 68; Skender Rizaj, **“Lidhja Shqiptare e Prizrenit”**; 95; Hough Poulltan, **“Muslim identity and the Balkan state”**; 15.

osman dhe nga popujt tjerë joshqiptarë.⁹⁵ Një veprim i tillë ndikoi që shqiptarët të reagojnë ashpër dhe të grinden me të huajt joshqiptarë, të cilët Porta e Lartë osmane i dërgonte në territoret shqiptare.

Nga pasojat negative për shqiptarët ishte edhe dëmtimi i madh i të drejtave të punëtorëve dhe të varfërve shqiptarë, si p.sh. anulimi i pagesës ushtarake, ngase para sjelljes së këtij ligji, shërbimi ushtarak mund të paguhej. Pastaj para këtyre ligjeve të reja, ushtria vazhdonte dhe zgjaste në bazë të luftërave, kurse pas reformave, periudha e shërbimit ushtarak ishte *“prej shtatë deri në dymbëdhjetë vjet”*.⁹⁶

Më pëlqejnë mendimet dhe idetë objektive të historianit shqiptar Hysamedin Ferajt, i cili në këtë kontekst thotë: *“Natyra e reformave komentohej si antishqiptare, gjë që ndikoi në lindjen, formimin dhe cytjen e idesë (së bashkimit kombëtar (H. Hoxha). Po ashtu, ata ndikuan negativisht edhe në traditat shqiptare e që kishin rëndësi dhe vlerë të madhe në rregullimin e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve në vendin e tyre. Ata mendonin se reformat ishin sulm ndaj shqiptarëve.*

Pra, siç vërehet nga kjo që u tha më sipër, tërë kjo situatë ndikoi në përforcimin e idesë së unitetit kombëtar kundër armikut të përbashkët. Ideja e unitetit kombëtar për shqiptarët ishte forma më e mirë dhe më e fuqishme për realizimin e sigurimit kombëtar dhe politik shqiptar, dhe kjo ide ngërthente në vete të gjitha fraksionet shoqërore e fetare që ekzistonin. Në bazë të kësaj ideje, sipas tyre mund të realizoheshin interesat politike të të gjitha shtresave në të gjitha sferat gjuhësore, historike, qendrore e kulturore shqiptare. Ideja e tillë krijoi bashkim politik dhe kulturor, dhe në bazë të këtij parimi lindi ideja e nacionalizmit kombëtar shqiptar.⁹⁷

Këto ishin vetëm disa faktorë të brendshëm dhe të jashtëm, të cilëve hulumtuesi u bëri një përmbledhje të shkurtër, në bazë të studimit dhe hulumtimit të historisë shqiptare, dhe këto ishin disa pasoja negative që i përjetuan shqiptarët pas rrënimit të shtetit osman. S'ka dyshim se ekzistojnë edhe faktorë tjerë, por uroj që ata t'i studiojë ndonjë hulumtues tjetër, për shkak të hapësirës së kufizuar që kam në këtë disertacion.

⁹⁵ Shih më gjerësisht Hysamedin Feraj, **“Skicë e mendimit politik Shqiptar”**; 68-77.

⁹⁶ Po aty.

⁹⁷ Hysamedin Feraj, **“Skicë e mendimit politik shqiptar”**; 68-77; Stavro Skendi, **“Zgjimi kombëtar shqiptar”**; 17-83.

III: ÇËSHTJA E EVROPËS DHE ÇËSHTJA E BASHKIMIT TË SHQIPTARËVE

Me nocionin “Çështja lindore” nënkuptoj atë që e thotë historiani Bedrush Shehu: *“Ngjarjet ballkanike dhe qëllimet e okupimit nga ana e shteteve të mëdha evropiane, orvatjet dhe projektet e tyre për ndarjen e tokave të okupuara ballkanike, dialogu diplomatik ndërkombëtar kundër dhe pro turqve, çështja e popujve të robëruar dhe çështje tjera formulojnë atë që historianët e quajnë “Çështja lindore”.*⁹⁸

Në bazë të studimeve dhe hulumtimeve të mia mbi zhvillimin dhe ngjarjet historike në Ballkan, arrita të konkludoj se ekzistojnë disa faktorë dhe shkaqe kryesore që patën ndikim aktiv dhe të drejtpërdrejtë në çështjen e unitetit kombëtar shqiptar, ku ndër më kryesoret janë:

- Konflikti ruso-austrohungarez rreth pozicionit se kush do të ketë rol udhëheqës dhe dominues në Ballkan,
- Ngjallja e drejtimit kombëtar turanian turk si rezultat i revolucionit francez dhe lëvizja ortodokse sllavo-ruse për dominim politik;
- Vendimet e Konferencës së Londrës dhe të Berlinit, pakti i turqve me rusët në Shën Stefan për ardhmërinë e shqiptarëve; dhe:
- Formimi i shteteve të vogla të krishtera ortodokse përreth Shqipërisë, siç ishin Serbia, Greqia, Mali Zi dhe Bullgaria, të cilat rrezikonin mjaft ardhmërinë shqiptare.⁹⁹

Krahas këtyre faktorëve, edhe zhvillimet politike ndërkombëtare evropiane luanin rol të rëndësishëm për shkak të projekteve të tyre mbi mënyrën e shkatërrimit të shtetit osman.¹⁰⁰ Muslimanët shqiptarë dhe joshqiptarë i përjetonin së bashku zhvillimet e çështjes orientale, posaçërisht zhvillimet që ndodhën në territoret shqiptare.¹⁰¹

⁹⁸ Bedrush Shehu, “Çështje shqiptare në vitet e 30-ta të shek. XIX”; 15.

⁹⁹ Hysamedin Feraj, “Skicë e mendimit politik shqiptar”; 38.

¹⁰⁰ Më gjerësisht mbi historinë e Austro-Hungarisë në Bosnjë e Hercegovinë, shih: Fikret Karçiç, “The Bosniaks and the challenges of modernity, late Ottoman and Habsburg times”; 20-125; Journal of Islamic Studies, vol. 5, nr. 2, July 1994, Oxford University press; “Islam in the Balkans”; Alexander Lopasic, “Islamization of Balkans with special reference to Bosnia”; 163-186.

¹⁰¹ Më gjerësisht shiko dy veprat e historianit tonë të njohur prof.dr. Skender Rizaj, “Lidhja shqiptare e Prizrenit”; 39; dhe: “Historia e përgjithshme; Koha e re-1453-

Sa i përket lëvizjes fetare sllavo-ortodokse ruse, mund të thuhet se kjo lëvizje ka pasur për qëllim çlirimin e të krishterëve ortodoksë nga pushteti osman dhe austriak, me pretekst se banorët e Rusisë, Polonisë, Çekosllovakisë, Serbisë, Kroacisë, Bullgarisë dhe Sllovenisë janë një popull me një rrjedhë gjaku.¹⁰²

Të gjithë ata besonin se Evropa ishte e sëmurë dhe se kishte ardhur koha që të shkatërrohet e të zhduket, dhe se pas shkatërrimit të saj, do të formohet një perandori e madhe me seli në Stamboll. Kur filloi lufta ruso-osmane në vitin 1853-1856, ata filluan të mendojnë se ishte afuar koha e formimit dhe themelimit të perandorisë së madhe e të shumëpritur.¹⁰³

Historia na rrëfen se bashkimi i Gjermanisë Lindore me atë Perëndimore në vitin 1871, i nxiti ndjenjat e rusëve për realizimin e ambicieve dhe aspiratave të tyre fetare, kjo vërehet qartë edhe nga fjalët e orientalistit më të njohur rus, Nikolaj Jakovleviq Danilevski, i cili në librin "Rusia dhe Evropa", thotë: "*Çështja orientale në shek. XIX ishte një hallkë në zinxhirin e luftërave të gjata në mes Romës dhe Greqisë, gjegjësisht në mes Romës katolike dhe Greqisë ortodokse, ndaj nisur nga kjo, gjermanët konsideroheshin përkrahës të Romës, ngase ishin katolikë, ndërsa rusët ishin ithtarë bizantinë ortodoksë*".¹⁰⁴

Në bazë të këtij raporti do të zhvillohen luftëra të vazhdueshme, posaçërisht kur dihet se fenomeni i urrejtjes fetare tek rusët do të ekzistojë në zemrat e tyre gjer në Ditën e Kijametit.

Meqë në Evropë dominonin tri perandori: Perandoria e Rusisë, e Gjermanisë dhe ajo e Austro-Hungarisë, ato, shpeshherë takoheshin në Berlin, Vjenë apo Petrovgrad, me qëllim që t'i planifikojnë projektet e ardhmërisë¹⁰⁵ së Evropës. Dhe kështu ata lypnin çështje që kishin të bënin me pozicionet e popujve të krishterë ortodoksë sllavë, i financonin dhe shpirtërisht i përkrahnin ata, derisa nxitën kryengritje të popujve të krishterë në Bosnjë e Hercegovinë, në Mal të Zi dhe në Serbi kundër shtetit osman, gjë e cila edhe ndodhi, përkatësisht u realizua.¹⁰⁶

1789"; Prishtinë, Universiteti i Kosovës në Prishtinë, bot. II, 1983, 317-321 dhe f. 355-356.

¹⁰² Skender Rizaj, "**Lidhja Shqiptare e Prizrenit**"; 40; Mehdi Frashëri, "**Historia e lashtë e Shqipërisë dhe shqiptarëve**"; 34-35.

¹⁰³ Po aty, f. 40.

¹⁰⁴ Skender Rizaj, "**Lidhja Shqiptare e Prizrenit**"; 43.

¹⁰⁵ Skender Rizaj, "**Lidhja e Prizrenit**"; 44; Georges Castellan, "**Histori e Ballkanit**"; 342.

¹⁰⁶ Mehmet Maksudoglu, "**Ottoman history based manily on Ottoman sources**"; 293; Justin McCarthy, "**Death and Exile**"; 6,10,12.

Pas ngjarjeve të tilla, Serbia dhe Mali i Zi, nën ndikimin e lëvizjes sllavo-ortodokse ruse, më 01.07.1876 i shpallën luftë shtetit osman. Me kalimin e kohës, rreziku nga lëvizja ruse sa vinte e bëhej akoma edhe më i qartë, derisa erdhi tek konflikti i Islamit me krishterimin ose i muslimanëve me të krishterët, përkatësisht Evropës me Azinë. Në të njëjtën kohë, edhe Anglia i shpalli luftë pushtetit osman, dhe kështu, situata u përkeqësua edhe më shumë,¹⁰⁷ sa që tërë forcat kryqtare botërore u bashkuan kundër shtetit osman, gjegjësisht kundër Islamit dhe muslimanëve.

E gjithë kjo rezultoi me Konferencën e Berlinit, ku merrnin pjesë shtetet më të mëdha evropiane, që u mbajt nga 23.12.1876 deri më 20.01.1877, ku edhe doli në shesh e vërteta, përkatësisht urrejtja fanatike fetare e kombëtare kundër Islamit dhe muslimanëve, dhe ku u vendos që të shtronin kërkesa të rënda dhe tepër të vështira për shtetin osman. Në Berlin, doli në pah dhe u diskutua edhe çështja e shqiptarëve.

Në këtë Konferencë u vendos që:

- Të largohen armët nga muslimanët e Bullgarisë dhe Bosnjë e Hercegovinës;
- Të largohen nëpunësit muslimanë nga këto vende;
- Të formohet policia vetëm nga të krishterët;
- T'i lejohet ushtrisë osmane të qëndrojë nëpër kalatë e larta;
- Të mënjanohej pagesa e një të dhjetave dhe tagrambledhësit të jenë vendas;
- Të përdoret gjuha sllavo-ortodokse në gjykatë dhe administratë;
- Të emërohen guvernatorë të krishterë ashtu siç ishin emëruar në Liban; dhe:
- Të dënohen muslimanët që kishin marrë pjesë në krimet kundër të krishterëve dhe obligimi i tyre për kompensime materiale.¹⁰⁸

Në këtë dokument nuk bisedohej aspak për shqiptarët, çështja e tyre ishte lënë në harresë, diplomatët perëndimorë madje as që e kishin potencuar këtë çështje.¹⁰⁹

Pasi dolën nga kjo Konferencë të nënçmuar dhe kokëulur, duke mos u pajtuar me këtë dokument, ngase shteti osman në mënyrë kate-

¹⁰⁷ Po aty, f. 48.

¹⁰⁸ Skender Rizaj, **“Lidhja Shqiptare e Prizrenit”**; 48-49; Nexhip P. Alban-Nesim Koci, **“Shqiptarët në Perandorinë Osmane”**; 34; **“Historia e Popullit Shqiptar”**-vëll. 2; 106-173.

¹⁰⁹ Është për t'u habitur fakti se profesori turk dr. Mehmet Maksudoglu, në librin e tij nuk ka përmendur asgjë mbi shqiptarët në shtetin osman dhe mbi rolin e tyre në këtë shtet, kur në tërë librin e tij flet për historinë e shtetit osman, vërtet çudi!!!

gorike kishte refuzuar përmbajtjen e tij, kulminacioni i nënçmimit arriti më 26.06.1878, kur Rusia, nuk ngurroi t'i shpall luftë shtetit osman.

Në këto çaste mjaft kritike dhe të vështira, edhe Serbia dhe Mali i Zi i shpallën luftë shtetit osman, duke shfrytëzuar rastin e preokupimit të osmanëve me Rusinë, kësisoji duke menduar se shteti osman, nuk do të ketë mundësi të sundojë përsëri.¹¹⁰

Duke marrë parasysh dobësinë e shtetit osman si në numër ashtu dhe në pajisje, plotësisht ishte e qartë se nuk ishte e favorshme për ta, që të zhvillojnë një luftë me Rusinë, ku rezultatet dështuese veçmë ishin në dukje. Ndaj, nisur nga kjo, shteti osman u detyrua të nënshkruaj marrëveshje me Rusinë, e cila përmbante edhe 29 nene që ishin kundër shqiptarëve, përkatësisht kundër ardhmërisë së tyre politike, gjeografike, kombëtare dhe kulturore.¹¹¹

Një situata e tillë ndikoi që shqiptarët fuqishëm të reagojnë kundër zhvillimeve politike që ishin kundër tyre dhe kështu në vitet 1878-1885, e formuan Lidhjen Shqiptare të Prizrenit me qëllim për t'u mbrojtur nga rreziku që u kërcënohej. Kjo Lidhje Shqiptare ishte si një revolucion i përgjithshëm shqiptar kundër qëndrimeve të shtetit osman dhe marrëveshjeve të tij me shtetet e mëdha kolonizuese, e që ishin në dëm të tyre. Kjo Lidhje ka rëndësi të madhe në historinë e kohës bashkëkohore të shqiptarëve. Kur bisedohet për faktorët dhe shkaqet që ndikuan në formimin e saj, historiani i njohur, prof.dr.Skender Rizaj, thotë se ishin katër faktorë të jashtëm dhe të brendshëm që ndikuan në formimin e Lidhjes:

1. Mosmarrëveshjet dhe grindjet në mes shteteve të mëdha në llogari dhe në dobi të shqiptarëve;
2. Reformat politike shoqërore dhe administrative të shtetit osman kundër interesave të shqiptarëve;
3. Deportimi dhe dëbimi i një numri të madh të shqiptarëve nga shtëpitë e tyre; dhe;
4. Nevoja e madhe dhe obliguese për pavarësi.¹¹²

Kjo Lidhje në fillim nuk dëshironte të ndahej nga shteti osman, por kërkonte pavarësi në kuadër të këtij shteti.

Shkaku kryesor i daljes në shesh të kësaj Lidhje nënkuptohet qartë nga fjalët e historianit turk që i thekson profesori i njohur Skender Rizaj: *"Nga lufta turko-ruse në vitin 1877 doli në pah fakti se shtetet fqinje të Ballkanit dëshironin t'i zgjerojnë kufijtë në dëm të shqiptarëve dhe tokave*

¹¹⁰ Po aty f. 67; Uthman Uglu, **"Mudhekkirâtul-Emireti Aishe"**; Validi Es-Sulltan Abdulhamid Eth-Thâni, 11-56.

¹¹¹ Skender Rizaj, **"Lidhja Shqiptare e Prizrenit"**; 69-70.

¹¹² Skender Rizaj, **"Lidhja Shqiptare e Prizrenit"**; 8.

*të tyre. Gjendja e tillë i nxiti shqiptarët të mendojnë për ardhmërinë e tyre dhe për situatën e tyre nëse shkatërrohet shteti osman. A mund të pranojnë pushtetin grek ose serb e të rikthehen në robëri?! Ky ishte shkaku që nxiti formimin e Lidhjes Shqiptare për të formuar qeveri kombëtare në Shqipëri e pastaj të ndahen nga pushteti osman”.*¹¹³

Siç vërehet nga ky raport, shqiptarëve rreziku u kanosej nga të gjitha anët. Profesori i njohur thekson se një ndër personalitetet fetare islame që ndihmuan dhe morën pjesë në formimin e Lidhjes ishte Shejhu, Myftiu e Muderrisi, Haxhi Ymer Prizreni,¹¹⁴ Shejh Haxhi Zeka dhe gjykatësi i Sheriatit Shejh Ahmed Korenica, si dhe disa personalitete të njohura nga viset tjera mbarëshqiptare.

Dhe në fund, në Luftën Ballkanike 1912-1913, kur u kërcënohej rreziku para dyerve nga ndarja dhe coptimi i vendit, më 28.11.1912 në qytetin e Vlorës-Shqipëri, shpallën Deklaratën e Pavarësisë së Shqipërisë, nën udhëheqjen e aktivistit dhe intelektualit të njohur shqiptar, Ismail Qemali.¹¹⁵

Pra, në këto rrethana, shqiptarët vendosën për pavarësinë e shtetit të tyre dhe ndërmorën një hap të tillë kombëtar, duke shpallur shtetin e tyre, për të pasur një vend ku do të përqëndrohen dhe të cilin do ta mbrojnë. Jam i bindur se, sikur shteti osman të sillej mirë me shqiptarët, sikur t'i mbronte dhe sikur t'i plotësonte disa kërkesa të tyre, ata do të ishin përkrahës dhe ndihmues më të mirë për ta, ngase një gjë e tillë ngaherë është dëshmuar dhe vërtetuar historikisht,¹¹⁶ kur dihet se në çdo ekspeditë ushtarake osmane, komandanti ishte shqiptar për shkak të karakteristikave që i dallonin, siç ishin trimëria, besa, komandimi dhe aftësitë/shkathtësitë ushtarake. Shteti osman po të mendonte kështu dhe sikur edhe më shumë të investonte në to, atëherë nuk do të rrënohej...Por, megjithatë të vërtetën e di vetëm Zoti!

¹¹³ Skender Rizaj, **“Lidhja shqiptare e Prizrenit”**; 115. Marrë nga Mehmet Ali Ayni **“Milliyetçilik”**; 279-280.

¹¹⁴ U lind në vitin 1820 në qytetin e Prizrenit dhe u dallua për aktivitete fetare, sufiste dhe kombëtare. Vdiq në Ulqin të Malit të Zi në vitin 1886 në rrethana misterioze. Ai ishte i përndjekur nga shteti osman. Më gjerësisht për jetën e tij shih: Abib Ahmeti, **“Theranda, Prizreni ndër shekuj”**; Orient, Prizren, 1996, f. 175-177.

¹¹⁵ Më gjerësisht shih: Skender Rizaj, **“Lidhja shqiptare e Prizrenit”**.

¹¹⁶ Nexhip P. Alpan-Nesim Koci, **“Shqiptarët në Perandorinë Osmane”**; 15; **“Historia e Shqipërisë”**-vëll. 2; 243.

IV: ÇËSHTJA E EMIGRIMIT DHE EMIGRANTËVE

Nga ajo që theksuam më parë rreth zhvillimeve, ndryshimeve dhe luftërave të ndryshme në territoret shqiptare, vërehet se çështja orientale kishte filluar të trajtohet nga aspekti politik, ekonomik, shoqëror dhe fetar. Një prej çështjeve të tilla ishte edhe ajo e emigrimit dhe emigrantëve muslimanë, të cilët përkundër vullnetit të tyre u detyruan të emigrojnë në vende të ndryshme e të largohen, duke bartë me vete fenë, shpirtin dhe atë që mund të bartet.

Forcat ruse, serbe dhe ato bullgare, kishin bërë një marrëveshje për realizimin e këtij projekti dhe kishin filluar në praktikë ta aplikojnë, kështu, duke detyruar të emigrojnë shumë muslimanë, ndërsa në vend të tyre sillnin kolonë serbë, rusë, bullgarë dhe malazezë. Në këtë pjesë do t'i shqyrtojmë ngjarjet më të rëndësishme që kishin ndodhur gjatë emigrimit dhe deportimit.

Sipas historianëve gjendja aktuale politike në rajonin e Kosovës, paraqitej shumë e keqe, ndaj dhe në këtë kontekst, parlamentari shqiptar në shtetin osman, Osman Mustafa Efendiu, thotë: *"Qytetet kosovare Piroti, Prokuplja dhe Leskovci që i takojnë Vilajetit të Kosovës janë okupuar nga Serbia. Çdo qytet në Vilajetin e Kosovës konsiderohet si Shqipëri, madje është shpirt dhe zemër e Shqipërisë"*.¹¹⁷

Ekzistonin një varg i faktorëve të shumtë që ndikuan dhe ndihmuan në emigrimin e shqiptarëve nga vatani i tyre: Disa prej tyre ishin fetarë, ndërsa disa të tjerë ekonomikë dhe politikë. Por, siç duket, shkakun më kryesor ishte shërbimi ushtarak i obliguar në favor të serbëve të krishterë ortodoksë, kur veçmë botërisht dihet dhe është e qartë se shqiptarët muslimanë pikërisht më shumë se gjithçka tjetër e urrenin uniformën ushtarake serbe.¹¹⁸

Një nga arsyet që i kishin detyruar shqiptarët dhe muslimanët të emigrojnë ishte terrori i madh dhe presioni i ashpër që ushtronin rusët, serbët dhe malazezët ndaj tyre,¹¹⁹ për të mbrojtur fenë e krishterë sllave.

¹¹⁷ Skender Rizaj, *"Lidhja Shqiptare e Prizrenit"*; 77-78.

¹¹⁸ Po aty, f. 79.

¹¹⁹ Për therjet, masakrat dhe ekzekutimet e tjera të kryera nga serbët dhe malazezët ndaj shqiptarëve muslimanë, shikoni më gjerësisht në burimet dhe dokumentet historike të rëndësishme: *El Mexhzeretu fi Jugosllafia - Thertorja në Jugosllavi*, Kuvajt, Darul-Vithak; Zekeria Cana, *"Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullatën shqiptare 1912-1913-*

Literatura historike i konfirmon krimet e tyre që bëheshin në forma nga më të ndryshmet, p.sh.: Përdhunimi i grave muslimane, vjedhja dhe konfiskimi i pasurisë së muslimanëve, duke i shndërruar kështu, brenda natës në të varfër e të sëmurë, pastaj djegia e xhamive, dyqaneve dhe pronave tjera, si dhe shumë lloje tjera të maltretimeve, të cilat madje as fjalët nuk mund t'i përshkruajnë.¹²⁰

Shqiptarët muslimanë gajloheshin për mbrojtjen e identitetit kombëtar dhe fetar, por nga presionet e mëdha që i përjetonin nga serbët, malazezët dhe grekët që ishin fanatikë dhe urryes të egër, më në fund, u detyruan të marrin rrugën e emigrimit.¹²¹ Përveç kësaj, frika e muslimanëve të Ballkanit nga konvertimi i tyre në të krishterë ortodoksë sllavë, ishte shkas që shqiptarët të fillojnë të mendojnë për emigrim, ashtu siç ndodhi fatkeqësisht me muslimanët e Bullgarisë, ku pjesa dërrmuese e tyre u konvertua në të krishterë, ngase ata që bëheshin të krishterë, u shpëtonin ekzekutimeve dhe torturave çnjerëzore serbe dhe bullgare.¹²²

Sipas disa historikanëve tjerë, shkas i emigrimit të shqiptarëve ishte edhe faktori ekonomik. Ky faktor është relativisht i vërtetë, ngase vetëm një numër i vogël i tyre ishte larguar për shkaqe ekonomike. Ithtarë të kësaj ideje janë evropianët perëndimorë të krishterë.

Njëri prej tyre thotë: *"Zhvillimet ekonomike dhe shoqërore të shek. XIX ndikuan që një valë emigrimesh në grupe të marrin rrugën për në Stamboll, e që numri i tyre përbëhej prej 60 mijë emigrantësh. Ata merrnin rrugën për në Greqi, Egjipt, Rumani, Rusinë Jugore, Itali dhe në fund për në Amerikë e Australi. Nëpërmes kontakteve me banorët tjerë, këta emigrantë patën sukses të luajnë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e identitetit kombëtar shqiptar"*.¹²³

(Dokumente)"; Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1996, 11; Azem Ajdini, **"Masakra srbo-malazeze e Tivarit"**, Edlor, Tiranë 1998; Huseyin Kansu, **"Kosova inkinci Bosnya olmasin"**; Yildizlar Matbaasi, Istanbul 1998; Huseyin Kansu, **"Kosova inkici Bosnja olmasin"**, Yildizlar Matbaasi, Istanbul 1998, 11-33; Hakif Bajrami, **"Kosova-njëzet shekuj të identitetit të saj-argumente historike"**; Era, Prishtinë 2001, 77-81; AIITC, **"Gjenocidi serb në Kosovë"**, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, sesion shkencor, qershor 1999, 35, 44, 65; Harrila Kola, **"Gjenocidi serb ndaj shqiptarëve në viset e tyre etnike në Jugosllavi, 1941-1967"**; Elton, Tiranë 2000, 116-222; Bedri Tahiri, **"Adem Jashari legjendë e legjendave"**; Rilindja, bot. III, Prishtinë 2001; Bedri Tahiri, **"Agu i Lirisë-kronikë lufte, 22.02.1999-22.06.1999"**; Zëri i Kosovës, Prishtinë 2001.

¹²⁰ Justin McCarthy, **"Death and exile"**; 131-141.

¹²¹ Po aty, f. 1, 19, 59, 94.

¹²² Po aty, f. 152-153.

¹²³ Georges Castellan, **"Histori e Ballkanit"**; 379-380.

Siç thash edhe më parë, shqiptarët e Shqipërisë Jugore, të cilët ishin ortodoksë, emigruan për arsye ekonomike dhe të jetesës, por jo edhe shqiptarët muslimanë që jetonin në veri të Shqipërisë ose në vilajetet tjera shqiptare.¹²⁴

Emigrimi i detyruar i shqiptarëve nga toka e tyre ishte projekt dhe ide e lashtë serbe. Një historian serb që ishte përkrahës i fortë i idesë së deportimit të shqiptarëve dhe zëvendësimin e tyre me njerëz tjerë nga Jugosllavia, shprehet se, Serbia nëse dëshiron të jetojë e sigurt dhe e qetë, duhet patjetër ta pastrojë tokën e saj nga elementet e huaja, përpos elementit serb. Ky kriminel thoshte se shqiptarët dhe muslimanët kanë emigruar me dëshirë pa kurrfarë dhune ose detyrimi rus, serb apo bullgar!!!¹²⁵

Fenomeni i emigrimit kolektiv të muslimanëve shqiptarë zhvillohej në bazë të një marrëveshjeje të fshehtë në mes të Turqisë dhe Jugosllavisë gjatë viteve 1939-1944,¹²⁶ për ta zbrazur dhe liruar tokën shqiptare dhe për vendosjen e banorëve të rinj, kolonëve serbë aty. Pushteti jugosllav detyroi të emigrojnë më shumë se tetë mijë familje shqiptare muslimane me forcë dhe dhunë, ashtu siç kishte vepruar edhe në qytetet kosovare Pirot, Leskovc, Prokuplje, Vranjë dhe Kurshumli,¹²⁷ si dhe në qytet e tjera, duke ua djegur shtëpitë, konfiskuar pronat, shkatërruar fshatrat dhe duke përdorur mënyra të ndryshme të dhunës shtazarake. Vërtet u ndërmorën vepra të shëmtuara dhe vandale vite me radhë kundër muslimanëve shqiptarë, përkatësisht në gjysmën e parë të shek. XX, kur u dogjën dhe u shkatërruan 182 fshatra shqiptare muslimane.¹²⁸

Prijësat fetarë Islam, hoxhallarët dhe ulematë, nuk rrinin duarkryq, por mendonin për çështjet e vatanit të tyre dhe të muslimaneve, dhe

¹²⁴ Petrika Thëngjilli, **“Historia e Shqipërisë”**; 27; Muhamed Mufaku, **“Shqiptarët në botën arabe”**; 97-130; Haris Silajxhiç, **“Shqipëria dhe SHBA-të në arkivat e Uashingtonit”**-(**“Albanija i SAD, Kroz archive Vashingtona”**); 1991, përkthyer nga Xhelal Fejza, Dituria, Tiranë 1999; 25-42.

¹²⁵ Skender Rizaj, **“Lidhja Shqiptare e Prizrenit”**; Zamir Shtylla, **“The Deportation of Albanians in Yugoslavia after the Second World-War 1950-1966”**; 233-239; Vaso Çubriloviq, **“The Problem of Minorities in the Now Yugoslavia: The truth on Kosova”**; 301-306.

¹²⁶ Kjo ishte periudha e sundimit të Ataturkut dhe pas rënies së halifatit osman. Zyrtarisht në vitin 1924, pushtetin në Turqi e morën masonët hebrenj, d.t.th. pushteti administrativ, ekonomik dhe ai politik ra në duart e masonëve.

¹²⁷ Emin Plana, **“On the deportation of Albanians from the territory of Sanjak, of Nish, of Kosova 1877-1878-The Truth on Kosova”**; 73-78.

¹²⁸ Hakif Bajrami, **“Kosova njëzet shekuj të identitetit të saj”**; 84.

përcillnin me vëmendje situatën politike. Edhe pse nuk kam hasur në ndonjë studim mbi aktivitetet e hoxhallarëve shqiptarë në situata të tilla, siç ndodhi në Mesjetë, fjala bie me ulematë e Bosnjë e Hercegovinës dhe disa të tjerë në vende të ndryshme, p.sh.: Në vitin 1563, në Moricous, myftiu i komunës së Oranit e lejoi praktikimin e devotshmërinë së fshehtë, (Al takij-jetu) nëse muslimanët me dhunë detyrohen të bëhen të krishterë, duke i lejuar që vetëm me fjalë dhe formalisht të deklarojnë kufrin (mosbesimin) dhe shirkun (politeizmin), përderisa zemrat e tyre ishin përplot iman (besim).¹²⁹

Tokat shqiptare kishin edhe hoxhallarë të atillë që refuzonin dhe haptazi luftonin kundër dhunës, diktaturës, tiranisë dhe armiqësisë së krishterë fanatike serbe. Myftiu i qytetit të Prishtinës, Zenel-Abidin Efendiu, i cili ishte parlamentar në shtetin osman, qe trim dhe shumë i spikatur. Ai qysh herët e kishte kuptuar të vërtetën dhe mjerimin e shqiptarëve dhe thoshte se nëse situata vazhdon kështu, vendin do ta banojnë serbë të rinj që vijnë nga Serbia për qëllime banimi, dhe në këtë mënyrë muslimanët do t'i humbin tokat e tyre shekullore stërgjyshore.

Myftiu i lartëpermendur ka përgatitur edhe një raport mbi situatën në Vilajetin e Kosovës dhe e ka paraqitur atë në Parlamentin osman, dhe pasi është lexuar para parlamentarëve të shtetit osman, Myftiu është ngritur në këmbë dhe ka thënë: *"Zotërinj! Lexova letrën e dërguar nga Vilajeti i Kosovës që në mënyrë të qartë e të kuptueshme na sqaronte për gjithçka po ndodh atje. Ndaj, shkurt thënë: Të shkojmë atje e të luftojmë! Në të kundërtën ose të vdesim, ose të zgjedhim "ndonjë alternativë" tjetër për sigurimin dhe mbrojtjen e vendit tonë"*.¹³⁰

Sa qëndrim i mrekullueshëm dhe sa fjalë të sinqerta e vendimtare, por siç duket kjo letër nuk depërtoi në veshin e parlamentarëve dhe atyre që ishin të pranishëm! Mjerisht, muslimanët u deportuan nga fshatrat dhe nga shtëpitë e tyre, ngase rusët dhe bullgarët ua shkatërronin dhe digjnin shtëpitë e tyre, dhe ata kështu detyroheshin të ikin e t'i braktisin vatrat e tyre shekullore, siç ishte p.sh. ngjarja e muajit prill të vitit 1877. Ushtria ruse i armatoste bullgarët dhe i nxiste në luftë të shenjtë fetare ortodokse, se si t'ua djegin shtëpitë muslimanëve dhe t'i thernin ata. Nga ana tjetër, pushteti i krishter i Malit të Zi u kërcënohej muslimanëve vendas dhe i

¹²⁹ Journal of the Internacional Institute of Islamic Thought and Civilization, (ISTAC), vol. 6:1, Abdal-Rahim Muddathir, **"Muslim Minorities in Western Societies, the Medieval scene"**; 10.

¹³⁰ Skender Rizaj, **"Lidhja Shqiptare e Prizrenit"**; 78. Marrë nga Basbakanlik arsihi, Istanbul, Meclisi Meb'usan, II-ed, cild 13, Aralık 1877 -16 Subat, 1878 In'ikadlar, Istanbul 1954, 77-78.

vinte para dy mundësive: Ose të emigronin e t'i braktisnin fshatrat e tyre, ose të merrnin armët e të luftonin kundër tyre.¹³¹ Kjo gjendje ishte një sprovë tejet e vështirë për muslimanët, ngase “Ose të luftonin ose t'ua linin pasurinë, shtëpitë dhe pronën serbëve”¹³² - të dy këto opsione ishin të hidhura. Në bazë të njohurive të mia, asnjë shqiptar musliman nuk ka pranuar t'i shërbejë ushtrisë serbe dhe malazeze, por me zemër të thyer ka preferuar të emigroj.

Dhe kështu, shqiptarët e Nishit, që ishte qytet i Vilajetit të Kosovës, emigruan kah mesi, pasi ishin në Verilindje të Kosovës, disa të tjerë shkuan në Stamboll, ku përjetuan jetë të vështirë, pa para, pa pasuri e pa tokë. Sipas të dhënave statistikore vetëm gjatë viteve 1877-1879 u deportuan më shumë se një milion shqiptarë dhe muslimanë nga Ballkani në shtete tjera.¹³³

Është krejtësisht për t'u habitur me qëndrimet dhe sjelljet e shtetit osman gjatë periudhës së fundit, përkatësisht ndaj mënyrës së transportimit të emigrantëve të tillë, ngase, ai madje kishte huazuar edhe anije nga Anglia, Franca, Egjipti dhe Rusia dhe kishte caktuar vende të posaçme për zbarkimin e tyre në Edrene, Stamboll, Çanak Kala, Samsun dhe Izmir.¹³⁴

Numri i emigrantëve dhe refugjatëve sa vinte e rritej, ai gjithnjë ishte në rritje e sipër dhe drejtohej në rrugë të ndryshme gjatë ikjes së tyre. Gjendja e tyre u përkeqësua aq shumë, sa që filluan të lypnin nëpër rrugët e vendeve ku ishin vendosur, siç ishte p.sh. rasti në Prizren, ku dhjetëmijë të deportuar ishin vendosur dhe ishin nën kujdesin e këshillave të posaçëm që ishin formuar për t'u kujdesur për ta.¹³⁵

Emigrantët muslimanë edhe pse jetonin çaste të vështira në kurbet, nuk rrinin të qetë, por lëviznin për të siguruar vetveten e tyre, duke shkruar 145 ankesa, duke bërë demonstrata për të fituar opinionin publik, duke mbrojtur ndarjen dhe copëtimin e tokave të tyre në favor të serbëve, duke kërkuar prej shteteve perëndimore të ndërhyjnë dhe t'u lejohet të

¹³¹ Skender Rizaj, “**Lidhja Shqiptare e Prizrenit**”; 79.

¹³² Rreth statistikës, gjegjësisht numrit më të saktë të emigrantëve dhe të deportuarve nëpër vendet e botës, shih: Justin McCarthy, “**Death and exile**”; 88-91, 159, 161, 162, 163, 164; Sipas historianit të njohur shqiptar, Skender Rizaj, ambasadori britanik në Stamboll Layard ka thënë se ushtria ruse dhe bullgare ka pasur për qëllim deportimin e tërë muslimanëve nga Ballkani dhe konfiskimin e pasurive dhe pronave të tyre; Skender Rizaj, “**Lidhja shqiptare e Prizrenit**”; 81; Hough Poullton, “**Muslim identity and the Ballkan State**”; 19-20.

¹³³ Skender Rizaj, “**Lidhja Shqiptare e Prizrenit**”; 80.

¹³⁴ Po aty, 80-81; Hough Poullton, “**Muslim identity and the Ballkan State**”; 146-148.

¹³⁵ Po aty.

rikthehen në shtëpitë e tyre, por të gjitha këto pa asnjë sukses. Tokat e tyre u humbën dhe pasuritë e tyre shkuan pa kthim, madje edhe shpirti i tyre ishte shkatërruar në vendet e huaja e të panjohura, ku nuk dihej se ç'do të sillte e nesërmja, përkatësisht ç'do të bëhej me jetën e tyre. Të vërtetën e kësaj gjendjeje më së miri e di vetëm Zoti i Madhërishëm!¹³⁶

Në bazë të dhënave që i kemi nga burimet historike, vërehet qartë se disa emigrantë muslimanë janë nisur nga Ballkani për në Anadoli, disa të tjerë në Siri, disa në Qipro dhe disa të tjerë në Siujdhesën Arabe, në Halep, Damask, Adana, Diarbakir, Selanik, etj.¹³⁷ Ndërsa, vetëm në Vilajetin e Kosovës ishin vendosur afër 200 mijë emigrantë, mbi 5000 në qytetin e Kumanovës në Maqedoni, si dhe në shumë vende tjera, kuptohet që të gjitha nuk mund t'i përmendim këtu.¹³⁸ Por, na duhet patjetër të përmendim e të sqarojmë një çështje shumë të rëndësishme: Dëshirën e flaktë të emigrantëve shqiptarë në përgjithësi, dhe atyre muslimanë në veçanti, për t'u kthyer në atdheun dhe pasuritë e tyre, mirëpo, shteti osman i pengonte mjaft, saqë disa punonjës të shtetit osman këtë pengesë madje e paguan edhe me vdekje nga dora e emigrantëve, kjo për shkak se punonjësit e tillë osmanlinj i pengonin dhe nuk i lenin të ktheheshin në atdhe emigrantët.¹³⁹

Një qëndrim i tillë i shtetit osman nuk ishte në rregull dhe ishte i gabuar dhe mjaft i keq, ndaj dhe assesit nuk u falet një gjest, përkatësisht veprim i tillë. Shteti osman është dashur t'u lejojë të kthehen individualisht ose kolektivisht në trojet e veta, dhe nëse luftonin, do të luftonin për atdheun e vet deri në vdekje kundër serbëve dhe malazezve. Por, siç duket dobësimi i shtetit osman gjatë kohëve të fundit ka ndikuar që më, as Serbia e as Mali i Zi të mos frikësohen nga pushteti osman dhe të mos i japin ndonjë rëndësi të madhe.¹⁴⁰

¹³⁶ Po aty, f. 83.

¹³⁷ Justin McCarthy, **"Death and exile"**; 36-37, 65, 89; **"Muslim identity and the Balkan States"**; Yulian Konstantinov, **"Strategies for sustianity a vulnerable idetentity-case of Bulgarian Pomaks"**; 33-53.

¹³⁸ Numri i emigrantëve boshnjakë kishte tejkaluar 50 mijë gjatë sundimit austro-hungarez në mes viteve 1878-1918. Më gjerësisht shih: Fikret Karçiq, **"The Bosniaks and the challanges of modernity"**; 53; Journal of islamic Studies, 5:2, July 1994; Dr. Muhamed Mufaku, **"Two Hijras and two Fatwas"**; 242.

¹³⁹ Skender Rizaj, **"Lidhja Shqiptare e Prizrenit"**; 87-88.

¹⁴⁰ Krahazo fenomenin e procesit të emigrimit të shqiptarëve dhe emigrimin e muslimanëve të Bosnjës në bazë të të dhënave në Journal of Islamic Studies, 5, 2 July, 1994, **"Islam and Muslims in Bosnia"**; Dr. Muhamed Mufaku, **"Two Hijras and two Fatwas"**; 242-253.

Në bazë të të dhënave historike franceze, osmane dhe angleze që disponojmë, edhe emigrantët që ishin vendosur në tokat greke kërkonin pandërrerë dhe me ngulm që të ktheheshin në atdhe.¹⁴¹

Vlen të theksojmë raportin e kriminelit fanatik serb, prijësit dhe ideologut të deportimit dhe dëbimit të muslimanëve, Vaso Çubriloviqit, ku thuhet: *“Procesi i dëbimit dhe deportimit të turqve (shqiptarë, boshnjakë, turq dhe çerkezë) nga fshatrat dhe nga qytetet e tyre, dhe zëvendësimi i tyre me ardhacakë nga Serbia e Mali i Zi është realizuar shumë më shpejtë se sa e paramenduam. Serbët e torturuar nga shqiptarët që ishin larguar në vende malore të papastruara, janë kthyer në fshatrat e zbrazura. Banorët e Malit të Zi janë kthyer gradualisht në këto fshatra e qytete të pastruara nga shqiptarët dhe muslimanët, dhe kështu, fshatrat e reja serbe kanë filluar të mbijnë pasi nuk ekzistonin...”*¹⁴²

Kjo ishte nga njëra anë, ndërsa nga ana tjetër, sipas disa historianëve shqiptarë dhe turq, gjurmët që ngelën nga emigrimi i tillë kolektiv i shqiptarëve, turqve dhe boshnjakëve, i pësuan në dëme madje edhe vetë serbët... Sipas Skender Rizajt, serbët merrnin nga muslimanët drithin, mineralet dhe prodhimet tjera tregtare, ndërsa, tash, pas dëbimit masiv, ata u privuan nga dobitë e tilla. Historiani serb Millan V. Smilaniq ua ka tërhequr vërejtjen serbëve për dëmet ekonomike që do të dalin nga deportimi i shqiptarëve.¹⁴³

Nga gjurmët politike e shoqërore që u formuan nga emigrimi i detyruar e i dhunshëm i shqiptarëve dhe muslimanëve, ishte edhe krijimi i një urrejtjeje të madhe në mes muslimanëve dhe serbëve, urrejtje kjo që do të vazhdojë deri në Ditën e Gjykimit.¹⁴⁴ Deri dje jetonin bashkë dhe ishin fqinjë të njëri-tjetrit në një fshat dhe në një qytet duke e ndihmuar njëri-tjetrin, ndërsa tash s'ka mbetur më asgjë nga marrëdhëniet e dikurshme të vjetra, por çdo gjë është zhdukur...

¹⁴¹ Skënder Rizaj, **“Lidhja Shqiptare e Prizrenit”**; 89; Ibrahim Daut Hoxha, **“Viset kombëtare shqiptare në shtetin grek”**; 85, 99, 139, 170, 224, 233.

¹⁴² Historiani i njohur prof. Dr. Skender Rizaj, kur i komenton fjalët e kriminelit të lartpërmendur, thotë: “Historikisht nuk është e vërtetë se shqiptarët nga Vilajeti i Kosovës i kanë dëmtuar serbët, kjo është gënjeshtër dhe trillim, ngase ndodhte e kundërta. Dihet se Lidhja Shqiptare i ka mbrojtur edhe serbët dhe se në këto treva nuk ka pasur serbë me gjak të pastër serbi. Serbët e Kosovës ishin shqiptarë ortodoksë që praktikonin ritet fetare në gjuhën e kishës sllave...” Skender Rizaj, **“Lidhja Shqiptare e Prizrenit”**; 97-98; Shefqet Dibrani, **“Feja në shërbim të Kombit”**; www.albmuslim-yahoogroups.com.

¹⁴³ Po aty, f. 93.

¹⁴⁴ Po aty.

Muslimanët në këtë mënyrë e kishin kuptuar të vërtetën mbi serbët dhe ndjenjat e tyre, si dhe urrejtjen e madhe që e kishin fshehur ata në zemrat e tyre kundër muslimanëve. Serbët shfrytëzuan çdo rast për t'i vrarë ose terrorizuar shqiptarët dhe muslimanët, dhe kjo ndodhi edhe tash para disa viteve në Bosnjë dhe së fundit edhe në Kosovë, ngjashëm siç kishin vepruar dikur paganët me Pejgamberin, a.s.(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe sahabët e tij, r.a.(Zoti qoftë i kënaqur me ta!)

Në këtë kontekst historiani prof. Skender Rizaj thotë se numri i fshatrave dhe qyteteve që mbetën të zbrazura nga deportimi i muslimanëve nga Kosova ishte i madh, dhe më vonë këto vende ishin zëvendësuar me kolonë serbë dhe ishin shndërruar në qytete e fshatra serbe, si p.sh. Leskovci, i cili kishte përreth 87 fshatra me 2.445 shtëpi muslimanë dhe me 16.327 banorë. Edhe në Prokuplje kishte 72 fshatra, 785 shtëpi dhe 13.239 banorë, etj. Pra, numri i përgjithshëm ishte 227 fshatra, 5.793 shtëpi dhe 42.300 banorë. Mjaftojnë vetëm këto të dhëna statistikore, kurse për të dhënat e tjera do të flasim më vonë.

Kështu ky kapitull përfundon me të gjitha këto të dhëna që kishin të bënin me ngjarjet dhe zhvillimet fatkeqe e të kobshme, ngase shqiptarët muslimanë si në të shkuarën, ashtu edhe sot, ishin dhe mbetën viktimë e zhvillimeve të tilla ogurzeza në çdo drejtim dhe çdo lëmi.

Aspak nuk duhet të habitemi nëse shohim se dijetarët shqiptarë muslimane gjatë kësaj kohe historike tejet të vështirë, do të përqëndrohen në dy çështje të rëndësishme:

- 1: Mbrojtjen e identitetit të mendimit islamik fetar; dhe:
- 2: Mbrojtjen e mendimit kombëtar shqiptar.

Shpresoj se me ndihmën e Allahut xh.sh. patëm sukses në paraqitjen e disa karakteristikave më të rëndësishme të historisë së shqiptarëve. Të vërtetën e di më së miri vetëm Zoti i Madhërishëm!

KAPITULLI I TRETË

SITUATA FETARE NË TERRITORET SHQIPTARE NË KOHËN BASHKËKOHORE

I: PËRHAPJA E ISLAMIT NË TOKAT SHQIPTARE

Bazat historike të fenomenit të përhapjes së islamit

Kontaktet e para të shqiptarëve me arabët datojnë që nga kohërat e lashta, madje sipas disa mendimeve, kontaktet e tilla kanë ekzistuar edhe para lindjes së Krishtit.¹⁴⁵ Duke marrë parasysh pozitën e lakmueshme gjeo-strategjike, lidhjet e drejtpërdrejta tregtare dhe të ndryshme me vendet arabe dhe turke për qëllime tregtie ose për përhapjen e Islamit janë vërejtur qysh herët, në periudhën paraosmane.¹⁴⁶ Nëse e pranojmë këtë fakt, atëherë mund të themi se depërtimi dhe përhapja e Islamit në këto vende ka filluar së pari me tregtarët dhe vizitorët e tillë. Kur osmanlinjtë i çliruan këto vende, përhapja e Islamit fillon të intensifikohet më shumë dhe më gjallë në mesin e individëve.¹⁴⁷ Muslimanët shqiptarë përbënin pjesën dërmuese të banorëve të Ballkanit në krahasim me popujt e tjerë. Muslimanët banonin në katër vilajete shqiptare: Vilajeti i Kosovës, Vilajeti i Shkodrës, Vilajeti i Manastirit dhe Vilajeti i Janinës.¹⁴⁸

Ekzistojnë mendime të ndryshme mbi mënyrat e përhapjes së Islamit në këto territore, posaçërisht në mes të shkrimtarëve dhe historianëve shqiptarë. Disa janë të mendimit se Islami është përhapur me forcë, dhunë e shpatë,¹⁴⁹ por, kjo ide krejtësisht është e pavërtetë, ngase pjesa dërmuese e historianëve janë të mendimit se Islami është përhapur në këto troje nëpërmes paqes dhe sjelljes së mirë,¹⁵⁰ pra me bindje dhe

¹⁴⁵ Muhamed Mufaku, "Shqiptarët në botën arabe"; 7.

¹⁴⁶ Nexhat Ibrahim, "Islami në Ballkan para shek. XV"; Zëri Islam, Prizren 2000; 6; Noel Malcolm, "Kosova një histori e shkurtër"; 96-119, 120-143.

¹⁴⁷ Ferit Duka, "Momente të kalimit në Islam të popullsisë shqiptare në shek. XV-XVI"; në: Simpoziumin Ndërkombëtar "Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarët"-Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë 1995; Selami Pulaha, "The Albanians in Kosova in the 12th-18th centuries, në: Truth on Kosova"; 33-44.

¹⁴⁸ Po aty, Kristaq Prifti, "Popullsia Muslimane Shqiptare në Ballkan në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX"; Në: Truth on Kosova, 153-166.

¹⁴⁹ Don Shan Zefi, "Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve"; Drita, Prizren 2000; 57-86, 96, 102, 122, 123, 147, 148.

¹⁵⁰ Stavro Skendi, "Zgjimi Kombëtar Shqiptar"; 21-22.

vullnet të lirë, me dëshirë¹⁵¹ pa kurrfarë dhune ose presioni fetar,¹⁵² dhe kjo e dhënë është plotësisht e vërtetë historikisht. Mendimit tjetër është se Islami është përhapur herë me forcë e fuqi dhe herë me paqe.¹⁵³

Në këtë kontekst, disa historianë thonë: *"Islami është përhapur me të madhe në vendet ballkanike në kohën kur është pozicionuar dhe shtrirë pushteti osman. Popujt ballkanikë kanë hyrë në Islam në mënyra të ndryshme. Pjesa dërmuese e boshnjakëve kanë hyrë në Islam përnjëherë, duke e pranuar edhe pushtetin osman pa kurrfarë rezistence,¹⁵⁴ dhe në fillim të shek. XVI në tërë Bosnjën dhe Hercegovinën dominonte feja Islame,¹⁵⁵ për shkak se boshnjakët i takonin sektit të krishter heretik bogumil, mësimet e të cilit sekt ishin në kundërshtim me mësimet fetare ortodokse dhe ishin më afër Islamit. Edhe pse boshnjakët e pranuan Islamin, pra edhe pse hynë në fenë e re islame, ata nuk u bënë turq, por e ruajtën gjuhën dhe traditën e tyre"*.

Pjesa dërmuese e serbëve, malazezve, bullgarëve, maqedonasve dhe grekëve nuk e pranuan Islamin për shkak të ndikimit të madh të kishës ortodokse dhe natyrës së tyre fanatike. Prej tyre pranuan Islamin vetëm disa individë, dhe këta që e pranuan Islamin u asimiluan në rrjedhën turke brenda kohës, ngase ishin pakicë dhe kisha assesi nuk i pranonte si serbë, për shkak të konvertimit të tyre në katolicizëm dhe në Islam. Islamizimi i shqiptarëve u zhvillua shumë shpejt, gradualisht dhe në mënyrë të vazhdueshme për shkak të ndikimit të faktorëve politikë, ekonomikë, shoqëror dhe psikik, si dhe për shkak të faktorëve tjerë që do t'i theksojmë më vonë.¹⁵⁶

Dhe kështu, në fillim të gjysmës së dytë të shek. XVI, gjysma e popullatës shqiptare që jetonte nëpër qytete e kishte pranuar Islamin, ndërsa në shek. XVII e pranuan edhe fshatrat shqiptare. Islami në përgjithësi nuk ka ndikuar negativisht në gjuhën, traditat dhe adetet e

¹⁵¹ Dr. Muhamet Pirraku, **"Roli i Islamit në integrimin e Shqipërisë etnikë dhe të kombit shqiptar"**; në: **Feja, Kultura, dhe Traditat Islame ndër Shqiptarët**, 41-54-58.

¹⁵² Dr. Ali Hadri, **"Historia e Popullit Shqiptar për shkollat e mesme"**; Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore, Prishtinë 1967; 76.

¹⁵³ **"Historia e Popullit Shqiptar"**; grup autorësh, për vitin e katërt të shkollës së mesme, vëll. 4-104; Petrika Thëngjilli, **"Historia e Popullit Shqiptar"**; 306-312; **"Historia e Popullit Shqiptar"**- vëll. 1, 342-344; Akad.Mark Krasniqi, **"Aspekte mitologjike-besime e bestytë"**; Rilindja, Prishtinë 1997, 70-81.

¹⁵⁴ Po aty, f. 70, 92.

¹⁵⁵ Po aty, f. 70, 92.

¹⁵⁶ Për shkaqe ligjore dhe juridike, por jo edhe për shkaqe fetare-kështu supozojnë disa hulumtues priftërinj shqiptarë. Shih më gjerësisht librin e Don Zef Shanit: **"Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve"**; f. 88, 101.

shqiptarëve, përkundrazi, ai madje i ka përforcuar dhe i ka ruajtur edhe më shumë ndjenjat kombëtare të shqiptarëve.¹⁵⁷

Sa i përket përhapjes së Islamit në paqe, ekzistojnë fakte që konfirmojnë një gjë të tillë, madje edhe nga armiqtë e Islamit. Një historian i njohur serb Vladislav Shkariq thotë: *"Uzrparatori osmanli karakterizohej me tolerancë fetare dhe rrallë herë i detyronte njerëzit me dhunë të pranonin Islamin. Të krishterët pranonin Islamin me vullnet dhe dëshirë të lirë. Ata që e kishin pranuar Islamin me forcë ishin fëmijët e të krishterëve që shërbenin në ushtrinë osmane dhe që merreshin qysh kur ishin fëmijë!"*¹⁵⁸

Pra, siç shihet, Islami është përhapur me paqe dhe njerëzit konvertoheshin në grupe dhe ndiheshin të lumtur e të kënaqur nga ky veprim i tyre, ngase e shijonin besimin apo imanin pas vuajtjeve nga kisha dhe pas maltretimeve shtazarake, si dhe pas vuajtjeve që i përjetonin brenda në shpirt dhe nga nënçmimi social para pranimit të Islamit. Kur u bindën në të vërtetën e fesë islame, u bënë të respektuar, pasi që ishin të nënçmuar, u bënë të fuqishëm, pasi që ishin të dobët, u bënë pushtetarë dhe udhëheqës, pasi që ishin robër dhe të pushtuar, u bënë të pasur, pasi që ishin të varfër, e panë dritën dhe udhëzimin hyjnor, pasi që jetonin në errësirën e trinisë dhe idhujtarisë, në errësirën e varfërisë dhe të mjerimit nga padrejtësia sociale. Pra, vuajtjet e tyre ishin të llojllojshme dhe nga më të ndryshmet!

Me plot bindje them dhe pohoj se shqiptarët e donin Islamin, ndaj edhe e pranuan atë si fe të tyre, ngase në Islam ndiheshin plotësisht të qetë dhe të shpëtuar nga ata që i dëmtonin. Falënderimi i qoftë Zotit të botëve, kurse ata që janë tiranë, s'do mend se do ta përjetojnë ashpër dënimin e Zotit!

Ata që supozojnë dhe zhurmshëm trumbetojnë se gjoja Islami është përhapur me fuqi dhe dhunë në mesin e shqiptarëve, janë ose marksistë-leninistë, ateistë ose priftërinj katolikë fanatikë që janë edukuar në qarqet e Vatikanit në Romë. E gjithë kjo fushatë çmendurake kundër muslimanëve shqiptarë ishte dhe vazhdon të jetë pjesë e projektit kryqtarë të krishterë misionarë evropian, me qëllim që të mbjellë dyshim dhe luhajtje në zemrat e muslimanëve.

¹⁵⁷ Skender Rizaj, **"Kosova gjatë shekujve XV, XVI, XVII, administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore"**; 460-461.

¹⁵⁸ Po aty, f. 461-462.

II: ARSYET QË NDIKUAN TE SHQIPTARËT PËR TË PRANUAR ISLAMIN

Çështja e arsyeve dhe shkaqeve¹⁵⁹ që ndikuan dukshëm te shqiptarët për ta pranuar Islamin dhe për t'i njohur qëllimet dhe synimet e kësaj feje është shumë e vështirë të zbërthehet, ndaj, dhe për këtë shkak, këtë çështje ia lëmë Zotit të Madhërishëm, i Cili i di fshehtësitë dhe të dukshmet dhe Ai është i Vetmi që di se çka fshihet në zemrat e njerëzve.

Natyra e kësaj çështjeje është e ndërlidhur ngushtë me rrethanat shoqërore, kombëtare, politike, gjeografike dhe nacionale, pastaj duke u nisur edhe nga fakti se burimet e tilla janë të pakta e të kufizuara, jemi të detyruar që të mos japim ndonjë mendim kategorik mbi arsyet e shqiptarëve rreth kësaj çështjeje. Siç thashë edhe më sipër, të vërtetën e kësaj e din më së miri vetëm Zoti i Madhërishëm.¹⁶⁰

Edhe pse kjo temë është e vështirë, hulumtuesit dhe ekspertët shqiptarë të historisë së shtetit osman dhe historisë shqiptare, janë përpjekur që gjatë studimeve të tyre të historisë njerëzore dhe qytetërimeve tjera, të përfitojnë disa rezultate mbi arsyet e konvertimit të shqiptarëve në Islam. Mendimet e tilla mund të reduktohen në pikat vijuese:

Sipas disa historianëve, ekzistonte një arsye shumë e fuqishme që i ka shtyrë shqiptarët ta pranojnë Islamin, dhe kjo arsye ishte psikike dhe shpirtërore, e cila kishte lidhje të ngushtë me historinë e luftërave fetare, heretike kryqtare që zhvilloheshin kundër Islamit në vendet ballkanike, që nga shek. X, pastaj konfrontimi i vazhdueshëm historik i mosmarrëveshjeve në mes të kishës greke dhe asaj latine-katolike në mes shekujve XII dhe XIV, që zhvillohej për t'i dominuar dhe nënshtruar popujt e Ballkanit. Këto ngjarje dhe luftëra kishin nxitur urrejtjen e shqiptarëve dhe largimin e tyre nga kisha, dhe për rrjedhojë, kishin filluar të kërkonin rrugëdalje në fenë e re,¹⁶¹ ngase vetëm në fenë islame gjenin prehje shpirtërore dhe trupore për t'i plotësuar nevojat e kësaj bote dhe të botës tjetër, dhe për këtë shkak e pranuan krahëhapur Islamin si fe natyrore të tyre.

¹⁵⁹ Më gjerësisht mbi arsyet e konvertimit të shqiptarëve në Islam shih veprën: Abib Ahmeti, **"Theranda-Prizreni ndër shekuj"**; 84-90; Mark Krasniqi, **"Aspekte mitologjike-besime e bestytë"**; 70-81.

¹⁶⁰ Muhamet Pirraku, **"Shkaqet e kalimit në Islam të shqiptarëve"**; në revistën shkencore **Përparimi**, Prishtinë 1991; (viti XLV 2), 185-186.

¹⁶¹ Muhamet Pirraku, **"Roli i Islamit në integrimin e Shqipërisë etnike dhe të kombit shqiptar"**; në: **Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarët**, 42, 44.

Ndikimi i Islamit te shqiptarët ishte shumë i madh dhe padyshim që ka luajtur një rol të madh dhe aktiv në jetën e tyre, posaçërisht në çështjen e unitetit kombëtar, kulturor, politik. Islami me parimet dhe karakteristikat tolerante, humane e shoqërore, nuk ka qenë vetëm besim, por ka qenë edhe mënyrë e jetesës individuale dhe shoqërore, shembull për të tjerët dhe kulturë dinamike me karakteristika hyjnore, morale, fetare, edukative, etike, kritike, shoqërore, juridike, teknike, shkencore, filosofike... Islami nuk ishte fe e turqve apo e arabëve, por ishte fe botërore dhe mesazh botëror për të gjithë njerëzit, pa dallim ngjyre, feje, race apo kombi, përfshirë këtu edhe shqiptarët. Besimi në Zotin e Madhërisëm dhe të Plotfuqishëm i ka nxitur që të largohen nga adhurimi i putave, idhujve dhe personave. Këto arsye i nxitën arabët më parë të besojnë në Zotin e Madhërisëm dhe po këto arsye ishin ato që më vonë i nxitën edhe shqiptarët ta pranojnë Islamin. Parimet e tilla të Islamit ishin më afër trurit të shqiptarëve se sa filozofia, besimet e kota dhe fetë e tjera pozitive njerëzore e të komplikuar.¹⁶²

Sipas disa historianëve, të parët nga shqiptarët që pranuan Islamin ishin elita shqiptare (aristokracia) që kishte për qëllim të ruajë pozitën e tyre të lartë në shoqëri, dhe për të marrë pjesë në elitën ushtarake pushtetare të shtetit osman. Kishte edhe shqiptarë të tillë që kishin ambicie për të fituar pasuri dhe pushtet e pozita të larta në shtetin osman, që ishte fuqia më e madhe botërore e asaj kohe”.¹⁶³ Sipas mendimit tim, këta njerëz ishin të paktë dhe njiheshin në gishta dhe nuk mund të prezantojnë shumicën e atyre që kishin pranuar Islamin për arsye dhe shkaqe të lartëpërmendura.

Sipas disa historianëve të krishterë shqiptarë, mungesa e teologëve ortodoksë dhe katolikë ka ndikuar që të ketë zbrazëti të shpirtërore te njerëzit që nuk ishin krejtësisht të bindur në fenë e tyre, dhe për këtë shkak janë larguar nga feja e tyre dhe e kanë pranuar Islamin.¹⁶⁴

S’do mend që një konstatim i tillë është një gënjeshtër e kulluar historike, ngase Papa i Vatikanit ka qenë në lidhje të përhershme me ta dhe gjithnjë u ka ndihmuar në aspektin material dhe shpirtëror, dhe në asnjë mënyrë nuk është distancuar prej tyre deri në ditët e sotshme.

¹⁶² Shih artikullin e historianit tonë prof.Dr. Muhamet Pirraku mbi arsyet e pranimit të Islamit nga shqiptarët, në: Muhidin Ahmeti, **“Rreth përhapjes së Islamit ndër shqiptarët”**; Penda, Prizren, bot. II, 25-34.

¹⁶³ Skender Rizaj, **“Kosova gjatë shekujve XV, XVI, XVII, administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore”**; 463; Don Shan Zefi, **“Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve”**; 62-63.

¹⁶⁴ Stavro Skendi, **“Zgjidhimi kombëtar shqiptar”**; 22-23.

Një ndër shkaqet që ndikuan në kalimin e shqiptarëve në Islam, ishte edhe shkak i natyrës së hapur e tolerante të fesë islame, gjë që nuk gjendej në fenë ortodokse. Islami është fe e lehtë dhe e thjeshtë për ta vënë në praktikën ditore dhe fëmijët e elitës së rëndomtë shqiptare mësonin falas nëpër shkolla. Falë Islamit, populli kishte mundësi të lëvizë prej një shtrese drejt një tjetreje më të mirë, e jo ashtu siç ishte situata në Evropë dhe në sistemin feudal serb.¹⁶⁵

Pra, Islami u jepte vlerë të madhe njerëzve, u siguronte jetë më të mirë shoqërore në çdo aspekt dhe u siguronte begati si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër. Sa i përket mënyrës dhe metodës së depërtimit të shqiptarëve në Islam dhe ceremonive që zhvilloheshin kur ndokush pranonte Islamin, historianët thonë se transferimi prej fesë së krishterë në Islam bëhej me ceremoni. Ndonjëherë bëhej musliman i zoti i shtëpisë ose e tërë familja apo vetëm ndonjë një anëtar i familjes. Personi që kishte vendosur ta ndërrojë fenë është dashur të sjellë edhe dëshmitarë me vete, që cilësoheshin të drejtë e muslimanë, e pastaj të gjithë shkonin te gjykatësi i Sheriatit të qytetit (kadiu) dhe para tij i deklaronte të dy dëshmitë. Personi i tillë është deklaruar haptazi para gjykatësit se nuk e ka pranuar Islamin me dhunë, por vullnetarisht ka shprehur dëshirë që të konvertohet nga krishterimi i devijuar në Islamin e drejtë. Pas kësaj deklarate, gjykatësi ia ka përsëritur dëshminë dhe deklaratën (Shehadetin ne gjuhen arabe)

(أشهد أن لا إله إلا الله و أن محمداً رسول الله)

se “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhammedi është Pejgamber dhe i Dërguar i Zotit”- dhe pas kësaj, gjykatësi ka regjistruar emrin e tij në regjistër, dhe ia ka ndërruar emrin me një emër musliman. Në regjistër, nga ana e gjykatësit po ashtu regjistroheshin edhe emrat e dëshmitarëve.¹⁶⁶

Pra, siç shihet, aty nuk kishte dhunë dhe presion, e as shpatë për t'i detyruar shqiptarët që ta pranojnë Islamin, madje vetë të konvertuarit deklarorin se nuk janë nën asnjë lloj presioni për një konvertim të tillë në fenë islame nga feja e krishterë. Sipas historianëve objektivë, kjo paraqiste nderë për shqiptarët, ngase kështu shpëtonin nga humbja dhe

¹⁶⁵ Skender Rizaj, “Kosova gjatë shekujve XV, XVI, XVII, administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore”; 473-474.

¹⁶⁶ Skender Rizaj, “Kosova gjatë shekujve XV, XVI, XVII, administrimi, ekonomia, shoqëria dhe lëvizja popullore”; 470-472. Më gjerësisht rreth kësaj çështjeje shih librin e autorit; Muhidin Ahmeti: “Rreth përhapjes së Islamit ndër shqiptarët”; Thomas W. Arnold, “Përhapja e Islamit në Shqipëri”; f., 5-24.

shkatërrimi kulturor, kombëtar e fetar që e përjetonin më parë nga kisha serbe dhe greke, për shkak të dhunës permanente që ata ushtronin për t'i bërë shqiptarët me çdo kusht të të krishterë. Islami ka pranuar shumë tradita dhe adete të trashëguara të shqiptarëve, dhe kur e pranonin Islamin, shqiptarët merrnin llogat, “arnaut”, me qëllim që të dalloheshin nga muslimanët tjerë.¹⁶⁷

Sipas historianëve, kisha dhe teologët e krishterë kanë pasur qëndrim armiqësor dhe negativ ndaj interesave kombëtare dhe patriotike të shqiptarëve. Shqiptarët katolikë që nuk e pranuan Islamin, që jetonin në veri të vendit dhe i takonin fisit të njohur "gegë", u shkrinë në tërësi, përkatësisht u shndërruan në serbë dhe malazezë (pra, u asimiluan plotësisht) dhe vërtetë humbën çdo gjurmë shqiptare dhe u bënë serbë. Edhe shqiptarët ortodoksë "toskë" u asimiluan në fenë ortodokse fanatike greke dhe u shndërruan në grekë. Vlen të theksohet këtu, se edhe hoxhallarët dhe teologët muslimanë shqiptarë në kohën bashkëkohore janë përpjekur me mençuri dhe urtësi që ta predikojnë Islamin ndër shqiptarët katolikë dhe ortodoksë për t'i shpëtuar nga humbja dhe asimilimi i plotë në gjak tjetër.¹⁶⁸

Siç vërehet nga këto të vërteta historike nga ana e dijetarëve dhe historianëve, këto ishin rezultatet e përfituara rreth arsyeve dhe shkaqeve të kalimit të shqiptarëve nga Krishterimi në Islam. S'ka dyshim se ka edhe arsye tjera personale të vet individëve që pranuan Islamin të cilat i di vetëm Zoti i Madhërishëm. Siç theksova edhe më parë, besimi dhe bindja janë çështje të fshehta që i di vetëm Zoti i Madhërishëm. Ajo që u tha deri më tash bën pjesë në çështje të supozuara, dhe sipas mendimit tim, Zoti i Madhërishëm me Urtësinë dhe Mëshirën e Tij ka dashur që t'i udhëzojë e t'i shpëtojë nga humbja, mosbesimi, idhujtaria e t'i drejtojë kah drita e Islamit dhe udhëzimi i Kur'anit, dhe në këtë kontekst, në Kur'anin Fisnik, Zoti i Madhërishëm thotë:

([الأنعام : 125] ﴿لِلَّاسْلَمِ صَدْرُهُ يُشْرَحُ يَهْدِيهِ أَنْ اللَّهُ يُرِدْ فَمَنْ﴾)

"Atë që do Zoti e udhëzon dhe ia hapë zemrën për Islamin".¹⁶⁹ Është më se e vërtetë se Zoti ua ka hapur zemrat që ta pranojnë Islamin. Ata e pranuan Islamin, ngase vërejtën në të karakteristika dhe parime të vlefshme, si p.sh.: Universalizmi i ligjeve të sheriatit islam (Shumulijetul Islam) në jetë, në të gjitha aspektet, thjeshtësia në praktikë dhe në

¹⁶⁷ Po aty, f. 474.

¹⁶⁸ Po aty, f. 475.

¹⁶⁹ El En'amë, 125.

parimet moderate (Al vasatijetu). Parimet e tilla moderate të shariatit islam vërehen në parimet dhe principet islame që janë permanente, të pandryshuara - si p.sh. pesë shtyllat e islamit, gjashtë shtyllat e besimit islam, parimet morale islame, etj., - dhe poashtu vërehet aspekti moderativ i islamit në parimet që janë fleksibile dhe sekondare, që janë dinamike dhe mund të pësojnë ndryshime sipas vendit dhe kohës, në çështjet e lehta dhe të vështira, në përmbushjen e kërkesave të shpirtit dhe trupit, të kësaj bote dhe ahiret. Kjo është hyjnore, ka qëllim hyjnor dhe natyrë hyjnore.¹⁷⁰ Shqiptarët që e kishin pranuar Islamin ishin të shkathtë dhe inteligjentë, dhe kur vërejtën se Islami ka për qëllim formimin dhe ruajtjen e njeriut dhe të individit, familjes, shoqërisë, ummetit dhe shtetit të mirë, shfrytëzuan çastin dhe e pranuan pa kurrfarë hezitimi dhe luhatjeje,¹⁷¹ ngase në vete ndjenin nevojë psikike dhe shpirtërore për këtë ligj hyjnor. Ata vërejtën se Islami siguronte paqe për njerëzit, u ndihmon kur hasin në vështirësi dhe përçarje, u mundëson që t'i realizojnë qëllimet e tyre, i bashkon kur kanë mendime të kundërta, gjejnë udhërrëfyes, si dhe i shpëton nga frika, i qetëson në momentet e dëshpërimit, i bën ta dallojnë të mirën nga e keqja, të dalin nga errësira në dritë me lejen e Zotit, dhe i nxjerr në rrugën e shpëtimit, rrugën e Zotit të Madhërishëm e të Plotfuqishëm.¹⁷²

Disa hulumtues shqiptarë priftërinj, mendojnë se shqiptarët kishin pranuar Islamin sipërfaqësisht dhe jo me bindje dhe se e kishin braktisur në shumë raste pas një kohe të shkurtër, për shkak të besimit të dobët të tyre. Sipas tyre, ata e kishin pranuar Islamin edhe për arsye të interesave personale, dhe se ata janë popull që shpejt e ndryshojnë mendjen dhe fenë e tyre etj.¹⁷³

Them se ndoshta mund të ketë diçka të vërtetë në këto trillime e gënjeshtër dhe kjo është normale në raste konkrete individuale, por nuk

¹⁷⁰ Më gjerësisht shiko në traktatet e martirit islam, Shehid Hasan El-Benna, **“Mexhmuatu resailil Imamish-Shehjd Hasan El-Benna”**; Kajro, Darut Tenzil li neshril Islami, 1992, f. 113, 155, 223, 243; Dr. Jusuf Kardavi, **“El-Med’hal lidirasetis-Sunnetin-Nebevijeti”**; bot. 3, 1992; **“Med’hal li Ma’rifeti Fehmil-Islam”**; Kajro, Mektebetu Vehbe, bot. 3, 133-190; **“El-Merxheijjetul-ulja fil-Islam lil-Kur'an ves-Sunneti-Davabit ve Mehadhijr fil-fehmi vet-tefsiri”**, Kajro, Mektebetu Vehbe, f. 240.

¹⁷¹ Po aty, f. 190-269.

¹⁷² Dr. Jusuf El-Kardavi, **“El-Merxheijjetul-ulja fil-Fslami lil-Kur'ani ves-Sunneti”**; 340; Isam Tulejme, **“El-Kardavi feki jhen”**; Bur Se'id, Darut teuzi'i ven-neshri el-Islamijeti; bot. I, 2000, f. 57-87.

¹⁷³ Muhamet Pirraku, **“Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit”**; 279, 283, 289; Nathalie Clayer, **“Islam State and Society in post-communist Albania”**, at: **“Muslim Identity and the Balkan State”**; 115-138.

ka mundësi dhe është e pamundur që të ketë dyfytirësi dhe hipokrizi në mesin e gjithë myslimanëve shqiptarë që pranuan islamin. Po ashtu them se ky fenomen nuk ekziston vetëm te shoqëria shqiptare, por mund t'i ndodhë çdo individ në çdo shoqëri që pranon Islamin rishtazi, dhe s'ka afër tij ndonjë udhëzues, mësues dhe përkrahës të besimit të tij. Sahabët e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur e pranuan Islamin kishin shokë muslimanë që i këshillonin, i udhëzonin, i urdhëronin në të mira dhe i ndalonin nga të këqijat dhe u nënshtroheshin plotësisht rregullave të Zotit dhe Pejgamberit të Tij. Edhe pse ekzistonte një atmosferë e tillë, në mesin e tyre megjithatë, ekzistonin edhe hipokritë që janë të njohur në historinë tonë islame.

Shqiptarët muslimanë në fillim nuk gjenin shokë, e si mund të gjenin kur ata jetonin në mesin e familjeve jobesimtare ose në mesin e prindërve apo vëllezërve të krishterë?! Si të përforcohet imani i këtij të mjeri dhe si të largohet nga dyshimet?! Ne besojmë në fenë islame dhe në atë se besimi i muslimanit rritet e përforcohet në bazë të veprave të mira dhe adhurimeve, ndërsa pakësohet dhe dobësohet nga mëkatet dhe veprat e shëmtuara. Pra, nuk është për t'u habitur nëse ka disa raste gjatë historisë së shqiptarëve kur janë larguar nga Islami. Qëllimi që potencohet nga këta hulumtues priftërinj shqiptarë, fshihet në faktin se ata dëshirojnë t'i bindin shqiptarët muslimanë se e kaluara e tyre ka qenë e krishterë, dhe sipas tyre shqiptarët muslimanë duhet të kthehen në krishterizëm ! Fatkeqësisht idetë e tilla kohëve të fundit kanë marë përmasa të mëdha në vendin tonë, kështu duke e çuar ujin në mulli të qarqeve të ndryshme kryqtare perëndimore antishqiptare, por

Zoti e plotëson dritën e Tij edhe nëse e urrejnë jobesimtarët dhe idhujtarët në çdo kohë dhe në çdo vend.

III: SHKAQET E PËRHAPJES SË ISLAMIT TE SHQIPTARËT

Menjëherë pas depërtimit të Islamit në shpirtrat e shqiptarëve,¹⁷⁴ jeta e tyre fillon të lulëzojë në të gjitha sferat, gjegjësisht në sferën edukative, ndërtimore, fetare, etj. Shqiptarët filluan të ndërtojnë xhami dhe mesxhide për t'i vënë në praktikë ritet e përditshme fetare, javore e vjetore. Historia e ndërtimit të xhamive dhe mesxhideve fillon që nga fillimi i ardhjes së shtetit osman në këto treva, dhe ky fenomen

¹⁷⁴ Po aty.

argumentohet me faktin se ekzistojnë xhami që janë ndërtuar prej kohës së depërtimit të tyre, si p.sh. xhamitë e Prizrenit në Vilajetin e Kosovës, gjegjësisht, Bajrakli Xhamia që është ndërtuar në vitin 1573/74, Xhamia e Sinan Pashës në vitin 1615. Ekzistojnë edhe xhami tjera të tilla, por s'kemi mundësi t'i theksojmë këtu e që janë ndërtuar para disa shekujve.¹⁷⁵

Përveç kësaj, sufizmi me sektet dhe tarikatat e ndryshme të tij, kishte filluar të depërtojë në këto treva dhe ithtarët e këtij fraksioni fetar veçmë kishin ndërtuar teqetë e tyre afër xhamive, për të praktikuar ritet e tyre fetare sufiste. Në gjysmën e dytë të shek. XX, këto xhami e teqe u bënë pronë e shtetit dhe hynë nën mbrojtjen e shtetit me ligj.¹⁷⁶ Në trevat shqiptare u gjendën ithtarë të bektashizmit apo alevizmit, nusajritë sufistë, që përkraheshin dhe financoheshin nga shtetet joislame katolike dhe ortodokse që ishin përreth Shqipërisë, si p.sh. Italia e Greqia, ngase parimet dhe mendimet e tilla sufiste u ngjanin shumë mësimëve të fesë krishtere.¹⁷⁷

Arsimi në shkollat dhe mektebet fetare, nëpër territoret shqiptare që nga shek. XVI deri në shek XIX, aplikoheshin në gjuhën turke dhe arabe. Hoxhallarët dhe ekspertët e lëndëve fetare jepnin mësim dhe ua mësonin nxënësve leximin e Kur'anit dhe alfabetin arab. Në qytete të mëdha u hapën disa shkolla të mëdha të mesme ku mësoheshin më së shumti lëndë fetare. Rreth kësaj çështjeje të rëndësishme dhe rreth këtij faktori gjithashtu të rëndësishëm, mendoj se është me rëndësi t'i theksojmë fjalët

¹⁷⁵ Më gjerësisht mbi arkitekturën islame osmane të xhamive në Prizren, shih: Raif Virmica, **"Prizren camileri"**; Turk Demokratik Yayinlari, Prizren 1996, 13-14, 16, 23, 24, 37; Ramiz Zekaj, **"Zhvillimi i kulturës islame ndër shqiptarët gjatë shek. XX"**; 153-163; Faik Miftari, **"Pakës dritë për Kosovën"**; NFL-BAF, Prizren 2001, 31-38.

¹⁷⁶ Mbi historinë e doktrinëve sufiste dhe teqeve, shih: Jashar Rexhepagiq, **"Dervishët, rendet dhe teqet në Kosovë, në Sanxhak dhe në rajonet përreth Dukagjinit"**; Pejë 1999, 155-217, 219-264.

¹⁷⁷ Mbi mësimet dhe doktrinat e këtij fraksioni fetar të devijuar sufist, shih më gjerësisht: John Kingsley Birge, **"The Bektashi Sufi order of Dervishes"**; Hartford seminary, Press, Hartford, Conn, USA, 1937; Hajdar Salihu, **"Poezia e Bejtexhinjve"**; Rilindja, Prishtinë 1987, 85-120; Baba Selim Rexhep Kaliçani, **"Dede Ahmedi i gjallë mes nesh"**; Fushë Krujë 2000; Hajredin Hoxha, **"The Bektashi sufi order; general survey on it's history and doctrines"**; 2000; I.I.U., Kuala Lumpur, Malaysia; Dr. Ali Vishko, **"Harabati Teqe e Tetovës dhe veprimtaria në të në periudhën e kaluar"**; Design, Tetovë 1997; Roberto Maroco de la Roka, **"Kombësia dhe feja në Shqipëri, 1920-1944"**; Përktheu nga italishtja Luan Omari, Elena Gjika, Tiranë 1994, 37-44; H.T.Norris, **"Islam in the Balkans-religion and society between Europe and Arab world"**; 89, 123, 169, 174, 190, 211.

e dr. Ramiz Zekajt, në disertacionit e doktoraturës mbi zhvillimin e kulturës islame te shqiptarët ku potencon:

"Pasi depërtoi Islami dhe u përhap në këto treva, muslimanët filluan me sistematizimin e mësimit islam, ndërtuan shkolla e mektebe për t'ia mësuar popullit parimet elementare të fesë islame. Këto shkolla u hapën në Kosovë, Maqedoni dhe në disa qytete të Greqisë. Shkollat dhe mektebet e tilla punonin dhe kryenin detyrën e vet afër xhamive dhe aty punonin imamë e hatibë. Sistemi arsimor ishte i përzier, kurse moshë e fëmijëve ishte prej 6-7 vjet deri në 14 vjet. Lëndët e parapara ishin në gjuhën arabe, ndërsa komenti, sqarimi dhe mësimi zhvilloheshin në gjuhën shqipe. Gjatë mësimit, Kur'anit dhe tefsirit i kushtohej rëndësi e posaçme. Mësimi i tillë fillor ishte tre vjet dhe quhej: Shkolla e periudhës përgatitore (Rushdije). Pas pavarësisë së Shqipërisë dhe pas okupimit jugosllav të një pjesë të madhe të tokave shqiptare, u ndalua mësimi në shkollat e tilla në gjuhën shqipe, ndërsa mektebet islame që ishin afër xhamisë u mbyllën në Greqi pas luftës ballkanike në vitet 1912-1913, deri më sot. Muslimanët në territoret e okupuara shqiptare në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi e organizonin mësimin fetar nëpërmes Bashkësisë Islame me qëllim që të edukohen dhe arsimohen gjeneratat e reja. Në fillim të shek. XX, në Shqipëri ishin të njohura disa mektebe arsimore islame, si p.sh. mektebet në Shkodër, Tiranë dhe qytete të tjera. Disa dokumente dhe regjistrime osmane konfirmojnë se në veri dhe në jug të Shqipërisë ishin hapur shumë shkolla. Hoxhallarët dhe mësuesit, si p.sh. Shejh Hafiz Ymer Shemsedini, përdornin të dy alfabetet gjatë mësimit, gjegjësisht alfabetin arab për lëndët fetare dhe alfabetin shqip me shkronja latine për lëndët shkencore ose natyrore.

Pas luftës ballkanike u ndërpre procesi mësimor për një kohë, ndërsa shkollat u shndërruan në depo, në ahur kafshësh dhe në qendra emigrantësh, si p.sh. ashtu siç ndodhi në qytetin Pejë, etj. Në një dokument serb, të cilin ministri i çështjeve fetare serbe ia kishte dërguar Ministrisë së Arsimit në Beograd në vitin 1923, thuhet se "Arsimi fetar te shqiptarët muslimanë është çështje e ndërlikuar dhe shumë e rëndësishme. Në këto treva ekzistojnë afër pesëdhjetë muftinjë fetarë dhe afër 600 imamë e hatibë dhe asnjëri prej tyre nuk e di gjuhën serbe, të gjithë janë kundër shtetit serb dhe s'ka fshat e as qytet pa shkolla fetare

që gëzojnë autoritet të lartë nga banorët e fshatit ose qytetit. Në këto shkolla mësohet vetëm urrejtja dhe armiqësia kundër serbëve”.¹⁷⁸

Pastaj profesor Zekaj vazhdon e thotë: "Edhe pse kishte presione dhe shtypje shtetërore për të ndaluar mësimin fetar, kjo lëvizje ka vazhduar dhe falë Zotit të Madhërishëm nuk është ndërpre fare, p.sh. në Kosovë në vitin 1936 shkollat e tilla funksiononin si "Sibjan Mejtepe". Në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë dhe rreth tij kishte 33 mejtepe arsimore për fëmijë. Në vitin 1936 në Mitrovicë kishte edhe një medrese me të njëjtin emër ku mësonin 216 fëmijë (djem e vajza). Edhe në Gjakovë u hapën shkolla të tilla gjatë viteve 1932-1938, dhe pritej që të hapeshin edhe shkolla tjera, derisa numri i tyre të arrinte 80. Pas Luftës së Dytë Botërore, situata ndryshoi shumë në Shqipëri dhe u bë gati se absurde hapja e shkollave të tilla për shkak të qëndrimeve të shtetit laik kundër fesë, dhe për këtë shkak edhe u mbyllën të gjitha shkollat dekada me radhë. Shqiptarët e Kosovës dhe të Maqedonisë nuk e ndërprenë mësimin, por vazhduan edhe pse mësuesit e tillë dhe hoxhallarët në rrethanat e atëhershme nuk merrnin rroga për punën e tyre.

Shkolla të mesme fetare ekzistonin edhe në trevat e tjera shqiptare, si p.sh. në Shkup, Prizren, Shkodër, Elbasan, Berat, Vlorë, Ulqin, Janinë, Tetovë, etj. Në qytetin e Shkupit, Maqedoni, kishte një shkollë të mesme me autoritet, që ishte ndërtuar para katër shekujsh, gjatë pushtetit osman e që quhej Medreseja e "Isa Beut". Po ashtu edhe në qytetin Prishtinë të Kosovës ekziston shkolla e mesme që quhet Medreseja "Alaudin" e që ka degë reprezentive edhe në qytete tjera. Në këto shkolla diplomuan shumë nxënës që më vonë u bënë ulema dhe dijetarë të famshëm”.¹⁷⁹

Krahas përhapjes së edukatës fetare islame, me një hov të madh vazhdonte edhe përhapja e fesë së krishterë nëpërmjet ndërtimit të kishave dhe manastireve ortodokse që ngërthenin në vete shkolla në gjuhën greke e që funksiononin në përkrahje të shteteve ortodokse. Ekzistonte lëvizje e fuqishme dhe fushatë e egër fetare katolike kundër Islamit. Disa priftërinj shqiptarë kishin hapur shkolla në gjuhën italiane dhe këta priftërinj katolikë filluan mësimin e gjuhës shqipe në shkollat e tilla, edhe pse kishin një numër të vogël të nxënësve, që nuk tejkalonte numrin 10, në çdo shkollë.

¹⁷⁸ Shih më gjerësisht: Dr. Ramiz Zekaj, "Zhvillimi i kulturës islame ndër shqiptarët gjatë shek. XX"; 74-79, Marrë nga arkivi i Jugosllavisë, Ministarstvo Pravde Kraljevine Jugosllavije-vjersko odeljenje, 129, 4814/19.

¹⁷⁹ Po aty, f. 81-85.

Priftërinj më të njohur ishin Pjetër Bogdani, Frang Bardhi, Andrea Bogdani, etj. kurse çuditërisht emrat e tyre glorifikohen edhe sot e kësaj dite me të madhe, nga shqiptarët katolikë dhe ata marksistë e laikë, por me emra muslimanë... Në rrethana të tilla u hap edhe shtypshkronja e krishterë për shtypjen e librave dhe traktateve. Priftërinjtë e tillë aplikojnë metodën e pastër evropiane në mësim, dhe shqiptarët që mësonin aty, diplomonin sipas metodës perëndimore. Kjo përhapje fetare e krishterë dhe kjo fushatë e ashpër kundër Islamit kishin filluar që nga fillimi i shek. XIX.¹⁸⁰

Vlen të përmendet se lëvizja kombëtare shqiptare në periudhën e Rilindjes kishte arritur kulmin letrar kombëtar e fetar nga shek. XVII deri në shek. XIX. Lëvizja e tillë karakterizohet me shumë vepra të shkruara në alfabetin arab, nga shkrimtarët shqiptarë muslimanë,¹⁸¹ si p.sh. divanet poetikë dhe prozaikë të disa sufistëve etj. Disa divane u përkthyen nga gjuha arabe dhe turke, ndërsa pjesa më e madhe e tyre u përkthyen nga gjuha perse.¹⁸² Pra, fenomeni i përhapjes së Islamit, njëherit karakterizohet edhe me përhapjen e tarikateve dhe doktrinave të ndryshme të sufizmit.¹⁸³

Ndër poetët dhe shkrimtarët shqiptarë më të njohur, që ndihmuan në lëmin e sufizmit bektashian ishin Dalip Frashëri, Naim Frashëri, Sami

¹⁸⁰ "Historia e Popullit Shqiptar"- vëll. 4, 100; Muhamet Pirraku, "Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit"; 274, 278, 280, 456.

¹⁸¹ Muhamed Mufaku, "El-Ebxeidijetul-Arabijetu fith-thekafetil-Albanijjeti"; f. 5-40; "Melamihun Arabijjetun Islamijjetun fil-Edebil-Albanij"; f. 60-67, po nga i njëjti autor; Muhamet Pirraku, "Gjurmime albanologjike-seria e shkencave filologjike"; 16/1986, Prishtinë 1987, 197-212; Muhamet Pirraku, "Gjurmime albanologjike" IX/1979-1980, 203-236; Naim Frashëri, "Vepra letrare 5-Qerbelaja"; 1996; 13-316.

¹⁸² Muhamet Pirraku, "Kultura Kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit", f. 456.

¹⁸³ Më gjerësisht mbi lëvizjen dhe mësimet e sufizmit si dhe mbi qëndrimin e disa dijetarëve të njohur, shihni veprat: Muhamed Ahmed Durnejk dhe Siham Teufik El-Misrij, "Ibn Tejmijje ves-Sufijje"; (Tripoli, Mektebetul-Imân, bot. 1, 1992), f. 53-167; Abdurahman Bedevi, "Shatahat sufijje"; Kuvajt, Vikaletul-metbu'at, bot. 2, 1976, f. 7-48; Irfan Abdulhamid Fettah, "Nesh'etul-felsefetis-sufijjeti ve tetavvuruha"; Bejrut, Darul-Xhil, bot. 1, 1993, f. 27-249; Ibn El-Xheuzi, Ali Hasan Ali Abdul-Hamij, "El-Munteka en-Nefis min Telbisi iblis"; (Darul' ibn-Xheuzi), 208-513; Ebu Bekër Muhamed El-Kilabudhi, (ka vdekur në vitin 358 hixhri), "Et-Tearruf li Medhhebi Ehli-Tesavvuf"; komenti i Mahmud Emin En-Nevavij, (Kajro, 1969); Abdurrahman Ebu El-Kasim Abdulkerim ibn Heuzan El-Kushejri (ka vdekur në vitin 456 hixhri) "Er-Risaletul-Kushejrijjeti"; (Kajro, Mektebetu Muhamed Ali Subajh, 1957), f. 126; Esh-Shejh El-Ekber Muhjiddin Muhammed ibn Ali El-Arabijj, (ka vdekur në vitin 638 hixhri), "El-Futuhatu el-Mekkijjetu"; (Bejrut, Darus-Sadir, El-babu 373).

Frashëri, Hasan Zyko Kamberi, Sulejman Naibi, Sheh Kadria, Nezim Frakulla, Dervish Hasani, Baba Abidin Leskoviku, etj.¹⁸⁴ Aspak nuk duhet të habitemi nga ekzistimi i fenomenit sufist në mesin e shqiptarëve,¹⁸⁵ ngase shteti osman nuk i kundërshtonte tarikatet dhe doktrinat sufiste.¹⁸⁶ Shteti osman pajtohej me mendimin sufist dhe doktrinat e tij të ndryshme, përveç me ato të sektit bektashian.

Për shkak të zhvillimeve rrënjësore që i përjetonte toka shqiptare në sfera të ndryshme intelektuale, letrare, kombëtare e fetare, priftërinjtë shqiptarë shfrytëzuan rastin dhe i përkthyen tekstet e shenjta fetare¹⁸⁷ nga gjuhët latine, italiane e greke në gjuhën shqipe, pastaj i botuan dhe i shpërndanë në mesin e shqiptarëve, anëmbanë tokave shqiptare, dhe këtu patjetër na duhet të potencojmë se e tërë kjo fushatë e tyre, zhvillohej nën moton e mbrojtjes dhe mësimi të gjuhës amtare shqipe!¹⁸⁸

Nëse i analizojmë shkrimet e tilla prozaike e letrare dhe divanet poetike, do të vërejmë se ata përmes tyre zbërthenin probleme shoqërore, fetare, politike e ekonomike, dhe e përjetonin popullin shqiptar në të gjitha sferat dhe ashtu siç e përjetonin shqiptarët veten e vet. Siç duket, ata kishin gjetur liri të plotë që të shkruanin për çështjet e lirisë dhe të robërisë nën pushtetin osman, ngase i urrenin osmanlinjtë për shkak se ata, nuk interesoheshin për çështjen e shqiptarëve.

Për ta realizuar këtë qëllim, apo thënë më mirë, për të nxitur urrejtje, përdornin fjalët më të egra dhe më të vrazhda, vetëm e vetëm për t'u hakmarrë. Një grup tjetër shqyrtonte çështjen e papunësisë dhe varfërisë ndër shqiptarët, ndërsa disa të tjerë merreshin me çështjen e emigrimit dhe largimit nga vatani apo atdheu, posaçërisht njerëzit që kishin lënë fëmijët e tyre në gjendje jashtëzakonisht të mjerueshme.

Në shkrimet e tyre ekzistojnë edhe shqyrtime të çështjeve materiale, si p.sh.: Çështja e pasurisë dhe dashurisë së njerëzve ndaj parasë pa kurrfarë përjashtimi, qofshin njerëz të fesë islame, udhëheqës a gjykatës, apo njerëz të rëndomtë. Ata po ashtu shkruanin për çështjen e

¹⁸⁴ Hajdar Salihu, “Poezia e bejtexhinjve”; 13, 144, 147, 165, 265, 268, 289; H.T. Noris, “Islam in the Balkans”; 161-190; Muhamet Pirraku, “Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit”; 273, 274-278, 309, 324.

¹⁸⁵ Po aty.

¹⁸⁶ Po aty.

¹⁸⁷ Mbi historinë e përkthimeve të Biblës në gjuhën shqipe dhe në gjuhët e tjera, shih më gjerësisht studimin e linguitit dhe latinologut fanatik katolik shqiptar Engjëll Sedaj, “Bibla dhe përkthimet e saj në gjuhën shqipe”; Shtufi, Prishtinë 1999, 94-121, 125-172.

¹⁸⁸ Muhamet Pirraku, “Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit”; 368-456; “Historia e Popullit Shqiptar”-vëll.4, 100-101.

përhapjes së ryshfetit dhe korrupsionit financiar, çështjen e gjakmarrjes që ekzistonte ndër shqiptarët shekuj me radhë¹⁸⁹ dhe çështjen e urrejtjes dhe zilisë në mes njerëzve fetarë muslimanë, për shkak të lidhjeve të afërta të disave prej tyre me sulltanin.¹⁹⁰

Njohja e letërsisë shqiptare islame, qoftë sufiste apo sunite, ka rëndësi të madhe, ngase është një pasuri e madhe që prezanton doktrinat e mendimit fetar islam në mesin e shqiptarëve, ashtu sikur që pasqyron edhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Nga çështjet e tjera shoqërore që gjenden në këtë periudhë, është edhe mbështetja e shqiptarëve të tillë muslimanë në fenomenin e tolerancës fetare dhe bashkëjetesa në paqe në mes shqiptarëve muslimanë, ortodoksë e katolikë, ngase sipas tyre dallimet në mes feve nuk duhet të krijojnë urrejtje. Para tyre qëndronte armiku i përbashkët dhe të dy palët ishin të rrezikuara prej tij, pra nga shteti osman!!!

S'ka fije dyshimi se kjo fushatë çmendurake zhvillohej kundër Islamit dhe muslimanëve, pikërisht në kohën kur shtetet fqinje joislame i përkrahnin dhe i nxitnin disa shqiptarë në ide të tilla destruktive. Shtetet e tilla kolonizuese gjetën urë fetare, intelektuale, sufiste bektashiane për t'i realizuar qëllimet dhe synimet e tyre të krishterizimit.¹⁹¹

Në shkrimet e tyre po ashtu shqyrtohej faktori i arsimit, kulturës dhe letërsisë.¹⁹² Faktor i rëndësishëm i lulëzimit të Islamit në mesin e

¹⁸⁹ Gjakmarrja për vrasje është fenomen i vjetër që ekziston në të gjitha territoret etnike shqiptare. Kohëve të fundit, fatkeqësisht, kjo dukuri ka marrë përmasa të mëdha në trojet tona, ku ndodhin shumë vrasje për gjakmarrje. Kjo dukuri edhe në Kosovë ishte mjaft e përhapur, por në vitin 1990 ndodhi ndryshim radikal në historinë e shqiptarëve, ngase një grup intelektualësh shqiptarë muslimanë e katolikë, morën iniciativë për pajtimin e gjaqeve në mes familjeve që ishin në hasmëri dhe vërtetë me sukses të madh pajtuan qindra familje shqiptare që kishin armiqësi për shkak të vrasjeve. Më gjerësisht rreth pajtimeve në mes viteve 1990-1992 shih: Anton Çeta, Zymer Neziri, Myrvete Dreshaj, Sadri Fetiu dhe Mehmet Halimi, **“Pajtimi i gjaqeve 1990-1991”**; Era, Prishtinë 2001; Muhamet Pirraku, **“Lëvizja mbarëpopullore shqiptare për faljen e gjaqeve, 1990-1992 – kronikë”**; Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1998.

¹⁹⁰ Muhamet Pirraku, **“Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit”**; 294, 362, 356.

¹⁹¹ Muhamet Pirraku, **“Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit”**; 309-324, 393-394, 364-366, 380-388, 409-415, 440-453; Hajdar Salihu **“Poezia e bejtexhinjve”**; 133-141, 148-160, 212-213, 243-251; **“Historia e popullit shqiptar”**-vëll. 4, 105-106; Mark Krasniqi, **“Toleranca fetare në lëvizjet çlirimtare të popullit shqiptar në shek. XVII-XVIII”**; në: Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarët, 205-210; Mahmud Hysa, **“Tema sociale në letërsinë islame shqiptare të shek. XVIII-XIX”**; 258-2449.

¹⁹² Shih këtë vepër letrare që përmban në vete tri punime letrare të shejhut dhe komentuesit të shquar shqiptar Hafiz Ibrahim Dalliu, që shqyrtojnë çështje politike e

shqiptarëve ishin edhe udhëtimet për të kërkuar diturinë në vende të ndryshme të botës. Disa prej tyre për të mësuar, udhëtuan në Egjipt, përkatësisht në Universitetin e Al Az'har, disa të tjerë në Indi dhe një pjesë e bukur e madhe në Turqi, respektivisht në kryeqendrën e Perandorisë, në Stamboll. Përveç këtyre vendeve, ca të tjerë udhëtuan në Iran, Libi, Liban, Paris, Itali e disa në vende tjera.¹⁹³

Nga emigrantët shqiptarë që emigruan në shtetet arabe dhe u bënë dijetarë të mëdhenj e me famë botërore, mund të përmenden:

- Shejh Muhaddith Abdulkadër Arnauti, (Allahu e mëshiroftë) i cili jetoi dhe veproi në Damask, Siri e që njihet si ekspert i hadithit në shek. XX dhe recensues i një opusi të madh të literaturës së hadithit;
- Shejh Muhaddith Nasiruddin Albani, (Allahu e mëshiroftë) i cili ka jetuar në Aman, ku edhe kaloi tërë jetën e vet duke punuar në shkencën e hadithit;
- Shejh Muhaddith Shu'ajb Arnauti, i cili gëzon autoritet jo më pak se dy të parët;
- Prof.Dr. Muhamed Mufaku-Arnauti, i cili jeton në Aman, Jordani dhe vepron si historian dhe studiues i njohur; dhe:
- Shejh Vehbi Sulejman Gavoçi, (Allahu e ruajtë), fakih i njohur në Damask të Sirisë, i cili njihet si ekspert i shquar i fikhut hanefit.¹⁹⁴

Gjithashtu, ka pasur edhe jomuslimanë që udhëtuan në Itali, Bullgari e Greqi për t'u specializuar në shkencat fetare të krishtera (në shkencat katolike e ortodokse) si dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për punë e shkollim¹⁹⁵ apo në shtete të tjera.

shoqërore në mes viteve 1920-1942. Petrit Kusi, “**Hafiz Ibrahim Dalliu, Vepra letrare-Dokrra hini, Grenxat e kuqe të Tiranës, Një ëndërr e ime**”; botime enciklopedike, Tiranë 2000.

¹⁹³ Mahmud Hysa, “**Alamiada shqiptare**”; vëll. 2; 170.

¹⁹⁴ Këtë plejadë dijetarësh të shquar shqiptarë, kontributin e tyre të gjerë fetar nuk e kam studiuar në disertacionin tim, ngase ata kolosë nuk kanë jetuar dhe vepruar në tokat shqiptare, edhe pse janë me origjinë shqiptare. Dijetarët e sipërpërmendur jetuan, vepruan dhe punuan në rrethana të ndryshme fetare e politike në trojet arabe. Por, s’do mend që në të ardhmen sa më të afërme, meritojnë të studiohen, si dhe për to të shkruhen disertacione magjistrature apo doktorature në nivel universitar.

¹⁹⁵ Muhamet Pirraku, “**Kultura kombëtare shqiptare**”; 393, 433, 418; Eqber Skendi, “**Hoxhë Kadriu (Kadri Prishtina)**”; 14; Roberto Maroco de la Roka, “**Kombësia dhe fetë në Shqipëri 1920-1944**”; 209; Qazim Xhelili, “**Vehbi Dibra**”; 12; Ismail Ahmedi, “**Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra**”; 13-18; Shefik Osmani, “**Panteoni iranien dhe**

Ndikimi i shkollave turke dhe arabe te dijetarët shqiptarë ishte i madh, gjë kjo që vërehet qartë nga qëndrimet e tyre që mbajnë përkitazi ndaj disa çështjeve shoqërore dhe fetare. Me plot bindje, lirisht mund të konstatojmë se ekzistonte një mendim i përbashkët në mes të të diplomuarve në Az'har dhe atyre në Stamboll, ngase të dy grupet thërrisnin në reformimin e metodës shkollore fetare dhe të disa çështjeve shoqërore e fetare.

Dijetarët shqiptarë në përgjithësi nuk e refuzonin idenë e shkollës reformiste¹⁹⁶, gjë të cilën edhe do ta shohim insha'Allah më vonë në këtë libër.

Fatkeqësisht, nuk kemi mundësi të zgjerohemi më shumë në theksimin e shembujve të tjerë, për të parë akoma më mirë, se sa kanë ndihmuar shkollat dhe qytetërimet e popujve tjerë tek dijetarët shqiptarë, si p.sh.: Ndikimi i qytetërimit persian, i cili ishte shumë i madh në mendimet dhe qëndrimet e dijetarëve shqiptarë, saqë shumë prej tyre përkthyen literaturë nga letërsia dhe trashëgimia perse në gjuhën shqipe, literaturë kjo e cila ekziston edhe sot e kësaj dite. Pra, siç duket, kontaktet e tyre me personalitetet dhe qytetërimet tjera nuk i kanë shpëtuar nga dëmet dhe gjurmët anësore negative.¹⁹⁷

Ndër faktorët që ndikuan në lulëzimin e Islamit te shqiptarët ishte edhe fenomeni i mësimi përmendësh i Kur'anit Fisnik (hifzi). Ky fenomen i çuditshëm ekziston te shqiptarët qysh nga kohërat e hershme. Fenomeni i tillë është prestigjioz dhe vërehet që nga depërtimi i Islamit në këto treva.

Hifzi i Kur'anit Fisnik zhvillohej në mektebe e shtëpi, ndërsa më vonë formohen edhe shkolla fetare të posaçme për shkencat fetare, si p.sh. në Prizren, ku në kohën e pushtetit osman katër shekuj më parë u ndërtua një shkollë fetare shumë autoritare-Medreseja e "Gazi Mehmet Pashës". Në këtë shkollë kanë diplomuar shumë hoxhallarë dhe hafizë të Kur'anit Fisnik. Të rrallë ishin nxënësit që diplomonin aty e që nuk ishin hafizë të Kur'anit. Në bazë të disa të dhënave të fundit statistikore, në mes viteve 1950-1994, aty kanë diplomuar 70 hafizë të Kur'anit Fisnik, pjesa

iranologët shqiptarë"; Sadi Shirazi-Tiranë 1998; Ramiz Zekaj, "Zhvillimi i kulturës Islame ndër shqiptarët në shek XX"; f. 258-381.

¹⁹⁶ Ismail Ahmedi, "Hafiz Ali Korça-jeta dhe vepra"; Logos-A, Shkup 1997, 44-45.

¹⁹⁷ Shefik Osmani, "Panteoni iranian dhe iranologët shqiptarë"; 92-108, 109-121, 132-133.

dërmuese e të cilëve ishin meshkuj. Por, në mesin e tyre kishte edhe femra që ishin hafizë të Kur'anit Fisnik.¹⁹⁸

Në qytetet e Maqedonisë ku jetojnë shqiptarët, kohëve të fundit të këtij shekulli, ky fenomen është më i dukshëm, më i gjallë dhe më aktiv në mesin e hoxhallarëve dhe besimtarëve të atjeshëm. Në këto treva shqiptare dolën lexues me zë të bukur e reprezentativë, hafizë të fortë që mund të krahasohen me kompjuterë për nga preciziteti, memoria dhe mbajtja mend e ajeteve të Kur'anit pa ndonjë huti.

Preciziteti i tillë në hifz është fryt i hifzit të hershëm që nga mosha dhjetë-dymbëdhjetë vjeçare, madje në raste konkrete ka fëmijë që me ndihmën dhe bekimin e Zotit të Madhërishëm, e kanë kryer hifzin edhe në moshën gjashtëvjeçare,¹⁹⁹ siç ishte p.sh. rasti i para dhjetë vjetëve, me një hafiz nga qyteti i Tetovës në Maqedoni. Nga historia e dijetarëve shqiptarë në kohën bashkëkohore vërehet qartë se të dhënat biografike konfirmojnë se pjesa dërrmuese e tyre kanë qenë hafizë të Kur'anit Fisnik. Edhe sot e kësaj dite ekziston dëshira e madhe për vazhdimin e këtij fenomeni hyjnor në mesin e muslimanëve shqiptarë. Sheh fëmijën që nuk e njih arabishten fare e as që flet atë, por e lexon Kur'anin Fisnik në mënyrë të shkathhtë e me të gjitha rregullat e duhura të leximit (me texhvid), dhe një fenomen i tillë, deshëm apo s'deshëm, t'i nxit emocionet nga zëri i këndshëm dhe melodia e bukur.

Kohëve të fundit, në Kavajë të Shqipërisë, është themeluar një shkollë fetare enkas për mësimin e hifzit të Kur'anit Fisnik,²⁰⁰ aty, nxënësit mësojnë edhe lëndë tjera fetare, gjuhë angleze, informatikë etj, por përqëndrimi i plotë i tyre është dhe mbetet hifzi i Kur'anit. Një vepër e

¹⁹⁸ Ramiz Zekaj, “Zhvillimi i kulturës Islame ndër shqiptarët në shek. XX”; 207; Faik Miftari, “Pakëz dritë për Kosovën”; 45-49; Tayyib Okic, “Tefsir ve hadis usulunun bazi meseleleri”; Nun Yayincilik, Istanbul, Turkiye 1995, 141.

¹⁹⁹ Hoxha që e ka mësuar këtë fëmijë të vogël është Shejh Muhaffiz Mulla Mahmud Asllani nga Tetova, Allahu e ruajtë, me të cilin pata nderin që të takohem tri vjet më parë, për të parë se si ai, ua mëson fëmijëve hifzin e Kur'anit. Sipas mendimit tim dhe vështirimit të metodologjise së tij hifz, pash dhe u binda se hoxha në fjalë – ma sha Allah- ishte shumë i shkathhtë dhe ekspert për të nxjerrë hafizë të Kur'anit në shek. XX, ngase tërë jetën ia ka përkushtuar këtij qëllimi të lartë e sublim. Ai del nga shtëpia që në kohën e namazit të sabahut dhe kthehet në shtëpi pas namazit të jacisë. Numri i hafizëve që kanë kryer hifzin tek ky hoxhë deri më tash është 101 dhe s'di a ka ndonjë tjetër në botën islame apo arabe që ia ka tejkaluar në këtë çështje. Zoti na bëftë sikur ai!

²⁰⁰ Shih revistën islame që e boton Instituti i Mendimit dhe Qytetërimit Islam Shqiptar: **The Islamic Civilization News Periodic Bulletin** (Albanian Institute of Islamic Thought and Civilization); Tiranë, 17.01.2001, 13.

tillë është vërtetë e mahnitshme dhe me aq sa kam unë njohuri, është ndër të parat e këtij lloji në këto treva.

Lusim Zotin e Madhërishëm që t'i bekojë në jetën dhe në veprat e tyre dhe urojmë në të ardhmen të hapen sa më shumë shkolla të tilla edhe në qytetet tjera në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi.

I mbështetetemi sinqerisht Zotit të Madhërishëm, vetëm Ai udhëzon dhe drejton në rrugë të drejtë!

الباب الثاني

الأوضاع الإجتماعية في الأراضي الألبانية و الاتجاه
الإصلاحي في تفسير القرآن الكريم في العصر الحديث

PJESA E DYTË

SITUATA SHOQËRORE NË TOKAT SHQIPTARE DHE DOKTRINA REFORMISTE NË TEFSIR NË KOHËN BASHKËKOHORE

KAPITULLI I PARË

SITUATA SHOQËRORE NË TOKAT SHQIPTARE NË KOHËN BASHKËKOHORE

KAPITULLI I DYTË

DOKTRINA INTELEKTUALE SUNNITE SHOQËRORE REFORMISTE NË TEFSIR E PASQYRUAR NË MENDIMET E MENDIMTARIT ISLAM HAFIZ ALI KORÇA

KAPITULLI I PARË

SITUATA SHOQËRORE NË TOKAT SHQIPTARE NË KOHËN BASHKËKOHORE

Hyrje

Situata shoqërore në tokat shqiptare ishte përplot ngjarje dhe ndryshime të mëdha në sfera të ndryshme, ndaj dhe studimi në këtë kapitull trajtohet si hyrje për rezultatet që do t'i përfitojmë më vonë, p.sh. kur të zgjedhim shembull studimi doktrinën reformiste në Tefsir.

Periudha e viteve të tridhjeta të shek. XX karakterizohet si periudhë e gjallërisë dhe dialogut shkencor që zhvillohej në mes hoxhallarëve dhe ateistëve të njohur laikë. Mendimtarët laikë kishin përqëndruar tërë fuqinë dhe potencialin e tyre intelektual në mbrojtjen e teorisë së ateizmit, në nevojën për përkrahjen e teorisë së tillë dhe largimin e rinisë nga feja, duke u arsyetuar me parimin e lirisë së shprehjes dhe të mendimit!!!

Situata ishte aq shumë e tensionuar, saqë disa intelektualë që urrenin fenë kishin shkruar një letër përmes së cilës i akuzonin muslimanët dhe të krishterët bashkë, duke përdorur fjalë triviale dhe thumbime të ashpra që prekin nderin dhe dinjitetin e njeriut, si p.sh.: Nuk kanë tru ata që mendojnë se Zoti ka krijuar botën; Zoti është trillim i mendjes dhe nuk ekziston fare, triniteti është turpi i kohës sonë, zotëri Mesihu me fytyrë të shëmtuar nuk beson se është i biri i Zotit, por është i biri i Jusufit, Isai nuk është themelues i krishterimit, Bibla është përmbledhje tregimesh,²⁰¹ etj. Të gjitha këto ide bashkëkohore konfirmojnë se sa të rrezikshme ishin qëndrimet dhe grindja e tillë intelektuale.

Pasi që ne nuk mund t'i përmbledhim në detaje të gjitha ngjarjet e tilla, do të përqëndrohemi në studimin dhe analizimin e disa çështjeve të mëdha, të cilat do të na ndihmojnë të kuptojmë origjinalitetin e mendimit shqiptar fetar, dhe pozitën e mendimit të tillë në sheshin e konflikteve shoqërore dhe fetare.

Pjesa e dytë e këtij kapitulli të këtij hulumtimi, do të plotësojë pjesën e parë, ngase kuptimi i kësaj pjese varet ngushtë nga kuptimi i

²⁰¹ Shih më gjerësisht: Ali M. Basha, “Islami në Shqipëri gjatë shekujve”; 156-157.

pjesës së parë, sepse natyra e këtij studimi lypë një hap të tillë dhe plotëson të dhënat e njërës pjesë me tjetrën. Unë do të përpiqem që lexuesve t'u ofroj çështjet e tilla fetare e shoqërore, me qëllim që të kuptojnë sa më mirë doktrinën shoqërore reformiste në tefsir dhe mënyrën se si dijetarët shqiptarë përpiqeshin t'i zbërthejnë problemet e tilla. Çështja e parë, e cila i preokuponte shqiptarët ishte çështja e emancipimit të gruas shqiptare muslimane.

I: MODERNIZMI DHE SHQIPTARËT

Jehona e mendimit fetar reformist që vinte nga Lindja Arabe, gjegjësisht nga Egjipti, kishte depërtuar në tërë botën islame, si p.sh., në Indi, Turqi, në Rusi dhe veçanërisht në Kaukaz. Edhe fati i tokave shqiptare dhe atyre boshnjake²⁰² nuk ishte më i vogël se sa ai i botës islame.

Meqë Universiteti i Az'harit ishte minare apo qendër e mësimi dhe edukimit²⁰³ në të gjitha fushat shkencore, të rinjtë shqiptarë drejtoheshin kah ky Universitet për të mësuar shkenca të ndryshme, dhe në këtë mënyrë u formuan marrëdhënie vëllazërore fetare në mes dijetarëve të Az'harit dhe studentëve shqiptarë.

Shumë studentë shqiptarë më vonë u bënë dijetarë të njohur, me autoritet dhe të suksesshëm në kohën bashkëkohore. Kjo kohë dallohet me idetë e disa mendimtarëve islamë që ishin nën ndikimin e metodave dhe mendimeve perëndimore, si p.sh. mendimtari Xhemaludin Afgani, Shejh Muhammed Abduhu si dhe nxënësit e tyre shejh Rashid Rida, rektori i Universitetit të Az'harit Ahmed Meragi dhe shumë të tjerë,²⁰⁴ të

²⁰² Mbi bazat historike botërore reformiste dhe ndikimin e tyre në mendimin fetar boshnjak në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. dhe në shtetet e tjera që kanë qenë në ndikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë në Az'har shih: Fikret Karçiq, **"Drushtveno-pravni aspekt islamskog reformizma-Pokret za reformu Sherijatskog prava i njgov odjek u Jugoslaviji u prvoj polovini XX vjeka"**; Sarajevo 1990, 29-67.

²⁰³ Po aty, f. 69 (në marginë).

²⁰⁴ Mbi aktivitetet dhe veprat e mendimtarëve, dijetarëve dhe themeluesve të shkollës reformiste është shkruar shumë si nga autorët arabë, ashtu edhe nga ata perëndimorë dhe në këtë kontekst, shih më gjerësisht: Fehd ibn Abdurrahman Er-Rumi, **"Menhexhul-medresetil Islahijjetil-Akljijeti fit-Tefsir"**; Rijad, botimi i vitit 1994, 1; Daniel Neil Crecelius, **"The Ulema and the state in modern Egypt"**; Princeton, N. J. Princeton University Press, 1967; Ph. D. J. J. G. Jansen Thesis, **"Koran interpretation in the Modern Egypt"**.

cilët përpiqeshin të bëjnë ndryshime reformiste në metodën edukative az'hariane. S'ka dyshim se kjo ftesë gjeti ithtarë në botën islame, si p.sh., në Indi, Turqi, Siri, Bosnjë, Shqipëri, etj.²⁰⁵

Ndër çështjet politike në të cilat ishin përqëndruar reformistët, ishte çështja e gruas muslimane dhe pozita e saj shoqërore,²⁰⁶ e cila në krahasim me gruan perëndimore ishte e prapambetur, regresive dhe jetonte e mbyllur në prangat e traditës. Asaj nuk i lejohej të merrej me aktivitete politike e as me ato shoqërore, etj. Idetë e tilla reformiste ndikuan dukshëm në mendimet dhe idetë e shqiptarëve që mësonin dhe studionin në Egjipt, Turqi dhe Indi, të cilat njëherit edhe konsideroheshin qendra ndërkombëtare të diturisë dhe kulturës,²⁰⁷ ndaj, kur u kthyen në vendlindje, erdhën me idetë reformiste e ripërtëritëse.

Nëse i hedhim një shikim lëvizjes së filosofisë së mendimit islamik në tokat shqiptare dhe natyrës së dialogut e diskutimeve që zhvilloheshin në mes dijetarëve shqiptarë dhe oponentëve të tyre, do të bindemi plotësisht se edhe ata ishin të interesuar rreth këtyre çështjeve botërore dhe fetare. Çështjet e tilla filosofike dhe fetare do t'i kuptojmë, nëse i shfletojmë revistat, gazetatat dhe traktatet që i publikonte Këshilli i Lartë i Komunitetit Musliman në Shqipëri nëpër qytete dhe kryeqytete të mëdha. Nuk ka ndonjë vepër që i ngërthen në vete të gjitha këto çështje, por janë të shpërndara në artikuj dhe shkrime shkencore që botoheshin në revistat dhe gazetatat e tilla.

Para se të filloj me çështjen e çlirimit të gruas shqiptare, dëshiroj të flas për një çështje të rëndësishme që diskutohej shumë në mesin e dijetarëve shqiptarë, gjegjësisht për çështjen e ixhtihadit me të gjitha rregullat e tij,²⁰⁸ gjë që vërteton se dijetarët shqiptarë kishin kulturë të lartë islame në të gjitha fushat, dhe këtë që e them për ta, vërtetohet me hulumtimet e tyre rreth këtyre çështjeve që do t'i përmendim më vonë. Pra, ne do të qëndrojmë para një grupi të dijetarëve të mëdhenj me

²⁰⁵ Mbi historinë e ripërtëritjes së mendimit fetar, reformat dhe reformistët e njohur, shih veprën e Ebu A'la El-Maududi **"A short history of the Revivalist Movement in Islam"**; translated by Al-Ash'ari, the other Press, Petaling Jaya, Kuala Lumpur, Malaysia 1999, 24-77.

²⁰⁶ Gazmend Shpuza, **"Kuvendime për historinë kombëtare"**; 231-236, 237-242

²⁰⁷ Roberto Maroco de la Roka, **"Kombësia dhe feja në Shqipëri"**; 209; Muhamet Pirraku, **"Kultura kombëtare shqiptare"**; 393.

²⁰⁸ Një ndër veprat më të mira që janë shkruar mbi ixhtihadin dhe parimet e tij është vepra **"El-Muvafakat fi Usulish-Sheriatil-Islamijjeti"** nga autori Ebu Is'hak El Shatibi (ka vdekur në vitin 790 hixhri), recensoi: Shejh Ibrahim Ramadan dhe komentoi Shejh Abdullah Derraz, Bejrut, Darul-Ma'rifeti, bot. 4, 1999; vëll. 4, f. 463-638.

pikëpamje të ndryshme e që përpiqeshin të zbërthejnë çështje fetare e intelektuale të kohës së tyre, por që janë të rëndësishme edhe për kohën tonë.

Sipas disa burimeve historike është zhvilluar një debat i gjatë dhe i ashpër në mes mendimtarit dhe studiuesit shqiptar, Mehdi Frashëri²⁰⁹ dhe Shejh Hafiz Ismet Dibrës²¹⁰. Mendimtari shqiptar Mehdi Frashëri kishte botuar një varg artikujsh në disa gazeta shqiptare rreth reformave që mund të zhvillohen në fenë Islame. Këto artikuj kanë ndikuar që Shejh Hafiz Ismet Dibra të reagojë në revistën islame mujore, “Zani i Naltë”.

Kjo revistë përmbante në vete artikuj dhe mendime të tilla, dhe për këtë shkak gëzonte autoritet dhe pozitë të lartë te muslimanët dhe njerëzit në përgjithësi. Nëse u bëhet një rezymë ideve dhe fjalëve të Shejh Hafiz Ismet Dibrës në lidhje me reformizmin dhe përtëritjen e mendimit islam, do të arrijmë të konkludojmë se ai mendonte se Islami nuk kundërshton progresin shkencor dhe sfidat e kohës si dhe pranon reformat në disa çështje për të cilat flasin edhe hadithet e Pejgmaberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), përkatësisht për çështjet që kanë natyrë dhe karakteristikë specifike e që pranojnë të reformohen, ndërsa parimet fetare dhe bazat e besimit nuk mund të reformohen kurrë, ngase në këtë mënyrë shkatërrohet feja që nga themeli i saj.²¹¹

Çështja tjetër për të cilën ishte zhvilluar polemikë në mes tyre ishte pikëpamja e mendimtarit të sipërpërmendur, Mehdi Frashëri, se dera e ixhtihadit ishte mbyllur dhe se tani askujt më nuk i lejohet të merret me ixhtihad, dhe atë duke u bazuar në ëndrrën e Imam Gazaliut se dera e ixhtihadit ishte e mbyllur!!! Reagimi i Shejh Hafiz Ismet Dibrës ishte

²⁰⁹ Shkrimtar, historian dhe politikan eminent shqiptar nga fshati i njohur Frashër i Shqipërisë së Jugut. Ai është autor i shumë veprave mbi historinë e lashtë shqiptare. Ky dijetar ka jetuar në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Nuk pata mundësi të gjej gjë rreth datës së lindjes dhe vdekjes së tij: **“Historia e Popullit Shqiptar”**; vëll. 2, 449, 452, 603.

²¹⁰ U lind në qytetin Dibra e Madhe, Maqedoni në vitin 1886 dhe mësimet e larta i vazhdoi në Stamboll. Ka qenë ekspert i fikhut, tefsirit, logjikës, filosofisë dhe hadithit dhe ka kontribuar shumë në Medresenë e Mesme Fetare në Tiranë. Ai njihte arabishten, turqishten dhe persishten. Atij i është ofruar pozita e ligjëruesit dhe shefit të një katedre në Universitetin e Stambollit, por ka refuzuar ngase kishte preferuar vendlindjen dhe atdheun e vet. Ai karakterizohej si trim dhe mbrojtës i të vërtetës dhe është burgosur nga pushteti komunist vetëm se ishte fetar dhe kështu ka kaluar 12 vjet në burg. Ramiz Zekaj, **“Zhvillimi i Kulturës Islame te shqiptarët gjatë shekullit XX”**; 312-314.

²¹¹ Mbi polemikat e tilla shih më gjerësisht: Ali M. Basha, **“Islami në Shqipëri gjatë shekujve”**; 140-141.

kategorik dhe i prerë: Ai refuzonte transmetimin e tij që kundërshtonte parimet e fesë, duke thënë se dera e ixhtihadit është e hapur dhe nuk do të mbyllet asnjëherë deri në Ditën e Kijametit. Më tej vazhdon Hafiz Ismet Dibra duke thënë se; a ka menduar ndonjëherë deklaruesi i fjalëve të tilla se ç'mendonte me mbylljen e derës së ixhtihadit? Argumenti i dytë mbi pavërtetësinë e deklaratave të mendimtarit, Mehdi Frashëri, është se ëndrra nuk konsiderohet burim i Sheriatit islam dhe s'mund të përdoret si argument për të mbështetur ide.²¹² Këtu vërehet qartë origjinaliteti i mendimtarit fetar në të menduarit e Shejh Hafiz Ismet Dibrës mbi parimet e burimeve të fikhut gjatë reagimeve kundër mendimtarit Mehdi Frashëri.

Ne plotësisht pajtohem me reagimet e tij bindëse. Dijetarët kanë hulumtuar shumë rreth kësaj çështjeje, si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen, dhe kanë shkruar shumë rreth kësaj çështjeje, por ne këtu, nuk mund të zgjerohem më shumë për shkak të natyrës së kufizuar të këtij hulumtimi. Më pas, mendimtari, Mehdi Frashëri, ka zhvilluar polemikë edhe për një çështje tjetër fetare, duke thënë se ka mundësi të reformohen edhe disa çështje fetare adhuruese, të cilat konsiderohen si çështje të definuara e që s'mund të jenë temë e ixhtihadit në asnjë mënyrë. Ai deklaronte se nëse lejohet të falet namazi mbi kafshë vetëm me shenja pa ruku e sexhde, atëherë një mënyrë e tillë mund të lejohet për ne, që edhe ne ta falim namazin në karrige brenda xhamisë pa ruku e pa sexhde! S'ka dyshim se një krahasim i tillë është tërësisht i pavlefshëm dhe me dallim të madh, sepse udhëtimi ka rregulla speciale në Islam, si në aspektin e të falurit ashtu edhe në aspektin e të agjëruarit. Shejh Hafiz Ismet Dibra (Zoti e mëshiroftë!) reagon dhe thotë se këto fjalë nuk janë të bazuara në burime Islame, dhe se namazi mbi kafshë është nafile e jo farz, ndaj dhe lejohet, kuptohet vetëm në rast nevojë.²¹³ Si mund të krahasohet diçka që lejohet nga nevoja, sëmundja, siç është rasti me namazin ulur në karrige brenda xhamisë, me diçka pa ndonjë arsye dhe pa nevojë!? Si mund të bëhet një krahasim i tillë?!

Nga ajo që vërehet prej dialogut të tillë, argumentohet se vërtetë ka pasur mendimtarë me mendime të kundërta rreth disa çështjeve dhe parimeve të fesë islame. Gjatë viteve 1920-1930 në mesin e shqiptarëve doli edhe një tjetër mendimtar që u afirmua me idetë, mendimet, ligjëratat

²¹² Po aty, f. 141.

²¹³ Po aty, f. 141-142.

dhe përqëndrimin në çështjen e edukimit dhe kulturës së femrës shqiptare si dhe në të drejtat e dy bashkëshortëve.²¹⁴

Mendimtari në fjalë kishte përgatitur një rregullore që i ngjanë kushtetutës, e që përmbante dyzet nene rreth parimeve dhe ligjeve që kishin të bënin me martesën dhe kurorëzimin në Islam, kushtet e martesës dhe parimet e divorcit. Ai po ashtu shqyrtoi disa tradita shqiptare që ishin të pavlefshme e që kishin të bënin me martesën e femrave për kompensime parashë, krahas metrit (pajës) së caktuar. Kjo rregullore ndihmoi dukshëm në të kuptuarit e konceptit fetar që ekzistonte ndër shqiptarët në përgjithësi dhe ndër komunistët në veçanti, të cilët e shikonin fenë me urrejtje, me pretekstin se feja është regres dhe dekadencë.²¹⁵ Fatkeqësisht, në kohën e tij nuk kishte ndonjë Kur'an të komentuar e as të përkthyer nga gjuha arabe në gjuhën shqipe, për t'i kuptuar sa më mirë parimet e Sheriatit.²¹⁶

Çështja e femrës kishte marrë jehonë të madhe në mes dijetarëve dhe mendimtarëve shqiptarë, ashtu siç kishte marrë jehonë edhe në mesin e mendimtarëve dhe dijetarëve arabë, posaçërisht polemikat rreth emancipimit dhe mbulesës së fytyrës e të duarve të femrës. Arsyeja

²¹⁴ Dijetari i njohur Haxhi Vehbi Dibra-Agolli (mbimri i marrë sipas qytetit të lindjes Dibra e Madhe në Maqedoninë aktuale) u lind në vitin 1867 dhe vdiq në vitin 1937. Ai ka qenë i njohur si dijetar, myfti, politikan dhe muxhahid i spikatur; Rrjedh nga një familje fetare që respektonte parimet e fesë islame. I ati i tij ka qenë po ashtu myfti. Që nga fëmijëria dallohej për nga shkathtësia dhe interesimi i posaçëm ndaj personaliteteve të njohur nga historia shqiptare. Ai dallohej edhe për nga sjellja e mirë e tij. Mësimet e para i mori në vendlindje, ndërsa mësimet e larta në Stamboll, dhe ishte ndër studentët më të mirë. Ai mësoi arabishten, turqishten dhe persishten, pastaj u specializua në filozofinë islame, logjikë e fikh. Po ashtu dha kontribut të madh në politikë dhe në reformat fetare si dhe shkruante artikuj të rëndësishëm dhe hytbe në revistën **“Zani i Naltë”** që botohej në Tiranë. Ligjëratat e tefsirit te suretu El Fatiha u përmbledhën në një vepër me titull **“Ç’urdhënon Kur’ani – kuptimi i Fatijas me shpjegime”**, dhe unë pata rastin që ta posedoj kopjen e këtij tefsirit gjatë vizitës sime në Shqipëri, kur vizitova Komunitetin Musliman të Shqipërisë në Tiranë. Duke biseduar me autorin dhe profesorin Ali M. Basha rreth temës së disertacionit tim, ai më tha se kishte një kopje të këtij tefsiri që i kishte ardhur nga drejtori i Qendres Islame Shqiptare në ShBA, Imam Vehbi Islamilit, Allahu e mëshiroftë, dhe prof. Ali Basha më lejoi që ta fotokopjoj dhe për të cilin i falënderohem sinqerisht dhe lus Zotin e Madhërisëm që ta shpërblejë! Më gjerësisht shiko: Qazim Xhelili, **“Vehbi Dibra-personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare”**; Albin, Tiranë 1998, 4-20; Ramiz Zekaj, **“Zhvillimi i Kulturës Islame te shqiptarët gjatë shekullit XX”**; 288-291.

²¹⁵ Po aty, f. 142.

²¹⁶ Rreth detajeve të kontributit të këtij dijetari reformist më gjerësisht shih: Qazim Xhelili, **“Vehbi Dibra-personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare”**; 252-259.

kryesore që i shtyu dijetarët muslimanë të diskutojnë rreth kësaj çështjeje, ishte fakti se disa shkrimtarë laikë shqiptarë kishin shkruar një artikull historik ku thuhej se perçja i takonte historisë shqiptare të krishterë, gjegjësisht periudhës së murgeshave të virgjëra e beqare të kohës së mbretërshës së krishterë, Katerina de Medici, si dhe kohës së vejushave të krishtera, të cilat e mbulonin fytyrën për nder të burrave të tyre. Autori i artikullit më tej vazhdon e thotë se perçja apo mbulesa e fytyrës nuk ka ekzistuar për gratë muslimane në periudhën e parë të Islamit. Në Bagdad dhe në Kordovë kishte mësuese dhe dijetare femra që merreshin me arsim e që i kishin fytyrat e çelura.²¹⁷

Duke u bazuar në këto diskutime në mes dijetarëve reformistë, rryma reformiste islame filloi të përforcohet dhe të ndikojë në opinionin e përgjithshëm të muslimanëve dhe dijetarëve konservativë, ndaj, nisur nga ky fakt, Komuniteti Musliman i Shqipërisë (institucioni më i lartë fetar dhe shkencor) u detyrua të lëshojë më 01.03.1937, Vendimin nr. 1, për anulimin e perçes dhe për lejimin e shpalimit të fytyrës dhe duarve si dhe të drejtën që ajo të merret me aktivitete të jetës normale njerëzore. Në bazë të disa argumenteve të Sheriatit rreth kësaj çështjeje, anëtarët e Këshillit Suprem të Çështjeve Islame (Komiteti i përhershëm për Fetva) i kanë informuar muslimanët nëpërmes ligjëratave, mësimëve dhe revistave periodike ashtu siç e kanë informuar edhe pushtetin mbretëror të Ahmet Zogut.²¹⁸ Në fund të këtij vendimi pasonin nënshkrimet e anëtarëve të Komunitetit Musliman që përkrahnin vendimin e tillë.²¹⁹

Pra, siç duket, këto ishin disa çështje që kishin të bënin me diskutimet reformuese rreth çështjeve fetare, gjegjësisht rreth femrës muslimane dhe çlirimit të saj. Këtë gjallëri dhe këtë aktivitet shkencor në mes dijetarëve e ka shfrytëzuar pushteti i Mbretit Ahmet Zogu në mënyrë negative për të ndërmarrë edhe disa reforma tjera që kundërshtonin

²¹⁷ Ali M. Basha, “Islami në Shqipëri gjatë shekujve”; 142-143.

²¹⁸ Mbreti Ahmet Zogu, i biri i Xhemal Pashë Zogollit, u lind më 05.10.1895 në Burgajet të Matit, Shqipëri. Saktësisht nuk dihet rrjedha e këtij mbreti. Në fillim ishte kryetar i Shqipërisë, pastaj është bërë Mbret i saj gjatë viteve 1925-1939. Gjatë periudhës së tij, Shqipëria ka përjetuar korrupsion, mjerim dhe dekadencë politike, fetare, ekonomike e shoqërore. Ishte humbës dhe i pa përvojë në udhëheqjen e shtetit dhe njerëzve, ngase nuk ishte i përgatitur për një post të tillë. Ka qenë në shërbim të pushtetit italian dhe jugosllav. Në vitin 1961 ka vdekur në Paris nga kanceri në stomak dhe nga shumë infarkte në zemër. Më gjerësisht mbi jetën dhe veprat e këtij mbreti tiran shih: Bernd J. Fischer, “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri”; përktheu nga origjinali Krenar Hajderi, Çabej, Tiranë, bot. II, 1984, 11-27, 305-322; “Historia e Popullit Shqiptar”, vëll. 2, 546-613.

²¹⁹ Po aty f. 143.

rrënjësisht parimet e fesë islame, duke i dhënë përkrahje të fortë tarikatis të devijuar sufist bektashian, edhe atë në bashkëpunim me pushtetin italian për shkatërrimin dhe deformimin e Islamit.²²⁰

Periodha në mes viteve 1920-1940 njihet si periudhë e ndryshimeve dhe modifikimeve të parimeve dhe ligjeve të Sheriatit në Shqipëri,²²¹ si p.sh. ndryshimet rrënjësore në të drejtën civile.²²² Pushteti i kishte pranuar ligjet perëndimore pozitive të Zvicrës, Francës dhe Egjiptit, dhe gjithashtu kishte ndërmarrë edhe disa hapa për ndryshimin e disa simboleve fetare dhe mënyrën e jetësimit të tyre, pastaj i kishte revokuar nga puna gjykatësit islamë.

Në vitin 1921 kishte marrëveshje kombëtare islame shqiptare kundër shtetit osman, dhe nga marrëveshja e tillë rezultoi vendimi për pavarësinë nga Shejhul-Islami dhe nga shteti osman. Në mars të vitit 1923, kur pushteti osman ishte në fazë kritike, u mbajt një konferencë në Tiranë ku u caktua Myftiu i përgjithshëm i shtetit të Shqipërisë dhe zyrtarisht u ndërpreu lidhjet me halifatin osman. Ndërsa në qytetet e tjera të Shqipërisë, akoma edhe për një kohë vazhdoi lidhja me halifatin osman dhe respektimi i urdhrave që vinin nga Stambolli, siç ishte rasti p.sh., me qytetin e Shkodrës.²²³

Në vitin 1923 filloi të botohet revista islame “Zani i Naltë”, ku dijetarët dhe mendimtarët shqiptarë diskutonin dhe shqyrtonin tematika që kishin të bënin me jetën bashkëkohore, si p.sh. çështja e reformave në fe, kërkesa këmbëngulëse për heqjen e perçes dhe zbulimi i fytyrës. Perçja u ndalua zyrtarisht me vendim në vitin 1937.

Në vitin 1924, Ahmet Zogu lëshoi një dekret me të cilin ndalon diskriminimin fetar në Shqipëri, ku thuhet “*Diskriminimi fetar nuk duhet të ekzistojë në jetën e shqiptarëve në asnjë mënyrë dhe se muslimanët dhe të krishterët duhet të gjejnë një zgjidhje të kësaj çështje, gjegjësisht duhet t’i anulojnë mospajtimet fetare...*”

²²⁰ Roberto Maroco de la Roka, “**Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944**”; 117-142; Ismail Bardhi, “**Hafiz Ibrahim Dalliu dhe Egzegjeza e tij kur’anore**”; 84-86. Frances Trix, “**Spiritual discourse-learning with an Islamic master**”; University of Pensilvania, 1993.

²²¹ Roberto Maroco de la Roka, “**Kombësia dhe feja në Shqipëri, 1920-1944**”; 2728.

²²² Mbi gjykatat e Sheriatit, mënyrat e funksionimit dhe ligjet e të drejtës civile në shoqërinë islame në ish-Jugosllavi, shih: Fikret Karçiq, “**Sherijatski sudovi u Jugosllaviju 1918-1941**”; Islamski Teoloshki Fakultet, biblioteka posebnih izdanja, Sarajevo 1986, 49-73.

²²³ Roberto Maroco de la Roka, “**Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920-1944**”; 28.

Ata që më së shumti e pësuan nga instruksionet e këtij ligji të ri, ishin hoxhallarët (teologët), të cilët patjetër duhej të largoheshin krejtësisht nga aktiviteti politik. Shteti i ndërroi teologët e njohur dhe ata nuk kishin më kurrfarë të drejte të kenë ndonjë lidhje me çështjet financiare që vinin nga jashtë. Sipas shtetit, feja nuk mund të jetë rrezik e as ndonjë pengesë politike dhe kategorikisht ndalohet shfrytëzimi i fesë për qëllime politike”.²²⁴

Në rrethana të tilla jostabile shoqërore e fetare, ndodhi edhe një anulim i parimeve fetare që kanë të bëjnë me shoqërinë muslimane shqiptare, gjegjësisht ndalimi i poligamisë. Në këto rrethana filluan të përkthehen²²⁵ tekste kur’anore pjesërisht,²²⁶ filluan të shfaqen ide të ndryshme fetare mbi mënyrën e aplikimit dhe jetësimit të Islamit. Çështja e dytë që kishte pësuar ndryshime ishte përpjekja e parlamentarëve për ta penguar alfabetin arab në shkrimet shqipe dhe zëvendësimin e tij me alfabetin latin. Në kushtetutën e shtetit shqiptar në vitin 1928 thuhet qartazi se në Shqipëri nuk ka fe zyrtare. Të gjithë fetë respektohen si dhe ndalohet përdorimi i feve për qëllime politike. Siç duket, parimet e shtetit shqiptar ishin laicizmi dhe sekularizmi,²²⁷ liria fetare individuale, barabarësia e feve dhe shfrytëzimi i feve në favor të shtetit laik.²²⁸ Pra, në rrethana të tilla, pozita e muslimanëve filloi të dobësohet dhe të përkeqësohet. Aplikimi i parimeve të Islamit u bë shumë i vështirë në kohën e Mbretit Ahmet Zogu.²²⁹

Në vitin 1929 u organizua një konferencë e madhe në Shqipëri, ku u takuan dijetarë të mëdhenj sunitë dhe morën disa vendime që ishin të vështira, por të pranueshme nga mbretëria e Mbretit Ahmet Zogu. Në atë konferencë u vendos që arabishtja të përdoret vetëm në ligjërata, vaze,

²²⁴ Po aty, f. 26-36.

²²⁵ Mbi lejimin, ndalimin, problemet e përkthimit të Kur’anit Fisnik shih punimet e profesorëve të respektuar dr. Suad Jëldërim, dr. Abdulkahhar El-Ani, dhe dr. Habibur-Rahman Ibremisa në **“7th International Conference of Translation-the Translating of Religions Texts”**; 6-8, December, 1999, Kuala Lumpur, Malaysia, 101-106, 293-315, 319-355.

²²⁶ Mbi historinë e përkthimeve të Kur’anit Fisnik gjuhën shqipe, tërësisht ose pjesërisht, shih studimin e prof. dr. Feti Mehdiut me titull, **“Përkthimet e Kur’anit në gjuhën shqipe”**; Logos-A, Shkup 1996.

²²⁷ Mbi të vërtetën dhe rrezikun nga laicizmi shih: Dr. Jusuf El-Kardavi, **“El-Islam vel-Almanijjetu vexhhen li vexhhin”**; Kajro, Mektebu-Vehbe, bot. 7, 1997, f. 74-106.

²²⁸ Po aty, f. 31-32.

²²⁹ Mbi jetën, kulturën dhe veprat politike të këtij mbreti shih: Bernd J. Fischer, **“Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri”**; 11-29, 94, 114, 248.

lutje e derse, të gjitha shkollat fetare dhe qendrat edukative të jenë nën kontrollin e mbretërisë shqiptare dhe të mbyllen shumica e xhamive të mëdha, përveç dy ose tri xhamive në çdo qytet.

Sipas disa të dhënave statistikore, numri i xhamive u zvogëluar në mënyrë të jashtëzakonshme për shkak të vendimeve të kësaj konference. Në vitin 1929, numri i xhamive në të gjitha qytetet e Shqipërisë ishte 990, ndërsa në vitin 1934 numri është zvogëluar në 560 xhami. Hoxhallarët ishin të obliguar të mbanin legjitimacion të dhënë nga pushteti qendror i Tiranës, me qëllim që më lehtë të kontrolloheshin dhe të gjendeshin nga shteti.²³⁰

Ndër personalitetet që ftonin në reforma dhe në çlirimin e gruas shqiptare brenda doktrinës fetare reformiste ishte profesori, Shejh Hoxhë Kadriu, që kishte mbaruar shkollën e mesme fetare “El-Fatih” në Stamboll, pastaj kishte diplomuar me sukses të lartë në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Stambollit. Pas diplomimit, punoi si ligjërues në të njëjtin Universitet dhe fitoi autoritet të lartë. Tërë jetën e vet e kaloi në aktivitete fetare, politike, kombëtare dhe në shërbim të Islamit. Nga shokët dhe bashkëkohësit e tij është përcjellë se ka qenë shumë i drejtë dhe objektiv në mendime. Kur është caktuar Ministër i Drejtësisë në Shqipëri, ka bërë disa ndryshime në ligjin e të drejtës civile që kishin të bëjnë me çështjen e kurorëzimit dhe martesës. Ai po ashtu kërkonte që të ndryshohet ligji që e kishin trashëguar nga shteti osman.²³¹ Ky ishte i njohur edhe për nga aktivitetet rreth çështjeve që kishin të bënin me

²³⁰ Ali M. Basha, “Islami në Shqipëri gjatë shekujve”; 140-146; Ismail Bardhi, “Hafiz Ibrahim Dalliu dhe Egzgjekja e tij Kur’anore”; 75, 87; Roberto Maroco de la Roka, “Kombësia dhe fetë në Shqipëri”; 32-33.

²³¹ Shejh Hoxhë Kadri Prishtina u lind në vitin 1878 në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë. Mësimet e para i mori në vendlindje në gjuhën turke dhe që nga fëmijëria u dallua me interesimin e madh të tij ndaj personaliteteve të mëdha. Pastaj vazhdoi shkollën e mesme në qytetin e Shkupit, Maqedoni, duke u dalluar nga të tjerët për nga serioziteti në mësimet. Prindi i tij i ndihmoi që të vazhdojë studimet universitare në Fakultetin Pedagogjik në Stamboll, edhe pse jetonte në kushte të vështira jetese. Më tej pati sukses që të regjistrohet në shkollën “El-Fatih” të Stambollit, ku mësoi gjuhën arabe, perse dhe kulturat e popujve tjerë. Ai dallohej me aktivitetet e tij në fushën e reformave fetare dhe kombëtare. Në vitin 1904 regjistrohet në Fakultetin e Drejtësisë, ku edhe diplomon dhe më pas caktohet profesor po në të njëjtin fakultet. Ka punuar në gjykatën e Stambollit në shtetin Osman dhe më pas punoi avokat, pasi i kaloi të gjitha provimet e nevojshme për një detyrë të tillë. Në vitin 1921, u caktua Ministër i Drejtësisë në Shqipëri dhe botoi revistën fetare me titull “Udhë e së vërtetës”. Vdiq në vitin 1925 në Tiranë, kryeqyteti i Shqipërisë. Më gjerësisht shih: Eqber Skendi, “Hoxhë Kadriu-Kadri Prishtina”; Rilindja, Prishtinë 1992, 8-20, 217-219; Qemajl Morina, “Hoxhë Kadri Prishtina-mendimtar Islam”; Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë 2000, 7-97.

emancipimin, por në kushte dhe rregulla të posaçme.²³² Ishte shumë objektiv me shkrimet e tij dhe në diskutimet që i zhvillonte me kundërshtarët dhe oponentët e tij, duke mos dalë asnjëherë nga kultura islame, kur nuk pajtohej me të tjerët,²³³ madje as që është hakmarrë ndonjëherë ndaj dikujt.²³⁴ Nga qëndrimet më të njohura të tij që i shkruante nëpër gazeta e revista kundër laikëve ishte mendimi i tij se gruaja është gjysma e shoqërisë, ndaj si mund të braktiset, të injorohet e të sakatohet kjo qenie fisnike?! Ai nuk pranonte mendimin e laikëve që gruaja të del e zhveshur dhe lakuriqe. Ai po ashtu mendon se nuk duhet ta kushtëzojmë gruan me lakuriqësi, nëse dëshirojmë ta edukojmë dhe arsimojmë. Ky mendimtar ishte i mendimit që gruaja duhet të punojë punë të ndershme për të kontribuar në ngritjen e ekonomisë së shtetit. Hoxhë Kadriu nuk lejonte që femra të vozitë veturë, tren ose aeroplan.²³⁵

Për sa i përket çështjes së martesës së gruas muslimane, ai mendonte se duhet të merret pëlqimi i saj në martesë dhe se nuk duhet të detyrohet në martesë me ndonjë burrë që e urren, ashtu siç e kishin zakon dhe traditë shqiptarët. Ai gjithashtu ashpër e luftonte hipokrizinë dhe hipokritët.²³⁶ Mendoj se natyra e tillë e tij ishte formuar në edukatën islame që e kishte marrë në shkollën “El-Fatih” dhe në Universitetin e Stambollit, ashtu siç ishte përgatitur edhe me ide e kulturë të lartë islame dhe kombëtare.²³⁷

²³² Eqber Skendi, “Hoxhë Kadriu-Kadri Prishtina”; 35-102.

²³³ Mbi etikën e dialogut shih më gjerësisht: Taha Xhabir El-Ulvani, “Kultura e dialogut në Islam”; botuar nga Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam, bot. 2, 1992, Kuala Lumpur, Malaysia, 97-98.

²³⁴ Po aty, f. 152-154; “Historia e Popullit Shqiptar”; vëll. 4, 308-310.

²³⁵ Po aty, f. 150-152.

²³⁶ “Historia e Popullit Shqiptar”; vëll. 4, 308-310.

²³⁷ Ky personalitet i rëndësishëm islamik zë një vend të zgjeruar në hulumtime, studime e punime rreth aktiviteteve kombëtare e politike, por, për fat të keq, gjithnjë ia kanë injoruar aspektin islamik. Punimi më i mirë që studion aspektin islam të këtij eruditi është ai i profesorit Mr. Qemajl Morina: “Hoxhë Kadri Prishtina-Mendimtar islam”.

II: ALFABETI SHQIPTAR: FORMIMI DHE ZHVILLIMI

Erërat e doktrinës reformiste fetare frynin në të gjitha sferat e jetës fetare, kulturore dhe shkencore shqiptare. Ndër çështjet tridimensionale (shkencore, kulturore dhe fetare) ishte edhe çështja e vazhdimit të alfabetit arab ose zëvendësimi i tij me alfabetin latin. Dobësimi i shtetit osman arriti kulmin aty nga fundi i shek. XIX dhe fillimi i shek. XX. Krerët e rezistencës kundër shtetit osman filluan të paraqiten aty këtu nga vetë turqit dhe nga kombet e tjera. Historikisht është vërtetuar se mësimi dhe shkrimi i alfabetit shqip ishte i ndaluar shekuj me radhë nga shteti osman, përderisa ishte i lejuar²³⁸ për pakicat e tjera hebraike, serbe, greke, kurde, etj.²³⁹ Ndoshta një gjë e tillë ka ndodhur nga arsyeja se shteti osman i konsideronte të gjithë muslimanët si një popull,²⁴⁰ edhe pse dalloheshin në gjuhë e komb, dhe se gjuha e tyre duhet të jetë vetëm gjuha e shtetit osman. Siç duket, në bazë të këtij opcioni, janë trajtuar shqiptarët dhe muslimanët e tjerë.

Gjuha shqipe u lejua pas revolucionit të xhonturqve, dhe deri në vitin 1908, shkollat në Shqipëri ishin të ndara sipas feve, gjegjësisht muslimanët, katolikët dhe ortodoksët kishin shkollat e tyre të posaçme.²⁴¹

Problemi i arsimit në Shqipëri filloi të zbërthehet kur doli vendimi i Ministrisë së Arsimit të shtetit osman, më të cilin shqiptarëve u lejohej shkollimi në shkolla “T’dadije” dhe “Rushdije”(fillore).²⁴²

²³⁸ Vërtetë është për t’u habitur nga fakti se hebrenjve, serbëve, grekëve dhe kurdëve iu lejohej gjuha e tyre amtare dhe hapja e shkollave në gjuhët e tyre, ndërsa shqiptarëve një gjë e tillë iu ndalohej!!! Mendoj se shteti osman nuk është dashur të veprojë kështu, kur dihet se 36 oficerë, ministra dhe funksionarë të mëdhenj të shtetit osman ishin shqiptarë, madje dy prej tyre ishin edhe Shejhul-Islamë.

²³⁹ Skender Rizaj, “Kosova gjatë shekujve, XV-XVI-XVII”; 467; Stavro Skendi, “Zgjimi kombëtar shqiptar”; 334.

²⁴⁰ Këto të dhëna mbi politikën e shtetit osman, m’i ofroi profesori dhe mentori im i dashur dhe i nderuar prof.dr.Fikret Karçi, mirëpo sipas një profesorit tim tjetër dhe gjithashtu mentorit tim të respektuar prof.dr.Behauddin Muhammed Husejn (Allahu e mëshiroftë) nëse osmanlinjtë vërtetë i konsideronin muslimanët një popull, atëherë do të duhej t’i mësonin arabisht e jo turqisht, ngase arabishtja është gjuhë e Kur’anit dhe Sunnetit të Pejgamberit si dhe gjuhë e halifatit të Hulefai-Rashidinëve dhe të Abasidëve. Sipas tij, elementi nacionalist ka ndikuar që osmanlinjtë dhe turqit t’ua ndalojnë popujve tjerë përdorimin e gjuhëve të tyre dhe t’ua mësojnë turqishten, dhe ky fenomen sipas tij, konsiderohet thyerje e të drejtave të tyre në mënyrë shumë të vrazhdë.

²⁴¹ Stavro Skendi, “Zgjimi kombëtar shqiptar”; 58, 334.

²⁴² Po aty, f. 335.

Çështja e përcaktimit përfundimtar të përdorimit të alfabetit u studiua shumë, si në të shkuarën, ashtu edhe sot. Sipas disa studiuesve, rruga e shkronjave dhe alfabetit shqiptar ka qenë shumë e vështirë dhe përplot viktimë e sakrificë, gjersa e ka marrë formën e sotshme. Është harxhuar jashtëzakonisht mund i madh, dhe është derdhur shumë gjak për mbrojtjen e këtij alfabeti. Nuk ka dyshim se sakrifikimi i tillë konsiderohet ngjarje shumë e rëndësishme dhe e ndritshme në historinë e shqiptarëve, dhe pak çështje ekzistojnë në histori ashtu siç ekziston sakrifikimi këmbëngulës i shqiptarëve për hir të alfabetit. Përpjekjet e zbërthimit të këtij problemi shoqëror dhe edukativ në jetën dhe historinë e shqiptarëve ishin herë individuale e herë kolektive.²⁴³

Kërkimi i një alfabeti të përbashkët për shqiptarët muslimanë dhe të tjerët, kishte marr hov të madh në shek. XIX. Ideja e tillë kishte lindur nga elita intelektuale shqiptare që jetonte në egzil për shkak të rrethanave politike dhe shoqërore të asaj kohe brenda pushtetit osman. Në rrethana të tilla, çdo popull kërkonte me plot kuptimin e fjalës të pavarësohej dhe të fitonte pavarësi të plotë.²⁴⁴ Para depërtimit të osmanlinjve në tokat shqiptare, gjuha shqipe shkruhej me shkronja latine, ngase ishte më afër gjuhës amë,²⁴⁵ dhe tokat shqiptare konsideroheshin pjesë e kontinentit evropian, dhe falë pozitës gjeografike që e ka duhet ta përdorë alfabetin latin. Këtë mendim e përkrahnin disa studiues. Në fund të shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX u ngjallën ndjenjat kombëtare fetare shqiptare dhe kjo vërehej qartë nga përkthimi i teksteve të shenjta të krishtera nga greqishtja e latinishtja në shqip.

Në atë kohë ekzistonin disa lloje të alfabetit që përdorehin, si p.sh., alfabeti grek, alfabeti latin, alfabeti arab dhe alfabeti osman.²⁴⁶

Në periudhën mes viteve 1831-1884 dolën në shesh disa përpjekje individuale rreth alfabetit shqiptar, dhe kjo periudhë, nga ana e hulumtuesve dhe shkrimtarëve njihet në histori si periudha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, për shkak të disa zhvillimeve dhe ndryshimeve që ndodhën brenda kësaj periudhe. Qëllimi i kësaj Lëvizjeje ishte çlirimi dhe bashkimi i të gjitha tokave shqiptare dhe rezistenca kundër pushtetit osman në të gjitha mënyrat e mundshme.

²⁴³ Tomorr Osmani, “Udha e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit”; Idromeno, Shkodër 1999, 3-4.

²⁴⁴ Stavro Skendi, “Zgjidhja kombëtare shqiptare”; 336.

²⁴⁵ Tomorr Osmani, “Udha e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit” Idromeno, Shkodër 1999; 5-6.

²⁴⁶ Po aty, f. 93.

Duke u nisur nga zgjimi i tillë i shqiptarëve, marrëdhëniet në mes të shqiptarëve dhe osmanlinjve u keqësuan shumë, për shkak të rezistencës dhe kryengritjes së vazhdueshme të intelektualëve shqiptarë. Në vitin 1876 u tubuan një grup mendimtarësh shqiptarë rreth idesë së formimit të ndonjë organizate ose shoqate kulturore shqiptare në Stamboll. Kjo shoqatë kishte për detyrë të tubojë kontribute vullnetare financiare për botimin e librave shqiptare.²⁴⁷

Kulmi i kësaj rezistence arriti me formimin e Lidhjes Shqiptare në qytetin e Prizrenit, Kosovë në vitin 1878, ashtu siç theksuam edhe në kapitullin e parë. Qëllimi i kësaj Lidhje ishte i njëjtë me qëllimin e zgjimit kombëtar shqiptar. Në një atmosferë të tillë jostabile, ndodhi një ndryshim i madh në historinë e shqiptarëve. Mendimtarët shqiptarë, muslimanë dhe jomuslimanë, deklarorin se shqiptarët janë popull në vete dhe për këtë shkak duhet të kenë edhe flamurin e vet, dhe kështu u takuan përsëri në Stamboll dhe formuan një alfabet të posaçëm në vitin 1879.

Përpjekjet dhe mosmarrëveshjet rreth kësaj çështjeje zgjatën plot tri vjet, deri në konferencën e cila u mbajt në vitin 1908, në qytetin e Manastirit, që ishte kryeqendra e njërit nga katër vilajetet kryesore shqiptare (Vilajetit të Manastirit), qytet ky që sot ndodhet në Maqedoninë aktuale. Kjo konferencë u quajt “Kongresi i Manastirit”.²⁴⁸

Edhe letërsia shqiptare islame që shkruhej me alfabetin arab, filloi të merret me çështje kombëtare shqiptare, nëpërmjet tematikave që i shqyrtonte në poezi, prozë e ligjërata. Krahas kësaj, edhe lëvizja e përkthimit të Biblës dhe literaturës së shenjtë të krishterë në gjuhën shqipe ishte në vazhdim e sipër nga ana e priftërinjve, me pretekst të ruajtjes së gjuhës shqipe, ngase ajo është gjuha amë! U hapën disa shkolla në qytete e fshatra, dhe njerëzit filluan të mësojnë gjuhën shqipe me alfabet grek, përmes botimit të disa librave dhe shkrimeve shkencore që kishin të bënin me gramatikën e gjuhës, e që shkruheshin nga disa priftërinj ortodoksë të afërt me Greqinë.²⁴⁹

Krahas kësaj lëvizjeje fetare të krishterë që merrej me përkthimin e teksteve të shenjta, lulëzuan edhe aktivitetet e dijetarëve muslimanë nëpërmes punimeve poetike, prozaike e divaneve sufiste shqiptare islame të shkruara me alfabet arab. Këta përkthenin literaturë të llojllojshme nga gjuha arabe, perse e turke. Dijetarët dhe hulumtuesit shqiptarë të kohës

²⁴⁷ Po aty, f.296.

²⁴⁸ Stavro Skendi, “Zgjimi kombëtar shqiptar”; 5-6, 334-350.

²⁴⁹ Tomorr Osmani, “Udha e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit” Idromeno, Shkodër 1999; 87-92.

bashkëkohore ishin shumë të përqëndruar në këtë lulëzim fetar dhe letrar. Dijetarë dhe historianë shqiptarë nga Maqedonia Kosova e Shqipëria studiuan, hulumtuan dhe kritikuan shkrimet e tilla letrare të shkruara në gjuhën arabe, qofshin regjistrime (sixhilet), dokumentacion apo divane poetike e prozë, si p.sh., dijetari dhe orientalisti i njohur prof.Dr.Hasan Kaleshi,²⁵⁰ Osman Myderrizi, historiani i njohur prof.Dr.Muhamet Pirraku dhe letrari prof. Mahmud Hysa,²⁵¹ pastaj, dy hulumtuesit letrarë dhe orientalistë shqiptarë prof. Dr. Ismail Ahmedi dhe prof. Dr. Mehdi Polisi, etj. Këta personalitete gëzojnë autoritet të lartë në kohën tonë për shkak të studimeve të tyre në fushën e letërsisë dhe historisë shqiptare.²⁵²

Dijetarët dhe hulumtuesit e periudhës së zgjimit kombëtar ishin të ndarë në dy grupe:

1- Grupi letrar që shkruante në gjuhën shqipe me alfabet latin dhe grek, e që përbëhej nga të krishterët shqiptarë; dhe:

2- Grupi tjetër që shkruante në shqip me alfabetin arab e që përbëhej nga muslimanët shqiptarë.

Grup i shkrimtarëve dhe poetëve shqiptarë që shkruante në gjuhën shqipe me alfabetin arab,²⁵³ ishte përhapur në Vilajetin e Kosovës, të Manastirit, e në disa qytete tjera shqiptare dhe kishte ndikuar shumë në përparimin e letërsisë islame në vitin 1947 të shek. XX,²⁵⁴ madje disa historianë mendojnë se veprat nga letërsia shqipe me alfabet arab janë

²⁵⁰ Mbi aktivitetet dhe punimet shkencore të këtij profesori dhe orientalisti të njohur shqiptar u botuan dy punime të rëndësishme kohëve të fundit nga autorët; Riza Sadiku, **“Hasan Kaleshi-jeta dhe vepra”**; Grafoprin, Prishtinë 1996 dhe: Feti Mehdiu, Safet Q. Purellku, **“Hasan Kaleshi-Vepra 1”**; Studime publicistike, Logos-A, Shkup 1996; Disertacioni i doktoraturës së tij ka qenë: **“Najstariji vakufski dokumenti-iz Makedonije u Jugoslaviji na arapskom jeziku”**; Beograd 1960.

²⁵¹ Po aty, f. 137. Autori në fjalë dallohet po ashtu me shkrime dhe studime të veprave të autorëve të njohur shqiptarë islam në dy vëllime, **“Alamiada shqiptare”**, Logos-A, Shkup 2000.

²⁵² Autori i këtij studimi ka pasur nderin dhe ka përfutur shumë nga takimi i tij në Kosovë me profesorët e nderuar dr. Muhamet Pirraku, dr. Ismail Ahmedi dhe dr. Mehdi Polisi gjatë tubimit të materialit të nevojshëm për disertacionin. Ata më ndihmuan shume që të pasurohem me tituj të ndryshëm e të rrallë dhe nisur nga respekti i madh ndaj tyre si shkencëtarë, desha që në këtë disertacion t’u shpreh falënderim të singertë për kontributin që e dhanë, duke uruar Zoti i shpërbleftë me shpërblimet e Tij më të mira!

²⁵³ Ismail Ahmedi, **“Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra”**; Logos-A, Shkup 1999, 61-69.

²⁵⁴ Tomorr Osmani, **“Udhë e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit”**; Idromeno, Shkodër 1999;138.

shkruar edhe në vitin 1970 të shek. XX në Kosovë.²⁵⁵ Nga grupi i tillë veçojmë shkrimtarin sufist Nezim Frakulla, dijetarin dhe hoxhën Muhamed Kyçyku-Çamin,²⁵⁶ hoxhë Tahir Efendi Boshnjakun, hoxhë Vesel Xheladin Gutën²⁵⁷ dhe shumë të tjerë.

Si rezultat i përpjekjeve të tilla individuale dhe kolektive, u formuan katër drejtime kryesore mbi alfabetin shqiptar:

1. Grupi që dëshironte të pranonte alfabetin latin;
2. Grupi që dëshironte të pranonte alfabetin grek;
3. Grupi që dëshironte të krijojë një alfabet të ri që nuk u ngjanë alfabeve paraprake; dhe:
4. Grupi që tentonte përdorimin e alfabetit arabo-turk të trashëguar nga shteti osman.

Grupi i katërt argumentonte qëndrimin e vet dhe e mbronte me pretekst se Kur'ani Fisnik është shkruar në gjuhën arabe dhe për këtë shkak nuk duhet të zëvendësohet me gjuhën latine. Përveç kësaj, shkrimi nga e majta në të djathtë është imitim perëndimor dhe në këtë mënyrë njerëzit largohen nga Islami, kështu që zëvendësimi gjuhësor konsiderohet mëkat, gjynah. Krahas këtij qëndrimi konservativ, ekzistonte edhe një drejtim tjetër i dijetarëve reformistë dhe iluministë, që deklarorin se është gabim të mendohet se Kur'ani Fisnik na urdhëron ta përdorim vetëm gjuhën arabe,²⁵⁸ por, kjo çështje është alternativë dhe nuk jemi të obliguar t'i detyrojmë njerëzit që ta përdorin këtë alfabet. Ndër intelektualët shqiptarë iluministë që diskutonin rreth kësaj çështjeje

²⁵⁵ Muhamed Mufaku, “**Eth-Thekafetul-Albanijetu bil-Ebxhedijjetil-Arabijjeti**”; 2-20.

²⁵⁶ Profesori i nderuar dhe hulumtuesi i njohur shqiptar nga Kosova, Qazim Qazimi, ka mbrojtur doktoraturën rreth drejtimit letrar të tregimeve kur'anore në vjershën e njohur të hoxhë Muhamed Kyçyku-Çamit: “**Jusufi dhe Zylejhaja**”. Disa pjesë të kësaj poezie janë publikuar në revistën e njohur islame “**Dituria islame**” që e boton Bashkësia Islame e Kosovës: “**Vepra letrare e Muhamed Kyçyku-Çamit dhe poetët e Lindjes**”; Nr. 133, 2001, Nr. 134-135, 2001, “**Jusufi e Zylejhaja-histori e poetizuar**”; Nr. 143, 2002, Nr. 144-145, 2002.

²⁵⁷ Mulla Vesel Xheladini-Guta, “**Perëndia më frymëzoi**”; Focus, Shkup; Salih Hajdari, “**Poezia e Bejtexhinjve**”; 344-380, 429-476; Muhamet Pirraku, “**Kultura kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit**”; 226-227, 229, 244-249; Tomorr Osmani, “**Udha e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit**”, Shkodër, 1999; 139-142; Ramiz Zekaj, “**Zhvillimi i Kulturës Islame te shqiptarët gjatë shekullit XX**”; 252-381.

²⁵⁸ Stavro Skendi, “**Zgjimi kombëtar shqiptar**”; 340.

ishin Naum Veqilharxhi, hoxhë Hasan Tahsini²⁵⁹ për te cilin do të flasim ma vonë, Sami Frashëri, etj.²⁶⁰

Shqiptarë që jetonin në egzil, si p.sh., në Aleksandri, në Stamboll, në Bukuresht dhe në Sofje, ndjenin zbrazëtirë nga mungesa e një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët, dhe mendonin se kjo është edhe arsyeja se pse shqiptarët kanë mbetur të prapambetur dhe dekadent. Në këtë kontekst, mendimtari dhe letrari erudit shqiptar, Sami Frashëri, thotë: *“Popujt dhe kombet jetojnë nëpërmes gjuhës së tyre, dhe nëse ndonjë popull nuk shkruan në gjuhën e vet, shpejt harrohet dhe zhduket...”*²⁶¹

Pas diskutimeve të gjata dhe debateve të shumta, më në fund, arritën një marrëveshje për formimin e alfabetit të përbashkët shqip. Edhe pse aty kah viti 1879, kishte ca mosmarrëveshje të vogla rreth disa shkronjave, përsëri çështja e alfabetit, akoma nuk ishte mbyllur në mënyrë definitive.

Pas rënies së Sulltan Abdulhamidit të II, bota islame dhe arabe ra në krizë të papërshtatshme, intelektualët shqiptarë e shfrytëzuan një kaos të tillë dhe formuan shumë shoqata kombëtare nacionale brenda dhe jashtë Shqipërisë, me qëllim të zhvillimit të arsimit dhe pavarësisë shqiptare.²⁶² Kah fundi i periudhës së formimit të alfabetit, nga data 14. 11. 1908 gjer më 22. 11. 1908, u organizua një Kongresi i madh, ku u zhvillua një debat i gjerë rreth alfabetit. Në këtë Kongres u diskutua në mënyrë marginale edhe qëndrimi i Sheriatit islam rreth shkrimit nga e majta në të djathtë, dhe rreth vështirësisë së mësimin të Kur'anit Fisnik. Pra, si duket, kjo çështje ka pasur edhe ngjyrimet fetare. Ndër rezultatet e hidhura dhe të ashpra që dolën nga ky kongres kombëtar, ishte shkarkimi i tetë

²⁵⁹ Ky hoxhë, astronom, psikolog e matematikan shqiptar nga Çamëria, ka qenë rektori i parë i Universitetit të Stambollit; Kishte kulturë shqiptare, arabe, franceze, turke, perse dhe ishte i mendimit se alfabeti arab, grek dhe latin nuk janë të përshtatshëm për gjuhën shqipe, për shkak të karakteristikave të gjuhës shqipe dhe gjuhëve të tjera evropiane, dhe për këtë arsye ai propozonte që gjuha shqipe të ketë alfabet të vetin, me karakteristika dhe tipare të shqipes. Ai kishte përgatitur një alfabet si mostër për të shkruar në shqip, por të tjerët e kishin refuzuar...me gjerësisht shih: Ibrahim Daut Hoxha, **“Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu-të tjerët për të”**; (AIITC, Tiranë 1998, 8-11, 30-33, 40, 58, 78-145; Tomorr Osmani, **“Udhë e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit”**, Shkodër, 1999; **“Historia e Popullit Shqiptar”**; vëll. 4, 135-139.

²⁶⁰ Tomorr Osmani **“Udhë e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit”**, Shkodër, 1999; 173-175; Stavro Skendi, **“Zgjidhje kombëtar shqiptar”**; 340.

²⁶¹ Tomorr Osmani **“Udhë e shkronjave shqipe-Histori e alfabetit”**, Shkodër, 1999;

²⁶² Më gjerësisht reth kësaj çështjeje shih: Stavro Skendi, **“Zgjidhje kombëtar shqiptar”**; 342; Qazim Xhelili, **“Vehbi Dibra-personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare”**; 30-78.

hoxhallarëve dhe imamëve nga xhamitë e tyre dhe pengimi i tyre që ata në të ardhmen të merren me punë si imamë në disa komuna shqiptare, me arsyetimin se ata nuk dinin të lexonin në alfabetin e ri latin. Ata, po ashtu u obliguan që të sjellin vërtetime dhe diploma nga institucionet arsimore se vërtetë kishin prezantuar në mësimet dhe ligjëratat që zhvilloheshin rreth alfabetit të ri, se e kishin mësuar atë alfabet dhe se kishin mundësi të lexojnë e të shkruajnë në alfabetin e ri.²⁶³ Kjo ngjarje në historinë tonë është shumë e çuditshme!!!

Mendoj se ishte një mjerim për fenë islame dhe ithtarët e Islamit dhe turp për ata që kishin sjellë një vendim të tillë!!! Kjo ndodh atëherë kur nuk ka pushtet islam, ndaj këtë çështje ia lëmë të Madhit Zot dhe Atij i mbështetemi! Fill pas kësaj, jehuan reagime të ashpra nga muslimanët e tërë trojeve etnike shqiptare, posaçërisht nga Vilajeti i Kosovës dhe i Shkodrës, ngase mendonin se, alfabeti i ri, sipas tyre, ishte hap i suksesit për krishterizimin e muslimanëve.²⁶⁴

Si rezultat i zhvillimeve dhe lëvizjeve të tilla kombëtare, shoqërore e fetare, u organizua edhe një kongres tjetër më 22.07.1909 në qytetin Dibra e Madhe, për të shqyrtuar çështjen e arsimit. Rezultatet e këtij kongresi ishin më të buta se ato të kongresit të Manastirit. Aty u vendos që të hapen shkolla fillore dhe të mesme në të gjitha viset e Shqipërisë, që arsimi të zhvillohet në gjuhën shqipe dhe në mënyrë të obligueshme të zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe nëpër shkolla dhe në administratë. Ky kongres dallohet, ngase në të nuk kishte rëndësi se a do të përdoret alfabeti arab apo ai latin, por kryesore është që çdo njeri në Shqipëri të mësojë shkrimin dhe leximin në cilindo alfabet qoftë.²⁶⁵ Shkaku që shteti osman nuk i kishte miratuar kërkesat e shqiptarëve rreth çështjes së alfabetit, ishte frika nga kryengritja dhe rebelimi i tyre, sepse pas kërkesave të tyre fshihej synimi për pavarësi të plotë dhe përfundimtar nga shteti osman.

Kjo frikë dhe droje e kishte shtyrë Shejhul-Islamin që më 22.03.1910, të del me një fetva të prerë, ku kategorikisht ndalonte përdorimin e alfabetit latin. Fetvaja e tij u distribuua në çdo qendër islame të qyteteve shqiptare. Përveç kësaj, shteti osman kishte filluar të përdorë fuqinë dhe dhunën për t'i mbyllur të gjitha shoqatat dhe qendrat shqiptare që merreshin me këtë çështje. Pas kalimit të një periudhe prej tetë muajsh nga përdorimi i dhunës dhe forcës, në një situatë kaotike të sigurisë

²⁶³ Stavro Skendi, “Zgjidhja kombëtare shqiptare”; 341.

²⁶⁴ Po aty, f. 342.

²⁶⁵ Po aty, f. 343.

brenda vendit. Shteti osman dështoi në ngulfatjen e lëvizjeve të tilla, dhe vërejmë se Ministria e Punëve të Brendshme e shtetit osman papritur, lëshoi një vendim të befasishtëm, me të cilin lejohej hapja e të gjitha shkollave që ishin mbyllur, madje lejohej edhe hapja e shkollave të reja. Në një nen të këtij vendimi potencohet e drejta e popullit shqiptar për të mësuar gjuhën shqipe me alfabetin e saj, ndërsa Kur'ani obligohet të mësohet vetëm në alfabetin arab.²⁶⁶

Dhe kështu, pas daljes së vendimit të ri, kjo grindje shoqërore përfundoi, dhe ndoshta një hap i tillë, ishte edhe hyrje në Pavarësinë e Shqipërisë në vitin që do të pasonte, përkatësisht më 28 nëntor të vitit 1912.

III: ÇËSHTJA E KONFLIKTIT IDEOLOGJIK NË SHOQËRINË SHQIPTARE GJATË SHEKULLIT XX

Zërat e parë të reformizmit shoqëror dhe fetar në trurin e shqiptarëve filluan të dëgjohen shumë më zhurmshëm në fillim të shek. XX, posaçërisht gjatë tre dekadave të para që ishin përplot lëvizje dhe ngjarje të shumta. Në këtë kohë, kishte filluar të përhapet e t'i përforcojë rrënjët edhe ideologjia komuniste në tërë territorin shqiptar, pastaj para Luftës së Dytë Botërore, gjendja ekonomike dhe politike ishte shumë e përkeqësuar, për shkak të polarizimit të situatës ideologjike dhe politike në mbarë Evropën.

Të gjitha këto zhvillime dhe ndryshime në Evropë, kishin ndihmuar që njerëzit të humbnin shpresat, të mos ishin të qetë në aspektin psikik dhe të frikësoheshin nga ardhmëria. Krimet ishin përhapur shumë, ashtu siç ishte përhapur prostitucioni, egoizmi, tirania shoqërore, spiunimi dhe korrupsioni, dhe e gjithë kjo kishte ndihmuar që njerëzit të frikësoheshin nga njëri-tjetri, ngase secili spiunonte për çdo kënd. Prej asaj kohe e deri më sot, mjerisht, akoma vazhdojmë t'i përfetojmë pasojat e hidhura të fenomeneve të tilla që mbizotëronin në atë kohë.²⁶⁷

Edhe ideja e ateizmit dhe mohimit të fesë, veçmë kishte filluar të shfaqet në shoqëri, duke i përhapur parimet e materializmit në shkolla, shoqata, organizata, etj. Ulematë dhe mendimtarët shqiptarë sakrifikonin çdo gjë për ta mbrojtur besimin islam dhe atdheun e tyre prej armiqve

²⁶⁶ Po aty, f. 350.

²⁶⁷ Ali M. Basha, “Islami në Shqipëri gjatë shekujve”; 147.

kolonialistë italianë e grekë.²⁶⁸ Ndër ulematë dhe hoxhallarët që qëndruan kundër rrymave ideologjike komuniste që vinin nga Evropa, konkretisht nga Rusia e që përhapeshin në këto treva, mund të përmendim shejhun, dijetarin dhe hoxhën Hafiz Ali Korça,²⁶⁹ i cili pa kurrfarë frike dhe me qëndrim kategorik reagonte dhe fliste të vërtetën, dhashë Zoti, ne përsëri, në këtë studim, do t'i kthehemi këtij personaliteti dhe do t'i analizojmë aktivitetet e tij që kishin të bënin me doktrinën e tij në interpretimet kur'anore, si shembull praktik i lëvizjes reformiste fetare, ndërsa këtu do të ndalemi në një çështje tjetër.

Nisur nga obligimi për mbrojtjen e fesë islame nga ideologjia shkatërruese dhe komunizmi i kuq, me fjalë dhe laps, hoxhë Hafiz Ali Korça, në vitin 1925 botoi një libër me titull “Bolshevizma a çkatërrim i njerëzimit”. Në këtë vepër ai kishte shkruar disa vargje me domethënie të madhe dhe shumë kuptimplote, si p.sh.:

*Bolshevizma s'pajton kurrë
Me dinin e Muhamedit
Çelët do ta kenë luftën
Gjer ditën e Kiametit.*²⁷⁰

Hafiz Ali Korça (Zoti e mëshiroftë!) dallohej me tru dhe rezon të shëndoshë, me mendime origjinale dhe me shkathtësi të hatashme.²⁷¹ Ai kishte kuptuar thellë lëvizjen komuniste dhe ua tërhiqte vërejtjen njerëzve nga dëmet e kësaj lëvizjeje. Para se t'i sqarojë dëmet materiale të

²⁶⁸ Po aty, f. 147-148.

²⁶⁹ Mbi këtë personalitet fetar shiptar dhe islam u botua kohëve të fundit një monografi e re dhe e rëndësishme me vlera historike dhe shkencore e profesorit dr. Ismail Ahmedit, që ishte disertacion doktore mbi jetën, veprën dhe mendimet e hoxhë Hafiz Ali Korçës, me titull: “**Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra**”.

²⁷⁰ U ballafaqova me probleme e vështirësi gjatë hulumtimit në Shqipëri rreth veprave të botuara dhe të pa botuara të këtij dijetari, madje edhe rreth fotokopjimit dhe nxjerrjes së tyre nga Biblioteka Kombëtare në Tiranë. Sikur të mos ishte mëshira e Zotit dhe ndihma nga disa vëllezër e profesorë, si p.sh.Dr. Ramiz Zekaj dhe prof. dr. Ibrahim Gashi, prof.Dr.Ismail Ahmedi, ndoshta nuk do të kisha mundësi t'i nxjerr veprat e tij jashtë Bibliotekës Kombëtare. Për këtë u jam shumë mirënjohës dhe lus të Madhin Zoti t'i shpërblejë me shpërblimet më të mira për ndihmën që ma ofruan!

²⁷¹ Më gjerësisht mbi bolshevizmin rus shih: Vernon Bogdanor, “**The Blackwell Encyclopedia of Political Institutions**”; Oxford, 1987, UK, 50-51; Joel Kriger, “**The Oxford companion to politics of the World**”; Oxford University Press, 1993, “**Russian Revolution**”; Frank Bealey, “**The Blackwell Dictionary of Political Science**”; Oxford 1999, UK, 31.

komunizmit në këtë vepër, ai zbërthen disa parime të Kur'anit Fisnik ndaj pasurisë.²⁷² Në këtë kontekst, ai përmend ajetin kur'anor:

([الشورى: 27] ﴿الْأَرْضُ فِي لَبَغْوًا لِعِبَادِهِ ۚ الرِّزْقَ اللَّهُ بَسَطَ وَلَوْ﴾)

“Sikur Allahu t’ua shumonte begatinë robërve të vet, ata do të kalonin kufijtë”.²⁷³

Nga ky ajet nënkuptohet se Zoti i Madhërishëm ka caktuar që të ketë furnizime të llojllojshëm për të vazhduar jeta në tokë, për të ndihmuar njëri-tjetrin dhe sikur të gjithë të kishin njësoj pasuri, atëherë jeta do të ishte ndalur, dhe për këtë shkak të gjithë duhet të kërkojnë në mënyrë të vazhdueshme rizkun dhe furnizimin, në mënyrë që rrota e qytetërimit të ecë përpara, të përparojë, dhe se Zoti i Madhërishëm nuk na ka krijuar kot.²⁷⁴

Dijetari Hafiz Ali Korça më tej vazhdon dhe sqaron rrënjët e kësaj ideje bolshevike komuniste ruse dhe thotë: “*Trungu i hidhët dhe i mallkuar bolshevik është mbjellë afro 70-80 vjet para Karl Marksit, pastaj është ujitur me ujin e Leninit dhe dëshirojmë t’i informojmë vëllezërit tanë për armiqësinë e fuqishme që e fshehin hebrenjtë në zemrat e tyre kundër muslimanëve. Në suren El Maide, Zoti i Madhëruar thotë: “Gjithqysh ti do të vëresh se hebrenjtë dhe ata që i përshkruan Zotit shok (idhujtarët), janë njerëzit me armiqësi më të fortë kundër besimtarëve (kundër muslimanëve)”*.²⁷⁵

Të gjitha katastrofat dhe vështirësitë që e kanë kapluar botën islame, që nga kohërat e lashta deri më sot janë nxitur nga hebrenjtë dhe idhujtarët, dhe shumë hebrenjë janë konvertuar në Islam, vetëm e vetëm për ta dëmtuar Islamin dhe muslimanët. Abdullah ibën Sebe’e ka përhapur ide dhe dyshime që kundërshtonin Islamin, duke thënë: “Aliu është Zot!” (Zoti është i pastër nga ajo që i përshkruajnë). Po ashtu edhe në betejën e Siffinit hebrenjtë kishin dorë të fshehtë, bile edhe ndërtimin e Mesxhidu Dirarit- xhamia e sherit dhe e dëmit- në Medinë e kishin

²⁷² Hafiz Ali Korça, “**Bolshevizma a çkatërrim i njerëzimit**”; Shtypshkronja Mbrothësia, Kristo P. Luarasi, 1925, 1.

²⁷³ Al Shura:27

²⁷⁴ Po aty; dhe gjithashtu shih disertacionin e doktoraturës së botuar të prof.Dr. Ismail Ahmedi, “**Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra**”; 45; Ismail Ahmedi, “**Largpamësia denoncuese për konceptin bolshevik-Hafiz Ali Korça**”; Jehona, No. 5, Tiranë 2000, 10.

²⁷⁵ El-Maide, 83.

*përkrahur hebrenjtë,²⁷⁶ me qëllim që të krijojnë dyshime dhe dëm. Në të kaluarën ata kanë vrarë pejgamberë e të dërguar të Zotit dhe kanë bërë shumë krime kundër njerëzimit”.*²⁷⁷

Hoxha po ashtu tërheq vërejtjen nga rreziku hebre në aspektin ekonomik. Ata kur dështuan me luftimet e tyre kundër të krishterëve dhe muslimanëve, u kthyen kah intrigat ekonomike dhe formimi i shoqatave masone, si p.sh.: Shoqata Masone Liberale- Free Masons, që kishin si parim dhe moto “Vëllazërimin dhe Bashkimin e të gjithëve”. Siç duket, hoxha ka qenë tërësisht i vetëdijshëm për idetë dhe doktrinat e kohës së tij që i përhapnin kundërshtarët e Islamit.

Pra, hoxha e kishte kuptuar fort mirë rrezikun nga ideja marksiste-hebraike, që e kishin trilluar në emër të qytetërimit dhe progresit, e që në esencë, nuk ishte asgjë tjetër pos luftë ndaj të gjitha feve dhe krijimit e problemeve dhe kaosit të pakufizuar në mes njerëzve.²⁷⁸

Nga disa gjurmë negative që ishin pasojë e kësaj ideje marksiste, Hafiz Ali Korça citon një thënie të një dijetari të burgosur në Rusi: “Ai që beson në kiametin e madh, le të shikojë kiametin e vogël që ka ndodhur në Rusi dhe Çekoslovaki. Shumë njerëz të pafajshëm u vranë, shumë xhami dhe faltore u prishën dhe u shkatërruan, shumë pasanikë u bënë të varfër dhe shumë njerëz nga elita e lartë u bënë të ulët, të nënçmuar dhe pavlerë, për shkak të aplikimit të socializmit në ngjyrë të komunizmit. Tufani i Nuhit a.s. ka qenë me ujë, ndërsa tufani i Marksit është vërtetë nga gjaku”.²⁷⁹ Them se ky përshkrim i saktë dhe i qëlluar na jep të nënkuptojmë në mënyrë precize pasojat dhe dëmet e sistemit komunist që u aplikua në Bashkimin Sovjetik dhe në shtetet e tjera që donin të aplikonin këtë sistem të dështuar.

Hoxhë Hafiz Ali Korça (Zoti e mëshiroftë!) është koncentruar edhe në një çështje tjetër fetare me rëndësi të madhe, dhe s’do mend se ngjarjet vendore e ndërkombëtare kishin edhe ngjyrë fetare. Në këtë kontekst, ai thotë: “Karl Marksi ishte hebre fanatik dhe përcillte mësimet e Talmudit në idetë dhe metodën e tij. Ai mendonte se patjetër duhet të ndodhë një revolucion i përgjithshëm i punëtorëve dhe të dobëtëve që

²⁷⁶ Mbi doktrinën dhe sektet e vjetra dhe bashkëkohore si dhe mbi rrezikun e tyre ndaj Islamit dhe muslimanëve shih studimin e profesorit tim Irakian (Allahu e mëshiroftë), prof.Dr. Irfan Abdulfettah Hamid: “**El-Jehudijjetu-ardun Tarihiyyun vel-Harekat el-hadithe fil-jehudijjeti**”, Amman, Daru-Ammar, bot. 1, 2002, f. 34-245.

²⁷⁷ Hafiz Ali Korça, “**Bolshevizma a çkatërrim i njerëzimit**”; 7-8.

²⁷⁸ Po aty, f. 10-11.

²⁷⁹ Po aty, f. 12-13.

*njiheshin me emrin “proletarë”, ata duhet ta marrin pushtetin, kurse të gjitha parimet shpirtërore që kishin të bënin me fenë, respektin, nderin dhe turpin duhet braktisur dhe refuzuar. Vërtet Marksist ishte adhures dhe ithtar i Teuratit dhe shërbyes i Talmudit!”*²⁸⁰

Siç duket, mësimet e Rasisë ateiste dhe revolucionit të Leninit, në vitin 1917, u përhapën me një shpejtësi të madhe, dhe hoxha i nderuar Hafiz Ali Korça e kishte kuptuar dëmin nga kjo ide që përhapej, po ashtu, shumë shpejt edhe në mesin e muslimanëve në Shqipëri. Ai mendohej t’ua sqarojë komunizmin marksist shqiptarëve muslimanë, që ta kuptojnë natyrën e vërtetë të tij nga vetë thëniet e dijetarëve dhe studiuesve të mëdhenj të tij. Shejh Hafiz Ali Korça theksonte se bolshevikët (komunistët) ndaluan dhe mohuan të gjitha fetë dhe se shumë priftërinj e hoxhallarë u dogjën të gjallë. Xhemaludin Afgani ka theksuar në një libër të tij qysh para pesëdhjetë vjetësh se komunizmi do ta shkatërroj botën dhe njerëzimin thellë gjer në rrënjë.²⁸¹

Ky depërtim apo ky rrezik i kuq i dogji mus’hafët-kur’anat, biblat dhe librat shkencorë. Parimet e komunizmit përgjithësisht mohonin Zotin, fenë dhe pejgamberët. Sipas tyre, koha e librave të shenjta veç më ka përfunduar dhe tani e tutje obligohemi të ndjekim kur’anin marksist!!! Ç’ide çmendurake, Zoti i mallkoftë! Ata mohojnë agjërimin dhe namazin, ndërsa trumbetonin se lumturia e vërtetë vjen vetëm nga ateizmi!! Në shkollat shtetërore arsimtarët nxënësve ua mësonin parimin dhe idenë e mosekzistimit të Zotit. Ata dyshonin në martesë dhe mendonin se njeriu s’duhet të martohet apo të marrë përgjegjësinë e fëmijëve. Burri është burrë e femra femër, dhe kur gjinden fëmijët nuk ka përgjegjësi për ata. Gruaja është e lirë të zgjedhë sa burra do dhe cilin e do, si dhe parime tjera destruktive e idiote, për të cilat edhe lapsit i vjen turp t’i shënojë.²⁸²

Metoda e Hoxhës ishte që gjatë bisedës dhe shqyrtimit të problemit, të mbështetet në argumente të shëndosha dhe të vërteta. Të dhënat statistikore, të cilat është vështirë të besohen, tregojnë se elementet e tilla e kanë dëmtuar shumë njerëzimin, ekonominë, fenë dhe bujqësinë.²⁸³

²⁸⁰ Po aty, f. 14.

²⁸¹ Shejh Hafiz Ali Korça nuk e ka theksuar titullin e librit të Xhemaluddin Afganit nga i cili e ka marrë këtë citat. Shkaqet përse ka vepruar kështu nuk i dimë. Megjithatë ai duhej ta potenconte titullin për ta konfirmuar fjalën e cituar.

²⁸² Po aty, 16-21; Daut I. Hoxha, **“Hafiz Ali Korça-Veprimtaria e tij në lëmin e atdhetarisë dhe arsimit-kulturës shqiptare dhe arabe-osmane-persiane”**; 1995 Tiranë, 5-12.

²⁸³ Shiko po të njëjtin libër për t’i lexuar të dhënat e tmerrshme statistikore, 22-23.

Në fund të fjalës së këtij hoxhe rreth kësaj ideje, thuhet se mundësitë e përhapjes së kësaj ideje në botë janë të mëdha, ngase hebreujtë dominojnë në të gjitha sferat e jetës. Hoxha ka vërejtur rrezikun prej tyre dhe ka thënë se feja islame nuk ka nevojë për këtë ide e as për këtë sistem të dështuar, ngase në vete i përmban demokracinë, vëllazërinë dhe barabarësinë e vërtetë dhe se Muhammedi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nuk bënte dallim në mes shokëve të tij, pastaj institucioni i zeqatit dhe sadakatul-fitrit e garantojnë vëllazërinë dhe socializmin dhe solidaritetin e vërtetë fetar.²⁸⁴

Po ashtu në mesin e atyre që refuzonin dhe luftonin këtë rrymë laike e ateiste në formë kategorike, ishte edhe Haxhi Vehbi Dibra-Agolli, (Allahu e mëshiroftë) i cili në këtë kontekst thotë: *“Për çudi!!! Të jetë ateizmi,²⁸⁵ afetaria dhe mohimi i Zotit, shërim i përçarjes dhe copëtimit në mes nesh! Këtë nuk e kemi ditur më parë! Për një popull si shqiptarët, ithtarë të fesë islame dhe të krishterimit (ortodoksë e katolikë), mjafton vetëm ndarja fetare dhe a dëshironi të formojmë edhe një përçarje e copëtim të ri dhe të shtojmë edhe një parti të re?! Feja s’mund t’u jepet njerëzve me forcë, por ne obligohemi që t’i thërrasim dhe ftojme! Kushtetuta e shtetit garanton dhe lejon lirinë fetare dhe thirrjen në fe. S’ka dyshim se nëse pranojmë ide dhe drejtime të tilla ateiste e laike, do të përçaheshim edhe më shumë, do të dobësoheshim edhe më tepër, dhe nuk do të mund të përballeshim me armikun dhe, kështu do të shkatërrohej shteti ynë. Armiku largohet prej nesh dhe i mbyllën të gjitha dyert vetëm me një kusht, gjegjësisht vetëm nëse bashkohemi rreth një pike dhe rreth një qëllimi të lartë!”²⁸⁶*

Për të njohur më shumë të vërtetën e kësaj sfide dhe rezistencën që ia bënin muslimanët shqiptarë, duhet t’i shfletojmë ligjëratat, hutbet dhe mësimet shkencore që i kishin zhvilluar ulemaja e kohës. S’ka dyshim se hoxhallarët dhe ulematë e tillë e kuptonin realitetin e ummetit islamik shqiptar dhe jetën e tyre. Ata ligjëronin vazhdimisht çdo ditë gjatë muajit

²⁸⁴ Po aty f. 22-31. Rreth kësaj çështjeje ka shumë të vërteta, të cilat nuk kemi mundësi të gjitha t’i theksojmë këtu. Vepra dhe monografia e prof. dr. Ismail Ahmedit ka të dhëna më tepër, referohuni asaj, edhe pse përsëri në kapitullin e ardhshëm, do të takohemi me këtë vepër, kur do t’i analizojmë shembujt dhe doktrinën e tefsirit të tij të Kur’anit Fisnik.

²⁸⁵ Mbi çështjet e hebraizmit, ateizmit, komunizmit dhe kritikave kundër ideve të tilla, mund të lexoni më gjerësisht në librin **“Kadhaiful-Hakki”** të dijetarit të madh islam Sheikh. Muhamed Gazaliut, Allahu e mëshiroftë, botuar nga Darul-Kalem; Damask, bot. II, 1997; 20-23, 187-207.

²⁸⁶ Ali M. Basha **“Islami në Shqipëri gjatë shekujve”**; 151-152.

të Ramazanit nëpër xhami, mesxhide e qarqe të xhematit të rëndomtë ligjërata nga tefsiri, hadithi, sufizmi, etika, fikhul-ibadati dhe mu'amelati. Ajo që tërhoqi vëmendjen time ishte ligjërata e hoxhës dhe dijetarit, Haxhi Vehbi Dibra. Për këtë personalitet të shquar, thuhej se shumë ishte thelluar në tefsirin e Kur'anit Fisnik, saqë vetëm tefsiri i sures "El-Fatiha" i ka zgjatur disa muaj, për shkak të kuptimeve të shumta që i ka kjo sure e bekuar, dhe për shkak të të kuptuarit të saktë e të thellë të hoxhës, si dhe të njohurive të gjera e të thella që i kishte nga literatura e tefsirit, gjuhës, sufizmit dhe fikhut.

Në revistën islame shkencore, që botohej nga Komuniteti Musliman i Shqipërisë botoheshin artikuj dhe punime të hoxhë Vehbi Dibrës (Zoti e mëshiroftë!). Unë, në vijim, do të nxjerr disa pasuse nga tefsiri i tij i sures "El-Fatiha" që të shohim se si ua tërhiqte vërejtjen muslimanëve shqiptarë nga pasojat e laicizmit, ateizmit dhe doktrinave destruktive. Ai po ashtu sqaronte vlerat tolerante të Kur'anit Fisnik dhe ato të Sheriatit islamik:

*"Kur'ai Fisnik ka caktuar elementet e qytetërimit dhe civilizimit, ka sqaruar drejtësinë, administrimin, mësimin, prodhimtarinë, tregtinë, ekonominë, vëllazërinë dhe moralin. Qytetërimi dhe civilizimi, në të cilin fton Kur'ani, garantojnë lumturi në të dy jetët, në këtë dhe në botën tjetër".*²⁸⁷ Nga komentimi i tij që i bën ajetit kur'anor:

أَنَّ النَّاسَ بَيْنَ حَكْمَتُمْ وَإِذَا أَهْلَهَا إِلَى الْأَمْنَتِ تَوَدُّوْا أَنْ يَأْمُرَكُمْ اللَّهُ إِنَّ *

([النساء: 58] بِالْعَدْلِ تَحْكُمُوا)

"Allahu ju urdhëron që t'u jepni amanetet të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë mes njerëzve",²⁸⁸ nënkuptohet se shoqëria shqiptare në atë kohë përjetonte korrupsion administrativ, shoqëror dhe ligjor, ndaj dhe në këtë kontekst ai thotë: *"Obligohemi që të zgjedhim një person që meriton të ushtrojë ndonjë detyrë, pastaj ai obligohet të veprojë e të gjykojë me drejtësi. A nuk është kjo teori e rëndësishme, e vlefshme dhe e lartë fetare, filosofike? Jeta e çdo populli dhe progresi i tij kushtëzohen me dy kushte: Besnikëri dhe drejtësi, nëpunës të aftë e të sinqertë dhe gjykim me drejtësi..."*²⁸⁹

²⁸⁷ Haxhi Vehbi Dibra, "Ç'urdhëron Kur'ani-Kuptimi i Fatihasë dhe shpjegime", Albanian Islamic, Harper Woods, Michigan, USA, 1st edit. 1993, 3.

²⁸⁸ En Nisa: 58

²⁸⁹ Po aty.

Në tefsirin e tij ai sqaronte përpjekjet e armiqve për të mbjellë dyshim në shpirtrat e muslimanëve. Ai deklaronte se nuk mjafton të mbështetemi vetëm në besimin që e kemi trashëguar nga prindërit tanë, sepse besimi i tillë është tradicional, por obligohemi që të kalojmë në shkallën e dytë, gjegjësisht në besimin induktiv që përfitohet nga studimet dhe hulumtimet shkencore të natyrës dhe në këtë mënyrë ta njohim Krijuesin e Madhërishëm.²⁹⁰

Sa i përket çështjes kombëtare patriotike, mund të themi se ka qenë mjaft me prioritet për hoxhallarët e atëhershëm. Të gjithë hoxhallarët që jetonin në territoret etnike shqiptare, përkrahnin dhe ndihmonin idenë e Pavarësisë së Shqipërisë nga shteti osman, gjatë viteve të fundit të Perandorisë, d.t.th. para shkatërrimit, si dhe luanin rol shumë të rëndësishëm e aktiv me anëtarët e Lëvizjes së Zgjimit Kombëtar Shqiptar, ngase frikësoheshin nga shtetet kryqtare fqinjë që tentonin të okupojnë vilajetin e fundit shqiptar që kishte mbetur nga katër vilajetet. Shteti osman gjatë ditëve të fundit, nuk kishte mundësi të mbronte as veten, e le më shqiptarët, dhe për këtë shkak shqiptarët ishin bashkuar rreth çështjes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe shpëtimit të saj nga okupimi kryqtar. Po ashtu, të gjithë dijetarët dhe ulematë përpiqeshin që të ndërpresin të gjitha lidhjet me Shejhul-Islamin e shtetit osman, dhe për këtë shkak fjalët e tyre mbi rëndësinë e vatanit, shtetit, pavarësisë, mos tradhtisë, mos spiunimit dhe mos kolaboracionit ishin fjalë që dëgjoheshin në çdo rast, në çdo ligjëratë dhe në çdo hutbe.

Doktrina dhe drejtimi i tefsirit shoqëror apo politik ishte fenomen që vërehej në fjalimet dhe hutbet e dijetarëve shqiptarë në kohën bashkëkohore. P.sh., në tefsirin e ajetit kur'anor:

([الفاتحة: 4] ﴿الَّذِينَ يَوْمِرَ مَلِكٍ﴾)

“Sunduesi i Ditës së Gjykimit”, El Fatihatu:4, ai thotë: *“Shikoni, vëllezër të nderuar dhe dinie se veprat tona i kontrollojnë Zoti i Madhërishëm dhe se do të japim llogari para Zotit të Madhërishëm për çdo vepër që e bëjmë. Dashuria ndaj atdheut në Islam ka vlerë të madhe dhe në këtë kontekst, në hadithin e Pejgamberit tonë (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thuhet se “Dashuria e vatanit është pjesë e imanit (besimit)”;*²⁹¹ *dhe për këtë shkak kini kujdes nga tradhtia, ngase tradhtia*

²⁹⁰ Po aty.

²⁹¹ Imam San'ani thotë “ky hadith është *mevdu’ë*, - (i fabrikuar, i rrejshëm, i çpikur)”; Ndërsa imam El Kari’u në “*El-Mekasid*” thotë: *“Lem ekif alejhi”*, - nuk kam hasur në këtë hadith-, dhe kuptimi i tij është i vërtetë... Imam San'ani thotë; Fjala e tij:

*ndaj vatanit mund të ndodhë lehtë, nëse muslimani nuk ka kujdes (lusim Zotin me na ruajtë nga kjo vepër), p.sh., vlerësimi i gjërave të importuara nga ndonjë shtet tjetër mbi gjërat e shtetit tënd konsiderohet tradhti ndaj shtetit, dhe nëse shtetit tonë i kërcënohet rrezik, nuk lejohet të heshtim e mos të lëvizim, ngase në të kundërtën, kjo çështje do të konsiderohet tradhti ndaj shtetit ”.*²⁹²

Doktrina shoqërore dhe politike në tefsir, qartë vërehet në komentimin e hoxhë Haxhi Vehbi Dibrës-Agollit, ashtu sikur që vërehet se ekzistonte në trurin e intelektualit shqiptar në kohën bashkëkohore, komentimi fetar në shërbim të interesave shoqërore dhe politike.

Krahas kësaj doktrine shoqërore, vërehej edhe një doktrinë tjetër fetare me karakter sufist në tefsiret e hoxhallarëve shqiptarë. Një doktrinë të tillë qartë e vërejmë në fjalët e hoxhë Vehbi Dibrës, i cili në tefsirin e tij të ajetit kur'anor:

([الفاتحة : 6] ﴿ الْمُسْتَقِيمَ الصِّرَاطَ أَهْدِنَا ﴾)

“Na udhëzo në rrugë të drejtë!”, El Fatiha: 6, ka bërë një koment të gjatë, duke shqyrtuar çështje sufiste që ekzistonin në kohën e tij. Ai (Zoti e mëshiroftë!), argumentonte në komentet e tij me fjalët e Shejhut dhe Mufes-sirit të njohur El-Kadi El-Bejdavi.²⁹³ Kur fillonte komentet sufiste, kërkonte prej atyre që ishin prezent të durojnë e të mos mërzhiten, ngase çështjet e tilla sufiste vështirë kuptohen dhe vërtet të mërzhisin... Ai ua shpjegonte çështjet e “mekamateve” (nacionet) dhe “keshfin” (zbulimin) nga aspekti sufist, pastaj ua sqaronte edhe epifaninë hyjnore, çështjen e Sheriatit, tarikatit, hakikatit dhe të ma’rifetit, si dhe botën e dukshme e të padukshme. I tërë ky koment doli nga fjala e Zotit të Madhërishëm:

“**kuptimi i tij është i vërtetë**”, mbështetet në ajetin kur'anor ku besimtarët thonë: “**S’kemi rrugë tjetër përpos të luftojmë në rrugë të Zotit, ngase jemi nxjerrë nga shtëpitë tona**”, El Bekare:246, dhe nga kuptimi i hadithit mund të thuhet se me fjalën “**vatan**” mund të nënkuptohet “**xhenneti**”, ose nënkuptohet “**Mek-ka**”, ngase ishte qendër apo kible e botës...” Shih veprën “**Keshful-hafai ve Muzilul-Ilbas mimma Ishteher minel-Ehadithi ala el-Sinetin-Nasi**”, të Ismail ibn Muhamed El-Axhluni El-Xherahi, recensoi: Ahmed-El-Kal-lash, vëll. I, f. 414. në “**El-Mektebetul-Elfijjeti lis-Sunnetin-Nebevijjeti**” CD, botim i vitit 1999- Versioni 1.5, Qendra e kompjuterëve Amman, Jordani.

²⁹² Po aty, f. 43-44.

²⁹³ Shih më gjerësisht: “**Et-Tefsiru vel-Mufessirunë**”, Muhamed Husejn Dhehebi, Kajro, Mektebetu-Vehbe, bot. 9, vëll. 1, f. 211-216.

([الفاتحة : 5] ﴿ نَسْتَعِينُ ۖ وَإِيَّاكَ نَعْبُدُ وَإِيَّاكَ ﴾)

“Vetëm në ty mbështetem”.²⁹⁴

Ky nivel intelektual që ekzistonte tek shqiptarët konfirmon se në atë kohë ekzistonin forma dhe mënyra të ndryshme të çështjeve fetare e intelektuale. Ngjyra sufiste në tefsire e komente të ajeteve, po ashtu, argumenton shumë qartë se ka ekzistuar edhe rryma dhe doktrina sufiste në studimet shqiptare të Kur’anit.

Dhe në fund, hoxhë Haxhi Vehbi Dibra u sqaronte muslimanëve se *“Islami është fe mesatare, në mes të dy ekstremeve; që refuzon ateizmin dhe idhujtarinë, ajo është fe e monoteizmit që të shpie drejt Zotit të Madhërishëm, i Cili është pa rival, i Vetëm, që s’ka nevojë as për djalë e as për vajzë, është Një dhe i pa shoq”*.²⁹⁵

Në mesin e dijetarëve të rëndësishëm ishin edhe ithtarët e drejtimit shoqëror politik që kishin qëndrime të njohura rreth çështjeve dhe doktrinave ideologjike filosofike të kohës moderne, siç ishte edhe hoxhë Hafiz Ali Kraja.²⁹⁶ Në librin e tij të njohur²⁹⁷ me titull: “A duhet feja? A e pengon bashkimin kombëtar?”²⁹⁸ Ai shqyrton çështje filosofike dhe

²⁹⁴ Po aty, f. 104-105. Më gjerësisht mbi sufizmin dhe çështjet sufiste, shih veprën **“Nesh’etul-Felsefetis-Sufijjeti ve Tetavvuruha”** nga autori dr. Irfan Abdulhamid Fettah, f. 175-249.

²⁹⁵ Po aty, f. 120, më gjerësisht shih tefsirin e tij të sures **“El-Fatiha”** dhe do të vëresh njohuri të gjera që hoxha në fjalë i posedonte (Zoti e mëshiroftë!)

²⁹⁶ Hoxhë Hafiz Ali Kraja u lind në vitin 1900 dhe mësimet e para i mori në qytetin e Shkodrës, pastaj vazhdoi studimet universitare në Az’har dhe më pas u nominua me pseudonimin **“Hoxhë-Dijetar i shkallës së lartë”**. Në vitin 1934 shkroi veprën e tij të njohur me titull: **“A duhet feja? A e pengon bashkimin kombëtar?”**. Këtë vepër e shkroi në kohën kur komunizmi kishte depërtuar në tërë vendin dhe i kritikoi ashpër parimet komuniste. Në vitin 1944 mbajti një ligjëratë me titullin: **“Ç’është komunizmi dhe cilat janë pasojat e tij tek shqiptarët”**. Ai kishte lidhje të ngushta me politikanët e kohës së tij. U burgos nga pushteti komunist shqiptar në vitin 1947 dhe u dënua me njëzet vjet burg. Vdiq në vitin 1974. Më gjerësisht shih librin e dr. Ramiz Zekajt, **“Zhvillimi i Kulturës Islame te shqiptarët gjatë shekullit XX”**, 328-329.

²⁹⁷ Kjo vepër për herë të parë u botua në Shkodër, në vitin 1934, në shtypshkronjën **“Ora”** në Shkodër, pastaj në vitin 1999 u ribotua nga Shtëpia Botuese **“Furkan”** në Shkup, Maqedoni, nën recensimin e prof. dr. Musa Gashi. Unë e posedoj ekzemplarën e recensuar, por jo edhe versionin origjinal, të cilin e kishte shkruar hoxha i nderuar (Zoti e mëshiroftë!)

²⁹⁸ Më duket se hoxha (Zoti e mëshiroftë!) nuk kishte për qëllim analizimin e të mirave të Ahiretit, por atë që e ka thënë ai ka qenë përgjigje kundër laikëve dhe ateistëve, të cilët thoshin se s’ka kurrfarë dobi në këtë botë nga kjo fe. Hoxha u drejtohej atyre dhe u tregonte se kjo fe ka për qëllim ruajtjen e interesave individuale dhe shoqërore të kësaj

etike, të cilat konfirmojnë qartë ekzistimin e lëvizjeve të tilla destruktive në atë kohë, si p.sh., çështja e nevojës së njerëzve për fe nga aspekti shpirtëror, etik, ligjor e shoqëror. Hoxha zbërthente një çështje shumë të rëndësishme në historinë e njerëzimit për shqiptarët që përballeshin me ateizmin, duke u thënë: *“Historia e njerëzimit asnjëherë nuk ka hasur në ndonjë popull pa ndjenja fetare, qofshin ato qiellore apo pozitive”*. Sipas tij, *“qëllimi i Sheriatit islamik është mbrojtja dhe siguria e interesave të kësaj bote për njerëzit”*.²⁹⁹ Hoxhë Hafiz Ali Kraja po ashtu sqaronte se bazë kryesore për vazhdimësinë e interesave të kësaj bote janë parimet e moralit dhe se popujt e egër nuk njohin parime të tilla, ngase në shoqëritë e tilla nuk ka moral, as vlera njerëzore e as vlera fetare, dhe një gjë të tillë e kanë vërtetuar ekspertët e etikës dhe filosofët.³⁰⁰

Një shikim sipërfaqësor i përmbajtjes dhe temave të këtij libri, do të na konfirmojë rrezikun e lëvizjeve të tilla, me të cilat ballafaqoheshin ulematë tanë gjatë dekadave të para të shek. XX. Pas temave të lartpërmendura, hoxha po ashtu ka sqaruar edhe çështjen e të vërtetës së fesë islame, çështjen e Islamit dhe fanatizmit të urrejtur, çështjen e Islamit dhe ateizmit, dhe se Islami ndaj fesë së krishterë, gjegjësisht ndaj ortodoksëve dhe katolikëve është i drejtë dhe i singertë, ngase sipas Kur’anit Fisnik, të krishterët janë më afër nesh dhe më të mëshirshëm se ithtarët e feve të tjera. Në këtë kontekst, në ajetin kur’anor thuhet:

وَلَتَجِدَنَّ أَشْرَكُومًا وَالَّذِينَ آمَنُوا لِلَّذِينَ عَدَاوَةً النَّاسِ أَشَدَّ لَتَجِدَنَّ ﴿٨٢﴾
 [المائدة : 82] نَصْرِي إِنَّا قَالُوا الَّذِينَ آمَنُوا لِلَّذِينَ مَوَدَّةً أَقْرَبَهُمْ

“Gjithqysh do të vëresh se hebrenjtë dhe ata që i përshkruan Zotit shok (idhujtarët) janë njerëzit me armiqësi më të fortë kundër besimtarëve (kundër muslimanëve). Ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët janë ata që thanë: “Ne jemi nesara-të krishterë””.³⁰¹

bote, duke theksuar disa prej tyre. Ky parim ka lidhje të ngushtë me të drejtën civile në Usuli-Fikh. Një ndër punimet më të mira që kam hasur në këtë lëmë është libri i dr. Seid Ramadan El Buti, gjegjësisht disertacioni i doktoraturës së tij me titull: **“Davabitul-Maslahati fish-Sheriatil-Islamijjeti”**, që është mbrojtur në Universitetin e Az’harit në vitin 1965.

²⁹⁹ Po aty f. 21-23.

³⁰⁰ Po aty, f. 24-25.

³⁰¹ El-Maide, 82.

Po ashtu është transmetuar se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe sahabët e tij u shqetësuan dhe u mërzitën kur dëgjuan se bizantinët (të krishterët) kishin humbur betejën me persianët (mexhusite - adhuruesit e zjarrit), ndaj për këtë arsye edhe zbriti ajeti kur'anor:

سَيَغْلِبُونَ عَلَيْهِمْ بَعْدَ مِثْقَلِ ذَرَّةٍ وَهُمْ لَا يَصِفُونَ ۚ وَالْأَرْضُ آدْنَىٰ فِي ۖ وَالرُّومُ غُلِبَتْ ۖ أَلَمْ

أَلْمُؤْمِنُونَ يَفْرَحُ وَيَوْمَئِذٍ بَعْدُ وَمِنْ قَبْلُ مِنَ الْأَمْرِ لِلَّهِ سِنِينَ ۖ بِضْعٍ فِي ۖ

([الروم : 1-4])

“Elif, Lamë, Mimë. Bizantinët (rumët) u mundën në tokën afër (tokës së arabëve), po pas disfatës së tyre, ata do të ngadhnjejnë brenda pak viteve”.³⁰² Pas këtij informimi kur'anor, u gëzuan zemrat e muslimanëve, dhe vërtetë bizantinët fituan kundër persianëve pas disa viteve (3-9), ashtu siç i informoi edhe Kur'ani Fisnik në ajetin e sipërpërmendur.³⁰³

Hoxha po ashtu shqyrtoi edhe çështjen e orientimit të botës kah qytetërimi dhe progresi pas Luftës së Dytë Botërore. Ai shqyrtoi edhe çështjen e Islamit dhe laicizmit si dhe tematika filosofike me të cilat merreshin njerëzit dhe intelektualët.³⁰⁴

³⁰² Er-Rum, 1-4.

³⁰³ Sa i përket qështjes se të krishterët janë më afër nesh dhe më të mëshirshëm ndaj mesh se hebrenjtë, mund të them se kjo ndoshta ka të bëjë me situatën që mbretëronte në kohën e Shpalljes së Kur'anit (Vahjit), ndërsa sot; mendoj se situata është krejt ndryshe nga ajo që është përshkruar. Situata politike, shoqërore dhe fetare është tërësisht ndryshe, posaçërisht me të krishterët, ngase ata posedojnë disa kopje të biblave dhe janë të ndarë në disa sekte e doktrina, si p.sh. në ortodoksë, katolikë, protestantë, etj. Prandaj ata së bashku me hebrenjtë, edhe pse janë të ndara në parimet e besimit, ata projektojnë programe, projekte e mënyra nga më të ndryshmet, me përmasa botërore kundër muslimanëve dhe Islamit. Të Krishterët dhe Hebrenjtë sot konsiderohen kundërshtarët më të rreptë të Islamit dhe muslimanëve, me përjashtime minimale... Mbi parimet, synimet dhe mënyrat e aktiviteteve ndërkombëtare të misionarëve të krishterë kundër Islamit dhe muslimanëve më hollësisht shih: Dr.M. McCarry, “**The Gospel and Islam-A compendium**”; 1978, March, West Huntington Drive, A Ministry of Vision International-Printed in the USA.

³⁰⁴ Shihi detajet rreth këtyre tematikave më gjerësisht në burimin e cituar më parë 21-77, ku vërtetë do të gesh informacion të shumtë mbi diapazonin e gjërë kulturor dhe të njohurive të nduarduarta të Hafizit (Zoti e mëshiroftë!)

Kontribut më të madh si institucion shkencor rreth lëvizjeve dhe sfidave ideologjike me të cilat ballafaqoheshin hoxhallarët në kohën e re, ka dhënë Këshilli i Lartë i Komunitetit Musliman në Shkodër, Shqipëri, i cili me rastin e 75-vjetorit të botimit të revistës “Zani i Naltë”, organizoi konferencë të madhe ndërkombëtare.

Hulumtuesi dhe hoxha Mr. Muhidin Ahmeti³⁰⁵ më ofroi një punim rreth përpjekjeve të kësaj reviste për të zbërthyer çështje dhe tema fetare e filosofike. Në këtë revistë reflektoheshin mendimet dhe idetë filosofike e fetare të dijetarëve dhe hulumtuesve, gjë që vërehet qartë edhe nga vetë hyrja e revistës “Zani i Naltë”, ku thuhet se *“Kjo revistë hulumton çështje të mëdha intelektuale e shpirtërore dhe synon ngritjen e njeriut në pozita të përhershme të jetës...”*³⁰⁶ Ky hulumtues po ashtu thekson se ndër dijetarët dhe hoxhallarët më të njohur që mbronin qëndrimet në këtë revistë nga kundërshtarët e tyre ishin: Haxhi Vehbi Dibra, Hafiz Ali Korça, Qazim ef. Hoxha,³⁰⁷ Haki Sharofi, Sali Vuçitërna, Hafiz Ismet Dibra, etj.³⁰⁸

Në këtë revistë botoheshin artikuj dhe punime shkencorë të rëndësishëm që kishin të bënin me filosofinë, fenë, etikën dhe sufizmin.³⁰⁹

Në këtë periudhë të vështirë dhe përplot akuza dhe dyshime të hedhura kundër Islamit dhe Pejgamberit, kuptohet, të nxitura nga armiqtë e muslimanëve, që u përhapën në mbarë botën islame, padyshim që hoxhallarët dhe intelektualët e Shqipërisë, luajtën rol tejet të rëndësishëm në mbrojtjen e fesë. Para se ta përfundoj fjalën time, dëshiroj të potencoj edhe një çështje tjetër.

Në këtë periudhë, u botua edhe një revistë tjetër islame që quhej “Udha e së vërtetës”, botues i së cilës ishte hoxha, hulumtuesi dhe avokati shqiptar, Kadri Hoxha nga Prishtina. Hoxhë Kadri Prishtina dallohej me rezon të shkathtë, me tru të shëndoshë dhe hulumtime serioze, si dhe

³⁰⁵ Profesori dhe hoxha në fjalë ishte i pari që më ndihmoi, duke më ofruar libra e punime nga biblioteka e tij personale, ndërsa më pas udhëtova për në Shqipëri që t’i blej titujt që m’i sugjeroi ai. Sinqerisht i jam shumë mirënjohës dhe uroj: Zoti e shpërbleftë për ndihmën që ma ofroi!

³⁰⁶ Islam Dizdari, **“Zani i Naltë”-përmbledhje kumtesash**; Veprimtari shkencore me rastin e 75-vjetorit të botimit të revistës **“Zani i Naltë”**, Rozafat, Shkodër 1999, 35.

³⁰⁷ Shih hytbet, ligjëratat dhe artikujt e ndryshëm filosofik e fetar dhe artikujt e Qazim Hoxhës me titull: **“Ç’urdhëron Kur’ani?”** në: **“Zani i Naltë”**; viti 1937, f. 369-384, pastaj Nr. 12 në vitin 1938, f. 4-7, 11-29, 57-61 dhe numra tjerë të revistës.

³⁰⁸ Po aty, f. 36.

³⁰⁹ Po aty, f. 38.

kishte vizion të qartë islam dhe politik. Në revistën e tij botoheshin artikuj rreth vlerës së institucionit të martesës në Islam dhe në shoqëri, rreth vlerave të Islamit dhe rreth korigjimeve të botëkuptimeve të gabuara. Ai po ashtu ftonë në reformimin e disa traditave dhe adeteve negative shqiptare, që kishin të bënin me martesën e vajzave pa vullnetin e tyre, si dhe të miturave, dhe ftonë në nivelin e barabartë në mes bashkëshortëve në rrjedhë, pasuri, moshë, mësim, me qëllim që të vazhdoj jeta martesore me sukses dhe pa probleme. Mosekzistimi i përputhshmërisë në mes të martuarve në moshë, pasuri, rrjedhë dhe arsim, në të ardhmen mund të krijojë problem martesor dhe shoqëror.

Nga çështjet që Hoxhë Kadri Prishtina i kritikonte në artikujt e tij ishte edhe çështja e spiunimit, tradhtisë dhe konvertimit në fenë krishtere. Sipas tij, pasi që Zoti na ka shpallur Kur'anin, në të cilin e ka ndarë të vërtetën nga e pavërteta, dhe meqë njeriu vetë është i aftë të ndajë të mirën prej së keqes, të dëmshmen dhe të padëmshmen, atëherë ai obligohet që ta zgjedhë më të mirën dhe s'ka nevojë të thërrasim në fe të re. Ai po ashtu shqyrtoi çështjen e llojllojshmërisë së feve dhe thoshte se Islami është fe e lirisë dhe barazisë.³¹⁰

Pra, siç duket, vërtetë ekzistonin çështje të rëndësishme dhe të rrezikshme, që zbërtheheshin e që nxitnin diskutime në tokat shqiptare para dhe pas periudhës së Pavarësisë. Këto ishin karakteristikat dhe ngjarjet që e dallonin periudhën historike të kohës bashkekohore kah fundi i shek. XIX dhe në fillim të shek. XX.

Dhe kështu, deri diku, lexuesve tanë të respektuar u përpoqëm t'ua pasqyrojmë situatën politike, shoqërore e fetare si hyrje të asaj që do të pasojë në analizat, shkrimet dhe studimet komentuese të Kur'anit Fisnik. Këtu dëshiroj të theksoj një të vërtetë të rëndësishme, gjegjësisht faktin se nuk mund të kuptohet mirë historia shqiptare islame dhe përpjekjet shkencore të dijetareve shqiptarë muslimanë, posaçërisht doktrinat dhe studimet e tyre komentuese kur'anore pa i lexuar kapitujt e mësipërm. Nuk pretendoj se kam theksuar çdo gjë rreth historisë shqiptare, përkundrazi, por kjo që shkrova më sipër, ishte vetëm një paraqitje e shkurtër e ngjarjeve më të rëndësishme historike, politike, shoqërore e fetare që kanë të bëjnë me temën e disertacionit tim.

³¹⁰ Qemajl Morina, **"Hoxhë Kadri Prishtina-Mendimtar islam"**, Kryesia e Bashkësisë Islame, Prishtinë 2000; 25-35, 37-48, 63-67. Rreth disa çështjeve tjera të rëndësishme intelektuale dhe doktrinarë, shih më gjerësisht **"Bedi'uz-Zeman Se'id Nursi"**; Konferenca Ndërkombëtare Rreth Ripërtërimit në Islam, mbajtur në Stamboll në vitin 1992, përktheu Orhan Muhamed Ali, 55-83, bot. 1, 1997; Yeni Bosna, Istanbul, Nesil-Basim-Yayın.

Tani, do të shqyrtojmë dhe studiojmë një shembull nga doktrinat më të njohura shoqërore reformiste në kohën e re, në bazë të aplikimit praktik, të asaj që shqyrtuam në aspektin teorik në kapitullin paraprak. Pra, tani do të vazhdojmë me dijetarin e shquar shqiptar Hafiz Ali Korçën, Zoti e mëshiroftë!

KAPITULLI I DYTË

DOKTRINA IDEOLOGJIKE SUNNITE SHOQËRORE REFORMUESE NË TEFSIR, E PERSONIFIKUAR NË MENDIMET E HOXHËS DHE MENDIMTARIT HAFIZ ALI KORÇA

Hyrje në mendimin fetar reformist të shqiptarët

Doktrina ideologjike reformiste tek intelektualët shqiptarë ka qenë fenomen origjinal dhe i përhapur. Kjo doktrinë fetare reformiste që ishte formuar gjatë kohës së pushtetit osman, kishte depërtuar edhe në tokat shqiptare e boshnjake dhe në tërë Ballkanin, gjë që vërehet qartë në tefsirët, shkrimet dhe përkthimet e librave dhe artikujve që shqyrtonin çështje të kohës, dhe ide të mendimtarëve të njohur që kryesonin shkollën reformiste intelektuale, si p.sh., Shejh Mustafa Meragi, shkrimtari i njohur Muhamed Ferid Vexhdi, Shejh Xhemaludin Afgani, Shejh Reshid Rida, etj.³¹¹

Arsyeja e përhapjes së këtij fenomeni intelektual fetar të shqiptarët qëndron në faktin se një numër bukur i madh i tyre kishte studiuar fenë në Al Az'har dhe në Indi,³¹² duke filluar që nga gjysma e dytë e shek. XIX e deri më sot. Një numër bukur i madh shqiptarësh dhe boshnjakësh kanë diplomuar në ato vende të lartëpërmendura, dhe kontakti këtyre studentëve me profesorët e tyre, ka ndikuar që të bien nën ndikimin e mendimeve dhe ideve të tyre, dhe një gjë e tillë është plotësisht normale, ngase siç dihet, studentët janë nën ndikimin e profesorëve të vet, ashtu siç janë fëmijët nën ndikimin e prindërve.

Ndikimi i shqiptarëve nga metoda e shkollës reformiste intelektuale ishte shumë i madh, saqë nëse i hedh një vështrim të shpejtë natyrës së hulumtimeve dhe artikujve të shkruar e të botuar nëpër revistat shqiptare islame që botoheshin edhe nga Këshilli i Lartë i Çështjeve Islame në Shqipëri në fillim të shek. XX, do të vëresh se ata shqyrtonin probleme dhe çështje fetare e të rëndësishme që ishin aktuale në kohën e tyre, si p.sh.: Çështja e ekzistimit të Zotit të Madhërishëm, çështja e nevojës për fe dhe devotshmëri, çështja e qytetërimit dhe civilizimit islamik, çështja e ballafaqimit me sfidat evropiane, çështja e emancipimit

³¹¹ Ismail Bardhi, "Hafiz Ibrahim Dalliu dhe egzegjeza e tij kur'anore"; 92.

³¹² Roberto Maroco de la Roka, "Kombësia dhe fetë në Shqipëri 1920-1944"; 209.

të gruas dhe aktivizimi i saj në punë e funksione, çështja e të drejtave të njeriut në shoqëri, çështja e laicizmit dhe ndarjes së fesë nga shteti, çështja e tolerancës fetare dhe solidaritetit në mes ithtarëve të feve dhe popujve të ndryshëm, çështja e ateizmit, komunizmit, kapitalizmit, socializmit, etj.³¹³

E tërë kjo na bën që të bindemi se lëvizja fetare reformiste kishte depërtuar në trurin dhe në zemrat e dijetarëve shqiptarë në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX. Në këtë studim nuk mund të flasim për aktivitetet dhe mendimet e të gjithë dijetarëve shqiptarë, por do të mjaftohemi që në këtë kapitull të studiojmë vetëm një shembull konkret, i cili konsiderohet prijës i njohur shqiptar i shkollës reformiste, e që ka ide të qarta të shkollës racionale reformiste, qoftë në ligjërata, në shkrime fetare apo në tefsirin e tij. Tefsiri i tij në tërësi është zhdukur dhe ka mbetur vetëm një pjesë prej tij, ndërsa disa punime të tij mjerisht janë djegur.

Falënderoj Zotin e Madhërishëm që pata mundësi të gjej një pjesë të tefsirit të këtij dijetari të shquar shqiptar dhe ta studioj në këtë

³¹³ Shih revistën e njohur islame me titull: **“Kultura Islame”** që botohej nga Komuniteti Musliman i Shqipërisë. Unë, fotokopjova një numër bukur të madh të kësaj reviste dhe pashë se ajo shqyrton mjaft tematika të ndryshme. Shih numrat:3-4, nëntor-dhjetor 1941; artikulli me titull: **“Islami është gjallë”**, nga orientalisti i njohur shqiptar Vexhi Buharaja, i cili shkruan për dijetarin dhe intelektualin e njohur arab enciklopedik prof. Muhamed Ferid Vexhdi, i cili ishte redaktor i revistës universitare të Az’harit. Ai po ashtu ka shkruar edhe një artikull me titull: **“Fuqia e Islamit në botë”**; f. 96-99. Shiko gjithashtu numrat: 17-19, fror-mars 1941; ku theksohen emrat e reformatorëve të mëdhenj të shkollës reformiste, si p.sh. Xhemaludin Afgani, Muhamed Ferid Vexhdi. Po ashtu shih numrin 10, 1944, 272-276, numrin 20, prill-maj 1942 dhe artikullin e rëndësishëm me titull: **“Feja, kultura dhe shkenca”**; 226-229. Po ashtu shih numrat: 1-2, fror 1946, ku jepet koment shkencor i gjatë i ajetit:

(وَلَا تَدْعُ مَعَ اللَّهِ إِلَهًا آخَرَ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ كُلُّ شَيْءٍ هَالِكٌ إِلَّا وَجْهَهُ لَهُ الْحُكْمُ وَإِلَيْهِ

تَرْجَعُونَ ﴿٨٨﴾ [القصص: 88]

“Veç Allahut mos adhuro ndonjë Zot tjetër, s’ka të adhuroar tjetër përveç Tij. Çdo send zhduket e Ai jo. Vetëm Atij i takon gjykimi dhe tek Ai do të kthehemi!” (El Kasas, 88), ku autori analizon materien, atomin, evolucionin dhe ndarjen e atomit, etj.; si dhe numrat e tjerë që s’mund ti përmendim këtu e që kanë të bëjnë me mendimin fetar shqiptar reformist.

disertacion. Prijësi i kësaj doktrine është, siç thash edhe më parë, dijetari dhe hoxha i njohur Hafiz Ali Korça³¹⁴ (Zoti e mëshiroftë!).

Hoxhë Hafiz Ali Korça konsiderohet personalitet i njohur shkencor me njohuri të mëdha kulturore, poet, letrar, shkencëtar, komentues i Kur'anit, trim dhe një ndër dijetarët e mëdhenj shqiptar që jetuan në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në gjysmën e parë të shek. XX. Ai kishte harmonizuar aktivitetet politike e fetare pa bërë ndonjë dallim në mes fesë, politikës dhe interesit shtetëror.

I: NJOHURI MBI HOXHËN, VENDLINDJA, ARSIMI, FAMILJA DHE KOHA NË TË CILËN JETOI

1. EMRI DHE VENDLINDJA E TIJ:

Hoxhë Hafiz Ali Iljaz Kadiu,³¹⁵ i njohur si Hafiz Ali Korça, mbiemër të cilin e mori sipas qytetit të Korçës, u lind në vitin 1873,³¹⁶ diku thuhet në vitin 1870,³¹⁷ në Korçë, në Jug të Shqipërisë. Ai rrjedh nga

³¹⁴ Kohëve të fundit u botua një studim dhe monografi shqiptare me rëndësi të madhe shkencore rreth mendimit të tij letrar, kombëtar e fetar, i prof.dr. Ismail Ahmedit, orientalistit dhe dijetarit të mirnjohur shqiptar, me titulli **“Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra”**. Ky studim është disertacion doktorature, dhe vërtetë është studim i rëndësishëm dhe mjaft me vlerë. Autori është mbështetur në pikëpamjet letrare të hoxhë Hafiz Ali Korçës, në pikëpamjet politike dhe kombëtare, të cilat kishin luajtur rol të rëndësishëm në historinë e re të Shqipërisë. Ai po ashtu i zbërthen pikëpamjet e tij fetare dhe tefsirin e disa ajeteve kur'anore në mënyrë të thuktë, pa theksuar shkollën doktrinare të Hafiz Ali Korçës. Ky studim më ndihmoi shumë, përkatësisht në titujt e burimeve dhe literaturës që i kishte përdorur autori i sipërpërmendur. Sa i përket jetës, lindjes dhe mësimeve të Hafiz Ali Korçës, do të mbështetemi në këtë studim të profesorit, si dhe në vepra tjera origjinale që i posedoj unë, të cilat i pata gjetur gjatë kërkimeve të mia në Bibliotekën Kombëtare të Tiranës dhe në Kosovë, disa si dorëshkrime e disa të botuara.

³¹⁵ Titulli **“Hafiz”**, te shqiptarët dhe turqit, i jepet atij që ka mësuar përmendësh dhe me texhvid Kur'anin Fisnik, që është edhe titull nderi e respekti për të deri në vdekje, qoftë edhe nëse ky person që e merr këtë titull nuk e njeh fare arabishten. Te shqiptarët termi **“hafiz”** nuk përdoret në konotacion të hadithit, d.t.th. për ata që dinë përmendësh hadithe të Pejgamberit.

³¹⁶ Ismail Ahmedi, **“Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra”**; 8-9.

³¹⁷ Gjatë kërkimeve të mia mbi jetën, veprën dhe aktivitetet letrare arabe, osmane e perse të Hafiz Ali Korçës në Shqipëri, gjeta një vepër me rëndësi të madhe shkencore tek historiani i njohur bashkëkohor Ibrahim Daut Hoxha, me titull **“Hafiz Ali Korça-Veprimtaria e tij në lëmin e Atdhetarisë dhe Arsim-kulturës arabe-osmane-persiane”**; 1, për të cilin jam edhe mirënjohës për të.

një familje fetare e intelektuale që i donte dijetarët dhe shkencën, dhe për këtë edhe vetë vazhdoi rrugën e prindërve dhe gjyshërve të tij në shkencë dhe dituri.³¹⁸

Qyteti i Korçës ka luajtur rol të madh në shek. XIX në sferën ekonomike, edukative e letrare në mbarë Shqipërinë, ngase ka pozitë mjaft të rëndësishme gjeostrategjike në jug-perëndim të vendit, që e lidhë Shqipërinë me Greqinë dhe Ballkanin në përgjithësi. Në këtë qytet u hap edhe shkolla e parë shqipe që punonte me alfabetin latin dhe ishte qendër e aktivistëve politikë shqiptarë, që punonin në Rumani, Bullgari e vendet tjera fqinjë.

Shteti grek i krishterë, Korçën e konsideronte si qendër të saj për përhapjen e misionarizmit dhe kolonializmit helmues kundër kulturës islame shqiptare, në këtë qytet p.sh. Greqia kishte 126 shkolla misionare krishtere, ashtu siç kishte edhe në qytetin tjetër shqiptar të Beratit. Zoti i Madhërisëm deshi që ky dijetar u lind në këtë qytet që t'iu kundërvihet dhe t'i mjerohë jobesimtarët.³¹⁹

Sa i përket kohës në të cilën jetoi, disa burime konfirmojnë se hoxhë Hafiz Ali Korça, ka jetuar në kohën e lëvizjes dhe zgjimit kombëtar shqiptar. Lëvizja letrare islame shqiptare ishte në kulmin e vet, por e marginalizuar nga elita intelektuale komuniste, të cilët nuk i jepnin fare rëndësi pasurisë së tillë shkencore.

Nga personalitetet që krijuan studime letrare të ndryshme në gjuhën shqipe, perse, turke e arabe në mërgim ishte hoxhë Hafiz Ali Korça. Biografia intelektuale e hoxhë Hafiz Ali Korçës ishte e pasur me ngjarje të rëndësishme. Ai, tërë jetën ia kishte kushtuar rrugës së Zotit dhe rrugës së çlirimit të vatanit nga kolonializmi. Ai thërriste me zë të lartë dhe ftonte në rëndësinë e formimit të vetëdijes fetare islame dhe kombëtare, në rikthimin e të drejtave të vjedhura e të humbura dhe në lirinë fetare krahas lirisë atdhetare dhe pavarësisë nga dora e kolonizatorit.³²⁰ Kërkesa për liri fetare dhe liri të shtetit ishte pjesë e aktiviteteve të të gjithë hoxhallarëve shqiptarë në kohën e re deri më sot, dhe kjo vërehet qartë në shkrimet, ligjëratat dhe artikujt, si në të kaluarën ashtu edhe sot.

³¹⁸ Po aty, f. 1.

³¹⁹ Ismail Ahmedi, **Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra**”, 12.

³²⁰ Po aty, f. 6-7; Ibrahim Daut Hoxha, **“Hafiz Ali Korça dhe veprimtaria e tij në lëmin e atdhetarisë...”**, 12-15.

2. ARSIMIMI:

Në mesin e valëve të tilla politike e fetare, u lind, u zhvillua, u arsimua dhe u formua personaliteti i hoxhë Hafiz Ali Korçës (Zoti e mëshiroftë!). Kur'anin Fisnik përmendësh e mësoi në moshën dymbëdhjetë vjeçare. Burimet historike nuk përmendin emrin e atij që ia mësoi hifzin e Kur'anit Fisnik. Me mësimin e hifzit të Kur'anit filloi hapat e parë në drejtim të Islamit. Mësimet fillore i kreu në vendlindje, ndërsa studimet universitare i vazhdoi në Universitetin e Stambollit, ku edhe i mësoi shkencat islame, gjuhët orientale, gjegjësisht gjuhën arabe, perse, turke dhe frënge. Gjatë qëndrimit të tij në Stamboll, mësoi nga literatura themelore arabe, perse e turke dhe u mahnit nga mendimet e filosofëve dhe letrarëve të mëdhenj, siç ishin p.sh.: Ibn Rushdi, Ibni Sinâ, Ibn Rumi, Omer Hajami dhe letrari persian Saa'di Shirazi, etj. Ai i studionte veprat e tilla dhe furnizohej me të dhëna intelektuale e trashëgimore kulturore.³²¹

Hoxhë Hafiz Ali Korça gjatë qëndrimit të tij në Universitetin e Stambollit, kishte rënë nën ndikimin e njerëzve të tillë të mëdhenj nga atmosfera e re shkencore që mbizotëronte aty, e cila dukshëm ndikoi në formimin e personalitetit të tij edhe në ngritjen e nivelit të tij.³²²

3. FAMILJA DHE FËMIJËT:

Familja e hoxhë Hafiz Ali Korçës ka jetuar në qytetin e Shijakut, Shqipëri. Ai ka pasur pesë djem dhe dy vajza. Djali më i madh që quhej Mexhdudin dhe i dyti Bahrudini vdiqën që në moshën e rinisë në një aksident, ndërsa djali i tretë Iljazi, i cili kishte kryer shkollën fetare në Tiranë, ishte dënuar me 25 vjet burg në kohën e diktatorit komunist shqiptar, Enver Hoxha, por pas kalimit 15 vjet në burg lirohet në vitin 1968 dhe vdes pas disa vitesh, përkatësisht në vitin 1975. I biri i tij Iljazi ishte trashëgimtar i vërtetë i diturisë së hoxhës Hafiz Ali Korça, por deshi Zoti që të mos jetojë gjatë. Djali i tij i katërt, Salahudini kishte kryer

³²¹ Mbi kontributin e hoxhë Hafiz Ali Korçës dhe të personaliteteve tjerë që përkthenin trashëgiminë letrare perse, shih: Shefik Osmani, **“Panteoni iranian dhe iranologët shqiptarë”**; 272-276.

³²² Ismail Ahmedi, **“Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra”**; 16-17; Ibrahim Daut Hoxha, **“Veprimtaria e tij në lëmin e atdhetarisë dhe arsim-kulturës”**; 11-17.

Akademinë Ushtarake në Itali dhe kishte punuar si mësues në Oborrin Mbretëror Shqiptar, përkatësisht si instruktor i oficerëve të rinj.

Pas luftës së Dytë Botërore, kishte dhënë dorëheqje nga kjo punë dhe në vitin 1944 u dënua me vdekje, ndërsa pas vdekjes, ish presidenti i Shqipërisë e dekoroi pas me titullin “ Dëshmor i demokracisë ”. Salahudini kishte një fëmijë që quhej Mexhdudin, i cili aktualisht jeton në ShBA. Djali i tij i pestë, Alaudini, po ashtu kishte diplomuar në Akademinë Ushtarake në Romë dhe ishte kthyer në Shqipëri me ftesë të babait, për t’i shërbyer vendit dhe t’ua mësojë bashkëvendësve të vet parimet ushtarake, por pas një kohe edhe ky u kap nga pushteti komunist dhe u dënua me katër vite burgim, dhe pas daljes nga burgu vdiq në vitin 1982. Njëra vajzë e hoxhës jetoi në Tiranë, ndërsa tjetra në Durrës.³²³

4. POZITAT SHKENCORE DHE FETARE TË HOXHË HAFIZ ALI KORÇËS:

1. I është ofruar ftesë zyrtare për pritjen e Princ Vidit, kur erdhi nga Austria në vitin 1914 për t’u bërë Mbret i Shqipërisë. Hoxhë Hafiz Ali Korça lexoi fjalën përshëndetëse në frëngjisht me rastin e ardhjes dhe caktimit të Mbretit të ri.
2. Në vitin 1916 u caktua Drejtor i Arsimit për disa qytete të mëdha në Shqipëri.
3. Nga viti 1918 deri në vitin 1924 ka qenë Kryetar i Këshillit Suprem Islamik në Shqipëri.
4. Nga viti 1924 deri në vitin 1949 punoi arsimtar në shkollën e madhe fetare të Tiranës (Medresenë), ku ligjëroi lëndët: gjuhë arabe, tefsir, logjikë, dhe disa lëndë tjera.
5. Nga viti 1924 deri në vitin 1938 punoi vetëm në tefsirin e Kur’anit Fisnik për revistën islame shqiptare “Zani i Naltë”, dhe konsiderohej komentues i vetëm në atë kohë.
6. Nga viti 1949 deri në vitin 1959 qëndroi në internim dhe punoi fshehurazi arsimtar në qytetin e Kavajës.
7. Punoi këshilltar i Ministrit të Arsimit në Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë.³²⁴

³²³ Ismail Ahmed, “Hafiz Ali Korça-jeta dhe vepra”; 51-53.

³²⁴ Ismail Ahmed, “Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra”; 41, 42, 43, 44, 49, 56, 63.

5. PASOJAT NGA AKTIVITETET PATRIOTIKE E POLITIKE:

Hoxhë Hafiz Ali Korça rrëfen disa ngjarje nga jeta tij dhe thotë se shumë herë ka përjetuar maltretime. Këtu do të rrëfejme vetëm një ngjarje, për shkak të natyrës së kufizuar të këtij punimi.

Ditën e hënë, më 18. 02. 1910, në orët e paraditës, ishin tubuar një grup i madh njerëzish (sipas një verzioni afro 12.000) dhe kanë filluar ta gjuajnë shtëpinë e tij me gurë, për shkak të disa qëndrimeve të tij kombëtare, që nuk përputheshin me xhonturqit, të cilët përpiqeshin ta ringjallin doktrinën nacionaliste turko-osmane dhe të cilët mendonin se çdo banor i shtetit konsiderohet osmanli, dhe në këtë kontekst të gjithë konsideroheshin osmanlinj. Kjo lëvizje e nxitur dhe përkrahur nga hebrenjtë cionistë, synim të vetëm kishte rrëzimin e shtetit osman. S'ka dyshim se ky qëndrim krijoi reaksion nga elita intelektuale shqiptare dhe nga elita fetare.

Hoxhë Hafiz Ali Korça rrëfen se kishte njerëz që e kritikonin atë, por në të njëjtën kohë kishte edhe njerëz që e përkrahnin dhe që e ndihmonin, saqë një ditë ithtarët dhe simpatizuesit e tij e kanë hipur mbi kalë dhe kanë filluar të bërtasin:

”Rroftë gjuha shqipe dhe rroftë i ati i gjuhës shqipe!”

Pas një kohe të shkurtër disa intelektualë mbajnë fjalime, e pastaj i vjen radha që të mbajë fjalim edhe hoxhës, Hafiz Ali Korça, dhe ky, pasi e përfundoi fjalimin, i lutet Zotit të Madhërishëm në tri gjuhë: Në arabisht, turqisht dhe shqip, pastaj i falënderohet Zotit për të mirat që ia ka dhënë dhe për krijimin e popujve të ndryshëm, që flasin gjuhë e dialekte të ndryshme, dhe më tej vazhdon duke thënë se kjo nuk nënkupton që ne ta urrejmë arabishten, ngase në gjuhën arabe mësojmë Kur'anin, por pasi që me ligjin e ri të Turqisë të shpallur në vitin 1908, lejohet një gjë e tillë, atëherë edhe ne me padurim dhe me gëzim të madh do ta mësojmë gjuhën tonë amtare dhe alfabetin, dhe nuk ka asnjë forcë që mund të na pengojë në këtë çështje.³²⁵

Pas kësaj pushteti osman fillon ta akuzojë Hafiz Aliun si latinxhi, përkatësisht si hoxhë perëndimor, apo me mendime vesterniane, në kuptimin e sotshëm, ngase në raport me alfabetin arab sipas tyre, Hafizi preferonte alfabetin latin, të cilin e përdorim edhe sot. Për këto qëndrime të tij, ai kërcënohej me vrasje dhe internim, por ai shumë herë, nuk

³²⁵ Po aty, f. 30; Hafiz Ali Korça, “Shtatë ëndrrat e Shqipërisë”; Shtypshkronja e shtetit, II, 1944, 25-60.

hezitonte t'ua sqaroj faktin se çdo gjuhë ka karakteristikat dhe rregullat e veta, dhe meqë gjuha shqipe është gjuhë indoevropiane, atëherë edhe ajo duhet t'i ketë edhe karakteristikat e veta dhe kjo gjë, nuk ka të bëjë fare me rrëzimin e halifatit ose me distancimin nga ai. Shkronjat e gjuhës janë instrumente shkrimi, nuk janë as besimtarë e as jobesimtarë, ashtu sikur nuk mund të trajtohen as si muslimanë e as si jomuslimanë.³²⁶

Çështja e alfabetit latin shqiptar ka pasur dimensione politike, fetare e edukative për të gjithë shqiptarët e të gjitha feve. Unifikimi i gjuhës shqipe, kishte rëndësi të madhe si për hoxhallarët, ashtu edhe për disa shqiptarë muslimanë dhe të krishterë, që jetonin në egzil, përkatësisht në vende të ndryshme të botës, si në Rumani, Bullgari, Greqi, Turqi, ShBA, etj.³²⁷ Zgjidhja shqiptar në atë periudhë kishte për qëllim bashkimin e shqiptarëve të ndarë nëpër botë dhe i ftonte që të rikthehen në vendlindje për shpëtimin e Shqipërisë nga copëtimi dhe ndarja nga shtetet fqinje. Situata dhe rrethanat politike në të cilat jetonin shqiptarët, nuk premtinin shpresa të mira për shkak të ambicieve gllabëruese të shteteve të fuqishme.

Ky ishte edhe shkaku dhe arsyeja më kryesore sipas historianëve të njohur shqiptarë, që i shtyu hoxhallarët të pranojnë alfabetin latin, ngase, në të kundërtën ata edhe më tej do ta kishin përdorur alfabetin arab në shkrimin e gjuhës shqipe pa kurrfarë problemi, kjo gjë vërtetohet me faktin se letërsia shqipe islame sufiste dhe sunite gjatë shekujve XVIII dhe XIX është shkruar me alfabetin arab, ngase njerëzit e njohnin dhe shkruanin në këtë alfabet në mënyrë krejtësisht të rëndomtë. Kolonializmi perëndimor evropian dhe sllav ishte ai që i nxiti intelektualët të ringjallin idenë e alfabetit latin si hap i parë për shkatërrimin e Islamit dhe devijimin e Kur'anit, duke u përqëndruar në përdorimin e dialekteve në vend të gjuhës letrare, dhe një gjë e tillë vërehet mjaft qartë, në shkrimet e hershme dhe të vonshme të disa orientalistëve bashkëkohorë.

Qëndrimi i studiuesit dallon nga ata që vendosën të pranojnë alfabetin latin në vend të alfabetit arab i cili njëherit ishte alfabeti i Kur'anit Fisnik dhe Hadithit të Pejgamberit a.s.(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) Përveç kësaj, me plot të drejtë shtrohet pyetja: Çfarë e dëmtoi Japoninë, Kinën, Tajvanin, Korenë dhe shtetet e tjera në rrugën e tyre drejt progresit dhe zhvillimit industrial e teknologjik, kur dihet se këto shtete akoma sot e kësaj dite vazhdojnë të përdorin alfabet

³²⁶ Po aty.

³²⁷ Ismail Ahmed, "Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra"; 28-29.

interesant që ka simbole të posaçme dhe një intonacion që i ngjanë alfabetit arab?!³²⁸

Sipas mendimit tim, pa marrë parasysh se çfarë forme ka alfabeti, ai, nuk mund ta pengojë kursesi progresin, por në fakt ekzistojnë faktorë tjerë konkretë dhe abstraktë që çojnë popujt kah progresi e përparimi ose kah prapambetja dhe regresi.

REAGIMI NDAJ AKUZËS PËR NDARJE NGA HALIFATI OSMAN:

Hoxhë Hafiz Ali Korça është akuzuar për aktivitetet e tij kombëtare patriotike dhe për pranimin e alfabetit latin, dhe kinse ai është përpjekur të ndahet nga halifati osman. Mirëpo, akuza e tillë ndaj hoxhës nuk është e vërtetë për disa arsye:

1. Shejh Hafiz Ali Korça kategorikisht refuzonte këtë akuzë, sidomos ndarjen nga kalifati osman, madje kjo vërehet qartë edhe në reagimin e tij kundër guvernatorit, Talat Pasha, i cili kishte mendim të ngjashëm me të akuzuesit. Në këtë kontekst, Hafizi i thotë: *“Shqipëria ka ofruar dhe flijuar shumë burra dhe trima për shtetin osman dhe asnjëherë nuk dëshiron të ndahet”*.

2. *“Populli shqiptar është i zhytur në injorancë dhe analfabetizëm dhe për të dalë nga kjo injorancë e të mësojë, duhet ta pranojmë këtë alfabet”*. Në këto fjalë guvernatori, Talat Pasha, reagon duke i thënë: *“Shqiptarët e njohin gjuhën turke dhe s’kanë nevojë për gjuhën shqipe”*; në çka hoxhë Hafiz Ali Korça reagon: *“Si mund të përparojë e të lulëzojë një popull që s’ka gjuhë, dituri, industri, e pasuri? Turqia s’ka dobi prej një populli që jeton jetë mizore e të egër në xhunglat e Afrikës. Nëpërmes këtyre shkronjave, mësimi të gjuhës dhe shkencës populli mund të përparojë e ta shpëtojë veten dhe të tjerët”*.³²⁸

Ekziston edhe një arsye tjetër që hoxhën e ka shtyrë të pranojë një gjë të tillë, dhe kjo qartë vërehet në veprat e tij. Sipas tij, Shqipëria është vend me disa fë dhe kombe, dhe për të mbizotëruar toleranca fetare dhe paqja në mes njerëzve, për t’i mënjeluar faktorët që krijojnë urrejtje e përçarje në mes feve të ndryshme, përkatësisht në mes të krishterëve ortodoksë e katolikë dhe muslimanëve, si dhe për t’u larguar nga nxitjet e tilla fetare në mesin e të gjithë banorëve, ai preferoi që në Shqipëri të ketë një alfabet që i bashkon të gjithë.

³²⁸ Hafiz Ali Korça, *“Shtatë ëndrrat e Shqipërisë”*; 59.

Qëndrimi i tillë i Hafiz Ali Korçës vërehet qartë edhe në dialogun e tij me Ministrin osman për Arsim në Shqipëri, guvernatorin, Emrulla Beu. Burimet historike theksojnë se Ministri i ka thënë atij: *“Ju, nëpërmes kësaj kërkesë dëshironi ta braktisni Kur’anin Fisnik e të largoheni nga gjuha turke dhe kështu do t’i lini fëmijët tuaj pa fe (ateistë)”*. Në këto fjalë Hafiz Aliu ka replikuar:

“Asnjëherë, ne kurrë nuk do të largohemi nga Kur’ani, e as nga gjuha turke, e nëse dëshironi ta fusni këtë ligj në kodeksin e ri ligjor të Kushtetutës e shtetit, futeni. Nëse hapen shkolla shqiptare në Shqipëri, ju do të mund t’i kontrolloni shkollat, mund të dërgoni inspektorë, e nëse zbulohet se në ndonjë shkollë nuk mësohet as Kur’ani e as gjuha turke, mbylleni atë menjëherë”.³²⁹

Pastaj hoxhë Hafiz Ali Korça vazhdon e thotë se i ka dërguar një letër Shejhul-Islamit, me të cilën e ka informuar për dialogun në mes tij dhe ministrit të arsimit, dhe në të njëjtën kohë ka kërkuar prej Shejhul-Islamit që t’i bindë dy guvernatorët Talat Pashën dhe Enver Pashën për një gjë të tillë. Dhe vërtetë, Shejhul-Islami kishte biseduar me Talat Pashën dhe e kishte bindur, ndërsa Enver Pasha kurrë nuk ishte bindur për një gjë të tillë. Shejhul-Islami i kishte dhënë përkrahje të plotë Hafiz Ali Korçës, dhe e kishte nxitur që të shkruajë artikuj e t’i botojë në gazetatat turke, ngase ai ishte habitur me stilin e bukur të shkrimeve të tij për lexuesit...³³⁰

Qëndrimi i tij ndaj kësaj çështjeje të ndjeshme vërehet qartë dhe dukshëm në vargjet poetike:

*“Shkronjat ngjyrë feje s’kanë, vegla për të shkruar janë;
Gjuha me çdo shkronja shkruhet, kjo hallall kjo haram s’thuhet
Kot e bëni vegël fenë, na turbulloni atdhenë...”*³³¹

Mendoj se kjo që u tha deri më tash mjafton për të argumentuar se qëllimi i hoxhë Hafiz Ali Korçës nuk ishte të ndahej nga pushteti osman, as të demonstrojë kundër këtij shteti dhe e as të braktisë mësimin e Kur’anit Fisnik. Qëllimi i tij reformist ishte pranimi i alfabetit latin për shqiptarët.

³²⁹ Po aty, 60-61.

³³⁰ Po aty, 60-61.

³³¹ Po aty, f. 63.

6. VDEKJA:

Shejh Hafiz Ali Korça jetoi në internim në qytetin e Kavajës, Shqipëri, ku edhe u sëmur nga ethet të shoqëruara me dhimbje të forta, derisa vdiq më 31.12. 1956. (Zoti e mëshiroftë!) Xhenazen e tij e ka larë dhe ia ka falë në prezencën e shumë besimtarëve muslimanë, nxënësi i tij, ish Kryetari i Komunitetit Musliman të Shqipërisë, hoxha i nderuar Haxhi Hafiz Sabri Koçi (Zoti e mëshiroftë).³³²

³³² Ismail Ahmedi, **“Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra”**; 5-51. Këtu duhet të potencoj për lexuesit se, kur është përgatitur ky disertacion i doktoraturës, Kryetar i Komunitetit Musliman të Shqipërisë ka qenë Haxhi Hafiz Sabri Koçi, i cili në vitin 2004 ndërroi jetë (Zoti e mëshiroftë!)

KAPITULLI I DYTË

VEPRIMTARIA DHE AKTIVITETET E HOXHË HAFËZ ALI KORÇËS NË SFERËN E REFORMAVE ARSIMORE

1. VEPRAT ME NGJYRIME POLITIKE:

1. “Bolshevizma³³³ a Ç’katërimi i Njerëzimit”³³⁴
2. “Shtatë³³⁵ ëndrrat e Shqipërisë”³³⁶

Veprat e tij të pabotuara janë:

1. “Filosofi e vjetër”;
2. “Filosofi mbi besimet myslimane”; dhe:
3. “Logjika”.³³⁷

2. ARTIKUJ POLITIK DHE FILOSOFIKË TË BOTUAR NËPËR GAZETA BOTËRORE DHE KORRESPONDENCAT ME MBRETËRIT E SHTETEVE ISLAME DHE SHTETEVE TJERA

Gazetat botërore, në të cilat botoheshin artikujt e Shejh Hafiz Ali Korçës ishin:

- Es-Sabah; الصباح
- Aksham; أقشام
- Siratu Mustekim; صراط مستقيم
- Bejanul-Hakki; بيان الحق
- Aksu Sada-Anatol seneleri; عكس صدا – أناضول سنلري

³³³ Hoxhë Hafiz Ali Korça (Zoti e mëshiroftë!) kishte koncept të kulluar ekonomik dhe vizion të qartë mbi dëmet e këtij sistemi hebraik-komunist-marksist. Ai shprehej se përhapja e kësaj ideje është e rrezikshme edhe për kontinentin e Evropës edhe për Shqipërinë, dhe se hebrenjtë shumë herë i kanë realizuar qëllimet e tyre nën emrin e demokracisë në çdo periudhë të historisë si në Lindje ashtu edhe në Perëndim.

³³⁴ Shtypur në “**Mbrothësia**”; mars 1925, Shkodër.

³³⁵ Ky divan poetik dhe prozaik politik i botuar për herë të parë në vitin 1924, përmban ëndrrat që i kishte parë hoxhë Hafiz Ali Korça e pastaj i kishte shkruar. Ai shkruan në të për rrezikun që i kërcënohet Shqipërisë nga jashtë e nga brenda. Nga jashtë i kërcënohej nga kolonializmi rus, italian e grek, ndërsa nga brenda rrezikohej nga udhëheqësit dhe politikanët amoralë. Hoxha kur e botoi këtë libër në vitin 1924, ua shpërndau njerëzve, dhe kur shteti dëgjoi për këtë gjest të tij, e shkarkoi nga posti Kryetar i Këshillit Suprem të Sheriatit Islam, por ai edhe më tej vazhdoi të jep mësim në logjikë e arabisht në Medresenë e Tiranës gjer në vitin 1949.

³³⁶ Shtypur për së dyti në shtypshkronjën e shtetit, 1944 Tiranë.

³³⁷ Hafiz Ali Korça, “**Bolshevizma a Çkatërim i njerëzimit**”; 1.

- Gazeta “El Hal-laxh” الحلاج në Iran i botonte artikujt e hoxhë Hafiz Ali Korçës që ishin të shkruara në gjuhën perse.

- Gazeta “Es-Sijasetu” السياسة në Egjipt i botonte artikujt e tij të shkruara në gjuhën arabe.³³⁸

Kemi të dhëna se artikujt e hoxhë Hafiz Ali Korçës kishin përfituar simpatinë e Shejhul-Islamit të shtetit osman dhe e kishte përkrahjen e tij të plotë për vazhdimin e shkrimeve.³³⁹

Hoxhë Hafiz Ali Korça po ashtu mbante korrespondencë edhe me rektorin e Universitetit të Az’harit, Shejh Mustafa Meragi. Në vitin 1939, Rektori i Az’harit i kishte shkruar: “*I respektuari dhe i nderuari profesor Ali, Es-selamu alejkum ve rahmetull-llah! Pas këtyre përshëndetjeve të sinqerta ju them se e lexova letrën tënde të fundit dhe s’ka dyshim se ajo është shkruar nga zemra e një njeriu besimtar...*”³⁴⁰

Hoxha po ashtu ka pasur korrespondencë edhe me Mbretin Faruk të Egjiptit dhe me Mbretin e Hajdarabadit, Osman Nizami, të cilëve u kishte thënë: “*Shqiptarët kanë mbetur si jetimë,*³⁴¹ *pa ndihma dhe pa krah prej askujt, toka më e mirë dhe më pjellore e tyre u është dhuruar shteteve fqinje (u është marrë me dhunë) Greqisë dhe Jugosllavisë, ndërsa për shqiptarët e varfër kanë mbetur vetëm kodrat dhe shkëmbinjtë jopjellorë*”.³⁴²

3. VEPRAT METODOLOGJIKE DHE LITERATURA E SHKOLLAVE FILLORE DHE TË MESME

1. Abetare;
2. Alfabeti arabisht;
3. Gramatika-Sintaksa Shqip-Arabisht;
4. Ilmi Bejan-Retorika;
5. Myslimanija,³⁴³

³³⁸ Hafiz Ali Korça, “**Shtatë ëndrrat e Shqipërisë**”; 22, 27, 31, 41, 48, 55, 61.

³³⁹ Po aty, f. 61.

³⁴⁰ Po aty f. 77.

³⁴¹ Në bazë të fjalëve të profesorit të nderuar dhe mentorit tim, dr. Abdul-Kahhar Davud El-Ani.

³⁴² Ismail Ahmedi, “**Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra**”; 43-49; Hafiz Ali Korça, “**Shtatë ëndrrat e Shqipërisë**”; 75-77.

³⁴³ Ndër çështjet të cilat i kishte zbërthyer hoxhë Hafiz Ali Korça ishin edhe çështjet mbi Cilësitë e Zotit të Madhërishëm në bazë të metodës së Imam Ebu Mensur El-Maturidiut, pastrimi i Zotit nga çdo cilësi që u ngjanë krijesave, mbi atë se imani nuk shtohet e as nuk pakësohet, por përforcohet dhe dobësohet. Ai po ashtu ka shqyrtuar edhe një çështje

6. Mevludi³⁴⁴ a jetë e pastër e Pejgamberit;³⁴⁵
7. Treqind³⁴⁶ e tri fjalët e Imam Aliut;³⁴⁷
8. Gjylistani-Trendafilishta e Saadiut;³⁴⁸
9. Rubaijati-Katrorët e Umer Hajjamit;
10. Jusufi me Zelihanë-a Ahsenul-Kasas; dhe:
11. Historia e shenjtë dhe të katër Halifetë.

4. STUDIM I SHKURTËR I LIBRIT ENCIKLOPEDIK KU VËREHET QARTË DHE HAPTAZI IDEJA REFORMISTE E HOXHËS

Libri “Historia e shenjtë islame dhe katër Hulefai-Rashidinët”, konsiderohet ndër librat më voluminozë të hoxhë Hafiz Ali Korçës pas tefsirit të tij të madh, dhe në të njëjtën kohë është edhe burim i ideve dhe mendimeve të tij shkencore e fetare. Ai në këtë libër ka shqyrtuar çështje të mëdha për të cilat do të flas në detaje, me qëllim që edhe njëherë të konfirmojmë mendimin reformist të tij në një formë sa më të mirë, më të bukur dhe më të përshtatshme.³⁴⁹

të rëndësishme që kishte të bëjë me rregullat e kufrit dhe ai ishte shumë i rreptë në këtë çështje të rrezikshme dhe nuk lejonte kursesi të akuzohet me kufër muslimani që bën mëkate të vogla.

³⁴⁴ Shtypshkronja e tretë, nëntor 1919, Shtypshkronja “Nikaj”, Shkodër.

³⁴⁵ Ky traktat i ngjanë poezisë “**El-Burdetu**” të Busajrit, madje hoxha ka marrë disa koncepte nga kjo poezi. Në këtë traktat ai shqyrton disa çështje të rëndësishme fetare, por natyra e disertacionit tim, nuk ma mundëson që të jap një analizë më të gjerë. Në këtë traktat hoxha kërkon domosdoshmërinë e aplikimit të Kur’anit dhe Sunnetit nëse muslimanët dëshirojnë të fitojnë lumturinë në të dy jetët. Ai po ashtu mbronte idenë që të gjithë popujt duhet të respektojnë monoteizmin. Ai mbronte edhe mendimin se Kur’ani në vete përmban të gjitha shkencat.

³⁴⁶ Shtypshkronja “Korça”, Korçë, 1910.

³⁴⁷ Sipas prof. dr. Ismail Ahmedit, libri në fjalë i hoxhë Hafiz Ali Korça është përkthim i disa pasuseve të librit “**Nehxhul-Belâga**” (**نهج البلاغة**) (“**Rruga e Elokuencës**”) nga Ali Sherif Radij, por kjo nuk mund të jetë e vërtetë, ngase hoxha nuk ka përmendur emrin e këtij autori në librin e tij dhe nuk ka përcaktuar burimin se nga ku i ka marrë fjalët dhe këshillat e Imam Aliut r.a. Ai vetëm potencon se i ka gjetur këto fjalë dhe këto këshilla dhe se i ka përkthyer për lexuesit shqiptarë. Gjatë leximit tim të këtij libri të hoxhë Hafiz Ali Korçës, u binda se ka hiperbolizime në këshillat e disa çështjeve, të cilat mendja vështirë e ka ti pranojë, janë të dyshimta dhe nuk mund të pranohen në mënyrë të sigurt të gjitha, Allahu e di më mirë

³⁴⁸ “Mbrotësia “Kristo P. Luarasi”; Tiranë 1917.

³⁴⁹ Shtypshkronja “Shkodra”; Tiranë 1942.

I. ARSYET E PËRPILIMIT TË LIBRIT

Hoxha i nderuar ka theksuar se kishte menduar tridhjetë vjet për përpilimin e historisë së shenjtë islame si tekst shkollor për nxënësit e tij, në formë poetike, që të jetë më i lehtë për mësim dhe lexim, ashtu sikur kishin vepruar dijetarët e fushave tjera, si p.sh., në shkencën e leximeve, hadithit, feraidit, dhe gramatikës.

Në kohën e tij shqiptarët kishin përvojë të madhe në poezi. Pasi që hoxha ishte edhe vet poet, vendosi që ta tregojë këtë aftësi edhe në këtë libër. Ai sqaron në hyrjen e këtij libri se poezinë e ka thurur në bazë të rregullave dhe parimeve poetike, me këtë u konkurronte bashkëkohësve të tij që krenoheshin me ndjenja kombëtare dhe i kritikonte se nuk mund të thurin poezi, ngase nuk e njihnin mirë gjuhën shqipe dhe nuk mund të ruanin rimën poetike të fjalëve. Pastaj ai thoshte se poezia nuk thuret lehtë dhe se çdokush nuk mund të thurë poezi, ndërsa për vete thoshte se poezia e tij buron nga zemra dhe shpirti.³⁵⁰

Ai nuk shprehej rëndë në poezi, por i dilnin fjalët bukur dhe rrjedhshëm si xhevahirë, dhe punonte ditë e natë në këtë aspekt.³⁵¹ Nga ajo që thotë hoxha në këtë libër të ri, është edhe deklarata e tij që në këtë libër nuk ka trillime dhe se ky libër ka rëndësi të madhe për historinë dhe se lexuesi gjatë leximit të tij ndjen se lexon tefsir të Kur'anit. Në këtë vepër autori ka pastruar biografitë e pejgamberëve nga shumë legjenda që ishin marrë nga Teurati i devijuar. Autori po ashtu i përmend edhe burimet e literaturës që i kanë ndihmuar për përpilimin e këtij libri, si p.sh., tefsiri “El-Menar” (تفسير المنار) i Shejh Reshid Ridasë; “Historia” i imam Taberit, (تاريخ الأمم والملوك للإمام الطبري), pastaj përmend edhe shumë libra të tjerë pa theksuar emrat e autorëve, por kjo mënyrë, nuk u përket normave metodologjike, si p.sh.: “Tarihu Raudatil-Ahbab” (تاريخ روضة الأحباب), “Tarihu Raudatis-Safa” (تاريخ روضة الصفاء), “Tarihul-Islam” (تاريخ الإسلام), “Muradul-Iber” (مراد العبر), “Tarihul-Enbija” (تاريخ الأنبياء), “Tarihud-Dinil-Islamij” (تاريخ الدين الإسلامي), “Kisasul-Enbija” (قصص الأنبياء), “Tarihu Asris-Se’adeti” (تاريخ عصر السعادة) etj.³⁵²

³⁵⁰ Në letërsinë arabe paraislame kemi mësuar se poetët markantë të atëhershëm, siç ishin p.sh. Imru’ul-Kajsi, Nabiga Dhubjani, Ebul A’la El-Mear-ri, nuk kishin ngarkesë në fjalën poetike, ngase poezia tek ata buronte nga brendia dhe shpirti. Kështu ishte edhe hoxha Hafiz Ali Korça.

³⁵¹ “Historia e shenjtë dhe të katër Halifetë”; 1-4.

³⁵² Po aty, f. 4-7.

Pastaj hoxhë Hafiz Ali Korça vazhdon dhe shqyrton çështjen e monoteizmit të Zotit të Madhërishëm, nëpërmes metodës deduktive dhe ekzistencës rreth nesh që konfirmon ekzistimin e Zotit të Madhërishëm. Hoxhë Hafiz Ali Korça ishte nën ndikimin e tefsirit shkencor,³⁵³ dhe mendonte se ekzistojnë gjallesa edhe në planetët e tjera, qofshin njerëz apo kafshë, dhe këtë e argumentonte me ajetin kur'anor të sures El Shura.

جَمَعَهُمْ عَلَىٰ وَهُوَ دَابَّةٌ مِّنْ فِيهِمَا بَثَّ وَمَا وَاللَّأَرْضِ السَّمَوَاتِ خَلَقَ آيَاتِهِ وَمِنْ

[الشورى : 29] (قَدِيرٌ يَشَاءُ إِذَا)

“Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve dhe i Tokës dhe shpërndarja e gjallesave në të dyja dhe Ai me fuqinë e Tij mund t’i bashkojë kurdo që të dëshirojë”.³⁵⁴ Me përparimin dhe progresin e shkencës dhe me satelitët precizë, kjo mrekulli kur’anore do të zbulohet. Ai argumenton se përemri “në të dyja”-(فيهما) nënkupton ekzistimin e krijesave dhe gjallesave në tokë dhe në qiell, dhe se këto krijesa në tokë e në qiell cilësohen si “gjallesa” (دَوَابٌّ) që ecin në këmbë ose rrëshqasin.³⁵⁵ Pastaj hoxha lexuesve që dëshirojnë më shumë dituri e

³⁵³ Mbi qëndrimet e Kur’anit ndaj shkencave astronomike shih: Muhammed Abduladhim Ez-Zurkani, “Menahilul-irfan fi Ulumil-Kur’an”; Daru-Kutejbe, bot. 1, vëll. 2, f. 406-412. Shejh Abduladhim Ez-Zurkani thekson se pesë parime duhet të merren parasysh kur flasim për këtë çështje: **1:** Kur’ani ka zbritur që të jetë udhërrëfyes dhe udhëzues e jo rrefyes i shkencave astronomike, ngase shkencat e tilla i takojnë ligjit të zhvillimit; **2:** Kur’ani thërret në këto shkenca ashtu siç thërret në vështtrim, studim dhe në shfrytëzimin e begative të gjithësisë; **3:** Kur’ani kur flet për qeniet e tilla, kuptojmë se i nënshtrohen dëshirës dhe vullnetit të Zotit të Madhërishëm; **4:** Kur’ani kur flet në ndonjë ajet për udhëzim, vërehet se ai flet duke i përmbledh në vete dituritë e shkencave astronomike-ngase është fjalë e Allahut xh.sh.-; dhe: **5:** Metoda që përdoret në ajetet kur’anore mbi gjithësinë është e qartë, përmbledhëse dhe bindëse. f. 409-412.

³⁵⁴ Shura, 29.

³⁵⁵ Të enjten më 26.12.2002 në orën 02:45 min. pas mesnate, më rastisi të dëgjoj një emision televiziv mbi tefsirin, në kanalin televiziv **ART**, në Kuala Lumpur, Malajzi, ku pashë se komentim të ngjashëm me këtë të Hafiz Ali Korçës, kishte edhe dijetari bashkëkohor egjiptas, i ndjeri Shejh. Muhammed El-Gazali (Zoti e mëshiroftë!), dhe nga ajo që ai theksonte, citoj: **“Qeniet e tjera të gjalla të planetëve tjera nuk nënkuptojnë që të jenë në formë të njeriut, dhe se nëse Zoti dëshiron, mund t’i tubojë në një planet, dhe atë që thotë shkenca sot se uji është burim i jetës në planetët e tjera logjikisht nuk është e saktë, si p.sh. peshku merr frymë në ujë, ndërsa njeriu nga ajri dhe sikur të hynte në ujë do të mbytej, ashtu sikur që peshku po të dilte në tokë, do të ngordhte...sidoqoftë këtë që e potencova është e mundur dhe atë që e potencojnë komentatorët e Kur’anit është e mundur...”** Fjalët e Shejh Gazaliut u përputhën me

Hoxha po ashtu shqyrton edhe një çështje tjetër që ka të bëjë me Krijuesin e vërtetë të kësaj gjithësie-Zotin e Madhërishtëm. Fjalët e perëndimorëve, filosofëve që mohojnë cilësinë e krijimit janë të pavërteta dhe gënjeshtër. Hoxha i hedhë poshtë fjalët e tyre, duke u mbështetur në argumente shkencore dhe duke thënë se materia nuk është krijuar nga vetvetja ose nga rasti, por edhe atë e ka krijuar Zoti i Madhërishtëm. Këtë e vërteton edhe gjeologjia.³⁵⁷ Zoti i Madhërishtëm ka krijuar kohën dhe vendin, por Ai nuk ka as fillim e as mbarim dhe çdo gjë do të zhduket përveç Zotit të Madhërishtëm.³⁵⁸

Hoxha po ashtu hodhi poshtë teorinë e Darvinit mbi evolucionin, duke thënë se mendja e shëndoshë nuk pranon suksesivitetin e gjërave e as rotacionin dhe se të dy hipotezat janë të pabaza. E vërteta në këtë çështje është se Zoti i Madhërishtëm është Lëvizës i materies dhe se Zoti i Madhërishtëm i ka dhënë formën specifike çdo krijese dhe pastaj e ka

momentin e përpilimit të disertacionit tim rreth ideve të Shejh Hafiz Ali Korçës mbi të njëjtin ajet. Sipas mendimit tim, mund të ekzistojnë në botët e tjera ekzistenca tjera gjallesash apo insektesh, por është e pamundur të ketë njerëz si nga aspekti racional ashtu edhe nga aspekti i Sheriatit. Aspekti i Sheriatit nënkuptohet nga ajeti kur'anor:

(﴿ مِنْهَا خَلَقْنٰكُمْ وَفِيْهَا نُعِيْدُكُمْ وَمِنْهَا نُخْرِجُكُمْ تَارَةً اٰخَرٰی ﴾) [طه: 55]

“Prej saj ju krijuam, në të ju rikthejmë dhe prej saj ju nxjerrim përsëri”. (Taha, 55). Këtu përemri (﴿ مِنْهَا ﴾) (saj) nënkupton “tokën”-nga konteksti në fjali. Zoti i Madhërishtëm po ashtu thotë ajetin tjetër:

(﴿ قَالَ فِيْهَا تَحْيَوْنَ وَفِيْهَا تَمُوْتُوْنَ وَمِنْهَا تُخْرَجُوْنَ ﴾) [الأعراف: 25]

“Në të jetoni, në të vdisni dhe prej saj nxirreni” (El A'rafë, 25). Edhe këtu përemri (në të) (﴿ فِيْهَا ﴾) dhe (prej saj) (﴿ مِنْهَا ﴾) nënkupton tokën ku jetojmë dhe ku kanë zbritur Ademi dhe Hava a.s. Në bazë të këtyre ajeteve, jeta, vdekja dhe ringjallja janë në këtë tokë. Ndërsa sipas aspektit logjik Zoti i Madhërishtëm ka vulosur mesazhet qiellore me dërgimin e Pejgamberit të fundit-Muhammedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) që është njeri si gjithë njerëzit që jetojnë në këtë tokë, dhe se pas tij nuk ka më pejgamber tjetër. Nëse themi se ka njerëz tjerë ndokund, atëherë Zoti do të duhej t'u dërgonte edhe atyre pejgamberë për t'i udhëzuar. Përpjekjet amerikane, ruse e britanike gjatë këtyre ditëve kanë qëllime politike dhe ekonomike. Pra, fjalët e Shejh Gazaliut mund të jenë të sakta, por edhe të mundshme.

³⁵⁶ Hafiz Ali Korça, **“Historia e shenjtë dhe të katër Halifetë”**; 10-11.

³⁵⁷ Po aty, f. 11.

³⁵⁸ Po aty, f. 12-13.

udhëzuar.³⁵⁹ Në bazë të asaj që kuptoj unë, hoxhë Hafiz Ali Korça, në këtë kontekst aludon në ajetin kur'anor:

([طه: 50] هَدَىٰ ثُمَّ خَلَقَهُ شَيْءٌ كُلَّ أَعْيَىٰ الَّذِي رَبُّنَا قَالَ)

“Zoti ynë ia ka dhënë formën çdo pjese që e ka krijuar pastaj e ka udhëzuar (orientuar)”,³⁶⁰ dhe në ajetin tjetër:

(فَهَدَىٰ قَدَرًا وَالَّذِي فَسَوَىٰ خَلَقَ الَّذِي أَلَّا عَلَىٰ رَبِّكَ أَسْمَ سَبَّحَ)

[3] الأعلى: 1-

“Madhëroje larg të metave Zotin tënd, më të Lartësuarin, i Cili krijoi dhe përsosi dhe i Cili përcaktoi e orientoi”.³⁶¹

Hoxha (Zoti e mëshiroftë!) i zbërthente edhe idetë e natyralistëve që thoshin se njeriu e ka origjinën nga majmuni dhe për ta vërejtur këtë ndryshim kemi nevojë për miliona vite. Hafizi i shqyrtoi edhe katër parimet e natyralistëve: Trashëgiminë, dallimin, grindjen për mbijetesë dhe selekcionimin, dhe në këtë kontekst ai thotë se këto janë teori e hipoteza të paqëndrueshme dhe, për këtë shkak, s'mund kursesi të mbështetemi në to.³⁶² Në këtë enciklopedi të madhe shkencore,³⁶³ hoxha shqyrton edhe çështjen e imanit në Zotin e Madhërishëm, duke mbrojtur mendimin se imani (besimi) nuk shtohet e as pakësohet,³⁶⁴ por përforcohet dhe dobësohet.

³⁵⁹ Po aty, f. 14-17.

³⁶⁰ Taha, 50.

³⁶¹ El A'ëla, 1-3.

³⁶² Po aty, f. 18-20.

³⁶³ **Vërejtje:** Për fat të keq, shumë faqe janë humbur nga ky libër voluminoz. Kopjen që e gjeta në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë i kishte faqet 1-31 dhe 232-288, dhe vetëm këtë e posedoj, ngase vetëm këtë e gjeta në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë. Shumë do të dëshiroja që ta gjej krejt librin në tërësi për të kuptuar më mirë idetë, mendimet dhe metodën e shqyrtimit të çështjeve racionale, filosofike e fetare. Elhmadulilah, për fat të mire në forumin alb-islam, të shqiptarëve në internet ca kohë më parë e kishte postuar dikush një kopje pak sa më të kompletuar të librit në fjalë të Hafiz Ali Korces, për të cilin jam mirnjohës, dhe e kam publikuar në faqen time personale për dobi të mbarë lexuesëve shqiptarë: <http://www.drhajredinhoxha.net>

³⁶⁴ Autori i kasides “El Bejkunije” kur flet për imantin në librin “Xhevheretut-Teuhid” të Shejh Ibrahim Bejxhurit thotë:

(وَرُجِّحَتْ زِيَادَةُ الْإِيمَانِ – بِمَا تَزِيدُ طَاعَةَ الْإِنْسَانِ) (وَنَقْصُهُ بِنَقْصِهَا وَ قِيلَ لَا – وَ قِيلَ ذَا خَلْفٍ كَذَا قَدْ نُقِلَا)

Në traktatin e tij “Myslimanija” thotë: *“Besimi në Islam: Zoti e mbron fenë nga dyshimet, Ai përsosë dritën e Tij, edhe pse e urrejnë atë jobesimtarët dhe ateistët, mrekullia e Kur’anit realizohet me ekzistimin dhe përhapjen e kësaj feje, ngase Islami ka ardhur për t’i shpëtuar njerëzit. Ky Pejgamber i Zotit nuk dëshironte as pushtet e as pozitë, por kishte ardhur për të shpëtuar njerëzit nga idhujtaria dhe triniteti, për t’i nxjerrë nga errësira në dritë, që të besojnë në Zotin Një dhe të Gjithëfuqishëm”*.³⁶⁵ Po ashtu ekzistojnë edhe çështje tjera të cilat i ka theksuar hoxhë Hafiz Ali Korça, si p.sh.: Madhështia e Pejgamberit, katër biblat,³⁶⁶ idetë dhe hulumtimet e dijetarëve perëndimorë dhe orientalistë, si dhe qëndrimi i tyre ndaj mesazhit islamik. Ai (Zoti e mëshiroftë!) shpesh herë theksonte në fusnota se ka transmetuar nga tefsiri “El-Menar”.³⁶⁷

Pas kësaj ekspozije të shkurtër të këtij tefsiri historik dhe fetar, mund të themi se ky libër na rrëfen disa dimensione nga metoda e hoxhës së nderuar Hafiz Ali Korça, përcakton doktrinën fetare të cilës i përkiste ai, ku vërehet qartë sa ngjashmëri e madhe ekziston në mes metodës së tij të shqyrtimit të çështjeve fetare dhe metodës së udhëheqësve të shkollës së re reformiste.

“Është vërtetë se shtimi i imanit vjen nga shtimi i adhurimit nga njeriu, dhe ai (imani) pakësohet me pakësimin e adhurimit, dhe është thënë edhe ndryshe...”. Këto vargje i mbaj mend që kur isha nxënës në shkollën e mesme “El Furkan” në Damask në vitin 1983.

³⁶⁵ Hafiz Ali Korça, **“Historia e shenjtë dhe të katër Halifetë”**; 26-27.

³⁶⁶ Shumë do të kisha dashur që hoxhë Hafiz Ali Korça të mos kishte transmetuar nga biblat dhe librat e shenjtë, që të mos vijë në kundërshtim me qëndrimin e tij se nuk ka transmetuar asgjë nga israilijatet. Për fat të keq, ai në këtë çështje, ka vazhduar rrugën e mësuesit të tij Shejh Reshid Ridasë, dhe nuk e ka vërejtur këtë lëshim që e kishte bërë edhe ai edhe mësuesi i tij.

³⁶⁷ Po aty, 236-239, 246-247.

STUDIM I SHKURTËR I TEFSIRIT TË HAFIZ ALI KORÇËS “KUR’ANI”³⁶⁸ I MADHNUESHËM E THEBI I TIJ”³⁶⁹

1. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË TEFSIRIT TË HOXHË HAFIZ ALI KORÇËS

Gjatë leximit dhe shqyrtimit tim që ua bëra mendimeve të hoxhë Hafiz Ali Korçës në përgjithësi dhe tefsirit të tij në veçanti, vërejta se Hafiz Ali Korça, (Zoti e mëshiroftë!) gjatë tefsirit të ajeteve dhe sureve në shqyrtimin dhe zbërthimin e çështjeve të rëndësishme:

- I luftonte format e amoralitetit dhe ua tërhiqte vëmendjen nga shpirti që urdhëron në të keqe si dhe i ftonte njerëzit të mbështeten në vlera morale;
- Përqëdrohej në rrezikun që hebrenjtë paraqisnin për botën, në qëllimet e këqija të tyre dhe përpjekjet e tyre të fëlliqta dhe jo etike në politikë, ekonomi e moral, me qëllim për ta sunduar botën;
- Shqyrtonte vlerat e Islamit dhe karakteristikat që e dallonin atë nga fetë tjera dhe argumentonte se ardhja e mesazhit të Islamit i shpëtoi arabët dhe tërë njerëzit nga errësira e injorancës dhe kolonializmit romak e persian;
- Përqëdrohej në vlerat e kulturës së Kur’anit në krahasim me kulturat e tjera të importuara perëndimore;
- Ai ua sqaronte njerëzve cilësitë dhe sjelljen e mirë të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) me njerëzit, posaçërisht me jetimët dhe bindshëm argumentonte se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) përfaqësonte pikën më kulmore të mundshme të humanizmit dhe demokracisë, pastaj sqaronte se halifët pas tij (Hulefai-Rashidinët) vërtetë kanë qenë demokratë (por jo sipas konceptit

³⁶⁸ Shtypshkronja “Ora e Shkodrës”; Shkodër 1926.

³⁶⁹ Edhe ky traktat është i mangët, ngase nuk është i tërë tefsiri në të. Këtë kopje e gjeta në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë dhe e fotokopjova. Edhe pse kërkoja diçka më tepër nga hoxhallarët që janë marrë me literaturën e tij, por për fat të keq mbeta vetëm me këtë që e kam. Të gjithë më thoshin se ai ka një tefsir të madh, por, për fat të keq, është humbur. Në bazë të këtij tefsiri që e kam dhe ajeteve të komentuar nëpër libra tjera dhe në numra të ndryshëm të revistës islame “Zani i Naltë”, inshalla mund të konfirmojmë qëndrimin e tij reformist.

bashkëkohorë të demokracisë), dhe se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në asnjë mënyrë nuk ka qenë njeri parazit i cili jetonte nga të tjerët, ashtu siç ndodh me udhëheqësit e sotshëm, dhe se të gjithë njerëzit, qofshin princër apo robër, në sytë e tij ishin të barabartë;

- Konfirmonte bindshëm faktin se Islami është përhapur me paqe e jo me dhunë, ndërsa krishterimi, në bazë të të dhënave historike, është përhapur me shpatë dhe me forcë. Sikur të mos ekzistonte toleranca fetare në Islam në raport me të tjerët gjatë përhapjes së tij, sot nuk do të gjeje asnjë të krishterë në botë, dhe sikur të ekzistonte dhuna, atëherë të gjithë do të duhej të bëheshin muslimanë nga frika prej tyre, por muslimanët nuk kanë detyruar askënd të pranojë Islamin dhe si argument i gjallë janë hebrenjtë dhe të krishterët, të cilët akoma ekzistojnë dhe jetojnë të pa konvertuar;
- Përforconte idenë e universalizmit dhe ndërkombëtarizmit të mesazhit të Islamit³⁷⁰ dhe vazhdimësinë e tij në këtë botë-dynja;
- Potenconte fuqinë racionale dhe shpirtërore të Islamit për t'i përballuar sfidat;
- Sqaronte se në Islam nuk ka persona të shenjtë (as mbretër shpirtëror) dhe se shenjtëria i takon vetëm Zotit të Madhërishëm, se askush nuk e bartë barrën e tjetërkujt dhe se çdo shpirt do të përgjigjet për atë që e ka bërë;
- Thërriste në reformimin e metodave edukative fetare, veçanërisht përqëndrohej në ringjalljen e trashëgimisë së vjetër shkencore intelektuale, në ngritjen e nivelit të gjuhës arabe, studimit të literaturës së gjuhës dhe stilistikës, nga autorët e njohur, siç janë p.sh.: Stilistika e Zemahsheriut, Ibn Haxhibit dhe të tjerëve, me qëllim që të bëhen të mëdhenj si Fahrudin Raziu, Ibni Sinâ, Xhelaludin Sujutiu, Imam Gazaliu etj. Ai nuk dëshironte që reformat shkollore të bëhen në bazë të imitimit të metodave perëndimore, por dëshironte që shkollat dhe metodat edukativo-arsimore të reformohen e të bëhen si shkollat fetare e shkencore të periudhës abaside në Bagdad dhe të periudhës

³⁷⁰ Mbi universalizmin e Islamit shih: Dr. Jusuf El-Kardavi, “**Shumulul-Islam fi dau’i sherhi mufessal lil-Usulil-ishrinë lil-Imamish-Shehid Hasan El-Benna**”; Kajro, Mektebetu-Vehbe, bot. 2, 1995, f. 35-120.

emevite në Andaluzi, si dhe të armatosen me armët e diturisë në bazë të kërkesave aktuale të kohës;³⁷¹

- Argumentonte mrekullinë e Kur'anit, të peygamberisë së Muhammedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe bënte kozmopolitizmin e mesazhit të tij për të gjithë njerëzit;
- Apelonte për përhapjen e shkollave fetare, ngase mendonte se ata luajnë rol shumë të rëndësishëm edukativ në jetën e mbarë Ummetit;
- Luftonte kundër idhujtarisë (shirkut) dhe kundër ndërmjetësimit në lutje përveç Allahut të Madhërishëm e jo të putave, qofshin ata të gjallë apo të vdekur;³⁷²
- Luftonte kundër traditave, adeteve, bestytive dhe risive të shoqërisë shqiptare dhe bënte apel për t'u mbështetur vetëm në Kur'anin Fisnik dhe në Sunnetin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

2. METODA E HOXHË HAFIZ ALI KORÇËS NË TEFSIR

Hoxhë Hafiz Ali Korça ka theksuar në hyrjen e tefsirit të tij të shkurtër që e kam në bibliotekën time, se ka shkruar shumë në komentimin e Librit të Zotit të Madhërishëm, duke u mbështetur në shumë vepra të njohura tefsiresh, por për fat të keq, rrethanat ekonomike kanë ndikuar që të mos botohet ky tefsir voluminoz, ngase botimi i tij kushtonte shumë shtrenjtë, dhe për këto arsye financiare, ai e ka shtyrë botimin e tefsirit, derisa t'i përmirësohen rrethanat ekonomike.

Përkundër gjendjes së vështirë financiare, ai megjithatë, kishte vendosur ta botojë përmbledhjen e tefsirit voluminoz, me qëllim që të jetë sa më i kapshëm për mbarë njerëzit, dhe një kopje të këtij tefsiri e kam edhe unë, por për fat të keq, shumë faqe të tij janë zhdukur... Shumë studiues thonë se tefsiri voluminoz dhe i humbur i hoxhë Hafiz Ali

³⁷¹ Dr. Muhammed Husejn Edh-Dhebij, “**Et-Tefsir vel-Mufessirunë**”; vëll. 2, f. 408-420; Krahason metodën e profesorit dhe Imamit, Muhamed Abduhu, me atë që thash më parë.

³⁷² **Zani i Naltë**, Nr. 3, mars, 1929, (796-797, 799-800); **Zani i Naltë**, Nr. 9, qershor 1924 (270); **Zani i Naltë**, Nr. 8, maj, 1924 (238-246).

Korçës i ka pasur afër 2000 faqe.³⁷³ Kjo përmbledhje e tefsirit jo të plotë fillon nga sureja “El-Fatiha” dhe përfundon deri në ajetin e tridhjetë e tetë të sures “El-Bekare”,³⁷⁴ dhe për shkak të faqeve të kufizuara të tefsirit dhe ajeteve të komentuara në veprat dhe artikujt e hoxhës, të botuara në revista të ndryshme, harxhova energji të madhe në një hapësirë të tillë të gjerë, gjersa kuptova më saktë të vërtetën e ideve dhe mendimeve të tij në tefsir, dhe mund të them se me sukses tubova një pasuri të madhe të komentimeve të përbërë nga idetë e Hafiz Ali Korçës, derisa e kuptova përcaktimin e tij doktrinar në tefsir.

Para se të flas për metodën dhe mënyrën e tij në tefsir, vlen t’i numërojmë burimet në të cilat është mbështetur Hafiz Ali Korça gjatë tefsirit të tij dhe punimeve tjera fetare.

1. Gjatë leximit dhe studimit të veprave të hoxhë Hafiz Ali Korçës, tefsirit të tij të shkurtër dhe tefsirit të ajeteve të ndryshme të botuara nëpër revista islame, kuptova se ai është mbështetur në një numër të madh të literaturës dhe veprave të ndryshme, falë njohjes së tij të gjuhëve orientale dhe perëndimore, nga të cilat ka përfituar kulturë të gjerë fetare, letrare e politike.

Në vijim do t’i përmendim titujt e literaturës që ka përdorur hoxhë Hafiz Ali Korça në punimet dhe artikujt e tij:

- Literatura e Sunnetit të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), literatura e biografisë së Pejgamberit dhe sahabëve të tij, pastaj literatura e llojllojshme e tefsirit në krye me tefsirin e Fahrudin Raziut, tefsiri “El-Menar” i Shejh Reshid Ridasë, literatura e historisë islame dhe jo islame, posaçërisht historia e Taberiut, literatura e gjuhës arabe, gjegjësisht literatura gramatikore e stilistike arabe, literatura filosofike islame dhe perëndimore, literatura e përgjithshme kulturore në gjuhë të ndryshme, literatura e letërsisë arabe, perse, turke e shqipe, literatura moderne në gjeografi, astronomi e biologji, literatura e fikhut dhe usuli- fikhut, literatura e shkencave kur’anore, literatura e tregimeve kur’anore, literatura apologjetike, literatura politike botërore, literatura orientaliste perëndimore dhe literatura të tjera shkencore, që konfirmojnë

³⁷³ Ramiz Zekaj, “Zhvillimi i Kulturës Islame te shqiptarët gjatë shekullit XX”; 317-319; Ismail Bardhi, “Hafiz Ibrahim Dalliu dhe egzegjeza e tij kur’anore”; 67; Shefik Osmani, “Panteoni iranien dhe iranologët shqiptarë”; 272-276.

³⁷⁴ El-Bekare, 38.

kulturën briljante dhe diapazonin jashtëzakonisht të gjerë të hoxhë Hafiz Ali Korçës (Zoti e mëshiroftë!)

2. Nga e tërë ajo që kam lexuar prej tefsirit dhe hulumtimeve të tij në këtë lëmë, kuptova se në të kuptuarit e Librit të Zotit të Madhërishë, ka përdorur metodën vijuese:
 - Thekson nocionet “ajete mekase dhe medinase” të sureve dhe numrin e ajeteve;
 - Zbërthen termet e sureve dhe fjalëve të huaja;
 - Thekson emrat e sureve dhe zbërthen qëllimin e emërimit të tyre me emrat përkatës;
 - Mbështetet në analiza gramatikore, si p.sh., vlera e nyjës shquese “El” në ajetin:

([الفاتحة:2] ﴿ اَلْعَلَمِیْنَ رَبِّ لِلّٰهِ الْحَمْدُ ﴾) (“*El-Hamdulil-lahi Rab-bil-Alemin*”;

- Nga ndonjëherë i thekson llojet e leximeve (kiraetet e Kur’anit) në formë të thuktë;
- Thekson mendimet e dijetarëve dhe komentuesve të Kur’anit rreth shkronjave simbolike në fillim të sureve, por në një formë shumë të reduktuar;³⁷⁵
- Në tefsirin e tij, i thekson shoqëritë që ekzistojnë në Gadishullin Arabik, si p.sh.: Hebrenjtë, të krishterët, idhujtarët e totemëve, idhujtarët e yjeve dhe disa eternalistë;³⁷⁶
- Thekson arsyen e zbritjes së ajetit nëse ka ndonjë shkas dhe sipas tij, mund të ketë disa arsye të zbritjes së ajeteve për një çështje;³⁷⁷
- Mbështetet në biografinë e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe të sahabëve të tij për të sqaruar kuptimin e ajetit;
- Anon nga komentimi shkencor i ajeteve dhe një gjë të tillë, qartë e vërejmë në komentin që i bën suren “Ez Zelzele”, ku i shqyrton disa ligje të ndryshme fizike që kanë të bëjnë me shkatërrimin e tokës para Ditës së Kijametit, vullkanet, rënien e

³⁷⁵ Në fusnotat e tefsirit të dhëna në përmbledhjen, hoxhë Hafiz Ali Korça thotë se ka përpiluar një libër të posaçëm rreth shkronjave simbolike, gjë që konfirmon interesimin e tij të madh në lëndën e tefsirit. Për fat të keq, edhe ky libër është zhdukur.

³⁷⁶ “Kur’ani i Madhëruar e thebi i Tij”; 3-13.

³⁷⁷ Po aty, f. 13.

yjeve, qiejve dhe gjëra tjera që do të ndodhin. Sipas mendimit tim, tefsiri shkencor dhe mbështetja e tij në Tefsirin e Fahrudin Raziut në të shumtën e rasteve kanë ndikuar aq shumë në të, saqë mendonte se ekzistojnë krijesa tjera kafshësh dhe njerëzish në planetët e tjera, dhe këtë mendim e vërteton me ajetin kur'anor:

جَمَعَهُمْ عَلَىٰ وَهُوَ دَابَّةٌ مِّنْ فِيهِمَا بَثَّ وَمَا وَاللَّأَرْضِ السَّمَوَاتِ خَلَقُ أَيَّتَهُ وَمِنْ

([الشورى: 29] ﴿قَدِيرٌ يَشَاءُ إِذَا﴾

“Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe shpërndarja e gjallesave në të dyja dhe Ai me fuqinë e Tij, mund t'i bashkojë kurdo që të dëshirojë”.³⁷⁸ Pastaj vazhdon hoxha dhe transmeton fjalët e Fahrudin Raziut pa theksuar numrin e faqes dhe vëllimin,³⁷⁹

- Ndonjëherë thekson disa nocione dhe terme që kanë ngjyrimet sufiste, si p.sh., në tefsirin e sures “Ed-Duha” thekson se kur Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) sheh Shpalljen (Vahjin-Xhibrilin a.s.) për herë të parë, është habitur dhe është zhytur në Detin e Dritës së Zotit të Madhërishëm si dhe është lodhur në valët e këtij Deti jo të rëndomtë, nga Drita e Zotit të Madhërishëm!³⁸⁰
- Ndonjëherë gjatë tefsirit largohet nga tema, pastaj sërish kthehet në temë;
- Ndonjëherë gjatë tefsirit argumenton me poezi origjinale të tij,³⁸¹
- Kur flet për vlerat e Islamit që ua ka sjellë arabëve, atë e argumenton me historinë arabe paraislame.³⁸²
- Hoxhë Hafiz Ali Korça shkruante fjalë të bukura poetike gjatë tefsirit, ngase aftësia e tij poetike kishte shpërthyer qysh nga fëmijëria e tij e hershme. Ai thurte poezi në të gjitha disiplinat islame, përdorte fjalë me kuptim të lartë dhe synonte qëllime sublime dhe të pastra,³⁸³

³⁷⁸ Esh Shura, 29.

³⁷⁹ **Zani i Naltë**, Nr. 6, 1927, (162-167).

³⁸⁰ **Zani i Naltë**, Nr. 8, mars, 1927, (227-228).

³⁸¹ Po aty, f. 233.

³⁸² Po aty.

³⁸³ Po aty f. 236.

- Në tefsirin e tij ai theksonte fjalët e të urtëve, filosofëve dhe historianëve të ndryshëm nga Perëndimi si dhe tregonte përshtypjet e tyre pozitive që i kishin përfutur nga madhështia e mesazhit të Islamit dhe nga personaliteti gjenial i Muhammedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), meqë ai ka qenë njeri me personalitet të lartë, i cili pandërprerë përpiquej për realizimin e qëllimeve njerëzore dhe madhore hyjnore: Hafiz Ali Korça reagon ndaj dyshimeve dhe trillimeve të armiqve, qofshin orientalistë ose misionarë dhe në të njëjtën kohë tregon edhe për tentativat e tyre për krishterimin e muslimanëve në Afrikë, Kinë e Indi;³⁸⁴
- E kishte zakon që të shkruante një hyrje të shkurtër para fillimit të tefsirit të ajeteve, si p.sh., në tefsirin e sureve “El-Kadru” dhe “Et-Tekathur” dhe të sureve e ajeteve tjera, pastaj vazhdon e zgjerohet në tefsir dhe sqarime;³⁸⁵
- Sipas mendimit të hoxhë Hafiz Ali Korçës, theksimi i numrave si p.sh. (1000 muaj) në suren e “Kadrit” dhe në suret e tjera kur’anore nuk nënkupton numra konkret, por ato përdoren për të treguar sasi të madhe, ashtu siç është zakon në gjuhën arabe;³⁸⁶
- Ai transmeton nga komentues tjerë, posaçërisht nga Imam Fahrudin Raziu, “Tefsirul-Menari” i Reshid Rida-së dhe të tjerë pa i përmendur emrat e tyre;³⁸⁷
- Ai thekson këshillat dhe leksionet që dalin nga ajetet kur’anore si dhe i kritikon ashpër pasanikët që preferojnë jetën e luksit dhe që krenohen me pasuri e fëmijë dhe nuk japin ndonjë kontribut social apo fetar për vendasit e tyre, si p.sh., nuk ndërtojnë shkolla, nuk u ndihmojnë të varfërve të martohen etj. Dhe shpeshherë thërriste në investim të mirë të begative të tyre;³⁸⁸
- Ndonjëherë vazhdon tefsirin e ajetit dhe në fund përfundon me një përmbledhje, si dhe ndonjëherë argumenton tefsirin e ajeteve me hadithin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!);

³⁸⁴ **Zani i Naltë**, Nr. 1, nëntor, 1927, 383-388 dhe Nr. 3, prill, 1924, (203-217).

³⁸⁵ **Zani i Naltë**, Nr. 7, prill, 1924, (195-201).

³⁸⁶ Po aty.

³⁸⁷ **Zani i Naltë**, Nr. 6, 1926, (163-167).

³⁸⁸ Shih tefsirin e sures “Et-Tekathur” në: **Zani i Naltë**, nr. 9, qershor, 1924, (261-265).

- - Ai tërësisht i refuzonte israilijatat dhe më duhet të theksoj se gjatë tefsirit të tij nuk kam hasur diçka të tillë, dhe siç duket, kjo karakteristikë i dallon ithtarët e shkollës reformiste racionale që kishin ndikuar thellë tek ai.³⁸⁹
- - Mbështetëj në zbulimet shkencore të kohës së tij dhe kur fliste për dëmet nga vera, alkooli e duhani dhe për dobite shëndetësore nga agjërimi, argumentonte me raporte mjekësore;³⁹⁰
- - Nuk ripërsëriste fjalët dhe kur sqaronte kuptimin e ajetit dhe fshehtësitë që përmbante ai, theksonte mënyrat retorike të Kur'anit, me qëllim të dallimit të fjalëve që ishin të posaçme vetëm për Pejgamberin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe për muslimanët në përgjithësi;³⁹¹
- - Mbështetëj në ekspresivizmin stilistik të ajeteve, duke thënë: *“Është afruar dielli i fesë së vërtetë të shndritë...”*, ose *“Nga thellësia (deti) i dashurisë hyjnore”*; etj.³⁹²
- - Ndonjëherë shqyrtonte çështjet që kishin të bënin me kaderin (determinizmin), shpesh herë i luftonte adetet, traditat dhe bestytnitë e shqiptarëve dhe i korrigjonte pikëpamjet e gabuara të tyre;³⁹³
- - Me bindje të plotë mbronte Ehli-Sunnetin dhe xhematin, thërriste në mbështetjen e plotë në Kur'anin Fisnik dhe Sunnetin, si dhe ftonë në përkthimin e teksteve të Kur'anit dhe hadithet e pejgamberit a.s.(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për shoqërinë shqiptare.³⁹⁴

Në bazë të asaj që pata mundësi të tuboj nga punimet, veprat dhe artikujt e tij të ndryshëm, këto ishin disa nga karakteristikat e metodës së hoxhë Hafiz Ali Korçës në tefsirin e Librit të Zotit të Madhërisë.

³⁸⁹ Shih tefsirin e ajetit të agjërimin në: **Zani i Naltë**, nr. 6, mars, 1924, (174).

³⁹⁰ Po aty.

³⁹¹ Po aty, f. 164; Mbi mënyrat kur'anore të rrëfimeve shih: Abdulhamid Muhammed Neda Xha'rane, **“El-Med-hal ilet-Tefsir”**; Mektebetu-Vehbe, Kajro, bot. 1, 1996, 405-424 (disertacion doktrature); Xhelaluddin Abdurrahman Es-Sujuti, **“Et-Tahbir fi Ilmit-Tefsir”**; recensoi: dr. Fet-hi Abdulkadir Ferid, Darul-Menar, Kajro 1986, f. 235-242.

³⁹² **Zani i Naltë**, nr. 6, 1924 (174).

³⁹³ **Zani i Naltë**, nr. 2, fror, 1929 (776) dhe nr. 3, mars, 1929, (799).

³⁹⁴ **Zani i Naltë**, nr. 3, mars, 1929 (800).

Të nderuar lexues!

Besoj se me ndihmën e Zotit të Madhërishëm, ia kam dalë mbanë dhe deri diku pata sukses t'ju ofroj disa parime racionale dhe metodologjike të këtij dijetari dhe komentuesi shqiptar që i takon shkollës reformiste të kohës së re, edhe pse thënë realisht, ishte mjaft vështirë të gjej gjurmë të tij të botuara.

3. NDIKIMI I SHKOLLËS REFORMISTE RACIONALE NË MENDIMET E HOXHËS DHE MOHIMI I HADITHIT SAHIH

Ajo që na bën të bindemi se hoxhë Hafiz Ali Korça i përkiste drejtimit reformist është qëndrimi i tij ndaj ngjarjes kur Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i është bërë sihr dhe që përmendet në hadithe “sahih”.³⁹⁵

Nuk dua që të them të pavërteta mbi hoxhë Hafiz Ali Korçën (Zoti e mëshiroftë!), ndaj dhe për këtë shkak në vijim tekstin e tij, do ta transmetoj fjalë për fjalë, me qëllim që këtë çështje ta kuptojmë sa më mirë. Në tefsirin që i bën sures “El-Felek”, hoxhë Hafiz Ali Korça thotë:

“Ajo që thuhet nga Lebijd ibn El-A’ësamî, çifuti nga Medina, se i ka bërë sihr Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në pus dhe se Pejgamberit i janë parafytyruar gjërat dhe se i është dukur kinse bën diçka e në realitet nuk bënte gjë, kinse flet diçka e në realitet nuk fliste gjë, derisa Zoti i Madhërishëm i ka treguar dhe informuar për vendin e sihr...etj... dhe fjalë të tjera. Them se këto të dhëna nuk janë të vërteta në asnjë mënyrë, ngase pejgamberët nuk i kap sihri, ndaj si mund t’i bëhet sihr Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)? Ai që e ka thënë këtë fjalë vërteton fjalën e idhujtarëve që thonë:

يَقُولُ إِذْ نَجَوَى هُمُ وَإِذْ إِلَيْكَ يَسْتَمِعُونَ إِذْ بِهِ يَسْتَمِعُونَ بِمَا أَعْلَمُ نَحْنُ

([الإسراء: 47] مَسْحُورًا رَجُلًا إِلَّا تَتَّبِعُونَ إِنِ الظَّالِمُونَ

³⁹⁵ Hadithin mbi sihrin që i është bërë Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e transmeton Imam Buhariu në “Sahihun” e tij, “Kapitulli i sihrin”, Nr. 5430, vëll. 5, f. 2174; dhe Imam Muslimi në “Sahihun” e tij, “Kapitulli i sihrin”, Nr. 2189, vëll. 4, f. 1719.

“Ju nuk i shkoni pas përpos një njeriut të magjepsur..”
në suren Isra, ajeti 47, dhe

إِنَّ الظَّالِمُونَ وَقَالَ مِنْهَا يَأْكُلُ جَنَّةً لَهُمْ تَكُونُ أَوْ كَنْزٍ إِلَيْهِ يُلْقَى أَوْ

([الفرقان: 8] مَسْحُورًا رَجُلًا إِلَّا تَتَّبِعُونَ)

“Të padrejtët thonë: Ju ndiqni vetëm një njeri të magjepsur ! “
ElFurkan, ajeti 8.

Me termin “I magjepsur” (مسحوراً) nënkuptohet njeriu që i janë përzier gjërat dhe që ka iluzione, gjoja se bën diçka, e në realitet ai nuk bën asgjë ose beson se i është shpallur apo inspiruar diçka, kurse në realitet nuk i është shpallur e as inspiruar asgjë. Ata që thonë këtë nuk e njohin realitetin e pejgamberisë dhe rëndësinë e saj, dhe pa kurrfarë turpi ia ngjisin këto akuza dhe këto gjëra qesharake Pejgamberit të Zotit dhe mendojnë se çifuti Lebijd ibn El-A’sami i ka bërë sihër. Ata harruan se Kur’ani Fisnik është i vërtetë dhe se është vërtetuar që Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është i mbrojtur dhe i ruajtur nga gabimi. Ne obligohemi të besojmë atë që duhet të besojmë dhe të refuzojmë atë që duhet ta refuzojmë.

Kur u përhap lajmi mbi sihrin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ai vetë e mohoi lajmin e tillë duke thënë: “Unë nuk magjepsëm”. Sidoqoftë, nëse ka ndonjë lajm të tillë nga Pejgamberi i Zotit, atëherë ai është transmetim individual (Ahad) (طريق الأحاد) që s’ka rëndësi në vlerën e tij. Prej nesh kërkohet që të besojmë se Alejhisselami është i mbrojtur, i pastër dhe i dëlirë nga çdo gjë që është thënë apo thuhet për të. Le të flasim sa të duan, ngase ne jemi të obliguar me atë që na urdhëron Kur’ani. Sikur të ishin të vërteta trillimet e tilla nga mendjeboshët se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është magjepsur, atëherë do ta informonte Ummetin e vet për diçka që nuk e ka urdhëruar Zoti i Madhërishëm dhe nuk e ka inspiruar. Po, sihri mund të ekzistojë,³⁹⁶ por megjithatë ai nuk mund të ndikojë në asnjë

³⁹⁶ Nëpërmes këtyre fjalëve hoxhë Hafiz Ali Korça konfirmon ekzistimin e sihrit, por refuzon dhe mohon të ketë ndonjë ndikim në personalitetin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) Në komentimin e ajetit :

(وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ) [الفلق: 4]

“Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja”; (Felek, 4) në gjuhën shqipe, hoxhë Hafiz Ali Korça thotë se të tillët janë ata që fryjnë. Gjatë krahasimit të këtyre fjalëve me fjalët e Muhamed Abduhusë vërejtja se janë identike, gjë që konfirmon idenë dhe

﴿ تَسْعَىٰ أَنهَا سِحْرُهُمْ مِنْ إِلَهِ تَخَيَّلُ وَعَصِيَّتُهُمْ حِبَاهُمْ فَإِذَا أَلْقُوا بَلَّ قَالَ ﴾

[طه: 66] (

“Kur, ja, atij iu duk se nga ajo magji e tyre litarët dhe shkopinjtë lëviznin (si gjarpërinj)”.³⁹⁷ dhe nuk thotë: “Iu duk se litarët dhe shkopinjtë lëviznin nga magjia e tyre”, dhe siç themi ne shqiptarët ndonjëherë: “Filani ma ka marrë trurin dhe më ka gjuajtur dhë apo zall në sy”- për të treguar se diçka është hile dhe intrigë. Pejgamberi thotë: (وَ إِنَّ) “Edhe në fjalë ka magji”.³⁹⁸ Në politikën e sotshme, diplomatët përdorin këtë lloj magjie në çështjet e mëdha të hapura, nëpërmjet konferencave të shumta dhe fjalive e teksteve të mëdha me kuptime të zbrazëta e boshe dhe premtime të shumta e të parealizuara. Kështu i përdorin fjalët e tilla kur dështojë në zgjedhjet e tyre, madje edhe në raste lufte.

Argumenti i dytë se ky lajm nuk është i vërtetë vërehet edhe në suren “El-Felek” e cila ka zbritur në Mekë, ndërsa Lebijd ibn El-A’sami ka qenë në Medinë, pra si mund të pranohet një gjë e tillë?!³⁹⁹

Sidoqoftë, ky është një trillim i pakuptimtë që nuk pranohet nga njerëzit me mendje të shëndoshë e të mirë dhe nuk i besojmë një gjëje të tillë”.⁴⁰⁰

metodën e përbashkët në mes tyre. Shih më gjerësisht “Tefsiru xhuz’i “Amme”, nga autori Muhamed Abduhu, f. 181-192, transmetuar nga “Et-Tefsir vel-Mufessirunë” i dr. Muhammed Husejn Dhehebiut, vëll. 2, f. 420-421.

³⁹⁷ Taha, 66.

³⁹⁸ Këtë hadith e transmeton Imam Tirmidhiu në “Sunenin” e tij me numër 2028, vëll. 4, f. 376.

³⁹⁹ Ibn Kethiri në tefsirin e tij thekson se dy suret e fundit janë medinase, shiko tefsirin e tij vëll.4 f. 574, ndërsa sipas Ibn Shihab Zuhriut, në librin “Tenzilul-Kur’an”-thuhet se sureja “El-Felek” ka zbritur në Mekë, vëll. 1, f. 24. Pra, siç duket, në këtë çështje ekzistojnë dy mendime të ndryshme.

Ky është një qëndrim i qartë dhe transparent i hoxhë Hafiz Ali Korçës ndaj kësaj ngjarjeje apo këtij tregimi. Ai analizoi logjikisht dhe fetarisht shkaqet se një gjë e tillë nuk mund t'i ndodhë Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) Ky ishte mendimi i tij dhe kjo ishte metoda e tij, por në këtë çështje ekziston edhe një mendim tjetër. Para se ta kritikoj mendimin e tij, vlen të përmendi fjalët e prof. dr. Muhammed Husejn Edh-dhehebiut, (Allahu e mëshiroftë) i cili në këtë kontekst thotë: *“Këtë hadith që e refuzon Imami,(Shejh Muhamed Abduhu) e ka transmetuar Buhariu dhe autorët e tjerë të veprave autentike, dhe asgjë nuk ndikon në autenticitetin e pejgamberisë. Sihri që e kishte kapluar Pejgamberin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kishte të bëjë me sëmurjet e trupit pa ndikuar në mendjen e tij, dhe thuhet se sihrin që Lebijd ibn El-A'sami ia ka bërë Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) mund të jetë diçka që u takon fryrjeve të grave e që quhet “lidhje”, dhe i dukej se i shkonte njëres prej grave të tij dhe kur i është ofruar s'ka mundur të bëjë gjë, ndërsa “sihrin” që e ka mohuar Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)ka të bëjë me personin e marrë dhe s'ka dyshim se njeriu i tillë s'mund të jetë pejgamber. Në këtë mënyrë edhe i janë drejtuar duke i thënë:*

([الحجر: 6] ﴿لَمَجْنُونٌ إِنَّكَ الذِّكْرُ عَلَيْهِ نُزِّلَ الَّذِي يَأْتِيهَا وَقَالُوا﴾)

“O ti që të ka zbritur (Kur’ani) vërtetë je i marrë”.⁴⁰¹

Në hadithin që e ka transmetuar Buhariu dhe të tjerët në veprat autentike, edhe pse Imami-(Shejh Muhamed Abduhu) dhe bashkëmendimtarët e tij nuk bëjnë dallim në mes transmetimit të Buhariut dhe të tjerëve, nuk ekziston ndonjë mëkat, nëse nuk pranon ndonjë transmetim nga Buhariu, si dhe, sipas tyre, mund të jetë transmetim individësh që s'mund të pranohet në formë të sigurt, e sipas mendimit tim, ky mendim shkatërron një pjesë bukur të madhe të Sunnetit që në krahasim me Kur'anin është sqarim e udhërrëfyes”.⁴⁰²

Sipas kësaj që e përmend dr. Muhammed Husejn Dhehebiu, themi se sunneti autentik nuk kundërshton Kur'anin, por “Sunneti sqaron

⁴⁰⁰ **Zani i Naltë**, Nr. 2, fror 1929; 777-779.

⁴⁰¹ El-Hixhr, 6.

⁴⁰² Dr. Muhammed Husajn Edh-Dhehebij, “**Ef-Tefsir vel-Mufessirunë**”; vëll.2, f.421-422.

Kur'anin ose e përforcon atë". "Nuk ekziston asnjë hadith i vërtetë që kundërshton Kur'anin, e nëse ndodh diçka e tillë, atëherë hadithi është i vërtetë, por i paqartë, ose është i qartë por jo autentik, dhe hadithi jo autentik nuk pranohet, e nëse nuk është i qartë, atëherë duhet të shpjegohet konform Kur'anit, ngase Kur'ani është primar, kurse sekondarja nuk mund të kundërshtojë primaren".⁴⁰³

Ekziston edhe një çështje tjetër e rëndësishme këtu, gjegjësisht fakti se refuzimi i haditheve autentike i ngjanë pranimit të haditheve të trilluara dhe kjo i jep një autoritet negativ Ummetit, dijetarëve dhe imamëve që janë më të mirët e gjeneratave të tyre. Refuzimi i haditheve autentike të nxjerr nga feja...⁴⁰⁴

Vazhdojmë e themi se Imam Shatibiu (Zoti e mashiroftë!), në kapitullin mbi sunnetin në librin e tij:

الموافقات في الشريعة الإسلامية – حول السنة و أصولها في القرآن الكريم و أهمية اتباعها و (نم تركها)

"El-Muvafekat... " Haules-Sunneti ve Usuliha fil Kur'anil-Kerim ve ehemmiyyeti ittiba'iha ve dhemmu terkiha", thotë: "Sunneti, në kuptimin e vet mbështetet në Kur'an, sqaron kuptimin e tij, zbërthen problematikat e tij dhe lehtëson domethënien e tij".⁴⁰⁵

Siç shihet, në asnjë mënyrë nuk refuzohet sunneti autentik dhe i qartë, i cili assesi nuk mund të kundërshtojë ndonjë themel të besimit ose burim të Sheriatit. Hoxhë Hafëz Ali Korça, (Allahu e mëshiroftë) është dashur të jetë më i kujdesshëm dhe të mos gjykojë se këto rrëfime janë të pasakta ose të transmetuara nga individë.

Zhvlerësimi i dy "Sahihëve" ose i njërës prej tyre është traditë e muslimanëve properëndimorë, e orientalistëve dhe kundërshtarëve të fesë islame si në të shkuarën, ashtu edhe në ditët e sotshme. Tejkalimi i kufijve të komentimit të teksteve, posaçërisht të teksteve profetike të prijësit e shkollës reformiste racionale dhe ideja mu'tezilite në këto çështje është një ndër aspektet më negative dhe ndër gabimet më të mëdha të tyre ndaj burimit të dytë nga burimet e Sheriatit Islam, gjegjësisht Sunnetit të pastër profetik. Kjo formë e komentimit të tyre duhet të zhduket e të anulohet dhe të zëvendësohet me ndonjë formë më të mirë, përkatsësisht t'i

⁴⁰³ Dr. Jusuf El-Kardavi, "El-Merxhejjetul-ulja fil-Islami lil-Kur'ani ves-Sunneti-Davabit ve Mehudhiyr fil-fehmi vet-Tefsir"; Kajro, Mektebu-Vehbe, f. 99.

⁴⁰⁴ Dr. Jusuf El-Kardavi, "El-Med-hal li dirasetis-Sunnetin-Nebevijjeti"; Kajro, bot. 3, 1992, f. 103.

⁴⁰⁵ Ebu Is'hak Esh-Shatibi, "El-Muvafakat fish-Sheriatil-Islamijjeti"; vëll. 4, f. 396.

rikthehen metodës së selefus-salihit dhe dijetarëve muslimanë, si në vepra ashtu edhe në fjalë e besim, nëse vërtet dëshirojmë sukses dhe lumturi.

Askush nuk guxon të prekë autoritetin e dy “Sahihëve” të Imam Buhariut dhe Muslimit, ngase tërë Ummeti janë unanimit në autenticitetin e tyre, ose në të kundërtën, do të turpërohen me etiketën mu’tezilite tërë jetën, si dhe do të jenë përgjegjës edhe për ata që do t’i pasojnë pas tyre deri në Ditën e Gjykimit.

4. HOXHË HAFIZ ALI KORÇA DHE TEFSIRI SIMBOLIK (التفسير الإشاري)

Nga reflektimet dhe gjurmët e doktrinës reformiste në mendimet e hoxhë Hafiz Ali Korçës ishte tefsiri i disa ajeteve në mënyrë simbolike. Ç’është e vërteta, kjo mënyrë e tefsirit simbolik është një lloj tefsiri i lejuar sufist, dhe ka bazë në Sheriatin tonë, e që njihet në shkencën e tefsirit si

(التوفيق بين المعنى الظاهر و المعنى الباطن) “harmonizim i kuptimit ekzoterik (*dhahir*) me atë ezoterik (*batin*) të ajetit”, apo siç deklarojnë disa dijetarë se “çdo ajet ka kuptim të brendshëm dhe të jashtëm”.

Këtë çështje të tefsirit e kanë studiuar shumë dijetarë, si në të kaluarën, ashtu edhe në ditët e sotshme, gjegjësisht në të kaluarën e kanë studiuar Imam Gazaliu, Imam Ebu Is’hak Esh-Shatibiu, etj., ndërsa në ditët e sotshme janë marrë Shejh prof.Dr. Muhammed Husejn Dhehebi, Shejh prof.Dr. Muhamed Abduladhim Zurkani, Shejh prof.Dr. Fehd ibn Abdurahman Er-Rumi dhe Shejh prof.Dr. Jusuf El-Kardavi, etj.

Ithtarët e kësaj doktrine ekzistimin e këtij lloji të tefsirit e argumentojnë me hadithin e transmetuar nga Imam Buhariu, ku thuhet: Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se ka thënë: “*Omeri më trajtonte si më të afërm të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)*”; ndaj dhe për këtë, Abdurahman ibn Aufi i thotë Omerit: “*A e trajton ashtu kur edhe ne kemi fëmijë si ai?*” Omeri i përgjigjet: “*Ai trajtohet në bazë të diturisë*”, dhe më pas më pyeti për këtë ajet:

([النصر: 1] وَالْفَتْحُ اللَّهُ نَصْرُ جَاءَ إِذَا)

“*Kur erdhi ndihma e Allahut dhe çlirimi (ngadhënjimi)*”.⁴⁰⁶; e unë iu përgjigja me atë çfarë më kishte mësuar Pejgamberi i Zotit, dhe kur e

⁴⁰⁶ En Nasr, 1.

lexova suren deri në fund, Omeri tha: “Betohem në Zotin se unë nuk di më tepër se ajo që ti e di...”.⁴⁰⁷

Gjithashtu edhe Taberiu dhe komentuesit e tjerë theksojnë se kur ka zbritur ajeti:

([المائدة: 3] ﴿ نِعْمَتِي عَلَيْكُمْ وَأَتَمَّمْتُ دِينَكُمْ لَكُمْ أَكْمَلْتُ الْيَوْمَ ﴾)

“Sot e plotësova fenë tuaj”,⁴⁰⁸ në Haxhin e Madh Lamtumirës, Omer ibn Hatâbi ka qarë, dhe kur e ka pyetur Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) se për çfarë po qanë, ai i është përgjigjur: “Më bëri të qaj (fakti) se deri tash plotësohej feja jonë, dhe pasi u plotësua, atëherë patjetër diçka të mungojë”; dhe në këtë Pejgamberi a.s. i ka thënë: “Ke të drejtë!”

Ekzistojnë ajete dhe hadithe tjera që i theksojnë dijetarët e që konfirmojnë kuptimin ezoterik apo këtë ngjyrë simbolike në tefsir. Ana e dukshme e Kur’anit është ajo që Zoti i Madhërishëm u drejtohet robërve të vet në gjuhën e pastër arabe, e që ka rregulla e parime që na mundësojnë të kuptojmë në mënyrë të shëndoshë. Kuptimi ezoterik (i fshehur dhe i brendshëm) ka të bëjë me dëshirën e Zotit të Madhërishëm dhe me qëllimin për të cilin e ka zbritur Kur’anin, dhe këtë e kuptojmë nëpërmes të kuptuarit të parimeve dhe rregullave të tilla gjuhësore krahas dhuntisë hyjnore, e cila, sipas Imam Sujutiut, konsiderohet kusht i rëndësishëm i komentuesit të Kur’anit, e që nënkupton Dritën e Zotit të Madhërishëm që e ndez në zemrën e dijetarit dhe njohësit të Zotit të Gjithëfuqishëm, e që ka zemër, mendim dhe sjellje të shëndoshë.

Disa dijetarë caktojnë kushte për kuptimin ezoterik, gjegjësisht për të kuptuar aspektin ezoterik të gjuhës arabe; ai kuptim ezoterik duhet të përputhet me kuptimin ekzoterik dhe me qëllimet e gjuhës arabe, dhe të ketë fakt tekstual i cili e argumenton një kuptim të tillë. Pra, kuptimi ezoterik ndërlidhet ngushtë me kuptimin e shëndoshë ekzoterik të tekstit,

⁴⁰⁷ Vazhdimi i hadithit.

⁴⁰⁸ El-Maide, 3.

sepse në të kundërtën do të ndeshemi me thëniet dhe komentimet e çuditshme dhe të habitshme të disa sufistëve dhe ithtarëve të tyre.⁴⁰⁹

Tani le të shohim një shembull nga përmbledhja e tefsirit të hoxhë Hafiz Ali Korçës. Në tefsirin e ajetit kur'anor:

مَنْ إِذَانِهِمْ فِي أَصْبَعِهِمْ تَجْعَلُونَ وَبَرْقٌ وَرَعْدٌ ظَلَمْتُ فِيهِ السَّمَاءِ مَنْ كَصَيْبٍ أَوْ

([البقرة: 19] بِالْكَافِرِينَ مُحِيطٌ وَاللَّهُ الْمَوْتِ حَذَرَ الصَّوَاعِقِ

“Ose shembulli i tyre është si ndonjë shi i rreptë prej së larti në errësirë, me bubullimë e me vetëtimë, e prej frikës së vdekjes, nga rrufeja, ata vejnë gishtat në veshët e tyre. Po Allahu është rrethues i mosbesimtarëve (Atij nuk mund t’i shpëtojë askush)”.⁴¹⁰ Hoxhë Hafiz Ali Korça thotë: “Shiu i rreptë dhe retë nënkuptojnë imanin dhe Kur’anin, errësira dhe bubullima nënkuptojnë veprat e rënda, si p.sh., namazi, agjërimi, xhihadi kundër jobesimtarëve, largimi nga fetë e vjetra dhe nga pozitat e kësaj bote, gjë që është shumë vështirë për ta. Kur dëgjonin çështje të tilla të ahiretit që i ngjanin rrufesë dhe bubullimës, jobesimtarët i vënin gishtat në veshët e tyre që të mos i dëgjojnë”.⁴¹¹

5. QËNDRIMI I HOXHË HAFIZ ALI KORÇËS NDAJ ISRAILIAETEVE

Ndër çështjet që kanë rëndësi të madhe për temën time dhe për doktrinën fetare reformiste të hoxhë Hafiz Ali Korçës, padyshim është edhe çështja e rrëfimeve të hebrenjve dhe të krishterëve, që në Sheriatin Islamik në përgjithësi dhe në tefsir në veçanti, njihen dhe quhen dhe me emrin: “israiliate”. Siç dihet, ndër parimet racionale ose nga disiplinat e nevojshme të tefsirit të Kur’anit Fisnik, sipas ithtarëve të shkollës

⁴⁰⁹ Më gjerësisht rreth kësaj çështje sensitive shih: Ebu Is’hak Shatibi “**El-Muvafakat fi Usulush-Sheriati**”; vëll. 3, f. 346-359; dr. Muhamed Husejn Dhehebi, “**Et-Tefsir vel-Mufessirunë**”; vëll. 2, f. 261-280; Fehd ibn Abdurrahman Er-Rumi, “**It-Tixhahatut-Tefsir fil-Karnir-rabi’ asher**”; vëll. 1, 407-412; Muhamed Abduladhim Zerkani, “**Menahilul-irfan fi ulumil-Kur’an**”; vëll. 2, f. 89-93; dr. Jusuf El-Kardavi, “**El-Merxheijjetul-ulja fil-Islam lil-Kur’an ves-Sunneti**”; f. 315.

⁴¹⁰ El-Bekare, 19.

⁴¹¹ Hafiz Ali Korça, “**Kur’ani i Madhnushëm e Thebi i Tij**”; 11.

reformiste racionale është çështja e refuzimit kategorik të israiliateve dhe mbështetja vetëm në atë që thuhet në Kur'an dhe Sunnet autentik.⁴¹²

Hoxhë Hafiz Ali Korça kur shqyrton dhe kritikon mendimin ateist dhe komunist të elitës intelektuale të shqiptarëve laikë, tërheq vëmendjen e lexuesve të devotshëm muslimanë, duke thekruar se ekzistojnë hoxhallarë, ligjërues e hatibë që nuk e kuptojnë fare se çfarë ishin duke iu thënë njerëzve gjatë ligjëratave dhe vazeve të tyre. Madje, Shejh Hafiz Ali Korça rrëfen një ngjarje me një hatib, i cili ka hypur në minber dhe ka filluar të bërtasë me zë të lartë në dersin e tij, para të pranishmëve, duke përmendur tregime e bestytini israiliatesh rreth krijimit të Ademit, rreth mënyrës së formimit të lumenjve në Xhennet dhe rrëfimeve tjera që aspak s'kanë lidhje me fenë tonë.

S'do mend që Hoxhë Hafiz Ali Korça është prekur nga sjellja e tillë naive, ndaj dhe në enciklopedinë e tij (Historia e shenjte dhe të katër halifetë) thekson se për një hoxhë sikur ky që e përmend, mjafton për të Kur'ani Fisnik dhe njohuritë më elementare gjeologjike mbi shtresat e tokës dhe mënyrën e krijimit të lumenjve, dhe nuk kishte arsye për të rrëfyer tregime të tilla të kota në dersin e tij. Në këtë libër hoxha bën apel që të largohemi nga rrëfimet e tilla hebraiko-krishtere, ngase ata kanë shkatërruar fenë e muslimanëve.⁴¹³

6. IXHTIHADI DHE MENDIMI REFORMIST I HOXHË HAFIZ ALI KORÇËS

Ixhtihadi dhe përpjekja e Hafiz Ali Korçës (Zoti e mëshiroftë!) në përgatitjen e këtij traktati metodologjik mbi besimin e muslimanëve ka ndikuar që pesë kushteve të njohura të Islamit që janë: Dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është Pejgamber i Zotit; Falja e namazit; Dhënia e zeqatit; Agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e haxhit sipas mundësisë-ashtu siç është transmetuar nga Abdullah ibn Omeri r.a. në hadithin e gjatë të Xhibrilit me Pejgamberin a.s.⁴¹⁴ ...t'ua shtojë edhe kushtin e gjashtë. Dhe ky kushti i gjashtë, sipas hoxhë Hafiz Ali Korçës, është xhihadi në rrugë të Zotit.

⁴¹² Shih më gjerësisht mbi metodën e Muhamed Abduhusë në tefsir: Muhammed Husejn Edh-Dhehebij, **“Et-Tefsir vel-Mufessirunë”**; vëll. 2, f. 410-411; Fehd ibn Abdurrahman Er-Rumi, **“Menhexhul-Medresetil-Akljijetel-Islahijjeti fit-Tefsir”**; f. 100-130.

⁴¹³ Hafiz Ali Korça, **“Historia e shenjtë dhe të katër Halifetë”**; 28-29,

⁴¹⁴ Transmetuar nga Imam Muslimi në **“Sahihun”** e tij, Nr. 7, vëll. 1, f. 37.

Më duket se gjatë studimit të rrethanave politike, shoqërore e fetare të Hoxhës dhe duke u mbështetur në realitetin e hidhur të kohës së tij, vërehet se ai ka punuar që të mbjell në zemrat e bashkëvendasve të tij dashurinë për vatanin, sakrifikimin dhe mbrojtjen nga intrigat e armiqve. S'ka dyshim se kjo çështje është e ndjeshme dhe ka nevojë për një elaborim.

Ideja se pesë shtyllat e Islamit kanë nevojë edhe për xhihadin si shtyllë e gjashtë e tij; është çështje diskutabile që ka nevojë për një studim më të gjerë. E vërteta është se s'duhet të shtohet diçka në atë që kanë vendosur muslimanët unanimisht, por siç dihet, dijetarët duhet të bëjnë ixhtihad në çdo kohë dhe çdo vend. Dijetarët po ashtu duhet të përcjellin lëvizjen e jetës shoqërore e fetare dhe se obligohen të gjejnë alternativa ose ilaç nga farmacia islame⁴¹⁵ për shërimin e sëmurjeve të Ummetit islam dhe ballafaqimin me sfidat e kohës. Dera e ixhtihadit është e hapur deri në Ditën e Kijametit.

Unë mendoj se rrethanat e atëhershme kishin ndikuar në shpirtin dhe mendjen e hoxhës dhe kur vërente se njerëzit ishin lodhur e rraskapitur dhe ishin larguar nga ky obligim, ai bënte apel për rikthimin e këtij obligimi dhe për bashkëngjitjen e tij në pesë shtyllat e njohura të Islamit. Mirpo ato rrethana nuk e arsyetojnë mendimin dhe ixhtihadin e Hafiz Ali Korçes, sepse hoxha ka bërë dicka që Muhamedi a.s. nuk e ka bërë e as shokët e tij, përkundër vuajtjeve dhe persekutimeve dhe rrethanave të vështira fetare, politike dhe ekonomike. Ixhtihadin dhe mendimin e Hafiz Ali Korçes duhet kuptuar dhe komentuar me xhihadin e lapsit dhe të diturisë, me xhihadin e epshit dhe të pasurisë, e jo xhihadin dhe luftën e përgjakshme, dhe s'do mend se ky mendim bazohet në parimet islame, burime Kur'anore dhe ato profetike. Të shtohet diçka mbi pesë shtyllat e Islamit nuk është e lejuar, ngase në këtë mënyrë pasardhësit do të anulojnë ose shtojnë parime të besimit apo Sheriatit në bazë të nevojave dhe sfidave të kohës. Xhihadi është temë speciale që Kur'ani dhe Syneti e kanë shqyrtuar detalisht sipas konditave dhe rrethanave specifike, në çdo vend dhe në çdo kohë. Këtu nuk mundemi të zgjerohemi më tepër, dhe Allahu e di me mirë për qëllimin dhe nijetin e Hafiz Ali Korçes.⁴¹⁶

⁴¹⁵ Shprehjen mjaft të qëlluar dhe elokuede **“ilaç nga farmacia islame”**, e kam dëgjuar nga prof.dr. Jusuf El-Kardavi (Zoti e ruajtë!) në ligjëratën e tij të xhumasë të mbajtur në xhaminë e Universitetit Ndërkombëtar Islamik në Malajzi, gjatë vizitës së tij të fundit në vitin 1998.

⁴¹⁶ **“Myslimanija”**; f. 5, 7, 8, 9, 10, 17.

IV: KUSHTET E MUFESIRIT NË PERSONALITETIN HOXHË HAFIZ ALI KORÇËS⁴¹⁷ DHE ASPEKTET E PËRBASHKËTA NË MES MENDIMEVE TË TIJ DHE TË SHKOLLËS REFORMISTE

1. KUSHTET E MUFESIRIT NË PERSONALITETIN HOXHË HAFIZ ALI KORÇËS

Dhe në fund, pas këtij rrugëtimi shkencor që e kalova me hoxhën e nderuar Hafiz Ali Korça dhe, para se të gjykoj për suksesin apo dështimin e tij, dëshiroj që t'i përgjigjem një pyetjeje shumë të rëndësishme: “A i posedonte ky mendimtar shqiptar kushtet dhe kualifikimet e mufesirit, komentuesit të Librit të Zotit të Madhërishëm, dhe nëse i posedonte, atëherë cili ishte niveli i tyre?” Pa kurrfarë hiperbolizimi të gjërave përgjigjja është:

Siç duket, pas studimit të mendimeve të këtij thirrësi në fe dhe metodës së tij, ai posedonte pasuri të madhe dhe të mjaftueshme të shkencave islame (falënderimi i qoftë Zotit!) për të pasur kapacitete dhe mundësi që ta komentojë Librin e Zotit të Madhërishëm, dhe kjo pasuri shkencore e tij karakterizohet me këto dimensione:

- Hifzi, leximi dhe texhvidi i Librit të Zotit të Madhërishëm, dhe ky fenomen siç thamë edhe më parë, ishte shumë i përhapur në mesin e dijetarëve shqiptarë në të kaluarën, ndërsa sot, ka një ekzistencë relative;
- Njohja e tij e gjuhës arabe në mënyrë të gjerë dhe të thellë, përkatësisht njohja e thellë e gramatikës, retorikës, stilistikës e veçanërisht e prozodisë, ngase ai ishte edhe profesor i letërsisë;
- Njohja e tij e Synnetit, dhe njohja e haditheve të vërteta nga të pavërtetat;
- Njohja dhe diapazoni i gjerë në shkencat e Kur'anit, si p.sh.: Njohja e ajeteve mekase, medinase, shkaqet e zbritjes së Kur'anit, nasih, mensuh, mutlak, mukajjed, am, has, stilet retorike të Kur'anit, zbritja e parë dhe zbritja e fundit, muhkem, muteshabih, etj.;

⁴¹⁷ Shihi këto kushte dhe krahasoi me kushtet e Imamit Muhamed Abduhusë që i ka theksuar shejh Muhammed Abduladhim Zerkani në “**Menahilul-irfan fi Ulumil-Kur'an**”; vëll. 2, f. 62-64.

- Morali i lartë i tij islam dhe edukata e shëndoshë islame që posedonte, bënë që ai të mos ketë gjuhë triviale e as të fëlliqur, përpos kur i kritikonte ashpër hebrenjtë dhe të krishterët dhe pa kurrfarë ngurrimi referonte për intrigat e tyre gjatë historisë njerëzore e deri në ditët e sotshme.

Të gjitha këto njohuri të ndryshme shkencore që i posedonte ky mendimtar i shquar islam dhe që i mundësuan të merret me komentimin e Kur'anit Fisnik, i kanë ndihmuar që në mënyrë precize të kuptojë Librin e Zotit të Madhërishëm, dhe besoj se me sukses e ka kryer këtë mision sublim.

Këtë dhunti Zoti ia jep kujt të dojë dhe vetëm Atij i takojnë Vlerat dhe Virtytet e Larta dhe të Përkryera!

2. ASPEKTET E PËRBASHKËTA NË MES MENDIMEVE TË HOXHË HAFIZ ALI KORÇËS DHE PARIMEVE TË SHKOLLËS REFORMISTE

Në këtë pikë dëshiroj të theksoj në mënyrë shumë përmbljedhëse disa mendime të hoxhë Hafiz Ali Korçës me parimet dhe elementet e shkollës reformiste:

- Thirrja e tij në korrektimin dhe reformimin e metodave edukativo-arsimore në përgjithësi dhe atyre fetare në veçanti, që në të vërtetë ishin të njëjtat parime për të cilat thërrisnin edhe prijësit e shkollës reformiste, gjegjësisht reformat në metodat e Universitetit të Az'harit;
- Mësimi i lëndëve shkencore krahas lëndëve fetare në mënyrë precize dhe hapja e fakulteteve të posaçme për qëllime të tilla;
- Korrektimi i metodave të mësimi të gjuhës arabe, dhe në këtë kontekst, hoxhë Hafiz Ali Korça preferonte metodën franceze në mësimin e gjuhës;
- I ftonte hoxhallarët që të pajiseshin me njohuri shkencore, ashtu siç kishin vepruar ithtarët e reformizmit fetar arab klasik dhe modern, si p.sh.: Imam Gazaliu, Xhunejdi, Ibni Sinâ, Muhamed Abduhu, Xhemaludin Afgani, etj.;
- Refuzimi kategorik i israiliateve dhe mospranimi i tyre në mënyrë të prerë, si dhe kërkesa e tij e vazhdueshme që të jemi të kujdesshëm në këtë çështje;
- Refuzim kategorik i imitimit të verbër;

- Qëndrimi i tij ndaj ngjarjes së sihrit të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe mospranimi i hadithit të vërtetë (sahih);
- Përqëndrimi i tij në çështje kombëtare dhe politike botërore;
- Përcjellja e ngjarjeve që ndodhnin në Indi dhe masakrimi, vrasja e maltretimi i muslimanëve në kohën e sundimit të tiranit Mahatma Gandhi, dhe përqëndrimi i tij në aktivitetet e Ahmed Ebu Kelamit (i njohur me nofkën Sir. Ahmed Han);
- Mos brengosja e tij e madhe nga rënia e shtetit osman dhe mos hulumtimi i tij për ta shpëtuar nga shkatërrimi. Ky qëndrim ekzistonte edhe në mesin e prijësve të shkollës reformiste në Az'har, madje disa prej tyre deklarorin prioritetin e hilafetin kombëtar arab dhe përparësinë e tij!!!

I mbështetemi Zotit të Madhërishëm të na mbrojë nga kjo ide, e cila nuk ka fare dyshim se kishte gjurmë negative, e që ishin rezultat i fanatizmit racor e nacionalist.

3. SHEMBULL NGA HORIZONTI FETAR REFORMIST KOMBËTAR NË MENDIMIN E HOXHË HAFIZ ALI KORÇËS

Kjo e vërtetë vërehet në kujdesin e tij të posaçëm për mbrojtjen e parimeve të Islamit në Shqipëri, dhe në kujdesin për t'u mbrojtur nga intrigat e kundërshtarëve. Ky kujdes i tij specifik vërehet në letrën e tij të gjatë e të hapur drejtuar vëllezërve të tij dijetarë e hoxhallarë të Shqipërisë. Ne këtu do t'ju ofrojmë një ilustrim të shkurtë nëpërmes disa citateve nga letra e tij:

“Zotërinj, dijetarë e hoxhallarë, nëse dëshironi të përfitoni respektin e popullit ashtu si paraardhësit tuaj, atëherë duhet t'i përgatitni fëmijët tuaj me të njëjtën armë me të cilën ishin të armatosur paraardhësit tuaj, gjegjësisht me armën e diturisë dhe shkencës, ngase kjo është trashëgimia jonë dhe këtë trashëgimi duhet t'ua lëmë fëmijëve tanë... Populli nuk mund të dëgjojë më trillime, israiliate dhe fjalë boshe. Turp për ne është që të krenohemi me paraardhësit tanë kur ne jemi lakuriqë dhe nuk posedojmë asgjë. Çfarë dobie do të ketë shteti nga ata të cilët edukohen jashtë vendit tonë?! (Ka për qëllim intelektualët që studionin në Perëndim, H. Hoxha.)

Vëllezër e zotërinj, dijetarë e hoxhallarë!

Nëse keni dashuri dhe ashk ndaj Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) mos rrini në gjumë dhe patjetër të mendoni për gjeneratat e ardhshme si dhe medoemos të koncentroheni dhe të keni kujdes ndaj këtyre gjërave:

- 1. Mos dorëzohen të rinjtë dhe të rejat në duart e misionarëve dhe të atyre që i bëjnë të krishterë;*
- 2. Leximi dhe mësimi përmendësh i Kur'anit të jetë për çdo fëmijë, qoftë djalë apo vajzë;*
- 3. Obligohemi që të dërgojmë në shkollën fetare çdo fëmijë që ka mbushur trembëdhjetë vjet;*
- 4. Çdo thirrës në fëmijë patjetër të ketë më së paku një fëmijë në shkollën fetare që të bëhet trashëgimtar i tij;*
- 5. Çdo musliman dhe çdo muslimane duhet të sakrifikojë çdo gjë që e posedon në përmirësimin dhe zhvillimin e shkollës fetare që të ketë nivelin e merituar;*
- 6. Dijetarët dhe hoxhallarët duhet të udhëtojnë nëpër fshatra e qytete për ta nxitur popullin që të ofrojë ndihmë dhe ta përkrahë këtë projekt;*
- 7. Të pasurohet buxheti i shkollës, të sigurojmë profesorë dhe hoxhallarë specialistë për çdo lëndë; dhe:*
- 8. Nëse nuk ndodhë kështu, interesi i dijetarëve dhe hoxhallarëve për gjendjen e Ummetit, do të humbë dhe kjo do të ishte arsyeja kryesore e rrënimit dhe shkatërrimit të Islamit. Këto janë sëmurjet tona dhe kjo është mënyra e shërimit në këtë situatë mjekësore. Në kohën e abasidëve, dijetarët dinin gjashtë ose shtatë gjuhë, ndërsa ne sa gjuhë njohim?*

Këto janë burimet për të cilat folëm. Dërgoni fëmijët tuaj trembëdhjetë vjeçar për të mësuar te ne dhe unë ju siguroj, me lejen e Zotit, se pas tre vjetëve ata do të kenë mundësi të flasin arabisht, persisht dhe frëngjisht, si dhe do të mësojnë disa lëndë shkencore e artistike. Ne do të përpiqemi që të mos turpërohemi para Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në Ditën e Gjykimit dhe nëse nuk na ndihmoni në atë që thamë më lartë, do të përgjigjemi para Zotit në Ditën e Kijametit.

Si t'i armatosim dhe përgatisim fëmijët tanë?

Krahas gjuhës amtare dhe gjuhës arabe, secili obligohet të mësojë një gjuhë të njohur botërore dhe të armatoset me armën e diturisë në bazë

të nevojave të kohës dhe ardhmërisë, ngase në të kundërtën do të jemi të vdekur në çdo aspekt...”⁴¹⁸

Zoti e mëshiroftë Hafiz Ali Korçën!

Sa e madhe është nevoja e Ummetit islam për këto këshilla këtyre ditëve...

S’ka fuqi më të Madhe se Fuqia e Zotit të Madhërishëm!

4. DISA LËSHIME METODOLOGJIKE DHE FETARE TË HOXHË HAFIZ ALI KORÇËS

Të nderuar lexues!

Po e përfundojmë takimin tonë me këtë dijetar të madh (Zoti e mëshiroftë!), duke i theksuar disa lëshime të tij metodologjike e tematike:

- Në shumë raste vërej se ai (Zoti e mëshiroftë!) nuk e tregon faqen apo vëllimin prej të cilit citon;
- Detaje mbi të dhënat e burimeve dhe literaturës së përdorur nuk ekzistojnë, por i thekson vetëm titujt e librave;
- Mbështetje e kufizuar në hadithe të vërteta profetike (sahih) gjatë argumentimit në artikuj dhe shkrime;
- Refuzimi i autenticitetit të ngjarjes së sihrit që është transmetuar në “Sahihun” e Imam Buhariut dhe Muslimit, dhe në këtë mënyrë thumbon librin më autentik pas Kur’anit Fisnik, gjegjësisht librin për autenticitetin e të cilit i gjithë ummeti ka qëndrim unanim. Mendoj se hafizi i nderuar, është dashur që të jetë i kujdesshëm para se të gjykojë për të. Ky ishte lëshimi më i madh metodologjik dhe fetar që kishte bërë hoxhë Hafiz Ali Korça, dhe do të ishte më mirë për të sikur të kishte folur në përputhje me hadithin e refuzuar, i cili kishte të bëjë me sihrin;
- Nuk i thekson numrat e ajeteve që i komenton;
- Në të shumtën e rasteve neglizhon tekstin e Kur’anit në gjuhën arabe, duke theksuar vetëm në përkthim e komentim pa e pasur përpara tekstin arab. Në raste të tilla, përparësi ka teksti arab, pastaj përkthimi dhe komentimi; dhe:
- Në shumë raste nuk dallon mes përkthimit dhe komentimit të tekstit, dhe kështu, lexuesi i rëndomtë nuk mund të dallojë nëse

⁴¹⁸ Zani i Naltë, nr. 8, maj, 1924; (238-246)

është ajeti i përkthyer apo i komentuar. Preferohet dhe më me prioritet do të ishte sikur të përkthente ajetin dhe pastaj ta komentonte e sqaronte.⁴¹⁹

Këtë e vërejta gjatë studimit tim të këtij personaliteti dhe mufessiri të njohur intelektual shqiptar reformist, dhe ky studim më duhet të pranoj, se më mori shumë kohë, duke tubuar material nga burime të ndryshme e të ndara.

Shpresoj se me ndihmën e Zotit të Madhërishëm dhe të Gjithëfuqishëm realizova me sukses qëllimin tim për hir të Zotit!

Falënderimi dhe lavdërimi i takon vetëm Zotit të botëve!

⁴¹⁹ Ismail Ahmed, “**Hafiz Ali Korça-Jeta dhe Vepra**”; 209-221.

الاتجاه العلمي الفلسفي و الاتجاه العلمي التجريبي في
تفسير القرآن الكريم

PJESA E TRETË

**DOKTRINA FILOSOFIKE DHE AJO
EKSPERIMENTALE E STUDIMEVE KUR'ANORE TE
SHQIPTARËT**

KAPITULLI I PARË

**DOKTRINA FILOSOFIKE NË RELACION ME DISA
ÇËSHTJE KUR'ANORE TE SHQIPTARËT**

KAPITULLI I DYTË

**DOKTRINA SHKENCORE EKSPERIMENTALE, E ILUSTRUAR
ME STUDIMET E MJEKUT Prim. Dr. Sci Med. ALI FAHRI
ILJAZI**

KAPITULLI I PARË

DOKTRINA FILOSOFIKE NË RELACION ME DISA ÇËSHTJE KUR'ANORE TË ILUSTRUARA ME MENDIMET E HOXHË HASAN TAHSIN EFENDIUT

I: HYRJE NË GJENEZËN HISTORIKE TË KËTYRE DY DOKTRINAVE TE DIJETARËT SHQIPTARË

Historia e këtij drejtimi te shqiptarët fillon që nga gjysma e dytë e shek. XIX, kjo në bazë të shënimeve që gjenden në artikuj, shkrime e disa hulumtime shkencore rreth këtij drejtimi me dy tehe: shkencor filosofik dhe shkencor eksperimental. Nuk ka pasur ndonjë punim që është marrë me këtë çështje, ngase ende nuk ishte formuar si drejtim me karakter të frytshëm shkencor. Për shkak të kësaj të vërtete historike, nuk kemi ndonjë burim ose literaturë të posaçme rreth kësaj çështjeje, përpos revistave periodike dhe revistave islame mujore që i botonte dhe i shpërndante Këshilli Suprem i Sheriatit Islam në Shqipëri,⁴²⁰ ku shkruheshin mendimet dhe idetë e tilla të thella shkencore dhe filosofike.⁴²¹

⁴²⁰ **Kultura Islame;** Nr. 7-8, mars-prill 1944, 173-179. Në këtë numër të kësaj reviste është botuar një artikull tefsiri rreth ajetit:

(وَلَقَدْ خَلَقْنَا الْإِنْسَانَ مِنْ سُلَالَةٍ مِنْ طِينٍ ۖ ثُمَّ جَعَلْنَاهُ نُطْفَةً فِي قَرَارٍ مَكِينٍ ﴿١٣﴾)

ثُمَّ خَلَقْنَا النُّطْفَةَ عَلَقَةً فَخَلَقْنَا الْعَلَقَةَ مُضْغَةً فَخَلَقْنَا الْمُضْغَةَ عِظْمًا فَكَسَوْنَا

الْعِظْمَ لَحْمًا ثُمَّ أَنْشَأْنَاهُ خَلْقًا آخَرَ ۚ فَتَبَارَكَ اللَّهُ أَحْسَنُ الْخَالِقِينَ ﴿١٤﴾) (

[المؤمنون:12-14]

“Për Allahun ne krijuam njeriun prej një ajke (lëngu), e një balte, pastaj atë (ajkë-baltë) e bëmë (e shndërruam) pikë uji (farë) në një vend të sigurt. Më pas, atë pikë uji e bëmë copë gjaku, e atë gjak të ngurtë e bëmë copë mishi, e atë copë mishi e shndërruam në eshtra edhe eshtrave ua veshëm mishin, pastaj atë e bëmë krijesë tjetër (me shpirt). I lartë është Allahu, më i Miri Krijues!” (El Mu'minun, 12-14).

⁴²¹ Shih kumtesat shkencore në **Zanin e Naltë**, përkatësisht Përmbledhjen e kumtesave 10-46, që janë lexuar në takimin shkencor që është mbajtur në Shqipëri në solemnitetin e

Ky drejtim ose kjo metodë shkencore në relacion me Librin e Zotit si nga aspekti i të kuptuarit ashtu edhe nga aspekti i komentimit, vjen si pasojë e drejtimit reformist racional që u zbërthye në kapitullin e kaluar, e që kishte ndikuar, për fat të mirë, edhe në mendimtarët shqiptarë. Mund të thuhet se kjo metodë shkencore është krahu i dytë i mendimit fetar reformist që vërehej nëpër shkrimet e shqiptarëve deri në gjysmën e dytë të shk. XX.⁴²²

Disa nga artikujt e tillë i gjetëm të përkthyer nga gjuhët e tjera, por pjesa dërmuese e tyre ishin shkrime dhe punime origjinale nga truri shqiptar.⁴²³

organizuar me rastin e shtatëdhjetë e pesë vjetorit të botimit të revistës së njohur islame **“Zani i Naltë”**, e cila ishte revistë fetare, filosofike, etike e sociale. Numri i parë i saj u botua në vitin 1924 dhe vazhdoi të botohet deri në vitin 1939, pastaj është ndërprerë nga pushteti laik. Më vonë ka nisur përsëri të botohet, por me tjetër emër: **“Kultura Islame”**.

⁴²² Këtë fenomen mund ta gjejmë edhe në revistat dhe periodikët islamë shqiptarë në Kosovë, si p.sh., në revistën **“Edukata Islame”** Nr. 37-38, 1983 (12-18); Nr. 46-47, 1986 (3-8); Nr. 33-34, 1982, (15-21).

⁴²³ **VËREJTJE E RËNDËSISHME:** Thamë se ishin produkt origjinal i trurit shqiptar, me qëllim që t'i dallojmë nga punimet jo origjinale, të cilat nuk do të jenë pjesë e disertacionit tim. Përveç kësaj, edhe titulli i këtij disertacioni nuk na lejon që t'i fusim studimet e tilla të përkthyer, ngase këtu do të studioj shkrimet dhe studimet origjinale kur'anore nga autorë shqiptarë e jo përkthime, edhe pse përkthimet e tilla kanë lidhje të ngushtë në hulumtimin tim. Nuk ka fije dyshimi se autorët e veprave të përkthyer meritojnë respekt e nder të madh për punën e tyre, dhe përkthimet e tilla bëjnë pjesë në grupin e studimeve kur'anore dhe studimeve të tefsirit. Në vijim do t'i theksoj titujt e studimeve të përkthyer që nuk janë përfshirë në këtë hulumtim:

- E nxora jashtë studimit tim librin e tefsirit të përkthyer me titull **“Esbabun-nuzul”** i Imam Vahidiut që i takon doktrinës tradicionale të tefsirit. Kështu i përshkruan prof.dr.Fehd Er-Rumi në librin e tij **“It-tixhahut-tefsir fil-karnir-rabi'asher”**; vëll. 1, f. 45. Në gjuhën shqipe është përkthyer nga gjuha boshnjake me titull: Jusuf Ramiq, **“Shkaqet e shpalljes së Kur'ani Kerimit”**; përktheu Bahri Aliu, 1992. (Ed-Darul-Alemijjetu lil-Kitabil-Islami, Rijad, Arabia Saudite).

- Nga studimi im kam mënjanuar edhe Kur'anin e përkthyer dhe të komentuar në gjuhën shqipe nga një autor pakistanez i sektit të devijuar dhe destruktiv - kadijanit. Ky përkthim dhe ky koment është përplot kufër dhe shirk, devijime e shkatërtime. Ky përkthim është përgatitur për t'i humbur dhe devijuar muslimanët shqiptarë në Perëndim, Shqipëri, Kosovë e gjetiu. Edhe profesori Emin ef.Behrami ka një studim të vlefshëm kritik rreth këtij përkthimi dhe tefsiri të devijuar dhe destruktiv në gjuhën shqipe. Edhe pse ky përkthim në gjuhën shqipe ka rëndësi studimi, por nuk është produkt i dijetarëve dhe mendimtarëve shqiptarë, dhe meqë nuk është prodhim i shqiptarëve, nuk mund të jetë pjesë e studimit tim. Titulli i këtij tefsiri të përmbledhur është: Muhammad Zakaria Khan, **“Kur'ani i Shenjtë, arabisht-shqip-përkthim dhe komentim”**; 1990; Islam Publications LTD, Islamabad Sheephatch Lane Tilford, Surrey, GU 10-2 AQ, UK.

Punimet shkencore që botoheshin në këto revista periodike islame, kishin për qëllim të tregonin urtësinë dhe mrekullinë shkencore të Kur'anit Fisnik, përmes jetësimit të obligimeve dhe parimeve, të cilat Zoti i Madhërishëm i ka shpallur në Kur'anin Fisnik dhe i ka obliguar njerëzit që t'i kryejnë në mënyrën sa më të mirë. Lloji i studimeve të tilla, dhe natyra e temave kishin të bënin me tefsirin dhe komentimin e ajeteve që ndalonin verën, mishin e derrit dhe dëmet që dalin nga pirja e duhanit, etj...

Pastaj, këto komentime verifikoheshin me raportet e mjekëve specialistë në shkenca moderne, për të qenë sa më afër urtësisë së parimeve hyjnore legjislativë. Punimet e tilla shqyrtonin edhe tematika filosofike të thella, si dhe studionin mendimet e filosofëve të mëdhenj klasikë muslimanë rreth sufizmit, logjikës, ateizmit dhe ekzistencës, si

- Po ashtu e distancova nga studimi im edhe Kur'anin e përkthyer nga anglishtja në shqip, autorët e të cilit janë dr. Tekijjuddin Hilali dhe dr. Muhsin Han. E distancova për shkak të arsyeve që i përmenda pak më parë rreth përkthimit të Muhammad Zakaria Khanit. Titulli i këtij Kur'ani të komentuar është: **“Shpjegimi i kuptimeve të Kur'anit të Lartë në gjuhën shqipe”**; përmbledhur në një vëllim, nga dr. Muhamed Takiud-din El-Hilali dhe dr. Muhamed Muhsin Khan (Përkthyer në shqip nga një grup përkthyesish pranë Darus-Selam, Shtëpia botuese dhe shpërndarëse, Rijad, Arabia Saudite, 2000).

- Për arsye të sipërpërmendura distancova nga studimi im edhe librin e Sejjid Kutubit, **“Et-Tesvirul-fennij fil-Kur'anil-Kerim”**- të përkthyer në gjuhën shqipe nga Omer Musa me titull: **“Ilustrimi artistik në Kur'an”**; Logos-A, Shkup, 1996.

- Edhe tefsirin **“El-Muntehab fi tefsiril-Kur'anil-Kerim”**, të botuar në Egjipt nga Ministria e Vakëfit, dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga Haxhi Selim Stafa, nuk e shtyra në këtë studim. Ky tefsir quhet, **“Përzgjedhje në komentimin e Kur'ani Kerimit”**; Komuniteti Musliman i Shqipërisë, Komiteti i Botës Islame, përktheu nga origjinali Haxhi Selim Stafa, Tiranë, 1998.

- Po ashtu e tërhoqa edhe tefsirin e sures **“Jasinë”** nga tefsiri **“Fi Dhilalil-Kur'an”** i Martirit Sejjid Kutub, i përkthyer në gjuhën shqipe nga prof. Muhamed ef. Mustafa me titull: **“Jasini“-përkthim dhe komentim”**; Logos-A, Shkup, 1999.

- Nga ky disertacion distancova edhe librin **“Edh-Dhahiretul-Kur'anijjetu”**, nga autori Malik ibn Nebi, në gjuhën shqipe **“Fenomeni Kuranor”**; Mitrovicë 1997.

- Njësoj veprovë edhe me librin e përkthyer në gjuhën shqipe **“El-Kur'an, Muhaveletu li fehmin asrijjin”**; nga Mustafa Mahmudi, në shqip me titull: **“Kur'ani përpyekje për të kuptuarit bashkëkohor”**; Mitrovicë 1997.

- Po ashtu ndodhi edhe me librin e përkthyer në gjuhën shqipe, **“El-Kur'an vel-Ilmu”**; nga Dr. Maurice Bucaille, me titull: **“Kur'ani dhe shkenca”**; Prishtinë 1996; si dhe:

- Me librin e përkthyer në gjuhën shqipe nga prof. Mr. Qemajl Morina **“Mu'xhizetul-Kur'an”**, i Shejh Muhammed Mutevel-li Sha'ravi; me titull: **“Mrekullia Kur'anore”**; botuar nga Dituria islame, Prishtinë 1996.

p.sh., filosofët El-Kindi, El-Farabi, Ibn Rushd, Ibn Sinâ dhe Imam Gazaliu.

Këtu jemi të obliguar që t'i zbërthejmë këto dy metoda shkencore dhe filosofike, përmes punimeve të mendimtarëve dhe dijetarëve shqiptarë, dhe të theksojmë disa personalitete të njohura shqiptare që jetuan në shek. XIX dhe në shek. XX, në mënyrë që t'i kuptojmë rrethanat historike që ndikuan në formimin e këtij fenomeni dhe personalitetet që u prijnë këtyre dy metodave.

Njëri nga dijetarët e tillë shqiptarë u takua me udhëheqësit e shkollës reformiste islame, gjegjësisht me Shejh Xhemaludin Afganin dhe Shejh Imam Muhamed Abduhunë, dhe jetoi në periudhën kohore, kur në Evropë mbizotëronte iluminizmi francez. Në të njëjtën kohë, lëvizja e reformistëve kishte filluar të përhapet edhe në Universitetin e Az'harit. Studimi i doktrinës shkencore filosofike, do të na ndihmojë ta kuptojmë këtë hoxhë reformist dhe dijetar shqiptar, i cili i kishte tejkaluar bashkëkohësit e vet, mendimtarë dhe hoxhallarë të shtetit osman në shkenca të ndryshme humane, dhe këtë dhashtë Zoti, qartë do ta vërejmë në biografinë e tij.

II: NJOHURI MBI JETËN, ARSIMIMIN DHE VEPRIMTARINË E HOXHË HASAN TAHSIN EFENDIUT ⁴²⁴

Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu u lind në fillim të shek. XIX, në vitin 1811⁴²⁵ në Janinë, përkatësisht në fshatin Ninat të komunës së Filatit, në Juglindje të Shqipërisë, në krahinën shqiptare të Çamërisë, që aktualisht ndodhet nën uzurpimin dhe okupimin e Greqisë. I ati i tij ishte gjykatës fetar, andaj mësimet e para i mori tek i ati i tij. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa studimet universitare i mbaroi në Stamboll, ku edhe diplomoi me sukses të lartë.

Mbi diturinë dhe jetën e Hoxhë Hasan Tahsin Efendiut më mirë na rrëfen nxënësi i tij, eruditi i njohur dhe hulumtues i madh shqiptar në

⁴²⁴ Mbi jetën dhe mendimin e këtij hoxhe me ide perëndimore dhe iluministe, kanë shkruar shumë hulumtues shqiptarë, turq e perëndimorë në enciklopedi të ndryshme fetare e shkencore. Në Shqipëri është formuar një shoqatë humanitare kulturore shqiptaro-turke me emrin e këtij hoxhe. Kjo shoqatë ka organizuar në Tiranë, në bashkëpunim me drejtorin e **Institutit Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam (AIITC)** dr. Ramiz Zekaj, organizoi një Konferencë Ndërkombëtare rreth mendimit dhe aktiviteteve të këtij hoxhe, më 20.12.1997, ku prezantuan shumë personalitete të njohura fetare islame, joislame e kombëtare. Më pas, drejtori i Institutit i ka botuar artikujt, hulumtimet dhe punimet e Konferencës në formë të librit, që të jenë edhe në duart e lexuesve në përgjithësi. Kisha nderin që ta vizitoj drejtorin e shoqatës humanitare kulturore shqiptaro-turke, prof. Ibrahim D. Hoxha në shtëpinë e tij në Shqipëri, për të më ofruar ndihmë titujsh, burimesh dhe literature të rëndësishme për studimin tim. Titulli i librit që përmban punimet e konferencës quhet: Ibrahim Daut Hoxha, **“Hoxhë Hasan Tahsini-të tjerët për të”**; Tiranë, 1998.

VËREJTJE: Duke marrë parasysh mungesën e burimeve dhe literaturës së mjaftueshme në Shqipëri rreth mendimeve të Hoxhë Hasan Tahsin Efendiut, unë do ta elaboroj personalitetin e tij nëpërmes veprave dhe hulumtimeve të kësaj Konference Ndërkombëtare, ku vërtet ka punime shumë të rëndësishme të përkthyer nga gjuha turke dhe gjuhë të tjera në gjuhën shqipe. Ndër nxënësit më të njohur të Hoxhë Hasan Tahsin Efendiut ishte autori, letrari, enciklopedisti dhe eruditi shqiptar Shemsedin Sami Bej Frashëri, autor i enciklopedisë letrare e shkencore mjaft të njohur në gjuhën osmane, me titull **“Kamusul-A’lam”**. Gjithashtu do të mbështetem edhe në studimin e gjerë të hulumtuesit turk, Ömer Faruk Akuni, që është botuar në enciklopedinë fetare turke: **“Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi”**; 198-206. Do të kisha dashur që të mbështetem në veprat origjinale të Hoxhë Hasan Tahsin Efendiut dhe të formoj një pasqyrë më objektive mbi të, por për fat të keq, kjo është e vërteta, ndaj dhe detyrohem që të marr nga të tjerët punime që janë shkruar për të. Ndërsa për shkak të përgjegjësisë dhe objektivitetit shkencor, që në fillim po i informoj lexuesit e nderuar për këtë çështje.

⁴²⁵ Sipas disa versioneve tjera, ai u lind në vitin 1812 ose në vitin 1813. **“Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi”**; 198.

Shtetin Osman, Shemsedin Sami Bej Frashëri.⁴²⁶ Nxënësi i tij rrëfen se Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu vërtetë tërë jetën e vet ia kishte kushtuar hulumtimit shkencor, dhe atë afro gjysmë shekulli. Hoxha i preferonte shkencat humane, dhe nuk i parapëlqente shkencat historike. Shkencat e ndryshme fetare, si p.sh., tefsirin, hadithin dhe lëndët e Sheriatit në përgjithësi, i kishte mësuar nga prindi i vet, pasi që ai kishte qenë dijetar dhe gjykatës fetar. Shumë rrallë mund të gjesh njerëz në mesin e shqiptarëve dhe turqve që njëkohësisht ishin njohës të shkencave fetare dhe shkencave humane. Ndër rastet e tilla të rralla, bën pjesë dijetari në fjalë, gjegjësisht hoxhë Hasan Tahsin Efendiu.

Ai njihnte letërsinë arabe, persiane, osmane dhe atë perëndimore. Kishte shkruar poezi në gjuhën osmane, ashtu siç kishte shkruar edhe studime shkencore matematikore. Atij i pëlqenin dy gjëra: Zgjerimi në shkencë për ta arritur të vërtetën dhe shërbimi njerëzimit, posaçërisht bijve të popullit të vet.

Ai largohej nga takimet ku nuk flitej për njohuri e shkencë, dhe në këtë kontekst thoshte: *“Çka do ta gëzojë të dashurin, nëse në takime nuk hulumtohet dashuria, të cilën e lyp i dashuruari?!”*

Interesat e mëdha kombëtare dhe popullore për të kishin më prioritet se sa interesat e tij personale. Sa herë që i binte në dorë ndonjë para, blinte libra dhe shpesh herë e zinte gjumi duke lexuar libër. Bukë hante vetëm atëherë kur uritej shumë, dhe nuk hante kushedi se çka, por vetëm bukë me djathë. Dhoma e tij ishte përplot libra, instrumente inxhinierike, astronomie e tapia të ndryshme. Ai ishte i preokupuar tepër me gjendjen e ummetit islam, dhe mendonte për format e mënyrat për bashkimin e popujve dhe të mbarë ummetit islam. Dhjetë vjet para vdekjes së tij, themeloi një shoqatë speciale në shkollën e tij private me emër: *“Shoqata gjeografike për bashkimin e popujve muslimanë”*, dhe këtu preferonte përdorimin e termit *“gjeografike”*, me qëllim që të mos nxiste përçarje në mes njerëzve, ndaj preferonte emrin *“gjeografike”* në vend *“muslimane”*. Në këtë kontekst ai thotë: *“Obligohemi që ta përhapim fenë tonë dhe të punojmë në këtë rrugë dhe s’kanë të drejtë evropianët që të na pengojnë, ngase ata vetë dërgojnë misionarë krishterë*

⁴²⁶ Ky letrar dhe mendimtar shqiptar ka përpiluar shumë libra e traktate me tematika të ndryshme në gjuhën arabe, osmane dhe frënge. Traktati i tij më i njohur është **“Himmetul-humam fi neshril-Islam”**. Krahas këtij traktati, ai ka shkruar edhe traktate tjera gramatikore të botuara e të pabotuara. Shih më gjerësisht rreth traktatit të tij të përkthyer në gjuhën shqipe me titull: Sami Frashëri, **“Përpjekja e heronjve në përhapjen e Islamit”**, përktheu nga gjuha arabe prof.dr. Ismail Ahmedi; Logos-A, 2003, Prishtinë, Kosovë, f. 41-43.

në mbarë vendet e botës, dhe për këtë shkak është e natyrshme që edhe ne ta përhapim fenë tonë”.

Në takimet shkencore, ai përqëndrohej në një pikë kryesore, gjegjësisht në çështjen se Sheriati nuk kundërshton në asnjë mënyrë të vërtetat shkencore dhe nuk pengon qytetërimin dhe civilizimin, dhe gjithë këtë e argumentonte me ajete kur'anore dhe hadithe pejgamberike. Ai nuk gjente vend për mendimet dhe idetë e tij në mesin e qarqeve të përgjithshme dhe të posaçme shkencore, ngase disa hoxhallarë dhe imamë të shtetit osman e kritikonin dhe kundërshtonin aq ashpër, saqë autoriteti i tij para njerëzve seriozisht është prekur, dhe kishin filluar ta akuzojnë si heretik dhe të pafe, ashtu siç i ndodhi Muhjiddin ibn Arabiut, Ibni Sinës, Ibn Rushdit, Sokratit, etj.

Mirëpo, ai nuk merrej me thashethemet e njerëzve... dhe vërtet si mundej një njeri i kalibrit të tij të mohojë Krijuesin (Zotin e Madhërishëm) kur ai vetë e njihte shumë mirë Krijuesin?! Shpesh herë njerëzit i braktisnin ligjëratat e tij, ngase zbërthente dhe sqaronte probleme të vështira filosofike dhe ata nuk e kuptonin, e dukej sikur thoshin: *“Mbështetemi në mbrojtjen e Zotit nga devijimet e këtij hoxhe!”* Ai ishte asket dhe e donte diturinë!⁴²⁷

Ministri i Arsimit të shtetit osman, Reshid Pasha, dëshironte të dërgojë një grup studentësh të dalluar në Evropë për të studiuar shkenca të ndryshme humane, dhe për t'i përhapur ato në shtetin osman, ngase shteti osman jetonte në një prapambetje qytetëruese e shkencore, dhe, sipas Ministrit, ky ishte një hap për ta shpëtuar shtetin osman nga shkatërrimi i mëtutjeshëm.

Një grup studentësh u paraqitën për studime të tilla, por vetëm tre prej tyre patën fatin të shkojnë, dhe njeri prej tyre ishte Shejh Hasan Tahsin Efendiu, e si destinacion të tyre kishin zgjedhur Parisin, kryeqytetin e Francës. Dy prej tyre u kthyen në Stamboll, ngase nuk dëshironin të vazhdojnë studimet, ndërsa hoxhë Hasan Tahsin Efendiu vendosi t'i vazhdojë studimet dhe të mësojë kulturën dhe fillofi të ndryshme shkencore franceze. Ai kishte marrëdhënie të mira me ambasadorin turk dhe pati fat që të punësohet në ambasadën e shtetit

⁴²⁷ Në të njëjtin burim shih artikullin e Shemsedin Sami Bej Frashërit të përkthyer nga gjuha turke në shqip, f. 65-73. Shih në të njëjtin burim, në fq. 81, 83, 88, 122-124 dhe 161, dhe shih:

“Türkiye Diyanet İslam Ansiklopedisi”; Cilt, 18, 1998- Baglar Bashë, kisikli caddesi, 7, Üsküdar, İstanbul 192, 200, 201, 202, 203, 205, 206.

osman në Paris, dhe të jetë imam për të punësuarit e ambasadës dhe mësues i fëmijëve të tyre.

Kështu pra, Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu kryente detyrën e imamatit, dhe në të njëjtën kohë edhe studionte në Universitetin e Sorbonës në Paris. Ai qëndroi atje afër gjashtëmbëdhjetë vjet, dhe i mësoi shkencat astronomike dhe ato humane me sukses të dalluar, si p.sh., fizikën, kiminë, gjeografinë, gjeologjinë, astronominë, astrologjinë, psikologjinë, etj.

Kur vdiq një personalitet i lartë diplomatik në Paris, gjegjësisht Sadri-Azemi (kryeministri) - Fuad Pasha, Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu caktohet për larjen e xhenazes së tij, dhe për shoqërimin e kufomës së tij deri në Stamboll. Pasi arrinë në Stamboll, më nuk kthehet në Francë.⁴²⁸

Shteti osman kishte përgatitur dhe projektuar kohë më parë hapjen e një universiteti për mësimin e lëndëve humane, dhe pas kthimit të Hoxhë Tahsinit në Stamboll, i cili kishte fituar një autoritet të lartë në qarqet shkencore, shteti osman e kishte emëruar Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu drejtor-rektor të këtij Universiteti që quhej (دار الفنون) “Darul-Funun” (Shtëpia e Arteve). Pas emërimit të tij drejtor universiteti, ai filloi të kontaktojë me dijetarë të ndryshëm nga bota islame, dhe t’i ftojë në Universitet për të zhvilluar ligjërata të ndryshme para studentëve.

Një herë e kishte ftuar Xhemaludin Afganin që ta caktojë ligjërues në këtë Universitet. Një ditë Xhemaludin Afgani⁴²⁹ kishte mbajtur një ligjëratë shkencore, për të vërtetuar para njerëzve nevojën e frymëmarrjes, ngase asnjë qenie s’mund të jetojë pa të. Ai këtë e ka vërtetuar nëpërmes një eksperimenti: Kishte futur një pëllumb në kafaz, dhe më pas e mbylli kafazin në mënyrë hermetike, dhe pas disa çasteve pëllumbi kishte ngordhur. Kur audienca vërejti këtë sjellje të çuditshme të Shejh Xhemaluddin Afganit, e kritikoi ashpër, duke thënë: “Si mund që Universiteti të lejojë njerëz të tillë që vrasin kafshë të pafajshme?!” Ata thoshin se një gjë e tillë nuk lejohet, dhe se kjo sjellje s’ka lidhje fare me Islamin, duke shtuar se drejtori i këtij Universiteti ka studiuar në Francë dhe për këtë shkak ai është laik, ateist dhe i pafe, andaj ai duhet të shkarkohet nga posti drejtor i Universitetit.

⁴²⁸ Po aty, studim i përgatitur nga hulumtuesi turk Ismail Habib, f. 89-97.

⁴²⁹ Mbi filosofinë iluministe të Xhemaludin Afganit dhe Muhamed Abduhusë, shih Muhamed Amare, “**El-Islamu bejnet-tenviri vet-tezviri**”; Kajro, Darush-Shuruk, bot. 1, 1995, f. 238-268; Nasir Hamid Ebu Zejd, “**Minel-mu’tezileti ve ibni Rushd ila Muhamed Abduhu**”; Mahmud Hamdi Zakzuk, “**Mefhumut-tenviri fi fikri ibn Rushdi**”, Murad Vehbe dhe Muna Ebu Sunne, “**Ibën Rushd vet-tenvir**”- Daruth thekafetil-xhedideti; bot. 1, 1997, f. 105-113, 129-148.

Një herë tjetër, Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu ka kërkuar prej Shejh Xhemaludin Afganit që të zhvilloj një ligjëratë rreth rëndësisë së industrisë dhe t'i sqarojë mendimet e veta, që i kishte shkruar në traktatin e tij: “Er-Reddu aled-dehriijn”(الرد على الدهريين) në gjuhën perse. Në fillim Shejh Afgani kishte kërkuar falje për shkak të mosnjohjes së gjuhës turke, e pastaj ai e kishte sjellë ligjëratën në gjuhën turke dhe ia kishte dorëzuar Ministrit të Arsimit, në çka ai edhe ishte pajtuar dhe kështu Shejh Afgani kishte mbajtur ligjëratën në gjuhën turke para hoxhallarëve dhe dijetarëve.

Në mesin e dëgjuesve të ligjëratës ishte edhe Shejhul-Islami i shtetit osman, Shejh Hasan Fehmi Efendi. Dihet se dijetarët e shtetit osman kishin qëndrim negativ ndaj lëvizjes reformiste fetare, si dhe kundërshtonin pikëpamjet e Shejh Afganit, Shejh Hasan Tahsinit dhe Shejh Muhamed Abduhusë. Prandaj idetë e tyre nuk gjetën vend të merituar në qarqet shkencore. Në ligjëratën e Shejh Xhemaludin Afganit thuhej se “*profecia e asaj që do të ndodhë në të ardhmen është pjesë e artit dhe profesionit specifik*”, dhe në këtë kontekst, audienca i keqkomentoi fjalët e tij, posaçërisht Shejhul-Islami i shtetit osman, dhe përhapën fjalën se Shejh Afgani thotë që profecia është lloj arti ose profesioni. Akuzat e tilla nuk janë të vërteta, ngase ka dallim të madh në mes fjalëve, “profeci” (Et Tenbbu’ë) (التنبؤ) dhe “pejgamberi” (En nubuvvetu), (النبوة) dhe për shkak të kësaj atmosfere, Shejh Afgani detyrohet të udhëtojë në Kajro në vitin 1871 (në vitin 1288 hixhri.). Për shkak të ngjarjes me pëllumbin dhe ngjarjes së fundit, pas qëndrimit një vit si drejtor, Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu shkarkohet nga Universiteti.⁴³⁰

Burimet konfirmojnë se Shejh Hasan Tahsin Efendiu nuk është martuar dhe se ka qenë asket dhe tepër i dhënë pas shkencave astronomike e eksperimentale. Afër gjysmë shekulli ka dhënë mësim në shkollën e tij private, dhe është endur prej një vendi në vendin tjetër, me një grup nxënësish, duke ua mësuar këto shkenca astronomike që i njihnte aq shumë, sa që kishte filluar ti rritej mendja dhe ta pëlqejë vetveten, aq sa disa lëvizje e mendime të tij binin ndesh me mësimet e Sheriatit islam, gjithë kjo si rrjedhojë e mahnitjes së tij nga qytetërimi francez perëndimor, dhe nga mendimi filosofik perëndimor, ashtu siç kishte ndodhur edhe me të tjerët që ishin edukuar në qarqet perëndimore.

Në vitin 1880 (thuhet edhe në vitin 1881) Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu ndërroi jetë, në moshën shtatëdhjetëvjeçare në vendin Erenkoy

⁴³⁰ Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi, 202.

afër Stambollit dhe është varrosur në varrezat “Sahrayi-Cedid Mezarligi” pa shënuar varrin e tij, dhe për këtë shkak tamam nuk dihet se ku e ka varrin. Zoti e mëshiroftë dhe ia faltë gabimet!

TITUJT E VEPRAVE TË TIJ

Pjesa dërrmuese e veprave të Hoxhë Hasan Tahsinit ka qenë në gjuhën turke e shqipe, por ato fatkeqësisht kanë humbur. Në vazhdim po japim titujt e veprave të tij që i kishin theksuar studiuesit në konferencë, dhe që janë shënuar në disa burime tjera:⁴³¹

- Tarih-i Tekvin yakut Hilkat (Historia e krijimit) - në gjuhën turke;⁴³²
- Esas-i ilm-i Hay’et (Bazat e gjeometrisë)- në gjuhën turke;⁴³³
- Psikholoji yakut ilm-i Ruh (Psikologjia-shkenca e shpirtit)- në gjuhën turke;⁴³⁴
- Esrar-i Abu Hava (Fshehtësitë e ujit dhe ajrit)- në gjuhën turke;⁴³⁵
- Hej’etul-alem (Forma e botës)⁴³⁶ - në gjuhën turke;⁴³⁷
- Mir’atus-sema’i (Pasqyra e qiellit) në gjuhën turke;
- “Ligjet natyrore”- traktat i përkthyer nga frëngjishtja;
- Aklamul-ekvam- s’di në cilën gjuhë është shkruar;
- Hulasatul-efkar (Rezyme e mendimeve)- s’di në cilën gjuhë është shkruar;
- Usul-i Fenn-i Felahet-Kimyayi Ziraat- (Bazat e agrikulturës)⁴³⁸; dhe:
- Murabbi-i Et-fal (Pedagogu i fëmijëve)⁴³⁹ në bashkëpunim me një autor tjetër.

⁴³¹ **Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi**, dhe burime të tjera.

⁴³² U botua në Stamboll në vitin 1310 hixhri.

⁴³³ U botua në Stamboll në vitin 1311 hixhri.

⁴³⁴ U botua në Stamboll në vitin 1309 hixhri.

⁴³⁵ U botua në Stamboll në vitin 1309 hixhri.

⁴³⁶ Ky punim është i njëjtë me punimin “**Esasu ilmil-hej’eti**”, por është botuar me titull tjetër në vitin 1297 (hixhri) në formë artikulli në revistën “**Mexhmuatul-ulum**”.

⁴³⁷ Po aty, punim i studiuesit turk Mahmut Kemal Inal, f. 106, ku hoxhë Hasan Tahsin Efendiu renditet në rangun e poetëve të mëdhenj turq. Titulli i librit është: “**Esh-Shu’ara el-etrak fil-karnil-ehir**”.

⁴³⁸ U botua në Stamboll në vitin 1291 hixhri.

Artikujt e tij janë botuar në revistën islame me titull: “Mecmua-i Ulum”,⁴⁴⁰ krahas gazetave ditore që shtypeshin në Stamboll, si p.sh., gazeta “Hafta” dhe gazeta tjera në gjuhën turke.⁴⁴¹

Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu ishte edhe astronom i madh. Në një vepër të tij mbi astronominë, thuhet se ai është i pari në zbulimin e katër gjërave ose katër qarkullimeve të lëvizjes së yjeve rreth Diellit dhe se Dielli është epiqendër e sistemit heliocentrik, apo siç quhet sistemi diellor. Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu thotë se shkenca moderne e ka zbuluar këtë çështje më vonë, edhe pse Kur’ani ka folur për gjërat e tilla dymbëdhjetë shekuj më parë, në formë decide dhe të mahnitshme. Në këtë kontekst Kur’ani Fisnik thotë:

فَدَّرَنَّهُ وَالْقَمَرَ ﴿٣٨﴾ أَلْعَلِمِ الْعَزِيزِ تَقْدِيرُ ذَلِكَ لَهَا لِمُسْتَقَرٍّ تَجْرِي وَالشَّمْسُ ﴿٣٩﴾ أَلْقَمَرَ تُدْرِكُ أَنْ هَا يَنْبَغِي الشَّمْسُ لَا ﴿٤٠﴾ الْقَدِيمِ كَالْعُرْجُونِ عَادَ حَتَّىٰ مَنَازِلَ
([يس: 38-40] ﴿٤٠﴾ يَسْبَحُونَ فَلَكَ فِي كُلِّ نَهَارٍ سَابِقُ اللَّيْلِ وَلَا

*“Edhe Dielli udhëton për në kufirin e vet (në cakun përfundimtar). Ai është (udhëtim) përcaktim i Ngadhënjyesit, të Dijshmit. Edhe hënës i kemi caktuar fazat (pozicionet), derisa të kthehet në trajtën e harkut (rrem i hurmës së tharë). As Dielli nuk mund të arrijë hënën e as nata para ditës, por secili noton në një galaksion.”*⁴⁴²

⁴³⁹ U botua në Stamboll në vitin 1289 hixhri.

⁴⁴⁰ U botua në Stamboll në vitin 1297 hixhri.

⁴⁴¹ Më gjerësisht për veprat dhe idetë e tij shkencore, shih enciklopedinë fetare turke: Ömer Faruk Akun, “**Türkiye Diyanet İslam Ansiklopedisi**”; 203-206.

⁴⁴² Jasin, 38-40.

III: STUDIMI DHE ANALIZA E DOKTRINËS SË TIJ FILOSOFIKE

E vërtetë është thënia: “Nëse termi “filosofi” nënkupton dashurinë ndaj diturisë, atëherë e duam, përderisa ka të bëjë me gjetjen e të vërtetës, e nëse ka të bëjë me devijimin e instiktit nëpërmjet përpjekjeve të falsifikuara dhe teorive destruktive, atëherë nuk e pranojmë një dituri të tillë, qoftë kjo edhe prej ndonjë muslimani që ka njohuri në mendimin islamik, ngase pranimi ose refuzimi i nje ideje apo mendimi duhet te jete konform shpalljes kur’anore dhe asaj që thotë Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i inspiruar nga Zoti i Madhërishëm”.⁴⁴³ Këtë e them për hoxhën, profesorin dhe astronomin shqiptar Hasan Tahsin Efendiun, ngase për fat të keq, shumë hulumtues të Konferencës, konfirmuan se Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu ka qenë nën ndikimin e madh të doktrineve filosofike franceze dhe është larguar nga saktësia, derisa është bërë ekspert⁴⁴⁴ i shkollës filosofike pozitiviste të August Kontit,⁴⁴⁵ e cila mbështetet në eksperimentin dhe në çështjet e dukshme më shumë se në teori e ide..⁴⁴⁶

Ai po ashtu ka qenë nën ndikim të madh të filosofisë deiste që njihet si filosofi hyjnore që pranon ekzistimin e Zotit, por refuzon nevojën për shpallje dhe fe “Deisti beson në Krijues, por mendon se s’ka nevojë për shpalljed dhe se intelektin dhe mendja e njeriut mjafton, dhe në këtë mënyrë mohan shpalljen. Qëndrimi i tillë përputhet me brahmanët indian modernë, të cilët mendojnë se çdo besim fetar që nuk përputhet me intelektin, refuzohet”.⁴⁴⁷

Sa i përket çështjeve të kësaj filosofie që kanë të bëjnë me natyrën dhe ligjet e natyrës, këta mendojnë se nuk ka kurrfarë intervenimi nga Zoti i Madhërishëm, ngase vetë natyra i ka ligjet e veta që e mbrojnë, dhe se vetë natyra vetëvendosë për vetveten, ndaj dhe për këtë shkak, nuk ka

⁴⁴³ Ömer Faruk Akun, “Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi”; 203-206; Neda Xha’rane, Abdulhamid ibn Muhamed, “El-Med-hal ilet-tefsir”; f. 303.

⁴⁴⁴ Ibrahim Daut Hoxha, “Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu”; Prof. Nexhip P. Alban, 31.

⁴⁴⁵ “Kamusul-meuridil-vesit”; Munir Ba’lebekkij dhe Ruhi Ba’lebekkij, f. 455.

⁴⁴⁶ Oxford Advanced Learners Dictionary of Current English, 5th edition, Oxford University press, 1995, 899.

⁴⁴⁷ Nga të dhënat që i mora në kabinetin e prof. dr. Irfan Abdulhamid Fettah, profesor i filosofisë dhe feve krahasuese në Universitetin Ndërkombëtar Islamik në Malajzi, Allahu e mëshiroftë)

nevojë për rolin e krijimit dhe kreacionin,⁴⁴⁸ kurse lëvizja dhe zhvillimi biologjik i krijesave në natyrë janë punë dhe përgjegjësi e natyrës!!!

Realiteti i kësaj ideje filosofike është i rrezikshëm, dhe për këtë shkak duhet sqaruar dhe detajuar që ta kuptojmë në mënyrë objektive mendimin e Hoxhë Hasan Tahsin Efendiut.

Ky zgjerim relativ është shumë i rëndësishëm, ngase kemi të bëjmë me analizimin dhe studimin e një ideje të rrezikshme dhe të re, që të mund ta kuptojmë rrënjën e problemit dhe që të jemi objektiv me ithtarin e kësaj ideje. Së pari obligohemi ta kuptojmë të vërtetën mbi çështjen, pastaj të gjykojmë.

Sipas mendimit tim, këtë mendim filozofik dhe këtë doktrinë filosofike shumë pak e kanë studiuar ata që hulumtojnë në tefsir dhe në studimet kur'anore, dhe mund të thuhet se jam ndër të parët që jam marrë me studimet kur'anore të një dijetari dhe mendimtari shqiptar në kohën moderne, ndaj dhe për këtë shkak duhet t'i theksojmë parimet e saj në këtë studim. Për ta kuptuar këtë problematikë jemi referuar në analizimin dhe verifikimin e ca autorëve në disa fjalorë e enciklopedi bashkëkohore arabe dhe perëndimore, për ta kuptuar domethënien e vërtetë të saj. Në vijim do të jap definicionet e filozofisë dhe doktrinës iluministe, ngase kanë lidhje të ngushtë me këtë problematikë, posaçërisht me pikëpamjet e Hoxhë Hasan Tahsin Efendiut, për të cilin veçmë është konfirmuar se ka qenë nën ndikimin e filozofisë deiste në një shkallë shumë të lartë.

1: NATYRA E FILOZOFISË ILUMINISTE-REZYME E PASQYRËS HISTORIKE

Në disa fjalorë filozofik arabë thuhet se (التنوير) “iluminizmi” është lëvizje filosofike e shek. XVIII që mbështetet në intelekt, dhe që përmban në vete parimin se vetëdija është faktori kryesor i zhvillimit të shoqërive, dhe se cilësitë negative të shoqërisë janë rezultat i mosnjohjes së natyrës njerëzore. Kjo filozofi është formuar para revolucionit borgjez si kundërveprim ndaj fanatizmit fetar, dhe ideologjisë së verbër feudale. Sipas Kantit *“Iluminizmi çliron njeriun nga paaftësia e funksionimit të intelektit pa ndonjë udhërrëfyes të jashtëm. Kjo paaftësi vjen nga humbja*

⁴⁴⁸ Ibrahim Daut Hoxha, **“Hoxhë Hasan Tahsin Efendiut”**; artikulli i prof. Dritan Spahiut, f. 43.

Në Enciklopedinë Sovjetike, të përkthyer në gjuhën arabe, kur definohet iluminizmi thuhet:

*“Drejt看 politik shoqëror, ithtarët e të cilit drejt看 përpiqeshin që të korrigjojnë antagonizmat e shoqërisë, të ndryshojnë moralin, mënyrën e jetës dhe politikën, nëpërmes përhapjes së mendimeve rreth të mirës, drejtësisë dhe njohurive shkencore. Në esencë, iluminizmi nënkupton parimin se vetëdija luan rol vendimtar në zhvillimin e shoqërisë, ndërsa gabimet shoqërore janë rezultat i injorancës së njerëzve dhe mosekzistimit të besimit në natyrën e tyre. Përveç kësaj, ata nuk kanë mund t’i kuptojnë rregullat objektive të shoqërisë. Mendimtarët iluministë u drejtoheshin gjitha niveleve të shoqërisë, posaçërisht atyre të pushtetit. Iluminizmi u formua para revolucionit feudal dhe ka ndikuar shumë në dobësimin e ndikimit të ideologjisë së kishës dhe feudalizmit. Iluministët nuk luftonin vetëm kundër kishës, por edhe kundër dogmave fetare dhe metodave të menduarit dogmatik. Iluminizmi sot nuk ka ndikim në të menduarit shoqëror dhe ekziston vetëm në mesin e intelektualëve marksistë”.*⁴⁵⁰

Në disa enciklopedi perëndimore fetare e politike, të shkruara në gjuhën angleze, jepen të dhëna të hollësishme mbi lëvizjen, qëllimet dhe personalitetet më të njohura të kësaj lëvizjeje, dhe mendoj se është e rëndësishme që të shohim në mënyrë të shkurtër se ç’thuhet për të: *“Periudhë historike dhe lëvizje intelektuale evropiane që përcaktoi raporte të reja mes fesë dhe politikës. Iluminizmi është term dy kuptimor. Hulumtuesit i kanë hulumtuar rrënjët e tij, vendet ku është përhapur, personalitet më të njohur dhe karakteristikat më të njohura që dominonin në të. Lëvizja e iluminizmit nënkupton lëvizjen iluministe franceze, gjegjësisht periudhën e intelektit dhe racios. Është paraqitur në shek. XVIII në Francë dhe ka përfunduar me revolucionin francez, pas dështimit të realizimit të qëllimit kryesor të revolucionit në vitin 1789”.*

Ky ishte kuptimi i ngushtë i saj, ndërsa kuptimi më i gjerë i kësaj lëvizjeje ka të bëjë me faktin se iluminizmi përmban në vete edhe karakteristika reformiste që rrjedhin nga koha e grekëve antikë, posaçërisht në kohën e renesancës dhe reformave greke. Në një kuptim

⁴⁴⁹ Murad Vehbe, **“El-Mu’xhemu El-Felsefiju”**; Daruth-thekafetil-xhedideti, bot.3; 1979, f. 135.

⁴⁵⁰ Një grup autorësh kanë përpiluar enciklopedinë filosofike nën mbikëqyrjen e Rozentalit dhe Judvinit, përktheu Serri Kerem në arabisht, recensoi dr. Sadik Xhelal dhe Xhorxh Tarabishi, Bejrut, Darut-tulaj’ati, bot. 6, 1987, f. 145-146.

më të gjerë iluminizmi ka filluar në shek. XIX në Angli, posaçërisht në kohën e metodës së Xhon Lokut dhe pikëpamjeve të tij ndaj shkencës, fesë dhe politikës. Përfaqësuesit e saj më të njohur anglezë e skocezë janë: Joseph Priesthy, Francis Hutcheson, Adam Smith, Eduard Gibbou. Ndërsa nga përfaqësuesit francezë, më të njohur janë: Voltaire, Baron de Montesquieu, Denis Didero, Jean-Jacques Rousseau. Në Gjermani: Christian Wolf, Mosses Mendelssohn, Imanuel Kanti etj.; kurse në Amerikën Veriore: Thomas Paine, Benjamin Franklin, Thomas Jeffersont, etj.

2: KARAKTERISTIKAT E ILUMINIZMIT

Në disa fjalorë dhe enciklopedi fetare e politike për iluminizmin thuhet:

*“Sistemi politik dhe fetar në mesjetë para iluminizmit ishte në duart e teologëve të krishterë, dhe njerëzit e kishës që pranonin shpalljen dhe librat e shenjtë, e që ishin të pushtetshëm dhe të fuqishëm për të ndërmarrë vendime. Mbretërit dhe qendrat politike merrnin zyrtarizimin nga teologët që konsideroheshin të shenjtë dhe me autoritet hyjnor. Përkrahësit e filosofisë iluministe refuzuan në tërësi këtë sistem politik e fetar, dhe e shenjtëronin natyrën e intelektin si burim esencial shkencor i të mirave të njerëzve. Krahas kësaj, u përqëndruan në rëndësinë e kritikës racionale, ligjit natyror objektivizmit dhe universalizmit. Ata po ashtu ishin përqëndruar në drejtime shkencore moderne, në të drejtat natyrore, në liri, barabarësi e dobi, dhe në mosfanatizmin dhe tolerancën fetare, me çlirim të plotë dhe absolut nga besëtytnitë fetare, iracionalizmi dhe mosmbështetja në autoritetin mbinatyror fetar...”*⁴⁵¹

Filosofi i njohur Kanti, kur definon iluminizmin në vitin 1784, i fton njerëzit që të mbështeten në vetveten e tyre, sepse njerëzit duhet vetë të posedojnë fuqi e vullnet për të menduar rreth politikës dhe fesë, dhe të besojnë në veten e tyre, në vend që të mbështeten në të tjerët në këto çështje. Njerëzit duhet ta lëvizin trurin e tyre dhe fuqinë njerëzore për të përfituar dituri të vërtetë dhe për ta kuptuar më së miri politikën dhe fenë.⁴⁵² Karakteristikat e kësaj filosofie ishin: Çlirimi i intelektit dhe mendjes nga besëtytnitë fetare e religjioze, çlirimi i intelektit dhe trurit nga iracionalizmi dhe metodat regresive, transferimi nga tirania politike,

⁴⁵¹ Robert Wuthman, “**The Encyclopedia of Politics and Religion**”; Routledge, United Kingdom, London 1998, 233-234.

⁴⁵² Po aty, f. 234.

amoraliteti dhe tortura e përhershme në progres e përkryerje. Me zhvillimin e këtyre fuqive intelektuale, njerëzit do të mund të ecin dhe të përparojnë deri në përkryerje.⁴⁵³ Bazuar në këto botëkuptime e parime, ai që studion fenë dhe politikën, obligohet ta studiojë dhe hulumtojë këtë natyrë, dhe natyrën e njeriut, vetëm në mënyrë racionale.

Natyra ka strukturë racionale të posaçme dhe lëvizë e vepron përmes ligjeve natyrore të gjithësisë. Fenomeni natyror dhe çështja politike, fetare e morale, duhet të studiohen në bazë të metodës racionale dhe parimeve racionale. Natyra që është rreth e përqark nesh, çështjet e përgjithshme njerëzore dhe çështjet komplekse shkencore e politike, duhet të ndahen në elemente e pjesë, për të zbuluar raportet në mes shkaktues dhe pasojës.⁴⁵⁴

Duke u bazuar në atë që u tha më sipër, çdo besim dogmatik ose bestytni fetare që nuk mund të kritikohet e të analizohet në mënyrë racionale, duhet të shkulet dhe të çrrënjohet, qoftë edhe iracionalizmi në çështje të fesë apo të politikës.

Filosofia e iluminizmit mbështetej në parimin e tolerancës dhe në afanatizëm që njerëzit të jenë të lirë në besim dhe në fjalët e tyre. Fanatizmi fetar dhe politik i ka bërë njerëzit të paaftë në aspektin racional dhe i ka penguar nga zhvillimi i tyre dhe të kuptuarit e të vërtetës.

Ky drejtim iluminist tentonte ta ndajë fenë nga politika, dhe nxiti formimin e një grupi iluministësh ateistë që mendonin se s'ka kurrfarë dobie nga feja dhe devotshmëria fetare, si dhe insistonin në pastrimin e politikës nga ndikimi fetar, kompleksi, injoranca e bestytnia. Karshi tyre ekzistonte një grup tjetër iluministësh që nuk ishin ateistë, por tentonin të formonin një fe racionale që do ta kontrollonte edhe fenë e inspiruar hyjnore. Ithtarët e këtij drejtimi racional fetar refuzonin dhe kundërshtonin ashpër pushtetin hyjnor të krishterë të priftërinjve, ngase sipas mendimit të tyre, feja që mbështetet në racio e natyrë duhet të respektohet dhe t'i çmojë parimet natyrore të politikës e gjithësisë, dhe t'i njohë të drejtat politike të të tjerëve, qofshin ata besimtarë apo ateistë.⁴⁵⁵

⁴⁵³ Po aty.

⁴⁵⁴ Rreth racionalizmit në mes shkaktues dhe pasojës shih më gjerësisht Muhammed El-Irakij, Muhamed Atif, **“En-Nez’atul aklijetu fi felsefeti Ibn Rushd”**; Egjipt, Darul-Mearif, pa vit botimi, fq. 163-167.

⁴⁵⁵ Shih më gjerësisht enciklopeditë filosofike: Rober Wuthman, **“The Encyclopedia of Politics and Religion”**; Routledge, United Kingdom, London 1998, 233-235; Paul Eduards, **“The Encyclopedia of Philosophy”**; Collier Macmillan Publishers, London 1967, 519-525.

3: DOKTRINA FILOSOFIKE DEISTE (DEIZMI) NË PIKËPAMJET E HOXHË HASAN TAHSIN EFENDIUT

Që në fillim mund të them se filozofia iluministe kishte ndikuar në formimin e kësaj filozofie të re. Kjo filozofi kishte arritur kulmin e vet në fund të shek. XIX. Ithtarët e iluminizmit besonin në filozofinë e progresit, e cila në esencë mohonte trashëgiminë kulturore, fetare e historike, sepse nuk përputhej me nevojat e kohës.⁴⁵⁶ Në disa fjalorë e enciklopedi, deizmi filozofik definohet kështu:

Feja e vërtetë është feja natyrore (racionale ose vetë natyra) dhe se pjesa dërmuese e ithtarëve të këtij drejtimi mohanin shpalljen, ngase e konsideronin bestytni dhe iluzion. Zoti u dëshiron lumturi krijesave të veta dhe për këtë shkak ka krijuar vlerën si mjet për realizimin e lumturisë së tillë. Shpëtimi i njerëzve nuk mund të mbështetet në shpallje të çfarëdolloji qoftë. Feja e vërtetë dhe e saktë është shprehje e lirë mbi lirinë e njerëzve që përfshinë intelektin në çdo kohë dhe çdo vend. Parimet e fesë së krishterë dhe asaj islame janë të thjeshta dhe kanë përmbajtje tiranie, politike, mashtrimi, kurthe dhe shkathtësi teologësh, si dhe e shkatërrojnë intelektin.⁴⁵⁷

Këto parime e mbulojnë fenë natyrore (racionale) me ide të fëlliqura dhe të papastrat. Kjo lëvizje ishte fenomeni i shek. XVII dhe XVIII dhe ishte përhapur tej mase në Angli në mesin e shumë personaliteteve të njohura. Në shek. XVIII, ky definicion merr koncept të ri që nënkuptonte mungesën e Zotit nga natyra. Zoti ka krijuar ligjet dhe sistemet e natyrës, pastaj e ka lënë të veprojë vetë natyrën sipas ligjeve të tilla,⁴⁵⁸ përkatësisht bota vetë kujdeset për veten e saj!!! Pasi e krijoi Zoti botën dhe u distancua nga krijesat e Tij, është larguar dhe përqëndruar në një botë tjetër të izoluar, duke e lënë botën që të funksionojë vetë sipas ligjeve dhe sistemeve racionale. Ky mendim filozofik në esencë ishte formuluar nga ideja e filozofit dhe fizikanit të njohur anglezo-hebre, Isak Njuton, i cili thotë se ekziston lidhje dhe përputhshmëri, punë e bashkëveprim racional në mes pjesëve të kësaj bote që i ngjanë

⁴⁵⁶ Më gjerësisht mbi filozofinë e iluminizmit francez shih: Peter Gay, “**The Enlightenment-An introduction**”; Randow House, New York, 1966.

⁴⁵⁷ Robert Audi, “**The Cambridge Dictionary of Philosophy**”; Cambridge University Press, 1995, 188.

⁴⁵⁸ Po aty, f. 188.

instrumentit mekanik që lëvizë e ecë.⁴⁵⁹ Ithtarët e kësaj lëvizje filosofike e çmonin shumë intelektin dhe potencialin e tij, që ia tejkalon shpalljes dhe, kështu, mohonin parimet fetare që i bënë njerëzit fanatikë, jo tolerantë dhe të mbyllur ndaj të tjerëve, deformuan pasqyrën e Zotit të Madhërishëm si Krijues racional të kësaj bote harmonike.

Ky progres shkencor dhe filosofik refuzoi teorinë që thoshte se intelektin kontrollohet nga kaosi për shkak të mëkatit që ka bërë babai ynë, Ademi a.s. Në shek. XVII, shumë ithtarë të lëvizjes ateiste refuzonin kategorikisht aplikimin e riteve dhe adhurimeve fetare, ngase sipas tyre, ritet e tilla ishin bestytni fetare të idhujtarëve dhe për këtë shkak duhet refuzuar.⁴⁶⁰

Për ta konfirmuar këtë që e thashë më parë, u konsultova me disa ekspertë dhe profesorë të mi të njohur,⁴⁶¹ e që kanë njohuri të thella në çështjet filosofike e fetare evropiane dhe pas bisedave të gjata me to, besoj se Zoti na ndihmoi ta kuptojmë të vërtetën, sepse përfundua se filozofia e përfutur nga leximi i thellë i Kur'anit na bën të kuptojmë disa çështje në aspektin e përgjithshëm, që s'mund të ndahen në pjesë më të imta e as të refuzohen:

1. Bota materiale lëviz sipas ligjeve dhe nuk ka kurrfarë kontradiktash në to, dhe kjo vërtetohet në shumë ajete kur'anore, si p.sh.:

فَارْجِعْ تَفْنُوتٍ مِنَ الرَّحْمَنِ خَلْقٍ فِي تَرَى مَا طَبَاقًا سَمَوَاتٍ سَبْعَ خَلْقِ الَّذِي
 خَاسِئًا الْبَصَرُ إِلَيْكَ يَنْقَلِبُ كَرَّتَيْنِ الْبَصَرَ أَرْجِعْ ثُمَّ ﴿٢٠﴾ فُطُورٍ مِنْ تَرَى هَلْ الْبَصَرُ
 ([الملك: 3-4] حَسِيرٌ وَهُوَ

- “Ai është që krijoi shtatë qiej palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj drejto shikimin

⁴⁵⁹ Merrian Websters's Encyclopedia of World Religions, Wendy Doniger, Consulting Editor, Springfield, Massachusetts 1999, 284.

⁴⁶⁰ Po aty, f. 284.

⁴⁶¹ Ky është profesori im i nderuar, Allahu e mëshiroftë, dr. Irfan Abdulhamid Fettah, profesor i sufizmit dhe i filozofisë se feve krahasuese në Fakultetin e Usuli Fikhut në Universitetin Ndërkombëtar Islamik në Malajzi. Intervistën me të e kam zhvilluar ditën e mërkurë, më 15.01.2003, në kabinetin e tij në fakultet. Edhe njëherë sinqerisht i falënderohem për të dhënat që m'i ofroi rreth këtyre çështjeve e që m'i qartësoi disa gjëra, që akoma i kisha të paqarta.

se a sheh ndonjë çarje? Mandej, herë pas here drejto shikimin, e shikimi do të kthehet te ti i përulur dhe i molisur”.⁴⁶²

كُلُّ أَتَقَنَّ الَّذِي اللَّهُ صُنْعَ السَّحَابِ مَرَّتُمْ وَهِيَ جَامِدَةٌ تَحْسِبُهَا الْجِبَالُ وَتَرَى
([النمل: 88] ﴿ ٨٨ ﴾ تَفْعَلُونَ بِمَا خَبِيرُ إِنَّهُ شَيْءٌ

“(Kjo është) mjeshtëri e Allahut që përsosi çdo send, e Ai është hollësisht i njohur se çka punoni”.⁴⁶³

لِقَوْمٍ لَا يَتَذَكَّرُ فِي إِبْنٍ مُبْصِرًا وَالنَّهَارَ فِيهِ لَيَسْكُنُوا أَلِيلَ جَعَلْنَا أَنَا يَرَوْنَ أَلَمَ
([النمل: 86] ﴿ ٨٦ ﴾ يُؤْمِنُونَ

- “A nuk shohin ata se Ne ua bëmë natën që të pushojnë, kurse ditën të ndritshme. Në këtë ka argument për një popull që beson”.⁴⁶⁴

([القمر: 49-50] ﴿ ٤٩ ﴾ بِالْبَصَرِ كَلَمٍ وَاحِدَةٍ إِلَّا أَمْرًا وَمَا ﴿ ٥٠ ﴾ بِقَدَرٍ خَلَقْنَاهُ شَيْءٌ كُلِّ إِنَّا

القمر: 49-50

- “Ne çdo send kemi krijuar me masë të caktuar. Puna jonë në krijim është e shpejtë sa çel e mshel sytë”.⁴⁶⁵

شَيْءٌ وَكُلٌّ تَزْدَادُ وَمَا الْأَرْحَامُ تَغِيضُ وَمَا أَنْتَ كُلُّ تَحْمِلُ مَا يَعْلَمُ اللَّهُ
([الرعد: 8-9] ﴿ ٩ ﴾ أَلْمُتَعَالِ الْكَبِيرُ وَالشَّهَادَةُ الْغَيْبِ عَلِيمٌ ﴿ ٨ ﴾ بِمِقْدَارٍ عِنْدَهُ

- “Tek Ai është çdo send në masë të caktuar, Ai është që di të fshehtën dhe të dukshmen, Ai është i Madhëruari e i Lartësuari”.⁴⁶⁶

⁴⁶² El-Mulk, 3-4.

⁴⁶³ En-Nemlu, 88.

⁴⁶⁴ En-Neml, 86.

⁴⁶⁵ El-Kamer, 49.

⁴⁶⁶ Er-Ra’d, 9.

2. Këto ligje harmonike dhe precize të natyrës janë nga Zoti i Madhërishëm e jo nga vetë natyra.
3. Meqë Krijuesi i Madhërishëm është Krijuesi i natyrës dhe i ligjeve të saj, atëherë vetëm Ai mund t'i shkatërrojë si të dojë dhe kur të dojë, dhe kjo është mrekulli hyjnore. Ajetet që konfirmojnë një fakt të tillë janë të shumta, si p.sh.:

([الأعراف: 54] ﴿الْعَالَمِينَ رَبُّ اللَّهِ تَبَارَكَ وَالْأَمْرُ الْخَلْقُ لَهُ أَلَا﴾)

- “Ja, vetëm Atij i takon krijimi dhe sundimi. I Madhëruar është Allahu, Zoti i botëve”.⁴⁶⁷

بِيَدِهِ الَّذِي فَسَّحَنَ ﴿أَفَيَكُونُ كُنْ لَهُ يَقُولُ أَنْ شَيْئًا أَرَادَ إِذَا أَمْرُهُ إِنَّمَا﴾

([يس: 82-83] ﴿تُرْجَعُونَ وَإِلَيْهِ شَيْءٌ كُلِّ مَلَكُوتٍ﴾)

- “Kur Ai dëshiron ndonjë send, urdhri i Tij është vetëm t’i thotë: “Bëhu”! Ai menjëherë bëhet. I Lartë është Ai që në dorën e Tij është pushteti mbi çdo send dhe vetëm tek Ai kthehem”.⁴⁶⁸

Edhe gjërat më të imta që ndodhin në natyrë janë nga Zoti i Madhërishëm, dhe në këtë kontekst, Ai thotë:

اللَّهُ غَيْرُ إِلَهٍ مِّنَ الْقِيَمَةِ يَوْمَ إِلَى سَرْمَدًا أَلَيْلَ عَلَيْكُمْ اللَّهُ جَعَلَ إِنْ أَرَاءَيْتُمْ قُلْ

الْهَارَ عَلَيْكُمْ اللَّهُ جَعَلَ إِنْ أَرَاءَيْتُمْ قُلْ ﴿تَسْمَعُونَ أَفَلَا بَضِيَاءٌ يَأْتِيكُمْ﴾

أَفَلَا فِيهِ تَسْكُنُونَ بَلِيلٍ يَأْتِيكُمْ اللَّهُ غَيْرُ إِلَهٍ مِّنَ الْقِيَمَةِ يَوْمَ إِلَى سَرْمَدًا

([القصص: 71-72] ﴿تُبْصِرُونَ﴾)

“Thuaj: “Sikur Allahu t’u bënte natën të përhershme (t’ua zgjaste) deri në ditën e Kiametit, ç’mendon, cili zot pos Allahut do t’ju sillte juve dritë? A nuk merrni veshtë? Thuaj: “Më tregoni nëse Allahu ua bën ditën

⁴⁶⁷ El A’raf, 54.

⁴⁶⁸ Jasin, 82.

*të vazhdueshme deri në ditën e Kiametit, cili zot pos Allahut do t'ju sjellë natë që të pushoni në të? A nuk shihni (se po gaboni)!”*⁴⁶⁹

Pas kësaj rezymeje të kësaj filosofie dhe synimeve të saja, besoj se tash mund të kuptojmë thelbin e mendimeve të Hoxhë Hasan Tahsin Efendiut dhe ndikimin e kësaj doktrine filosofike iluministe deiste me pikëpamjet e tij.⁴⁷⁰ Për fat të keq, ai ishte viktimë e kësaj filosofie në mënyrë të pavetëdijshme... Në vazhdim do të ilustroj ndikimin e tij nëpërmes disa shembujve praktikë nga filozofia deiste, gjegjësisht nga shkolla filosofike perëndimore. Këto qëndrime i kanë theksuar studiuesit në punimet e tyre shkencore në Konferencë dhe kanë qenë të shënuara edhe në disa burime të tjera.

⁴⁶⁹ El Kasas, 71-72.

⁴⁷⁰ Iluminizmi ka ndikuar në shumë mendimtarë shqiptarë. Më gjerësisht rreth këtij ndikimi shih: Irfan Abdulhamid Fettah, **“El-Fikrud-dinij fi muvaxheheti tehaddijatil-hadatheti”**; Universiteti Ndërkombëtar Islamik në Malajzi, Qendra e hulumtimeve, 2001, 29-37.

IV: PASOJAT NEGATIVE NGA NDIKIMI I KËSAJ DOKTRINE NË PIKËPAMJET E HOXHË HASAN TAHSIN EFENDIUT

PIKA E PARË: QËNDRIMI I TIJ NDAJ SHPIRTIT ⁴⁷¹ DHE FENOMENIT TË VDEKJES

Drejtori i Konferencës, historiani dhe studiuesi Ibrahim Hoxha, thekson se një herë, Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu ka prezantuar në një takim, në një qytet ku është biseduar dhe shqyrtuar çështja e shpirtit. Hoxhallarët e atij qyteti mendonin se shpirti është çështje materiale dhe me vdekjen e njeriut, ai del nga trupi në formë të avullit ose tymit dhe se ky shpirt shkon tek Allahu i Madhërishëm dhe ruhet deri kur t'i kthehet pronarit të vet në Ditën e Kijametit. Kur Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu, dëgjon këtë thënie, iu thotë: *“Jo, nuk është ashtu siç thoni, ngase shpirti nuk është diçka e ndarë nga trupi. Shkaku i vdekjes së trupit është ndërprerja e funksionimit dhe lëvizjes së gjymtyrëve dhe organeve: Nëse nuk merr frymë njeriu, nuk lëvizë dhe kjo është vdekja!!!”*

Të gjithë ata që ishin prezent u habitën nga ky sqarim i fenomenit të vdekjes nga Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu.⁴⁷² Ky definicion i vdekjes, ose ky sqarim i mënyrës së vdekjes në këtë formë nuk është i saktë, nëse merren parasysh argumentet e Kur'anit dhe Sunnetit, si dhe faktet që i theksojnë dijetarët e mëdhenj të kalibrit të Ibn Kajjim El-Xheuzijut në librin e tij: *“Er-Ruh” (الروح)* (Shpirti). Sipas këtyre fakteve, njeriu është i përbërë nga shpirti e trupi dhe kur vdes, shpirti del e shkon te Krijuesi që të rikthehet në varrin e tij gjatë procesit të marrjes në pyetje të të vdekurit. Në çështjen e katërt të librit të tij ai shkruan: *“A vdes shpirti apo vetëm trupi?”* Dhe në këtë kontekst, thotë: *“Njerëzit kanë mendime të ndryshme rreth kësaj çështje, një grup mendon se shpirti vdes dhe e shijon (vdekjen), ngase çdo gjë do ta shijojë vdekjen, ndërsa sipas një grupi tjetër shpirtit nuk vdesin, por janë krijuar të përhershëm, ndërsa trupat janë ata që vdesin. Në këtë, ata mbështeten në disa hadithe që tregojnë*

⁴⁷¹ **VËREJTJE:** “Këto fjalë që i theksoj për Hoxhën Hasan Tahsin Efendiu janë thënë në Konferencën e mbajtur në Tiranë. Unë personalisht nuk kam hasur diçka të shkruar nga lapsi i Hoxhës dhe, për këtë shkak, edhe unë do të mbështetem në atë që thanë hulumtuesit në atë Konferencë, ndërsa shumë do kisha dashur që qëndrimet e tilla të kishin qenë të regjistruara e të shkruara në librat e Hoxhë Hasan Tahsinut që të jemi më të qetë dhe më të sigurtë nga thëniet tona...”

⁴⁷² Po aty, f. 131-154.

Më saktë është të thuhet se vdekja nënkupton ndarjen e shpirtit prej trupave dhe daljen e tij nga trupi, dhe nëse thuhet kështu, atëherë ai shijon vdekjen dhe nëse thuhet se shpirti shkatërrohet dhe zhduket, atëherë nuk vdes, por jeton pas krijimit në begati ose dënim⁴⁷⁴. Ekzistojnë shumë hadithe që vërtetojnë se shpirtrat ndahen nga trupi në momentin e vdekjes dhe se u rikthehen trupave për të jetuar në mirësi ose në dënim në varr. Këtë e vërejmë edhe te Ibn Kajjimi,⁴⁷⁵ por këtu nuk kemi mundësi që të hyjmë në detaje. Të vërtetën e ndarjes së shpirtit nga trupi në momentin e vdekjes e ka theksuar edhe filosofi i madh, Ibn Sinâ, kur thotë se “Vdekja është ndarje e shpirtit nga trupi”,⁴⁷⁶ dhe në këtë mënyrë bie teoria e Hoxhë Hasan Tahsinut mbi vdekjen. E vërteta në këtë çështje është se shpirti⁴⁷⁷ është ekzistues i pavarur, por s’dimë se si duket, dhe në këtë kontekst, ajeti kur’anor është mjaft decid:

﴿ قَلِيلًا إِلَّا أَلْعَلِمَ مَنْ أُوتِيَتْهُ وَمَا رَبِّيَ أَمْرٌ مِنَ الرُّوحِ قُلِ الرُّوحُ عَنِ وَبَسْأَلُونَكَ ﴾

([الإسراء: 85])

“Të pyesin për shpirtin, thuaj: “Shpirti është çështje e Zotit tim dhe juve u është dhënë pak dituri”.⁴⁷⁸

⁴⁷³ Ali Imran, 169-170.

⁴⁷⁴ Ibn Kajjim El-Xheuzij, Ebu Abdullah Muhamed ibën Ebi Bekre Ed-Dimeshkij, “**Er-Ruh**”; recensoi dr. Sejjid Xhemili, Darul-kitabil-arabij, Bejrut, Liban, bot. I, 1994, 70-71.

⁴⁷⁵ Po aty, f. 97-98.

⁴⁷⁶ Dr. Ali Iljazi, “**Kur’ani dhe shkenca bashkëkohore**”; Gjakovë, 2000; 455.

⁴⁷⁷ Mbi shpirtin më gjerësisht shih: Ali Xhunda Muhamed Shafi’ij, “**Hashijetul-imam El-Bejxhuri ala xheheretit-teuhid el-musemma Tuhfetul murid ala xheheretit-Teuhid**”; Universiteti i Ez’herit, Darus-Selam, bot. I, 2002; 266-269.

⁴⁷⁸ El-Isra’a, 85.

PIKA E DYTË: QËNDRIMI I TIJ NDAJ SHIUT

Pastaj, në të njëjtin takim është hapur edhe biseda e rënies së shiut dhe mënyra se si formohet shiu. Njerëzit janë përgjigjur se Zoti bën që shiu të bjer nga Mëshira e Zotit ndaj robërve të Tij. Mirëpo, në atë çast Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu reagon dhe u thotë: “*Fenomeni i shiut është njësoj si fenomenet e tjera natyrore dhe është produkt i ligjeve të natyrës*”.⁴⁷⁹ Pastaj vazhdon Hoxhë Hasan Tahsini të sqarojë mënyrën e formimit të shiut, borës, breshrit dhe vesës.

Më pas, Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu vazhdon të argumentojë thënien e tij përmes disa eksperimenteve brenda dhomës ku ishin ulur. Gjatë eksperimentit në dhomë me disa instrumente e lëndë që i kishte prurë me vete, u formuan pika uji në tavan të dhomës dhe filluan të bien në kokat e atyre, që ishin prezent aty. Të pranishmit, kur e panë një gjë të tillë, filluan të kërkojnë shpëtim e mbrojtje nga Zoti i Madhërishëm, duke thënë: “*O Zot, na ruaj nga Hoxhë Hasan Tahsini i humbur dhe që i humb të tjerët e që është murted-i dalur nga feja, Zoti e mallkoftë!*”; Ndërsa Hoxhë Hasan Tahsini buzëqeshte me ata që u pëlqente eksperimenti.⁴⁸⁰

Këtë thënie dhe këtë teori të Hoxhës e kundërshtojnë dhe e hudhin poshtë shumë ajete të qarta të Kur’anit, ku thuhet se rënia e shiut është nga Mëshira e Zotit të Madhërishëm, Ai shiun e lëshon kur të dojë, mbi kënd të dojë dhe ku të dojë:

وَمَا الْأَرْحَامُ فِي مَا يَعْلَمُ الْغَيْثُ وَيُنْزِلُ السَّاعَةَ عِلْمٌ عِنْدَهُ اللَّهُ إِنَّ
عَلِيمُ اللَّهِ إِنَّ تَمُوتُ أَرْضٌ بَأَيِّ نَفْسٍ تَدْرِي وَمَا غَدَا تَكْسِبُ مَاذَا نَفْسٌ تَدْرِي
([لقمان: 34] خَيْرٌ

“S’ka dyshim se vetëm Allahu e di kur të ndodhë Kiameti. Ai e di kur e lëshon shiun. Ai e di se ç’ka në mitra (të nënave), nuk e di kush pos Tij se çka do t’i ndodhë (çka do të punojë) nesër, dhe askush nuk e di, pos Tij, se në ç’vend (ose kohë) do të vdesë. Allahu është më i Dijshmi, më i Njohuri”.⁴⁸¹

Në ajetet kur’anore vërtetohet në mënyrë kategorike e kundërta e fjalëve të Hoxhë Hasan Tahsinit rreth rënies së shiut dhe bubullimave e

⁴⁷⁹ Po aty, punimi i hulumtuesit dhe historianit Ibrahim Daut Hoxha , f. 131.

⁴⁸⁰ Po aty, f. 132.

⁴⁸¹ Lukman, 34.

vetëtimave si çështje natyrore. Në këtë kontekst, në Kur'anin Fisnik thuhet:

مَنْ بِهَا فُيْصِبُ الصَّوَاعِقَ وَيُرْسَلُ خِيفَتِهِ مَنْ وَالْمَلَكَةُ بِحَمْدِهِ الرِّعْدُ وَيُسَبِّحُ
([الرعد: 13]) الْحَالِ شَدِيدٌ وَهُوَ اللَّهُ فِي تَجْدُلُونَ وَهُمْ يَشَاءُ

“Ndërkaq murmurima madhëron (Zotin një) me falënderimin (që i takon) e Tij, (e madhërojnë) edhe engjëjt nga droja ndaj Tij. E Ai dërgon rrufetë dhe me ato godet kë të dojë, ndërsa idhujtarët polemizojnë rreth Allahut, e Ai është ndëshkues i rreptë”.⁴⁸²

مَاءَ السَّمَاءِ مِنْ وَأَنْزَلْنَا رَحْمَتِهِ يَدَى بَيْنَ بُشْرًا الرِّيحَ أَرْسَلَ الَّذِي وَهُوَ
كَثِيرًا وَأَنَاسِي أَنْعَمًا خَلَقْنَا مِمَّا وَنُسْقِيهِ مَيِّتًا بَلَدَةً بِهِ لِنُحْيِيَ طَهُورًا
([الفرقان: 48 – 49])

“Edhe Ai është që i lëshon erërat myzhde në prag të Mëshirës së Tij (shiut) dhe Ne lëshuam prej qiellit ujë të pastër, që me të t'i japim jetë një toke të vdekur dhe që t'u japim të pinë atyre që i krijuam, kafshë e shumë njerëz”.⁴⁸³

Këto ajete vërtetojnë disa të vërteta:

1. Zoti i Madhërishëm me Fuqinë dhe me Dëshirën e Vet na tregon vetëtimën, dhe këto gjëra i përkasin Zotit të Madhërishëm.
2. Zoti i Madhërishëm i dërgon murmurimat me Fuqinë dhe me Madhështinë e Tij, e jo natyra, dhe kjo vërehet qartë kur thotë se Ai i dërgon.
3. Vetëtimja gjuan me urdhër të Zotit atë që do Zoti, dhe në këtë kontekst, në ajetin kur'anor thuhet:

تَخْرِجُ الْوَدْقَ فَتَرَى رُكَّامًا تَجْعَلُهُ ثُمَّ بَيْنَهُ يُؤَلَّفُ ثُمَّ سَحَابًا يُزْجِي اللَّهُ أَنْ تَرَ أَلَمًا
وَيَصْرِفُهُ يَشَاءُ مَنْ بِهِ فُيْصِبُ بَرْدٍ مِنْ فِيهَا جِبَالٍ مِنَ السَّمَاءِ مِنْ وَيُنَزِّلُ خِلَالَهُ مَنْ

⁴⁸² Er Ra'd, 13.

⁴⁸³ El Furkan, 48-49.

إِنَّ وَاللَّهَارَ أَلِيلَ اللَّهُ يُقَلِّبُ ﴿٤٣﴾ بِالْأَبْصَرِ يَذْهَبُ بَرَقَهُ سَنَا يَكَادُ يَشَاءُ مَنْ عَن
 ([النور: 43-44] ﴿٤٤﴾ الْأَبْصَرِ لِأُولَى لَعِبَرَةٍ ذَلِكَ فِي

“A nuk ke parë se si Allahu drejton retë, pastaj i bashkon, i bënë grumbull ato dhe atëherë e sheh shiun se si rrjedh prej tyre. Ai lëshon prej së larti, nga retë e mëdha si kodra breshër dhe me të goditë këdo, e ia largon atij që do. Shkëlqimi i vetëtimës së dritës së resë gati se s’të merr të parit. Allahu bënë rrotullimin e natës e të ditës dhe në të gjitha këto ka fakte për ata që kanë të parit të shëndoshë”.⁴⁸⁴

4. Zoti i Madhërishëm është Ai që zbret shiun nga qielli, e jo natyra ashtu siç mendonte Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu dhe bashkëmendimtarët e tij.

Mendoj se këto ajete shumë qartë vërtetojnë të kundërtën e asaj që thoshte dhe e vepronte Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu rreth kësaj çështje dhe çështjeve tjera, që kundërshtojnë tekstet e Kur’anit Fisnik dhe hadithet e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

PIKA E TRETË: QËNDRIMI I TIJ NDAJ FORMIMIT TË VETËTIMËS

Një ditë Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu, rastësisht ndodhi po në të njëjtin fshat në Shqipëri, dhe në atë moment koha ndryshoi dhe qielli filloi të mbushet me re, dhe pastaj fillon të bjerë shi e të murmurojë dhe të vetëtojë, dhe në atë moment fshatarët fillojnë t’i luten Zotit që ta largoj prej tyre atë kohë të keqe, nga frika se ndoshta Zoti i dënon për shkak të ndonjë mëkati. Ata po ashtu besonin se vetëtimja është hekur i kuq nga zjarri që bie nga qielli ose gurë i zjarrtë, dhe kur Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu i pa se i luten Zotit për ta larguar prej tyre, iu drejtohet dhe u thotë: “Çka bëni, pse i luteni Zotit?” Ata i përgjigjen se duan që Zoti t’ua largojë atë të keqe, dhe në këtë përgjigje Hoxha reagon e u thotë: “Çka do ta detyrojë Zotin ta bëjë atë që ju kërkoni prej Tij?” Ata i thonë se askush s’mund ta detyrojë, por vetë Ai nga Mëshira e Tij. Në atë çast Hoxha Hasan Tahsin Efendiu u thotë: “Zoti nuk e dërgon vetëtimën e as që e largon prej jush!” Kur e pyesin se kush mund ta largojë përveç Zotit, ai u përgjigjet: “Instrumentet dhe natyra shkaktojnë vetëtimën dhe ato janë

⁴⁸⁴ En-Nur, 43-44.

burim i vetëtimës”. Në këto fjalë ata çuditen dhe i thonë: “*Mjerë për ty, o Hoxhë, çka thua?!*” Pastaj vazhdon Hoxha dhe u thotë: “*Sot do t’ua argumentoj atë që e them*”, dhe rastësisht afër tij ishte një gomar me samar, dhe i pyeti ata: “*A e shihni atë gomar atje?*” Kur i thanë se po, ai u thotë: “*Shikoni si do ta mbys gomarin me vetëtimë*”. Njëri prej tyre i thotë që ta bëjë atë, dhe kështu Hoxha e lidhë një copë hekur në samarin e gomarit dhe kur del përsëri vetëtimë e gjuan gomarin dhe në vend e mbytytë. Në atë çast Hoxha u thotë: “*A u bindët tash se Zoti nuk dërgon vetëtimën?*” Njerëzit u larguan të habitur nga sjelljet e Hasan Tahsin, ashtu siç habitem edhe unë me këto sjellje të Hoxhë Hasan Tahsin Efendiut!!!⁴⁸⁵

PIKA E KATËRT: QËNDRIMI I TIJ NDAJ ALFABETIT ARAB

Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu kundërshtonte ashpër përdorimin e alfabetit arab, ashtu siç kundërshtonte edhe propozimin e disa të tjerëve që të aplikohet alfabeti latin, dhe për këtë shkak ai kishte zbuluar një alfabet të posaçëm për gjuhën shqipe, por për shumë arsye, shumë shokë të tij nuk e kishin pranuar propozimin e tij. Mbi idenë e tij për pranimin e këtij alfabeti, Jani Vreto, një studiues bashkëkohor, shqiptar i krishterë ortodoks, thotë se Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu, kur refuzon idenë e alfabetit të tillë, thotë:

“Pejgamberi ynë ishte arab dhe fliste në gjuhën arabe, edhe Kur’ani është Shpallur në gjuhën arabe. Edhe unë e mësova arabishten dhe e lexoj Kur’anin shumë herë dhe ja këtu e kam me vete, dhe në të thuhet se Zoti i Madhërishëm ka dërguar për çdo popull pejgamber që ka folur në gjuhën e atij populli,⁴⁸⁶ po ashtu Zoti i ka dërguar secilit popull

⁴⁸⁵ Po aty, f. 132-133. Këtë ngjarje e transmeton historiani Ibrahim Daut Hoxha nga disa personalitete që kishin jetuar në kohën e Hoxhë Hasan Tahsin Efendiut, ndërsa më gjerësisht shihni punimet e Konferencës.

⁴⁸⁶ Autori nuk thekson ajetin, por mendoj se ai kishte për qëllim ajetin kur’anor:

(وَمَا أَرْسَلْنَا مِنْ رَّسُولٍ إِلَّا بِلِسَانِ قَوْمِهِ لِيُبَيِّنَ لَهُمْ فَيُضِلُّ اللَّهُ مَنْ يَشَاءُ)

وَيَهْدِي مَنْ يَشَاءُ ۚ وَهُوَ الْعَزِيزُ الْحَكِيمُ ﴿٤﴾ [إبراهيم: 4]

pejgamber nga mesi i tij.⁴⁸⁷ Aty po ashtu theksohet se ndër shenjat e mëdha të ekzistimit të Zotit janë qiejt, toka, gjuhët e ndryshme dhe ngjyrat e llojllojshme.⁴⁸⁸ Përveç kësaj edhe librat e shenjtë para Kur'anit Fisnik, si p.sh., Dhiata e Vjetër që është shkruar në gjuhën hebraike, ndërsa Dhiata e Re në gjuhën greke. Pa marrë parasysh gjuhët e tyre, ende sot e kësaj dite respektohen, çmohen dhe shenjtërohen nga njerëzit. Ja ku është Kur'ani para jush dhe ja ku janë ajetet dhe suret që flasin për atë që u thashë dhe le t'i lexojë ai që njeh arabishten e të vërtetohet për vërtetësinë e fjalëve të mia. Kur'ani i konsideron të gjitha gjuhët të barabarta dhe se alfabetet e gjuhëve të tilla respektohen dhe vlerësohen. Muslimanët obligohen ta mësojnë arabishten për ta lexuar Kur'anin Fisnik në gjuhën origjinale, gjegjësisht në gjuhën arabe dhe pastaj obligohen që ta përkthejnë për ata që nuk e njohin dhe që nuk e kuptojnë gjuhën arabe”.⁴⁸⁹

PIKA E PESTË: MENDIMI I AUTORIT NDAJ KËSAJ ÇËSHTJEJE

Theksova më parë se edhe pse ekzistonte presion i madh politik ndërkombëtar e kolonialist për ndryshimin e alfabetit arab dhe pranimin e alfabetit latin, ulematë shqiptarë e pranuan dhe e mbrojtën këtë ide të alfabetit latin, dhe argumentonin me ajete kur'anore, ashtu siç ishte rasti i Hoxhë Hasan Tahsin Efendiut, me argumente racionale, ashtu siç

“Nuk kemi dërguar asnjë pejgamber përpos në gjuhën e popullit që t’ua sqarojë...”
(Ibrahim, 4).

⁴⁸⁷ Siç duket ka për qëllim ajetin:

(إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ بِالْحَقِّ بَشِيرًا وَنَذِيرًا وَإِنْ مِنْ أُمَّةٍ إِلَّا خَلَا فِيهَا نَذِيرٌ ﴿٢٤﴾ [فاطر: 24])

“Ne të dërguam ty me atë që është e vërtetë, lajmërues, qortues, e nuk pati asnjë nga popujt që nuk pati të dërguar.” (Fatir, 24).

⁴⁸⁸ Siç duket ka për qëllim ajetin:

(وَمِنْ آيَاتِهِ خَلْقَ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَاخْتِلَافُ أَلْسِنَتِكُمْ وَالْوُكُوفُ إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِّلْعَالَمِينَ ﴿٢٢﴾ [الروم: 22])

“Nga argumentet e Tij është krijimi i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë argument për njerëz.” (Er-Rum, 22)

⁴⁸⁹ Po aty, f. 75-76.

argumenton hoxhë Hafëz Ali Korça dhe hoxhë Hafëz Ibrahim Dalliu, ku do ta vërejmë ma poshtë. Unë them se pa marrë parasysh përpjekjet dhe qëndrimet e tyre rreth kësaj çështjeje që ishte aktuale në kohën e tyre, nuk duhet harruar faktin se gjuha arabe është gjuha e Kur'anit dhe gjuha e Pejgamberit tonë Muhamedit a.s. (Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të !), dhe se ajo ka vlerë më të madhe se gjuhët dhe alfabetet e tjera në botë, dhe kjo nuk nënkupton urrejtjen dhe nënqimimin e gjuhëve të tjera botërore, përkundrazi... ngase Zoti i ka krijuar gjuhët si mjet për të komunikuar dhe për t'u njoftuar popujt e botës në mes vete.

Pra, gjuha arabe e ka vlerën e vet, për shkak se Kur'ani Fisnik është shpallur në këtë gjuhë dhe se Pejgamberi ynë (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), që na ka përcjellë Kur'anin është arab, hashimit dhe kurejshit. Pra, në bazë të këtyre vlerave arabishtja gëzon autoritetin e vet, por nuk do të thotë se arabët janë më të vlefshëm se të huajt, këtë gjë e vërteton edhe ajeti kur'anor në suren El Huxhuratë:

لِتَعَارَفُوا وَقَبَائِلَ شُعُوبًا وَجَعَلْنَكُمْ وَأُنْتَىٰ ذَكَرٍ مِّنْ خَلْقِنَا إِنَّا الْبَاقُونَ يَتَأَيُّهَا

([الحجرات: 13] ﴿ حَبِيرٌ عَلِيمٌ ۚ إِنَّ أَتَقَنُّكُمْ ٱللَّهُ عِنْدَ أَكْرَمَكُمْ ۚ إِنَّ ۝

“O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam juve prej një mashkull dhe një femre, ju bëmë popuj dhe fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat) e Allahut është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”.⁴⁹⁰

“Arsyeja që u jep vlerë, Zoti e di më mirë, është fakti që Zoti ju dha gjuhë, moral e vepra. Përveç kësaj, vlera është nga dituria ose nga vepra e mirë. Dituria ka parim dhe është fuqi e intelektit për të kuptuar dhe mësuar përmendësh, kurse fuqia e logjikës është fuqia e të shprehurit dhe ekspresivitetit. Arabët janë më të kuptueshëm, më të aftë për të mësuar përmendësh, dhe më të aftë në rrëfim e ekspresivitet, ndërsa gjuha e tyre është gjuha më e përkryer dhe më e dalluar në nocione.

Vepra mbështetet në moral që nënkupton instinktet e krijuara në shpirt dhe instinktet e tyre janë më të devotshme se instinktet e të tjerëve.

Ata janë më afër bujarisë, dorëdhënies, trimërisë dhe besnikërisë se të tjerët. Para Islamit kishin natyrë që pranonte të mirën, por të devijuar nga veprat, ngase nuk kishin dituri të shpallur, as sheriat hyjnor e as që dinin shkencë, kurse në mesin e tjerëve kishte njerëz që kishin libra të shpallur, fjalë pejgamberësh, por u humbën nga dobësia e

⁴⁹⁰ El Huxhurat, 13.

zemrave të tyre dhe instinktët e tyre të këqija. Dituria e arabëve,⁴⁹¹ përbëhej nga poezi e fjalime, njohuri rreth rrjedhës e ditëve të kaluara si dhe dinin atë për të cilën kishin nevojë në jetën e tyre për t'u orientuar me yje e të luftojnë. Kur e dërgoi Zoti Muhamedin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) me udhëzim pas një rruge të rëndë, Zoti i shndërroi nga traditat e xhahilietit që ua kishin mbuluar instinktët e zemrave të tyre në një instinkt të ri, të pastër e të udhëzuar. Në këtë mënyrë ata u bënë të përkryer në bazë të përkryerjes që ua zbriti Zoti i Madhërishëm, “bëri tokën të pëlleshme pasi ishte tokë e thatë dhe e fëlliqur përplot derra e egërsira, ku drunjtë filluan të mbijnë sikur asnjëherë më parë, dhe në këtë mënyrë, muhaxhirinët dhe ensarët u bënë krijesa më të rëndësishme e më të vlefshme përpos pejgamberëve a.s.(Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi ta !), dhe u bënë njerëzit më të mirë pas tyre ato gjenerata, të cilat do të veprojnë mirë deri në Ditën e Kiametit, si nga arabët ashtu edhe nga të huajt. Zoti e di më së miri, dhe falënderimi i takon vetëm Allahut. Zoti e mëshiroftë Pejgamberin tonë dhe Familjen e tij!...”⁴⁹²

Këtë që e cituam më sipër nga fjalët e Shejhul-Islamit, Ibn Tejmijes (Zoti e mëshiroftë!) është pikëpamja e tij rreth kësaj çështjeje,

⁴⁹¹ Këto fjalë i përmend Shejhul-Islam Ibni Tejmijje rreth vlerës së arabëve dhe dashurisë ndaj tyre, si p.sh.: **“Duani arabët për tre arsye: Se unë jam arab, se Kur’ani është arabisht, se banorët e Xhenetit do flasin arabisht dhe gjuha e Xhenetit është arabishtja”**; Imam Axhluni thotë se Taberaniu, Hakimi, Bejhekiu e të tjerë, transmetojnë nga Ibn Abasi me transmetim të shkëputur e të dobët. Edhe Taberaniu ka transmetuar nga Ebu Hurejre hadith (merfu’ë) me fjalët se: **“Unë jam arab, Kur’ani është arabisht dhe gjuha e xhenetlinjve është arabishtja”**; edhe pse ky hadith është i dobët, përsëri është më i fortë se hadithi i Ibn Abasit. Po ashtu edhe Ebu Shejhu transmeton hadith me sened të dobët (merfu’u) nga Ebu Hurejrja, me fjalët: **“Doni arabët dhe ruani ata, qëndrimi i tyre është dritë në Islam, ndërsa zhdukja e tyre është errësirë në Islam”**. Darakutni transmeton nga Ibën Umeri me fjalët: **“Dashuria ndaj arabëve është besim, ndërsa urrejtja e tyre është hipokrizi”**. Shih El-Mektebetul-Elfijjetu lis-sunnetin-Nebevijjetu, nga Xhemijjetu ihjait-turathil-arabij, Aman, Jordan, **Keshful-hafai ve muzilul-ilbasi amma ushtuhire minel-ehadithi ala elsinet-nasi**, Muhamed Axhluni Xherahi; Bejrut, Muessesetu li-risali, bot. 4,1405 hixh, vëll. 1, f. 414-415.

⁴⁹² Ahmed Ibn Tejmijje, Abdulhalim Ebu Abbas, **“Xhamiur-Resail”**; recensim i dr. Muhamed Reshad Refik Salim, Egjipt, pa vit të botimit, vëll. 1. F. 287; Mustafa Sabri, **“Muhtesar meukiful-akli vel-ilmi vel-alemi min Rabbil-alemin ve rusulih”**; i quajtur me titullin: **“El-kaulul-faslu bejnel-ledhine ju’minune bil-gajbi vel-ledhine la ju’minunë”**; Darus-Salam, Mektebetun-Nur, 1186 hixh. f. 115, 117, kapitulli **“Kush thotë se unë jam arab ose turk së pari, e më pas thotë se jam musliman, ai nënçon pejgamberinë”**.

dhe këtu, patjetër më duhet ta theksoj një të vërtetë se vlerësimi i popujve në baza nacionale apo gjuhësore nuk është cilësi e Islamit, nëse nuk veprohet sipas Sheriatit të shpallur të Zotit dhe Sunnetit të vërtetë të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) Begatitë dhe vlerat e një populli varen nga fakti se sa ata e praktikojnë Sheriatin e Zotit të Madhërishëm, qofshin ata arabë apo joarabë.

PIKA E GJASHTË: KRITIKË E SHKURTËR NDAJ MENDIMEVE TË HOXHË HASAN TAHSIN EFENDIUT

Këto ishin disa qëndrime të këtij Hoxhe të perëndimizuar dhe me ide iluministe. Pamë qartë drejtimin dhe doktrinën e tij filosofike gjysmë ateiste, gjatë shqyrtimit dhe analizimit të disa çështjeve dhe fenomeneve fetare e shkencore. Kjo doktrinë filosofike është e rrezikshme, ngase e largon Shpalljen nga intelektin dhe mbron cilësitë e Zotit të Madhërishëm, gjegjësisht cilësinë e hyjnisë së Zotit të Madhërishëm, i Cili një herë i krijon krijesat, pastaj kujdeset për furnizimin dhe lëvizjen e tyre.

Kjo është domethënia e faktit se Allahu është Zoti i njerëzve, i rregullon çështjet e tyre dhe e përmirëson gjendjen e tyre. Kur i ka krijuar Zoti i Madhërishëm krijesat, nuk i ka lënë në fatin e tyre ose në mëshirën e natyrës së pashpirt dhe ligjeve të saja. Në këtë kontekst, në Kur'anin Fisnik thuhet:

([السجدة: 7] طِينٍ مِّنَ الْإِنسِنِ خَلَقَ وَبَدَأَ خَلْقَهُ شَىْءٍ كُلِّ أَحْسَنِ الذِّى)

“Ai që përsosi krijimin e çdo sendi, e krijimin e njeriut e filloi nga balta”.⁴⁹³

([الأعلى: 3] فَهَدَىٰ قَدْرًا وَالَّذِي)

“Dhe i Cili përcaktoi e orientoi”.⁴⁹⁴

Në dialogun në mes Musait dhe Faraonit thuhet:

⁴⁹³ Es-Sexhde, 7.

⁴⁹⁴ El-A’la, 3.

يُضِلُّ لَا كِتَابٍ فِي رَبِّي عِنْدَ عِلْمِهَا قَالَ ﴿٥١﴾ الْأُولَى الْقُرُونِ بَالٌ فَمَا قَالَ)
 مِنْ وَأَنْزَلَ سُبُلًا فِيهَا لَكُمْ وَسَلَكَ مَهْدًا الْأَرْضَ لَكُمْ جَعَلَ الَّذِي ﴿٥٢﴾ يَنْسَى وَلَا رَبِّي
 ([طه : 51-53] ﴿٥٣﴾ شَتَّى نَبَاتٍ مِّنْ أَرْوَاجٍ بِهِ فَاَخْرَجْنَا مَاءً السَّمَاءِ

“Ai tha: “Si është gjendja e popujve të mëparshëm?” Musai (tha):
 “Dija për atë është te Zoti im, e i shënuar në një Libër. Zoti im nuk gabon
 e as nuk harron. (Zoti im) i cili për ju e bëri tokën si djep, për të mirën
 tuaj hapi rrugë nëpër të, lëshoi shi prej së larti, e kjo mundësoi që të
 mbijnë bimë të llojeve të ndryshme”.⁴⁹⁵

Rreth shpërndarjes së furnizimit në Kur'an thuhet:

﴿٥٤﴾ وَمُسْتَوْدَعَهَا مُسْتَقَرُّهَا وَيَعْلَمُ رِزْقُهَا اللَّهُ عَلَى إِلَّا الْأَرْضِ فِي دَابَّةٍ مِّنْ وَمَا ﴿٥٥﴾
 ([هود : 6] ﴿٥٦﴾ مُبِينٍ كِتَابٍ فِي كُلِّ

“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që Allahu të mos ia ketë garantuar
 furnizimin e saj. Ai e di vendbanimin dhe vendstrehimin e saj (pas
 vdekjes). Të gjitha (këto) janë në Librin e Njohur (Leuhi-Mahfudh).”⁴⁹⁶

Si mund të vlerësohet një doktrinë dhe si mundet që Hoxhë Hasan
 Tahsin Efendiu të thotë se Zoti i Madhërishëm është Krijuesi i krijesave, e
 pastaj ndërpret çdo ndërhyrje të Tij , që të lëvizin sipas ligjeve natyrore
 speciale biologjike e fiziologjike, kur dihet se Zoti i Madhërishëm thotë:

﴿٥٧﴾ الْعَالَمِ عَلِيمٍ لِّتَأْتِيَنَّكُمْ وَرَبِّي بَلَى قُلْ السَّاعَةُ تَأْتِينَا لَا كَفَرُوا الَّذِينَ وَقَالَ)
 وَلَا ذَالِكَ مِنْ أَصْغَرٍ وَلَا الْأَرْضِ فِي وَلَا السَّمَوَاتِ فِي ذَرَقٍ مِّثْقَالٍ عَنْهُ يَعِزُّ لَا
 [السبا : 3] ﴿٥٨﴾ مُبِينٍ كِتَابٍ فِي إِلَّا أَكْبَرُ

“Atij nuk mund t’i fshihet as në qiej e as në tokë sendi sa grimca e
 as më i vogël, e as më i madh, vetëm se janë të regjistruar në Librin e
 qartë”.⁴⁹⁷ Zoti di çdo gjë, madje edhe atomin që është grimcë më e vogël.

⁴⁹⁵ Ta-ha, 51-53.

⁴⁹⁶ Hud, 6.

⁴⁹⁷ Es-Sebe’e, 3.

Si mund të pranohet thënia se natyra ka ligjet e veta specifike të zhvillimit dhe lëvizjes jashtë Dijes së Zotit, Fuqisë dhe Dëshirës së Tij? Në këtë kontekst, Zoti i Madhërishëm thotë:

وَمَا وَالْبَحْرِ الْبَرِّ فَمَا وَيَعْلَمُ هُوَ إِلَّا يَعْلَمُهَا لَا الْغَيْبِ مَفَاتِحُ وَعِنْدَهُ *
 فِي إِلَّا يَابِسَ وَلَا رَطْبٍ وَلَا الْأَرْضِ ظُلُمَتْ فِي حَبَّةٍ وَلَا يَعْلَمُهَا إِلَّا وَرَقَةٍ مِنْ تَسْقُطُ
 [الأنعام : 59] مُمِينٍ كِتَابِ

“Ai di çka ka në tokë dhe në det. Ai e di për çdo gjeth që bie, dhe s’ka kokërr në thellësi të tokës, s’ka të njomë dhe s’ka të thatë që nuk është (shënuar) në Librin e qartë (Leuhi-Mahfudh)”.⁴⁹⁸

Kush e ngjallë tokën ose natyrën e vdekur me shi? Athua nga vetvetiu ngjallet? A vetë i nxjerr frytet pa ndonjë faktor tjetër, mendoj pa Fuqinë e Zotit të Madhërishëm?! Nëse thonë po, atëherë ne pajtohemi me ta, e nëse thonë jo, atëherë ne s’kemi të bëjmë me ata dhe do t’i kundërshtojmë deri në Ditën e Kiametit, ne punojmë të pavarur dhe larg tyre, dhe ne jemi të pastër në krahasim me ata, ngase ata i mohojnë ajetet e shumta të Kur’anit që konfirmojnë të kundërtën nga ajo që thonë e që besojnë. Në këtë kontekst në suren Fussilet, Zoti i Madhërishëm thotë:

إِنْ وَرَبَّتْ أَهْتَرَتْ أَلْمَاءَ عَلَيَّهَا أَنْزَلْنَا فَإِذَا خَشِيعَةً الْأَرْضِ تَرَى أَنَّكَ آيَتِهِ وَمِنْ
 ([فصلت : 39] قَدِيرُ شَيْءٍ كُلِّ عَلَى إِنَّهُ أَلْمَوِّقَ لَمْحَى أَحْيَاهَا الَّذِي

- “Nga argumentet e Tij është edhe toka që ti e sheh atë të thatë (shkretëtirë) e kur Ne i lëshojmë asaj shiun, ajo gjallërohet e shtohet. E, s’ka dyshim se Ai që e ngjalli atë, do t’i ngjallë të vdekurit, pse Ai ka mundësi për çdo gjë”.⁴⁹⁹

كُلِّ مِنْ وَأُنْبِتَتْ وَرَبَّتْ أَهْتَرَتْ أَلْمَاءَ عَلَيَّهَا أَنْزَلْنَا فَإِذَا هَامِدَةً الْأَرْضِ وَتَرَى
 [الحج : 5] بِهِجٍ زَوْجِ

⁴⁹⁸ El-En’am, 59.

⁴⁹⁹ Fussilet, 39.

- "E ti e sheh tokën e tharë - të vdekur, e kur Ne ia lëshojmë asaj ujin, ajo gjallërohet, shtohet dhe nga të gjitha llojet rritë bimë të këndshme".⁵⁰⁰

وَعَبَرُ صِنَوَانٌ وَخَيْلٌ وَزَرْعٌ أَعْنَبٍ مِّنْ وَجَنَّتْ مُتَجَبَّرَاتٌ قَطَعُ الْأَرْضِ وَفِي)
ذَٰلِكَ فِي إِنَّ الْأَكْلِ فِي بَعْضٍ عَلَىٰ بَعْضَهَا وَتُفْضَلُ وَاحِدٍ بِمَاءٍ يُسْقَىٰ صِنَوَانٍ

[الرعد: 4] ﴿يَعْقُلُونَ لِقَوْمٍ لَايَاتِ﴾

- "E në tokë, copa sipërfaqesh, të ngjitura njëra me tjetrën, kopshte të hardhisë të mbjella (të llojlojshme) dhe hurma (bimë këto) që janë të degëzuara në shumë trupa dhe jo të degëzuar (nga një filiz), e të gjitha ujiten nga një ujë, dhe Ne shijen në ngrënie të frutave të tyre e kemi dalluar njërin prej tjetrës. Edhe kjo dëshmon me argumente për njerëzit e mençur".⁵⁰¹

E vërtetë është se ata që pranojnë teorinë se natyra e vdekur kujdeset për veten dhe për sistemin e vet, janë njerëz që nuk kuptojnë, ngase sikur të mendonin pak, do të shihnin naivitetin e ideve që përkrahin.

Këtu, nuk kemi vend të theksojmë ajete tjera nga Kur'ani Fisnik që i refuzojnë dhe shkatërrojnë idetë e tilla filosofike, materialiste, të pashpresa dhe që janë larg të së vërtetës. Qëllimi ishte që të njihemi me ithtarin dhe pionerin kryesor të kësaj doktrine të devijuar të shqiptarët dhe mjafton me kaq që t'i kuptojmë disa karakteristika të kësaj doktrine. S'ka dyshim se kjo doktrinë, është doktrinë që nuk mund të pranohet për t'i kuptuar të vërtetat e Kur'anit Fisnik.

Në këtë studim përfituam njohuri historike të këtij drejtimi dhe të kësaj doktrine në kohën bashkëkohore, dhe s'ka dyshim se ka shkrime e punime të hulumtuesve dhe studiuesve tjerë shqiptarë që janë marrë me këtë çështje studimore, e që janë më të drejtë dhe më afër të së vërtetës objektive, që nuk karakterizohen me devijim e ateizëm. Edhe pse jetuan në kohën e Hoxhë Hasan Tahsin Efendiut, dalloheshin shumë nga Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu, ngase Hoxha ishte nën ndikimin e filosofisë perëndimore franceze, ndërsa ata qëndruan besnikë ndaj parimeve të shëndosha të besimit dhe mendimeve të tyre, pa kurrfarë ndikimi, si p.sh., hulumtuesi i njohur dhe orientalisti shqiptar, Haki Sharofi, i cili jetoi në fillim të shek. XX. Në këtë kontekst, ai thotë:

⁵⁰⁰ El-Haxh, 5.

⁵⁰¹ Er-Ra'd, 4.

"Studimi i shkencave natyrore nuk ndalohej në Kur'an, por është obligim, ngase ai që e njeh Zotin e Madhërishëm nëpërmes gjurmëve dhe argumenteve të gjithësisë është më i vlefshëm dhe më i respektuar se ai që e njeh nëpërmes imitimit dhe është i verbër".⁵⁰²

Filosofi dhe orientalisti ⁵⁰³ i njohur shqiptar, Ferit Vokopola, flet për idetë reformiste dhe emancipimin e gruas, por nuk i përket doktrinës së devijuar dhe as nuk mahnitet nga qytetërimi perëndimor francez, ashtu siç ndodhi me Hoxhë Hasan Tahsinin, dhe në këtë kontekst thotë: *"Besimi im islamik është burim dhe promotor i qytetërimit, kapitalit dhe fryteve të tij, mësues i njerëzimit, prijës i progresit dhe lulëzimit, përkrahës, nxitës dhe urdhërues për të kërkuar diturinë dhe njohurinë, shtyllë e moralit dhe edukatës, shkatërrues i injorancës dhe errësirës!... Ne kërkojmë përmirësimin dhe shfrytëzimin e kësaj bote ashtu siç kërkojnë që t'i përmirësojnë veprat për të përfituar lumturinë e ahiretit".⁵⁰⁴*

Qëllimi ynë në këtë studim është argumentimi i ekzistimit të personaliteteve shkencore orientaliste në kohën bashkëkohore që i përjetonin të njëjtat rrethana dhe sfida, të cilat i përjetoi edhe Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu, por pa pranuar doktrinën e devijuar filozofike perëndimore që e kishte pranuar Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu. Ndoshta për këtë, kishte ndikuar atmosfera e ndryshme që ekzistonte në qarqet e atëhershme shkencore. Mendimtarët e tillë objektivë jetuan nën hijen e shkencave të pastra shqiptare islame, ndërsa Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu, për fat të keq kishte jetuar në një ambient të prishur, labil dhe steril shkencor.

⁵⁰² Shih punimet e Konferencës Ndërkombëtare që u organizua në Shqipëri me rastin e përkujtimit të profesorit të njohur Haki Sharofi: Haki Sharofi dhe veprat e tij: Kumtesa, shkrime origjinale dhe përkthime, Botime të A.I.I.T.C., Tiranë 2000, 40.

⁵⁰³ **VËREJTJE:** Kur e përdorim termin **"orientalizëm"** ose **"orientalizëm shqiptarë"**, duhet të mos mendojmë se ka të njëjtin kuptim si ai i orientalizmit të perëndimorëve. Orientalizmi në kohën bashkëkohore të shqiptarët nënkupton atë që studion dhe njeh tre gjuhët orientale: arabishten, turqishten dhe persishten. Ky term po ashtu ka të bëjë edhe me atë që përkthen e shkruan për trashëgiminë letrare arabe, perse e turke, dhe në asnjë mënyrë nuk nënkupton konceptin e keq të orientalizmit që perëndimorët, të cilët e studiojnë gjuhën arabe ose perse, me qëllim që t'i devijojnë dhe shtrembërojnë tekstet e Kur'anit dhe Sunnetit. Pra, orientalizmi shqiptar ka domethënie të pastër e të ndritshme përkundër orientalizmit perëndimor.

⁵⁰⁴ **"Haki Sharofi dhe Vepra e tij"**; 58-59.

KAPITULLI I DYTË

DOKTRINA SHKENCORE EKSPERIMENTALE E ILUSTRUAR NË STUDIMET E MJEKUT PRIM. DR. Sci. Med. ALI FAHRI ILJAZI

HISTORIKU I KËTIJ DREJTIMI

Në këtë kapitull të disertacionit tim, dëshiroj që të njoftohemi me një metodë tjetër shkencore, krahas metodës së parë filosofike që ishte përhapur në shkrimet e dijetarëve dhe hulumtuesve shqiptarë gjatë studimeve kur'anore. Kjo metodë shkencore ose ky drejtim shkencor eksperimental, është më afër të vërtetës se sa metoda e parë filosofike. Kjo metodë kishte arritur kulmin e saj në kohën e fundit të këtij shekulli. Deri para disa vitesh, askush nuk ka shkruar në këtë lëmi, derisa doli në skenë profesori dhe mjeku i njohur specialist kardiolog dhe internist shqiptar nga Kosova, Prim. dr. Sci Ali Fahri Iljazi.

Dr. Ali Iljazi ka shkrime tejet të vlefshme në këtë sferë, Ai ende është gjallë dhe konsiderohet personalitet me famë të madhe shkencore. Para dy viteve ka shkruar librin e tij të njohur me titull: "Kur'ani dhe shkenca bashkëkohore".⁵⁰⁵

Lirisht mund të themi se ky libër i takon korpusit të librave të tefsirit të thuktë, dhe përmban në brendi tefsir të rezimuar objektiv të ajeteve që kanë të bëjnë me çështjet e krijimit të njeriut, gjithsesi dhe fenomeneve tjera natyrore, dhe këtu fshihet edhe urtësia e këtij libri dhe arsyeja që më shtyri ta studioj dhe analizoj. Dhashë Zoti, do të shqyrtoj më disa pjesë nga ky libër, që të njihemi me metodën e autorit gjatë komentimit të disa ajeteve kur'anore që kanë të bëjnë me disa tematika shkencore bashkëkohore. Ky libër plotëson librin e tij të parë që e ka shkruar katër vite më parë me titull: "Aspekte shkencore në Kur'an" e që ka të bëjë me fenomenet shkencore të Kur'anit Fisnik.

⁵⁰⁵ Gjakovë, Kosovë, 2000.

I: NJOHURI MBI JETËN, ARSIMIMIN DHE VEPRAT E PROF. DR. ALI FAHRI ILJAZIT

Prof. dr. Ali Fahri Iljazi u lind në qytetin e Gjakovës, Republika e Kosovës më 11.06.1949. Rrjedh nga një familje fetare dhe intelektuale. Nga rrjedha e kësaj familje kanë dalë më shumë se njëzet thirrës në fe, shtatë dijetarë dhe mësime të njohur, dhe i fundit prej tyre që ka vdekur ishte pikërisht i ati i tij Hoxha, Hafizi dhe Myderrizi i njohur Fahri Iljaz Efendiu (Zoti e mëshiroftë!).

Prof. dr. Ali Fahri Iljazi ka kryer shkollën fillore dhe të mesme me sukses të shkëlqyeshëm në vendlindje, pastaj ka vazhduar studimet universitare në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Sarajevës dhe ka diplomuar me sukses shembullor. Ka marrë shumë mirënjohje dhe medalje të arta e dhurata financiare. Më tej vazhdon studimet e specializimit në të njëjtin Universitet derisa i përfundon me sukses të shkëlqyeshëm në vitin 1979, pastaj vazhdon magistraturën dhe doktoraturën në Novi Sad, ish-Jugosllavi, në mes viteve 1981-1988, ku edhe përfundon me sukses të shkëlqyeshëm studimet në lëmin e sëmurjeve të brendshme të pneumologjisë. Në vitin 1987 fiton titullin e lartë të mjekësisë "primarius" nga Ministria e Kulturës dhe Arsimit të Republikës së Kosovës. Deri tash ka botuar më shumë se tetëdhjetë artikuj e hulumtime shkencore,⁵⁰⁶ në revista të ndryshme mjekësore, si dhe prezantoi në shumë konferenca ndërkombëtare që organizoheshin në shumë qytete të ish-Jugosllavisë. Ai po ashtu ka një libër të njohur rreth sëmurjeve të mushkërive, dhe krahas këtij libri merret edhe me tefsirin shkencor të Kur'anit, dhe në këtë sferë ka botuar më shumë se shtatëdhjetë artikuj e punime shkencore nëpër revista islame në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Maqedonisë. Ndër punimet e tjera të tij janë edhe titujt që vijojnë:

1. Agjërimi nga aspekti medicinal;
2. Aspekte shkencore në Kur'an;
3. Kur'ani dhe shkenca bashkëkohore; dhe:
4. Mrekullia dhe komentimi i Kur'anit në dritën e njohurive shkencore.⁵⁰⁷

⁵⁰⁶ Shih revistën islame filosofike e kulturore me titull: **"Frymëzimi"**; numrat. 1-10. Këtë revistë që përmban punime e artikuj të ndryshëm shkencor rreth mrekullisë së Kur'anit, e boton vetë dr. Ali Iljazi në qytetin e vet-Gjakovë.

⁵⁰⁷ Prof. dr. Ali Iljazi vet e shkroi biografinë në shtëpinë e tij në qytetin e Gjakovës, kur e vizitova për të biseduar rreth çështjeve shkencore më 27.07.2001. Gjatë kësaj vizite, ai

Mbështetja ime më e madhe në studimin e kësaj tematike do të jetë në librin e fundit mbi mrekullitë e Kur'anit të prof.dr.Ali Fahri Iljazit, dhe në disa ligjërata shkencore e fetare që i ka zhvilluar në manifestime të ndryshme nëpër xhamia, posaçërisht gjatë muajit të Ramazanit. Momentalisht kryen detyrën si hatib vullnetar në xhaminë qendrore në qytetin e Gjakovës në Kosovë, dhe në të njëjtën kohë është mjek specialist në Spitalin Shtetëror dhe në ordinancën e tij private. Metoda e tij atraktive ka ndikuar që rreth tij të tubohen shumë të rinj muslimanë e intelektualë të sferave të ndryshme.

Për sa i përket aftësisë së tij shkencore në tefsirin e Kur'anit Fisnik, të prof. dr. Ali Fahri Iljazit, me plot respekt dhe konsideratë ndaj tij, në bazë të asaj që vërejta gjatë takimeve të mia dhe bisedave me të, si dhe në bazë të specializimit të tij në sëmundjet e zemrës dhe sëmundjet e brendshme, them se njohuritë e tij mjekësore plotësojnë njohuritë e tij në Sheriat, konkretisht në tefsirin e Kur'anit Fisnik, e të cilat burojnë nga imani i tij i fortë se duhet t'i shërbejë Librit të Zotit të Madhërishëm.

Ndoshta ky kontribut i tij është rezultat i edukatës së vërtetë islame që e ka përfituar dhe trashëguar nga i ati i tij, Hoxha dhe alimi Fahri Iljaz Efendi. Nëse e kuptojmë këtë të vërtetë, mund të themi se prof.dr. Ali Fahri Iljazi nuk ka mësuar në shkollë, fakultete e universitete fetare që të përfitojë njohuri nga shkencat e Sheriatit dhe në gjuhën arabe, si dhe t'i njeh metodat e mufesirëve (komentuesve) klasikë e modernë. Është më se e vërtetë se ai ka nevojë për t'u thelluar shumë në gjuhën arabe, gjegjësisht në gramatikë, stilistikë, prozodi, hadith, në terminologjinë e hadithit, në shkencat e Kur'anit, në parimet e fikhut, edhe pse vetë me sytë e mi pashë, se ai posedonte një numër të madh të librave fetare dhe tefsireve të ndryshëm, sufizmit e moralit, që ishin pronë e tij dhe e të atit të tij, alimit Fahri Iljaz Efendiut.

Interesi i tij për tefsirin e Kur'anit Fisnik ka lindur si rezultat i leximeve të shumta të artikujve të ndryshëm nga dijetarët dhe hulumtuesit bashkëkohorë perëndimorë e arabë muslimanë, qofshin ato botime origjinale ose përkthime rreth tefsirit shkencor të Kur'anit Fisnik. Krahës kësaj, ai ka njohuri elementare të gjuhës arabe edhe shkencave të Sheriatit. Pra, si duket, këto ishin disa shtylla dhe pikënisje shkencore prej të cilave prof.dr. Ali Fahri Iljazi ka filluar të komentojë ajetet e librit të Zotit në baza shkencore bashkëkohore e moderne.

më furnizoi me tituj dhe burime të reja shkencore që kishin të bënin me disertacionin tim rreth komentimeve shkencore të Kur'anit.

II: PARIMET E TEFSIRIT SHKENCOR TË PROF. DR. ALI FAHRI ILJAZI ME SHEMBUJ NGA TEFSIRI, DHE KOMENTET E TIJ TË AJETEVE KUR'ANORE

Në hyrjen e librit të tij: "Kur'ani dhe shkenca bashkëkohore", theksohen çështjet e rëndësishme që i shqyrton autori, duke vënë disa parime mbi të cilat vijojnë rezultatet e mëvonshme. Natyra e hyrjeve të tilla ka të bëjë me argumentimin e ekzistimit dhe autenticitetit të metodës bashkëkohore shkencore si doktrinë e re për t'i kuptuar ajetet kur'anore që kanë kuptime shkencore.

Autori në hyrje thekson ajetin kur'anor:

بِرَبِّكَ يَكْفُ أَوْلَمَ الْحَقُّ أَنَّهُ لَهُمْ يَتَبَيَّنَ حَتَّى أَنْفُسِهِمْ وَفِي الْأَفَاقِ فِي آيَاتِنَا سُنُرِيهِمْ
([فصلت : 53] شَهِدُ شَيْءٍ كُلِّ عَلَى أَنَّهُ)

*"Ne do t'u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t'u bëhet e qartë se ai (Kur'ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë ?"*⁵⁰⁸

Pas theksimit të këtij ajeti, autori potencon edhe disa çështje tjera, të cilat mund të radhiten në pikat vijuese, për ta kuptuar metodën e autorit. Në këtë kontekst, ai thotë: "Ai që studion Kur'anin Famëlartë me sinqeritet dhe seriozitet, i çliruar nga përkufizimet e mëparshme e të errëta ideologjike, do të zbulojë pasuri ari dhe do ta kuptojë të vërtetën shpirtërore, kulturore e qytetëruese që ka sjellë Islami. Së pari, unë ju konfirmoj se Kur'ani Famëlartë nuk është libër shkencor që hulumton imtësitë dhe hollësitë e shkencës. Ky është Libër i Zotit të Madhërishëm, Krijuesit të qenieve dhe është e natyrshme që ky Libër t'i hulumtojë çështjet e krijimit dhe sistemit preciz në këtë gjithësi të gjerë, këtë koherencë të çuditshme në tokë, dete, oqeanë e në vetë qenien e njeriut. Në këtë kontekst, Zoti i Madhërishëm thotë:

الْأَلْبَبِ لِأُولَى لَأَيَّتِ وَالنَّهَارِ اللَّيْلِ وَاحْتَلَفِ وَالْأَرْضِ السَّمَوَاتِ خَلْقِ فِي إِنِّ)
([آل عمران : 190])

⁵⁰⁸ Fussilet, 53.

"Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës ka argumente të ⁵⁰⁹ qarta për ata që kanë arsye dhe intelekt". ⁵¹⁰

Pastaj vazhdon dhe flet për disa çështje të rëndësishme për të cilat flet Kur'ani Fisnik qysh para katërmëdhjetë shekujsh në mënyrë të shkurtër apo të zgjeruar. Kur'ani flet për krijimin e Gjithësisë që kur ishte si top zjarri, mbi yjet, kometet, sistemet diellore, tokën, hënën, etapat e krijimit të njeriut, llojet e kafshëve, rrotullimi i tokës rreth vetes dhe rreth Diellit, parimet e moralit njerëzor dhe shoqëror etj. ⁵¹¹

Autori mbron tezën e atyre që thonë se Kur'ani Fisnik nuk ka zbritur që të jetë libër kozmologjik, gjeografik, kimik, mjekësor, por ka zbritur që të jetë Libër i imanit në Zotin e Madhërishëm dhe Libër i udhëzimit për të gjithë njerëzit.

Në momentin kur arsyeton dhe mbron këtë aspekt themelor, ai mbron edhe mendimin e atyre që thanë se ekzistojnë shumë çështje shkencore dhe mrekulli për të cilat ka folur Kur'ani gjatë kohë më parë, kur shkencat moderne s'kishte mundësi dhe ishte e paafte që t'i kuptonte të vërtetat e tilla. ⁵¹² Mbi precizitetin e definicionit të shkencës, teorisë e hipotezës, ai thotë: *"Shkenca është çështje që mund të verifikohet, fillon nga një teori ose hipotezë që argumentohet me fakte dhe konfirmohet apo përgënjeshtrohet nëpërmes eksperimentit. Shumë herë zhvlerësohen hipotezat e mëparshme dhe nuk mund të konfirmohet asgjë nëpërmes metodës së eksperimentit"*. ⁵¹³

Rreth përputhshmërisë së Kur'anit dhe shkencës thuhet se të dyja ecin bashkë në një rrugë të njëjtë dhe në një vijë të përbashkët, si dy binjakë. Sot shkencat janë bërë ndihmuese më e mirë për kuptimin e tekstit kur'anor dhe përderisa Zoti i Madhërishëm është Krijuesi i të gjitha shkencave dhe njohurive, atëherë Libri i Tij do të ketë mundësi që t'u përballojë të gjitha sfidave në çdo kohë.

Ai është libër i mrekullisë eternale në këtë jetë, i sfidon të gjithë njerëzit dhe se Islami është shok i afërt dhe i sinqertë i shkencës dhe diturisë, ashtu siç thotë Zoti i Madhërishëm:

⁵⁰⁹ Ali Imran, 190.

⁵¹⁰ Dr. Ali Iljazi, **"Kur'ani dhe shkencat bashkëkohore"**; 7.

⁵¹¹ Po aty, f. 8.

⁵¹² Po aty, f. 8.

⁵¹³ Po aty, f. 8.

إِلَّا إِلَهَ لَا بِالْقِسْطِ قَائِمًا الْعِلْمِ وَأُولُوا وَالْمَلَكَةِ هُوَ إِلَّا إِلَهَ لَا أَنَّهُ اللَّهُ شَهِدَ

([آل عمران : 18] الْحَكِيمُ الْعَزِيزُ هُوَ)

"Allahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij, Fuqplotit e të Urtit".⁵¹⁴ Edhe në një ajet tjetër thuhet:

وَمَا كَثِيرًا خَيْرًا أَوْتِيَ فَقَدْ الْحِكْمَةَ يُؤْتِ وَمَنْ يَشَاءُ مِنَ الْحِكْمَةِ يُؤْتِي

([البقرة : 269] الْأَلْبَبِ أُولُوا إِلَّا يَذْكُرُ)

"Ai i dhuron urtësinë atij që do e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësi e madhe,⁵¹⁵ përveç të mençurve, këtë nuk e kupton kush".⁵¹⁶

Autori është në dijeni të plotë për vështirësitë me të cilat do të ballafaqohet gjatë tefsirit (komentimit) të Kur'anit Fisnik. Ai deklaroi se komentimi shkencor i Kur'anit nuk është gjë e lehtë, dhe se komentuesi duhet të ketë njohuri të mjaftueshme për ta aplikuar këtë art, dhe këto fjali i argumenton me thënien e hulumtuesit dhe dijetarit të njohur francez dr. Maurice Bucaille: "Secili njeri që dëshiron të kuptojë Kur'anin në mënyrë të vërtetë, patjetër duhet të posedojë njohuri enciklopedike".⁵¹⁷

Kjo është një hyrje e shkurtër e autorit, para se të kalojë në rrethanat historike të këtij arti dhe në periudhat e zhvillimit të tij që nga koha e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e deri më sot. Ai thekson se pasi Pejgamberi ndërroi jetë, tefsirin e udhëhiqnin katër Hulefai-Rashidinët, Abdullah ibën Mes'udi, Ubej ibn Ka'bi, Zejd ibn Thabiti, Ibn Abasi, etj. Pas kalimit të tre dekadave ideale, shkenca e tefsirit u zhvillua dhe kaloi në periudha tjera, si p.sh., periudha tradicionale, periudha racionale, pastaj periudha shkencore e tefsirit. Në kohën e progresit shkencor, në periudhën abaside, dolën në pah personalitete të njohura në tefsirin e Kur'anit Fisnik.

Në këtë periudhë po ashtu u dalluan edhe personalitete tjera shkencore në shumë lëmi fetare e filosofike, si p.sh., Imam Gazaliu, Shejh

⁵¹⁴ Ali Imran, 18.

⁵¹⁵ El Bekare, 269.

⁵¹⁶ Po aty, f. 9.

⁵¹⁷ Po aty, f. 10.

Ebu El-Fadli el Mersi dhe më vonë Imam El-Hafidh Xhelaluddin Es-Sujutiu.

Më vonë në kohën bashkëkohore, vërejmë edhe personalitete tjera shkencore në tefsir, si p.sh., Xheuheri Tantavi dhe Shejh Muhamed Abduhu, ndërsa si hulumtues u dalluan Nedim El-Xhisër, Mustafa Mahmud, Maurice Bucaille, etj.⁵¹⁸ Pas kësaj, autori vazhdon të definojë tefsirin shkencor dhe në këtë kontekst thotë: *"Me këtë nënkuptohet që njeriu të përdorë gjatë tefsirit të Kur'anit terminologji shkencore moderne"*.⁵¹⁹ Kjo lëvizje në tefsir ka ekzistuar në të kaluarën në shkrimet e dijetarëve që njiheshin me klauzolën: "Thënie mbi përmbajtjen e të gjitha shkencave në Kur'an", qofshin shkenca të kohës së tyre ose shkenca që do të zbulohen më vonë, dhe prijës i kësaj lëvizjeje, s'do mend që ishte Imam Gazaliu, i cili në librin e tij enciklopedik "Ihja ulumiddin", transmeton thënien e Ibn Mes'udit r.a.: *"Kush dëshiron diturinë e të parëve dhe të më vonëve, le të vrojtojë rreth Kur'anit"*.⁵²⁰

Përpos kësaj, autori vazhdon të rrëfej për Imam Gazaliun dhe kontributin e tij në këtë shkencë duke thënë: "Të gjitha shkencat merren nga një det, nga deti i diturisë së Zotit të Madhërishëm. Ky det është vepër e Zotit të Madhërishëm dhe s'ka breg, dhe sikur të ishte ngjyrë për Fjalët e Zotit do të thahej deti para se të përfundonin Fjalët e Allahut. Nga veprat e Zotit është edhe sëmundja dhe shërimi, dhe në këtë kontekst, kur flet për Ibrahimin a.s. Zoti i Madhërishëm thotë:

([الشعراء: 80] يَشْفِيهِ فَهُوَ مَرْصُتٌ وَإِذَا)

"Dhe kur sëmurem, ai më shëron".⁵²¹ Këtë det të Zotit e kupton ai që kupton medicinën, ngase medicina i njeh sëmurjet në përgjithësi, i njeh shenjat dhe simptomat e sëmurjes, mënyrën e shërimit dhe pasojat e tyre".⁵²²

Pastaj autori vazhdon për Imam Gazaliun dhe thotë: *"Nga veprat dhe krijimet e Zotit është përcaktimi i pozicioneve të diellit dhe hënës, dhe s'mund të dijë një gjë e tillë përpos atij që njeh këtë shkencë, e cila sot*

⁵¹⁸ Po aty, f. 12.

⁵¹⁹ Ky definicion i tefsirit shkencor nuk pranohet dhe këtë do ta sqarojmë më vonë.

⁵²⁰ Po aty, f. 12.

⁵²¹ Esh Shu'ara, 80.

⁵²² Po aty, f. 11-12, edhe autori nuk thekson vendin prej ku e ka marrë citatin nga libri **"Ihja ulumid-din"** as vëllimin e as faqen, dhe ky padyshim është një lëshim i madh metodologjik.

është shkencë në vete, si p.sh., astronomia dhe astrologjia. Njeriu nuk mund të kuptojë ajetin kur'anor

﴿فَعَدَّلَكَ فُسُوكَ خَلَقَكَ الَّذِي﴾ ﴿الْكَرِيمِ بِرَبِّكَ غَرَّكَ مَا الْإِنْسَانُ يَتَأْتِي﴾

([الإنفطار : 6-8] ﴿رَبِّكَ شَاءَ مَا صُورَةَ أَيِّ فِي﴾)

"O ti njeri, po ç'të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është bujar e i urtë? I cili krijoi, të përsosi dhe të drejtoi, të dha formën që Ai dëshiron",⁵²³ vetëm nëse njeh morfologjinë e organeve, anatominë dhe histologjinë.

Çështja e tefsirit shkencor apo përmbajtjes së Kur'anit shkenca të parëve e të vonshmëve, ka qenë preokupim edhe Imam Sujutit, i cili mendonte njësoj si Imam Gazaliu. Imam Sujuti fillon fjalën e tij në "El-Itkan" me ajetin kur'anor:

([الأنعام : ﴿تُحْشَرُونَ رَبِّهِمْ إِلَىٰ شَيْءٍ مِّنَ الْكِتَابِ فِي فَرْطَانَا مَا﴾])

[38

"Asgjë nuk kemi lënë pas dore nga evidenca."⁵²⁴, dhe me ajetin:

﴿لِّلْمُسْلِمِينَ وَبُشْرَىٰ وَرَحْمَةً وَهُدًى شَيْءٍ لِّكُلِّ تَبَيَّنَّا الْكِتَابَ عَلَيْكَ وَنَزَّلْنَا﴾

([النحل: 89])

"Ne ty të shpallëm Librin sqarim për çdo send",⁵²⁵ dhe me disa hadithe të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), si p.sh., hadithin që e ka transmetuar Imam Tirmidhiu dhe të tjerët se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "Do të ndodhin fitne", dhe kur e kanë pyetur: "Cila është rrugëdalja, o Pejgamber i Zotit?" Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) u ka thënë: "Libri i Zotit, në të keni informata për të kaluarën dhe për ata pas jush dhe vendim për ju."⁵²⁶

⁵²³ El-Infitar, 6-8.

⁵²⁴ El-En'am, 38.

⁵²⁵ En-Nahl, 89.

⁵²⁶ Këtë hadith me këtë shprehje nuk e kam gjetur te Imam Tirmidhiu. Në versionin e Tirmidhiut në "Sunenin" e tij, nr. 2195 thuhet "Kapitulli rreth asaj se do të ndodhin fitne si nata e errët". Shih: "Muhammed ibn Isa Ebu Isa Et-Tirmidhi Es-Sulmij"; recensoi Ahmed Muhamed Shahin dhe të, tjerë Bejrut, Daru ihjait-turathil-arab, vëll. 4, f. 487.

Në një hadith tjetër, Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë: *"Sikur të mos dinte Zoti diçka, nuk do të dinte për grimcat, karkalecin dhe mushkonjën"*.⁵²⁷ Prof. dr. Ali Iljazi i thekson fjalët e Imam Sujutit dhe Imam Gazaliut për të përforcuar metodën dhe qëndrimin e tij ndaj kësaj çështje. Në mesin e dijetarëve të vonshëm, të cilët konfirmojnë ekzistimin e doktrinës shkencore në tefsir është edhe Shejh Muhamed Abduhu, i cili thotë se elektriciteti, telefoni dhe treni elektrik nënkuptohen nga ajeti kur'anor:

مِنْ ءَاذَانِهِمْ فِي أَصْبِعِهِمْ يَجْعَلُونَ وَبَرْقٌ وَرَعْدٌ ظَلَمْتُ فِيهِ السَّمَاءِ مِنْ كَصِيبٍ أَوْ

([البقرة: 19] ﴿ ١٩ ﴾ الْمَوْتِ حَذَرَ الصَّوَاعِقِ

*"Ose (shembulli i tyre është) si ndonjë shi i rreptë prej së larti në errësirë, me bubullimë"*⁵²⁸ *e me vetëtimë, e prej frikës së vdekjes, nga rrufeja ata vejnë gishtat në veshët e tyre"*.⁵²⁹

Pastaj vazhdon e thekson fjalët e dr. Mustafa Mahmudit rreth kësaj çështje, dhe thotë: *"Në Kur'anin Fisnik ka shumë ajete që argumentojnë se Islami është fe e shkencës, qytetërimit dhe përparimit. Zbulimet e reja shkencore na ndihmojnë shumë në komentimin e ajeteve të tilla. Ajetet që flasin për astronominë dhe gjithësinë komentohen në bazë të zbulimeve të reja. Kur'ani nuk është vetëm Libër i Sheriatit ose Besimit, e as nuk përfaqëson aty vetëm aspektet stilistike, retorike e gramatikore. Kur'ani Fisnik është enciklopedi e madhe shkencore që i përmbledh parimet e moralit, politikës, psikologjisë, sociologjisë, historisë, medicinës, filosofisë dhe biologjisë."*

Ata më kundërshtuan dhe më sulmuan kur u përpoqa ta komentoj tefsirin kur'anor në bazë të racios dhe intelektit shkencor, si dhe kërkuan prej meje diplomë nga Az'hari, sikur Kur'ani ka zbritur që vetëm ata ta komentojnë, ngase të tjerët s'kanë aftësi për një gjë të tillë".⁵³⁰

Unë mendoj se fjalët e dr. Mustafa Mahmudit nuk pranohen në përgjithësi, ngase ata që kanë kërkuar prej tij diplomë Az'hari, kishin për

⁵²⁷ Po aty, f. 13; Shih po ashtu **"El-Ithun fi ulumil-Kur'an"**; vëll. 3, f. 136.

⁵²⁸ El Bekare, 19.

⁵²⁹ Po aty, f. 14.

⁵³⁰ Po aty, f. 14, cituar nga **"El-Kur'an Muheveletun li fehmin asrijjin"**, Mustafa Mahmud. Autori nuk ka theksuar faqen prej ku e ka marrë citatin dhe ky gjithashtu është lëshim metodologjik i pa falshëm, ngase në këtë mënyrë është e pamundur të përcjellim me saktësi burimet e transmetimit të citateve.

qëllim që komentuesi të ketë mësuar nga dijetarët e mëdhenj të Az'harit të nderuar. Këtu qëllimi është se njohuritë e sakta të Sheriatit i ndihmojnë komentuesit ta kuptojë Librin e Zotit të Madhërishëm e jo diploma dhe fesi. Fesi nuk ndihmon në komentimin e Librit të Zotit të Madhërishëm në asnjë mënyrë, por është vetëm uniformë e njohur islame, kurse diploma vërteton se ke mësuar nga dijetarët e tillë dhe ke përfituar prej tyre. Ata kishin për qëllim faktin se shkenca e vërtetë mundëson hulumtimin e Librit të Zotit të Madhërishëm.

Pas kësaj hyrje të rëndësishme, autori ua sqaron lexuesve faktin se ekzistojnë edhe aspekte tjera shkencore që janë pjesë e studimit të Kur'anit, si p.sh., aspektet retorike, stilistike, të koncepteve, kreative, formale, mrekullie, të Sheriatit, rrëfime, psikike, strukturale, konsensus, metodologjike, muzikore, melodike, estetike e artistike.⁵³¹

Aspekti shkencor është po ashtu pjesë e aspekteve të tilla, dhe pikërisht ky aspekt i intereson më shumë autorit të librit. Autori flet me objektivitet edhe për aspektet e tjera, e jo vetëm për këtë aspekt të Kur'anit. Edhe pse ekzistojnë përpjekje të shumta njerëzore për zbulimin e thesarit dhe margaritarëve nga Libri i Zotit të Madhërishëm, Kur'ani vazhdon të jetë Kur'an Fisnik, ngase është Fjalë e Zotit të Madhërishëm, që është Cilësi e përhershme e Madhërisë së Tij, mesazh i përhershëm e i saktë dhe i pastër nga çdo lloj antagonizmi.⁵³²

Duka i pasur parasysh hulumtimet e shumta shkencore që janë realizuar rreth Kur'anit dhe duke i marrë parasysh njohuritë e thella e të gjera të autorit, nuk mund të analizoj çdo punim të tij, por me lejen e Zotit, do të përpiqem që t'i theksoj disa hulumtime shkencore të rëndësishme të prof. Ali Fahri Iljazit, duke i ilustruar me shembuj dhe citate rreth metodës së tij në koment e tefsir, për të konfirmuar natyrën shkencore eksperimentale të studimeve të tij të Kur'anit Fisnik. Nëpërmes të kësaj ekspozite do ta paraqes së pari metodën e tij në tefsir, e pastaj do të vijoj me vështirimet e mia kritike ndaj metodës së tij.

⁵³¹ Po aty, f. 15-19.

⁵³² Po aty, f. 20.

III: SHEMBUJ PRAKTIK NGA TEFSIRI DHE KOMENTI I TIJ I DISA AJETEVE KUR'ANORE

1). ILUSTRIMI I DISA FENOMENEVE QË ARGUMENTOJNË FUQINË E ZOTIT TË MADHËRISHËM

Në komentimin dhe në tefsirin e tij të ajtetit kur'anor:

([الذاریات 20:] ﴿لِّلْمُؤْمِنِينَ ءَايَاتٌ مِّنَ الْأَرْضِ وَفِي﴾)

"Edhe në tokë ka argumente për ata të bindurit",⁵³³ ai thotë: "Ekzistojnë shumë ajete në Kur'anin Famëlartë që argumentojnë se Islami është fe e vërtetë dhe se madhëria e tij shfaqet në shumë çështje shkencore, dhe shkenca moderne është lëndë konkrete për komentimin e çështjeve të tilla. Në ajetet e lartpërmendura Zoti i Madhërishëm kërkon prej njeriut që t'i observojë të vërtetat e tilla, t'i studiojë në tokë dhe në vetë njeriun. Është vërtetuar shkencërisht se ekzistojnë më shumë se një milionë e gjysmë lloje të ndryshme kafshësh dhe më shumë se gjysmë milioni lloje bimësh në tokë. Kur'ani Famëlartë nxit njeriun gjithmonë të mendojë e përsiatë, ngase sipas të dhënave shkencore, njeriu shfrytëzon vetëm 10% nga potenciali i trurit, dhe për ta shfrytëzuar edhe pjesën tjetër të mbetur të trurit, njeriu duhet të lëvizë dhe ta zgjojë pjesën tjetër të trurit të mbyllur apo të papërdorur. Ky tru i mbuluar në vete ngërthen 90% të fuqisë së papërdorur intelektuale".⁵³⁴

2). KOMENTIMI I ZEMRËS MADHËSHTORE TË NJERIUT

Në tefsirin dhe komentimin e ajtetit kur'anor:

([الذاریات 21:] ﴿تُبْصِرُونَ أَفَلَا أَنفُسَكُمُ وَفِي﴾)

"Po edhe në veten tuaj, a nuk jeni kah e shihni ?"⁵³⁵ thotë:

⁵³³ Edh-Dharijat, 20.

⁵³⁴ Po aty, f. 24.

⁵³⁵ Edh-Dharijat, 21.

"Në këtë ajet kur'anor ka pak fjalë, por domethënie të mëdha. Zoti i Madhërishëm kërkon prej njeriut që t'i vështrojë shenjat dhe faktet e Krijuesit të Madhërishëm. Kur'ani së pari na urdhëron të studiojmë dhe t'i observojmë faktet e gjithësisë, e nëse s'mund të bëjmë një gjë të tillë, atëherë obligohemi të shohim vetveten tonë që t'i shohim faktet dhe argumentet hyjnore. Në vazhdim vijojnë disa të vërteta mbi njeriun, si p.sh., zemra. Zemra është gjëja më precize në botë, në çdo 23 sekonda zemra shtypë pesë litra gjak dhe brenda një dite 19.000 litra gjak, ndërsa për gjashtëdhjetë vjet shtypë 480.000.000 litra gjak. Kjo shtypëse-pompë interesante peshon 230 gr. te gratë, ndërsa 280 gr. te burrat. Gjatësia e rrjedhjes së gjakut është 100 km për 23 sek. dhe kjo shpejtësi është 215 herë më e shpejtë se satelitet. Mrekullia hyjnore mund të jetë më e kuptuar për trurin e njeriut në mënyrë vijuese: Rruazat e kuqe të gjakut jetojnë 42 ditë, ndërsa ata që kanë rezistencë më të madhe jetojnë 127 ditë, e kjo nënkupton se gjaku ynë ripërtërihet çdo dy muaj, që po ashtu nënkupton se dyqind milionë rruaza gjaku çdo ditë lindin dhe vdesin në trupin e njeriut, dhe për këtë shkak, Allahu i Madhërishëm kërkon prej njerëzve të shikojnë madhështinë e krijimit të Tij, duke ua tërhequr vërejtjen dhe duke u thënë: "A nuk jeni kah e shihni?"⁵³⁶

3). KOMENTI I TIJ MBI TRURIN MADHËSHTOR TË NJERIUT

Truri i njeriut është kompjuteri (aparati) më preciz në botë. Ky aparat përbëhet prej më shumë se njëqind miliardë qeliza të vogla, dhe mund të krahasohet me më shumë se dhjetë mijë programe kompjuterike në funksion të vazhdueshëm e të përhershëm. Sipërfaqja e nevojshme për këtë kompjuter është 250.000 km² e që mund të krahasohet me gjysmën e sipërfaqes së Francës.

Dhe këtë nuk mund ta bëjë asnjë aparat tjetër në botë deri në Ditën e Gjykimit, dhe këtu autori deklaron se pa marrë parasysh formën e aparateve, asnjëherë nuk do të mund të bëjë atë që e bën truri i njeriut. Çdo ditë shkenca na sjell gjëra të reja që i zbulon në vetë njeriun dhe, p.sh.: kohëve të fundit u zbulua në Universitetin e Michiganit se lëkura dhe flokët e njeriut përmbajnë në vete minerale të ndryshme si argjend, plumb, hekur, alumin, etj. Shpejtësia e erërave dhe e stuhive rrallëherë tejkalon 130-140 km në orë, ndërsa shpejtësia e ajrit dhe oksigjenit që del

⁵³⁶ Po aty, f. 27-28.

nga gjoksi dhe mushkëritë e njeriut arrijnë shpejtësinë prej 390 km në orë. Sa mrekulli e madhe e Krijuesit të Madhërishëm!⁵³⁷

Pastaj vazhdon e thotë: “Në realitet njeriu është qenie e çuditshme elektrike, ngase në trupin e tij punojnë gjashtëdhjetë miliardë qeliza sipas elektricitetit natyror që e ka vendosë Krijuesi i Madhërishëm. Shkenca vërteton se njeriu nga brenda ka elektricitet negativ, ndërsa nga jashtë pozitiv. Në bazë të kësaj shkenca moderne mund të bëjë ekzaminime të ndryshme kardiologjie e që quhet EKG ose EEG edhe atë për të zbuluar nxehtësinë elektrike në mes trurit dhe zemrës. Zoti thotë në Kur'anin Famëlartë:

([الذاریات : 21] تَبْصُرُونَ أَفَلَا أَنْفُسَكُمْ وَفِي)

"Po edhe në veten tuaj, a nuk jeni kah e shihni?"⁵³⁸

Pas theksimit të këtij ajeti, autori vazhdon e thotë se shumë njerëz e lexojnë këtë ajet pa vetëdije dhe pa përsiatje të thellë rreth kuptimit të tij. Në bazë të analizimit dhe studimit tonë të këtij ajeti, vërejmë se ekzistojnë shumë ajete në veten tonë. Ndoshta ndokush mund të thotë se unë vetë vendosi apo “unë bëj si të dua”- por kjo nuk vlen dhe nuk është e saktë, ngase trupi i njeriut është pronë e Zotit të Madhërishëm. A mund të ndalësh të rrahurat e zemrës tënde vetëm edhe për një çast?! (Nëse ndalet, a mund ta bësh që të rrahë përsëri? Si ke guxim të thuash se ti vendos për veten tënde?! A nuk e sheh se edhe kur flen zemra nuk ndalet nga të rrahurat?

4). KOMENTI I TIJ MBI APARATIN MADHËSHTOR TË FRYMËMARRJES DHE RRUAZAVE TË BARDHA TË GJAKUT

Për sa i përket frymëmarrjes, pyete veten se a merr frymë sipas dëshirës tënde? Duhet të dish se procesi i frymëmarrjes është operacion instiktiv. Ti merr frymë 16 herë për një minutë pa dëshirën tënde, dhe kur vjen urdhri hyjnor ndalet, askush s'mund ta rikthejë më kurrë. E njëjta gjë vlen edhe për stomakun dhe procesin e tretjes së ushqimit. A ndodhin të gjitha këto veprime sipas dëshirës tënde? Jo, asnjëherë! Funksioni i zorrëve dhe mënyra e lëvizjes së ushqimit në to, dhe shpërndarja e ushqimit nëpër trup, mbajtja e ushqimit të nevojshëm dhe nxjerrja e

⁵³⁷ Po aty, f. 28.

⁵³⁸ Edh-Dharijjat, 21.

ushqimit të panevojshëm jashtë, ndodhin sipas dëshirës tënde apo funksionojnë vetë pa të pyetur fare? E njëjta gjë vlen edhe për rruazat e bardha të gjakut kur ballafaqohen me viruse helm-prurës brenda trupit. Rruazat e tilla janë të përgatitura për vetëmbrojtje nëpërmes prodhimit të lëndëve të posaçme për mbrojtje brenda trupit të njeriut. A urdhëron ti, që të funksionojnë proceset e tilla në brendinë tënde e që i ngjajnë luftës së madhe defanzive?! A ti ndërhyjnë në proceset e tilla biologjike e kimike? Për një sekondë zhvillohen mijëra procese në trupin tënd pa e ditur fare. Të gjitha këto organe lëvizin sipas dëshirës së Zotit të Madhërishëm.

Mëshira e Zotit të Madhërishëm është e madhe kur i krijoi këto organe që të jenë në shërbimin tonë, por kuptohet, nën kontrollin e Tij, ngase në të kundërtën, njeriu nuk do të jetonte, nuk do të punonte dhe nuk do ta luante rolin e vet në këtë gjithësi dhe në këtë ekzistencë, p.sh., sikur të ishin proceset dhe të rrahurat e zemrës në duart tona, nën kontrollin tonë dhe sipas dëshirës sonë, atëherë çfarë do të ndodhte? S'ka dyshim se do të duhej gjithnjë të jemi të zgjuar, që ta kontrollojmë zemrën se a punon në rregull apo jo, dhe kështu nuk do të flinim asnjëherë nga frika se mos po ndodhë ndonjë ç'rregullim në të rrahurat e zemrës.

Sikur të ishte barku në kontrollin dhe në dëshirën tonë, do të detyroheshim që pas çdo ushqimi të kontrollojmë procesin e tretjes, gjegjësisht a zhvillohet në mënyrë normale apo jo, nga frika se mos po ndodhë ndonjë ç'rregullim. Pastaj autori thotë se të gjithë këto shembuj janë të njohur për njerëzit. Zoti e ka krijuar njeriun në këtë formë për t'u treguar njerëzve se nuk kanë kurrfarë mundësie të ndërhyjë në këto gjëra, se çdo gjë është në duart e Zotit të Madhërishëm dhe se çdo gjë ndodhë sipas Dëshirës, Fuqisë dhe Madhërisë së Tij.⁵³⁹

Autori e zgjat fjalën e tij dhe komentin rreth ajetit të sipërpërmendur në pjesën e parë të librit të tij, si dhe është përpjekur shumë që të tregojë Madhërinë e Zotit të Madhërishëm në krijimin e njeriut, ngase shumë njerëz nuk i njohin të vërtetat e tilla.

Ai nuk mjaftoi vetëm me paraqitjen e ideve shkencore, por përmes gjithë kësaj dëshironte që t'i korrigjojë mendimet njerëzore dhe t'i përmirësojë konceptet e tyre të gabuara.

⁵³⁹ Po aty, f. 30-34.

5). KOMENTI I TIJ I AJETIT KUR'ANOR:

[النجم : 43] وَأَبْكِي أَصْحَاكَ هُوَ وَأَنَّهُ)

"Dhe se Ai bën për të qeshë dhe bën për të qarë".⁵⁴⁰

Në këtë kontekst, ai thotë: *"Shumica e njerëzve lexojnë këtë ajet pa u thelluar në domethëniet e tij të mëdha. Nëse vëzhgojmë më thellë rreth tij, do të vërejmë se ajeti përmban në vete mrekulli të madhe hyjnore.*

Nëse i shikojmë njerëzit e tërë botës do të shohim se fenomeni i qeshjes dhe i qarjes është identik në mes njerëzve, pa marrë parasysh llojllojshmërinë e ngjyrës, gjuhës dhe kombeve të tyre. Nuk ekziston buzëqeshje angleze, amerikane apo afrikane, por ekziston buzëqeshje e përbashkët për të gjithë. Po ashtu nuk ekziston qarje aziatike e as qarje australiane, por ekziston qarje e përbashkët për të gjithë, ekziston një qendër në trurin e madh të njeriut që kontrollon ndjenjat, të cilat nxisin qarje ose qeshje me urdhër të Zotit të Madhërishëm, dhe kjo nënkupton se qeshja ose buzëqeshja ndodhë nga dëshira e Zotit të Madhërishëm dhe nga Mëshira e Tij. Kjo argumentohet me faktin se i Madhërishmi ua ka dhuruar të gjitha krijesave këtë cilësi. Po ashtu vërehet se Zoti i Madhërishëm përmes kësaj krijon drejtësi në mes njerëzve, ngase kur Zoti dhuron diçka, u dhuron të gjithëve pa dallim fare.⁵⁴¹

Të gjithë janë të barabartë në këto begati, në dhurata e dhunti hyjnore dhe se Zoti i Madhërishëm është i drejtë. Edhe pse i përmendëm të gjitha këto të vërteta, megjithatë ekzistojnë disa njerëz që nuk pranojnë një gjë të tillë, dhe me krenari e mendjemadhësi ngrenë zërin lartë e bërtasin: *Njeriu i drejtë, i fuqishëm dhe stabil vendos për ardhmërinë e vet dhe se ai dirigjon vetveten e vet...!*"⁵⁴²

⁵⁴⁰ En-Nexhm, 43.

⁵⁴¹ Qeshja dhe qarja janë cilësi të posaçme vetëm për njeriun, ngase asnjë qenie apo gjallesë tjetër s'mund të qeshë apo të qajë. Rreth këtij fenomeni të njeriut, më gjerësisht shih: Muhamed Adil Mahmud Ebu El-Hajr, **"Ixtihadat fit-tefsiril-ilmi fil-Kur'anil-Kerim"**; Kajro, bot.1, 1988, f. 38-42.

⁵⁴² Po aty, f. 36-37.

6). KOMENTI I TIJ I AJETIT:

وَتُعِزُّ نَشَاءُ مِمَّنْ أَلْمَلِكُ وَتَنْزَعُ نَشَاءُ مَنْ أَلْمَلِكُ تُؤْتِي أَلْمَلِكُ مَلِكُ أَللَّهِمْ قُلْ
([آل ٢٦] قَدِيرُ شَيْءٍ كُلِّ عَلَى إِنَّكَ أَلْخَيْرُ بِيَدِكَ نَشَاءُ مَنْ وَتُذِلُّ نَشَاءُ مَنْ

عمران: 26

"Thuaj: "O Allah, Sundues i çdo sendi, Ti ia jep pushtetin atij që do, Ti ia heq prej dore pushtetin atij që do, e lartëson atë që do dhe e përul atë që do. Çdo e mirë është vetëm në dorën Tënde, vërtet, Ti ke mundësi për çdo gjë!"⁵⁴³

Dr. Ali Fahri Iljazi thotë: "Mendimi im ndaj ajetit kur'anor:

(نَشَاءُ مِمَّنْ أَلْمَلِكُ وَتَنْزَعُ)

"Dhe ia merr pushtetin atij që do...", është; se nuk ekziston person që zbret apo tërhiqet vetë nga pushteti, pozita ose pasuria nga modestia apo vetvetiu, por duhet t'i merret me forcë ose dhunë, dhe domethënia e fjalës arabe (النزع) "En nez'u"-nënkupton marrje me forcë, dhe si rezultat i kësaj çështje janë zhvilluar shumë revolucione dhe grushtështete të përgjithshme prej atyre që mendonin se janë përgjithmonë mbretër të njerëzve dhe që mendonin se mund të bëjnë çdo gjë. Në këtë ajet ka argument se në pozitë, në pasuri apo në autoritet, nuk mund të vijë askush vetvetiu, përpos me dëshirën e Zotit të Madhërishëm, Mirësisë, Fuqisë dhe Caktimit të Tij. Njeriu nuk posedon asgjë dhe nuk mund ta vazhdojë (shtyejë) exhelin (çastin e vdekjes) as edhe për një sekondë, edhe pse ka rezultate laboratorike që përgëzojnë shëndetin e njeriut. Pra, njeriu nuk posedon gjë. Shumë herë shohim ndokënd që vdes para nesh dhe vdes papritmas para nesh- me caktimin e Zotit të Madhërishëm. Ndoshta do të thonë se i ka ra infarkti ose sulmi në tru, por të gjitha këto janë shkaqe, kurse faktori kryesor dhe i vërtetë është se exheli (çasti i vdekjes) i njeriut ka ardhur ashtu si thotë ajeti kur'anor:

([الأعراف: 34] يَسْتَقْدِمُونَ وَلَا سَاعَةً يَسْتَأْخِرُونَ لَا أَجْلُهُمْ جَاءَ فَإِذَا)

"E kur t'u vijë afati i tyre,⁵⁴⁴ ai s'mund të shtyhet për asnjë moment e as të shpejtohet më parë".⁵⁴⁵

⁵⁴³ Ali Imran, 26.

⁵⁴⁴ El A'raf, 34.

Në të njëjtën mënyrë vazhdon autori edhe në pjesët tjera të hulumtimeve që ndodhen në libër, dhe në çdo çështje kozmologjike mbështetet në ajet kur'anor. Mendoj se mjafton me kaq që të kalojmë në vlerësimin dhe analizimin e metodës së tij që e ka përdorur në librin e tij.

IV: ILUSTRIMI I METODËS SË AUTORIT NË SHQYRTIMIN E ÇËSHTJEVE TË INSPIRUARA DHE TË NXITURA NGA AJETET KUR'ANORE DHE VLERËSIMI I SAJ

Pas kësaj ekspedite shkencore me këtë autor të vlefshëm, unë arrita të kuptoj disa karakteristika të metodës së tij, ato janë:

- Shumë rrallë argumenton me fjalët e komentuesve të mëdhenj, si Imam Fahrudin Raziu, Imam El Kurtubiu, Imam El Bejdaviu, Imam Ebij Hajan... etj. Do të ishte më mirë dhe më saktë së pari të mbështetej në idetë dhe përpjekjet e gjigantëve të tillë të tefsirit dhe domethëniesve të ajetit që do të komentohej, e pastaj le t'ia mësyjë komentimit në mënyrë shkencore .
- Ndonjëherë i qaset zbërthimit të çështjeve gramatikore për të ilustruar urtësinë e përdorimit të fjalëve të tilla në Kur'an, dhe kjo ndodhë pak herë.⁵⁴⁶
- Synon dhe i ndërlidh fenomenet e ndryshme shkencore dhe natyrore, si p.sh., ndodhjen e tërmetejeve, eksplozimit e vullkaneve dhe lëvizjen e kodrave me fenomenin e Ahiretit që do të ndodhë, gjegjësisht fenomenet nga destabilizimi i gjithësisë, eksplozimi i Diellit dhe zhdukja e yjeve para Ditës së Gjykimit.⁵⁴⁷
- Çdo fenomen natyror e ndërlidhë me Fuqinë e Zotit të Madhërishëm dhe se Fuqia dhe Dëshira e Zotit qëndrojnë pas çdo gjëje. Kjo çështje është pozitive dhe e rëndësishme për të, përkundër metodës që e përdorte Hoxhë Hasan Tahsin Efendiu.
- I flet në mënyrë të drejtpërdrejtë intelektit njerëzor kur i paraqet të vërtetat e reja shkencore për të cilat ka folur Kur'ani shekuj më parë, dhe e thërret atë që të mendojë e përsiatë rreth tyre.

⁵⁴⁵ Po aty, f. 37-39.

⁵⁴⁶ Po aty, f. 129-130.

⁵⁴⁷ Po aty, f. 115-130.

- Shpesh-herë argumenton me ajete të ndryshme rreth të gjitha çështjeve dhe problematikave fetare dhe shkencore, dhe nga ajo që kam parë, deklaroj se ai me sukses të madh ka zgjedhur domethënien përkatëse të ajeteve, edhe pse në disa raste nuk e ka përkthyer ajetin mirë.⁵⁴⁸
- Argumenton me fjalët e dijetarëve dhe hulumtuesve muslimanë dhe jomuslimanë, por ajo që mund të thuhet si vështirësi negativ për të, është fakti se ai nuk thekson numrin e faqes e as titullin e librit prej të cilit ka marrë citate, përpos në raste të rralla.
- Kultura e tij është e gjerë dhe burimet e librit të tij janë të shumta, sa që autori harmonizon burimet e njohura sufiste, si p.sh., veprat e Xhelaludin Rumiut, Imam Gazaliut, Muhjedin ibn Arabiut, Abdulganij Nabulsiut, Abdulkadir Xhejlanit, Ibn Kajjimit, Malik ibn Nebij, Sejjid Kutubit, Muhamed Husejn Dhehebiut, Muhamed Muteveli Sha'ravit, Mustafa Mahmudit, Abdulmexhid Zendanit dhe mjekëve të njohur nga ish-Jugosllavia dhe shtetet e tjera,⁵⁴⁹ dhe s'do mend se tërë kjo e pasuron metodën e tij dhe e lartëson vlerën e saj shkencore.
- Ndonjëherë i analizon fjalët dhe përbërjet kur'anore në bazë të gramatikës dhe rregullave të saj për të kuptuar domethënien e vërtetë të ajetit.⁵⁵⁰
- Ndonjëherë nuk ruan kronologjinë e tematikave të studiuara dhe kësisoji krijon tollovi në fjalën e tij. Derisa flet për një temë dhe pasi i thekson ajetet përkatëse, menjëherë kalon në një temë tjetër që s'ka lidhje me temën e parë.⁵⁵¹ Kjo e vërtetë gjendet në temën e tij rreth krijimit, embriologjisë dhe evolucionit, sipas këndvështrimit kur'anor dhe shkencor.⁵⁵²

⁵⁴⁸ Po aty, f. 186-197.

⁵⁴⁹ Po aty, p.sh.: Në fjalët e tij rreth të vërtetës dhe esencës së shtatë qiejve thekson ide dhe mendime shumë të çuditshme. Sipas mendimit tim, me gjithë respektin dhe konsideratat që kam ndaj autorit, megjithatë, mendimet e tilla shkencore nuk janë aspak të vërteta, si p.sh.: Ai thotë se është zbuluar se drita ka shtatë ngjyra të ndryshme prej të kuqes deri në vjollcë; pastaj kjo u ngjanë shtatë shkollave muzikore, se java i ka shtatë ditë, se fëmija finalizon formimin e vet në muajin e shtatë. Ai zbulon se drita e Diellit ka shtatë ngjyra për shkak të bashkimit të elektroneve me hidrogjen, dhe nga kjo nënkuptohet se eksplozimi i elektroneve dhe përhapja e tyre në shtatë bota, d.m.th. në shtatë qiej!!! Shih detajet në të njëjtin burim, f. 175.

⁵⁵⁰ Po aty, f. 159-168.

⁵⁵¹ Po aty, f. 173-180.

⁵⁵² Po aty, f. 159.

- Ka lënë pas dore një çështje të rëndësishme shkencore dhe metodologjike. Pra, si mund të neglizhojë potencimin e ideve që i ka marrë prej të tjerëve. Është e pamundshme që të gjithë kapitujt e librit të jenë të tij, ngase në bibliografi ka potencuar shumë tituj si burim dhe literaturë të përdorur. Kjo çështje edhe më tepër na mjegullon trurin dhe vështirëson përpjekjen tonë për të njohur doktrinën e autorit dhe përcaktimin e drejtimit të tij. Autenticiteti dhe potencimi i detajeve të literaturës së shfrytëzuar është shumë i rëndësishëm dhe theksimi i burimit të fjalëve është begati shkencore dhe fetare.
- Nuk i përmend shkaqet e shpalljes së ajeteve, as llojet e leximeve, (kuraetet Kur'anore) e as parimet e fikut, përpos në raste të rralla,⁵⁵³ as çështjet stilistike, as problematikat sekondare. Përqëndrimi i tij më i madh ishte në interesimin e tij në citimin e zbulimeve shkencore të hulumtuesve të ndryshëm.
- Nuk kam vërejtur ndonjë dozë rezerve ndaj çështjeve të tilla shkencore që i thekson, i përmend ato sikur të ishin të vërteta dhe realitete e jo teori, edhe pse një numër i madh i çështjeve shkencore janë ende teori dhe hipoteza. Sikur çështjet fetare që kanë nevojë për verifikim shkencor, po ashtu edhe çështjet shkencore nuk pranohen nga hera e parë, përpos pas vërtetimit dhe konfirmimit të nevojshëm shkencor. Secili që lexon librin e tij, punimet e tija shkencore i konsideron mendimet dhe zbulimet e tilla si të pranuar dhe realitete, dhe kjo nuk është fare e vërtetë.
- Vështrim tjetër i rëndësishëm që mund t'i jepet autorit është fakti se ai natyralistët dhe dijetarët e shkencave humane i lartëson në pozitë shumë të lartë kur komenton ajetin kur'anor:

([فاطر : 28] ﴿ غَفُورٌ عَزِيزٌ ۚ إِنَّهُ أَعْلَمُتُ أَعْبَادِهِ مِنَ اللَّهِ تَخَشَىٰ إِنَّمَا ﴾)

"Vërtetë prej robërve të Tij vetëm dijetarët i frikësohen Zotit",⁵⁵⁴ dhe në këtë kontekst ai thotë: "Nga ajeti i lartpërmendur nxjerrim një pyetje: "Cilët janë dijetarët që i frikësohen Atij ? Përgjigja vjen se ata janë dijetarët që kanë specializuar në studimin e krijesave që i ka krijuar Zoti i Madhërishëm, qofshin krijesa njerëzore, shtazarake apo bimore. Intelekti njerëzor mund t'i njeh shkencat e tilla në bazë të observimit,

⁵⁵³ Po aty, f. 204.

⁵⁵⁴ Fatir, 29.

*hulumtimit e eksperimentit, por shpesh ndodhë se njeriu pasi t'i përfundojë eksperimentet laboratorike dhe eksperimentale nuk mund t'i kuptojë disa çështje që nuk u nënshtrohen shqisave dhe eksperimentit, si p.sh., çështja e shpirtit dhe materies si dhe cili është gjetur më parë, shpirti apo materia".*⁵⁵⁵

Nga përgjigja e autorit kuptoj se përkufizimi dhe përcaktimi i llojit të dijetarëve ne ajetin e sipërm me: “ dijetarët e shkencave të botës bimore dhe shtazore janë njerëz special dhe të respektuar te Zoti, sepse vetëm këta i frikësohen Zotit, kurse të tjerët, jo! ” është i pavend dhe jo i qëlluar, dhe kjo është vërtetë e çuditshme! Ai nuk duhej të harronte rolin dhe nivelin e lartë të dijetarëve të cilët mirren me problematikën e moralit dhe të zemrës, akaidit, fikhut, tefsirit, hadithit, sheriatit, gjuhës e retorikës nga ajeti i tillë fisnik. A është e vërtetë se ata nuk dinë frikën nga Zoti dhe nuk i frikësohen singërisht !?. Nuk është ashtu siç mendon autori i ndershëm, shpresoj se ai do ta korrigjoj kete mendim me vone.

- Nga ana tjetër, autori është shumë i dobishëm në disa çështje pa dalë apo devijuar nga tema. Ai flet për rëndësinë e ujit, mjaltës dhe fryteve të ndryshme sipas aspektit kur'anor dhe shkencor. Këtu nuk ka dalë fare nga tema, madje as edhe sa një fije floku. Pastaj vazhdon hulumtimin e tij me ajetin kur'anor:

مَنْ وَجَعَلْنَا فَفَتَقْنَهُمَا رَتْقًا كَانَتْا وَالْأَرْضَ السَّمَوَاتِ أَنْ كَفَرُوا الَّذِينَ يَرِ أَوْلَمَ)

([الأنبياء : 30] ﴿ ٣٠ ﴾ يُؤْمِنُونَ أَفَلَا حَى شَى كُلِّ أَلْمَاءِ

“A nuk e dinë ata të cilët nuk besuan se qiejt e toka ishin të ngjitura, e Ne i ndamë ata të dyja dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi,⁵⁵⁶ a nuk besojnë?”⁵⁵⁷

الشَّجَرِ وَمِنْ بِيُوتًا الْجِبَالِ مِنْ آتَخَذِي أَنْ أَلْخَلِ إِلَى رَبُّكَ وَأَوْحَى ﴿ ١٧ ﴾

ذُلًّا رَبِّكَ سُبُلَ فَاسْلُكِي الثَّمَرَاتِ كُلِّ مِنْ كُلِّ ثُمَّ ﴿ ١٨ ﴾ يَعْرِشُونَ وَمِمَّا

⁵⁵⁵ Po aty, f. 180.

⁵⁵⁶ El-Enbija, 30.

⁵⁵⁷ Po aty, f. 188-196.

ذَٰلِكَ فِي إِنَّ لِلنَّاسِ شِفَاءٌ فِيهِ الْوَلَانُهُ مُخْتَلَفٌ شَرَابٌ بَطُونَهَا مِنْ يُخْرِجُ

([النحل : 68 - 69]) يَتَفَكَّرُونَ لِقَوْمٍ لَّآيَةٍ ﴿٦٩﴾

“Zoti i dha instinkt bletës: "Ndërto shtëpi nëpër kodra (male), nëpër drunj (pemë) dhe nëpër kulmet që ata (njerëzit), ndërtojnë. Pastaj ha nga të gjitha (llojet) frytet dhe futu nëpër rrugët e nënshtruara (e të mësuar) prej Zotit tënd. Nga barqet e tyre (të bletëve) del lëng, ngjyra e të cilit është e ndryshme dhe në të cilën ka shërim (ilaç)⁵⁵⁸ për njerëz. Edhe në këtë ka arsye për atë popull që mendon thellë ".⁵⁵⁹

Nga ndonjëherë ndërlidhë fjalën dhe komentin e tij me ngjarje nga biografia e Pejgamberit, edhe pse ndërlidhja e tillë nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me tekstin, si p.sh., kur flet për rëndësinë e qumështit, thotë se qumështi në Islam është simbol i diturisë ashtu siç ndodhi në Natën e Miraxhit, kur Xhibrili i solli dy enë Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), e në njërin prej të dy enëve kishte qumësht dhe Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) zgjodhi qumështin (diturinë).⁵⁶⁰

- Disa herë, kur dëshiron të përforcojë fjalën e tij dhe të pasurojë hulumtimin e tij, argumenton me hadithe pejgamberike.
- Argumenton me fjalë të mjekëve, filosofëve dhe dijetarëve të mëdhenj muslimanë dhe jomuslimanë, si p.sh., Ibn Sinës, Ibn Rushdit, Imam Gazaliut, Palmerit, Vivinos, Tonkurit, etj.⁵⁶¹
- I thekson mësimet dhe leksionet e dobishme gjatë studimit dhe analizimit të disa çështjeve kur'anore dhe shkencore. Kjo pikë ishte shumë pozitive për autorin. Besimi kaplonte zemrën, ndjenjat dhe emocionet e tij. Shumë herë kërkon prej lexuesve që të marrën mësim nga begatitë e shumta që janë të panumërta, e që ia ka dhënë Zoti i Madhërishëm njeriut, dhe për të parë këtë të vërtetë, ai flet me fjalë të veta që ta vërtetojë rëndësinë e tyre.
- Pasi përfundon fjalën e tij në detaje dhe precize për mjaltin dhe dobitë e saj nga aspekti kur'anor dhe shkencor, autori thotë:

⁵⁵⁸ En-Nahl, 68 -69

⁵⁵⁹ Po aty, f. 206-241.

⁵⁶⁰ Po aty, f. 197.

⁵⁶¹ Po aty, f. 213-215.

Ashtu siç është bleta e gjallë dhe precize në zgjedhjen e ushqimit në ndërtimin e çerdhes, në mbrojtjen e dashamirëve dhe në prodhimin e ilaçit (mjaltës), gjithashtu duhet të jetë edhe gjendja e muslimanit dhe e besimtarit të vërtetë. Ai nuk duhet të ushqehet me ushqim të keq e të ndaluar, por duhet të kërkojë ushqim të pastër e hallall...

لَقَوْمٍ لَّأَيَّةٌ ذَالِكَ فِي إِنَّ لِلنَّاسِ شِفَاءٌ فِيهِ الْوُثَّةُ مُخْتَلَفٌ شَرَابٌ بَطُونَهَا مِنْ تُخْرُجُ)

[النحل: ٦٩] (يَتَفَكَّرُونَ)

(Nga barqet e tyre (bletëve) del lëng, ngjyra e të cilit është e ndryshme dhe në të cilin ka shërim (ilaç) për njerëz.)

Pra, kështu edhe muslimani duhet të flet fjalë të ëmbla si mjalti, fjalë që shëron zemrat e njerëzve dhe asnjëherë nuk flet fjalë amorale që dëmtojnë njerëzit.

Siç thotë Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) bleta as nuk e thyen e as nuk e dëmton drurin apo bimën prej të cilës thithë nektarin, kështu duhet të jetë edhe muslimani i vërtetë dhe i edukuar me edukatë të vërtetë islame, me moral të bukur, me vepra të mira pa dëmtuar e pa tradhtuar të tjerët. Kështu, pra, në këtë mënyrë mund të marrim shembull nga bleta për përmirësimin e jetës sonë, të fitojmë barërat e zemrave tona nga Kur'ani Famëllartë".⁵⁶²

- Ai i thekson mendimet shkencore që kundërshtojnë tekstet kur'anore dhe parimet islame, ashtu siç veproi me reagimin e tij kundër dijetarit suedez që quhet Nils Olaf Jacobson, i cili në teorinë e tij thotë se shpirti i njeriut peshon 21 gram në bazë të eksperimenteve të tij që i ka bërë me njeriun në momentin e agonisë së vdekjes. Ai peshonte çdo të sëmurë që ishte afër vdekjes në një peshore të saktë para vdekjes dhe pas vdekjes, dhe në bazë të kësaj, kur vdes njeriu nga trupi i tij humbin disa gramë nga pesha e tij para vdekjes!!! Autori reagon ndaj kësaj dhe thotë se këto janë rezultate të pabaza, thashetheme dhe gënjeshtër, ngase zvogëlimi i tillë në peshën e të vdekurit, pa dyshim vjen nga ajri dhe oksigjeni që dalin nga mushkëritë.⁵⁶³

- Shqyrton disa çështje shpirtërore të sufizmit që kanë të bëjnë me llojet e shpirtrave dhe shtatë shpirtrave që i theksojnë dijetarët sufistë, si p.sh., shpirti nxitës, shpirti qortues, shpirti frymëzues, shpirti i qetë,

⁵⁶² Po aty, f. 216-217.

⁵⁶³ Po aty, f. 456.

shpirti i pajtuar, shpirti i pëlqyer dhe shpirti i përkryer dhe llojet e shtatë botëve që i përmend sufisti i madh Xhelaludin Rumi, si psh., bota paraprake, bota hyjnore, bota e fuqisë, bota e pasurisë, bota e koncepteve, bota e formave dhe bota e natyrës..., ⁵⁶⁴ pastaj mekamatet e larta dhe shkrirja në Zotin e Madhërishëm, etj.

- Shkurt thënë, nga kjo çështje kuptojmë se së pari, autori nuk është dashur të thellohet në këto tema të rënda e të vështira sufiste, të cilat nuk mund t'i kuptojnë shumë dijetarë e hoxhallarë që punojnë në fushën e thirrjes islame, as njerëzit e rëndomtë.

Kështu që as Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), as sahabët fisnikë e të devotshëm nuk kanë aplikuar diçka të tillë që u takon gjërave të vështira e të rënda. Ne s'dimë gjë se ata i kanë hulumtuar këto çështje, dhe kështu, edhe ne duhet të bëjmë atë që kishin bërë ata me çështjet e besimit dhe mos ua vështirësojmë njerëzve parimet e kësaj feje, si dhe të mos shtyjmë besime e çështje metafizike në çështjet filosofike, të cilat nuk janë transmetuar nga Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i mbrojtur nga mëkatet, ngase Islami është fe për të gjithë njerëzit dhe karakterizohet me besim jo të komplikuar, por të lehtë e të thjeshtë.

Nuk mund të përkufizojmë të kuptuarit e fesë vetëm në një grup njerëzish, gjegjësisht vetëm në filosofët dhe sufistët që janë të zotët e mekamateve dhe simbolistë... ⁵⁶⁵ Ne jemi të urdhëruar për lehtësim dhe se Zoti dëshiron vetëm gjëra të lehta për ne, e jo të vështira. Çështjet që i thekson autori janë të vështira dhe rëndë konceptohen. Së dyti, këto çështje janë plotësuese dhe sekondare në jetën e muslimanëve, dhe për rrjedhojë Zoti i Madhërishëm nuk pyet se pse nuk kanë hipur në mekamatet e larta, dhe pse nuk ka kaluar në periudhat e shtatë shpirtrave, por i pyet vetëm për atë që është e domosdoshme në fe. Shumica e njerëzve nuk e kryejnë namazin sipas parimeve dhe kushteve të njohura. Shumica nuk e kuptojnë ekzistimin e Zotit të Madhërishëm, të vërtetën e monoteizmit të sinqertë, të pastër dhe pa risi e bestytni, ashtu siç është gjendja në pjesën dërmuese të shteteve islame e arabe.

Pjesa dërmuese e muslimanëve të të gjitha kombeve, e ndër ta edhe disa shqiptarë muslimanë janë zhytur në zina, alkool, vjedhje, keqtrajtimin e prindërve, drogë dhe s'japin zeqat... Pra, siç duket,

⁵⁶⁴ Po aty, f. 467-472.

⁵⁶⁵ Ky koment dhe kjo ndërhyrje është e profesorit tim të respektuar dhe anëtarit të tretë të komisionit të këtij disertacioni, prof. dr. Muhamed Bahaiddin Husejn. Zoti e shpërbleftë dhe e meshirofte!.

muslimanët kanë nevojë për edukimin me edukatë islame, posaçërisht në çështjet themelore dhe primare dhe për thjeshtëzimin e çështjeve të fesë së tyre,. Së treti, çështjet që i shqyrton autori dalin nga doktrina për të cilën është zotuar autori se do t'i përmbahet që nga fillimi i librit, gjegjësisht metoda dhe doktrina shkencore eksperimentale bashkëkohore në tefsirin e Kur'anit Fisnik, në bazë të të dhënave të shkencave moderne. Ne e pyesim autorin: Ç'farë lidhje kanë shtatë botët me shkencën moderne? Çfarë lidhje kanë shtatë shpirtat me shkencën moderne? A ka zbuluar shkenca moderne diçka nga çështjet që i thekson ai? Përgjigja është natyrisht se jo, dhe nuk dimë gjë për çështjet e tilla, ngase as ai vetë s'ka theksuar gjë rreth këtyre çështjeve në libër, sepse në të kundërtën do të kishte theksuar përveç disa definicioneve të filosofëve perëndimor të mëdhenj spiritualë që interesoheshin për shpirtin.⁵⁶⁶ Së pesti, s'ka dyshim se thellimi në këto çështje është rezultat i mos respektimit të shkallës së prioriteteve në da'vetin në Islam.

Do të ishte më mirë që mos shqyrtoheshin çështje të tilla filosofike sufiste që janë të rrezikshme e që nxisin dyshim, krijojnë diversitet dhe mospajtim, derisa të përforcohet dhe shtohet imani i muslimanëve shqiptarë dhe të tjerë dhe të tjerëve.⁵⁶⁷

Këto ishin disa karakteristika të këtij drejtimi dhe të kësaj doktrine shkencore eksperimentale që e ka përdorur prof.dr. Ali Fahri Iljazi në tefsirin e ajeteve të Kur'anit Fisnik, në bazë të zbulimeve të reja shkencore. Nuk ka dyshim se doktori i çmuar konsiderohet prijës i këtij drejtimi dhe kësaj doktrine në shoqërinë shqiptare, dhe këtij i takon merita

⁵⁶⁶ Po aty; dhe shih punimin e tij me titull: “**Meda ma’rifetina lir-ruhi**”; f. 458-472.

⁵⁶⁷ **VËREJTJE E RËNDËSISHME:** Lëvizja e sufizmit dhe sufistët kanë ndikim mjaft të madh në territorin shqiptar në kohën bashkëkohore, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoni dhe në Bosnjë e Hercegovinë, që nga periudha e shtetit osman në Ballkan. Ekzistojnë shumë tarikate sufiste që janë të shpërndara në territorin shqiptar e që posedojnë teqe. Nga disa tarikate kanë mbetur vetëm emrat e tyre dhe pa ithtarë, ndërsa disa të tjerë kanë edhe ithtarë edhe teqe e aktivitete. Perëndimorët kanë treguar interes të posaçëm për sofistët, dhe disa orientalistë perëndimorë i kanë studiuar sektet e tilla me qëllim që të krijojnë fitne e tollovi dhe të mbjellin dyshim nëpërmes ringjalljes së sekteve të zhdukura. Falënderoj Zotin që ithtarët e tillë janë të paktë dhe për këtë edhe kanë dështuar. Pjesa dërrmuese e popullit shqiptar musliman është sunnite, posaçërisht në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, ndërsa në Shqipëri ekziston një rrezik më i madh prej tyre, ngase ekziston sekt i devijuar bektashian që selinë kryesore e ka në Tiranë (Kryegjyshata Botërore Bektashiane). Më gjerësisht rreth historisë së sufizmit, sufistëve dhe teqeve në tokat shqiptare shih librin: Dr. Jashar Rexhepagiq, “**Dervishët, Rendet dhe Teqetë në Kosovë**”, poashtu shih edhe punimin tone: “**The Bektashi Sufi Order – It’s Doctrines and Believes**“, i pabotuar.

në mesin e shqiptarëve të kohës moderne, ngase asnjë shqiptar më parë nuk i ka komentuar ajetet kur'anore në këtë mënyrë profesionale shkencore dhe enciklopedike moderne.

Sidoqoftë autori dhe studiuesi Dr. Ali Fahri Iljazi Allahu e ruajate është njeri që ia qëllon, por dhe që gabon. Libri i tij është shume i domosdoshëm në këtë kohë, posaçërisht për thirrësit dhe hoxhallarët shqiptarë për të argumentuar se çështjet shkencore që theksohen në Kur'an nuk kundërshtojnë të vërtetat e shkencës moderne. Ne mund të mbështetemi në këtë tefsir të rezimuar dhe të thuktë shkencor krahas vështrimeve, rregullave dhe kushteve që i theksuam më parë.

Besoj se me ndihmën e Zotit të Madhërishëm isha i suksesshëm në ilustrimin e disa civateve nga tefsiri i rezimuar shkencor dhe në studimin e mendimeve të tij. E kuptuam qartë doktrinën, mënyrën dhe drejtimin e tij, si dhe me sukses argumentuam fuqinë hyjnore dhe mrekullinë e Kur'anit Fisnik që theksohen në shumë ajete kur'anore, të cilat i ka studiuar dhe shqyrtuar. Uroj dhe lus: Zoti e shpërbleftë me shpërblimet më të mira për punët e tij!

Dhe tani, pasi u njoftuam me doktrinën shkencore eksperimentale, mendoj se erdhi momenti i përshtatshëm, së pari për ta vlerësuar, e pastaj për ta kritikuar këtë doktrinë.

V: ILUSTRIMI I METODËS SHKENCORE TË TEFSIRIT TË KUR'ANIT FISNIK NËPËRMES VËSHTRIMIT KRITIK GJATË SHQYRTIMIT TË MENDIMEVE TË DISA DIJETARËVE KLASIKË DHE BASHKËKOHORË

Kjo çështje e rëndësishme shkencore ka preokupuar shumë dijetarë, hulumtues dhe studiues të Kur'anit dhe tefsirit të Kur'anit si në të kaluarën ashtu edhe në të sotshmen. Edhe mua më preokupoi kjo çështje, ashtu siç i kishte preokupuar ata. Kam vërejtur se ekziston një përzierje dhe kompleks në fjalët e disa dijetarëve dhe hulumtuesve rreth kësaj çështje, madje ende ekzistojnë disa paqartësi rreth çështjes në fjalë si dhe nuk është thjeshtëzuar aq sa duhet. Që ta kuptojmë më mirë këtë çështje, obligohemi që të bëjmë një përmbledhje të shkurtër rreth karakteristikave të saj. Gjatë leximeve të mia dhe përcjelljes së lëvizjes së këtij koncepti shkencor, që nga e kaluara e deri më sot, vërejta se fjalët e dijetarëve janë kontradiktore në këtë çështje, ngase shpeshherë dijetarët mendonin ndryshe dhe asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë mendim të përbashkët përfundimtar, dhe për këtë u detyrova që të bëj një përmbledhje të

mendimeve dhe botëkuptimeve të tyre, rreth kësaj çështje të rëndësishme nëpër sqarimet e çështjeve të tilla esenciale, kuptohet në mënyrë të përmbledhjes.

1. Ç'ka nënkuptohet me nocionin التفسير العلمي للقرآن “tefsir shkencor” dhe cili është qëllimi i tij?

Sipas Imamit Abduladhim Zurkanit, tefsiri shkencor nënkupton shkencat kozmologjike, njohuritë dhe çdo gjë që ekziston në botë nga artet dhe njohuritë, si p.sh.: inxhinieria, matematika, astronomia, ekonomia, sociologjia, natyra, kimia, kafshët, bimët, shkenca e shtresave të tokës, etj.⁵⁶⁸

Mendoj se ky mendim është më i saktë rreth kësaj çështjeje, dhe kur flasim për tefsirin shkencor të Kur'anit Fisnik duhet patjetër t'i dimë çështjet shkencore të cilat i theksova më parë.

Komentuesi që praktikon këtë metodë në tefsirin e tij, ka për qëllim ndërlidhjen e domethënieve të disa ajeteve kur'anore me të vërtetat shkencore autentike, e jo me teori e hipoteza me qëllim që ta tregojë Madhësinë e Krijuesit të Gjithësisë si dhe mrekullinë e Kur'anit se është Libri i Zotit të Urtë dhe të Gjithëdijsëm. Tefsiri shkencor nuk nënkupton përdorimin e terminologjisë shkencore e filosofike në ajete kur'anore, ashtu siç mendojnë disa dijetarë të kohës bashkëkohore, si p.sh., Prof. Emin El-Huli dhe Shejh prof. dr. Muhamed Husejn Dhehebij, të cilët thonë se tefsiri shkencor është ai që i referohet terminologjive shkencore për t'i kuptuar tekstet e Kur'anit si dhe nxjerrjen e shkencave të ndryshme dhe ideve filozofike nga Kur'ani”.⁵⁶⁹

Komentuesi i Kur'anit nuk i referohet termave shkencore moderne për t'i kuptuar tekstet e Kur'anit, por mbështetet në ato shkenca, me qëllim që t'i sqarojë më tepër kuptimet e pafund të Kur'anit, e që deduktohen nga ajetet kur'anore dhe pikërisht kjo është domethënia e tefsirit shkencor.

2. Definicioni i tefsirit shkencor: تعريف التفسير العلمي

Nëse e kuptojmë qëllimin dhe synimin e tefsirit shkencor, atëherë mund të formulojmë një definicion tjetër që përputhet me qëllimin e tij, krahas definicionit të parë që e thoshin hulumtuesit. Ndoshta definicioni i prof. dr. Ahmed Umer Ebu Haxher-it është më afër qëllimit të synuar dhe më i kapshëm për ne. Në këtë kontekst, ai thotë: “Ky është tefsiri, ku komentuesi përpiqet t'i kuptojë tekstet e Kur'anit në bazë të rezultateve të

⁵⁶⁸ Muhamed Abduladhim Ez-Zurkani, “Menahilul-irfan fi ulumil-Kur'an”; vëll.2, f.1-6.

⁵⁶⁹ Muhamed Husejn Edh-Dhehebij, “Et-Tefsir vel-mufessirunë”; vëll. 3, f. 140.

*konfirmuara të shkencës, dhe t'i zbulojë fshehtësitë e mrekullisë së tij, nëpërmes të dhënave precize shkencore, të cilat njerëzit nuk i dinin në kohën e zbritjes së Kur'anit, dhe kjo argumenton se Kur'ani nuk është fjalë njerëzish, por është fjalë e Zotit, Krijuesit të Fuqishëm dhe të Fortë”.*⁵⁷⁰

3. A ka kundërshtim në mes ajeteve të qarta kur'anore dhe të vërtetave të konfirmuara shkencore?

Me fjalë të shkurtëra themi se nuk ka kundërshtim në mes të ajeteve të qarta të Kur'anit Fisnik dhe në mes të vërtetave të konfirmuara e të sakta shkencore, përkundrazi, madje Kur'ani Fisnik i përkrahë dhe i përforcon. Në këtë kontekst, Shejhul-Islam, Ibn Tejmije, thotë: لا تعارض بين النقل الصحيح و العقل الصحيح “S’mund të ketë kundërshtim në mes traditës së saktë dhe racios së qartë...”, dhe mendoj se kjo thënie është shumë e qartë dhe s’ka nevojë për sqarim të mëtejshëm.⁵⁷¹

Dhe nëse ekziston diçka që mund të jetë kontradiktë ose kundërshtim, sipas disa dijetarëve; ajo mund të jetë e qartë por e pasaktë, ose e saktë por e paqartë. Nuk jam dakord me prof. dr. Ahmed Ebu Haxherin dhe transmetimin e tij të fjalëve të Shejh Imam Muhamed Abduhusë dhe disa të tjerëve rreth kontradiktës së intelektit me traditën, pa kritikuar apo kundërshtuar atë. Shejh Muhamed Abduhu thotë: “Në mesin e popullatës islame ka pajtueshmëri, përpos disa që s’janë shumë të rëndësishëm, dhe nëse intelekt i kundërshton traditën, merret parasysh intelekt i, ndërsa në traditë ka dy rrugë:

1. Pranimi i autenticitetit të traditës, por pa pasur mundësi të kuptohet dhe në këtë rast çështja i mbështetet Zotit; dhe:
2. Komentimi i traditës duke i mbrojtur rregullat e gjuhës, derisa të harmonizohet kuptimi i saj me atë që konfirmon intelektin.”⁵⁷²

Është për t’u habitur me hulumtuesin dr. Ahmed Umeri, përse nuk e ka kritikuar Shejh Muhamed Abduhunë qoftë edhe me një resht të vetëm, sepse kështu nënkuptohet se ai është dakord me mendimin e Shejh Muhamed Abduhusë.

⁵⁷⁰ Ahmed Umer Ebu Haxher, “Et-Tefsirul-ilmijj lil-Kur’ani fil-mijzan”; Bejrut, Daru Kutejbe lin-neshri vet-teuzi; bot. 1, 1991, f. 66.

⁵⁷¹ Po aty, f. 83; Më gjerësisht rreth kësaj çështje të rëndësishme shih enciklopedinë e Shejhul-Islam Ibën Tejmijes, me titull: “Der’u tearudil akli ven-nekli ve muvafekatu sahihil-menkul li sarihil-ma’kul”; Rijad, Darul-kunuzil edebijjeti; 1391 hixhri, Muhamed Rishad Salim, vëll. 1, f. 4-5. Në këtë libër shqyrtohet gjatë kjo çështje.

⁵⁷² Po aty, f. 86, transmeton nga Imam Muhamed Abduhu: “El-Islam ven-nesranijjetu meal-ilmi vel-medenijjeti”; bot.1320 hixhri, f. 61.

Pajtojohem me pjesën e parë të fjalëve të Muhamed Abduhusë, ndërsa nuk dakordohem me pjesën e dytë të fjalëve të tij. Këtu lind pyetja “Nëse shpjegojmë tekstin tradicional sipas rregullave të gjuhës arabe dhe nuk përputhet dhe nuk harmonizohet me intelektin, atëherë ç’duhet bërë? A do ta komentojmë tekstin, duke e nxjerrë jashtë kontekstit, deri sa të përputhet me intelektin? Këtë nuk e thotë askush, bile as ai që ka pak njohuri në gjuhën arabe dhe në usuli fikh. Në këtë rast jemi dakord me Imam Muhamed Abduhunë kur thotë: *“Pranojmë autenticitetin e traditës, si dhe pranojmë se nuk mund ta kuptojmë, dhe në këtë rast çështjen ia mbështesim Zotit të Madhërishëm dhe nuk i japim prioritet intelektit ndaj traditës së vërtetë”*.

4. Klasifikimi i qëndrimeve të dijetarëve që përkrahin apo kundërshtojnë drejtimin e tefsirit shkencor në të kaluarën dhe në të sotshmen.

A. Përkrahësit klasik të tefsirit shkencor janë: **المؤيدون للتفسير العلمي**

- Imam Ebu Hamid El-Gazali, i vdekur në vitin 505 hixhri, në librat e tij “Ihjau Ulumiddin” dhe “Xhevahirul-Kur’an”.
- Imam Fahrudin Er-Razi, i vdekur në vitin 606 hixhri në tefsirin e tij të njohur “Mefatihul-Gajb”.
- Ibn Ebu El-Fadli El-Mersi, i vdekur në vitin 655 hixhri, dhe këtë e ka theksuar Imam Es-Sujuti në librin “El-itkan fi ulumil-Kur’an”.⁵⁷³
- Imam Bedruddin Muhamed ibn Abdullah Ez-Zerkeshi, i vdekur në vitin 794 hixhri në librin “El-Burhan fi ulumil-Kur’an”.
- Iman Xhelaluddin Es-Sujuti, i vdekur në vitin 911 hixhri në librin “El-itkan fi ulumil-Kur’an” dhe “Mu’terekul-ekran”.⁵⁷⁴

B. Përkrahësit ekstremistë të tefsirit shkencor në kohën moderne:⁵⁷⁵

المؤيدون المغالون للتفسير العلمي في العصر الحديث

- Shejh Imam Muhamed Abduhu (1848-1905) në tefsirin e xhuzit “Amme”.
- Shejh Tantavi Xheuheri, i lindur në vitin 1862 në tefsirin e tij “El-Xhevahir fi tefsiril-Kur’an”.

⁵⁷³ Es-Sujuti, “El-Itkan fi ulumil-Kur’an”; vëll. 2, f. 126-128.

⁵⁷⁴ Më gjerësisht shih: Ahmed Umer Ebu Haxher, “Et-tefsirul-ilmij lil-Kur’an fil-mizan”; f. 145-165.

⁵⁷⁵ Po aty, f. 169-216.

- Es-Sejjid Abdurahman El-Kevakibi, i lindur në vitin 1265, në librin “Taba’iul-istibdadi ve mesari’ul-isti’badi”.
- Prof. Abdurrezak Neufel, në librin “All-llahu vel-ilmul-hadith”.

C. Përkrahësit e moderuar të tefsirit shkencor:

المؤيدون المعتدلون للتفسير العلمي في العصر الحديث

- Shejh Muhamed Bahijt El-Muti’ij, 1882-1935 në librin “Tenbihul-ukulil-insanijjeti lima fi ajatil-Kur’an minel-ulumil keunijjeti vel-imranijjeti”.
- Shejh Abdulhamid ibn Badis, i vdekur në vitin 1940, në librin “Tefsiru ibn Badis” ose “Mexhalisul-tedhkir min kelamil-habir.”
- Shejh Mustafa El-Meragi, 1881-1945, “Tefsirul-Meragi”.
- Shejh dr. Muhamed Abdullah Derraz, i vdekur në vitin 1947, në librin “Med-hal ilal-Kur’anil-Kerim”.
- Mendimtari Shejh Vehiduddin Han në librin “El-Islamu jetehadda”.
- Shkrimtari dhe letrari Mustafa Sadik Er-Rafi’ij, i vdekur në vitin 1938, në librin “I’xhazul-Kur’an vel-belagatun-nebevijjeti”.
- Hulumtuesi dhe specialisti i kimisë dr. Muhamed Ahmed El-Gamravi.
- Dijetari dhe astronomi dr. Muhamed Xhemaluddin El-Fendij, në librin “El-Kur’anu vel-ilmu”.
- Shejh Muhamed Tahir ibn Ashur, i vdekur në vitin 1973, në librin “Et-tahrir vet-tenvir minet-tefsiri”.⁵⁷⁶
- Nga moderatorët që nuk i ka theksuar hulumtuesi i lartpërmendur janë edhe dijetarët:
- Mendimtari i njohur islam Muhamed Ferid Vexhdi në komentet e tij të librit “El-Islam vet-tibbul-hadith”.⁵⁷⁷
- Mendimtari i njohur i Islamit Bedi’uz-Zeman Se’id En-Nursij, i vdekur në vitin 1960, në tefsirin e sures “El-Bekare” me titull:

⁵⁷⁶ Po aty, f. 219-270.

⁵⁷⁷ Sejjid Ganim Karim, “El-isharat el-ilmijjetu fil-Kur’anil-kerim bejn ed-diraseti vet-tatbijk”; “Kajro, Darul-fikril-arabij, bot. 1, 1995, f. 130.

“Isharatul-i’xhaz fi medhānnil-ijxhaz”, si dhe disa punime tjera të tij që titullohen: “Kul-lijjatu resailun-nur”.⁵⁷⁸

- Shejh Muhamed Mutevel-li Sha’ravi, në librin “Mu’xhizetul-Kur’an”.
- Mjeku dhe mendimtari Dr. Mustafa Mahmud, në librin “El-Kur’an... muhaveletun li fehmin asrijjin”.
- Mendimtari Mahmud Nadjim Nesimi, në librin “Me’at-tibbi fil-Kur’anil-Kerim”.
- Mendimtari i njohur i Islamit Shejh Abdurmexhid Zendani në shumë vepra dhe shkrime të tij, si p.sh.: “El-Mu’xhizetul-ilmijjetu fil-Kur’an ves-sunneti”, kumtesë shkencore në Konferencën e Parë Ndërkombëtare në Islamabad në vitin 1987.⁵⁷⁹ Këta qka i përmendëm sipër janë dijetarë të mëdhenj e të njohur në lëmin e tefsirit shkencor, qofshin ato përkrahës apo kundërshtarë. S’ka dyshim se ne nuk i kemi përmendur të gjithë hulumtuesit, si dhe ditët e ardhshme do të nxjerrin në shesh edhe dijetarë tjerë. Lusim Zotin e Madhërishëm që t’i shpërblejë, muxhtehidët që kanë mendime të sakta dhe të qëlluara, dy herë, ndërsa ata që gabojnë, një herë!

5. Analiza e mendimit të Imam Shatibiut:

Hulumtuesi dr. Ahmed Umer Ebu Haxheri shqyrton këtë temë në disertacionin e tij mjaft të rëndësishëm dhe tejet të vlefshëm, përkatësisht i rreket temës së atyre të cilët kanë refuzuar tefsirin shkencor në të kaluarën dhe në të tashmen nga kundërshtuesit klasikë në përgjithësi, kurse në veçanti e thekson Imam Shatibiun (Zoti e mëshiroftë!).

Ç’është e vërteta, gjatë leximit tim të fjalëve të Imam Shatibiut në “El-Muvafakat” الموافقات في الشريعة الإسلامية, vërejtja se ai nuk e kundërshton tefsirin shkencor në përgjithësi, por as edhe në detaje, ndaj dhe nuk mund ta klasifikojmë në grupin e refuzuesve të këtij lloji të tefsirit, ashtu siç e kishte klasifikuar hulumtuesi i sipërpërmendur dhe paraprijësit e tij. Imam Shatibiu hulumtonte çështjen se a i përmbledh

⁵⁷⁸ Po aty, f. 121 dhe f. 135-139. Shih edhe punimin e dr. Su’ad Jëldërëm që e paraqiti në Konferencën e Parë Ndërkombëtare rreth Mrekullisë Shkencore të Kur’anit dhe Sunnetit me titull: “**Mustenedatut-teufik bejnen-nususil-kur’anijjeti ve bejnen-netaixhil el-ilmijjetis-sahihati**”; Islamabad, 1987.

⁵⁷⁹ Shejh Abdurmexhid Zendani ka një traktat tjetër të rëndësishëm në këtë sferë me titull: “**Min euxhuhil-i’xhazil-ilmij lil-Kur’anil Kerim fi alemil-bihar**”; Mekketul-Mukerremetu, Rabitatu-Aleml Islam, 1999.

Ai gjithashtu shqyrton edhe një çështje tjetër në librin “El-Muvafakat”, gjegjësisht çështjen e përmbajtjes së shkencave në Kur’an, e që ekzistonin vetëm në mesin e arabëve dhe kështu ai përkufizon shkencat vetëm për arabët!⁵⁸⁰ Imam Shatibiu (Zoti e mëshiroftë!) nuk mohon të vërtetën e ekzistimit të disa shkencave në Kur’anin Fisnik që ishin vetëm në mesin e arabëve, dhe në këtë mënyrë Imam Shatibiu nuk mund të klasifikohet në grupin e atyre që kundërshtonin tefsirin shkencor në përgjithësi dhe në detaje, ashtu siç mendonin shumica e hulumtuesve të kësaj tematike, ngase ky është një keqkuptim dhe trillim për të.⁵⁸¹

Më pëlqen kritika e hulumtuesit dr. Ahmed Umerit ndaj fjalëve të Imam Shatibiut në çështjen e shkencave që ekzistonin tek arabët, i cili në këtë kontekst thotë: *“Sikur të përkufizohej vetëm me arabët, nuk do të kritikohesh, nuk do të ishin njerëzit të barabartë në shkencë. Pra, ky qëndrim nuk është i saktë dhe nuk përputhet me realitetin, ashtu siç nuk përputhet edhe me qëndrimet e muslimanëve të parë rreth kësaj çështje për të cilën flet Imam Shatibiu.”*⁵⁸² Nuk mund të ndalohet tefsiri shkencor për asnjë gjeneratë, ngase Kur’ani është për të gjitha gjeneratat që do të jetojnë në tokë.”⁵⁸³

Jo fort larg këtij mendimi ka qenë, edhe një tjetër dijetar, Shejh dr. Abdullah Derraz (Allah e meshirofte) i cili ka kritikuar këtë çështje në “El-Muvafakat”.⁵⁸⁴ Këtu e shoh të dobishme që t’i citoj fjalët më të rëndësishme të Imam Shatibiut rreth kësaj çështjeje, derisa ta kuptojmë mirë këtë problematikë. Imam Shatibiu (Zoti e mëshiroftë!) në “El-Muvafakat” thotë: *“Arabët kishin interes për shkencat që i dinin njerëzit, si p.sh. astrologjinë, ngase sipas saj orientoreshin në tokë e në det, dhe e dinin ndërrimin e stinëve dhe kjo çështje shumë herë theksohet në Kur’anin Fisnik:*

⁵⁸⁰ “El-Muvafakat”; vëll. 2, f. 79-80.

⁵⁸¹ Kështu mendon hulumtuesi dr. Ahmed Umer Ebu Haxheri në disertacionin e doktoraturës së tij: **“Et-tefsirul-ilmij lil-Kur’ani fil-mijzan”**; f. 271; dhe para tij edhe prof. dr. Shejh Muhamed Husejn Dhehebij në **“Et-tefsir vel-mufessirun”**.

⁵⁸² “El-Muvafakat”; vëll. 2, f. 80.

⁵⁸³ **“Et-tefsirul-ilmij lil-Kur’ani fil-mijzan”**; f. 290.

⁵⁸⁴ Sqarim i Shejh Abdullah Derrazit në **“El-Muvafakat”**, vëll. 2, f. 73.

فَصَلَّنَا قَدْ وَالْبَحْرِ الْبَرِّ ظُلُمَتْ فِيهَا لِيَتَهْتَدُوا النُّجُومَ لَكُمْ جَعَلَ الَّذِي هُوَ)

([الأنعام : 97] ﴿٩٧﴾ يَعْلَمُونَ لِقَوْمٍ أَلَايَتِ

“Ai është që krijoi yjet për ju që me ta të orientoheni në errësira kur jeni në tokë ose në det”.⁵⁸⁵

([النحل : 16] ﴿١٦﴾ يَهْتَدُونَ هُمْ وَبِالنَّجْمِ وَعَلِمَتْ

“Ndërsa (natën) ata orientohen me anën e yjeve”.⁵⁸⁶

Pastaj ata merreshin me të reshurat e shiut, formimin e reve dhe me erërat e forta, dhe në këtë kontekst, Zoti i Madhërishëm thotë:

وُدُسِّبِحُ ﴿١٣﴾ الثَّقَالِ السَّحَابِ وَيُنشِئُ وَطَمَعًا خَوْفًا الْبَرْقِ يُرِيكُمْ الَّذِي هُوَ)

([الرعد : 12-13] ﴿١٣﴾ بِحَمْدِهِ ۚ الرَّعْدُ

“Ai është që u shfaq vetëtimën trishtuese (nga ndonjë fatkeqësi), por edhe shpresëdhënëse (për shi), dhe formohen re të dendura. Ndërkaq murmurima madhëron (Zotin një) me falënderimin (që i takon) e Tij”.⁵⁸⁷

Përveç kësaj, arabët njihnin historinë dhe të dhënat mbi popujt e kaluar, dhe një gjë e tillë shumë herë theksohet në Kur'an dhe në Sunnet. Kur'ani i informon më shumë se sa dinin dhe u rrëfente shumë gjëra që nuk i dinin arabët, p.sh. në Kur'an, Zoti i Madhërishëm thotë:

أَيُّهُمْ أَقَلَّمَهُمْ يُلْقُونَ إِذْ لَدَيْهِمْ كُنْتَ وَمَا إِلَيْكَ نُوحِيهِ الْغَيْبِ أَنْبَاءٍ مِنْ ذَلِكَ

([آل عمران : 44] ﴿٤٤﴾ يَخْتَصِمُونَ إِذْ لَدَيْهِمْ كُنْتَ وَمَا مَرِيَمَ يَكْفُلُ

“Këto janë nga lajmet e fshehta (të hershme) që po të shpallim ty. Ti nuk ishe ndër ta kur i hidhnin shortet se kush prej tyre do të bëhej kujdestar i Merjemes”.⁵⁸⁸

Arabët kishin eksperiencë të gjatë edhe në mjekësi, ngase atë e aplikonin dhe e kishin mësuar nga përvoja. Në këtë kontekst, Imam

⁵⁸⁵ El-En'am, 97.

⁵⁸⁶ En-Nahl, 16.

⁵⁸⁷ Er-Ra'd, 12-13.

⁵⁸⁸ Ali Imran, 44.

Shatibiu thotë se shumë njerëz që e kanë tepruar gjatë komentimit, duke ia shtuar Kur'anit të gjitha shkencat e të parëve dhe të mëvonshmëve, si p.sh., shkencat natyrore, pedagogjike, logjike, të simbolikës, etj. Siç thamë më parë, një gjë e tillë nuk është e vërtetë. Selefi i devotshëm i sahabëve, tabi'inëve dhe atyre që vinin pas tyre, e njihnin më së miri Kur'anin dhe shkencat e tij, dhe nuk na ka ardhur asgjë prej tyre se kanë folur për këto çështje, dhe sikur të kishin njohuri rreth gjërave të tilla, do të transmetohej diçka prej tyre dhe do ta dinim origjinën e problemit, dhe meqë nuk ka asgjë të tillë, kjo gjë argumenton se as që ka ekzistuar fare.

Mungesa e transmetimeve të tilla argumenton se Kur'ani nuk kishte për qëllim atë që e deklaroin. Është e vërtetë se Kur'ani përmban në vete shkenca të arabëve ose atë që e vështrojnë njerëzit që mendojnë, por asgjë më tepër. Nuk është në rregull t'i shtohet diçka Kur'anit apo t'i pakësohet dhe duhet përkufizuar vetëm në atë që ka të bëjë me arabët.⁵⁸⁹

Nëse i lexojmë me vëmendje fjalët e Imam Shatibiut (Zoti e mëshiroftë!) do të gjejmë të kundërtën nga ajo që thonë kundërshtarët e drejtimit shkencor në përgjithësi dhe në detaje, dhe kështu, ajo që thuhet për të është trillim, ngase ai nuk e mohon këtë drejtim shkencor në tefsir tërësisht, por e ka përkufizuar vetëm në atë që ekzistonte tek arabët. Por, ne themi se edhe ky mendim i tij është gabim, ngase:

1. Potenciali i arabëve në atë kohë ka qenë i kufizuar deri në atë shkallë të cilën e thekson edhe vetë Imam Shatibiu. Ata i kuptonin shkencat e atëhershme në bazë të kapacitetit të tyre shkencor dhe njerëzor. Sikur të jetonin arabët e gjeneratës së parë në kohën tonë, s'ka dyshim se do të mësonin këto shkenca që janë formuar në kohën tonë, do t'i shfrytëzonin në favor të tyre dhe do t'i mësonin këto shkenca ashtu siç i kishin mësuar shkencat e atëhershme.
2. Po, patjetër duhet përkufizuar vetëm në atë që ekzistonte tek arabët, kur është fjala për shkencat e gjuhës arabe, artet e stilistikës e retorikës dhe lojën e fjalëve, ngase Kur'ani ka zbritur në gjuhën e pastër arabe. Nuk mund të përqëndrohemi e të flasim për mjekësinë apo astronominë arabe, ngase mundësitë e njerëzve për t'i përfutur shkencat kozmologjike nga Kur'ani Fisnik janë të ndryshme. Pastaj, dituria (dituria e re dhe e dobishme) është gjë e humbur e besimtarit, dhe ai është i obliguar ta kërkojë dhe ta marrë kudo që ta gjejë.

⁵⁸⁹ Ebu Is'hak Shatib+iu, "El-Muvafakat fish-Sheriatil-Islamijjeti"; vëll. 2, f. 381-391.

Ç. Bashkëkohorët që refuzojnë tefsirin⁵⁹⁰ shkencor janë:

العلماء المعاصرون الرافضون للتفسير العلمي:

- Shejh Reshid Rida, 1865-1935.
- Shejh Mahmud Sheltut, 1893-1964.
- Shkrimtari dhe letrari i njohur islam Abbas Mahmud El-Akkad, (i vdekur në vitin 1964), në librin e tij “El-Felsefetul-Kur’anijje”.
- Profesori Shejh Muhamed Izzet Derruzetu, i lindur në vitin 1888, në librin e tij “Et-Tefsirul-hadith”.
- Shejh Dr. Muhamed Abduladhim Ez-Zerkani, në librin “Menahilu el-irfan fi ulumul-Kur’an”, ku thekson se ekzistojnë kushte dhe rregulla për tefsirin shkencor.
- Shehidi dhe komentuesi Sejjid Kutub (Zoti e mëshiroftë!) 1906-1966, në shumë vende të tefsirit të tij “Fi dhilalil-Kur’an”, si p.sh., komenti i tij i ajetit kur’anor:

([البقرة : ٢٥٥] وَالْحَجَّ لِلنَّاسِ مَوَقِيتٌ هِيَ قُلُوبُ الْأَهْلِ عَنْ يَسْئُلُونَكَ *)

[189

“Të pyesin ty për hënën e re (dhe fazat e saj). Thuaj: “Ato janë përcaktime të kohës për njerëzit dhe për haxh”,⁵⁹¹ si dhe në tefsirin e tij që i bën ajetit kur’anor në suren Fussilet:

بِرَبِّكَ يَكْفِ أَوَّلَهُ الْحَقُّ أَنَّهُ لَهُمْ يَتَّبِعْنَ حَتَّى أَنْفُسِهِمْ وَفِي الْأَفَاقِ فِي آيَاتِنَا سَنُرِيهِمْ

([فصلت : 53] شَهِدُ شَيْءٌ كُلِّ عَلَى أَنَّهُ

“Ne do t’ju bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë”.⁵⁹²

Këtu patjetër duhet të ndalemi në një pikë shumë të rëndësishme që ka të bëjë me mendimin e Shehidit Sejjid Kutub rreth kësaj çështjeje. Qëndrimin e tij kundër tefsirit shkencor në tefsirin e tij “Fi dhilalil-Kur’an”, Shehidi Sejjid Kutubi (Zoti e mëshiroftë!) arsyeton me fjalë të

⁵⁹⁰ Më gjerësisht rreth tefsirit shkencor në Kur’anin Fisnik shih: Es-Sejjid Gunejm Kerijm, “El-Isharat el-ilmijjetu fil-Kur’anil-Kerim bejned-diraseti vet-tatbik”; Kajro, Darul-fikril-arabij, bot. 1995, f. 113-167, 255-283; 284-300.

⁵⁹¹ El Bekare, 189.

⁵⁹² Fussilet, 53.

thukta e të qarta. Sipas tij, ky është gabim metodologjik parimor dhe në vete përmban tre nocione që nuk përputhen me natyrën e Madhështisë së Kur'anit Fisnik.

1. Ndjenja dhe dështimi shpirtëror i brendshëm i disa njerëzve se shkenca është kryesore dhe se Kur'ani ecë pas saj (shkencës);
2. Keqkuptimi i natyrës së Kur'anit, mesazhit dhe funksionit të tij. Kur'ani është një e vërtetë absolute; dhe:
3. Komentimi i vazhdueshëm që del jashtë kontekstit të teksteve të Kur'anit, duke vrapuar pas teorive dhe hipotezave që nuk janë të qëndrueshme e stabile.

Të gjitha këto çështje nuk përputhen me natyrën e përkryer të Kur'anit Fisnik. Ai më tej vazhdon e thotë: *“Kjo nuk do të thotë se ne nuk duhet t'i shfrytëzojmë dobitë që i zbulon shkenca nga teoritë dhe të vërtetat rreth gjithësisë, jetës e njeriut, për ta kuptuar në tërësi Kur'anin. Nuk ishte ky qëllimi im nga ajo që thash më parë...”*⁵⁹³

- Profesori dhe mendimtari Abdulvahid Vafi dhe profesori Ismail Madh'har janë të mendimit se ky lloj tefsiri është një lloj risie dhe bidat që do të nxisë automatikisht grindje në mes të fesë dhe shkencës.⁵⁹⁴
- Dr. Muhamed Husejn Edh-Dhehebij, në librin e tij të njohur “Et-Tefsir vel-mufessirunë”, f. 178.
- Profesori i filosofisë islame dr. Atif El-Iraki.
- Shejh Abdulkerim El-Hatib.

Mund të thuhet se ky është drejtimi i pjesës dërmuese të komentuesve klasikë si Imam Taberiu, Imam Kurtubiu, Bejdavi, Ibn

⁵⁹³ Shih **“Fi dhilalil-Kur'an”**; vëll. 1, f. 180-184; **“Et-tefsirul-ilmij lil-Kur'ani fil-mijzan”**; f. 318-321. Autori i këtyre rreshtave ka edhe disa punime tjera rreth mendimit dhe metodës së shehidit Sejjid Kutub në Tefsir, ku konfirmon se nuk i takon përkrahësve të tefsirit shkencor. E vërteta është ajo që e pamë nga vetë fjalët e shehidit kur thotë se nuk ka dëm nëse shfrytëzohen begatitë dhe dobitë nga zbulimet shkencore që janë të vërteta të pandryshueshme dhe të padiskutueshme, po që nuk janë teori e as hipoteza.

⁵⁹⁴ **“Et-tefsirul-ilmiju lil-Kur'ani fil-mijzan”**; f. 297-330. Më gjerësisht rreth tefsirit shkencor të Kur'anit dhe përpjekjeve të dijetarëve rreth kësaj problematike shih burimet e rëndësishme dhe të vlefshme: Muhamed Adil Ebu El-Hajr, **“Ixhtihadat fit tefsiril-ilmij fil-Kur'anil-Kerim”**; Merkezu Delta lit-tiba'ati, isportenxh, Kajro, bot. 1, 1988, f. 21-82; Halil Imaduddin, **“Med'hal ila meukifil-Kur'anil Kerim minel-ilm”**; Bejrut, Muessetur-risaleti, bot. 1, 1983, f. 9-14; Es-Sejjid Gunejm Karim, **“El-isharat el-ilmijetu fil Kur'anil-Kerim bejned-diraseti vet-tetbik”**; Kajro, f. 121-122. Profesori im dr. Su'ad Jëldërim i ka theksuar arsyet të cilat kanë ndikuar që Shejh Dhehebiu të mendojë ashtu në punimin që e ka prezantuar në Konferencën Ndërkombëtare në Islamabad në vitin 1987.

Kethiri, Ebus Su'udi, etj., ngase askush nuk ka transmetuar asgjë prej tyre që ka lidhje me këtë çështje.

E. Harmonizuesit në mes ajeteve kur'anore dhe shkencave kozmologjike.

أصحاب التوفيق بين الآيات القرآنية و العلوم الكونية :

Pasi u njoftuam me kategoritë e qëndrimeve të njerëzve rreth kësaj çështje, po ashtu hasim edhe në një grup tjetër njerëzish, që mendojnë se mund të harmonizohen shkencat kozmologjike dhe të dhënat shkencore me ajetet kur'anore që kanë të bëjnë me shkencat e tilla. Kështu mendon një grup muslimanësh e filosofë klasikë, si p.sh., Ibn Sinâ, El-Farabiu dhe Ibn Rushdi. Drejtimi i ithtarëve që tentonin harmonizimin në mes filosofisë e fesë, mbështetet në komentimin e teksteve fetare dhe harmonizimin e kuptimit të tyre me filosofinë. Ky drejtim i ka rrënjët tek filosofët grekë dhe në legendat e tyre që kishin shenjtëri fetare, dhe të cilat komentoheshin në mënyrë alegorike. Disa filosofë muslimanë komentonin filosofinë greke dhe pastaj përpiqeshin t'i harmonizojnë idetë e tyre me idetë e Islamit, derisa thoshin se qëllimi i tyre primar ishte harmonizimi në mes fesë dhe filosofisë. Kështu mendonin filosofët arabë dhe kjo qartë vërehet në thënien e Imam Bejhekiut se filosofi El-Kindi ka harmonizuar në veprat e tij në mes parimeve të Sheriatit dhe parimeve të racionales.

El-Kindiu ka mbështetur tefsirin e tij të ajeteve të Kur'anit në baza racionale, të cilat i ka nxjerrë nga studimi i filosofisë. Po ashtu edhe filosofi musliman Ebu Nasr El-Farabi është përpjekur të harmonizojë filosofinë me Sheriatin, dhe në komentimin e ajetit kur'anor:

(﴿عَلَّمَ شَيْءٌ بِكُلِّ وَهُوَ وَالْبَاطِنُ وَالظَّاهِرُ وَالْآخِرُ الْأَوَّلُ هُوَ﴾)

[الحديد : 3]

“Ai është i pari dhe i fundit, i dukshmi dhe i padukshmi”,⁵⁹⁵ Farabiu thotë: “S’ka ekzistencë më të përkryer se të Tij dhe ekzistenca e Tij s’ka kurrfarë mangësie; Ai në qenien e Tij është i dukshëm, dhe pasi që është shumë i dukshëm shndërrohet në të padukshëm; Të duket çdo gjë e dukshme si Dielli që zbulon çdo imtësi, por vetë s’mund të shikohet”. Ai po ashtu është përpjekur të konfirmojë se s’ka kurrfarë dallimi në mes filosofisë greke dhe besimit të Sheriatit islamik. Po ashtu edhe Ibn Sinâ

⁵⁹⁵ El-Hadid, 3.

është përpjekur të harmonizojë në mes fesë dhe filosofisë,⁵⁹⁶ ashtu siç vepruan edhe disa hulumtues bashkëkohorë, por që nuk janë filosofë. Ithtarët bashkëkohorë të këtij drejtimi në përgjithësi janë shkrimtarë, hulumtues e mjekë, por jo edhe komentues të njohur e as ekspertë të tefsirit. Njerëzit e tillë kontribuojnë në studimet kur'anore dhe shkencore, duke i përcjellë zbulimet e reja shkencore dhe duke i krahasuar ajetet kur'anore që kanë të bëjnë me çështjet e tilla.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër, mund të gjejmë një qëndrim të moderuar në këtë çështje të rëndësishme, po ashtu, mund të themi se këtë lloj tefsiri shkencor të Kur'anit nuk e pranojmë në tërësi, por as që e refuzojmë në tërësi, por mbështetemi në disa rregulla dhe kushte, që i kanë theksuar dhe i kanë bërë rezyme disa dijetarë në veprat e tyre, përfshirë edhe studimin tim dhe nëse plotësohen këto kushte dhe rregulla, atëherë mund të mbështetemi në një tefsir të tillë.

VI: KUSHTET DHE RREGULLAT E TEFSIRIT SHKENCOR FILOSOFIK DHE SHKENCOR EKSPERIMENTAL

شروط و ضوابط التفسير العلمي للقرآن الكريم :

Dijetarët i potencojnë disa rregulla e kushte, të cilat duhet të plotësohen kur të aplikohet një tefsir i tillë, dhe këto janë:

- Hulumtimet e tilla të mos mbulojnë qëllimin parësor të Kur'anit, e që është udhëzimi dhe mrekullia.
- Kur bëjmë përzierjen apo kur i implikojmë shkencat e tilla në tefsir, duhet të kemi kujdes ndaj nevojave aktuale të njerëzve, ngase mund të jenë të dobishme në qarqet intelektuale, por mund të shkaktojnë fitne e tollovi në qarqet injorante të njerëzve.
- S'ka problem nëse komentuesi argumenton me zbulime dhe të vërteta shkencore të pathyeshme, e që s'janë hipoteza përderisa pasuron dhe ndihmon në kuptimin e tekstit kur'anor, si dhe është në përputhje me shpirtin dhe qëllimet e Sheriatit Islam, si dhe nëse zbulimet e tilla i shfrytëzon për të konfirmuar madhështinë e ajetit kur'anor.

⁵⁹⁶ Es-Sejjid Esh-Shehhat Zuglul, "El-It-tixhahat el-fikrijje fit-tefsir"; El-hej'etu el-misrijjetul-el-ammetu lil-kitab, bot. 2, 1977, 299-318. Më gjerësisht rreth mendimeve të filosofit El-Farabi shih: Feuzi Atvi, "El-Farabi, Fejlesuful-medinetil-fadile"; recensim i dr. Subhi Salih-it, Darul-kitabi-arabij, pa datë botimi, f. 97-171.

- Komentuesi të mos del nga konteksti dhe të sjell domethënie të largëta e që s'kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me kuptimin e përgjithshëm të ajeteve. Në shoqërinë islame ekzistojnë edhe komentues të tillë që e kanë mbushur tefsirin e tyre përplot teori e hipoteza, duke menduar se janë të vërteta, dhe pas një kohe të vërtetat e tilla të supozuara shndërrohen në teori e hipoteza të anuluar e të pavlefshme, ngase shkenca ec me shpejtësi të madhe dhe çdo ditë ndryshon...
- Që të mos dështojmë shpirtërisht e t'ju themi njerëzve se çdo gjë e re argumenton mrekullinë e Kur'anit, me qëllim që të besojnë në Kur'an, siç p.sh., thoshte Shehidi Sejjid Kutub (Zoti e Mëshiroftë!) në tefsirin e tij: "Fi dhilalil-Kur'an". Ne obligohemi të fillojmë nga e vërteta fetare që del nga Kur'ani dhe të kalojmë në të vërtetën shkencore apo filosofike, e jo e kundërta, ngase në Kur'an ka të vërteta absolute dhe të palëvizshme, kurse në shkencë ka të vërteta shkencore variable, dhe kështu, nuk mund të komentohet e vërteta absolute me të vërtetën relative.⁵⁹⁷
- Në të kaluarën të gjithë dijetarët ishin kompakt se qëllimi apo synimi themelor dhe më i lartë i zbritjes së Kur'anit është udhëzimi i gjithë njerëzve në besim të vërtetë që s'ka devijime dhe që është i pastruar nga bestytnitë, gjërat e kota dhe risitë. Pra, ata udhëzohen në diçka që është më e fortë dhe më e shëndoshë. Kur'ani nuk është shpallur që të jetë enciklopedi e fizikës, astronomisë, matematikës, mjekësisë, gjeologjisë dhe shkencave tjera të zbuluara humane. Është e vërtetë se ka disa shenja në disa ajete kur'anore që aludojnë në shkenca të tilla, dhe ai që dëshiron të thellohet dhe të zgjerohet me njohuri të tilla, duhet të mbështetet në burimet shkencore të shkencëtarëve specialistë dhe të mësojë prej tyre.

Mendoj se pikërisht këtu qëndron edhe mrekullia e Kur'anit Fisnik, ngase ai vetëm i potencon ato shkenca humane dhe sikur na thotë se ja-kjo është rruga që u shpie në atë thesar dhe ju hulumtoni. Besoj se muslimani nuk dyshon se Kur'ani është përplot fshehtësi e thesare dhe se zbulimet shkencore do të vazhdojnë deri në Ditën e Gjykimit, ngase kjo formë përputhet me mrekullinë e tij dhe natyrën e tij të përshtatshme për çdo kohë e çdo vend. Në këtë kontekst një poet thotë:

⁵⁹⁷ Muhamed Abduladhim Ez-Zerkani, "Menahilul-irfan fi ulumil Kur'an"; vëll. 2, f. 113.

(سَتَبْدِي لَكَ الْاَيَّامَ مَا كُنْتَ جَاهِلًا – وَ تَأْتِيكَ بِالْاَخْبَارِ مِنْ لَمْ تَزُور)

*“Ditët dhe koha do të tregojnë atë që s’e ke ditur,
dhe do të lajmërojnë për atë që s’e ke vizituar!”*

- Besimi dhe bindja se Kur’ani Fisnik është shpallur për meditim, vrojtim e përsiatje mbi ajetet e tij, me qëllim që të udhëzohemi deri në imanin në Zotin e Madhërishëm, përmes meditimt dhe vrojtimit tonë. Është shpallur për të na sjellë lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe ky pa dyshim është edhe qëllimi esencial i shpalljes së tij. Këtë e konfirmojnë edhe vetë Shejh Muhamed Abduhu, Shejh Reshid Rida dhe reformistët e tjerë.

- Dhe në fund Shejh Muhamed Abduladhim Zerkani i thekson disa dobi dhe privilegje që përfitohen nga integrimi i shkencave kozmologjike në tefsir. Në këtë kontekst, ai thotë: *“Përputhshmëria e mendimeve të njerëzve dhe njohurive të tyre me tefsirin e Kur’anit i ushqen nevojat e tyre për kulturë kozmologjike. Ai po ashtu mbron idenë e armiqësisë në mes shkencës dhe fesë, si dhe tërheqjen e vëmendjes së jobesimtareve për Islamin nëpërmes kësaj metode shkencore në të cilën mbështetet këto ditë. Ai insiston në shfrytëzimin e dobive nga fuqitë e gjithësisë”*. Sipas tij, shpirti përmbushet me iman në Zot dhe në fuqinë e Tij kur njeriu i komenton fjalët e Zotit që kanë të bëjnë me gjërat specifike dhe krijesat precize.⁵⁹⁸ Në fund, unë këtë e kuptova gjatë studimit të kësaj problematike dhe këtë që e potencova besoj se është më se e vërtetë dhe e saktë, edhe atë në bazë të analizimit të thënieve të dijetarëve të kaluar e të mëvonshëm. Besoj se ky është qëndrimi i moderuar dhe më i shëndoshë.⁵⁹⁹

⁵⁹⁸ Muhamed Abduladhim Ez-Zerkani, *“Menahilul-irfan fi ulumil Kur’an”*; vëll. 2, 112.

⁵⁹⁹ Më gjerësisht rreth kësaj çështje në tefsir shih: Abdurrahman Halid El-Akk, *“Usulut-tefsir ve kava’iduhu”*; Bejrut, Darun-nefais, Liban, bot. 2, 1986, f. 217-224; Fehd ibn Abdurrahman Er-Rumi, *“Usulut-Tefsiri ve menahixhuhu”*; Rijad, Mektebetut-teubeti, 1413 hixhri, f. 94; Dr. Jusuf El-Kardavi, *“Kejfe neteamelu me’al-Kur’anil-adhim”*, Kajro, Darush-shuruk, bot. 1, 1999, f. 324-369; Sejjid Kutub, *“Fi dhilalil-Kur’an”*, Kajro, Darash-shuruk, bot. 11, 1985, vëll. 1, f. 180-182; Is’hak Esh-Shatibi, *“El-Muvafakat fish-Sheriatil-Islamijjeti”*; vëll. 2, f. 69; Muhamed Husejn Edh-Dhehebi, *“Ef-tefsir vel-mufessirunë”*; Kajro, Mektebetu- Vehbe, bot. 2, 2000, f. 364-381; Ebu Hamid El-Gazali, *“Ihjau ulumiddin”*; tahkik Ebu Hafs Sejjid ibn Ibrahim ibn Sadik, Kajro, Darul-hadith, bot.1, pa vit botimi, vëll. 1, f. 289; Ebu Abdurrahman Es-Sujuti, *“El-itkan fi ulumil-Kur’an”*; Bejrut, Darul-Fikri, 1979, vëll. 4, f. 27-31; Muhamed Husejn Edh-Dhehebi, *“El-It-tixhahat el-munharifetu fi tefsiril-Kur’anil-Kerim-devafi’uha ve def’uha”*; Kajro, Muktebetu-Vehbe, bot. 3, 1986, f. 83-91; Abduladhim Muhamed Ez-Zerkani, *“Menahilul-irfan fi ulumil-Kur’an”*; vëll. 2, 109-113; Iffet

Nuk ka dyshim se kjo çështje shkencore është pjesë e problemeve të mëdha dhe se hulumtuesit kanë nevojë për shqyrtimin e mendimeve dhe shkrimeve të tyre herë pas here, për shkak të zbulimeve të shumta shkencore dhe ndoshta më vonë, disa teori shkencore do të shndërrohen në të vërteta. Por, gjithashtu është shumë e mundshme që disa të vërteta shkencore, për të cilat mendohet se janë të konfirmuara, të shndërrohen në teori të pavlefshme.

Falënderimi dhe lavdërimi i takon vetëm Zotit të botëve!

Muhamed Esh-Sherkavi, “**El-fikrud-dinijju fi muvaxhetil-asri**”; Dirase tahlilijje li it-tixhahatit-tefsir fil-asril-hadith, f. 393-405; J.J.G. Jansen, “**The interpretation of Kor’an in Modern Egypt**”; 34-53.

PJESA E KATËRT

الاتجاه العقدي السني الماتريدي في تفسير القرآن الكريم

Doktrina akaidologjike sunnite maturidite në studimet kur'anore, e ilustruar në mendimet e Shejh Hafiz Ibrahim Dallit

KAPITULLI I PARË

Studimi i tefsirit të Shejh Hafiz Ibrahim Dallit: “Ajka e kuptimeve të Kur’ani Qerimit”.⁶⁰⁰

KAPITULLI I DYTË

Shqyrtimi i disa çështjeve të mëdha akadiologjike në tefsirin e Shejh Hafiz Ibrahim Dallit si dhe sqarimi i qëndrimit të tij ndaj tyre

⁶⁰⁰ Këtu dëshiroj që t’ju sqaroj lexuesve një çështje shumë të rëndësishme. Duke marrë parasysh materialin e shpërndarë shkencor në shumë burime, hulumtime e literaturë rreth jetës së Shejhut Hafiz Ibrahim Dallit dhe veprave të tij, si dhe duke pasur parasysh të dhënat e pakta, vendosa që të shkruaj rreth jetës dhe veprave të tij në mënyrë të përgjithshme, pa e theksuar literaturën që ka të bëjë me çdo ide ose mendim që e shkruaj, ngase nuk kam gjetur të dhëna të mjaftueshme dhe të kënaqshme në një burim. Po ashtu vendosa që të shënoj literaturën e përdorur në fund të hulumtimit për ata që dëshirojnë më shumë rreth kësaj çështje.

KAPITULLI I PARË

Studimi i mendimeve të Shejh Hafiz Ibrahim Dallit në bazë të tefsirit të tij: “Ajka e kuptimeve të Kur’ani Qerimit”;

- Ambienti historik i kësaj doktrine të shqiptarët

Në fillim të shekullit XX janë përpiluar disa libra rreth kësaj doktrine sunnite-maturidite në tefsir. Në shoqërinë shqiptare ka pasur njerëz që e kanë komentuar një të tretën e Kur’anit Fisnik në mënyrë shkencore dhe me metodë të vërtetë, si p.sh., tefsiri i Shejh Hafiz Ibrahim Dallit (Zoti e mëshiroftë!), i cili (dhashtë i Madhi Zot!) ka për të qenë edhe temë e studimit tonë në këtë kapitull.

Gjithashtu ka pasur edhe tefsire të disa ajeteve dhe sureve të komentuar nga disa dijetarë të tjerë, si p.sh., tefsiri i gjatë i sures “El-Fatiha” nga Shejh Haxhi Vehbi Agolli-Dibra, tefsiri i shkurtër i disa ajeteve dhe sureve nga Shejh Hafiz Ali Korça, ashtu siç u pa më parë, tefsiri i shkurtër⁶⁰¹ i Shejh Haxhi Sherif Ahmetit (Zoti e Mëshiroftë!), si dhe disa tefsire të të tjerëve që i theksuam më sipër.

Kjo rrymë akadiologjike sunnite-maturidite ka ekzistuar ngaherë të shqiptarët, si në të kaluarën ashtu edhe në ditët e sotshme, ndaj dhe për këtë shkak, preferuam që të seleksionojmë vetëm një shembull nga komentuesit e tillë, për ta studiuar në këtë hulumtim edhe atë, duke e bazuar në diturinë dhe në autoritetin e tij që e gëzonte në mbarë shoqërinë islame shqiptare.

Në këtë kapitull (dhashtë Zoti i Madhërishëm!) do ta shqyrtojmë personalitetin, metodën dhe tefsirin e Hafiz Ibrahim Dallit: “Ajka e kuptimeve të Kur’ani Qerimit”, si dhe qëndrimin e tij ndaj disa ajeteve që kanë të bëjnë me çështje akadiologjike, si p.sh.: ajetet e Emrave, Cilësive dhe të Parit e Zotit të Madhërishëm etj. Këto çështje do ti studiojmë në detaje gjatë këtij hulumtimi, përkatësisht kësaj analize.

Tefsiri i Shejh Hafiz Ibrahim Dallit është një ndër tefsirët më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm që i njeh trashëgimia islame shqiptare në kohën e re, e që ekziston edhe sot e kësaj dite. Duke u nisur nga ky fakt,

⁶⁰¹ Shih më gjerësisht në faqet e tefsirit të thuktë të Sherif Ahmetit: **“Kur’ani - përkthim me komentim”**, për të parë se si i ka komentuar ajetet e Cilësive të Zotit të Madhërishëm në bazë të metodës maturidite. (Sherif Ahmeti, **“Kur’ani - përkthim me komentim”**; Medinë, 1413 H; Arabia Saudite, fq: 32, 88, 260, 322, 452, 524, 589, 590, 603, 617, 663, 665).

ne më së shumti do t'i mbështetemi këtij tefsiri në krahasim me personalitete e shembuj të tjerë.

1. Njohuri mbi autorin e këtij tefsiri

Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu u lind në vitin 1878 në Tiranë. Ai rrjedh nga një familje fetare intelektuale që dallohej dhe shquhej me kulturë të lartë fetare. Lindja e Shejhut koïncidoi në kohën e Rilindjes Kombëtare shqiptare, gjegjësisht në kohën kur kishin filluar të duken sythat e ideve të ndarjes dhe largimit nga halifati osman në mesin e shoqërisë intelektuale shqiptare, ashtu siç thamë në kreun e parë të këtij disertacioni. Mësimin fillor dhe të mesëm e mori që në moshën e fëmijërisë së hershme. Shejhu (Zoti e mëshiroftë!) e mësoi hifzin e Kur'anit në moshë të re. Literatura nuk thekson se në cilin vit e ka mësuar hifzin e Kur'anit Fisnik e as emrat e hoxhallarëve që ia mësuan hifzin e Kur'anit Fisnik. Hifzi i Kur'anit Fisnik ishte një karakteristikë e përhapur dhe një fenomen që dominonte te dijetarët shqiptarë, saqë rrallë kishte në mesin e studiuesve të lëndëve fetare në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX të atillë që nuk e dinin përmendësh Kur'anin.

Pastaj Shejhu, për t'i vazhduar studimet e larta regjistrohet në Universitetin e Stambollit Darul-Ulum, që njëherësh ishte kryeqyteti dhe qendra e shkencave, dijeve dhe kulturave të ndryshme të cilat zhvilloheshin në gjuhët lindore, gjegjësisht në turqishte, arabishte dhe persishte. Mirëpo, kushtet e vështira ekonomike e detyruan Shejhun që t'i ndërpres studimet për një kohë, me shpresë se përsëri do t'i vazhdonte..., por Zoti e kishte caktuar që të mos i vazhdojë më studimet e larta. Personaliteti i Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu dallohej me kulturë kozmopolite, ngase kishte njohuri të gjëra fetare, politike e patriotike. Ka dëshmi se jeta e tij ishte përplot me orvatje të vazhdueshme për mbrojtjen e identitetit kombëtar shqiptar nga zhdukja dhe shkrirja e plotë në kulturën greke, italiane e atë serbe.

Ky personalitet mbeti anonim dhe larg syve të studiuesve për afro gjysmë shekulli. Deshti Zoti e u shkatërrua sistemi i egër djallëzor komunist dhe doli në shesh personaliteti erudit i këtij dijetari të famshëm, i cili la gjurmë të shumta e të çmueshme shkencore që vlejné të studiohen e të analizohen. Gjatë kryerjes së detyrës si imam dhe hatib dhe gjatë aplikimit të rregullave fetare në Shqipëri, Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu tregoi interes të madh për çështjen patriotike shqiptare, ngase ai gjatë tërë jetës merrej me çështjet e kohës së tij. Ai hapi shkolla në gjuhën shqipe dhe botoi libra e traktate të shumta në gjuhën shqipe për ta mësuar dhe

edukuar popullin shqiptar, edhe pse kjo vepër ishte e rrezikshme në sy të shtetit osman, për të cilin arsimi në gjuhën shqipe konsiderohej krim, për të cilin kryerësi duhej ndëshkuar rreptë, dhe vërtetë ky qëndrim i autoriteteve osmane ishte i çuditshëm!!!

Shkolla e parë që Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu e hapi, ishte ajo e vajzave në vitin 1908, dhe prej aty diplomoi gjenerata e parë e mësueseve muslimane, e cila ndihmoi dukshëm në historinë kulturore e islame të Shqipërisë. Në vitin 1909 u caktua si mësues i gjuhës shqipe në shkollën e mesme në qytetin e Elbasanit në Shqipëri. Në atë shkollë, Shejhu nxënësve ua mësonte edhe gjuhët orientale (arabishten, persishten dhe turqishten). Shejhu bëri një xhihad të madh me shpirt, gjuhë e laps. Ai ishte elokuent, orator i fortë, preciz në fjalë, ndaj dhe si rezultat i ligjëratave dhe hutbeve që i zhvillonte nëpër xhami të ndryshme, fama e tij shumë shpejt u përhap anembanë territoreve shqiptare.

2. Maltretimet dhe vuajtjet e tij për shkak të qëndrimeve të tij fetare dhe patriotike⁶⁰²

Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu është torturuar në burgjet osmane gjatë viteve të fundit të pushtetit osman, e më vonë edhe në burgjet shqiptare është maltretuar dhe dënuar në mënyrat dhe metodat më të këqija. Sipas mendimit tim, ky është ligj hyjnor, ngase rrallë ndonjë prej dijetarëve, thirrësve ose mendimtarëve muslimanë ka shpëtuar nga kjo sprovë. Lusim Zotin e Madhërishëm që të na përqendrojë stoikisht në fenë dhe në adhurimin e Tij!

Sot shumë burgje në vende të ndryshme të botës islame janë të mbushur përplot me dijetarë të tillë. Lusim Zotin e Madhërishëm që të na mbrojë neve dhe ata nga diktatorët zullumqarë kudo qofshin-Amin!

Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu (Zoti e mëshiroftë!) nga duart e zullumqarëve ka përjetuar dënime që nuk mund as të përshkruhen me fjalë... Nga burimet kuptojmë se atij ia kanë shkukur dhëmbët dhe e kanë veshur me tesha femrash para njerëzve. Shejhu dhe shokët e tij thirrës, nuk mund të dilnin në rrugët publike, ngase guvernatorët osmanë

⁶⁰² **Vërejtje:** Këtu dëshiroj të potencoj një çështje shumë të rëndësishme, gjegjësisht faktin se koncepti i patriotizmit ose i çështjes kombëtare të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu dhe bashkëkohësve e shokëve të tij hoxhallarë, ashtu siç do ta vërejmë në këtë hulumtim, ishte i njëjtë sikur koncepti i shehid Shejh Hasan El-Bennasë (Zoti e mëshiroftë!), të cilin e ka përhapur nëpërmes shkrimeve të tij të ndryshme. Shehidi dhe Imami Hasan El-Benna, i përqendruar në këtë ide në një traktat të tij, ju flet njerëzve për ndjenjat e sinqerta të tyre ndaj atdheut të tyre, për flijimin e tyre për hir të atdheut si dhe për respektimin e atyre që punojnë në shërbim të tij. Ai porositi mirësi e respekt në mes njerëzve, edhe nëse kanë besime e fe të ndryshme:

﴿ لَا يَنْهَكُمُ اللَّهُ عَنِ الَّذِينَ لَمْ يُقْتِلُوكُمْ فِي الدِّينِ وَلَمْ يُخْرِجُوكُمْ مِّنْ دِينِكُمْ أَنَّ تَبْرُوهُمْ وَتُقْسِطُوا

إِلَيْهِمْ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ ﴾ [الممتحنة : 8]

“Allahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; Allahu i do ata që mbajnë drejtësinë!” (El-Mumtehine, 8). Ai po ashtu porositi drejtësi dhe mirësjellje ndaj jo muslimanëve në territorin islam: “Ata meritojnë atë që e kemi ne dhe ata përjetojnë atë që e përjetojmë edhe ne”. Ne nuk nxisim ndarje racore e as fanatizëm sektar. Dashuria ndaj kësaj toke, respektimi i saj dhe emocionet, ashtu siç thërrasin patriotët në një anë janë çështje të përqendruara në instinktin e shpirtrave dhe në anën tjetër konsiderohen edhe urdhër i Islamit. Ne jemi dakord me qëndrimin e tyre se me patriotizëm përforcohen lidhjet në mes individëve të një vendi. Ne po ashtu jemi dakord me ata se ky përforcim duhet të përdoret në favor të tyre. Në shkrimin “**Ilâ esh-shebâb**”, fq. 180-181; “**Da’vetunâ**”, fq. 19-20; Nga kodeksi i letrave të imamit dhe shehidit Hasan El-Benna, “Darul-teuzi-ven-neshril-islamij”; Mejdan es-Sejjide Zejneb, 1992.

xhonturq, kah fundi i kësaj periudhe, i nxitnin fëmijët dhe njerëzit naivë që t'i gjuanin me guralecë, t'i shanin dhe t'i ofendonin ashtu siç vepruan njerëzit e marrë dhe fëmijët e Taifit me Pejgamberin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Shteti i kishte izoluar tërësisht, ngase muslimanët nuk guxonin të faleshin pas tyre, t'i përshëndesin, po madje as të flisnin me ta. Ata, po ashtu, nuk thirreshin në dasma, martesë, vdekje e falje të xhenazeve, ashtu siç thirreshin më parë. Izolimi i plotë i tyre i ngjante izolimit që ia bënë idhujtarët Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe muslimanëve në Mekë.

Ai dënohet me dhjetë vjet burg nga gjykata ushtarake, pastaj dërgohet në internim dhe transferohet prej një burgu në tjetër. Burgu i fundit të cilin e përjetoi me përjetime të tejet hidhura ishte ai i "Jedi Kules" në Selanik, Greqi. Këtij burgu i referohet edhe vetë Shejhu, i cili i tregon torturat e mëdha që i ka përjetuar aty. Ai e përshkruan këtë burg si "shtatë xhehenneme". Edhe pse përjetoi maltretime të tilla, Shejhi nuk lëshoi pë dhe nuk u dorëzua para tyre, por përkundrazi, bënte thirrje haptazi për eliminimin e analfabetizmit dhe injorancës që mbretëronin në popullin shqiptar dhe kundër rrezikut që u kanosej për copëtim, ngase vetë shteti osman nuk tregonte interesim ndaj rrezikut të tillë që u kanosej.

Pushteti osman mjaft shpesh e thërriste në biseda informative me qëllim që ta largoj nga mësimi dhe përhapja e gjuhës shqipe. Ata e kundërshtonin Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, ngase ekzistonte një grup turqish hipokritë e tradhtarë që quheshin "xhonturq" e që përhapnin gënjeshtër e dezinformata dhe nxitnin shtetin osman kundër shqiptarëve, duke thënë se mësimi i gjuhës shqipe me shkronja latine e nxjerr njeriun nga Islami, e bën kafir, e largon nga Kur'ani dhe e nxit që t'i shkatërrojë xhamitë e teqetë...! Turqit e lartpërmendur ishin kundër shtetit osman islamik, dhe në të njëjtën kohë, dëshironin që të formonin shtet kombëtar, edhe atë nën ndikimin e cytjeve nga hebrenjtë. Ata ishin hipokritë në shoqërinë islame osmane dhe shqiptare dhe nuk ju takonin as këtyre e as atyre...

Në rrethana të tilla dhe në orvatjet nga më të ndryshmet që "xhonturqit" bënin që si e si ta pengojnë Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu nga aktivitetet e tij, Hafiz Ibrahim Dalliu e deklaroi thënien e tij të fundit: "Injoranca nuk zhduket me tanke e topa, por zhduket me njerëz që punojnë për përhapjen e diturisë".

Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu qëndroi këmbëngulës në mendimet e tij deri në ditët e mbretit tiran, Ahmet Zogu. Ai, po ashtu, u maltretua dhe u burgos edhe gjatë pushtetit fashist italian në Shqipëri, si dhe gjatë

ardhjes së pushtetit komunist, përkatësisht presidentit të mëparshëm shqiptar, komunistit kriminel, Enver Hoxha. Ai qëndroi fortë si një kodër e palëkundur dhe nuk u luhat as edhe për një çast të vetëm para çrregullimeve të tilla shoqërore, fetare e politike. Pra, ai ishte shembull më i mirë i durimit derisa vdiq në atdheun e tij, në vitin 1952, në moshën 70 vjeçare, gjegjësisht në Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë. Ai ishte me plotë kuptimin e fjalës Shejh, dijetar, hoxhë e muxhahid. Ndaj dhe e lusim Allahun që ta mëshirojë me Mëshirën e Tij të Madhe!

3. Veprat dhe aktivitetet e tij shkencore

Ashtu siç thamë më sipër, Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu ishte personalitet me diapazon të gjerë, ndaj edhe veprimtaria e tij ishte konform diapazonit të tij (Zoti e mëshiroftë!) Veprat e tij përqendroheshin në katër pika: në aspektin fetar, shoqëror, letrar dhe politik. Por për fat të keq, pjesa dërrmuese e veprave të tij është djegur nga pushteti komunist shqiptar dhe ka ngelur një pjesë fare e vogël nga trashëgimia letrare e këtij dijetari të madh me përmasa botërore...

Dëshmia e bashkëkohësit të tij, e imanit dhe hoxhës shqiptar Imam Vehbi Ismaili,⁶⁰³ konfirmon numrin e madh të shkrimeve të tij. Sipas disa hulumtuesve, ai ka thënë se Hafiz Ibrahim Dalliu ka shkruar mijëra e mijëra faqe. Nëse kjo informatë është e vërtetë, atëherë ky dijetar ka realizuar diçka që nuk kanë mund ta realizojnë kolegët e tij dijetarë. Nuk duhet të habitemi nga një gjë e tillë, ngase ai kishte çelësat e kulturave dhe qytetërimeve të mëdha, dhe çelësi i çdo kulture është gjuha e saj, dhe ai (Zoti e mëshiroftë!), e njihte arabishten, turqishten dhe persishten, gjegjësisht gjuhët themelore orientale. Pra, fare nuk duhet të habitemi nga aktiviteti i tij dhe nuk ka dyshim se Zoti këtë vlerë (dhunti) ia jep atij që do, e nuk ka kurrfarë dyshimi se Zoti është i Madhërishtëm.

Në vazhdim do t'i theksojmë veprat e Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, të cilat me mund të madh i gjeta në Shqipëri, ndërsa disa të tjera i kanë theksuar hulumtues të tjerë:

1. "Ajka e kuptimeve të Kur'ani Qerimit"

⁶⁰³ Imam Vehbi Ismaili (Zoti e mëshiroftë!) është shqiptar nga Shkodra, studimet i mbaroi gjatë Luftës së Dytë Botërore në Universitetin e famshëm të Az'harit në Kajro, por pas studimeve kurrë më nuk u kthye në Shqipëri, ngase në pushtet erdhën komunistët. Shërbeu si imam dhe ligjërues i shqiptarëve në SHBA dhe kryetar i Qendrës Islame Shqiptare për SHBA dhe Kanada. Edhe Imam Vehbi Ismaili është marrë me shkrime, publicistikë dhe me përkthime të ndryshme nga arabishtja dhe anglishtja në gjuhën shqipe. Ndërroi jetë në maj të vitit 2008. Zoti e mëshiroftë!

Kjo është vepra më e madhe dhe më e rëndësishme e tij që ka arritur te ne, përkatësisht ka mbijetuar gjer në ditët tona, perkundët inkuizicionit dhe terrorit komunist shqiptar. Kjo vepër është tefsir jo i plotë i Kur'anit Fisnik. Autori e komenton Kur'anin deri në fillim të sures Teube në tre vëllime.

Në librin “Libri i së falmes”, Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu thotë: *“Libri: ‘Ajka e kuptimeve të Kur’ani Qerimit’ është përkthyer nga unë dhe është botuar në dy vëllime nga Komuniteti Islamik. Po ashtu ekzistojnë edhe tre vëllime të pabotuara...”*⁶⁰⁴

Edhe pse nuk është i plotë, falënderoj Zotin që ky personalitet islamik shqiptar ka tefsir metodologjik me plot kuptimin e fjalës tefsir, dhe dëshira ime e madhe do të ishte që ta kishte të përfunduar tërësisht atë, mirëpo dëshira e Zotit ishte që ai të vdes pa e realizuar këtë vepër të tij fisnike...

Lus Zotin e Madhërishëm dhe të gjithëfuqishëm që të përgatitë njerëz të sinqertë e dijetarë shqiptarë që do ta vazhdojnë këtë projekt të madh të papërfunduar, ngase kemi nevojë të madhe për një vepër të tillë, ashtu siç ka ndodhur me dijetarët e mëdhenj, të cilët vdiqën pa i përfunduar tefsiret e tyre, por nxënësit e tyre të sinqertë e plotësuan veprën e tyre, gjegjësisht punën e tyre, si p.sh.: tefsiri i Shejh Muhamed Abduhusë, të cilin ai nuk pati mundësi ta përfundojë gjatë jetës së tij, por e vazhdoi nxënësi i tij Shejh Reshid Rida, i cili po ashtu nuk pati mundësi ta përfundojë tefsirin e tij. E njëjta gjë ndodhi edhe me tefsirin e Shejh Muhamed El Emin Shankitit, të cilin e vazhdoi nxënësi i tij i sinqertë, dijetari i njohur Shejh Muhammed Atijeh Salim, apo me tefsirin e Imam Fahrudhin Raziut, atë të Xhelalejnrit dhe me tefsirë të tjerë.

Çështja tjetër e rëndësishme që ka të bëjë me këtë tefsir dhe me autorin e tij, është kontestimi i autorësisë së Hafiz Ibrahim Dalliu. Sa i përket këtij tefsiri nga ana e disa hulumtuesve me pretekst se nuk figuron emri i Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu në kopertinën e tefsirit. Aty figuron titulli i tefsirit, vendi dhe data e botimit: “Ajka e kuptimeve të Kur’ani Qerimit”,⁶⁰⁵ botimet e Këshillit të Naltë të Sheriatit, dhe aty po ashtu shkruan: “U lexua, u shqyrtua e u pëlqye prej Këshillit të Naltë të Sheriatit”.

Këto janë të dhënat që shkruhen në kopertinën e tefsirit dhe siç shihet, aty nuk figuron fare emri i Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu.

⁶⁰⁴ Dr. Feti Mehdiu, “Përkthimet e Kur’anit në gjuhën shqipe”; fq. 48.

⁶⁰⁵ Shtypshkronja “Ora e Shkodrës”, Shkodër 1929.

Replikë ndaj kësaj problematike

Qe ne fillim dua te konfirmoj se ky tefsir i jo kompletuar eshte 100% (in sha Allah) autentik i Hfz. Ibrahim Dalliu. Argumentet vijuese na flasin se:

- A. Ndodh që për shkaqe sigurie e politike njeriu preferon të mos e shënojë emrin e vet në libër, por e shënon emrin e ndokujt tjetër, apo e autorizon ndonjë autoritet islamik që të merr përsipër botimin e librit. Në kohën kur u botua tefsiri i Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, rrethanat politike, shoqërore e fetare në Shqipëri ishin shumë të këqija. Sulmi i ashpër ndaj fesë dhe njerëzve të fesë ishte një realitet i hidhur.
- B. Hulumtuesi dr. Ismail Bardhi e konfirmon autenticitetin e autorësisë së Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu në këtë tefsir në studimin e tij mbi metodën e Shejhut në tefsir. Hulumtuesi i sipërpërmendur e vërteton këtë në bazë të një transmetimi gojor nga një dijetar shqiptar që jetoi dhe veprroi në SHBA, e që ka qenë bashkëkohësi i Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, pra nga fjalët e Imam Vehbi Ismailit (që e përmendëm edhe më sipër). Në bazë të këtij transmetimi verbal ky tefsir është vepër origjinale e Hafiz Ibrahim Dalliu.⁶⁰⁶
- C. Unë mendoj se këto argumente e zbërthejnë çështjen e autorësisë, ngase janë argumente shumë të fuqishme. Këtë realitet e konfirmon vetë Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, ku në një vepër të tij (Libri i se falmes) thekson se ai vet e ka shkruar tefsirin “Ajka e kuptimeve të Kur’ani Qerimit” dhe se Komuniteti Islamik ia ka botuar dy vëllime, ndërsa kanë ngelur edhe tre vëllime tjera të pabotuara fare.⁶⁰⁷
- Ç. Po ashtu unë mendoj dhe besoj se argumenti më i fuqishëm mbi autenticitetin e këtij tefsiri është uniteti metodologjik, uniteti formal dhe tematik, dhe mënyra e tefsirit, stili igjuhës së përdorur, analiza e ajeteve dhe zbërthimi i temave. Në tefsirin e tij vërehet një mënyrë dhe një formë në komentimin e ajeteve, ngase nuk e komenton ndonjë ajet në llogari të ajetit tjetër dhe nuk vëren ndonjë ndryshim. Secili që e përjeton tefsirin e tij dhe që lexon diçka prej tij e vëren këtë të vërtetë metodologjike të tij, dhe Allahu e di më mirë.

⁶⁰⁶ Ismail Bardhi, “Ibrahim Dalliu dhe egzegjeza e tij kur’anore”; fq. 101.

⁶⁰⁷ Feti Mehdiu, “Përkthimet e Kur’anit në gjuhën shqipe”; fq. 48.

Mendoj se me kaq, falë Zotit u zbërthye kjo problematikë, posaçërisht kur dihet se disa hulumtues të mëvonshëm e kanë studiuar jetën dhe tefsirin e Shejhut dhe janë pajtuar se ky tefsir është i Hafiz Ibrahim Dallit pa fije dyshimi.

Falë Zotit, unë pata fat që të gjej vetëm dy vëllime e t'i fotokopjoj nga biblioteka personale e dr. Ramiz Zekajt në Shqipëri, themelues dhe drejtor i Institutit Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islamik (AIITC) në Tiranë, dhe për këtë arsye, i jam shumë mirënjohës!

Veprat e tjera të Shejh Hafiz Ibrahim Dallit janë:

- “E lemja”⁶⁰⁸ dhe jeta e të madhit Muhamed alejhisselam”.⁶⁰⁹
- “Dhuntie Ramazani”.⁶¹⁰ Këtu, në këtë vepër Shejhu e komenton ajetin e agjërit në bazë të tefsirit të imam Fahrudin Raziut, pastaj flet për dobitë fetare, morale, shëndetësore, sociale, ekonomike e obliguese nga agjërimi si dhe për atë se çka e prishë agjërimin, etj.
- “Degët e imanit”.⁶¹¹ Në bazë të fjalëve të Shejhut, kjo broshurë është përkthim i komentimit të hadithit “Besimi ndahet në shtatëdhjetë e ca degë”- nga komentimi i Sahihut të Buhariut që e ka shkruar dijetari i njohur Mahmud Bedruddin El-Ajnij El-Hanefij.
- “Besimi i Muslimanëve”.⁶¹² Këtu autori i thekson disa argumente e fakte mbi ekzistimin e Zotit të Madhërishëm, në të falënderohet Allahu i Madhërishëm, thekson vlerat e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), të Hulefai-Rashidinëve, Imam Ebu Hanifes dhe Imam Ebu Mensur El-Maturidiut (Zoti e mëshiroftë!).
- “Ç’është Islamizma?”⁶¹³ Autori këtu i thekson disa çështje të Islamit dhe Imanit (besimit) me pyetje e përgjigje sipas Ehli Sunnetit dhe Xhematit.
- “Libri i së falmes”. Këtu autori i sqaron parimet e namazit, pastërtisë dhe dobitë prej tyre. Aty po ashtu i ka komentuar e përkthyer disa sure të shkurtra të cilat i lexon falësi i namazeve.

⁶⁰⁸ Shtypshkronja “Shkodra”, Tiranë 1934.

⁶⁰⁹ Fotokopjen e këtij libri e mora në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë, Shqipëri dhe i ka 228 faqe. Këtë libër e ka shkruar Shejhu me një gjuhë të lehtë, atraktive dhe të rrjedhshme prozaike.

⁶¹⁰ Shtypshkronja “Tirana”, Tiranë 1935.

⁶¹¹ Shtypi “Tirana”, Tiranë 1943.

⁶¹² Shtypi “Tirana”, Tiranë 1942.

⁶¹³ Shtypi “Qendra Islamike Amerikane, 1992.

- “Patriotizma⁶¹⁴ në Tiranë”.⁶¹⁵

Nga përkthimet e tij mund të theksojmë:

1. Përkthimin e librit të Imam Bergjeviut (929-981H) “Et-Tarikatu el-Muhammedijje”,⁶¹⁶ “Udha Muhamedane”,⁶¹⁷
2. Përkthimin e veprës së Profesor Omer Nassuhit: “Mësime teorike dhe praktike të moralit islam”,⁶¹⁸
3. Përkthimin e dyzetë haditheve të Imam Neveviut: “Hadithi Erbein”;
4. Përkthimin e librit “Texhvid i Kur’anit”, i përkthyer nga Hafiz Ibrahim Dalliu, por pa e theksuar gjuhën prej së cilës e ka përkthyer.⁶¹⁹
5. Përveç këtyre veprave autori ka shkruar edhe vepra të tjera letrare prozaike, kritike e politike, por këtu nuk kemi vend të mjaftueshëm për t’i theksuar në tërësi.⁶²⁰

⁶¹⁴ Shtypshkronja “Imazh”, Tiranë 1995.

⁶¹⁵ E përpiloi në kohët e fundit të shtetit osman në mes viteve 1908-1915 dhe i theksoi afër 150 patriotë krahas disa personaliteteve islame, të cilët përjetuan tortura shumë të mëdha e maltretime nga pushteti osman (xhonturq), përfshirë edhe vetë Shejhun. Shejhu thekson arsyen e maltretimeve dhe torturimeve të tij dhe të shokëve të tij, gjegjësisht që ka të bëjë me këmbëngulësinë e tyre në idenë për domosdoshmërinë e mësimit në gjuhën shqipe.

⁶¹⁶ Vëll. 1, “Tirana”, Tiranë 1936.

⁶¹⁷ Ky libër është ribotuar për herë të dytë në vitin 2000 nga dr. Ramiz Zekaj, drejtori i **Institutit Shqiptar të Mendimit dhe Qytetërimit Islam (AIITC)**. Në esencë ky libër është libër i besimit të Ehli Sunnetit dhe Xhematit dhe në të ka çështje që kanë të bëjnë me Kur’anin, monoteizmin, kritikën e monoteizmit, risitë në fe, llojet e shkencave, llojet e mëkateve të mëdha dhe sëmundjet e zemrës. Ky libër pati jehonë të madhe, ngase plotësoi një zbrazëtim të madhe që ekzistonte në shoqërinë shqiptare islame.

⁶¹⁸ Shtypshkronja “Tirana”, Tiranë 1935.

⁶¹⁹ Shtypshkronja “Sanxhakia”, Tiranë 1921.

⁶²⁰ Më gjerësisht rreth jetës, mendimeve dhe veprave të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu shih literaturën vijuese:

- Ismail Bardhi, “Hafiz Ibrahim Dalliu dhe egzgjekja e tij kur’anore”; 75-100; Ramiz Zekaj, “Zhvillimi i kulturës islame ndër shqiptarët gjatë shek. XX”; 309-312; “Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët” - (veprat dhe hulumtimet e Konferencës Ndërkombëtare), artikulli i Hysni Myzyrit, “Hafiz Ibrahim Dalliu për mësimin shqip në etapën e fundit të Rilindjes”; 405-410; Feti Mehdiu, “Përkthimet e Kur’anit në gjuhën shqipe”; Logos-A, Shkup 1996, 21-30; Hafiz Ibrahim Dalliu, “Patriotizma në Tiranë”; Imazh, Tiranë, 1995, 37-48; **Türkiye Diyanet Vakfi Islam Ansiklopedisi**, Baglarbashi, Kisikli caddesi, 7, Üsküdar - İstanbul 1997, vëll. 15, fq. 92. Faik A. Kasollja, “Hafiz Ibrahim Dalliu, jeta dhe vepra”; Sinan Tafaj, “Jeta e Hafiz Ibrahim Dalliu”; Rezarta Delisula, “Tiranasi që përktheu Kur’anin”; - (artikuj dhe hulumtime nga interneti); Ibrahim Hasnaji, “Hafiz Ibrahim Dalliu”; Vepra letrare,

4. Metoda e Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu në tefsirin e tij

Muslimanët që jetonin në shtetet ballkanike ballafaqoheshin me probleme të shumta shoqërore, politike, fetare e ideologjike, dhe ndër të parët që i përjetuan golgotat e vështira në jetë nga sfidat e tilla ishin mendimtarët dhe dijetarët shqiptarë, në këtë kontekst hulumtuesi dr. Ismail Bardhi thotë: *“Muslimanët e hapësirës sonë, si shqiptarët, boshnjakët etj., e përjetuan ngjyrën e kohës, ishin brenda gjendjes që me të vërtetë për muslimanët ishte tejte e rëndë, përjetuan krizën e mendjes dhe krizën e të vërtetës historike, dridhjes së vlerave të civilizimit modern; shumë probleme ishin të paprekura ose të interpretuara në mënyrë të demoduar. Mirëpo, besimi i tyre, dashuria për Islamin dhe vëllazërimi i tij, i detyruan që, ndër të tjera, të fillojnë të merren edhe me fushën e tefsirit.*⁶²¹

Është e vërtetë se asokohe ndikimi i Perëndimit dhe dashuria e Lindjes ishin prezente si në paraqitjen e idesë për Zotin, po ashtu edhe të idesë për njeriun, botën, natyrën, lirinë, femrën, etj. Në këtë kohë, përpos përkthimeve të Kur’anit u paraqit edhe tefsiri. Kjo u bë si nga ana e shqiptarëve, ashtu edhe nga boshnjakët. Është për t’u habitur se përafërsisht, në të njëjtën kohë, paraqiten metoda të përafërta të interpretimit të Kur’anit me nuanca të vogla dalluese për nga aspekti i metodologjisë. Te shqiptarët tefsiri së pari botohet në vitin 1929, autor i të cilit është Hafiz Ibrahim Dalliu, ndërsa edhe te boshnjakët thuajse në të njëjtën kohë hasim tefsirin nga Shukrija Alagiq,⁶²² botuar nën vitin 1931, e që ishte përkthim i tefsirit të Reshid Ridasë”.

Për sa i përket metodës dhe mënyrës së tefsirit të tij, mund të them sa vijon:

- Komentuesi Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu (Zoti e mëshiroftë!) tefsirin e tij e fillon pa hyrje, pa prolog, dhe kjo nuk përputhet me metodën e komentuesve të mëdhenj nga selefi i devotshëm dhe nga komentuesit e mëvonshëm gjatë komentimeve të tyre. Shejhu nuk e sqaron metodën që e përdor në tefsirin e tij, dhe s’ka dyshim se këtu është bërë një lëshim i rëndësishëm. Ai nuk vepron ashtu siç veproi Imam Kurtubiu në hyrje të tefsirit të

“Dokrra hini”; **“Grenxat e kuqe të Tiranës”;** Petrit Kuse, **“Një ëndër e ime”;** botimet enciklopedike, Tiranë 2000, 91-95.

⁶²¹ Mbi krizën e mendimit islamik shih më gjerësisht veprën e dr. Ebu Sulejman Abdulhamid: **“Ezmetul aklil-muslimi”;** Darul-alemijje lil-kitabil-islamij, bot. 2, 1992.

⁶²² Ismail Bardhi, **“Hafiz Ibrahim Dalliu dhe egzegjeza e tij kur’anore”;** f. 160.

tij,⁶²³ apo ashtu siç veptoi komentuesi Imam Ibn Xherir Et-Taberij,⁶²⁴ Imam Ibn Kethiri,⁶²⁵ Imam Ebu Haggani⁶²⁶ dhe shumë të tjerë. Shejhu Hafiz Ibrahim Dalliu kishte njohuri për komentuesit e tillë dhe nuk ka pasur arsye që të bëjë një lëshim të tillë. Hyrja dhe prologu i veprës ka rëndësi të madhe, ngase aty autori sqaron metodën, punën dhe kushtet, ashtu siç veptoi Imam Kurtubiu (Zoti e mëshiroftë!) apo shehidi Sejjid Kutubi në tefsirin e tij “Fi dhilalil-Kur’an” etj.⁶²⁷

- Ai menjëherë fillon me komentimin dhe analizën e sures dhe thekson “Besmelen” në arabisht, e pastaj tregon vendin e zbritjes së sures.
- Ai thekson vlerën e sures nëse diçka e tillë është transmetuar dhe pastaj i thekson emrat e sures. Ai shqyrton arsyen e emrit të sures si dhe tregon rëndësinë dhe vlerat e mëdha të sures.⁶²⁸ Fjala “qëllimet” është përdorur nga vetë Shejhu në tefsirin e tij të sures El-Fatiha në gjuhën shqipe: “Qëllimet e mëdha të Kur’anit”. Sureja El-Fatiha përmban disa ose të gjitha qëllimet në përgjithësi, aty ka falënderim ndaj Zotit, aty ka adhurim absolut si dhe qëllime tjera të rëndësishme.
- Fillon tefsirin e “Besmeles” dhe pasi që përfundon thotë: “Komentimi”; dhe më pas hollësisht i komenton ajetet. Në komentimin e “Besmeles”, Shejhu (Zoti e mëshiroftë!) thekson atë që e theksojnë pjesa dërmuese e komentuesve dhe që ka të bëjë me fjalët e zhdukura: “Po, (apo) në emër të Zotit lexoj apo shkruaj”.

⁶²³ Shih Tefsirin e Kurtubiut, Ebu Abdullah Muhamed ibn Ahmed El-Ensari, “**El-Xhami’u li-ahkamil-Kur’an**”, Kajro, Darul-Kutub, El-Misrijje, 1962, vëll. 1, f. 20.

⁶²⁴ “**Xhamiul-bejan an te’vili Ajil-Kur’an, takrib ve tahdhib li imamil-mufessirinë vel-muerrihin Ebi Xha’fer Muhamed ibn Xherir Et-Taberij**”, 224-310; recensoi Salah Abdulfetah El-Halidij, ndërsa hadithet i nxori Ibrahim Muhamed El-Alij, Darul-kalem, Damask, bot. 1, 1997, vëll. 1, f. 1-3.

⁶²⁵ Ismail Ibn Kethir, “**Tefsirul-Kur’anil-adhim**”; Bejrut, Darul-Ma’rife bot. 1, 1406 hixhri, vëll. 1, f. 1-5.

⁶²⁶ Shih Tefsirin e Ebu Hagganit, Ethiruddin Muhamed ibn Jusuf, “**El-Bahrul-Muhit**”, Egjipt, Matba’atus se’adeti, bot. 1, 1328 hixhri, vëll. 1, f. 6-9.

⁶²⁷ Sejjid Kutub, “**Fi Dhilalil-Kur’an**”; Kajro, Darush-shuruk, bot. 11, 1985, vëll. 1, fq. 38-39.

⁶²⁸ Rreth qëllimeve dhe rëndësisë së kësaj shkence shih: “**El-Muvafekat fi usulit-teshri il-islamij**”; Imam Ebu Is’hak Esh-Shatibij, recensoi Shejh Ibrahim Ramadan, krahas botimit të komentuar nga Shejh Abdullah Derraz, vëll. 2, fq. 323-662; shih, po ashtu edhe Se’id Ramadan El-Buti, “**Davabitul-maslahati fish-Sheriatil-Islamijjeti**”. Edhe unë kam një punim dhe studim të pabotuar rreth këtij libri të prof.dr.Butit

- Pastaj ai (Zoti e mëshiroftë!) e komenton fjalën e Madhërisë “Allah”, dhe thotë se ky është nga Emrat e Bukur të Zotit dhe se vetëm Allahu quhet me këtë emër. Ai (i pastër nga të metat) është Qenie e Domosdoshme, dhe kur e shqiptojnë këtë emër menjëherë paramendojnë qenien e Zotit të Madhërisë të cilësuar me cilësi të përkryera që i takojnë vetëm Zotit të Madhërisë.⁶²⁹
- Gjatë tefsirit të ajeteve, thotë: “Rregull - Definicion” - ashtu siç vepronte Imam Ibn Kethiri në të shumtën e rasteve gjatë tefsirit të tij. Në këtë rregull Shejhu sqaron disa çështje shkencore dhe rregulla logjike që kanë të bëjnë me kuptimet e Emrave të Zotit të Madhërisë.
- Ai i shqyrton disa çështje të ndjeshme që kanë të bëjnë me Emrat dhe Cilësitë e Allahut të Madhërisë, i sqaron kuptimet e tyre, por e privon nga çdo gjë që mund ta paramendojë njeriu rreth Qenies së Zotit të Madhërisë.
- Atij (i pastër nga të metat!) nuk i ngjanë asgjë, Ai është i pastër nga cilësitë e mangëta dhe Ai (i Madhërisë) dëgjon gjithçka dhe sheh çdo gjë, si dhe atribuohet me të gjitha cilësitë e përkryera, e që i takojnë vetëm Atij.⁶³⁰
- I kritikon ata që i qasen Kur’anit përmes logjikës dhe ata që janë nën ndikimin e tyre, gjegjësisht sektet e devijuara dhe risit, si p.sh., mu’tezilët, xhehmitët dhe të tjerët, të cilët nëpërmes rregullave logjike e filosofike orvateshin të kuptonin metafizikën dhe çështjet e fesë, dhe kështu devijuan dhe i devijuan edhe të tjerët. Edhe pse kishin qëllime të pastra për të pastruar Zotin e Madhërisë, ata përsëri ranë në grackën e mohimit, privimit dhe të suspendimit të Cilësive të Allahut të Madhërisë.⁶³¹ Shqyrtimi i çështjeve të logjikës është argument se Shejhu e njihte shumë mirë logjikën e Aristotelit.

⁶²⁹ Shih tefsirin e Hafiz Ibrahim Dallit: “**Ajka e kuptimeve të Kur’ani Qerimit**”; vëll. 1, fq. 305. Më tutje lexo vetëm: “**Ajka e kuptimeve**”.

⁶³⁰ Ai me kujdes të madh e shpjegon pastërtinë e Zotit dhe i shqyrton ajetet e cilësive sipas doktrinë së tij maturidite dhe këtë më mirë do ta shohim në kapitullin e dytë të kësaj pjese.

⁶³¹ Më gjerësisht rreth drejtimeve të devijuara në fe e tefsir shikoni: Muhammed Husejn Edh-Dhehebi, “**EL-Ittixhahatu el-munharifetu fij tefsiril-Kur’anil-kerim**”; Mektebu vehbe, Kajro 1996, fq. 47-62; Zaglul Esh-Shahat, “**EL-Ittixhahatu el-fikrijjetu fit-tefsir**”; Aleksandri, El-hej’et ul-misrije el-ammetu lil-kitab, bot. 2, 1977, fq. 186-216.

- Nëpërmes tefsirit të tij, ai përpigjej të korrektonte disa koncepte të gabuara që ekzistonin në mesin e shqiptarëve muslimanë dhe në mesin e të tjerëve, ngase konflikti ideologjik veçmë ekzistonte në shoqërinë shqiptare, si p.sh., komunizmi dhe sulmi i tij i ashpër kundër fesë e besimtarëve gjatë viteve të njëzeta e tridhjeta të këtij shekulli.⁶³² Pra, Shejhu ishte i obliguar që të merrej me çështje të tilla dhe të tregojë të vërtetën dhe kjo argumenton se ai e njihte mirë realitetin e kohës së tij dhe dinte si t’ju përgjigjej sfidave të kohës së tij.
- Ai i shqyrton disa çështje gjuhësore e sintaksore dhe kjo gjë vërehet qartë në tefsirin e tij që i bën fjalës “Rabb-un” “رب”. Ai (Zoti e mëshiroftë!) nuk mbështetej vetëm në kuptimin e fjalës, por zhytej thellë në domethëniet e fjalës për të nxjerrë edhe kuptime tjera. Ai thekson se nga kuptimet e fjalës “Rabb” janë: Krijues, ushqyes, rregullues, mbajtës i pushtetit. S’ka dyshim se Zoti kur i krijoi krijesat nuk i la të hutohen, por ua sistematizoi çështjet nga aspekti fetar dhe i kësaj bote.⁶³³ Ai, po ashtu në komentimin e fjalës: “El-alemin - botët”, “العالمين” thotë: “Kjo fjalë përdoret në shumës dhe ky emër përdoret për të gjithë emrat, përveç Allahut të Madhërishëm, qofshin qeniet e vogla apo të mëdha. Qeniet e tilla argumentojnë ekzistimin e Zotit të Madhërishëm dhe se nuk mund të ekzistojnë pa edukimin dhe sistemimin e Zotit, dhe për këtë shkak përdoret forma e shquar me “el” që të tregojë përgjithësinë dhe vazhdimësinë. Ato duhet ta falënderojnë Atë ashtu siç e meriton. Të gjitha krijesat, pas krijimit kanë nevojë për mbikëqyrje e mbrojtje dhe për Atë që kujdeset për jetën e tyre. Tefsiri i ajetit: “Rabbil-alemin - Zoti i botëve” “رب العالمين” - është kështu apo Zoti është Krijues dhe Mbikëqyrës i të gjitha botëve”.⁶³⁴
- Ndonjëherë i thekson fshehtësitë e parimeve që dalin nga ajetet, këtë gjë e kuptova nga tefsiri i tij i sures “El-Fatiha”, gjegjësisht ajeti: “إياك نعبد” “Ijjake na’budu – Vetëm Ty të adhurojmë!”; ku thotë: “Lexuesi i “El-Fatihës” kur e lexon këtë ajet dhe është vetëm, nuk thotë: “Vetëm Ty të adhuroj”, por thuhet në shumës, ngase ka edhe të tjerë vëllezër e robër të Zotit, evlia e engjëj, si

⁶³² Rreth karakteristikave historike fetare e shoqërore të territoreve shqiptare shih studimin e hulumtuesit dhe orientalistit italian Roberto Maroko Dela Roka, “**Kombësia dhe feja në Shqipëri...**”; 117-142.

⁶³³ “**Ajka e kuptimeve...**”; vëll. 1, fq. 8-9.

⁶³⁴ Po aty, f. 10.

- Ndonjëherë thekson disa gjurmë apo të dhëna për të cilat mendohet se janë israiliate,(nga burimet çifute apo krishtere) ngase nuk i thekson burimet e gjurmëve të tilla.⁶³⁶

Të dhënat dhe gjurmët që janë israiliate sipas dijetarëve Islam ose përputhen me Sheriatin tonë ose jo, e nëse kundërshtojnë Sheriatin tonë, nuk i pranojmë dhe i hedhim, madje nuk lejohet as të transmetohen, e nëse përputhen, i theksojmë për inkurajim e jo për argumentim.⁶³⁷ Kështu thotë edhe Shejhul-Islami, ibn Tejmije (Zoti e mëshiroftë!).⁶³⁸ E nëse nuk përputhen e as nuk kundërshtohen me Sheriatin tonë; atëherë nëse ai që mëson dhe studion Sheriatin është fillestar, ai pra nuk duhet të lexojë diçka nga israiliatet që të mos krijohet ndonjë fitne në besimin dhe mendjen e tij, ndërsa nëse është dijetar i thelluar në shkencat islame dhe nuk frikësohet nga fitneja, atëherë për atë nuk ekziston ndonjë frikë që ai të lexojë atë që e ka kundërshtari.

* Ndonjëherë formon pyetje gjatë tefsirit të tij pastaj përgjigjet, si p.sh., në tefsirin e ajetit kur'anor: " **صراط الذين أنعمت عليهم** " *"Në rrugën e të cilëve e begatove për ta"* - dhe në këtë kontekst, Shejh Dalliu thotë: *"Për cilët flet Zoti i Madhërishëm në këtë ajet fisnik dhe cilët i dallon me begati e respekt?"*; Dhe më pas, vetë Shejhu përgjigjet: *"Pjesa dërrmuese e dijetarëve thonë se me këtë ajet nënkuptohen pejgamberët, të dërguarit, evliatë, shehidët dhe robërit e devotshëm të Zotit"*.⁶³⁹ Më mirë do të ishte që Shejhu t'i përgjigjej pyetjes me ajetin e sures "En-Nisaë", në të cilin Zoti i Madhërishëm thotë:

⁶³⁵ Po aty, f. 14.

⁶³⁶ Po aty, f. 16.

⁶³⁷ **Vërejtje e rëndësishme:** Profesori dhe mentori im i nderuar, prof.dr. Abdulkahhar Al Ani nga Iraku, në një ligjëratë të tij të mbajtur ditën e Premte në Universitetin Ndërkombëtar Islamik në Malajzi (Kuala Lumpur), kërkoi që israiliatet të eliminohen tërësisht nga tefsiri dhe të mos i përdorim gjatë komentimeve tona, duke pohuar se edhe vetë Imam Ibn Tejmije në kohën e tij thoshte se **"Israiliatet kanë plot gënjeshtër e trillime."** Duke pasur parasysh kohën kur jetoj ai dhe diturinë e tij enciklopedike të gjerë, atëherë me plot të drejtë lind pyetja: Sot ç'do të bënim ne?!

⁶³⁸ Ibn Tejmije, **"Usulut-tefsir"**; recensoi Ferijal Ulvan, Bejrut, Darul-fikril-lubnani, Bejrut, Daru Kutejbe, 1989, fq. 11-110.

⁶³⁹ **"Ajka e kuptimeve..."**; vëll. 1, f. 19.

النَّبِيِّنَ مِّنْ عَلَيْهِمُ اللَّهُ أَنْعَمَ الَّذِينَ مَعَ فَأُولَٰئِكَ وَالرَّسُولَ اللَّهُ يُطِيعُ وَمَنْ

([النساء: 69] ﴿ ٦٩ ﴾ رَفِيقًا أُولَٰئِكَ وَحَسَنٌ وَالصَّالِحِينَ وَالشُّهَدَاءِ وَالصَّادِقِينَ

“E kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit, të tillët do të jenë së bashku me ata që Allahu i shpërblen: (me) pejgamberët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe më të mirët. Sa shokë të mirë janë ata!”⁶⁴⁰ Kishte qenë ma e udhës që ai (Allahu e mëshiroftë) në këtë kontekst të komentojë Kur’anin me Kur’an, ngase metoda më e mirë e tefsirit; është tefsiri i Kur’anit me Kur’an, dhe kjo metodë është më e preferuara te dijetarët e selefit dhe të halefit (të hershmit dhe të vonshmit).⁶⁴¹

* Ai i thekson shkaqet e zbritjes së ajetit dhe sures, dhe në këtë kontekst Shejhu (Zoti e mëshiroftë!) thotë: “Thuhet se “El-Fatiha-ja” është prej sureve të para të shpallura, ndërsa ajetet e para të shpallura janë pesë ajetet e parë të sures: “El-Alek”.⁶⁴²

Nga fjalët e Shejh Hafiz Ibrahim Dalliut vërehet qartë se ai kishte njohuri të plotë rreth dallimit në mes ajeteve të para që zbritën dhe sureve të para të plota që zbritën, dhe në këtë çështje, ai ka qenë i përpiktë. Këtë mendim edhe Shejh Menna’ë El- Kattan, (Allahu e mëshiroftë) e ka theksuar nga Imam Zerkeshiu rreth këtyre dy çështjeve.⁶⁴³

* Ai i thekson mendimet dhe pastaj në bazë të shkathtësisë së tij, e zgjedh mendimin më të mirë. Në tefsirin e tij të ajetit kur’anor:

([الفاتحة: 7] ﴿ ٧ ﴾ الضَّالِّينَ وَلَا عَلَيْهِمُ الْمَغْضُوبِ غَيْرَ)

“Jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!”, Shejhu thotë: “Disa dijetarë thonë se “jo në të atyre që kundër veti tërhoqën hidhërimin”- janë hebrenjtë, ndërsa “e as në të atyre që e humbën veten”- janë të krishterët. Më e preferuara te “xhumhuri” është se “ata që kundër veti tërhoqën hidhërimin”- janë mëkatarët e kriminelët e çdo populli, ndërsa “ata që humbën veten”- janë ata që nuk dinë se si të arrijnë te Zoti i vërtetë dhe preferojnë të qëndrojnë në errësirë...”⁶⁴⁴

⁶⁴⁰ En-Nisaë, 69.

⁶⁴¹ Shih: “Usulut-tefsir” të Ibn Tejmijes, fq. 60-61.

⁶⁴² “Ajka e kuptimeve...”, vëll. 1, fq. 19-20.

⁶⁴³ Men-na’ El Kattan, “Mebahith fi ulumil-Kur’an”; Bejrut, Mues-sesetul-risaleti, bot. 23, 1998, fq. 66-68.

⁶⁴⁴ Po aty, vëll. 1., fq. 20-21.

Këtu mund të shtrohet pyetja se në çfarë baze Shejhu e preferoi një gjë të tillë? Shejhu nuk e ka theksuar burimin apo mendimin që preferoi një gjë të tillë, përpos nëse thuhet se ai është bazuar në metodën e tij dhe në rregullën e shkencës së Usuli Fikhut, **"العبرة بعموم اللفظ لا"** që nënkupton se; mësimet dhe dobitë nga tekstet kur'anore dhe ato profetike duhet të merret nga kuptimi dhe struktura e përgjithshme e fjalës, e jo nga specifika e arsyes për të cilin ka zbritur teksti, dhe kështu Shejhu e përdor këtë kuptim në bazë të kuptimit esencial për të cilin edhe është shpallur teksti. Në këtë kontekst ai ka qenë shumë i qëlluar dhe i përpiktë.

- Ai thërret në marrjen mësim nga gjendja e popujve të mëparshëm dhe në studimin e historisë, dhe kjo vërehet qartë në tefsirin e tij të sures "El-Fatiha" ku i thekson dobitë që nxirren nga kjo sure. Ne obligohemi të marrim mësim nga gjendja e popujve të kaluar dhe nga përjetimet e tyre gjatë historisë.⁶⁴⁵
- Dëshira e madhe e Shejhut për sqarim e shpjegim e bënte që të përdorë shpesh disa thënie thelbësore, si p.sh.: "ajka e tefsirit", ndonjëherë gjatë sqarimit përdorte fjalën, "shkoqitje", ndonjëherë "shpjegime".⁶⁴⁶ Në disa vende përdorë: "Thelbi i Kur'anit",⁶⁴⁷ dhe kur përfundon tefsirin, thotë: "Fund!"⁶⁴⁸
- Ndonjëherë i thekson gjurmët dhe të dhënat nga sahabët e mëdhenj, si p.sh., gjurmët që transmetohen nga Abdullah ibn Abbasi dhe Ibn Mes'udi r.a.⁶⁴⁹
- Ai i thekson mësimet dhe dobitë alegorike dhe stilistike të bukura të ajetit, si dhe ndonjëherë i thekson fshehtësitë e kuptimeve të shkronjave të ndara që përdoren në fillim të sureve. Ndonjëherë shqyrton çështje morfologjike e ndonjëherë edhe prozodike.⁶⁵⁰
- Ndonjëherë e përcakton një kuptim të ajetit nga shumë kuptimet e tjera, dhe kjo e vërtetë ka një rëndësi shumë të madhe. Në tefsirin e tij të ajetit:

([البقرة: 2] لِّلْمُتَّقِينَ هُدًى)

⁶⁴⁵ Po aty, fq. 23.

⁶⁴⁶ Po aty, fq. 42-84,89.

⁶⁴⁷ Po aty, fq. 53-57.

⁶⁴⁸ Po aty, vëll. 2, fq. 699.

⁶⁴⁹ Po aty, vëll. 1, fq. 25.

⁶⁵⁰ Po aty, fq. 29.

“Udhëzues për të devotshmit”, kur flet për domethënien e të devotshmëve, thotë se ekzistojnë tre kuptime dhe tre shkallë të devotshmërisë:

1. Të frikësohet njeriu nga shirku në Zotin e Madhërishëm, ngase idhujtari meriton dënim të përhershëm;
 2. Të frikësohet njeriu nga veprat e këqija, nga morali i keq dhe nga punët e ndaluara; dhe:
 3. Zemra të pastrohet nga çdo gjë përveç Zotit të Madhërishëm, në Të të përqëndrohet tërësisht dhe Atij absolutisht t’i drejtohet. Kjo shkallë është e evliave dhe e të afërmeve si dhe këto janë veprat e tyre. Qëllimi i ajetit ka të bëjë me shkallën e parë dhe të dytë...⁶⁵¹
- Nuk i ka theksuar llojet e leximit të kur’anit (القراءات القرآنية) (Kiraetet e kur’anit) asnjëherë gjatë tefsirit të tij dhe nuk vërejtja ndonjë gjë të tillë gjatë leximit të tefsirit të tij.⁶⁵²
 - Ka qenë i qartë në fjalë dhe i kuptueshëm në tefsir, në shkrim e përkthim. Për ta kuptuar lexuesit, ai shpesh herë i sqaronte paqartësitë e disa definicioneve dhe rregullave të Sheriatit, si p.sh., dallimin në mes والتأويل والتفسير والمحكم (te’vil, tefsir, muhkem) dhe “muteshabih” etj.

Nëse pëson ndonjë ndryshim gjatë komentimit apo sqarimit, ai ua tregon atë lexuesve që të kenë njohuri rreth çështjes së tillë.⁶⁵⁴ Kur vëren ndonjë gabim shtypi, tematik apo shkencor, thotë: “Korrigjim” - dhe pastaj thekson vëllimin, faqen dhe rreshtin ku duhet korrigjuar.⁶⁵⁵

Personalisht them dhe jam i mendimit se me këtë besnikëri shkencore dhe objektivitet duhet të pajiset çdo hulumtues.

- * Nuk e preferon ndonjë mendim më tepër, dhe ndonjëherë Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu i thekson disa tefsire të një ajeti pa e preferuar asnjërin prej tyre, si p.sh., në tefsirin e ajetit kur’anor:

([البقرة: 23] ﴿صَدَقِينَ كُنْتُمْ إِنْ أَلَّهِ دُونَ مِّنْ شُهَدَاءَ كُمْ وَأَدْعُوا﴾)

“Dhe thirrni (në ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotat) pos Allahut, nëse jeni të sinqertë (në thëniet tuaja se Kur’ani nuk është prej Zotit)”.⁶⁵⁶

⁶⁵¹ Ajka e kuptimeve, vëll. 1, fq. 31-32.

⁶⁵² Ajka e kuptimeve, vëll. 2, fq. 986-989.

⁶⁵³ Po aty, vëll. 1, fq. 458.

⁶⁵⁴ Po aty, vëll. 1, fq. 449-450.

⁶⁵⁵ Po aty, vëll. 1, fq. 336.

⁶⁵⁶ El Bekare, 23.

Ai këtu i thekson pesë kuptime ose mendime pa e preferuar ndonjërin konkretisht, mendoj se do të ishte më mirë për të, sikur të preferonte mendimin që ishte më i kapshëm për lexuesin shqiptar dhe të mos e lë atë të hutuar.⁶⁵⁷

- Ndonjëherë i thekson mendimet e komentuesve dhe pastaj komenton apo thekson diçka nga studimet apo hulumtimet e shkencëtarëve amerikanë e evropianë rreth Islamit.⁶⁵⁸
- Ndonjëherë bën dy përkthime të ndryshme në mënyrë dhe tekst, kjo ngase në rast se lexuesi e ka të vështirë që të kuptojë përkthimin e parë, dhe për t'ia lehtësuar atij përkthimin, sjell edhe përkthim tjetër krahas përkthimit të parë.⁶⁵⁹
- Ai mbështetëj në aspektin ekzoterik (ظاهر النص) (dhahirun-nas) të tekstit dhe nuk anonte në alegori ose metafora (المجاز) (el mexhaz)⁶⁶⁰ dhe në tefsirin e ajetit kur'anor:

وَجَعَلَ عَلَيْهِ وَغَضِبَ اللَّهُ لَعْنَهُ مَنْ أَلَّهِ عِنْدَ مَثُوبَةٍ ذَلِكَ مِّنْ بَشَرٍ أُتْبِعْتُمْ هَلْ قُلْ
السَّبِيلِ سَوَاءٍ عَن وَأَضَلُّ مَكَانًا شَرُّ أَوْلَيْكَ الطَّغُوتِ وَعَبَدَ وَالْخَنَازِيرَ الْقِرَدَةَ مِنْهُمْ

([المائدة : 60])

“Thuaj: “A t’ju lajmëroj për një të keqe (të zezë) më të dëmshme (nga ajo e metë) si dënim nga Allahu? (Ajo është) mallkimi i atij që e mallkoi Allahu dhe hidhërimi ndaj tij, që disa prej tyre i shndërroi në majmunë e në derra e i bëri adhures të djallit”.”⁶⁶¹

Ai transmeton fjalët e disa komentuesve se ata (disa çifut) vërtetë u shndërruan në derra e majmunë dhe se nuk është shprehje alegorike. Në bazë të hulumtimit të kësaj çështje, mendoj se pjesa dërrmuese e komentuesve të selefit kanë mendim identik me Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, ngase Zoti realisht i ka bërë disa çifutë të rinj majmunë e disa pleq derra, dhe se kjo nuk është vetëm shprehje figurative, por është realitet, dhe se ky ndëshkim erdh për shkak të maltretimit, tradhetise dhe vrasjes së pejgamberëve të tyre. Pra, për këtë arsye, Zoti ua ka shndërruar formën në majmunë e derra si në pamje ashtu edhe në sjellje. Sjelljet e

⁶⁵⁷ Ajka e kuptimeve, vëll. 1, fq. 68-69.

⁶⁵⁸ Po aty, fq. 560, 580.

⁶⁵⁹ Po aty, fq. 544-545, 558.

⁶⁶⁰ Po aty, fq. 986-989.

⁶⁶¹ El-Maide, 60.

disa çifutëve cioniste ende edhe sot e kësaj dite janë më të këqija dhe më brutale se sjellja egërsirave.

Pra, duke pasur parasysh fuqinë e Zotit të Madhërishëm, atëherë mund të thuhet se Zoti i Madhërishëm ua ka shndërruar formën në kafshë të tilla në një periudhë të caktuar historike. Pra, Zoti është i Gjithëfuqishëm dhe bën çdo gjë! Zoti i Madhërishëm ka fuqinë të krijojë njeriun pa prindër ashtu siç e krijoi Ademin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

Zoti i Madhërishëm po ashtu ka fuqi që të krijojë njeriun vetëm nga nëna, por jo edhe nga babai, ashtu siç veproi me Isain (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) Zoti i Madhërishëm ka fuqi që t'ua ndërrojë fytyrat njerëzve në forma tjera e t'i ruajë fytyrat e të tjerëve!

I Madhërishëm është Zoti i botëve!⁶⁶²

* Shejhu (Zoti e mëshiroftë!) nuk i ka theksuar burimet e informatave dhe të dhënave të potencuar. U desh që t'i shënonte, ngase transmetimi i të dhënave të sakta i përket fesë islame dhe sikur të mos ishte mbështetja në burime të sakta në fe, atëherë secili do të fliste sipas dëshirës së vet dhe një gjë e tillë nuk lejohet në Islam.

* Ndonjëherë zgjerohej në sqarimin e disa çështjeve të rëndësishme fetare. Në tefsirin e ajetit kur'anor:

(﴿يُوفُونَ هُمُوبًا لَّآخِرَةَ قَبْلَكَ مِنْ أَنْزَلْ وَمَا إِلَيْكَ أَنْزَلْ بِمَا يُؤْمِنُونَ وَالَّذِينَ﴾)

[البقرة: 4]

“*Të cilët besojnë në atë që të është shpallur ty...*”, ai thotë se secili musliman duhet të besojë përgjithësisht në librat e mëparshëm, gjegjësisht në Teuratin e Musait a.s, në Inxhilin e Isait a.s. dhe në Zeburin e Davudit a.s si dhe nuk duhet besuar veçmas në detajet e tyre. Sa i përket Kur'anit, muslimani duhet të besojë në të si në aspektin e përgjithshëm ashtu edhe në atë detal, ngase në Kur'an ka parime islame në të cilat duhet besuar në

⁶⁶² Më gjerësisht rreth kësaj çështje, shihni tefsirët: Ebu Xha'fer Muhamed ibn Xherir ibn Jezid ibn Halid Et Taberi, “**Xhamiul bejan an te'vili ajil-Kur'an**”; vëll. 6, f. 293; Ebus-Sa'ud El-Hasen ibn Mes'ud El-Ferra El-Begavij, “**Me'alimut-tenzijl**”; recensoi Halid El-Akk, Mervan Sevvar, Bejrut, Darul Ma'rifeti, bot. 2, 1987, vëll. 1, 37; Abdurrahman ibn Kemal Xhelaluddin Es-Sujuti, “**Ed-durrul-menthur**”; Bejrut, Darul-fikri, 1993, vëll. 3, fq. 109-110; Abdurrahman ibn Alij ibn Muhamed El-Xheuzij, “**Zadul-mesijr fi ilmit-tefsir**”; Bejrut, El-Mekteb-el-islamij bot. 3 1404 H. vëll. 2, 387-388; Ali ibn Ahmed Ebu El-Hasen El-Vahidij, “**El-Vexhiz fi tefsiril-kitabil-aziz**”; recensoi Safvan Adnan, Bejrut, Ed-darush-shamijje, bot. 1, 1415 hixhri, vëll. 1, f. 326; Muhamed ibn Muhamed El-Imadij Ebus-Su'ud, “**Irshadul-aklis-selim, ila mezajal-Kur'anil-Kerim**”; Bejrut, Daru ihjait-turathil-arabij, pa vit botimi, vëll.3, f. 155.

përgjithësi dhe detalisht. Njohja në detaje e kuptimeve të ajeteve është obligim i përgjithshëm e jo obligim i veçantë individual (*fard kifaje* e jo *fard ajn*)”⁶⁶³

- Për disa çështje e parime të rëndësishme ai flet në detaje për shkak të rëndësisë së tyre, si p.sh., parimet e abdesit, namazit, agjërit, haxhillëkut etj., ngase muslimanit i duhen çdo ditë. Ai, në çështje të besimit (akides) dhe ato juridike i përkiste medhhebit hanefit, dhe në asnjë mënyrë nuk është larguar asnjëherë nga çështjet juridike dhe akaidologjike të besimit hanefit.⁶⁶⁴
- Ndonjëherë i thekson thëniet e imamëve të mëdhenj tabi’inë gjatë sqarimit të parimeve të nxjerra nga ajeti, si p.sh., në tefsirin e ajetit kur’anor:

ط
الْأَيْمَنَ عَقَدْتُمْ بِمَا يُؤَاخِذُكُمْ وَلَكِنْ أَيْمَنِيكُمْ فِي بِاللَّغْوِ اللَّهُ يُؤَاخِذُكُمْ لَا)

([المائدة: 89])

“Allahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet tuaja të paqëllimta (për betim)...” (El-Maide, 89). Gjatë komentimit të këtij ajeti, ai thekson tetë mendime të dijetarëve komentues të mëdhenj tabi’inë.⁶⁶⁵

- Kur i shqyrton çështjet juridike të fikhut, Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu mjaftohet me njohuritë e veta juridike që i ka rreth çështjes konkrete juridike pa i theksuar mendimet e dijetarëve rreth asaj çështje, dhe kjo ndoshta është rezultat i njohurive të tij të mëdha, ndërsa në çështjet e tefsirit të fjalës së Zotit të Madhërishëm transmeton nga të tjerët që janë më të dijsëm se ai,⁶⁶⁶ nga frika që të mos gabojë në fjalën e Zotit të Madhërishëm.
- Ai gjatë tefsirit të tij i kushtonte rëndësi mësimave dhe leksioneve që nxirren nga ajetet kur’anore.⁶⁶⁷
- Ai përdor metodën krahasuese në ekspozenë e thënieve. Shumë herë i paraqet disa mendime nga komentues të ndryshëm dhe e lë lexuesin që ta zgjedh mendimin e preferuar.⁶⁶⁸

⁶⁶³ Po aty, vëll. 1, fq. 40.

⁶⁶⁴ Po aty, vëll. 1, fq. 337.

⁶⁶⁵ Po aty, vëll. 1, fq. 337.

⁶⁶⁶ Po aty, vëll. 2, fq. 986-989.

⁶⁶⁷ Po aty, vëll. 1, fq. 142.

⁶⁶⁸ Po aty, vëll. 1, fq. 148-149.

- I kritikon Ithtarët e Librit, gjegjësisht çifutët dhe të krishterët posaçërisht çifutët, ngase nuk pranojnë abrogimin si dhe e përshkruajnë Zotin me padituri. Zoti i Madhërishëm e di dhe e njeh gjendjen e njerëzve në kohën e Musait, Isait dhe Muhamedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)⁶⁶⁹

Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu transmeton tekste nga Teurati dhe Inxhili për t'i kritikuar çifutët, të krishterët dhe protestantët për shkak të trillimeve të tyre me qëllim që të konfirmojnë abrogimin e ligjeve të mëparshme hyjnore. Abrogimi në Kur'an nuk është risi dhe i panjohur ashtu siç mendonin çifutët, dhe mua personalisht më pëlqen kritika e Shejhut kundër tyre. Më hollësisht rreth kësaj kritike shihe tefsirin e tij.⁶⁷⁰

- Fillimi është padyshim çështje e besimit hebraik dhe se Teurati flet për të në kapitullin e Krijimit: “Dhe Zoti e pa se çdo gjë që e ka bërë është shumë e mirë”- dhe kjo nënkupton se Zoti ka krijuar pa e ditur se çka krijon, e mirë apo e keqe dhe pastaj e kupton se atë që e ka krijuar “është shumë e mirë”.⁶⁷¹
- Kur përfundon komentimin e ajeteve të një tematike, thotë: “Ky është fundi i ajeteve që flasin për Beni Israilët dhe tash do të kemi punë me ajetet që janë shpallur për këtë e këtë gjë”.⁶⁷² Kjo metodë e tefsirit i ngjanë shumë metodës së tefsirit të shehid Sejjid Kutubit në “Fi dhilalil-Kur'an”.
- Është shumë preciz në transmetimet që bën nga tefsiri i Raziut dhe i Bejdaviut dhe asgjë nuk transmeton pa e kuptuar dhe pa e analizuar. Ai me kujdes të madh i zgjedh kuptimet që kanë të bëjnë me temën dhe largohet nga transmetimi i çështjeve sekondare që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me tekstin dhe kjo anë është shumë pozitive te Hafiz Ibrahim Dalliu dhe për këtë padyshim meriton fjalë miradije, ndaj dhe Zoti e mëshiroftë me Mëshirën e Tij të gjerë.⁶⁷³

⁶⁶⁹ Po aty, vëll. 1, f. 169.

⁶⁷⁰ Po aty, vëll. 1, fq. 170-171; Më gjerësisht rreth kësaj çështje, shih: “**El-Muvafekat fish-Sheriatil-Islamijjeti**” të Imam Ebu Is'hak Esh-Shatibij, vëll. 3, fq. 95-111 dhe veprën: “**Mebahith fi ulumil-Kur'an**”, të Shejh Menna'ë El-Kattanit, fq. 231-244.

⁶⁷¹ Zaglul Esh-Shehhat, “**El-Ittixhahat el-fikrijje fit-tefsir**”, fq. 292; Ebu Xha'fer En-Nehas, “**En-nasih vel-mensuh**”. Në këtë vepër ka të dhëna të mira rreth dallimit në mes abrogimit dhe fillimit. Abrogimi lejohet dhe ndodhë në Sheriat dhe nuk është fillim ashtu siç theksonin çifutët. Më gjerësisht shih në këtë libër, që e recensoi dr. Muhamed Abduselam Muhamed, Kuvajt, Mektebul-felah, bot. 1, 1408 hixhri, vëll. 1, fq. 40-46, 62-63.

⁶⁷² Ajka e kuptimeve, vëll. 1, f. 191

⁶⁷³ Po aty, f. 190.

- Ndonjëherë e përdor tefsirin objektiv dhe shumë herë argumenton me ajete kur'anore që kanë të bëjnë me të njëjtën temë, por kjo ndodhë pak dhe rrallëherë.⁶⁷⁴
- Sa i përket tefsirit shkencor të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliut, ashtu siç thamë edhe më parë, ai dallohej me shkathtësi intelektuale, me mendime iluministe dhe të hapura dhe vërtetë ishte shembull në kohën e tij, ngase ua kishte tejkaluar shokëve dhe të afërmeve të tij, për shkak të njohurive shkencore e kulturore që i kishte. Në tefsirin e ajetit kur'anor:

بِهِ فَأَخْرَجَ مَاءَ السَّمَاءِ مِنْ وَأَنْزَلَ بِنَاءَ وَالسَّمَاءِ فِرَاشًا الْأَرْضَ لَكُمْ جَعَلَ الَّذِي

([البقرة: ﴿٢٢﴾ تَعْلَمُونَ وَأَنْتُمْ أَنْدَادًا لِلَّهِ تَجْعَلُونَ فَلَا لَكُمْ رِزْقًا الثَّمَرَاتِ مِنْ

[22

“Ai, i cili për ju bëri tokën shtrat (vendbanim) e qiellin kulm...”⁶⁷⁵, ai thotë se është vërtetuar forma e rrumbullakët e tokës, në të cilën jetojmë ne dhe se kjo vërtetohet me argumente e fakte shkencore. Toka në fillim ka qenë gaz e zjarr ndriçues si ylli në qiell, pastaj periudha e zjarrit kalon një afat të gjatë kohor dhe në shumë zhvillime derisa përfundon në këtë gjendje mesatare: as e fortë, as ujore e as e butë, derisa u bë e përshtatshme për jetë...⁶⁷⁶

Për sa i përket qëndrimit tonë rreth tefsirit shkencor, kushteve e rregullave të tij, ne biseduam në kapitullin e tretë.⁶⁷⁷

Kjo ishte metoda e tij dhe mënyra e tefsirit, ashtu siç e vërejta unë gjatë leximit me plot përkushtim të tefsirit të tij. S’ka dyshim se kjo

⁶⁷⁴ Po aty, fq. 85-90.

⁶⁷⁵ El Bekare, 22.

⁶⁷⁶ Ajka e kuptimeve, vëll. 1, f. 66-82.

⁶⁷⁷ Më gjerësisht rreth kësaj teme të tefsirit shih: Halid Abdurahman El-Ak’k, “**Usulut-tefsir ve kavaiduhu**”; Bejrut, Darun-Nefais, Liban, bot. 2, 1986, fq. 217-224; Fehd ibn Abdurrahman Er-Rumi, “**Usulut-tefsir ve menahixhuhu**”; Rijad, Mektebetut-teubeti, 1413 hixhri, f. 94; Dr. Jusuf El-Kardavi, “**Kejfe Nete’amel me’al-Kur’anil-adhim**”; Darush-shuruk, bot. 1, Kajro, 1999, fq. 324-369; Shehid Sejjid Kutub, “**Fi dhilalil-Kur’an**”; Darush-shuruk, Kajro, bot. 11, 1985, vëll. 1, fq. 180-181; Ebu Is’hak Esh-Shatibij, “**El-Muvafekat fish-Sheriatil-Islamijjeti**”; vëll. 2, f. 69; Muhamed Husejn Edh-Dhehebij, “**Ef-tefsir vel-mufessirunë**”; Mektebeti Vehbe, Kajro, bot. 2, 2000, fq. 364-381; Ebu Hamid El-Gazali, “**Ihjau ulumid- din**”- recensoi Ebu Hafs Sejjid ibn Ibrahim ibn Sadik; Darul-hadith, Kajro, bot. 1, pa datë botimi, vëll. 1, f. 289; Ebu Abdurrahman Es-Sujuti, “**El-Itkan fi ulumil-Kur’an**”; Bejrut, Darul-fikri, pa datë botimi, 1979, vëll. 4, fq. 27-31.

metodë është e fuqishme, shkencore, objektive, precize, larg emocioneve e epsheve dhe kjo argumenton nivelin e lartë shkencor të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, Zoti e mëshiroftë me Mëshirën e Tij të gjerë!

5. Shembull nga vizioni politik i tefsirit të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu

Ashtu siç thamë më parë, Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu ishte një personalitet me kulturë të gjerë fetare, shoqërore, ekonomike⁶⁷⁸ dhe politike, bile ishte edhe ushtarak i mbrojtjes e sigurimit. Në tefsirin e tij të ajetit kur'anor:

([البقرة: 247] مَلِكًا طَالُوتَ لَكُمْ بَعَثَ قَدْ أَلَّهَ إِنَّ نَبِيَّهُمْ لَهُمْ وَقَالَ)

“Pejgamberi i tyre ju tha: “Allahu caktoi sundues tuajin Talutin”,⁶⁷⁹ Shejhu thotë se dërgimi i Talutit si sundues të Beni Israilëve argumenton se kryetari ose sunduesi ka rol të madh në shtet dhe në mbrojtjen e interesave e jetës së popullit. Kryetari apo sunduesi duhet të jetë fetar, trim i mençur njohës i politikës së brendshme e të jashtme, dhe të tillët duhet të respektohen, përderisa nuk kundërshtojnë kushtetutën e shtetit e nëse ndodhë e kundërta, atëherë njerëzit duhet ta shkarkojnë e të zgjedhin një tjetër.

Ushtarët, po ashtu, duhet ti respektojnë urdhëresat e komandantit të tyre në fushëbetejë dhe nuk lejohet kundërshtimi i tyre dhe se besimtarët duhet të bashkohen në xhihad në rrugë të Zotit kundër kundërshtarit...⁶⁸⁰

Mësimet e përfituara nga ajetet kuranore vërehen edhe në aspektin politik dhe të sigurimit, ku ai aplikon parimet usuliste juridike të njohura në shkencën e Usuli Fik'hut (قواعد أصول الفقه) dhe të shkencave kuranore (علوم القرآن), për kuptimin e tekstit për qëllime politike, ekonomike etj, si p.sh.:

⁶⁷⁸ Edhe aspekti ekonomik vërehet qartë në shqyrtimin e Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu rreth urtësisë së ndalimit të kamatës. Në këtë kontekst ai thotë se nga kamata vjen dëm ekonomik, kulturor dhe industrial. Aplikimi i kamatës i shkatërron dobijtë e tilla të rëndësishme, të cilat e bëjnë popullin të ecë përpara, të përparojë dhe të lulëzojë (Ajka e kuptimeve, vëll. 1, f. 428).

⁶⁷⁹ El-Bekare, 247.

⁶⁸⁰ Ajka e kuptimeve, vëll. 1, fq. 373-379, 380-381-613.

(العبرة بعموم اللفظ لا بخصوص السبب) “Shembulli duhet marrë nga kuptimi i përgjithshëm i fjalës e jo nga specifika e arsyes”. Në tefsirin e ajetit kur’anor:

أَنَّ النَّاسَ بَيْنَ حَكْمَتِهِمْ وَإِذَا أَهْلَهَا إِلَى الْأَمْنَتِ تُؤَدُّوْا أَنْ يَأْمُرُكُمْ اللَّهُ إِنَّ ﴿النساء﴾ بَصِيرًا سَمِيعًا كَانَ اللَّهُ إِنَّ بِهِ يَعْظُمُكُمْ نِعْمًا اللَّهُ إِنَّ بِالْعَدَلِ حَكْمًا

[58 :

“Allahu ju urdhëron që t’u jepni amanetin të zotëve të tyre dhe kur të gjykoni, ju urdhëron të gjykoni me të drejtë në mes njerëzve”⁶⁸¹,

Shejhu ua drejton thirrjen udhëheqësve, kryetarëve dhe sunduesve të shteteve që të punojnë sipas këtij ajeti fisnik, dhe nëse punojnë sipas tij, atëherë përforcohen shtyllat dhe bazat e shtetit si dhe shteti ecë përpara, e nëse largohen nga ky ajet, atëherë do të rrënohet e shkatërrohet shteti: Sipas Shejhut, pa marrë parasysh shkakun e shpalljes së këtij ajeti, ky ajet ka vlerë absolute e të përgjithshme, dhe se siguri nënkupton sigurimin fetar dhe të kësaj bote.⁶⁸² Këtu vërejmë qartë precizitetin dhe përcaktimin e çështjeve politike, shtetërore dhe të sigurimit. Nëse përdorim mirë këto çështje e koncepte për sqarimin e kuptimit të qëllimit të ajetit, një gjë e tillë konsiderohet (الاستحسان) “istihsan”.

6. Burimet e mendimit të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliut përmes tefsirit të tij

Literatura të cilën e ka përdorur Shejhu në tefsirin e tij është e shumtë dhe e llojllojshme, gjë që argumenton diturinë e tij të gjerë dhe autoritetin e tij të pacenueshëm. Ai bën simbiozën e literaturës tradicionale me literaturën e re, literaturën fetare me atë shkencore. Ai është mbështetur në libra të ndryshëm të tefsirit të përpiluar nga dijetarë klasikë e të rinj. Tefsiret klasikë që i ka përdorur Shejhu janë: Tefsiri i

⁶⁸¹ En-Nisaë, 58.

⁶⁸² Po aty, vëll. 2, fq. 806-807; Më gjerësisht rreth politikës së Sheriatit dhe të drejtave njerëzore shih: El-Kadi Burhanuddin Ibrahim ibn Ali El-Ja’murij, i njohur si Ibn Ferhun, “Tefsiretul-hukkam fi usulil-ukdijeti ve menahixhil-ahkam”; Bejrut, Darul-kutub el-ilmijje, pa vit botimi; Ahmed ibn Abdulhalim Ibn Tehmije, “Es-sijasetu esh-sher’ijje fi islahir-ra’i ver-re’ijjeti”; Bejrut, Darul-Ma’rifeti, pa vit botimi, 30-72.

Taberiut,⁶⁸³ tefsiri i Nisaburit⁶⁸⁴, tefsiri i Ibn Abbasit r.a.⁶⁸⁵ dhe të dhënat nga sahabët e mëdhenj si Omeri, Aliu, Ibn Mes'udi, Ibn Omeri, Zejd ibn Thabiti r.a.⁶⁸⁶

Ai flet në përgjithësi rreth komentuesve.⁶⁸⁷ Një nga komentuesit turk që jetoi në kohën e Shejhut, është Muhamed Vehbiu nga qyteti i Konjës,⁶⁸⁸ Turqi, dhe emri i tefsirit të tij është: (خلاصة البيان) “Hulasatul-bejan”. Tefsiri i Fahrudhin Raziut, Bejdavit dhe Hazinit janë shtylla të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, dhe në çdo faqe të tefsirit të tij, patjetër të theksohet njëri prej të treve, ose bashkërisht ose veçmas ose nga dy. Mund të konstatoj se tefsiri i Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu është rezyme e tre tefsireve të sipërpërmendur për shkak të mbështetjes së madhe të tij në tefsirët e tillë në çdo ajet. Nga burimet e tefsirit të Shejhut është edhe tefsiri

(الفواتح الإلهية و المفاتيح الغيبية الموضحات للكلم القرآنية و الحكم الفرقانية)

“El-Fevatih El-Ilahijje vel-mefatih el-gajbijje El-mudihati lil-kelim el-kur'anijje vel-hikem-el-furkanijje”; i Shejh Baba Ni'metullah ibn Muhamed En-Nexhevani El-Efendiut.

Ç'është e vërteta, akoma nuk kam gjetur ndonjë biografi të këtij komentuesi, edhe pse Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu e thekson shpesh herë gjatë transmetimeve prej tij.⁶⁸⁹ Hulumtuesi dr. Ismail Bardhi thekson emrin e këtij komentuesi dhe tefsirin e tij në studimin e tij rreth Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu.⁶⁹⁰ Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, po ashtu, ka transmetuar nga tefsiri i Shejhut dhe diejtarit të famshëm Ebu Se'ud,⁶⁹¹ nga tefsiri i Hazinit, i Nesefiut dhe i Muxhahidit.⁶⁹²

Nga literatura sekondare, Shejhu ka përdorur librat e Ithtarëve të Librit, si p.sh., Teuratin, Inxhilin, dhe atë duke transmetuar tekste,⁶⁹³ bile edhe nga Zeburi:⁶⁹⁴ Shejhu transmeton, po ashtu, nga literatura historike

⁶⁸³ **Ajka e kuptimeve**, vëll. 1, fq. 559, 566, 608, 666, 684 dhe vëll. 2, fq. 739, 894, 926, etj.

⁶⁸⁴ Po aty, vëll. 2, fq. 407, 982.

⁶⁸⁵ Transmeton nga ai në formë thumbimi duke thënë: Transmetohet nga Ibn Abasi, apo u transmetua prej tij, vëll. 1, f. 434.

⁶⁸⁶ Po aty, vëll. 2, f. 340.

⁶⁸⁷ Po aty, vëll. 1, f. 272.

⁶⁸⁸ Bardhi, Ismail, **Hafiz Ibrahim Dalliu dhe ekzegjeza e tij kur'anore**, 1

⁶⁸⁹ **Ajka e kuptimeve**, vëll. 2, f. 734.

⁶⁹⁰ Bardhi, Ismail, **Hafiz Ibrahim Dalliu dhe ekzegjeza e tij kur'anore**, 162.

⁶⁹¹ **Ajka e kuptimeve**, vëll. 1., fq. 128, 133, 688, 689, 901.

⁶⁹² **Ajka e kuptimeve**, vëll. 1. fq. 170-171.

⁶⁹³ Po aty, vëll. 1, fq. 262.

⁶⁹⁴ Po aty, vëll. 1, fq. 262.

islame e llojlojshme, nga librat e Sires dhe të betejave, raporte, hulumtime të mjekëve, nga librat e fikhut e usulit, nga librat rreth shkaqeve të shpalljes, nga shkenca e Kur'anit, nga librat e va'dhit e irshadit, nga rrëfimet e pejgamberëve dhe librat e tij personale, nga librat e gjuhës, rregullave, statistikës, nga librat e ndryshëm të astronomisë, fizikës, kimisë e gjeografisë, nga librat e moralit dhe edukimit, si p.sh., libri “Ihja ulumiddin” i Imam Gazaliut, nga librat e kulturës së përgjithshme, nga librat e feve të tjera, hulumtime e studime të amerikanëve dhe evropianëve etj. E gjithë kjo argumenton kulturën e tij të gjerë dhe njohuritë e tij në shkenca të ndryshme.⁶⁹⁵

7. Metoda e transmetimit të Shejh Hafizit nga librat e tefsirit

Pas sqarimit të metodës dhe mënyrës së tij në përpilim, bazuar në objektivitetin shkencor me të cilin duhet të pajiset çdo musliman në përgjithësi, posaçërisht hulumtuesit dhe thirrësit, i shfletova burimet origjinale në të cilat është mbështetur Shejhu për ta verifikuar saktësinë dhe metodën e transmetimit të tij nga tefsirët e tillë në tefsirin e tij, si dhe mënyrën e argumentimit me mendimet e tyre. Në vazhdim do t'i theksoj disa komentues të mëdhenj dhe do t'i krahasoj me transmetimet dhe përkthimet që i ka bërë Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu.

A. Do të filloj me tefsirin e Fahrudhin Raziut (Zoti e mëshiroftë!) ngase konsiderohet shtyllë e tefsirit të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu. Gjatë transmetimit, vërej se Shejhu nuk transmeton tekstualisht nga tefsiri i tij e as që i thekson musnedet ashtu siç bën Fahrudhin Raziu. Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu thekson vetëm kuptimin e përgjithshëm dhe rezymenë e fjalëve të Imam Raziut.⁶⁹⁶ Më mirë do të ishte sikur Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu të thoshte: “*Thotë Fahrudhin Raziu me fjalë të dhëna në rezymë*”, - që lexuesi të dijë se ai nuk e transmeton Fahrudhin Raziun tekstualisht apo se ai transmeton vetëm kuptimin.

⁶⁹⁵ Më gjerësisht shihe tefsirin e tij në vëll. 1, fq. 97, 114-115, 132, 170-171, 247, 259, 262, 408, 508, etj.

⁶⁹⁶ Nëse dëshiron krahaso fjalët e Imam Fahrudhin Raziut në tefsirin e tij, vëll. 2, f. 10, çështja e tetë rreth llojit të drurit prej të cilit hëngrën Hava dhe Ademi e pastaj krahasoj në tefsirin e Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, vëll. 1, f. 95.

Ekzistojnë edhe disa vende tjera, të cilat i kam theksuar në të dy tefsirët për krahasim e verifikim.⁶⁹⁷

- B. Kur Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu transmeton nga Fahrudin Raziu nuk thotë se Fahrudin Raziu i thekson disa kuptime e disa hulumtime dhe shumë çështje të nxjerra sekondare, ndërsa unë e zgjedh vetëm një kuptim dhe kush dëshiron më gjerësisht, le ta lexojë tefsirin e tij... Shejh Dalliu nuk e thotë këtë gjë dhe lexuesi kur i lexon fjalët e Shejh Dallit, mendon se edhe Raziu e ka theksuar vetëm atë kuptim, dhe kjo nuk është e vërtetë.⁶⁹⁸
- C. Sa i përket transmetimit të tij nga Imam Nesefiu (Zoti e mëshiroftë!) Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu transmeton vetëm mendimin e tij. Kur e shfletova tefsirin e Nesefiut për krahasim e verifikim e gjej ashtu siç thotë Shejh Dalliu, por pa e theksuar vendin prej ku e ka transmetuar.⁶⁹⁹ Ky është një lëshim i madh i Shejhut, ngase ai nuk thekson as faqen e as vëllimin e tefsirit. S'ka dyshim se ky është gabim i madh metodologjik dhe nuk duhet një figurë markante si Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu të bëjë një lëshim të tillë (Zoti na i faltë gabimet!). Për sa u përket komentuesve të tillë, Shejhu ndonjëherë thotë: “*Fahrur-Razi thotë në tefsirin e këtij ajeti*”,⁷⁰⁰ dhe ndonjëherë flet në emër të të gjithëve: “*Ashtu siç thonë të gjithë: Kadi Bejdaviu, Hazini dhe autori i “El-Medarik” Imam Nesefiu*”.⁷⁰¹ Ndonjëherë

⁶⁹⁷ Po ashtu krahaso fjalët e Fahrudin Raziut, vëll. 2 (pjesa e tretë), fq. 75-76 rreth ajetit kur'anor:

(يٰۤاَيُّهَا الَّذِيْنَ اٰمَنُوْا اذْكُرُوْا نِعْمَتِيَ الَّتِيْ اَنْعَمْتُ عَلَيْكُمْ وَاَوْفُواْ بِعَهْدِيْ اُوْفٍ بِعَهْدِكُمْ وَاِيَّيَّ

فَاَرْهَبُوْنَ ﴿البقرة: 47﴾]

“*Dhe unë ju preferova ndaj botëve...*” (El-Bekare, 47) dhe fjalët e Hafiz Ibrahim Dallit në tefsirin e tij, vëll. 1, f. 117.

⁶⁹⁸ Nëse dëshiron, krahaso fjalët e Fahrudin Raziut, vëll. 2 (pjesa e tretë), f. 178, rreth ajetit kur'anor:

(ثُمَّ قَسَتْ قُلُوْبُكُمْ مِّنْۢ بَعْدِ ذٰلِكَ فَهِيَ كَالْحِجَارَةِ اَوْ اَشَدُّ قَسْوَةً ﴿البقرة: 74﴾]

“*Edhe pas (fakteve të qarta), zemrat tuaja u bënë pastaj të forta si guri*” (El-Bekare, 74), dhe fjalët e Shejh Hafiz Ibrahim Dallit, vëll. 1, f. 139.

⁶⁹⁹ Krahaso fjalët e Imam Nesefiut në tefsirin e tij, vëll. 1, fq. 52-53 me tefsirin e Shejh Hafiz Ibrahim Dallit, vëll. 1, fq. 132.

⁷⁰⁰ *Ajka e kuptimeve*, vëll. 1, fq. 159.

⁷⁰¹ Po aty, vëll. 1, fq. 132.

Shejhu nuk thekson asnjë prej komentuesve duke thënë:
“Komentuesit thonë se kjo ngjarje ka ndodhur”.⁷⁰²

- Ç. Ajo që është thënë rreth dy komentuesve të mëparshëm, Fahrudin Raziut e Imam Nesefiut, thuhet nga transmetimi i tij prej tefsirit të Imam Taberiut (Zoti e mëshiroftë!) dhe prej tefsirit të Hazinit me ndryshime e ndërhyrje të vogla. Ai transmeton rezymenë e fjalëve të tyre dhe idenë. Ideja e transmetuar është e qartë dhe nuk ka asgjë që mund ta devijojë kuptimin.⁷⁰³
- D. Sa i përket transmetimit të tij nga gjykatësi suprem Imam Bejdaviu, ai ndonjëherë tekstin e transmeton tekstualisht pa shtuar apo hequr asgjë⁷⁰⁴ dhe ndonjëherë transmeton fjalët e tij pjesërisht.⁷⁰⁵

Jam i mendimit se ky verifikim i burimeve mjafton, ngase bëra një krahasim me tefsirët më të rëndësishëm dhe më të njohur, qofshin ata tefsirë tradicionalë apo racionalë.

Po ashtu e pamë se Hafiz Ibrahim Dalliu e ka nxjerrë tefsirin e vet nga një burim i tefsirëve dhe në shkallë të parë ua ka prezantuar lexuesve shqiptarë dhe pastaj edhe për të tjerët. Ky tefsir ka pasur jehonë të mirë e të madhe në mbarë territoret shqiptare dhe populli shqiptarë musliman e ka pritur shumë mirë, dhe kjo vërtetohet me faktin se Komuniteti Islamik e ka botuar, recensuar e distribuar në vitin 1929.⁷⁰⁶

Për sa i përket llojit të tefsirëve që i ka përdorur Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, mund të thuhet se ato janë:

I Tefsirët tradicionalë: si tefsiri i Imam Taberiut, tefsiri i Muxhahidit (rrallëherë), tefsiri i Ibn Abasit (më shumë). Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, po ashtu, ka theksuar Ibn Abasin, Muxhahidin dhe nuk e di a ka transmetuar drejtpërdrejtë prej tefsireve të tyre apo i ka transmetuar fjalët e tyre prej tefsirëve tjerë?! Këtë nuk kam pasur mundësi të zbuloj gjatë hulumtimit tim.

⁷⁰² Po aty, vëll. 1, fq. 133.

⁷⁰³ Tefsiri i Imam Taberiut, vëll. 3, fq. 67, tefsiri i Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, vëll. 2, fq. 926 dhe tefsiri i Hazinit, vëll. 1, fq. 124 ...

⁷⁰⁴ Për krahasim krahaso tefsirin e Imam Bejdaviut, vëll. 2, fq. 303, me tefsirin e Shejh Dalliu, vëll. 1, fq. 9.

⁷⁰⁵ Shiko tefsirin e Bejdaviut në ajetin kur'anor:

(وَالَّذِينَ كَفَرُوا وَكَذَّبُوا بِآيَاتِنَا أُولَٰئِكَ أَصْحَابُ الْجَحِيمِ ﴿١٠﴾) [المائدة: 10]

“E ata që mohuan dhe përgënjeshtroan argumentet Tona, ata janë banues të xhehennemit” (El-Maide, 10), vëll. 2, f. 303 dhe tefsirin e Shejh Dalliu, vëll. 2, f. 993.

⁷⁰⁶ Ismail Bardhi, “Hafiz Ibrahim Dalliu...”; f. 161.

II Tefsirët racionalë (shumë herë është mbështetur në këto tefsirë), si p.sh.: tefsiri i Fahrudhin Raziut, tefsiri i Bejdaviut, tefsiri i Hazinit, tefsiri i Nesefiut, tefsiri i Ebu Se'udit, tefsiri i Nisaburit, etj.

III Burime sekondare nga tefsirët e bashkëkohësve dhe shokëve të tij, si p.sh. tefsiri "Hulasatul-bejan" i Muhamed Vehbiut.

Kjo është ajo që desha të them rreth tefsirit, metodës, mënyrës së tefsirit, literaturës dhe mendimeve të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliut. Do të kisha dashur që Shejhu ta kishte përfunduar këtë tefsir, por Zoti kishte caktuar kaderin e Tij dhe e kishte kapluar vdekja pa e përfunduar këtë projekt të madh. Ndoshta Zoti do t'i jep mundësi ndonjërit nga robërit e Tij të singertë dijetarë e hulumtues shqiptarë që të vazhdojë këtë projekt të rëndësishëm...

KAPITULLI I DYTË

Shqyrtimi i disa çështjeve të mëdha akadiologjike në tefsirin e Shejh Hafiz Ibrahim Dallit si dhe sqarimi i qëndrimit të tij ndaj tyre⁷⁰⁷

I - Komentuesit dhe problemi i komentimit (*El Muev-vilune ve Ishkalijetu - Ta'vjl*)

(المؤلفون وإشكالية التأويل)

*** Hyrje historike rreth kësaj çështjeje:**

Para se ta shtjellojmë këtë çështje të ndjeshme akadiologjike, dhe para se të sqarojmë qëndrimin e Shejh Hafiz Ibrahim Dallit ndaj këtyre çështjeve përmes shembujve konkretë që theksohen në tefsirin e tij, e që përputhen me doktrinën e tij maturidite, them se ne duhet të mbështetemi në fjalën e Zotit të Madhërishëm dhe në Sunnetin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe në fjalët e dijetarëve të mëdhenj për ta kuptuar të vërtetën e problematikës dhe për të marrë qëndrimin tonë ndaj saj që të jetë peshojë - me të cilën i matim mendimet dhe medhhebet akadiologjike, të cilat i shtjellon Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu në tefsirin e tij. Një ndër problematika e tilla të mëdha është ajo e komentimit të teksteve kur'anore e pejgamberike që flasin rreth Cilësive të Zotit të Madhërishëm, (*تأويل الأسماء والصفات*) (*Te'vjlul Esmat ves-Sifat*) e të cilat sipërfaqësisht duket se iu ngjajnë cilësive të krijesave.

Shumë pak nga komentuesit dhe dijetarët e të kaluarës dhe të tashmes, ashtu siç theksohet në disa studime e hulumtime të fundit, kanë

⁷⁰⁷ Hulumtuesi Muhamed ibn Abdurahman El-Migravi në detaje i studion mendimet dhe qëndrimet e komentuesve më të njohur klasikë e modernë ndaj Cilësive të Zotit, në veprën e tij: “*El-Mufessirune bejnet-te’vili vel-ithbati fi ajatis-sifati*”; Rijad, Daru Tajjibe, 1985. Ai fillon me studimin e Taberit dhe përfundon me Shejh Muhamed Ali Sabunin. Ky studim është shumë i rëndësishëm, ngase sipas këtij hulumtuesi, nuk kanë shpëtuar shumë komentues nga komentimi i lejuar dhe i palejuar. Komentimi ishte përafërsisht fenomen shkencor të komentuesit klasikë dhe modernë, normal me përjashtime. Do të ishte më mirë që ata të vepronin ashtu siç vepruan mufessirët e selefit të devotshëm (selefu-salih r.a.), pa u fut në këto problematika, dhe Allahu e di më mirë.

pasur mundësi të shpëtojnë nga problematike. Komentimi i ajeteve të Cilësive të Allahut ishte përafërsisht fenomen e përgjithshëm ndër mufessirët, apo sipas tyre ishte nevojë e domosdoshmërive të tefsirit ! Me plot, kjo çështje nuk është ashtu siç thoshin dhe këtë do ta shqyrtojnë në bazë të argumenteve të Sheriatit e intelektit.

Këtu nuk dua të sqaroj aspektin etimologjik dhe terminologjik të fjalës komentim - *Te'vijl* e as që kam ndërmend ta sqaroj çështjen e përdorimit të tij në gjuhën arabe a është përdorur apo jo, ngase kam për qëllim që të thellohem drejt në thelbin e problematikës, për shkak se natyra e hulumtimit nuk lejon të zgjerohem më shumë se kaq.

Në botën islame shumë dijetarë të mëdhenj, të sinqertë, e precizë janë munduar tepër që të na sqarojnë çështjen dhe thellësinë e kësaj problematike si dhe rrezikun e saj. Ne mendojmë dhe besojmë bindshëm, pasi që çështja e komentimit të Cilësive të Allahut është prej çështjeve të mëdha dhe të ndjeshme akadiologjike e metafizike, të cilat nuk mund të jenë objekt i shqisave njerëzore, pasi që cilësitë janë pjesë e bisedës rreth Qenies së Shenjtë të Lartë e të Madhërishëm, për hir të mbrojtjes së besimit dhe të imanit tonë nga kundërshtimet, devijimet dhe kontradiktat, më mirë, më shëndoshë, më e urtë dhe më saktë do të ishte që për këtë çështje të mbështetemi në fjalët e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), i cili na tregon për Zotin e Madhërishëm si dhe në biografinë e sahabëve fisnikë, të cilët dëshmuuan shpalljen dhe ishin prezent gjatë shpalljes së mesazhit. Pra, si mbështetje kryesore në këtë çështje janë fjalët e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe fjalët e sahabëve fisnikë, të cilët nuk kanë bërë komente (*Te'vijl*) në çështjen e Cilësive të Allahut, por u kanë besuar ashtu sic nënkupton ajo ana formale e tyre, dhe se domethënien e tyre të vërtetë e din vetëm Allahu i Lartë Madhëruar. Dijetarët e të kaluarës dhe të tashmes e kanë shqyrtuar këtë çështje në detaje, dhe disa prej tyre ia kanë qëlluar realitetit në këtë çështje ndërsa disa jo. Lus Zotin e Madhërishëm që t'i shpërblejë hulumtuesit që e kanë qëlluar me dy shpërblime, ndërsa ata që kanë gabuar me një, ngase të gjithë megjithatë janë përpjekur ta gjejnë të vërtetën.

Unë po ashtu dëshiroj të theksoj edhe një çështje tjetër shumë të rëndësishme, e që ka të bëjë me ofendimin e disa hulumtuesve të së kaluarës dhe të tashmes, ngase nuk lejoj një gjë të tillë. Unë nuk lejoj në asnjë mënyrë që të thumbohen dhe të nënçmohen dijetarët tanë të mëdhenj të Ehli Sunnetit dhe Xhematit, të cilët mendonin ndryshe në disa çështje, si p.sh.: ithtarët e Ebu Hasan El-Esh'ariut ose esh'aritët, ithtarët e Ebu Mensur Maturidiut ose maturiditët, të cilët sipas mendimit të atyre

ekstremistëve konsiderohen ithtarë të risive ! Kjo nuk është e vërtetë, dhe ne besojmë si dhe jemi të bindur se ata i përkasin Ehli Sunnetit dhe Xhematit, dhe nuk lejohet në asnjë mënyrë që ata t'i nxjerrim nga ky grupi i Ehli Sunnetit, ashtu siç vepruan disa hulamtues në të kaluarën dhe në të tashmen.⁷⁰⁸

Metoda ime në këtë çështje do të ndryshojë nga metoda e shumicës dhe nuk do të ketë natyrë të vrazhdë e të ashpër kundër dijetarëve të tjerë të Ehli Sunnetit dhe Xhematit, të cilët nuk mendonin në disa aspekte akaidologjike ashtu siç mendonin dijetarët e selefit rreth kësaj çështjeje. Unë do të jem i sjellshëm në fjalë dhe objektiv gjatë sqarimit të gabimeve dhe devijimeve për ta treguar të vërtetën ashtu siç e mendoj unë rreth kësaj çështjeje.

Ndër dijetarët më të mirët që kanë shkruar dhe analizuar këtë çështje akaidologjike, dhe që e lënë të qetë zemrën, ndjenjat dhe mendjen e besimtarit, dhe sipas mendimit tim ata ia kanë qëlluar realitetit, dhe ne i bindemi Allahut xh.sh. me kete mendim dhe ecim ne rrugen e atyre te pareve (Selfus Salih) ne kete qeshtje akaidologjike te rendesishme; janë: Imami i respektuar, Ebu Hanife Nu'man ibn Thabit, Imam Ebu Mensur El-Maturidiu dhe Shejhul-Islam, Ahmed ibn Tejmije (Zoti i mëshiroftë të gjithë!). Vendosa që t'i shënoj fjalët e tyre këtu, me qëllim që të jenë shtyllë dhe mbështetje për ne dhe fjalët e tyre të jenë si gurë themeltar, mbi të cilin më vonë do t'i mbështesim fjalët e Shejh Hafiz Ibrahim Dallit dhe të tjerëve. Fjalët që do t'i them në vijim mbështeten në atë që e thotë Zoti i Madhërishëm rreth kësaj çështjeje të rëndësishme metafizike, në to jam i bindur plotësisht, dhe nuk jam dakord me dijetarët shqiptarë apo të tjerë, të cilët mendojnë ndryshe në këtë, edhe pse kam respekt dhe nder të madh për orvatjet e tyre shkencore dhe fetare.

A. Mendimi i Ebu Hanifes mbi Emrat dhe Cilësitë e Allahut të Madhërishëm

Imam Ebu Hanife (Allahu e mëshiroftë !) rreth kësaj çështjeje thotë: *“Zoti i Madhërishëm nuk cilësohet me cilësitë e krijesave; hidhërimi dhe pëlqimi i Tij janë dy cilësi nga cilësitë e Tij pa pyetur se si. Kështu mendon Ehli Sunneti dhe Xhemati. Ai hidhërohet dhe pajtohet, e nuk thuhet se hidhërimi i Tij është dënim prej Tij, e pajtimi i Tij, shpërblimi i Tij, dhe ne e cilësojmë ashtu siç e cilëson Ai Vetën e Vet. Ai është Një, Allahu është Ai që çdo krijesë i drejtohet (i mbështetet) për çdo*

⁷⁰⁸ Muhamed ibn Abdurahman El-Migravi, **“El-Mufessirune bejnel-ithbat fi ajatis-sifat”**; vëll. 1, fq. 45-46. Ky hulamtues i respektuar i ka nxjerrë maturiditetin dhe esh'aritetin nga rrethi i Ehli Sunnetit dhe Xhematit (Zoti e mëshiroftë!).

*nevojë, as s'ka lindur kë, as nuk është i lindur dhe Atij askush nuk i është i barabartë, Ai është i gjallë, i fuqishëm, i aftë, dëgjon çdo gjë, sheh çdo gjë, di çdo gjë, dora e Tij është mbi duart e tyre, nuk është si dora e krijesave dhe nuk është gjymtyrë ngase Ai është krijues i duarve; Fytyra e Tij nuk është si fytyra e krijesave, ngase Ai është Krijues i fytyrave; Shpirti i tij nuk është si i krijesave ngase Ai është Krijues i tij, Atij asgjë nuk i ngjanë dhe Ai sheh çdo gjë dhe dëgjon çdo gjë”.*⁷⁰⁹

Ai, po ashtu, thotë: “Të gjitha Cilësitë e Tij dallohen nga cilësitë e krijesave. Ai di, por jo si dituria jonë, ka fuqi, por jo si fuqia jonë, Ai sheh, por jo si shikimi ynë. Ai flet, por jo si e folmja jonë. Ai dëgjon, por jo si dëgjimi jonë. Ne flasim me mjete e shkronja, ndërsa Zoti flet pa mjete e pa shkronja. Shkronjat janë të krijuara, ndërsa Fjala e Zotit nuk është e krijuar. Ai është diçka, por jo si gjërat... Ai ka dorë, fytyrë e shpirt ashtu siç thekson Zoti i Madhërishëm në Kur'an. Cilësitë që i thekson Zoti i Madhërishëm në Kur'an, si p.sh., fytyra, dora e shpirti nuk dihet se si janë. Nuk thuhet se dora e Tij nënkupton fuqinë ose begatinë e Tij, ngase në këtë mënyrë priset cilësia. Kështu mendojnë kaderitë dhe mu'tezilët. Dora e Tij është cilësi e Tij, por s'dihet se si...”⁷¹⁰

Pra, si duket, fjalët dhe mendimet e Imam Ebu Hanifes (Zoti e mëshiroftë!) rreth kësaj çështje janë të qarta tamam si drita e diellit.

B. Mendimi i Imam Ebu Mensur El-Maturidiut rreth Cilësive dhe Emrave të Allahut Madhërishëm

Pas theksimit të mendimeve të ndryshme rreth përkufizimit të domethënies së Arshit dhe Istivasë, Imam Ebu Mensur El-Maturidiu haptas e refuzon komentimin e Cilësive dhe Emrave të Allahut xh.sh. dhe mbështetet në mendimin e medhhebit të selefit të devotshëm (Zoti e mëshiroftë!). Mendimi i qartë i Imam Ebu Mensur El-Maturidiut dhe i imamëve tjerë hanefitë kundërshton, refuzon dhe i hedh poshtë thëniet e atyre që i akuzojnë ata për komentim të Emrave dhe të Cilësive të Allahut xh.sh, dhe që i largojnë ata nga Ehli Sunneti dhe Xhemati. Kështu mendojnë disa hulumtues të rinj që kanë qëndrim emocional dhe jo objektive ndaj selefit tonë të devotshëm.

Imami Ebu Mensur El-Maturidiu thotë: “Në esencë, ne qëndrojmë në atë që thotë Zoti i Madhërishëm: “Atij asgjë nuk i ngjanë”; dhe siç vërehet këtu, Ai refuzon ndonjë ngjashmëri me krijesat. Ne sqaruar se Ai

⁷⁰⁹ Nu'man ibn Thabit ibn Zittij El-Hazzat El-Kufij Ebu Hanife, “**Esh-sherhul mujesseru alal-fikhejn El-ebset vel-ekber elmensubejni li Ebi Hanife**”; - pjesa e dytë: Rivajetu Ebu El-Belhi An Ebi Hanife, recensoi dr. Muhamed Abdurrahman Hamis, Axhman, Mektebetul-Furkan, bot. 1, 1999, f. 159.

⁷¹⁰ Po aty, pjesa e dytë, Rivajeti Hammad ibn Ebi Hanife an ebihi, fq. 24-27.

në veprat dhe në cilësitë e Tij nuk i ngjanë askujt. Në ajetin kur'anor: “Mëshiruesi mbi Arsh qëndroi”,⁷¹¹ duhet të pranojmë ashtu siç thuhet në ajet dhe ashtu siç e pranon mendja pa e komentuar fare, ngase mund të ndryshohet kuptimi apo mund të ketë ndonjë kuptim tjetër nga ajo që e themi e që nuk iu ngjanë krijesave. Ne besojmë në atë që dëshiron Zoti. Po ashtu në çdo gjë që është shpallur e që ka të bëjë me shikimin dhe gjëra të tjera, duhet që të mos i krahasojmë (me krijesat) si dhe duhet të besojmë ashtu siç dëshiron Zoti, pa pranuar diçka e refuzuar diçka tjetër...⁷¹²

Një nga hulumtuesit që kanë mendime të njëjta e identike me imamët hanefitë rreth mos thellimit në çështjet e Cilësive dhe rreth mos komentimit të tyre, është edhe Shejh Kadi Zade, i cili thotë: “Imamët hanefitë janë unanim, si Imam Fahrul Islami El-Bezdevij dhe dielli i imamëve El Imam Es-Serehsi, rreth konfirmimit të dorës, fytyrës e Arshit i takojnë Zotit të Madhërishëm, dihet si janë në esencë, por nuk dihet se si të përshkruhen, dhe nuk lejohet anulimi i esencës, nëse nuk mund të kuptohet cilësia (përshkrimi)”.⁷¹³

Në bazë të thënieve të dijetarëve të mëdhenj të selefit të devotshëm, qoftë nga zotërinjtë hanefitë, u vërtetua dhe u kuptua se ata nuk i kanë komentuar Cilësitë e tilla hyjnore, por i kanë pranuar ashtu siç janë shpallur pa krahasim, pa ngjashmëri, pa mohim, e pa antropomorfizëm.

C. Mendimi i Shejhul-Islam Ahmed Ibn Tejmijes, rreth çështjes së Cilësive dhe Emrave të Allahut xh.sh:

Mendimi i Shejhul-Islam, Ahmed Ibn Tejmijes, është i ngjashëm me mendimin e Imam Ebu Hanifes dhe Imam Ebu Mensur El-Maturidiut.

Në(**مجموع الفتاوى لشيخ الإسلام بن تيمية رحمه الله**) “Mexhmu’ul-fetava” thuhet: “Në emër të Zotit Mëshiruesit dhe Mëshirëbërësit, vetëm Zotit i takon falënderimi, salavati dhe selami qofshin për atë që s’ka më peygamber pas tij! Është pyetur Shejhul-Islam, Ahmed ibn Tejmije (Zoti e mëshiroftë shpirtin e tij!) se ç’mendon për medhhebin e selefit rreth besimit dhe për medhhebin e të tjerëve të mëvonshëm, ç’është e sakta në mes tyre dhe ç’pranoni ju nga dy medhhebet?”

⁷¹¹ Ta-ha, 5.

⁷¹² Ebu Mensur El-Maturidij, “Et-Teuhid”; f. 74.

⁷¹³ Belkasim El-Galij, “Ebu Mensur El-Maturidi, hajatuhu ve ara’uhu el-akadijje”; f. 179, transmetim nga Shejh Zade “Nudhmul-feraid ve xhem’ul-fevaid ” ferijdetu-14, fq. 22-23.

Ai (Ibn Tejmije) përgjigjet: “Falënderimi i takon Zotit! Zbërthimi i këtyre çështjeve ka nevojë për vëllime, por do të përqendrohemi vetëm në atë që është më e rëndësishme. Zoti i Madhërishëm thotë:

تَوَلَّى الْمُؤْمِنِينَ سَبِيلَ غَيْرٍ وَتَبَعَ الْهُدَى لَهُ تَبَيَّنَ مَا بَعْدَ مِنَ الرَّسُولِ يُشَاقِقُ وَمَنْ
([النساء : 115] ﴿ ١١٥ ﴾ مَصِيرًا وَسَاءَتْ جَهَنَّمُ وَنُصْلَهُ تَوَلَّى مَا

“Kush i kundërvihet të Dërguarit, pasi që i është bërë e qartë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që e ka zgjedhur (në dynja)dhe e fusim në Xhehennem. Përfundimi i keq është ai”.⁷¹⁴ Këtu dëshmon Zoti për sahabët e Pejgamberit të Tij dhe për ata që i përcjellin ata me vepra të mira e me besim dhe përfundimisht nënkuptohet se këtu ajeti fisnik aludon në ta.

Zoti i Madhërishëm thotë:

بِإِحْسَنِ اتَّبَعُوهُمْ وَالَّذِينَ وَاللَّذِينَ وَالْأَنْصَارِ الْمُهَاجِرِينَ مِنَ الْأَوَّلُونَ وَالسَّيْقُونَ
فِيهَا خَلِيدِينَ الْأَنْهَارُ تَحْتَهَا تَجْرَى جَنَّتْ لَهُمْ وَأَعَدَّ عَنْهُ وَرَضُوا عَنْهُمْ اللَّهُ رَضِيَ
[التوبة : 100] ﴿ ١٠٠ ﴾ الْعَظِيمُ الْفَوْزُ ذَلِكَ أَبَدًا

“Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) de prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë), dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhennete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh”.⁷¹⁵

Zoti i Madhërishëm po ashtu thotë:

فِي مَا فَعَلِمَ الشَّجَرَةَ تَحْتَ يُبَايَعُونَكَ إِذَ الْمُؤْمِنِينَ عَنْ اللَّهِ رَضِيَ لَفَدَ ﴿ ١٨ ﴾
[الفتح : 18] ﴿ ١٨ ﴾ قَرِيبًا فَتَحًا وَأَتْبَهُمْ عَلَيْهِمُ السَّكِينَةَ فَأَنْزَلَ قُلُوبِهِمْ

“Vërtetë, Allahu që i kënaqur me besimtarët kur ata nën hijen e atij druri të zotoheshin ty dhe Ai e dinte se ç’kishin zemrat e tyre, andaj u

⁷¹⁴ En-Nisaë, 115.

⁷¹⁵ Et -Teubetu, 100.

dhuroi qetësimin dhe së shpejti i shpërbleu me një fitore (çlirimin e Mekkes)”.⁷¹⁶

Këtu vërehet qartë se kush ndjek ndonjë rrugë tjetër përveç të tyre, Zoti i Madhërishëm e dënon dhe e fut në Xhehennem.

Rruga e tyre në besim është: “*Besimi në cilësitë e Zotit të Madhërishëm, në Emrat e Tij, me të cilët e përshkruan Vetveten dhe me të cilët e quan Vetveten në Librin e Tij, dhe në shpalljen e Tij ose nëpërmes gjuhës së Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) pa shtuar apo pa pakësuar diçka, nuk mund të tejkalohet kuptimi i tyre e as të komentohen, nuk lejohet të komentohen përkundër kuptimit sipërfaqësor, nuk mund t’ju ngjajnë cilësive të krijesave e as me karakteristikat e krijesave. Ata i pranojnë ashtu siç janë shpallur, njohuritë rreth tyre ia përkasim Thënësit të tyre dhe kuptimin e tyre Atij që flet për to...*”⁷¹⁷

Shejhul-Islami vërteton saktësinë e medhhebit të selefit në moskomentimin e Cilësive dhe Emrave duke argumentuar se ai nuk ka parë ndonjë argument se ata (Selefët e hershëm) kanë komentuar ndonjë gjë të tillë, gjegjësisht nuk është transmetuar se ata e kanë hulumtuar këtë çështje. Prej tyre ka ardhur vetëm heshtje dhe mos-thellim si dhe refuzim të atyre që hulumtojnë çështjet e tilla. Shejhul-Islami (Zoti e mëshiroftë!) thotë: “*Pejgamberi i Zotit transmeton duke i konfirmuar dhe besuar, i pranon dhe nuk dyshon, nuk dyshon në vërtetësinë e Thënësit të tyre, nuk i komentuan gjërat që kanë të bëjnë me Cilësitë, as nuk i shpjeguan e as nuk i krahasuan me cilësitë e krijesave. Sikur të bënin diçka të tillë, do të transmetohej dhe nuk do të mund të fshiheshin në përgjithësi. Nuk lejohet fshehja e asaj që duhet të transmetohet dhe është transmetuar heshtje e madhe rreth kësaj. Ata kur shihnin se ndokush pyet për gjëra të paqarta, ndonjëherë e kundërshtonin me fjalë të ashpra, ndonjëherë me rrahje dhe ndonjëherë me reagim të ashpër për t’i treguar se urrejnë shumë të bisedojnë rreth problematikës së tij*”.

Kur është pyetur Imam Maliku (Zoti e mëshiroftë!): “*O Ebu Abdullah! Mëshiruesi qëndroi mbi Arsh, e si qëndroi?*” Imam Maliku u nervozua, i dolën djersët, njerëzit pritën se çfarë do të përgjigjet Imam Maliku. Ai ngriti kokën në drejtim të pyetësit dhe tha:

(الاستواء معلوم و الكيف مجهول و الإيمان به واجب و السؤال عنه بدعة)

⁷¹⁶ El-Fet’h, 18.

⁷¹⁷ Ibn Tejmije, “*Mexhmu’ul-fetava*”; vëll. 4, fq. 1-2.

*“Istiva-ja nuk është e panjohur, mënyra nuk mund të kuptohet, besimi në të është i obligueshëm, pyetja për të është risi, të konsideroj njeri të keq!; më pas urdhëroi që të nxirret prej mexhlisit të tij...”*⁷¹⁸

Pastaj Shejhul-Islami (Zoti e Mëshiroftë) na tërheq vëmendjen për një çështje tjetër të rëndësishme e që nuk i ka ra ndërmend shumicës së dijetarëve, gjegjësisht faktin se thënia e Imam Malikut rreth cilësisë së “istivasë” (*“Istiva-ja nuk është e panjohur, ndërsa forma dhe realiteti i saj është e panjohur”*) duhet të mjaftojë e të aplikohet në të gjitha cilësitë tjera, si p.sh.: dora e Tij, fytyra e Tij, zbritja e Tij, ardhja e Tij, etj. Ky është argumentim i shëndoshë dhe i logjikshëm, ngase të gjitha këto cilësi kanë të bëjnë me Qenien e Zotit të Madhërishëm.

Shejhul-Islam Ibn Tejmije, thotë: “Kush e shpjegon “istivanë” si: “Istijlaë”- dmth: si “okupim dhe uzurpim” (الاستواء بمعنى الإستيلاء) - përgjigjet me përgjigje që nuk përputhet me përgjigjen e Malikut dhe ecë në rrugë tjetër. Përgjigjja e Malikut (Zoti e mëshiroftë!) rreth “istivasë” vlen për të gjitha cilësitë, si p.sh., zbritja, ardhja, dora, fytyra etj. Për “zbritjen” thuhet: “Zbritja është e njohur, ndërsa mënyra është e panjohur, besimi në të është i obligueshëm dhe pyetja për të është risi”. Kështu thuhet edhe për cilësitë tjera që janë të rangut të “istivasë” që theksohen në Kur’an dhe në Sunnet.

Transmetohet se Muhamed ibn Hasani, nxënës i Imam Ebu Hanifes ka thënë: “Fukahatë e Lindjes dhe të Perëndimit janë të gjithë unanimit sa i përket besimit në Kur’anin Fisnik dhe në hadithet që i kanë transmetuar njerëzit e besueshëm nga Pejgamberi i Zotit rreth Cilësive të Zotit të Madhërishëm pa komentim, pa përshkrim e pa krahasim... Nëse ndokush komenton diçka të tillë, atëherë del nga ajo ku ishte Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe largohet nga xhemati. Ata nuk e kanë cilësuar e as që kanë komentuar, por besuan në atë që është në Kur’an e Sunnet dhe pastaj heshtën. Kush thotë atë që e thotë Xhehmi⁷¹⁹ largohet nga xhemati...”⁷²⁰

Transmetohet se Rebi’ë ibn Sulejman ka thënë: “E pyeta Shafiun (Zoti e mëshiroftë!), për cilësitë e Zotit të Madhërishëm dhe ai tha: “Ndalohej për intelektin që ta krahasojë Zotin e Madhërishëm, për

⁷¹⁸ Po aty, vëll. 4, fq. 1-3.

⁷¹⁹ Xhehm ibn Safvani mendonte se “istiva” nënkupton “istijla’ë-okupim, uzurpim”, ai e ka marrë këtë ide nga Xha’d ibn Derhemi si dhe ide të tjera që mohonin Cilësitë e Zotit të Madhërishëm, krijimin e Kur’anit dhe risi tjera...Shih në detaje.. Muhamed ibn Abdurahman El-Migravi, “El-mufessirunë bejnet te’vili vel-ithbati fi ajatis-sifat”; vëll.1, fq. 76-77.

⁷²⁰ Po aty.

iluzionet ta përkufizojnë, për mendjet ta parafytyrojnë dhe ta mendojnë, për ndjenjat të thellojnë, për paramendimet ta imagjinojnë dhe për trurin ta mendojë, përpos me atë që e përshkruan veten ose me atë që e përshkruan Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)”

Pastaj Shejhul-Islami, Ibn Tejmije (Zoti e mëshiroftë!), thekson një argument dhe fakt tjetër racional shumë bindës. Biseda rreth Cilësive është pjesë e bisedës rreth Qenies së Shenjtë, dhe se besimi dhe bindja ynë në këtë Qenie të Shenjtë është besim e bindje se Ai ekziston, por jo në mënyrën se si është Ai. Ne besojmë në Të (i pastër është nga të metat) se është i gjallë, i fuqishëm, furnizues, dëshiron, dëgjon, sheh, si dhe cilësi tjera pa e ditur mënyrën e tyre e as esencën e Qenies së tillë të Shenjtë apo të Cilësive të tilla.

Në vijim, të shohim se ç’thotë Shejhul-Islami Ahmed in Tejmije rreth kësaj çështjeje: *“Medhhebi i selefit (r.a.) konfirmon Cilësitë ashtu siç thuhet, por mohon mënyrën e tyre, ngase biseda rreth Cilësive është degë e bisedës rreth Qenies. Konfirmimi i Qenies është konfirmim i ekzistencës e jo i mënyrës. Kështu është konfirmimi i Cilësive dhe në këtë mënyrë mendonte i gjithë selefi. Nëse zgjerohemi më tepër dhe e themi tërë atë që e kanë thënë selefi rreth kësaj, do të largohemi nga qëllimi ynë në këtë përgjigje. Mjafton kjo që e thashë për atë që kërkon të vërteton dhe dëshiron të saktën, e kush dëshiron vetëm të thotë thashetheme, të flet kot dhe të bëjë dialog, del nga rruga e drejtë”*.⁷²¹

II - Komentimi i lejuar dhe i palejuar (*Et-te'vijlul xhaiz ve gajrul xhaiz*)

(التاويل الجائز و غير الجائز)

Edhe pse nuk anojmë kah medhhebi i komentimit të Cilësive, përsëri kjo nuk nënkupton se ne duhet të mohojmë përgjithësisht dhe në detaje komentimin (*Te'vijlin*), apo se nuk ekziston ndonjë kuptim i përshtatshëm dhe i kapshëm për të. Imam Ibn Kajjimi, nxënës i Shejhul-Islamit (Zoti i mëshiroftë të dy!) jep një zbërthim të bukur rreth kësaj çështjeje në librin e tij: *“Essavaikul-mursele ala el-xhehmijjeti vel-mu’attileti”*. Ai në këtë libër flet për dy lloje të komentimit (*Te'vijlit*) *“Komentimi në kuptim të tefsirit e që është i kapshëm, i pranuar dhe komentimi i falsifikuar të cilin nuk e pranojnë, por përkundrazi, e refuzojnë”*. Lloji i dytë i komentimit që nënkupton falsifikim, devijim,

⁷²¹ Ibn Tejmije, *“Mexhmu’ul fetava”*; vëll. 4, fq. 1-6.

ndryshim...është ide dhe vepër e çifutëve që ia bënë Teuratit, si dhe këta janë paraprijës dhe autorë të këtij lloji të komentimit të devijuar gjatë historisë. Disa fraksione islame si *mutezilët*, *xhehemitët*, *kaderitët* dhe disa tjera e mbështesin komentimin e devijuar. Në këtë kontekst, Imam Ibnul Kajjimi (Zoti e mëshiroftë!) thotë: “Te’vijli- Komentimi bazohet në dy aspekte: në tefsir (te’vijl) dhe falsifikim (tahrif). Ai lloj i te’vijlit që nenkupton:(tefsir); ai është i vërtetë, ndërsa ai te’vijl që nenkupton(tahrif); ai është i pavlefshëm, ngase është një lloj i ateizmit(largim, ikje) dhe devijim i teksteve nga kuptimi i vërtetë, ose me thumbim ose me devijimin e të vërtetave. Kështu vepron edhe ateizmi me Emrat e Zotit, herë i refuzon kuptimet dhe të vërtetat e tyre, e herë e mohon bartësin e Emrave të tillë (Zotin) dhe herë i bëjnë shok. Komentimi i pavlefshëm(tahrif) është ateizëm e devijim, edhe pse ithtarët e tij e quajnë verifikim, njohje e komentim. Si komentim i falsifikuar dhe ateist xhehemist konsiderohet komentimi i ajetit kur’anor:

([النساء: 164] تَكْلِيمًا مُوسَىٰ ٱللَّهُ وَكَلَّمَ)

“E Musait i foli Allahu me fjalë”.⁷²² Këtu devijohet fjala dhe deklinacioni i fjalës: “ve kel-lemell-llahe...” (prej emërores e bëjnë në kallëzore), dhe merr kuptimin “Musai i foli Zotit e jo Zoti Musait” - dhe kjo është një lloj mënyre e falsifikimit të kuptimit nga ana e çifutëve, bile edhe më keq. Kur e devijuan xhehemitët kuptimin e tekstit, apologjetët(ata që ishin në rrugën e drejtë të ehli Sunnetit dhe Xhematit) thanë: “Ç’ka thoni për ajetin kur’anor:

([الأعراف: 143] إِلَيْكَ أَنْظُرْ أَرِنِي رَبِّ قَالَ رَبُّهُ وَكَلَّمَهُ لِمِيقَاتِنَا مُوسَىٰ جَاءَ وَلَمَّا)

[الأعراف: 143]

“E kur Musai erdhi në kohën që i caktuam dhe i foli Zoti i vet...”⁷²³ - atëherë u hutuan devijuesit dhe ngelen të shokuar. Po ashtu edhe komentimi i kaderitëve mexhusitë e devijojnë kuptimin e teksteve të kaderit duke i nxjerrë nga konteksti dhe nga kuptimi i vërtetë. Xhehemitët i komentojnë tekstet e Cilësive dhe i nxjerrin nga konteksti dhe kështu e privojnë Zotin e Madhërishëm nga Cilësitë e përkryera, ashtu siç e privojnë nga fuqia e dëshira. Ne nuk mohojmë komentimin, por pranojmë komentimin që mbështetet në të vërtetën shkencore dhe fetare, dhe

⁷²² En-Nisaë, 164.

⁷²³ El-A’rafë, 143.

dijetarët e thelluar në shkencë dhe ne fe janë të aftë për komentim, por cilin prej dy komentimeve? Ne jemi më të thirrur në tefsir dhe jemi te lumtur, ndërsa të tjerët që kanë ba(tahrijf) komentim të falsifikuar janë në mizori. Vetëm Zoti e di të vërtetën...!”⁷²⁴

Pastaj Ibn Kajjimi (Zoti e mëshiroftë!) i thekson dëmet dhe arsyet e këtij komentimi të pavlefshëm. Ky lloj i komentimit e ka dëmtuar shumë Islamin, e ka shkatërruar fenë dhe i ka eliminuar mësimet për shkak të tentativave të devijimeve dhe iluzioneve të tilla. Ai i quan argumentet dhe arsyetimet e tilla: *tavagijt* “djaj-idole” dhe në këtë kontekst thotë: “Thënia e tyre se Fjala e Zotit dhe fjala e Pejgamberit të Tij janë argumente verbale, nuk kanë ndonjë dituri dhe nuk përfitohet prej tyre ndonjë bindje, thënia e tyre se ajetet e Cilësive dhe hadithet e Cilësive janë alegori dhe s’ka gjë të vërtetë në to, thënia e tyre se të dhënat nga Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) që janë të vërteta e që transmetohen nga njerëzit të drejtë të ummetit nuk ofrojnë ndonjë dituri dhe kanë për qëllim hamendjen, si dhe thënia e tyre se nëse ekziston ndonjë kontradiktë në mes intelektit dhe teksteve të Shpalljes e marrim intelektin e jo Shpalljen, janë katër djaj-idole-tagute që e kanë dëmtuar shumë Islamin, i kanë eliminuar parimet e tij, i kanë zhdukur mësimet e tij, i kanë shkatërruar rregullat e tij, e kanë nxjerrë shenjtërinë e teksteve nga zemrat dhe kanë trasuar rrugën e thumbimit për çdo jobesimtar ateist dhe secili prej tyre është mbështetur në ndonjë djall prej djajve të tillë, është drejtuar në këtë drejtim dhe është larguar nga rruga e Allahut. Zoti i Madhërishëm, me Fuqinë dhe Forcën e Tij i ka shkatërruar këto djaj një nga një përmes pasardhësve të pejgamberëve dhe trashëgimtarëve të pejgamberëve të Tij. Ithtarët e Zotit dhe të Pejgamberit të Tij vazhdimisht i sulmojnë ata në çdo vend të botës, i gjuajnë me fakte nga Shpallja e me argumente racionale. Edhe ne i kundërshtojmë fjalët e tyre një nga një...”⁷²⁵

Mjafton kaq rreth sqarimit të qëndrimit të disa dijetarëve të selefit rreth kësaj çështje. Ne anojmë kah ky mendim dhe e pranojmë këtë qëndrim plotësisht, ngase mendojmë se ky është qëndrim i vërtetë dhe i saktë in sha Allah. Poashtu, ne pranojmë komentimin që është tefsir e sqarim e jo komentimin që devijon, ndryshon e falsifikon(ban tahrijf). Dëshiroja që kjo hyrje të jetë peshojë për matjen e fjalëve të Shejh Hafiz Ibrahim Dallit dhe të tjerëve, keshtu që gjatë elaborimit dhe analizës së

⁷²⁴ Muhamed ibn Ebu Bekër Ejjub Ezzer’ij Ebu Abdullah Ibn Kajjim, “**Es-savaik el-mursetu ala el-xehmijeti vel-muattileti**”; recensoi dr. Ali ibn Muhamed Dehilullah, Rijad, Darul-Alemijje, bot. 3, 1998, vëll. 1, fq. 217-219.

⁷²⁵ Po aty, vëll. 2, fq. 632-633.

mendimeve të tija akaidologjike më vonë në këtë studim, nuk do të kemi nevojë që të kundërshtojmë apo të bëjmë replikë ose të refuzojmë çdo çështje që do të pasojë më tutje, nese nuk perputhet me kete qe u cek më lartë. Kjo hyrje është shtyllë në këtë kapitull.

Për sa i përket qëndrimit të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliut ndaj komentimit, ndonjëherë ai anon kah komentimi i devijimit dhe ndryshimit dhe ndonjëherë anon kah komentimi me kuptim të tefsirit dhe sqarimit. Ai i komenton disa ajete në të cilët vërehet diçka nga cilësitë e krijesave, por e pastron Zotin e Madhërishëm nga ngjashmëria me krijesa dhe kështu kërkon kuptim të përshtatshëm që përputhet me tekstin kur'anor dhe me Madhërinë e Zotit. Në vijim do të theksojmë disa shembuj konkret rreth komentimit të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliut (Zoti e mëshiroftë!).

A. Komentimi i cilësive të turpit, dorës dhe fytyrës:

(تأويل صفة الحياء و اليد و الوجه)

1). Komentimi i Cilësisë së “turpit” dhe këtu komentimi përdoret në kuptim të tefsirit dhe sqarimit.

Në tefsirin e ajetit kur'anor:

([البقرة: 26] ﴿ فَوْقَهَا فَمَا بَعُوضَةً مَّا مَثَلًا لِّمَنْ يَضْرِبُ ۚ لَا يَسْتَحْيٰ ۚ لَا اِلٰهَ اِلَّا ۞ ﴾)

“Allahu nuk ngurron që të marrë çfarëdo shembulli, qoftë mushkonjë a diçka edhe më e imtë se ajo”,⁷²⁶ ai thotë se Zoti i Madhërishëm nuk ngurron, nuk ngushtohet dhe nuk heziton të marrë çfarëdo shembulli⁷²⁷ dhe këtë domethënie duhet ta kuptojmë prej këtij ajeti, e jo diçka që ju ngjanë cilësive të njerëzve ashtu siç sqaruam në komentimin tonë të ajetit (الرحمن الرحيم) “Er-Rahman Er-Rahim”. Këtu nuk duhet të kuptojmë turpin që e dimë, e që e njohim të gjithë dhe që manifestohet me skuqjen apo me zverdhjen e fytyrës e që është cilësi njerëzore.⁷²⁸ Pra, nga fjalët e Shejh Hafiz Ibrahim Dalliut kuptohet qartë se qëllimi i tij i komentimit të këtij ajeti konkretisht ka të bëjë me pastrimin e Krijuesit të Madhërishëm, dhe ky komentim i këtij lloji lejohet dhe është i kekrkuar, ngase nuk ka privim e as antropomorfizëm, por pastrohet Krijuesi nga cilësitë e krijesave.

⁷²⁶ El-Bekare, 26.

⁷²⁷ Këtë që e thotë Hafiz Ibrahim Dalliu për cilësinë e “turpit” e ka thënë edhe dijetari dhe mufessiri i njohur Imam Ibn Kethijr në tefsirin e tij: “**Zoti i Madhërishëm nuk ngurron dhe thuhet nuk frikësohet që të sjellë ndonjë shembull, qoftë i vogël apo (i madh)...**”; vëll. 1, f. 64. Ky citat transmetohet nga Muhamed ibn Abdurahman El-Migravi, “**El-mufessirun bejne te’vili vel ithbati fi ajatis-sifati**”; vëll. 1, f. 190.

⁷²⁸ Po aty, vëll. 1, fq. 77.

2). Komentimi i cilësisë së “dorës” me fuqi: **تَأْوِيلُ صِفَةِ الْيَدِ بِـ: (القدرة و القوة)**

Ai (Zoti e mëshiroftë!) e komenton cilësinë e “dorës” me Fuqinë e Zotit të Madhërishëm në dhënie e furnizim edhe atë duke u mbështetur në ajetin kur’anor:

([المائدة: 64] مَغْلُولَةً اللَّهُ يَدُ الْيَهُودُ وَقَالَتْ)

“Jehuditë thanë: ‘Dora e Allahut është e shtrënguar!’”⁷²⁹ Ai argumenton komentimin e tij me vazhdimin e po të njëjtit ajet, dhe në këtë kontekst Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu thotë: “Vazhdimi i ajetit të njëjtë është:

([المائدة: 64] يَشَاءُ كَيْفَ يُنْفِقُ مَبْسُوطَتَانِ يَدَاهُ بَلْ)

“Jo, duart e Tij janë të shkira. Ai furnizon ashtu si të dojë”⁷³⁰

Apo këto janë gënjeshtër e trillime të çifutëve dhe nuk janë të vërteta, ngase fuqia e Zotit të Madhërishëm për të dhënë është shumë e madhe, furnizon e ushqen ashtu si dëshiron Ai...”⁷³¹

Edhe pse ky argumentim i Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu mund të jetë i kapshëm dhe i mundshëm, nuk pranohet dhe nuk përputhet me ajetet e tjera të qarta që konfirmojnë dy duart e Zotit të Madhërishëm, si p.sh., ajetet kur’anore:

مِنْ كُنْتَ أَمْ أَتَكْبَرْتَ بِيَدَيَّ خَلَقْتُ لِمَا تَسْجُدُ أَنْ مَتَعَكَ مَا يَتَابِلِسُ قَالَ

[ص: 65] اَلْعَالِينَ

“(Zoti) tha: “O iblis, çka të pengoi ty t’i përulesh atij që unë vetë e krijova me dorën time? A bëre kryeneçësi apo ke qenë prej atyre që shesin fodullëk?”⁷³²

⁷²⁹ El-Maide, 64.

⁷³⁰ El-Maide, 64.

⁷³¹ “Ajka e kuptimeve....”; vëll. 2, fq. 1075-1076; Tefsiri i Bejdaviut: “Envarut tenzijli ve esrarut-te’vili (për krahasime). Nëse e krahason tefsirin e Shejh Ibrahim Dalliu me tefsirin e Bejdaviut do të shohësh se janë identikë. Sipas disa hulumtuesve ky tefsir i Imam bejdaviut është rezyme e tefsirit të Fahrudin Raziut dhe Zemahsheriut. Shih më gjerësisht në: Muhamed ibn Abdurahman El-Migravi, “El-Mufessirun bejne te’vili vel ithbati fi ajatis-sifati”; vëll.2, fq. 95-105.

⁷³² Sad, 75.

([أَيْدِيَهُمْ فَوْقَ اللَّهِ يَدُ اللَّهِ يُبَايِعُونَ إِنَّمَا يُبَايِعُونَكَ الَّذِينَ])

الفتح: 10

“Dora e Allahut është mbi duart e tyre”.⁷³³

([المائدة: 64] يَشَاءُ كَيْفَ يُنْفِقُ مَبْسُوطَتَانِ يَدَاهُ بَلْ)

“Jo, duart e Tij janë të shkira”.⁷³⁴

Si mund të përputhet kuptimi me ajetin e fundit, a mund të themi: “Dy fuqi të shkira?!” Çfarë pengese ka në gjuhën arabe që të përdoret në Kur’anin Fisnik fjala: “Fuqia e Zotit mbi fuqinë e tyre?” Nuk ka asnjë pengesë gjuhësore apo të Sheriatit të përdoret kjo fjalë. Atëherë pse të komentojmë fjalën: “dorë” me “fuqi”?!

3). Komentimi i cilësisë “fytyrë” me “anë”, me “qenie e Zotit” me “pëlqim të Zotit”:

تَأْوِيلُ صِفَةِ : الْوَجْهِ، بِ: الْجِهَةِ، وَبِ: ذَاتِ اللَّهِ الْعَلِيَّةِ، وَبِ: بَرَضَى اللَّهِ تَعَالَى

Shejhu (Zoti e mëshiroftë!), po ashtu, e komenton cilësinë e “fytyrës” që theksohet në shumë ajete kur’anore, si p.sh., ajeti kur’anor:

([عَلِيمٌ وَسِعَ اللَّهُ إِبْنَ اللَّهِ وَجْهُ فَتَمَّ تُولُوا فَأَيْنَمَا وَالْمَغْرِبُ الْمَشْرِقُ وَلِلَّهِ])

البقرة: 115

“Të Allahut janë edhe (anët nga) lindja dhe perëndimi dhe ngado që të kthehemi aty është fytyra e Allahut”.⁷³⁵

Këtë ajet dhe ajetet e tjera ai i komenton kështu: “Ngado që të kthehen aty është fytyra e Zotit, apo ana e adhurimit dhe pëlqimi i Zotit. Zoti i Madhërishëm është gjithëpërfshirës i gjithëdijshtëm, mëshirues dhe falës. Animi i atij që falet kah qenia e Zotit është e pamundshme dhe absurde, ngase Zoti i Madhërishëm nuk mund të ketë anë. Këtu fytyra e Zotit nënkupton Qenien e Zotit. Ai që falet përqendrohet në aspektin fizik dhe psikik para Qenies së Zotit. Ndoshta këtu nënkupton edhe pëlqimin e Zotit të Madhërishëm dhe të pastër nga të metat...”⁷³⁶

4). Komentimi i cilësisë “afër – i afër” me “dituri”:

⁷³³ El-Fet’h, 10.

⁷³⁴ El-Maide, 64.

⁷³⁵ El-Bekare, 115.

⁷³⁶ Po aty, vëll. 1, fq. 183-184.

تأويل صفة : القرب بـ: العلم

Në tefsirin e tij të ajetit kur'anor:

(﴿ دَعَانِ إِذَا الدَّاعِ دَعْوَةٌ أُجِيبُ قَرِيبٌ فَإِنِّي عَنِ عِبَادِي سَأَلْتُكَ وَإِذَا ﴾)

البقرة: 186

“Unë jam afër i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet...”⁷³⁷, ai e komenton fjalën “afër” me dituri dhe nënkupton se dituria e Zotit të Madhërishëm është afër robërve të Tij. Ai argumenton me fjalët e Bejdaviut, i cili mendon njësoj si ai, dhe mohon se ky ajet tregon se Qenia e Zotit është afër tyre, pasi që Zoti s’ka vend dhe nuk ka nevojë për vend, atëherë afërsia e Zotit është e pamundshme dhe absurde.⁷³⁸

III - Shfrytëzimi i tekstit kur'anor sipas medhhebit në bazë të argumentimit racional për t’u udhëzuar në besimin në Zotin e Madhërishëm

توظيف النص القرآني وفق المذهب الماتريدي على وجوب الاستدلال العقلي للاعتداء إلى الإيمان بالله تعالى

Në këtë pjesë të studimit tone nuk kemi për qëllim që ajetin kuranor “besën e Zotit” ta bëjmë Cilësi të Zotit të Madhërishëm, ngase kjo nuk është pjesë e cilësive të Zotit të Madhërishëm, por këtu kemi për qëllim sqarimin e metodës dhe drejtimit të tij komentues, ku vërehet qarte përdorimi e tekstit kur'anor për të përkrahur besimin e tij dhe medhhebin e tij përmes komentimit të tij të ajeteve.

Në tefsirin e ajetit kur'anor:

([البقرة: 27] ﴿ مِيثَاقَهُ بَعْدَ مِنْ اللَّهِ عَهْدَ يَنْقُضُونَ الَّذِينَ ﴾)

“Ata që e thyejnë besën e dhënë Allahut pasi që është lidhur ajo...”⁷³⁹ ai thotë:

“Këtu besa e Zotit është ajo që është në mes Zotit dhe atyre, dhe kjo besë është intelekti,⁷⁴⁰ të cilin Zoti ia ka dhënë atij për ta njohur Zotin

⁷³⁷ El-Bekare, 186.

⁷³⁸ “Ajka e kuptimeve të Kur’ani Qerimit”; vëll. 1, f. 272. Rreth historikut të komentimit, komentimit të pavlefshëm dhe çështjeve tjera që kanë të bëjnë me komentimin shih: Salim Ibrahim ibn Hasan, “Kadijjetut te’vjl fil Kur’anil-kerim bejnel-gulati vel-mu’tedilijn”; Bejrut, Daru Kutejbe, bot. 1, 1993.

⁷³⁹ El-Bekare, 27.

e Madhërishëm, për të argumentuar ekzistimin e Tij dhe për të konfirmuar mesazhin e Muhammedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), ngase kur e krijoi Zoti dritën e mendimit dhe njohjes në intelektin e njerëzve, ishte një lloj bese se ata do t'i besojnë Atij, do ta pranojnë monoteizmin e Tij dhe do të besojnë në mesazhin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) Mjafton intelektin për të kuptuar e për të konfirmuar argumentet e monoteizmit të Zotit dhe të pejgamberisë...⁷⁴¹

Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu e përsërit të njëjtën gjë edhe në një vend tjetër kur e bën tefsir ajetin kur'anor:

([البقرة : 38] هُدًى مِّنِي يَأْتِيَنَّكُمْ فَأَمَّا)

“E juve gjithqysh do t’u arrijë udhëzim prej Meje!”⁷⁴² Në këtë kontekst Shejhu thotë: “Theksimi i ajetit në formë kategorike për dërgimin e pejgamberëve duket sikur Zoti i Madhërishëm thotë: “Nëse ju vjen pejgamber, kjo është gjë e mirë dhe e bukur, e nëse jo, atëherë nuk është obligim për Mua (për Zotin e Madhërishëm) që t’ju dërgoj pejgamber. Nëse ju vjen pejgamber, atëherë kjo është një mirësi prej Zotit të Madhërishëm për robërit e Tij, e nëse nuk ju vjen, keni intelektin që ju argumenton besimin në Zotin e Madhërishëm dhe monoteizmin e Tij përmes shikimit dhe studimit tuaj të ajeteve të gjithësisë.”⁷⁴³

Gjatë hulumtimit të kësaj çështje, këtë të vërtetë që e thekson Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu e gjeta te imamët maturiditë dhe në vazhdim do ta theksoj mendimin e Imam Ebu Mensur El-Maturidiut që t’i shohëm pikat identike dhe jo identike në mes fjalëve të tij dhe fjalëve të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu.

Në komentimin e Imam Ebu Mensur El-Maturidiut në lidhje me ajetin:

([البقرة : 27] مِيثَاقَهُ بَعْدَ مِّنْ أَلَّهِ عَهْدَ يَنْقُضُونَ الَّذِينَ)

“Ata që e thyejnë besën e dhënë Allahut pasi që është lidhur ajo”,⁷⁴⁴ thuhet se njohja e Zotit nënkupton besën e dhënë dhe se besa e

⁷⁴⁰ Imami Nesefiu i thekson disa mendime të komentuesve rreth domethënies së ajetit të lartpërmendur dhe një ndër kuptimet e tilla është edhe ai që e thekson Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu. **Shih: Tefsiri i Nesefiut**, vëll. 1, f. 78.

⁷⁴¹ Po aty, vëll. 1, fq. 78.

⁷⁴² El-Bekare, 38.

⁷⁴³ **Ajka e kuptimeve...**, vëll. 1, fq. 98.

⁷⁴⁴ El-Bekare, 27.

dhënë Allahut ka dy forma: besa e krijesave se do të dëshmojnë veçmas për monoteizmin e Zotit të Madhërishëm, si p.sh. ajeti kur'anor:

[الذاريات: 21] ﴿تُبْصِرُونَ أَفَلَا أَنْفُسَكُمْ وَفِي﴾

“Po edhe në veten tuaj, a nuk jeni kah e shihni?”⁷⁴⁵

Forma e dytë nënkupton besën e mesazhit me gojën e pejgamberëve dhe të dërguarve, si p.sh., në ajetin kur'anor:

بِرُسُلِي وَءَامَنْتُمْ الزَّكَاةَ وَءَاتَيْتُمُ الصَّلَاةَ أَقَمْتُمْ لِيْنٍ مَعَكُمْ إِنِّي اللَّهُ وَقَالَ

([المائدة: 12] ﴿وَعَزَّزْتُمُوهُمْ﴾

“Allahu tha: “Unë jam me ju, në qoftë se falni namazin e jepni zekatin, u besoni të dërguarve të Mi dhe u ndihmoni atyre...”⁷⁴⁶

فَنَبَذُوهُ تَكْتُمُونَهُ وَلَا لِلنَّاسِ لَتُبَيِّنَنَّاهُ أَلَكْتَبُ أُوتُوا الَّذِينَ مِيثَقَ اللَّهُ أَخَذَ وَإِذْ

آل عمران: 187] ﴿يَشْتَرُونَ مَا فَبِئْسَ قَلِيلًا مِمَّا بِيءَ وَأَشْتَرُوا ظُهُورَهُمْ وَرَاءَ

“Dhe kur Allahu mori zotimin⁷⁴⁷ nga ata që iu pat dhënë libri: që gjithqysh t’ua publikoni atë njerëzve e të mos e fshihni...”⁷⁴⁸

Nga kjo nënkuptohet se, sipas maturiditëve, njohja e Zotit të Madhërishëm, edhe pse është evidente dhe deduktive, ajo është e mbjellë në shpirt para të menduarit.⁷⁴⁹ Njohja e Zotit ose besimi në Zotin e Madhërishëm është instinkt që e ka vënë Zoti në këtë ekzistencë, e cila dëshmon për ekzistimin e Qenies së Tij dhe e ndjen thellë në vetvete këtë të vërtetë.⁷⁵⁰

Për sa i përket çështjes së njohjes së obligueshme të Zotit të Madhërishëm dhe rrugëve që të shpijnë tek ajo, them se shumë kelamistë (apologjetë) janë marrë me këtë çështje, si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen. Përmes studimit dhe hulumtimit, kuptova se në botën islame

⁷⁴⁵ Edh – dharijat, 21.

⁷⁴⁶ El-Maide, 12.

⁷⁴⁷ Ali Imran, 187.

⁷⁴⁸ Bil-Kasim El-Gali, “Ebu Mensur El-Maturidij, hajatuhu ve ara’uhu el-akadijje”; fq. 98 nga “Te’viljatus-sunneti” Ebu Mensur El-Maturidi, vëll. 1, f. 80.

⁷⁴⁹ Po aty, fq. 98-99.

⁷⁵⁰ Sejjid Kutub, “Fi dhilalil-Kur’an”; vëll. 3, f. 668.

janë paraqitur disa drejtime rreth kësaj çështje, të cilat një hulumtues i ka bërë rezyme në disertacionin e tij universitar⁷⁵¹ (Zoti e shpërbleftë!). Në studimin e tij ai thekson se ka ekzistuar një drejtim që thoshte se njohja e Zotit është hermeneutike, sipas një drejtimit tjetër, njohja është e obligueshme, sipas disa të tjerëve, njohja vjen me inspirim, ndërsa sipas disa të tjerëve ajo vjen nga udhëheqësi fetar respektivisht, imami, si p.sh., ismailitët batinij (ezoterikë).

Krahas drejtimeve të sipërpërmendura, po ashtu, do të theksojmë:

1). Drejtimi racional dhe shkolla më e vjetër e këtij drejtimi apologjetik është ajo e mu'tezilëve, sipas të cilëve Zoti i Madhërishëm njihet me të menduar, studiuar, analizuar dhe logjikuar – hermeneutike)

(**بالنظر**) (*Bin Nadhari*). Ky lloj i mendimit për te arritur ne realitet duhet të jetë obligim i parë i të obliguarit. Këtë të vërtetë e sqaron Imami mu'tezilit El-Kadi Abdulxhebbar, i cili kur pyetet rreth obligimit të parë të njeriut, thotë: “Shikimi apo analiza e argumenteve shkencore dhe natyrore që të shpien në njohjen e Zotit të Madhërishëm”. Njëri nga imamët e tyre e tepron aq shumë, saqë thotë se kush nuk e njeh Zotin me argument, ai është jobesimtar (kafir), ngase kundër njohjes është mosnjohja dhe mosnjohja është pabesim (kufër)! S’ka dyshim se ky ekstremizëm është devijim nga rruga e drejtë...

2). Drejtimi tradicional në njohjen e Zotit të Madhërishëm. Ky drejtim është i selefit të devotshëm (Zoti e mëshiroftë!). Autori i këtij hulumtimi dhe disa hulumtues të tjerë këta i quajnë (**الحشوية**) “El hashevijetu” - për fat të keq - për shkak se, sipas tyre, njohja e Zotit është e padukshme dhe nuk perceptohet me intelekt, dhe për këtë shkak, si bazë duhet të jetë ajo që transmetohet nga gjurmët e sahabeve dhe hadithet profetike të Muhamedit a.s.

3). Drejtimi simbiozë në mes tradicionalizmit dhe racionalizmit. Kështu mendonin esh’aritët sipas të cilëve, njohuria e Zotit realizohet përmes Sheriatit në bazë të hermeneutikës dhe shikimit. Sheriati urdhëron shikimin dhe përsiatjen përmes teksteve të Kur’anit, Sunnetit dhe Ixhmait (konsensusit). Edhe Kur’ani Fisnik e vlerëson lartë rolin e intelektit dhe e ka bërë mjet për të njohur të vërtetën nga e pavërteta. Ky drejtim vërehet në fjalët e një imami të madh esh’arit, gjegjësisht në fjalët e Imam Ebu Hamid El-Gazaliut (Zoti e mëshiroftë!), i cili e ngre lartë rolin e intelektit dhe e çmon shumë atë. Ai thotë se intelekti dhe Shpallja janë dy gjëra që plotësojnë njëra-tjetrën. Sheriati është intelekt nga jashtë, ndërsa intelekti

⁷⁵¹ Hulumtuesi apo shtëpia botuese nuk theksojnë se kjo është temë magjistrature apo disertacion i doktoratures?!

është Sheriat nga brenda. Intelekti udhëzohet vetëm me Sheriat, ndërsa Sheriati sqarohet me intelekt. Intelekti është si themeli, ndërsa Sheriati si ndërtesa, dhe nuk vlen themeli pa ndërtesë e as nuk mund të vendohet ndërtesë pa themel.⁷⁵²

4). Drejtimi instinktiv apo i hermeneutikës tek Imam Ebu Mensur El-Maturidiu. Ky drejtim mbështetet në shpirt dhe instinkt. Më parë e theksuam këtë drejtim, i cili mund të sqarohet në bazë të pikave vijuese:

Domosdoshmëria e shikimit

Njeriu mund ta njeh Zotin me intelekt, ngase Zoti i Madhërishëm na urdhëron në shumë ajete që të mendojmë, përsiatim e të marrim mësim, si p.sh.: ajeti kur'anor:

لَا قَوْمٍ عَنِ وَالنُّذُرِ الْآيَاتُ تُغْنِي وَمَا وَالْأَرْضِ السَّمَوَاتِ فِي مَادَا أَنْظُرُوا قُلِ

([يونس:101] يُؤْمِنُونَ)

“Thuaj: “Vështroni me vëmendje çka ka (nga argumentet) në qiej e në tokë...”⁷⁵³

رَبِّكَ يَكْفِ أَوْلَمَ الْحَقُّ أَنَّهُ لَهُمْ يَتَبَيَّنَ حَتَّى أَنْفُسِهِمْ وَفِي الْأَفَاقِ فِي ءَايَاتِنَا سُنُرِيهِمْ

([فصلت : 53] شَهِدُ شَيْءٍ كُلِّ عَلَى أَنَّهُ)

“Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që të shohim argumentet tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë”.⁷⁵⁴

⁷⁵² El-Gali, Bel-kasim, **Ebu Mensur El-Maturidij - hayatuhu ve ara’uhu el-akadijjet**, Tunis, Darut-turkiy lin-neshri, 1989, fq. 90-94; Hoxha Hajredin, **Tekamuhul-vahji vel-akli vel-havas-si fi islamijetil-marifeti** (hulumtim shkencor i pabotuar nën mbikëqyrjen e prof. dr. Ibrahim Rexhep, Universiteti Islamik Ndërkombëtar, Malajzi 1998. Disa filozofë klasikë, si Kindi dhe Ibn Rushdi orvaten të bëjnë harmonizimin në mes shariatit ose teksteve kur’anore dhe filozofisë e parimeve të saj për të treguar mosekzistimin i kontradiktave në mes tyre, dhe sipas mendimit tim, dështuan. Më gjerësisht shikoni: “**Kitabu faslil-mekal ve takriru ma bejnesh-sheriati vel-hikmeti minel-ittisal**, Kadi Ebu El-Velid Muhamed ibn Ahmed ibn Rushd, recensoi dr. Xhorxh Fadl El-Haurani, Leiden, Matba’atu Bril, 1954, Libri: “**El-Madijjetu vel-mithalijjetu fi felsefeti ibn Rushd**, Muhamed Amare, Kajro, Darul-Me’arif, bot-2.

⁷⁵³ Junus, 101.

⁷⁵⁴ Fussilet, 53.

Edhe pse Imam Ebu Mensur El-Maturidiu flet për domosdoshmërinë e shikimit dhe hermeneutikës racionale si dhe për vlerën e madhe të intelektit, ai po ashtu, flet edhe për domosdoshmërinë e pejgamberit dhe mesazhit, ngase vetëm intelekti nuk mund ta njohë të vërtetën për shkak të epsheve, kënaqësive, grindjeve dhe konflikteve njerëzore, të cilët pengojnë arritjen në të vërtetën. Rruga e shikimit dhe hermeneutikës nuk është e lehtë për shkak të disa arsyeve, të cilat i thekson në librin e tij “Et-Teuhid” dhe thotë: *“Pastaj, ekzistojnë arsye se pse intelekti ka nevojë për pejgamberë. Arsyeja e parë është ekzistimi i grindjes së dukshme në mesin e krijesave se cili prej tyre e thotë të vërtetën dhe e di të saktën, ngase nuk ka kush ndërmjetëson në mes tyre që të gjykojë në mes tyre, e t’ju tregojë se në çka bashkohen zemrat dhe fjalët e tyre. Dihet se grindja është burim i çdo shkatërrimi dhe hyrje në çdo zhdukje, dhe e gjithë kjo është e keqe në intelekt. Dihet se askush nuk e njeh më së miri këtë se Ai që i krijoi dhe që i formoi, dhe për këtë shkak, ndihet nevoja për pejgamberin që vjen prej Tij. Përveç kësaj, dihet se intelektin e preokupojnë marritë, mërzitë dhe problemet e ndryshme njerëzore. Po ashtu, edhe llojet e ndryshme të dhimbjeve dhe arsyeve të panumërta e preokupojnë intelektin dhe e pengojnë që të njohë të vërtetën në çdo aspekt të qetë e të qartë. Po ashtu preokupimi i emocioneve dhe kënaqësitë e dëfrimet e shumta e preokupojnë (intelektin), dhe për këtë shkak ndihet nevoja e pejgamberit të Zotit për t’ia treguar në momentet e dyshimit të vërtetën. Vetëm Zoti është i fuqishëm. Falë Zotit, sqarova nevojën e intelektit për pejgamberinë, për udhëzimet e tij dhe për paaftësinë e intelektit që të kaplojë gjithçka...!”*⁷⁵⁵

Prandaj këtu vërehet qarte e dukshëm mendimi i Imam Ebu Mensur El Maturidiut rreth rëndësisë së pejgamberise apo ardhjes së pejgambereve, dhe se intelekti apo mendja e njeriut është e dobët dhe jo e afte për ta njohur Allahun xh.sh. në mënyrë të pavarur pa udhëzimin e pejgambereve të Allahut xh.sh.

Sa i përket argumentit të maturiditëve rreth domosdoshmërisë së shikimit e hermeneutikës, njëri nga imamët e tyre të mëdhenj⁷⁵⁶ argumenton domosdoshmërinë e argumentimit racional me fjalët e Zotit të Madhërishëm rreth rrëfimit të banorëve të Shpellës, të cilët thanë:

⁷⁵⁵ Ebu Mensur El-Maturidi, “**Et-Teuhid**”, recensoi dr. Fet’hull-Ilah Halif, Aleksandri, Darul-xhamiatil-misrijeti, 1970, fq. 182-183.

⁷⁵⁶ Po aty, f. 96, transmetim nga Ebu El-Mu’min En-nese’ij, **Bahrul-kelam**, f. 6.

مِنْ نَدَّعُوا لَنَا وَالْأَرْضِ السَّمَوَاتِ رَبُّ رَبُّنَا فَقَالُوا قَامُوا إِذْ قُلُوبُهُمْ عَلَى وَرَبَطْنَا)
([الكهف: 14] ﴿﴾ إِلَيْهَا دُونَهُ

“Zoti ynë është Zoti i qiejve e i tokës, nuk adhurojmë ndonjë zot tjetër pos Tij”.⁷⁵⁷ Ai argumenton edhe me ajetin kur’anor që ka të bëjë me rrëfimin e kërimit të Ibrahimit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në yje, diell e hënë derisa arriti të vërtetën dhe në këtë kontekst, Zoti i Madhërishëm thotë:

الْأَفْلَهِبِ أَحِبُّ لَا قَالَ أَفَلْ فَلَمَّا رَبِّي هَذَا قَالَ كَوَكَبًا رَأَى أَلِيلُ عَلَيْهِ جَنَّ فَلَمَّا)
([الأنعام: 76] ﴿﴾

“E kur atë e mbuloi nata, ai e pa një yll e tha: “Ky është Zoti im!”
E kur u zhduk ai (perëndoi) tha: “Unë nuk i dua ata që humben”.⁷⁵⁸

Pikërisht në këtë pikë bashkohen maturiditet dhe mu’tezilët në glorifikimin e rolit të intelektit dhe në prioritetin e tij në argumentim. Dallimi në mes mutezilëve dhe maturidive është në faktin se Ehli Sunneti nga maturiditet dhe esh’aritet mendojnë se duhet doemos të ekzistojnë parimet e Sheriatit si mjet që vjen vetëm nga Zoti i Madhërishëm. Sipas mu’tezilëve mjet⁷⁵⁹ është intelektu e jo Sheriati i pastër që është shpallur nga Zoti i Madhërishëm. Sipas mutezilëve e mira dhe e keqja janë dy qenie. Veprat janë të mira dhe bëhen të këqija nga qenia e tyre, apo e mira është cilësi qenësore e veprës së mirë, ndërsa e keqja është cilësi qenësore që i takon veprës së keqe. Intelekti e kupton të mirën e të keqen para se të thotë Sheriati diçka për të.⁷⁶⁰

Imam Shatibiu, në librin e tij “El-Muvafekat”, kur flet rreth çështjes së Sheriatit, thotë: “Për sa i përket doktrinës së mutezilëve ata po ashtu i trajtojnë të mirat dhe të këqijat në bazë të intelektit, dhe në përgjithësi, kështu realizohen të mirat në botë apo të këqijat. Sipas tyre, Sheriati zbulon atë që ua thotë intelektu, as më pak e as më shumë...”⁷⁶¹

⁷⁵⁷ El-Kehf, 14.

⁷⁵⁸ El-En’amë, 76.

⁷⁵⁹ Po aty, f. 97.

⁷⁶⁰ Irfan Abdulhamid Fettah, “Dirasat fil-fikril-arabijil -islamijj”-hulumtime në apologetikë, sufizëm, orientalizëm e në lëvizjet destruktive, f. 213.

⁷⁶¹ Imam Esh-Shatibi, “El-Muvafekat fish-sheriatil-islamijjeti”; vëll. 2, f. 357.

Imam Zamahsheri, po ashtu, e vërteton në tefsirin e tij këtë të vërtetë, e mbron përkatësinë e tij mu'ëtezilite dhe dëshiron të çlirohet nga aspekti ekzoterik i këtyre dy teksteve:

اللَّهُ وَكَانَ أَرْسُلَ بَعْدَ حُجَّةٍ اللَّهِ عَلَى النَّاسِ يَكُونُ لِقَاءَ وَمُنْذِرِينَ مُبَشِّرِينَ رَسُولًا)

([النساء: 165] ﴿ ١٦٥ ﴾ حَكِيمًا عَزِيزًا)

“pejgamber të dërguar që ishin lajmërues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të dërguarve, njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para Allahut”.⁷⁶²

([الإسراء: 15] ﴿ ١٥ ﴾ رَسُولًا نَبَعَثَ حَتَّىٰ مُعَذِّبِينَ كُنَّا وَمَا)

“E Ne nuk dënuam askënd para se t’ia dërgojmë të dërguarin”.⁷⁶³

Zamahsheri e shtron këtë pyetje: “Si mund të kenë njerëzit fakt (arsye) pas pejgamberëve kur ata janë përplot me argumente nga Zoti, me të cilët arrihet në njohje. Edhe vetë pejgamberët e kanë arritur këtë njohje në bazë të shikimit në këto argumente, e as që i dinin se janë pejgamberë të Zotit përpos pas shikimit (analizimit) të tyre? Themi: Pejgamberët duhet të kenë kujdes për zgjimin e popullit nga moskujdesja dhe habia dhe cjtjen në shikim. Po ashtu i sheh dijetarët e drejtësisë dhe teuhidit, edhe pse në detaje kanë folur për çështjet fetare dhe kanë sqaruar çështjet e obligimit e mësimin të Sheriatit, dërgimi i tyre është për të eliminuar arsyen dhe për të plotësuar argumentimin e të mos thonë: “sikur të na dërgoje pejgamberë që të na zgjojnë nga habia - gjumi e të na tërheqin vërejtjen për atë që duhet pasur kujdes...”⁷⁶⁴

Nga ajo që theksova rreth parimeve dhe bazave të mu’tezilëve, vërehet se edhe Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu thekson rolin e intelektit si të mjaftueshëm për ta arritur njohjen e monoteizmit të Zotit të Madhërishëm dhe ekzistimin e Tij përmes argumentimit me fakte kozmologjike që tregojnë ekzistimin e Tij të Madhërishëm. Kjo ide mu’tezilite ekziston në fjalët e tij.⁷⁶⁵

⁷⁶² En-Nisa’ë, 165.

⁷⁶³ Isra’ë, 15.

⁷⁶⁴ Tefsiri “El-Keshshaf”, Ez Zamahsherij, vëll. 1, f. 389

⁷⁶⁵ Më hollësisht rreth besimit maturidit shih librin: “El-Bidajetu fîj usuliddin”; të Nuruddin Ahmed ibn Muhamed ibn Ebu Bekër Es-Sabuni, (ka ndërruar jetë në vitin 580

Sipas mendimit të Zemasheriut vërehet qartë se roli i pejgamberëve është zgjimi i intelektit nga hutimi dhe moskujdesja dhe të kenë kujdes ndaj asaj që duhet pasur kujdes e jo për diçka tjetër. Ky është roli i pejgamberëve sipas mendimit të Imam Zemahsheriut!

Kjo teori apo ide mu'tezilite nuk është e vërtetë, ngase shumë ajete kur'anore qartë tregojnë se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nuk dinte as ç'është Kur'ani e as besimi i vërtetë para Shpalljes. Po ashtu, edhe njerëzit nuk dinin se ç'ishin vlerat e as ç'ishte morali fisnik njerëzor. Kjo vërehet qartë në ajetin kur'anor:

الْإِيمَانُ وَلَا الْكِتَابُ مَا تَدْرِي كُنْتَ مَا أَمَرْنَا مِنْ رُوحًا إِلَيْكَ أَوْحَيْنَا وَكَذَلِكَ

صِرَاطٍ إِلَى لَهْدَى وَإِنَّكَ عِبَادِنَا مِنْ كَشَاءٍ مَنْ بِهِ نَهْدَى نُورًا جَعَلْنَاهُ وَلَكِنْ

اللَّهُ إِلَى الْأَرْضِ فِي وَمَا السَّمَوَاتِ فِي مَا لَهُ الَّذِي اللَّهُ صِرَاطٌ ﴿٥٣﴾ مُسْتَقِيمٌ

([الشورى: 52-53] ﴿٥٣﴾ الْأُمُورُ تَصِيرُ

“Po kështu me urdhrin tonë Ne të shpallëm edhe ty shpirtin (Kur'anin). Ti nuk ke ditur çka është libri (Kur'ani) as ç'është besimi, por Ne atë e bëmë dritë me të cilën e vëmë në rrugë të drejtë atë që dëshirojmë prej robërve tanë. Në të vërtetë, edhe ti udhëzon për në rrugë të drejtë. Në rrugën e Allahut, të Cilit i takon çka ka në qiej dhe çka ka në tokë e ta dini se të gjitha çështjet janë me vullnetin e Allahut”.⁷⁶⁶

الظَّنَّ إِلَّا يَتَّبِعُونَ إِنَّ اللَّهَ سَبِيلٍ عَنْ يُضِلُّوكَ الْأَرْضِ فِي مَنْ أَكْثَرَ تُطِيعُ وَإِنْ

([الأنعام: 116] ﴿١١٦﴾ تَخْرُصُونَ إِلَّا هُمْ وَإِنْ

“Në qoftë se u bindesh shumicës (mohuese që janë) në tokë ata do të largojnë ty nga rruga e Allahut. Ata nuk ndjekin tjetër vetëm supozime dhe nuk janë tjetër vetëm se rrenacakë”.⁷⁶⁷

hixhri). Kritikën e komentoit në margjinë prof. dr. Bekir Topaloglu, Ankara, botoi Bashkësia Islame e Turqisë, bot. 5, 1995, fq. 16-31.

- Nureddin Es-Sabuni, “**Maturidiyye akaidi**”; - Arastirma ve notlar ilavesiyle tercume edem prof. dr. Bekir Topaloglu, Marmara Universitesi, Ilahiyat fakultesi, Kelam Ilmi Öğretim Uyesi, Diyanet Isleri Baskanligi Yayinlari, Ankara, 5. Baski, 1995, 71-74.

⁷⁶⁶ Esh-shura, 52-53.

⁷⁶⁷ El En'amë, 116.

الْقَوْمِ مِنْ يَتَوَارَى ﴿٥٨﴾ كَظِيمٌ وَهُوَ مُسَوَّدًا وَجْهُهُ ظَلَّ بِالْأُتَى أَحَدُهُمْ بُشِّرَ إِذَا مَا سَاءَ إِلَّا التُّرَابِ فِي يَدُسُّهُ أَمْرُهُونَ عَلَى أَيْمَسِكُهُ بِهِ بُشِّرَ مَا سُوءٍ مِنْ
 ([النحل: 58 - 59] ﴿٥٩﴾ تَحْكُمُونَ)

“Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet me (lindjen) vajzë, fytyra e tij i prishet dhe bëhet plotë mllef. Fshihet prej njerëzve për shkak të asaj të keqeje me të cilën u lajmërua (e konsideron bela, e jo dhuratë prej Zotit). Mandej (mendon) a do ta mbajë atë, ashtu i përlulur, apo do ta mbulojë atë (të gjallë) në dhë. Sa i keq është ai gjykim i tyre!”⁷⁶⁸

Rreth kësaj çështje ka shumë ajete, por këtu nuk ka vend që t’i theksojmë të gjitha.

Po ashtu, edhe intelektit, nëse lihet vetëm, shpejt do të humbet në mesin e mendimeve dhe drejtimeve të devijuara e destruktive, dhe kështu në fund do të përfitohet vetëm humbja, devijimi e shkatërrimi. Që të mos devijojë intelektit dhe që të mos endet në errësirat e hutesës dhe humbjes, Zoti i Madhërishëm zotohet se gjatë historisë, kohë pas kohe do të dërgojë pejgamberë udhëzues e udhërrëfyes, e pastaj intelektit, nëse dëshiron beson e nëse jo, bën kufër, ngase nuk ka argument për mos udhëzim nga Allahu i Madhërishëm. Nëse ia ofron të gjitha llojet e kënaqësisë dhe dëfrimit të kësaj bote intelektit, s’ka dyshim se do t’i pëlqejë të gjitha dhe asnjë prej tyre nuk do ta pranojë si të keqe, si p.sh., prostitucioni, vjedhja, marrja e pasurisë nga njerëzit me dhunë, vrasja, etj. Pra, vetëm intelektit nuk është peshore e saktë dhe e mbrojtur nga ajo që mund ta pengojë në njohjen e të vërtetës dhe të pavërtetës, të keqen dhe të mirën. Nëse ekziston kundërshtim i racionales me tradicionalen, tradicionalja preferohet mbi racionalen e jo e kundërta, ashtu siç e sqaruan vëzhguesit dhe analistët.

Drita e intelektit pa u mbështetur në inspirimin hyjnor është e dobët dhe e zbehtë. Sa larg prej nesh janë filosofët dhe racionalistët, të cilët kanë devijuar dhe janë hutuar gjatë historisë deri në ditët e sotshme!!!

Shejh Muhamed Nesib Rifai thekson fjalë të bukura në marginat e rezymesë së tefsirit të Ibn Kethirit. Ai rezulton nga ajeti një kuptim korrekt gjatë tefsirit të ajetit kur’anor:

⁷⁶⁸ En Nahl, 58-59.

([الإسراء: 15] ﴿رَسُولًا نَبَعَثَ حَتَّىٰ مُعَذِّبِينَ كُنَّا وَمَا﴾)

“Ne nuk jemi dënues (nuk i dënojmë) derisa të dërgojmë peygamber”;

dhe thotë: “Derisa të dërgojmë peygamber të dërguar, ngase “resuli” mund të mos jetë “nebij...” Nëse u arrijnë atyre libër, ua sqaron dhe ky është resul i tyre, apo dëgjojnë radio rreth Islamit dhe besimit islam, dhe e gjithë kjo është fakt. Pra, ti je i dërguar, Kur’ani është i dërguar, zëri i radios është i dërguar në kuptim të bartjes së mesazhit. Shejhu zgjerohet në sqarimin e kuptimit të fjalës “resul”, i cili theksohet në ajetin e lartpërmendur. Ai, po ashtu, mendon se vetë intelekti nuk mund të arrijë njohjen në mënyrë të pavarur, pa libër, radio apo diçka tjetër. Dijetari i njohur Imam Ibn Kethiri, kur e komenton këtë ajet thotë se Zoti nuk e dënon asnjë përpos pas ardhjes së argumentit përmes dërgimit të peygamberit! Kjo tregon drejtësinë e Tij të Madhërishme.⁷⁶⁹

IV - Qëndrimi i tij ndaj të parit të Zotit të Madhërishëm në Ditën e Kiametit, ndaj mëkatarit të madh dhe ndaj shtimit të besimit (imanit):

موقفه من مسألة رؤية الله تعالى يوم القيامة، مرتكب الكبيرة و مسألة زيادة الإيمان

* Të parët e Zotit të Madhërishëm: رؤية الله تعالى يوم القيامة

Në tefsir, Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu e shkoqit edhe një çështje tjetër, të cilën Ehli Sunneti e konfirmojnë ndërsa mu’tezilët e mohojnë.

Në tefsirin e tij të ajetit kur’anor:

([الأنعام] ﴿الْخَبِيرُ اللَّطِيفُ وَهُوَ الْأَبْصَرُ يُدْرِكُ وَهُوَ الْأَبْصَرُ تُدْرِكُهُ لَا﴾)

[103 :

“Të parët (e njerëzve) nuk mund ta përfshinë Atë, e Ai, përfshinë të parët. Ai është shumë i kujdesshëm, hollësisht i njohur”⁷⁷⁰,

ai e analizon këtë çështje që është e diskutueshme në mes Ehli Sunnetit dhe Mu’tezilëve (çështja e të parit të Zotit të Madhërishëm në Ditën e Kiametit) duke i zbërthyer argumentet e të dy grupeve në formë të

⁷⁶⁹ Muhamed Nesib Er-Rufa’ij, “Tejsirul-alijjil-kadir li ihtisari tefsiri ibn Kethir”; (Mektebetul-Me’arif, Rijad, pa vit botimi, 1989, vëll. 3, f. 16.)

⁷⁷⁰ El-En’amë, 103.

rezymesë, e pastaj refuzon mendimin e mu'tezilëve se nuk do të mund të shihet Zoti dhe më pas anon kah doktrina e Ehli Sunnetit, e cila mendon se një gjë e tillë është e mundshme”.⁷⁷¹

Sipas medhhebit të Ehli Sunnetit dhe Xhematit , dhe sipas një dijetari të madh maturidit, Imam Nuruddin Ahmed ibn Mahmud ibn Ebu Bekër Es-Sabuni El-Maturidij, thuhet: “Ithtarët e të vërtetës thonë se të parit e Zotit të Madhërishëm me sy në Ditën e Ahiretit është i mundshëm me mend, ndërsa i obligueshëm me dëgjim. Përkundër këtyre, mu'tezilët, nexharitë, harixhitë, zejditë dhe rafiditë mendojnë ndryshe. Ithtarët e të vërtetës si argument e kanë pyetjen që ia drejtoi Musa (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) Zotit të Madhërishëm për ta, siç theksohet në ajetin kur'anor:

([الأعراف : 143] ﴿إِلَيْكَ أَنْظَرُ أَرِنِي رَبِّ قَالَ﴾)

“Zoti im, më mundëso pamjen tënde e të shikoj!”⁷⁷²

Po ashtu, edhe në ajetet e tjera thuhet:

([القيامة : 22-23] ﴿نَاطِرَةً رَبَّهَا إِلَى ﴿نَاصِرَةٌ يَوْمَ يَوْمِذٍ وَجُوهٌ﴾)

“Atë ditë do të ketë fytyra të shkëlqyera (të gëzuara) që Zotin e tyre e shikojnë”.⁷⁷³

([الكهف : 110] ﴿رَبِّهِ لِقَاءَ يَرْجُوا كَانَ فَمَنْ﴾)

“E kush është që e shpreson takimin e Zotit të vet”.⁷⁷⁴

([يونس : 26] ﴿وَزِيَادَةُ الْحُسْنَىٰ أَحْسَنُوا لِلَّذِينَ﴾)

⁷⁷¹ “Ajka e kuptimeve...”; vëll. 2, 1259-1260; Po ashtu shih në tefsirin e Shejh Hafiz Ibrahim Dallit çështjen e mëkatarit të madh në mes mu'tezilëve dhe harixhive, ngase ai aty e kritikon në mënyrë bindëse shkencore dhe atë duke u mbështetur në ajetin që edhe ata vetë mbështeteshin:

(إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ وَمَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ افْتَرَىٰ

إِثْمًا عَظِيمًا ﴿النساء: 48﴾)

“Allahu vërtetë nuk falë kur i bëhet shok Atij, ndërsa falë çdo gjë tjetër për atë që dëshiron...”; vëll. 2, 794-795, 1044-1045.

⁷⁷² El-E'raf, 143.

⁷⁷³ El-Kijame, 22-23.

⁷⁷⁴ El-Kehf, 110.

“*Atyre që bëjnë vepra të mira u takon e mira (Xhenneti) e edhe më tepër (e shohin Allahun)*”.⁷⁷⁵ Komentuesit në përgjithësi janë të mendimit edhe atë në bazë të transmetimit nga Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) se fraza: (edhe më shumë) nënkupton të parit e Zotit të Madhërishëm, dhe në këtë kontekst ekzistojnë shumë hadithe, si p.sh.:

(**إنكم سترون ربكم كما ترون القمر ليلة البدر لا تضامون في رؤيته**)
رواه البخاري

“*Ju vërtetë do ta shihni Zotin tuaj ashtu siç e shihni hënën e plotë dhe nuk shtyheni në shikimin e tij!*” Hadithin e të parit të Zotit e transmetojnë njëzet e një sahabë e dijetarë të mëdhenj (r.a.) dhe kështu është i njohur dhe s’mund të mohohet”.⁷⁷⁶

Kjo është e sakta rreth çështjes së pamjes nga aspekti racional dhe i Sheriatit. Zoti i Madhërishëm do të shihet në ditën e ahiretit nga banorët e Xhennetit, po jo në atë mënyrë që e shohim njeri tjetrin në këtë jetë. Nëse intelekti është i pastër, nuk refuzon një gjë të tillë,⁷⁷⁷ ngase nuk mund të paramendohet që besimtarët të privohen nga kënaqësia e shikimit të Zotit të Madhërishëm në ditën e Ahiretit.

Në jemi të privuar nga pamja e Tij në këtë botë, ngase Musai (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kërkoi prej Zotit të Madhërishëm që ta sheh, por Ai nuk ia plotësoi dëshirën atij, dhe kështu e kemi pranuar këtë vendim hyjnor dhe bëjmë durim me shpresë se do ta takojmë dhe do ta shohim Zotin e Madhërishëm në jetën e amshueshme të ahiretit, sepse nëse ndodh e kundërta, atëherë çfarë dallimi do të kishte në mes nesh dhe jobesimtarëve, për të cilët Zoti i Madhërishëm thotë:

([**المطففين: 15**] ﴿لَّحْجُوبُونَ يَوْمَ يَمْيزُ رَّبُّهُمْ عَنْ إِبْنِهِمْ كَلَّا﴾)

“*Jo dhe jo! Atë ditë do të jeni të penguar prej (ta shohin) Zotit të tyre*”.⁷⁷⁸ Nga aspekti i Sheriatit, ekzistojnë shumë ajete kur’anore dhe hadithe të transmetuara që argumentojnë dhe konfirmojnë pamjen e Zotit të Madhërishëm në ditën e Kiametit nga besimtarët in sha Allah.⁷⁷⁹

⁷⁷⁵ Junus, 26.

⁷⁷⁶ Nuruddin Ahmed ibn Mahmud ibn Ebu Bekër Sabuni, “*El-Bidajetu fi usuliddin*”; fq. 34-41.

⁷⁷⁷ El-Akhisari Hasan Kafi (El-Bosnevi), “*Reudātul-xhennat fi usulil-i’tikad*”; recensuan dr. Fikret Karçic, dhe dr. Ibrahim Muhamed Zejn, (Univerziteti Ndërkombëtar Islamik, Malajzi, 2002, f. 38).

⁷⁷⁸ El Mutaaffifin, 15.

⁷⁷⁹ Ebu Xha’fer El Tahavi, “*Sherhul-akijdetit-tahavijjeti*”; Bejrut, El mekteb-El islamij, bot. 4, 1991, f. 203.

Mëkatari i madh: **صاحب الكبيرة**

Përkrahja dhe mbrojtja e besimit të Ehli Sunnetit dhe Xhematit nga ana e Shejhut vërehet qartë edhe në shumë çështje të tjera të besimit, të cilat nuk kemi mundësi këtu ti theksojmë dhe do të mjaftohemi vetëm me disa prej tyre:

Në tefsirin e ajetit kur'anor:

([البقرة: 5] ﴿الْمُفْلِحُونَ هُمْ وَأُولَئِكَ﴾)

“Dhe ata janë të shpëtuarit”.⁷⁸⁰

Në një formë të rezymesë, ai thotë se mëkatarët muslimanë do të nxirren nga zjarri para se të marrin dënimin e merituar në zjarrin e xhehennemit dhe kjo është në kundërshtim me qëndrimin e mu'tezilëve,⁷⁸¹ ngase mëkatari i madh sipas tyre, do të jetë në një vend në mes dy vendeve, del nga besimi (imani), por nuk hy në kufër apo ai nuk është as besimtar e as jobesimtar dhe nëse vdes pa pendim (teube), do të hyjë përgjithmonë në zjarr.⁷⁸²

Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu i shqyrton edhe disa çështje të besimit dhe apolegetikës sipas esh'aritëve⁷⁸³, maturidive⁷⁸⁴, muhadithinëve, mu'tezilëve e harixhive, si p.sh., çështja e shtimit të besimit, çështja e përfitimit të haramit dhe se a konsiderohet kjo risk i fituar apo jo, etj.

Kjo e vërtetë dhe kjo përkrahje ndaj Ehli Sunnetit vërehen në tefsirin e Shejh Hafiz Ibrahim Dallit në ajetin kur'anor:

([البقرة: 3] ﴿بِالْغَيْبِ يُؤْمِنُونَ الَّذِينَ﴾)

“Të cilët e besojnë të fshehtën”.⁷⁸⁵ Kur e shqyrton çështjen e besimit, definicionin, përbërjen dhe kërkesat e tij sipas doktrinave të tilla,

⁷⁸⁰ El-Bekare, 5.

⁷⁸¹ “Ajka e kuptimeve...”; vëll. 1., f. 42.

⁷⁸² Nuruddin Ahmed ibn Mahmud ibn Ebu Bekër Sabuni, “El-bidajetu fîj usuliddin”; f. 80; “Sherhul-akidetit-tahavijjeti”; fq. 365-367 dhe 416-417.

⁷⁸³ Mbi themeluesin e medhhebit sunnit esh'arit Imam Ebu Hasan El-Eshariun, shih një hulumtim të studiuesit Hajredin Hoxha, i pabotuar, me titull: “Studimi i dy librave të imam Ebu Hasan El-Esh'ariut: “El-ibanetu an usulid-dijaneti”, dhe traktati: “Istihsanul-khaud fî ilmil-kelam”; nën mbikëqyrjen e prof. dr. Irfan Abdulhamid Fettah, (Allahu e mëshiroftë !) Universiteti Ndërkombëtar Islamik, Malajzi 1998.

⁷⁸⁴ Rreth disa çështjeve të rëndësishme të besimit të dy imamëve të njohur Ebu Hasan El-Esh'ariut dhe Ebu Mensur El Maturidiut, si dhe rreth çështjeve për të cilat kanë mendime të ndara në besim, shih Vehbi Sulejman El-Gavoqi, “Mesail fî ilmit-teuhijd”; bot. 1, 1991, fq. 19-32, 43-74.

⁷⁸⁵ El-Bekare, 3.

thekson edhe çështjen se a është besimi (التصديق) “tasdik” me zemër i mjaftueshëm për të shpëtuar nga dënimi e për të fituar lumturinë e përhershme? Shejhu (Zoti e mëshiroftë!) thekson se sipas medhhebit të Ebu Hasan El-Esh’ariut kjo mjafton për shpëtim,⁷⁸⁶ ndërsa sipas medhhebit të Imam Ebu Hanifes (Zoti e mëshiroftë!) kjo nuk mjafton, ngase patjetër të ketë dëshmi me fjalë pas besimit me zemër, nëse nuk ka

⁷⁸⁶ Këtë që e thekson Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu mund të jetë mendim i disa ithtarëve dhe nxënësve të Ebu El-Hasan El-Esh’ariut të cilët jetuan më vonë, si p.sh., Imam El Bakil-lani etj. Imam El-Bakilani në librin e tij, “**Babul-kauli fi ma’nal-ijman**”, thekson: “**Nëse ndokush thotë: “Na informoni se ç’kuptoni me iman (besim)?”;** Thuaj se nënkuptojmë besimin në Zotin e Madhërishëm!” Dituria dhe besimi janë në zemër. Nëse thuhet: “Çfarë argumenti keni për fjalët tua?”, thoni: “Është thënë se të gjithë gjuhëtarët janë unanim se imani nga aspekti etimologjik para zbritjes së Kur’anit dhe dërgimit të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është besim dhe se nuk njohin në gjuhën e tyre ndonjë iman tjetër”, dhe këtë e vërteton ajeti kur’anor:

(وَمَا أَنْتَ بِمُؤْمِنٍ لَّنَا وَلَوْ كُنَّا صَادِقِينَ) [يوسف: 17]

“Ti nuk do të na besosh neve edhe po të ishim të vërtetë” (Jusuf, 17), apo ti nuk na beson neve. Po ashtu përdoret edhe “filani beson në shefa-at” dhe “filani nuk beson në dënimin e varrit” etj. “Temhidul-evail ve telhisud-delail”; Ebu Bekër Muhamed ibn Tajjib ibn Xha’fer ibn Kasim El-Bakilani, recensoi Imamuddin Ahmed ibn Hajdar, Bejrut, Mues-sesetuth-the kafeti, bot. 1, 1987, f. 389. Ndërsa Ebu Hasan Esh’ariu, themelues i drejtimit esh’arit kelamist nuk e thekson një gjë të tillë në sqarimin e tij të besimit të Ehli Sunnetit dhe Xhematit në librin e tij “**El-ibanetu an usulid-dijaneti**”; Matba’atu Darul-Ensar, f. 20-23, por gjatë hulumtimit e studimit gjeta se disa dijetarë të njohur maturiditë si Nuruddin Ahmed ibn Mahmud ibn Ebu Bekër Es-Sabuni, i cili thotë: “**Shokët tanë dijetarë thonë se imani është besim në zemër dhe dëshmia është kusht për aplikimin e rregullave në këtë botë**”; Imam Ebu Hanifja e potencon këtë çështje në librin e tij “**El-Alimu vel-mute’al-limu**”; dhe kjo është zgjedhja e Shejh Imam Ebu Mensur Maturidiut dhe Husejn ibn Fadl El-Bexhelijut (Zoti i mëshiroftë!) dhe më e sakta nga dy transmetimet e Imam Ebu Hasen El esh’ariut, “**El-Bidaje fi usulid-din**”, f. 87-88. Atë që e thekson Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu është nga thëniet e esh’aritëve të mëvonshëm, të cilët mendonin se imani është vetëm besim dhe mjafton kaq për të qenë besimtar dhe për të shpëtuar nga dënimi në Ditën e Kiametit. Kjo thënie është njëra prej dy transmetimeve. Nga Ebu Hasen El esh’ariu transmetohet edhe një mendim tjetër që konsiderohet më i saktë nga dy mendimet, gjegjësisht thënia se besimi i tillë nuk mjafton, por duhet të ketë besim në zemër dhe dëshmi në fjalë për të pasur përgjegjësi në këtë botë. Ne anojmë kah mendimi i dytë, ngase mendojmë se është më i saktë. Pra, përveç besimit në zemër, duhet të ketë edhe dëshmi me fjalë që të eliminohen dyshimet, akuzat dhe hamendjet ndaj atij që beson dhe heshtë, e nuk na informon me fjalë për të parë se a është i sinqertë apo gënjeshtar në zemër, ngase në të kundërtën, shumë lehtë është sot që kemi njerëz që thonë se kanë iman dhe se janë besimtarë në zemër, ky pretendim ka nevojë për argument dhe këtu argument është dëshmia (konfirmimi) me fjalë, normal këtu futen edhe veprat e myslimanit.

([النحل : الْكَافِرُونَ وَأَكْثَرُهُمْ يُنْكِرُونَهَا ثُمَّ اللَّهُ نِعِمَّتْ يَعْرِفُونَ)

[83

“Ata i njohin të mirat e Allahut, pastaj i injorojnë”.⁷⁸⁸
Vetëm Zoti e di të vërtetën!⁷⁸⁹

V - Qëndrimi i tij ndaj njohjes së ajeteve të qarta dhe të paqarta(*El Muhkem vel Muteshabih*) (موقفه من المحكم والمتشابه)

Qëllimi i kësaj çështjeje

Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu nuk është larguar nga metoda e Ehli Sunnetit dhe Xhematit në çështjet e ajeteve të qarta dhe të paqarta. Unë nuk do të hyj në këtë çështje për të sqaruar e për t'i theksuar mendimet e dijetarëve se çka nënkuptohet me ajete të qarta dhe të paqarta, apo cili ajet është i qartë e cili jo. Dijetarët kanë disa mendime rreth kësaj çështjeje, por ato janë hipoteza. Unë këtu dëshiroj të shqyrtoj origjinën dhe rrënjët e kësaj çështjeje, rreth të cilës është folur e diskutuar shumë, si dhe a ka mundësi që të thelluarit në shkencë dhe dituri islame (*Er rasihune fil Ilm*) (الراسخون في العلم) të dinë të vërtetën dhe kuptimin e saktë të ajeteve të paqarta apo jo? Pse kanë mendime të ndryshme? Shkaku kryesor i mendimeve të ndryshme të dijetarëve që interesohen për këtë çështje si në

⁷⁸⁷ Rregullat e kësaj bote (parimet), si p.sh., larja me gusul, varrimi, namazi i xhenazes dhe trashëgimia janë disa parime që varen nga deklarata e dy dëshmimeve ose besimi me fjalë, sepse në të kundërtën, ai do të jetë besimtar te Zoti në ahiret, ndërsa jobesimtar te ne në këtë botë, sepse sipas dijetarit boshnjak të shek. XVII. Shejh Hasan Kafi El-Akhisarij, në librin e tij “*Raudatul-xhennat fi usulil-i’tikad*”; dëshmia është shenjë dhe kusht për t’i aplikuar normat islame mbi të...f. 30.

⁷⁸⁸ En-Nahl, 83.

⁷⁸⁹ “Ajka e kuptimeve...”; vëll. 1, fq. 33-36, 38.

وَأُخْرُ الْكِتَابِ أَمْ هُنَّ مُحْكَمَاتٌ ءَايَتٌ مِنْهُ الْكِتَابَ عَلَيْكَ أَنْزَلَ الَّذِي هُوَ
وَأَبْتِغَاءَ الْفِتْنَةِ ابْتِغَاءَ مِنْهُ تَشْبِهَ مَا فَيَتَّبِعُونَ زَيْغٌ قُلُوبِهِمْ فِي الَّذِينَ فَأَمَّا مُتَشَبِهَاتٌ
مِنْ كُلِّ بِهِ ءَامَنَّا يَقُولُونَ الْعِلْمِ فِي وَالرَّاسِخُونَ اللَّهُ إِلَّا تَأْوِيلَهُ يَعْلَمُ وَمَا تَأْوِيلَهُ
([آل عمران: 7] ﴿ ٧ 〉)

“Vetëm Zoti e di domethënien e tij...” - dhe në pjesën tjetër të ajetit që vijon më pas: “Po, pos Allahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë ne kemi besuar...”⁷⁹⁰

Në tefsirin e tij të ajetit të theksuar Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu transmeton fjalët e Imam Fahrudin Raziut, i cili thekson medhhebin e selefit, të cilët lejojnë ndalimin në ajetin: “Vetëm Allahu e di domethënien e tij”, dhe fillimin me: “Dijetarët e pajisur me dituri thonë: “Ne i kemi besuar atij (ajeteve që janë të paqarta)”. Imam Fahrudin Raziu sqaron se edhe medhhebi i halofit (te vonshmit) pranojnë ndalimin në: “Po, pos Allahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë dhe dijetarëve të pajisur me dituri.”⁷⁹¹

⁷⁹⁰ Ali Imran, 7.

⁷⁹¹ Po aty, vëll. 1; Më gjerësisht rreth kësaj çështje shih “El-Muvafekat fish-sheriatil-islamijjeti”; të Imam Shatibiut, i cili kur flet për ajetet e qarta dhe të paqarta thotë se ajetet e paqarta janë më pak në krahasim me ajetet e qarta, vëll. 3, fq. 79-92. Shih po ashtu edhe: Dr Jusuf El-Kardavi, “Kejfe nete’amelu me’al-Kur’anil-adhim”; fq. 270-283.

Unë them: Ajo që anoj dhe që mendoj se është e saktë në këtë çështje është që të mos mbështetemi në leximet e jashtëzakonshme të këtij ajeti. Disa prej tyre thonë se ndalimi në:

(وَمَا يَعْلَمُ تَأْوِيلَهُ إِلَّا اللَّهُ)

“Vetëm Allahu e di domethënien e tij”- është më i saktë dhe më i preferuar gjatë leximit dhe se domethënien e vërtetë të ajeteve të paqarta e di vetëm Zoti i Madhërishëm. Kjo e vërtetë përputhet me atë që preferoi për ndalim këtu. Kjo nuk kundërshtohet me përjashtimin dhe mundësinë e disa dijetarëve të thelluar në shkencë që të dinë domethënien e ajeteve të paqarta të Kur’anit nga ajo që na ka mësuar Zoti i Madhërishëm me Mëshirën e Tij. Kështu mendojnë unanimisht dijetarët. Së dyti, rregulla kryesore në çështjet e leximit ose transmetimit, në ndalim e fillim në lexim është transmetimi (الرواية) (rivajeti) dhe përcjellja e lexuesve të njohur të mëdhenj dhe hafizë

Mirëpo, Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu nuk jep më shumë detaje se këto që i theksova pak më parë dhe do të ishte më mirë sikur të zgjerohej pak më shumë në detajet e kësaj tematike, ashtu siç është zgjeruar në komentimin e çështjeve tjera.

Imam Shatibiu (Zoti e mëshiroftë!) në librin e tij “El-Muvafekat” thekson se ka dy mendime të komentuesve rreth ajetit: “*Dhe dijetarët e pajisur me dituri*”, dhe se kjo është çështje e ixhtihadit, por e vërteta është me mendimin e selefit”.⁷⁹²

Këto ishin disa çështje të mëdha të besimit, të cilat i shqyrtoi Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu në tefsirin e tij, i analizoi, i kritikoi, i sqaroi, dhe në detaje e dha të vërtetën e tyre.⁷⁹³

VI - Disa vështrime mbi tefsirin e Shejh Hafiz Ibrahim Dallit

a). Vështrimet pozitive:

- Largimi dhe distancimi i tij nga përdorimi i fjalëve dhe termeve të urryer e trivialë kundër të tjerëve, përveç kundërshtimit dhe metodës së tij të posaçme ndaj Beni Israilëve dhe çifutëve. Ai është i ashpër kundër tyre dhe e kritikon sjelljen dhe lëvizjet e

⁷⁹² Ebu Is'hak El shatibij, “**El-Muvafekat fish-Sheriatil-Islamijjeti**”; vëll. 3, f. 91.

⁷⁹³ Po aty, vëll. 2, f. 7-14; Më gjerësisht shih: Ebu Abdullah Muhamed ibn Behadir ibn Abdullah Ez-Zerkeshij, “**El-Burhan fij ulumil-Kur'an**”; recensoi Muhamed Ebu El-Fadl Ibrahim, Bejrut, Darul-ma'rife, 1391 hixhri, vëll. 1, fq. 347-348.

tyre jonjerëzore kundër pejgamberëve të tyre gjatë historisë dhe në kohën tonë të sotshme.

- Tefsiri i tij, nga aspekti i metodës, sqarimit dhe gjuhës është i lehtë dhe i këndshëm.
- Në shumë raste ai jep dy përkthime ose dy domethënie të një ajeti, nëse kuptimi i parë është i paqartë, dhe ky është argument mbi elokuencën dhe stilistikën e tij të lartë në gjuhë, ngase përdorë shumë terme të ndryshme me domethënie e kuptime të pasura. Fjalët e tij i kuptojnë të gjitha shtresat e njerëzve, intelektualë e të rëndomtë. Ai bën simbiozën në mes origjinalitetit dhe rregullave të gjuhës arabe dhe mes fjalëve të reja që i përdorë.
- Ekziston harmoni dhe ndërlidhje e fuqishme në mes kuptimeve të ajeteve që i komenton Shejhu, si dhe ka unitet tematik. Ashtu siç thashë, Shejhu nuk është marrë me çështje sekondare, ngase qëllimi kryesor i tij ishte që të sqarojë domethënien e drejtpërdrejtë nga Kur’ani dhe për këtë shkak e ka ngritur lartë vlerën dhe nivelin e këtij tefsiri, dhe këtë e vërteton edhe intelektu i komentuesit që karakterizohet me objektivitet dhe metodologji të pastër.
- Ai nuk ka qenë nën ndikimin e mendimeve dhe parimeve të shkollës reformiste racionale në tefsir, dhe kështu ai ka pasur mendime që dalloheshin tërësisht prej tyre.
- Nga ajo që kam lexuar nuk kam vërejtur se Shejhu ka bërë thirrje për afrimin e feve, gjegjësisht me hebraizmin, krishterimin apo ndonjë fraksion tjetër. Përkundrazi kam hasur një urrejtje të madhe të tij posaçërisht ndaj çifutëve,⁷⁹⁴ për shkak të devijimeve të fjalëve të Allahut xh.sh. nga domethëniet e tyre të vërteta, për shkak të çrregullimeve në tokë si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen. Ky është një aspekt i rëndësishëm dhe i madh, me të cilin karakterizohet Shejhu dhe meriton fjalë miradije, ngase ata vërtetë meritojnë një gjë të tillë, bile ata meritojnë edhe më keq.
- Gjatë leximit të tefsirit të tij nuk kam gjetur ndonjë mendim të veçantë të tij apo të huazuar prej ndokujt tjetër...

⁷⁹⁴ “**Ajka e kuptimeve të Kur’ani Qerimit**”; vëll. 1, f. 150, 191, 202, 203; Ismail Raji Al-Faruqi, “**Islam and other faiths**”; edited by Ataullah Siddiqi, The Islamic Foundation and The International Institute of Islamic Thought, Markfield, Leicester, UK, 72-91, 161-194.

- Ai kishte potencial të madh në nxjerrjen e parimeve të Sheriatit, si p.sh.: tepër më pëlqeu përgatitja i tij e mësimave dhe leksioneve mbi rëndësinë dhe domosdoshmërinë e konsultimit, shura-së si dhe mbi rregullën juridike usuliste për të pranuar dëmin personal në mënyrë që të evitohet dëmi i përgjithshëm, nga ajeti kur'anor:

([البقرة: 30] ﴿ خَلِيفَةً لِّأَرْضِ فِي جَاعِلٌ إِنَّي لَلْمَلَكَةِ رُتُّكَ قَالَ وَإِذْ)

“*(Përkujto Muhammed) kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës”.*⁷⁹⁵ Nuk kam dëgjuar e as nuk kam lexuar fjalë të tilla më parë nga ndonjë tjetër.”⁷⁹⁶

- Të kuptuarit e tij korrekt dhe të saktë të gjuhës arabe si dhe njohuritë e tij mbi përdorimin e fjalëve dhe termeve arabe. Më pëlqen domethënia precize që ia jep ajetit dhe nuk kam gjetur asnjë vërejtje në këtë aspekt (nga aspekti i të kuptuarit korrekt e të shëndoshë të ajetit në gjuhën arabe). Sipas mendimit tim, ky ishte faktori kryesor që e shtyu të zhytet në komentimin e Librit të Zotit të Madhërishëm.

b). Vështrimet negative:

- Shejhu (Zoti e mëshiroftë!) la në neglizhencë një aspekt të rëndësishëm në tefsirin e tij, gjegjësisht mos verifikimi i fjalëve të tij dhe mos shenimi i numrit të faqes dhe vëllimit prej ku i merrte fjalët, bile ai nuk i ka theksuar as emrat e titujt e disa librave tjerë, përpos tefsirit në asnjë mënyrë. Tefsiri i tij, po ashtu, nuk e thekson numrin e ajeteve dhe kështu ajetet tek ai janë të shënuar pa numër.
- Shejhu e ka lënë pas dore edhe një aspekt tjetër metodologjik në tefsirin e tij, gjegjësisht nuk i ka theksuar burimet e transmetimeve prej të cilëve transmetonte, nuk i ka nxjerrë hadithet fisnike të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e as fjalët e sahabëve dhe kështu e ka lënë lexuesin të hutuar, ndoshta e pranon e ndoshta e përgënjeshton...

⁷⁹⁵ El-Bekare, 30.

⁷⁹⁶ “*Ajka e kuptimeve...*”; vëll. 1, fq. 86-88.

- Ekzistojnë gabime shtypi në tefsirin e tij, si dhe ndonjëherë ekziston ripërsëritje e disa kuptimeve që i ka theksuar, posaçërisht të të njëjtit ajet.
- Nuk dihet se ku është fillimi e ku është mbarimi i fjalëve të transmetuara, nuk ka kllapa të vogla e as të mëdha, dhe kështu lexuesi i rëndomtë nuk ka mundësi të bëjë dallimin në mes fjalëve të Shejhut dhe fjalëve të transmetuara ose të huazuara, përpos në një vend ku e kam gjetur se e aplikon këtë metodologji që e them.⁷⁹⁷

c). Vështrime të përgjithshme tematike:

- Gjatë leximit të tefsirit të tij, në shumë vende kam hasur, bile edhe e kam theksuar se Shejhu (Zoti e mëshiroftë!) është përkthyes prej arabishtes në shqip, dhe bartës i fjalëve të komentuesve të zgjedhur prej arabishtes në shqip, dhe sikur roli i Shejhut ka qenë vetëm të transmetojë e të përkthejë, dhe në këtë çështje ka diçka që nuk është në rregull!? Unë them se kjo çështje ka nevojë për argumente e fakte të tjera, dhe gjatë leximit tim kam hasur disa argumente të tilla, ngase në shumë vende ai vetë deklaroi se është " përkthyes " apo " ky mendim është i përkthyer " apo " filloj në përkthimin e kësaj sure " si dhe " kur e përkthejmë suren ".⁷⁹⁸

Sipas mendimit tim, ai është dashur të fillojë me fjalët: "Filloj me komentimin e sures" ose "filloj me sqarimin e domethënies të kësaj sure", apo "këto janë disa ide e mendime nga kjo sure", apo "këtë e kuptoi rob i varfër nga fjalët e dijetarëve të tefsirit rreth këtij ajeti...", e kështu me radhë. Megjithatë unë me bindje të plotë them se personaliteti i tij si komentues vërehet qartë në shumë vende të tefsirit të tij (Zoti e mëshiroftë!)

ç). Vlerësimi i përgjithshëm i komentuesit dhe komentimit:

Dëshiroj që ky vështrim të jetë në formë të pyetjeve dhe përgjigjeve që të jemi më objektivë dhe më afër realitetit.

⁷⁹⁷ Po aty, vëll. 2, fq. 1088-1089.

⁷⁹⁸ Për t'u bindur në këtë të vërtetë, shiko në tefsirin e tij faqet vijuese: vëll. 1, fq. 94, 198, 262, 377, 560 dhe vëll. 2, f. 1156.

Shtroj pyetjen: “Ky komentues, sa i ka plotësuar kushtet e nevojshme për tefsir të Kur'anit, të cilat i theksojnë disa dijetarë, që të merret me komentimin e Librit të Zotit?” Them, gjegjësisht përgjigjem, se nga ajo që pashë gjatë leximit të tefsirit të këtij dijetari, vërejta se ai është njohës i spikatur i gjuhës arabe dhe ky është një ndër kushtet më të rëndësishme që duhet t'i ketë ai që dëshiron të komentojë diçka nga Libri i Zotit të Madhërishëm. Kjo argumentohet me të kuptuarit e tij të mirë të fjalës arabe dhe çdo fjalë e rikthen në rrënjë e pastaj e analizon nga aspekti sintaksor dhe morfologjik. Njohja precize dhe e shëndoshë e gjuhës arabe dhe e gjuhës shqipe i ndihmoi që të jep përkthim preciz të fjalës që e komenton ose që e sqaron. Shejhu e posedonte këtë kusht themelor dhe arabishtja e tij dallohej me një stil të lartë, ndaj dhe me plotë të drejtë meriton fjalë miradije për këtë gjë.

Ai, po ashtu, i posedonte edhe kushtet e tjera që duhet t'i ketë një komentues, si p.sh., njohuritë apo shkencat mbi njohjen e ajeteve mekase e medinase (**المكي و المدني**) (*El mekkij vel medenij*), njohjen e shkaqeve të zbritjes (*Esbabun nuzul*), (**أسباب النزول**) njohjen e ajeteve të përgjithshme e të posaçme (*El a'm vel has*), (**العام و الخاص**) absolute e të përkufizuara (*El mutlak vel mukajed*) (**المطلق و المقيد**), *el muxhmel*,) (**المجمل**) *el mufesser*, (**المفسر**) njohjen e metodave të arabëve dhe traditave të xhahilijetit dhe edukatën e lartë islame, të cilën duhet ta ketë si besimtar i rëndomtë dhe komentues, të mos jetë fanatik dhe të jetë objektiv.

Sa u përket çështjeve të njohura juridike e kelamiste dhe të ixhtihadit në to si dhe hulumtimit të çështjeve tjera, them se komentuesi nuk është marrë me çështje të tilla, dhe siç thashë më parë, kjo është bërë për shkak të natyrës së të menduarit shqiptar, e cila nuk kishte nevojë për të diskutuar rreth këtyre çështjeve filozofike e kelamiste.

Për sa i përket shfaqjes së personalitetit të autorit në tefsir, them se ai vërtetë ka qenë përkthyes dhe komentues preciz i mendimeve të komentuesve të mëdhenj, klasikë e bashkëkohorë. Ai i zgjedh mendimet e tyre dhe me precizitet i transmeton si dhe zgjedh mendimet e tyre të preferuara rreth çështjeve të ndryshme. Në asnjë mënyrë kjo nuk nënkupton se ai nuk ka pasur personalitet dhe qëndrim, ngase ai ka zgjedhur dhe preferuar nga shumë mendime dhe s'ka dyshim se një zgjedhje e tillë nuk është fare e lehtë, përkundrazi...

Ai që zgjedh mendimin më të mirë duhet të ketë dituri dhe argumente të forta e jo të veprojë me hamendje. Në këtë mënyrë kanë vepruar dijetarët që në kohërat e lashta. Secili që sjell diçka të re, patjetër

të kishte formuar mendimin në bazë të ixhtihadeve dhe parimeve të dijetarëve e hulumtuesve paraprakë. Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu i transmetoi dhe i përktheu mendimet e dijetarëve të tillë si dhe në bazë të mendimeve të tyre, ai i formoi edhe mendimet dhe idetë e tij personale.

Sa i përket natyrës së tefsirit të Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu, mund të themi se i takon grupit të tefsirit racional dhe tradicional (التفسير بالرأي الجائز) (Et tefsir bir re'jil xhaiz vel bil me'thur), ngase Shejhu aty bën një simbiozë në mes tefsirit racional që mbështetet në ixhtihad të lejuar e në shkencë të vërtetë dhe në mes gjurmëve tradicionale, qoftë nga hadithet apo qoftë nga fjalët e sahabëve dhe tabi'inëve. Mbështetja e tij në racionalizëm është më e madhe, ndërsa në tradicionalizëm është më e kufizuar dhe kjo vërehet qartë në tefsirin e tij. Problemi është se gjurmët, transmetimet janë të pa nxjerra nga burimet e tyre dhe nuk iu përkasin pronarëve. Është për t'u habitur se pse Shejhu (Zoti e mëshiroftë!) nuk e ka theksuar këtë çështje, gjegjësisht çështjen e metodës se tij në tefsir !?!

Në pyetjen se a vërehen drejtime të devijuara në tefsirin e tij, si p.sh., drejtimi sufist, simbolik, ateist, filosofik, apologjetik, etj. Them se (falë Zotit!) nuk kam gjetur drejtime të tilla të devijuara e të humbura në tefsirin e Shejh Hafiz Ibrahim Dalliu. Ai mbase e ka lexuar thënien e Imam Gazaliut: *"I përjetova metodat e apologjetëve dhe rrugët filosofike dhe nuk i pashë se e shërojnë të sëmurin e as që e (shuajnë etjen) drejtojnë të humburin, si dhe e pashë se rruga më e vërtetë është ajo e Kur'anit"*.

Po ashtu nuk kam vërejtur tek ai fanatizëm doktrinar ose ideologjik në asnjë mënyrë, dhe ishte larg të gjitha cilësive që dobësojnë njerëzinë dhe personalitetin musliman. Medhhebi akaidologjik, ideologjik sunnit maturidit dhe juridik që vërehet në tefsirin e tij është doktrinë sunnite (sipas besimit të Ehli Sunnetit dhe Xhematit) në bazë të metodës dhe mendimit të Imam Ebu Mensur Maturidiut (Zoti e mëshiroftë!). Sa i përket medhhebit juridik, ai i përkiste medhhebit hanefit, ngase ky medhheb dominon në territorin e Ballkanit.

Ajo që e dallon këtë tefsir nga tefsiret e tjerë të dijetarëve shqiptarë, është fakti se ky është tefsiri i parë metodologjik që është shkruar në fillim të shek. XX, dhe për këtë shkak gëzon nder të lartë, pozitë të lartë dhe rëndësi paraprijëse në territoret shqiptare, posaçërisht në shoqërinë shqiptare islame.

Ky tefsir është i lehtë dhe i këndshëm, e pëlqen secili që e lexon dhe ka metodë atraktive. Komentuesi këtu ka bërë një harmonizim në mes origjinalitetit, tradicionales dhe asaj moderne gjatë shqyrtimit të tematikave islame. Karakteristikë e këtij tefsiri është se nuk ka fjalë të tepërta, të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me tekstin.

Zoti e mëshiroftë Shejhun dhe komentuesin e çmuar Hafiz Ibrahim Dalli, me mëshirën e Tij të madhe!; Kurse neve na bëftë si ai dhe na takoftë me të në xhennetet e begatshme! Amin!

Dhe në fund, e falënderoj Allahun, Zotin e botëve!

Fundi dhe rezultatet e hulumtimit

Falënderoj Zotin, i cili na udhëzoi dhe na mundësoi një gjë të tillë, sepse nuk do të udhëzoheshim e as nuk do të mund ta bënim këtë, sikur të mos na udhëzonte Zoti i Madhërishëm dhe të mos na mundësonte një gjë të tillë! Dëshmoj se zotëria ynë dhe peygamberi ynë, Muhammedi është robi i Tij, i dashuri i Tij, i zgjedhuri i Tij nga krijesat dhe i Dërguari i Tij. Salavatet e Zotit qofshin mbi të, mbi Familjen e Tij, mbi sahabet dhe tabiinët e pastër, e të mirë, deri në Ditën e Gjykimit! Falënderoj Zotin që më ofroi mundësinë për ta përfunduar këtë disertacion studimor! Nga ky studim modest nxora rezultate të rëndësishme, të cilat preferoj që t'i theksoj me radhë për t'i ofruar lehtësim lexuesit të respektuar.

Rezultatet më të rëndësishme të këtij studimi janë:

Historia e popullit shqiptar musliman është histori e shtrembëruar dhe falsifikuar dhe s'do mend që dora e zezë dhe e fshehtë komuniste, sllave, ruse, bullgare e shqiptare ndihmoi në shënimin, në formimin e metodave dhe të përpilimit të teksteve të saj. Kjo formë komuniste, në shkallë të parë është përqendruar në luftimin dhe deformimin e Islamit dhe muslimanëve. Studimi e zbulon të kundërtën e asaj që është theksuar dhe shkruar. Begati e madhe e Zotit ishte për popullin shqiptar që e pranoi Islamin, ngase Islami i shpëtoi dhe i nxori nga errësira dhe humnera e pabesimit, idhujtarisë, ateizmit, shkatërrimit asimilimit dhe zhdukjes në dritën e besimit, vigjilencës, udhëzimit dhe qëndrueshmërisë. Çështja tjetër e rëndësishme është se Islami është përhapur në paqe në këto vende e jo me dhunë dhe shpatë - ashtu siç shkruhet dhe shënohet në literaturën historike shqiptare të devijuar, si në të tashmen ashtu edhe në të kaluarën. Njerëzit e pranonin fenë e Zotit në grupe me dëshirë, me vullnet të lirë dhe në bazë të kësaj, duhet që të rishkruhet dhe të riformulohet historia e jonë shqiptare islame me obektivitet.

Ky studim zbulon urrejtjen dhe intrigat e mëdha evropiane perëndimore kolonialiste ndaj Islamit dhe muslimanëve në këtë periudhë të vështirë të kohës së re. Këto fuqi zullumqare i përdorën të gjitha mundësitë dhe të gjitha fuqitë për ta shkatërruar halifatin osman islamik.

Me rrëzimin e shtetit osman humbën dhe u zhdukën shumë interesa ekonomike, politike e gjeografike të muslimanëve në përgjithësi dhe të shqiptarëve në veçanti, ngase historia e tyre është e lidhur ngushtë me shtetin osman për disa shekuj me radhë... Shqiptarët e mbronin shtetin osman me trimërinë e tyre të rrallë, me fuqinë e jashtëzakonshme, me besnikërinë e madhe, me bujarinë fisnike dhe me idetë e tyre të ndritshme, precize dhe të spikatura. Të gjitha këto cilësi i posedonin udhëheqësit e popullit shqiptar muslimanë dhe i shfrytëzonin në interes dhe në shërbim të shtetit osman.

Studimi, po ashtu, zbuloi një sërë faktorësh, të brendshëm e të jashtëm që shkaktuan shkatërrimin dhe rënien e halifatit islamik. Si faktor kryesor i rrënimin të tillë ishin reformat administrative e ushtarake që u implementuan në ligjin osman(tanzimati), që ishin projekte sioniste-çifute (masone), kryqtare evropiane-katolike dhe pansllaviste ruse-ortodokse e që njiheshin me emrin “Tanzimate” dhe që ishin hap i parë për rrënimin e halifatit. Rënia e Perandorisë Osmane ishte katastrofë e madhe për muslimanët në botë, posaçërisht për vendet ballkanike.

Studimi zbuloi edhe shkakun e kryengritjes së shqiptarëve dhe aleatëve të tyre kundër shtetit osman përmes ngjalljes së rrymës kombëtare si reagim nga ajo që zhvillohej në shtetet fqinje sllave për shkak të humbjes së ndihmuesit dhe përkrahësit të shqiptarëve. Interesat e tyre fillojnë të kërcënohen nga rreziku i ambicieve të shteteve perëndimore dhe shteteve sllave fqinje. Kjo kryengritje shqiptare ka luajtur rol të madh në lëkundjen dhe në shkatërrimin e trupit të shtetit osman, ngase ata proklamuan pavarësinë dhe ndarjen e tyre nga shteti osman dhe nga Shejhul-Islami, si dhe i shpallën luftë.

Ky studim, po ashtu, zbuloi arsyet e migrimit dhe dëbimit të muslimanëve nga Ballkani dhe shpërndarjen e tyre në vende e shtete të largëta. Operacioni i pastrimit nacional –spastrimi etnik nga ana e serbëve, gjegjësisht qarqet pansllaviste ruso-serbe, ishte realizimi i ëndrrave të të krishterëve ortodoksë për t’i pushtuar vendet e tilla ballkanike dhe për të ç’rrënjosur Islamin nga këto troje.

Muslimanët tregonin interes të madh ndaj çështjeve të fesë së tyre, dhe këtë e vërtetojnë shumë fenomene, si p.sh., interesimi për hifzin e Kur’anit, për t’ua mësuar fëmijëve të tyre Kur’anin përmendësh, interesimi për ndërtimin dhe ngritjen e xhamive, dërgimi i fëmijëve të tyre në shtetet arabe dhe islame për të mësuar etj. Me kalimin e kohës niveli intelektual i tyre rritet aq shumë, saqë fillojnë të shqyrtojnë e analizojnë disa çështje të mëdha fetare e shoqërore, siç është çështja e çlirimit të

femrës shqiptare myslimane -emancipimit të saj, pranimi i alfabetit latin etj.

Nga studimi im pashë se niveli i dialogut dhe natyra e polemikës ishte shumë e lartë në mesin e intelektualëve shqiptarë. Ne, po ashtu, pamë se në mesin e mendimtarëve dhe hoxhallarëve që i mbronin parimet fetare kishte të atillë që kishin qëndrime kategorike kundër ideve destruktive dhe anti-islame, si p.sh.: Hoxha Hafiz Ismet Dibra, Haxhi Vehbi Dibra etj.. Në anën tjetër pamë një rrymë tjetër që anon kah ripërtëritja-reforma dhe modernizimi, siç ishte shkrimtari dhe mendimtari shqiptar Mehdi Frashëri etj.

Nga ky dialog dhe nga ky konflikt ideologjik e fetar në shoqërinë shqiptare, vërejmë rolin dhe rëndësinë e revistës së vetme islame në Shqipëri “Zani i Naltë” që u botua gjatë viteve 1923-1938 nga Këshilli i Lartë i Çështjeve Islame (Komuniteti Islamik).

Studimi zbuloi dëmet e mëdha fetare që i kanë përjetuar muslimanët shqiptarë, për shkak të anulimit të disa parimeve fetare islame në Shqipëri, si p.sh.: proklamimi zyrtar i ateizmit dhe laicizmit në Shqipëri, heqja e mbulesës islame, mbyllja e një numri të madh të xhamive, ndryshimi i të drejtës civile që kishte të bëjë me martesën dhe zëvendësimi i Sheriatit islam me ligjet perëndimore.

Ky studim konfirmon orvatjet dhe veprat e personaliteteve të mëdhenj shkencor e të njohur shqiptarë, si dhe rezistencën e tyre të madhe kundër sfidave laike e komuniste në fillim të shek. XX. Nga dijetarët e tillë e zgjodha mendimtarin dhe reformatorin islam, Hafiz Ali Korça, (Zoti e mëshiroftë!) ngase ishte më eklatant në rrethana të tilla.

Gjatë këtij studimi historik të gjendjes fetare, shoqërore e politike në territoret shqiptare, përfitova njohuri mbi drejtimet, trendët më të rëndësishme ideologjike e fetare që janë përhapur dhe që janë paraqitur në shkrimet e dijetarëve shqiptarë rreth studimeve kur’anore, posaçërisht në tefsir dhe si rezultat i gjendjes së tillë ideologjike shoqërore në tokat e tyre dhe në botën arabe e islame u formua një rrymë ideologjike reformiste shoqërore, e udhëheqës i kësaj rryme ishte mendimtari islam Hafiz Ali Korça. Studimi konfirmon se ai ka qenë nën ndikimin e madh të ideve dhe mendimeve të udhëheqësve të shkollës reformiste racionale, si p.sh., nën ndikimin e ideve të Shejh Muhamed Abduhusë, Shejh Reshid Ridasë, etj. Në këtë hulumtim konfirmova animin e tij kah kjo rrymë në bazë të qëndrimit të tij ndaj ngjarjes së sihrit, të cilën e transmeton Imam Buhariu, ngase sipas tij, ky hadith kundërshton mendjen dhe Sheriatin. Unë e sqarova pavlefshmërinë dhe refuzimin e këtij qëndrimi.

Studimi, po ashtu, zbuloi edhe ekzistimin e një rryme e doktrine tjetër në shkrimet dhe në studimet e Kur'anit Fisnik nga ana e dijetarëve shqiptarë, posaçërisht në tefsir. Ky ishte një drejtim ideologjik sunnit maturidit dhe kishte të bëjë me çështjet e besimit. Prijës i këtij drejtimi ishte dijetari dhe Shejhu Hafiz Ibrahim Dalliu. Në bazë të studimit të ideve të tij rreth çështjeve të besimit, vërejta se ndonjëherë aplikon metodën e komentimit të ajeteve të Cilësive dhe ndonjëherë e praktikon metodën e selefit dhe të Ehli Sunnetit dhe Xhematit në disa çështje tjera. E në disa çështje tjera, ai ishte nën ndikimin e mu'tezilëve, ashtu siç kishin vepruar edhe disa imamë maturiditë paraprakë, dhe kështu ai i ndoqi ata në çështjen e verifikimit të mirës dhe të keqes sipas racionale, dhe këtë e argumentuam me shembuj, e më pas sqaruam të vërtetën rreth kësaj çështjeje duke thënë se më i saktë këtu është mendimi i selefit të devotshëm përfshirë Imam Ebu Hanifen, Imam Ebu Mensur Maturidiun dhe Shejhul-Islam, Ibn Tejmijen (Zoti i mëshiroftë të gjithë!), të cilët thoshin se Cilësitë e tilla duhet të konfirmohen ashtu siç janë shpallur pa krahasim, privim apo personifikim, ngase vetëm Zoti i Madhërishtëm e di domethënien e vërtetë të tyre.

Unë po ashtu zbulova edhe dy drejtime tjera:

1). Drejtimi filosofik gjysmë-ateist reformist që ishte larg dijetarëve të Ehli Sunnetit dhe Xhematit. Arsyeja e formimit të këtij drejtimi është se filozofi hoxhë Hasan Tahsini ishte nën ndikimin e filosofisë iluministe evropiane, e cila filloi të përhapet në Evropë në shek. XVII. Filozofia e kësaj lëvizje ka një parim esencial, gjegjësisht e largon intelektin nga shpallja hyjnore, gjoja se duhet të ekzistojë feja e prodhuar nga intelektu, si dhe duhet të braktisen bestytnitë fetare, se Zoti kur i krijoi krijesat dhe natyrën, ia la natyrës që t'i kontrollojë ligjet e saj dhe se Zoti nuk ka kurrfarë ndërhyrje në të, e as që ka të drejtë të ndërhyjë në rregullim e lëvizje. Këto ide gjysmë-ateiste i vërejta në tefsirin dhe në sqarimin e tij të disa ajeteve dhe fenomeneve natyrore sipas filosofisë së lëvizjes iluministe dhe filosofisë deiste. Ky studim e rrënoi dhe e shkatërroi këtë drejtim, ngase i tregon pasojat dhe papërshtatshmërinë e tij në bazë të shumë ajeteve kur'anore dhe haditheve të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!);

2). Drejtimi shkencor në tefsir dhe në të kuptuarit e Kur'anit Fisnik në kohën bashkëkohore që u pranua dhe u përhap në ambientet shkencore. Po ashtu pashë se njerëzit ndahen në disa drejtime kur bisedohet për këtë çështje, madje disa edhe e mohojnë tërësisht!!! Prijës i këtij drejtimi tek shqiptarët në kohën bashkëkohore është dr. Ali Fahri Iljazi. Unë e sqarova autenticitetin e këtij drejtimi në të kuptuarit e Librit të Zotit të

Madhërishëm, por me kushtet, rregullat dhe parimet që i theksojnë disa shkencëtarë, duke e zgjedhur mendimin moderativ rreth kësaj çështje.

Studimi zbuloi nivelin e lartë intelektual të shqiptarëve, fuqinë e tyre shkencore në kohën bashkëkohore, fuqinë e tyre deduktive në ajetet kur'anore dhe shtjellimin e shumë temave të ndryshme shkencore. Ata nuk kanë qenë vetëm transmetues dhe përkthyes nga gjuhët e tjera, por kishin edhe mendime e qëndrime personale, të cilat historia i ka shënuar dhe se nuk kanë qenë viktimë e përkthimeve të shumta, përkundrazi. Ata vepronin drejtpërdrejtë në tekstet kur'anore dhe për së afërmi për të arritur të vërtetën e kërkuar. Pra, ata ishin kalorës në mejdane të tilla shkencore, komentuese dhe letrare.

Ky studim modest konfirmoi dashurinë e dijetarëve shqiptarë ndaj Kur'anit Fisnik, vlerësimin dhe mbështetjen e tyre në të, gjatë periudhave më të vështira kohore e historike si në laicizëm, komunizëm, ateizëm, diktaturë, në burg, internim, maltretim, etj. Ata po ashtu kishin interesim të madh për ta studiuar, analizuar, komentuar e mësuar përmendësh Kur'anin Fisnik që nga ditët e para të përhapjes së Islamit në mesin dhe në shoqërinë e tyre.

Nga rezultatet e tjera të rëndësishme është edhe fakti se duhet të shtohet puna kolektive institucionale e palodhshme për ta rikthyer formën origjinale të Islamit në mendjen dhe në trurin e shqiptarëve, ngase ky studim vërteton se ekziston një urrejtje e madhe ndaj fesë islame nga ana e disa mendimtarëve shqiptarë, si në të kaluarën, ashtu edhe në të tashmen, dhe ndoshta kjo ndodh për shkak të ndikimit laik, komunist-ateist për deformimin e fesë, me qëllim që të ikin dhe të largohen njerëzit prej saj. Unë po ashtu i porosis hulumtuesit që të studiojnë dhe hulumtojnë edhe më shumë dijetarët e tillë shqiptarë, ngase ata kanë edhe më shumë role të tjera përveç atyre që studiova. Të tillët presin që hulumtuesit objektivë të heqin pluhurin prej veprave të tyre dhe të flasin për aktivitetet e tyre shkencore e patriotike.

Këto ishin disa rezultate shkencore që i përfitova gjatë këtij studimi modest përplot katër vite. Nuk them e as që proklamoj se kam theksuar çdo gjë rreth këtij aspekti studimor, por kjo ishte një përpjekje individuale brenda kufijve të mia intelektuale dhe një tematikë për të shfaqur disa shembuj të zgjedhur nga dijetarët shqiptarë në kohën e re, si dhe për të sqaruar qëndrimin e tyre ndaj disa çështjeve kur'anore dhe aftësinë e tyre për t'u përballur drejtpërdrejtë me tekstet kur'anore në implementimin e tyre në jetën e përgjithshme intelektuale. Ky studim ka natyrë specifike dhe është i vetëm në këtë aspekt, ngase gjerësisht studion aspektin historik, politik, intelektual, fetar, e komentues nga aspekti i

pastër islamik. Në bazë të informatave të mia nuk është bërë një gjë e tillë deri ne momentin kur po shkruhen këto rreshta. Vërtet u lodha shumë disa vite me radhe, derisa arrita në këto rezultate dhe vetëm Zoti e di këtë lodhje timen, ngase lënda shkencore është e shpërndarë në vepra e literaturë, pastaj natyra e hulumtimi kishte të bëjë me përkthim dhe me bartjen e mendimeve të shpërndara ne burime te ndryshme, si dhe ishte vështirë të gjej literaturën dhe librat origjinale.... Gjithashtu u ballafaqova me lodhje e harxhime financiare personale, ngase nuk pata ndonjë ndihmë financiare nga institucionet shkencore e universitare për t'i siguruar burimet origjinale, e pastaj për t'i studiuar. Përveç ndihmës së Allahut të Madhërishëm, u mbështeta në harxhimet e mia personale, por falë ndihmës së Tij i tejkalova të gjitha vështirësitë, me të cilat u ballafaqova gjatë kësaj rruge goxha të vështirë!

Në fund, lus Zotin e Madhërishëm e të Fuqishëm që t'i kem ofruar bibliotekës islame arabe në përgjithësi dhe lexuesve shqiptarë në veçanti një punim të vlefshëm shkencor. Nëse e kam qëlluar, kjo është prej Zotit të Madhërishëm e nëse kam gabuar, atëherë kjo është prej meje dhe djallit (larg qoftë nga ne!).

Si në fillim ashtu edhe në mbarim falënderoj Allahun e Madhërishëm! Salavatet e Allahut të Madhërishëm gjithnjë qofshin mbi zotëriun dhe Pejgamberin tonë, Muhammedin dhe mbi Familjen e tij dhe sahabët fisnik!

Lutja ime e fundit do të ishte: “Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve!”

*Në Kuala Lumpur, Malajzi,
më 23. 03. 2003.*

PJESA E PESTË

**الاتجاه الاجتماعي في تفسير القرآن الكريم عند علماء
الألبان في العصر الحديث**

**DOKTRINA SHOQËRORE NË TEFSIRIN E KUR'ANIT TE
DIJETARËT SHQIPTARË NË KOHËN BASHKËKOHORE**

**STUDIMI ANALITIK DHE KRITIK I METODËS SË HOXHËS
DHE MENDIMTARIT HAXHI SHERIF AHMETI**

KUR'ANI-PËRKTHIM ME KOMENTIM NË GJUHËN SHQIPE

PËRKTHEU DHE KOMENTOI: HAXHI SHERIF AHMETI

Nderoi për shtypjen e Kur'anit Fisnik dhe përkthimit të tij
me komentim, shërbyesi i Dy Haremave (Qabesë dhe Xhamisë së
Pejgamberit a.s.), Mbreti Fehd ibn Abdulaziz Al-Saudi, Mbreti i
Arabisë Saudite.

KAPITULLI I PARË

NJOHURI MBI KËTË TEFSIR TË THUKTË

Ky kapitull ndahet në disa nëntituj:

1: Njohuri mbi hoxhën komentues (Zoti e mëshiroftë)- vendlindja, arsimi, veprat dhe vdekja:

Hoxha dhe mendimtari i njohur Haxhi Sherif Ahmeti u lind në vitin 1920 në fshatin Gumnasellë, komuna e Lipjanit, Kosovë. Shkollën fillore e kreu në një fshat tjetër që quhej Banullë, ndërsa Medresenë e mesme fetare “Alaudin” e përfundoi në vitin 1944. Në vitin 1965 caktohet mësimdhënës po në të njëjtën Medrese ku edhe kishte diplomuar.

Në vitin 1970 u caktua drejtor i Medresesë, post ky që e mbajti deri në vitin 1984. Në vitin 1985 caktohet Myfti i përgjithshëm i Kosovës. Në këtë post qëndroi deri në vitin 1990, kur edhe u pensionua. Në vitin 1992, kur u hap për herë të parë në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë, Fakulteti Studimeve Islame, Haxhi Sherif Ahmeti angazhohet si mësimdhënës.

Ai (Zoti e mëshiroftë!) u bë i njohur nga prezenca e tij e madhe nëpër takime e qarqe shkencore te dijetarëve. Ai mësoi nga Hoxha Ahmed Menduhi në shkollën fetare Pirinaz në Prishtinë dhjetë vjet me radhë, ku edhe diplomoi.

Është e vërtetë se hoxha (Zoti e mëshiroftë!) nuk ka mësuar nga profesorët dhe mësimdhënësit arabë, e as në shtetet arabe, madje as që ka diplomuar në universitetet arabe dhe islame. Duke i marrë parasysh gjithë këto fakte, ai përsëri arriti që me sukses ta mësojë gjuhën arabe nga qarqet mësimore, në të cilat prezantonte para hoxhallarëve dhe ulemasë shqiptare. Zoti ia hapi zemrën dhe ia mundësoi që të përfitojë dituri nga shkencat fetare dhe arabe, dhe tërë kjo dituri ia hapi dyert që të fillojë me projektin madhor të tefsirit të Kur’anit Fisnik. Padyshim që Zoti këtë dhunti ia jep atij që dëshiron Ai. Vetëm Zoti është i Gjithëfuqishëm dhe i Madhërishëm.

VEPRIMTARIA:

Në vitin 1968 përktheu nga gjuha boshnjake në shqip librin e njohur islamik “Ilmihali”,⁷⁹⁹ pastaj u caktua kryeredaktor i revistës së njohur islame “Edukata islame”, në cilën edhe vetë shkruante punime dhe artikuj të ndryshëm. Ai qëndroi kryeredaktor deri në vitin 1983. Ai po ashtu përktheu suren “Jasinë” në gjuhën shqipe, dhe në vitin 1987 dorëzoi në shtypshkronjë përkthimin e plotë Kur’anit Fisnik me një tefsir të thuktë. Ky përkthim është botuar në pesëdhjetëmijë kopje në Libi, tridhjetëmijë kopje në Kajro dhe në fund një milionë kopje në Medinë.

VDEKJA DHE EPITAFET:

Hoxha dhe komentuesi Haxhi Sherif Ahmeti (Zoti e mëshiroftë!) vdiq në vitin 1998, dhe në funeralin e tij prezantuan dijetarë, hoxhallarë e medresantë nga të gjitha qytetet e Kosovës dhe më gjerë. Një numër shumë i madh i njerëzve prezantuan në faljen e namazit të xhenazes së këtij dijetari dhe profesori të njohur, në Xhaminë e Madhe, në Prishtinë. Gjithashtu në xhenazen e tij prezantuan edhe delegacione të larta nga Maqedonia, Sanxhaku, drejtorë të shkollave shtetërore dhe të gjithë e respektuan me fjalime rasti, duke folur fjalë mirënjohjeje e miradije për aktivitetet e tij të dalluara shkencore. Hoxha i ndjerë ishte i njohur me qëndrimet e tij fetare e kombëtare kundër sistemit sllavo-komunist dhe serbo-jugosllavë. Ai po ashtu dallohet edhe me rolin e tij të madh në mbrojtjen e identitetit islamik shqiptar dhe identitetit kombëtar shqiptar kundër projekteve dhe kurtheve sllavo-komuniste serbe.

Disa dëshmitarë dëshmojnë për qëndrimet e tij burrërore dhe këmbëngulëse kundër emigrimit të muslimanëve shqiptarë në Turqi, sepse në këtë mënyrë do t’ua linin tokën serbëve nacionalistë fanatikë e urrejtës.⁸⁰⁰ Zoti e mëshiroftë Hoxhën tonë dhe ia shndërroftë varrin në kopsht të Xhenetit!

⁷⁹⁹ Ky libër ka karakter metodologjik edukativ islam, ngase përmban në vete parimet e përgjithshme islame. Me këtë libër filloi gjenerata e re e fëmijëve të mësojë Islamin dhe është libër shumë i njohur dhe më se i rëndësishëm për shqiptarët, boshnjakët dhe turqit.

⁸⁰⁰ Këtë përkthim e kam transmetuar nga një libër tjetër që e kanë botuar disa ish-nxënës të hoxhës, pasi i kanë tubuar punimet, artikujt dhe mendimet e tij, kuptohet, pasi që e kishin marrë pëlqimin nga vetë Hoxha (Zoti e mëshiroftë!), edhe pse në këtë libër nuk ishin të përmbledhur të gjitha punimet e tij. Hoxha dëshironte që të tuboheshin të gjitha punimet dhe të botoheshin në atë libër. Uroj dhe shpresoj se nxënësit e tij e kuptojnë këtë

2. Njohuri mbi përkthimin dhe tefsirin e tij:

Përkthimi dhe komentimi i thukhtë i Kur'anit, ka 767 faqe dhe është me një format mesatar 13,5 x 21.5. Tefsiri fillon me një hyrje në gjuhën arabe nga Liga e Botës Islame në bashkëpunim me Akademinë e Botimit të Mus'hafave. Pas Besmeles, citohet ajeti kur'anor:

[ص: 29] ﴿الْأَلْبَبِ أُولُوا وَلِيَتَذَكَّرْ ءَايَاتِهِ ۚ لِيَذَّبَرُوا مَبْرُكٌ إِلَيْكَ أَنْزَلْنَاهُ كِتَابٌ﴾

“(Ky është) Libër i begatshëm. Ne ta shpallëm ty këtë që t’i studiojnë argumentet e tij dhe që të marrin mësim prej tij ata që kanë mend”. (Sad, 29

أَخْتَلَفًا فِيهِ لَوْ جَدُّوا اللَّهَ غَيْرَ عِنْدِ مَنْ كَانَ وَلَوْ الْقُرْآنَ يَتَذَبَّرُونَ أَفَلَا)

([النساء: 82] ﴿كَثِيرًا﴾

“A nuk e përfillin ata Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në te shumë kundërthënie”. (En - Nisa, 82).

Krahas këtyre dy ajeteve kur'anore, aty theksohet edhe hadithi i Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!):

[خيركم من تعلم القرآن و علمه]، رواه البخاري

“Më i miri prej jush është ai që e mëson Kur'anin dhe ia mëson atë dikujt tjetër”.⁸⁰¹

Aty po ashtu shkruan fjalë miradije dhe fjalë të bukura për mundin dhe guximin që ka dhënë Shërbyesi i Dy Haremeve Fisnike (Mbretit Saudit) për botimin e përkthimit, dhe për shpërndarjen e tij në të gjitha vendet e botës. Liga konfirmon rëndësinë dhe nevojën e tefsirit,

boshllëk, dhe insha' Allah do ta realizojnë dëshirën e hoxhës dhe profesorit të tyre, si dhe do t'i pasurojnë lexuesit edhe me një libër tjetër që i përmbledh të gjitha punimet e hoxhës (Zoti e mëshiroftë!), ngase muslimanët shqiptarë kanë nevojë të madhe për veprat dhe punimet e tij shkencore e fetare. Ky libër u botua në vitin 1995 me titull: “**Komente dhe mendime islame**”. Po ashtu shih edhe revistën islame shqiptare: “**Dituria islame**” dhe revistën “**Përpjekja jonë**”, fq. 199-204.

⁸⁰¹ Sahihul Imam El-Buhari, “**El-Xhamiul-musned el-muhtesar min umuri-resulil-lahi ve sunenihi ve'ejjamihi**”, recensoi Muhamed Nezar Temim dhe Hajthem Nizar Temim, Sheriketu Darul-erkam ibn el-erkan, Bejrut, Liban, hadithi nr. 5027, f. 1108.

përkthimit dhe zbatimit të Kur'anit Fisnik në të gjitha gjuhët e botës, përfshi edhe gjuhën shqipe.

Meqë përkryerja absolute i takon vetëm Zotit të Madhërishëm, mund të themi se ky përkthim dhe ky tefsir i thuktë janë realizuar sipas mundësive dhe aftësive shkencore që i ka poseduar dijetari i njohur, hoxha dhe mendimtari Haxhi Sherif Ahmeti. Duke pasur parasysh këtë fakt, ai mund t'ia qëllojë ose të gabojë, ngase përkthimet sado që të jenë precize, ata, megjithatë kurrë s'mund t'i arrijnë domethëniet e sakta dhe qëllimet e larta të tekstit të Kur'anit Fisnik

3. Karakteristikat e metodës së komentuesit:

Hyrje e rëndësishme mbi Kur'anin fisnik

Komentuesi dhe hoxha Sherif Ahmeti (Zoti e mëshiroftë!), në hyrje sqaron qëndrimin e tij ndaj disa çështjeve të rëndësishme kur'anore, të cilat konsiderohen edhe karakteristika të metodës dhe drejtimit të tij në tefsir, dhe për këtë arsye isha i obliguar që t'i shqyrtoj dhe të analizoj qëndrimin e komentuesit ndaj disa çështjeve shkencore që kanë të bëjnë me shkencat e Kur'anit, kështu që në këtë mënyrë, të mund t'i zbardhim sa më shumë të jetë e mundur, mendimet dhe metodën e hoxhës (Zoti e mëshiroftë!). Ai hyrjen e fillon hyrjen me titullin “Vështrim rreth Kur'anit”; ndërsa çështjet që i shqyrton në të janë:

a. Shpallja-koncepti dhe definicioni

Në këtë çështje komentuesi sqaron se Kur'ani Fisnik padyshim është Fjalë e Zotit të botërave i inspiruar Pejgamberit të fundit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), nëpërmes Xhibrilit, i shkruar në mus'haf, dhe i transmetuar deri tek ne suksesivisht, leximi i tij konsiderohet adhurim, fillon me suren “El-Fatiha” dhe përfundon me suren “En-Nas”.

Pastaj vazhdon dhe thekson disa karakteristika të Kur'anit Fisnik, si p.sh., se Kur'ani Fisnik nuk është prodhim e as vepër e trurit të njeriut, si dhe se Kur'ani është Fjalë e Zotit të Madhërishëm e shpallur në gjuhën arabe. Në këtë kontekst, ai i thekson ajetet kur'anore:

مِنْ لَتَكُونَ قَلْبِكَ عَلَى ﴿١١٣﴾ الْأَمِينُ أَلرُّوحُ بِهِ نَزَلَ ﴿١١٢﴾ الْعَالَمِينَ رَبِّ لَتَنْزِيلُ وَإِنَّهُ،
 ([الشعراء: 192-195] ﴿١١٥﴾ مُبِينٍ عَرَبِيٍّ بِلِسَانٍ ﴿١١٤﴾ الْمُنْذِرِينَ

- “E edhe ai (Kur’ani) është Shpallje, (zbritje) e Zotit të botëve.
 Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili), (E solli) në zemrën tënde, për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen (pejgamber). Të shpallëm në gjuhë të kulluar arabe” (Shuara, 192-195).

([النمل : 6] ﴿٦﴾ عَلِيمٍ حَكِيمٍ لَّدُنَّ مِنَ الْقُرْآنِ لَتَلْقَىٰ وَإِنَّكَ)

- “E s’ka dyshim se ti (Muhamedi) e pranon Kur’anin nga i Urti, i Dijshmi” (En-Neml, 6).

Pastaj ai (Zoti e mëshiroftë!) kritikon supozimet e disa orientalistëve dhe bashkëmendimtarëve të tyre, të cilët thonë se Xhibrili a.s. ia ka sjellë Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) vetëm kuptimin e Kur’anit Fisnik, por jo edhe fjalët, dhe se Muhammedi është shprehur me fjalë të veta!? Hoxha vazhdon e thotë se këto dyshime janë gënjeshtër të kulluara dhe të pabaza, ngase kundërshtojnë të vërtetën që thuhet edhe në Kur’an edhe në hadith, përndryshe sikur të ishin vetë fjalët e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ose të Xhibrilit a.s., atëherë Kur’ani nuk do të ishte mrekulli, qoftë për nga kuptimi, apo edhe për nga aspekti gjuhësor.

Zoti i Madhërishëm në Kur’anin Fisnik thotë:

أَبْلَغُهُ ثُمَّ اللَّهُ كَلَّمَ يَسْمَعُ حَتَّىٰ فَأَجْرَهُ أَسْتَجَارَكَ الْمُشْرِكِينَ مِّنْ أَحَدٍ وَإِنْ)
 ([التوبة : 6] ﴿٦﴾ يَعْلَمُونَ لَا قَوْمٌ بِأَنَّهُمْ ذَلِكَ مَا مَنَّهُ

“E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim, t’i strehojë në mënyrë që t’i dëgjojë fjalët e Allahut (Kur’anin)”. (Teube, 6). Pra hoxha konfirmon se në bazë të këtij ajeti, fjalët dhe kuptimet e Kur’anit Fisnik janë nga vetë Zoti i Madhërishëm. Hoxha më tej vazhdon dhe shqyrton çështjen, definicionin, llojet dhe mënyrën e shpalljes, duke u mbështetur në ajetin kur’anor:

رَسُولًا يُرْسِلَ أَوْ حِجَابٍ وَرَأَى مِنْ أَوْ وَحِيًّا إِلَّا اللَّهُ يُكَلِّمُهُ أَنْ لِبَشَرٍ كَانَ وَمَا

([الشورى : 51] ﴿حَكِيمٌ عَلَىٰ إِنَّهُ يَشَاءُ مَا بِإِذْنِهِ ۖ فَيُوحِي﴾

“Nuk ka asnjë njeri që ti ketë folur Allahu ndryshe vetëm se me anën e frymëzimit, ose pas ndonjë perdeje, ose t’i dërgojë të dërguar (engjëll), e ai t’i shpallë me lejen e Tij atë që do Ai. Vërtetë, Ai është më i Larti më i Urti”. (Shura, 51). Më tej vazhdon që t’i përmendë vështirësitë e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) gjatë pranimit të shpalljes dhe mënyrën se si i vinte shpallja.

Ai gjithashtu shqyrton edhe çështjen e burimit të dytë legjislativ, gjegjësisht Sunnetin e pastër pejgamberik duke e quajtur “shpallje me frymëzim”. Edhe Sunneti është shpallje nga Zoti i Madhërishëm dhe kjo argumentohet me ajetin kur’anor:

([النجم : 3-4] ﴿يُوحَىٰ وَحْيٌ إِلَّا هُوَ إِنَّ أَهْلَؤَ عَنْ يَنْطِقُ وَمَا﴾

“Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kur’ani) nuk është tjetër pos shpallje që shpallet”. (En-Nexhm, 3-4).

Edhe hadithi kudsi është i këtij rangu, por nuk përmban në vete parime të Sheriatit.⁸⁰²

b. Tematika dhe përmbajtjet e Kur’anit

Ai (Zoti e mëshiroftë!), kur flet për tematikat dhe përmbajtjet e Kur’anit Fisnik thotë se Kur’ani është Libër i përhershëm fetar dhe edukativ, si dhe Libër i udhëzimit dhe mëshirë për individët dhe për mbarë shoqërinë njerëzore. Ky Libër zhvillon shpirtin e paqes në mes njerëzve, dhe i nxitë në zhvillim qytetërues dhe ngritje shpirtërore, dallohet me universalizëm në parime e rregulla, si dhe synon reformën shoqërore.

Nga aspekti fetar, Kur’ani Fisnik përmban në vete besimin e monoteizmit, besimin e vërtetë në Një Zot të Vetëm e të Madhërishëm, besimin në engjëjt, librat dhe në Ditën e Gjykimit. Nga aspekti shkencor, kërkon hulumtimin dhe përsiatjen mbi krijesat dhe qeniet që i ka krijuar Zoti i Madhërishëm në këtë gjithësi, për të depërtuar deri në thellësitë e

⁸⁰² Shih tefsirin e hoxhë Sherif Ahmetit, fq. 12-13.

tyre që argumentojnë Madhështinë e Zotit të Madhërishëm dhe Fuqinë e Tij. Ndërsa nga aspekti historik, Kur'ani Fisnik na rrëfen tregime mbi popujt e hershëm për të marrë mësim, shembull e frymëzim prej tyre. Kur flet për urtësinë e shpalljes së librave dhe ligjeve të mëparshme në formë të përkohshme, thotë se ato janë shpallur për t'i përgatitur dhe bindur njerëzit dhe popujt e atëhershëm, që të njohin e të besojnë në Zotin e Madhërishëm, si dhe të pranojnë Librin e fundit të shpallur të përkryer e të përhershëm⁸⁰³ dhe të përshtatshëm për çdo kohë e çdo vend.

c. Mrekullia e Kur'anit fisnik

Hoxha dhe komentuesi konfirmon se Kur'ani Fisnik gjithsesi është mrekulli e përhershme dhe eternale, ngase është Fjalë e Zotit, dhe meqë Fjala është Cilësi nga Cilësitë e Zotit të Madhërishëm, atëherë ajo duhet të jetë Cilësi e përhershme...

Çdo pejgamber apo resul ka pasur mrekulli të posaçme, ndërsa libri i shpallur ilustronte metodën e tij praktike, kurse mrekullia e Pejgamberit tonë (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), (Kur'ani) është në të njëjtën kohë edhe metodë edhe mrekulli; dhe për t'u realizuar mrekullia e tij, ai duhet të mësohet përmendësh me saktësi e besim (amanet), dhe për këtë konkretisht Zoti i Madhërishëm ka garantuar se do ta mbrojë nga falsifikimi, ndryshimi dhe ndërhyrjet.

Në këtë kontekst, hoxha dhe komentuesi i shqyrton dy çështje shumë të rëndësishme: Çështjen e aplikimit praktik të Kur'anit dhe çështjen e mbrojtjes së tij nga ndryshimi dhe devijimi. Prej fjalëve të bukura të tij, mund të citojmë thënien e tij se me kalimin e kohës, dobësohet faktori i aplikimit përkundër faktorit të mësimit përmendësh, i cili rritet dhe përforcohet. Sikur ta praktikonim Kur'anin Fisnik tamam ashtu siç duhet në jetën tonë, atëherë do të ishte e natyrshme dhe e logjikshme që të mbrohet ky Kur'an, mirëpo largimi dhe distancimi ynë nga udhëzimet dhe mësimet e Kur'anit Fisnik, na bën të ecim paralelisht me mbikëqyrjen precize dhe kontrollin e Zotit të Madhërishëm ndaj tij.

Si argument më i fortë se vetë Zoti i Madhërishëm e mbron Librin e Tij, është fakti se ekzistojnë muslimanë që e shkruajnë tërë Kur'anin me shkronja precize dhe me shkrim të bukur-kaligrafik. Pastaj sheh konkurrencë në mes njerëzve se kush do të botojë Kur'an më të bukur dhe

⁸⁰³ Shih tefsirin e hoxhë Sherif Ahmetit në fq. 13-14

më të mirë. Pra, e gjithë kjo argumenton se Zoti i Madhërishëm e mbron Librin e Tij, e jo ata që e praktikojnë në jetën e tyre.⁸⁰⁴

ç. Aspektet e mrekullisë së kur'anit fisnik

Hoxha (Zoti e Mëshiroftë!) thekson se ekzistojnë sfera dhe aspekte që konfirmojnë mrekullinë e Kur'anit Fisnik, por nga frika se mos e zgjasi shumë, i përmend vetëm tri aspekte: Aspektin gjuhësor, aspektin shkencor dhe aspektin psikik.

I - MREKULLIA GJUHËSORE E KUR'ANIT

Haxhi Sherif Ahmeti (Zoti e mëshiroftë!) thekson se Kur'ani është shpallur në gjuhën e arabëve që kishin arritur kulmin e elokuencës dhe retorikës. Kur'ani u garonte atyre në këtë aspekt, por ata s'kishin mundësi të thurnin diçka si ai, e as ta imitonin, dhe kur s'patën mundësi të bëjnë një gjë të tillë, filluan të deklaronin se ky Kur'an është një lloj magjie dhe se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) është magjistar! Hoxha u bëri replikë duke u thënë se sikur kjo të ishte e vërtetë, atëherë ata do të duhej të ishin të magjepsur, ngase magjistari e hipnotizon të magjepsurin dhe ia përvetëson dëshirën dhe lirinë e tij, por dihet se e vërteta ishte krejtësisht ndryshe.

Arabët elokuentë dhe kundërshtarë të Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), edhe pse e akuzonin me magji, nuk i besonin atij, dhe ky është fakt se ata gënjenin kur thoshin se Muhammedi ishte magjistar dhe se i hipnotizonte, ngase si mund që i hipnotizuari të kundërshtojë dëshirën e magjistarit dhe të mos i përfillë urdhrat e tij?!⁸⁰⁵

II - MREKULLIA SHKENCORE E KUR'ANIT

Pas theksimit të hoxhës dhe komentuesit se Kur'ani Fisnik është mrekulli e përhershme, ngase është shpallur nga Zoti i Gjallë dhe i Gjithëfuqishëm, ai po ashtu vazhdon e thotë se mrekullia e tij fshihet edhe në vetë natyrën e Kur'anit Fisnik si mrekulli shkencore përkundër mrekullive tjera. Arsyeja se përse Kur'ani është mrekulli shkencore,

⁸⁰⁴ Shih tefsirin e thuktë të hoxhës dhe haxhiut të çmuar Sherif Ahmeti, fq. 14.

⁸⁰⁵ Shih tefsirin e thuktë të hoxhë Sherif Ahmetit, fq. 15.

qëndron në faktin se disa njerëz, kohëve të fundit, kanë zbuluar mjaft fshehtësi shkencore kur'anore. Në çastet e para të shpalljes, Kur'ani Fisnik vetëm i ka përmendur kalimthi çështjet e tilla shkencore të zbuluara rishtazi, dhe se njerëzit në atë kohë nuk kishin mundësi t'i kuptonin të dhënat precize dhe fshehtësitë shkencore të Kur'anit Fisnik.

Kur'ani Fisnik, gjithashtu aludon edhe në disa fshehtësi tjera që i konsideronin si të vërteta, pa marrë parasysh se a i percepton truri njerëzor apo jo, dhe duket sikur ai na thotë në gjuhën e tij: “Kur t’ju them diçka ose kur t’ju lajmëroj për diçka, mos kërkon argument, ngase vetë ajo është argument”. Nëse ndonjëri prej nesh nuk ju beson këtyre fjalëve dhe dëshiron të mbështetet në shqisat e tij individuale, unë do t’ua mundësoj dhe do t’ua tregoj shenjat e mia në horizonte dhe në veten e tyre derisa të binden se Ai është i vërtetë. Në këtë kontekst, Zoti i Madhërishëm thotë:

بَرِّكَ يَكْفِ أَوْلَمَ الْحَقُّ أَنَّهُ لَهُمْ يَتَبَيَّنَ حَتَّى أَنْفُسِهِمْ وَفِي الْأَفَاقِ فِي آيَاتِنَا سُرِّيهِمْ)

[فصلت : 53] شَهِدُ شَيْءٍ كُلِّ عَلَى أَنَّهُ

“Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që të shohin argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?” (Fussilet, 53).

Kur’ani Fisnik i tejkalon kufijtë e kohës dhe hapësirës, dhe lexuesi i vëren qartë këto horizonte të kohës e vendit gjatë leximit të Kur'anit. Është e vërtetë se fshehtësitë e Kur'anit Fisnik ripërtërihen në çdo kohë dhe në çdo gjeneratë, dhe falë këtij fenomeni të gjerë të fjalëve dhe kuptimeve, Kur’ani ecën paralelisht me kohën dhe jetën në të cilën jetojmë dhe për këtë arsye, ai, vërtetë është edhe mrekulli shkencore.⁸⁰⁶

III - MREKULLIA PSIKIKE E KUR'ANIT

Fjalët e hoxhës dhe komentuesit rreth kësaj tematike mund të jepen si rezyme e faktit se Zoti i Madhërishëm e ka zbritur Kur'anin që të jetë mëshirë dhe dritë për njerëzit. S’do mend se për shpirtrat që ishin ushqyer

⁸⁰⁶ Shih tefsirin e hoxhë Sherif Ahmetit, fq. 14-16. Mbi mrekullinë gjuhësore dhe objektive të Kur'anit, hoxha dhe komentuesi Haxhi Sherif Ahmeti ka shkruar dy punime mjaft të vlefshme në librin e tij “**Komente dhe mendime islame**”, botuar nga Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë 1996, bot. 1, fq. 300-306 dhe 307-317.

e që kishin thithur adhurimin e putave, shpallja e Kur'anit Fisnik, ishte një goditje e fortë kundër tyre.

Kur'ani i thërriste që të braktisnin adhurimin e tillë që e kishin trashëguar nga etërit dhe gjyshërit e tyre, mirëpo ata refuzonin. Kjo thirrje e re kur'anore ishte një sfidë e madhe për ata dhe avash-avash i përfshinte nën ombrellën e vet.

Mrekullia shpirtërore dhe psikike e Kur'anit ndikonte gradualisht në zemrat e tyre, gjersa përfundimisht bindeshin në vërtetësinë e tij, por parpëseparapë pa vetëdije reagonin dhe thoshin se është magji!!! Qëndrimi i tillë argumentohet me ngjarjen që ndodhi me një elokuent të njohur kurejshit që quhej Velid ibn Mugire.

D. DISA KARAKTERISTIKA TË KUR'ANIT

A - MËSIMI MEKANIK-PËRMENDËSH:

Për sa i përket mësimin të Kur'anit përmendësh dhe shkrimit të tij, hoxha thotë se Kur'ani është shpallur te një popull analfabet arab, që s'dinin as shkrim e as lexim, dhe në këtë kontekst në Kur'anin Fisnik thuhet:

وَيُعَلِّمُهُم وَيُزَكِّيهِمْ ءَايَاتِهِ عَلَيْهِمْ يَتْلُوا مِنْهُمْ رَسُولًا أَلْمِيقِينَ فِي بَعَثَ الَّذِي هُوَ
([الجمعة : 2] ﴿٢﴾ مُبِينٍ ضَلَّلَ لَفِي قَبْلُ مِنْ كَانُوا وَإِنْ وَالْحِكْمَةَ أَلِكْتَبَ

“Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t’ju lexojë ajetet e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë Librin dhe Sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme” (El Xhumua, 2).

Arabët dalloheshin nga popujt e tjerë me fuqinë e memories dhe mësimin përmendësh, saqë mësonin qindra tekste poetike e fjalime, bashk me emrat dhe rrjedhat e autorëve. Pas shpalljes së Kur'anit dhe hyrjes së tyre në Islam, braktisën mësimin e poezive dhe u përqëndruan në mësimin përmendësh të Kur'anit, ngase në Kur'an gjenin prehjen dhe qetësinë shpirtërore të tyre, e pastaj shpërndaheshin në vende tjera dhe ua mësonin atë të tjerëve. Mësimi përmendësh i Kur'anit është karakteristikë e ummetit të Muhammedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe është dhuratë e dhuruar nga Zoti i Madhërishëm. Zoti ua ka lehtësuar atyre mësimin përmendësh, ndaj dhe u thotë:

([القمر : 17] ﴿ مُذَكِّرٍ مِّنْ فَهْلٍ لِلذِّكْرِ الْقُرْآنَ يَسِّرْنَا وَلَقَدْ ﴾)

“Ne Kur’anin e bëmë të lehtë për mësim, po a ka ndokush që merr mësimin?” (El Kamer, 17).

B - SHKRIMI I KUR’ANIT:

Kjo karakteristikë, është një nga dy karakteristikat e ummetit të Muhammedit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Pejgamberit i shpallej një libër, ndërsa njerëzit nuk kishin mjete për shkrim, e as letër përveç asaj që prodhohej nga persët dhe romakët, madje as ata nuk prodhonin sasi të mjaftueshme, ndaj dhe për këtë shkak e shkruanin Kur’anin në gurë të rrafshët, në lëkura të deveve dhe në fleta të palmave, si dhe në mjete tjera që ekzistonin në atë kohë.⁸⁰⁷

Më pas, hoxha dhe komentuesi thekson se pas vdekjes së Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe kalimit të tij në botën tjetër, për shkak të vrasjes së lexuesve të Kur’anit në betejën e Jemames, gjatë halifatit të Ebu Bekër Es-Sidikut, Omer ibn Hattabi r.a. i propozon Ebu Bekër Es-Siddikut që të tubojë Kur’anin në fleta ose në një mus’haf, nga frika se me vdekjen e hafizëve, mos po humbet Kur’ani.. Në fillim Ebu Bekri hezitonte, por më pas u pajtua me propozimin e Omer ibn Hattabit.

Për sa i përket shkrimit dhe tubimit të Kur’anit Fisnik në kohën e Osman ibn Affanit r.a., kur u zgjerua halifati dhe Islami u përhap jashtë Siujdhesës Arabe deri në Armeni e Azerbajxhan, sahabiu i njohur Hudhejfe ibn El-Jemani r.a. vëren ndryshime në leximin e Kur’anit dhe shqiptim tjetër të shkronjave të muslimanët joarabë, ndaj dhe nxiton te Osman ibn Affani, duke i thënë: “Shpejto para se të përçahet ummeti rreth Librit, ashtu siç u përçanë hebrenjtë dhe të krishterët!”

Në atë moment, Osmani r.a. i tubon sahabët dhe këshillohet me ata rreth kësaj çështje dhe pas pajtimit të tyre, urdhëroi që të shkruhen disa kopje dhe të shpërndahen në vende të ndryshme.

Nga kjo vërehet qartë se dallohej tubimi i Ebu Bekër Es-Siddikut nga tubimi i Osman ibn Affanit r.a., ngase Ebu Bekri urdhëroi tubimin e Kur’anit nga frika e humbjes së Kur’anit me vdekjen e hafizëve, kurse Osmani r.a. e tubon nga frika prej formimit të leximeve të ndryshme.⁸⁰⁸

⁸⁰⁷ Shih tefsirin e thuktë të hoxhë Sherif Ahmetit, fq. 19-20.

⁸⁰⁸ Po aty, fq. 21-22.

Ç - ÇËSHTJA E TEFSIRIT DHE PËRKTHIMIT TË KUR'ANIT:

Në fund të hyrjes, hoxha dhe komentuesi ynë, (Zoti e mëshiroftë!) flet mbi rëndësinë e komentimit të Kur'anit Fisnik dhe thotë: “Shpjegimi ose komentimi i asaj, të cilën Allahu nëpërmjet Fjalës së Vet e kërkon dhe e dëshiron prej krijesave, arrihet më së miri kur ndonjë pjesë e Kur'anit shpjegohet me pjesën tjetër të tij, (Tefsirul Kur'ani bil Kur'an), ose kur shpjegohet nga ana e vetë Pejgamberit (Tefsirul Kur'ani bis-Sunnah), ose kur ndonjë pjesë e tij shpjegohet nga as'habët e Pejgamberit (Tefsirul Kur'ani bi Kelamis-Sahabeh), dhe shpjegime mendore, logjike dhe individuale (Tafsirul Kur'ani Bir-Re'ji el Xhaiz). Përkthimi i domethënies të Kur'anit është i nevojshëm dhe është i kërkuar, ngase nëpërmjet tij besimtarët njoftohen në udhëzimet e tij të larta. Përkthimi i Kur'anit tekstualisht në ndonjë gjuhë tjetër nuk është i lejuar, ngase është e pamundshme të ruhet stili i tij artistik, dhe nuk mund të bartet në ndonjë gjuhë tjetër. Gabimet pa qëllim Allahu i falë!”⁸⁰⁹

D - LEXIMI I LIBRIT TË SHIKUAR DHE LIBRIT TË SHKRUAR:

Është dhunti e Zotit të Madhërishëm që njeriu të lexojë dy libra që të përfitojë dobi prej tyre dhe të udhëzohet kah i Madhërishmi: Libri i parë është libri i shikuar, gjegjësisht kjo gjithësi (Universi) që është rreth nesh, e që e ka krijuar Zoti për ta hulumtuar njeriu nëpërmes meditimeve, përsiatjeve e studimeve të fenomeneve natyrore. Ky libër i shikuar nuk flet dhe nuk ka gjuhë, por gjuhë i ka krijesat, bimët, mineralet dhe gjallesat. Hulumtuesit dhe studiuesit e këtij libri janë ata që i frikësohen më së shumti Allahut të Madhërishëm:

مَنْ أَلَّهَ تَخَشَىٰ إِنَّمَا كَذَلِكَ الْوَنُورُ مُحْتَلِفٌ وَالْأَنْعَامُ وَالْأَنْبَاءُ النَّاسِ وَمِنْ

([فاطر : 28] غَفُورٌ عَزِيزٌ اللَّهُ إِنْ أَلْعَلَّمُوا عِبَادِهِ

“Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij, vetëm dijetarët” (Fatir, 28).

Libri i dytë që flet është ky Libër i shkruar, gjegjësisht Kur'ani Fisnik që është para nesh. Hoxha dhe komentuesi potenconte

⁸⁰⁹ Shih tefsirin e hoxhës dhe komentuesit Haxhi Sherif Ahmeti, f. 22.

domosdoshmërinë dhe harmonizimin e të dy leximeve, ngase Kur'ani Fisnik përmban kuptime të reja edhe për gjeneratat e ardhshme, dhe pikërisht kjo është edhe mrekullia shkencore e objekteve të Kur'anit.

DH - TEFSIRI QË HOXHA DËSHIRONTE T'UA OFROJË
LEXUESVE:

Pastaj hoxha dhe komentuesi (Zoti e mëshiroftë!) vazhdon dhe sqaron metodën e tij gjatë komentimit të thuktë, duke e ngjyrosur përkthimin dhe tefsirin me ngjyrë imani, morali, shpirti të Sheriatit dhe me synimet islame.⁸¹⁰

⁸¹⁰ Po aty, fq. 743-750.

KAPITULLI I DYTË

I. STUDIMI DHE ANALIZIMI I TEFSIRIT TË HOXHËS DHE MENDIMTARIT SHERIF AHMETI

Hoxhë Haxhi Sherif Ahmeti (Zoti e mëshiroftë!) e thekson literaturën që ka përdorur gjatë tematikave të sureve dhe kuptimeve të ajeteve kur'anore:

1. Libri: صفوة التفاسير “Safvetut-tefasir” i profesorit, hoxhës dhe komentuesit të njohur Muhamed Ali Sabuni;
2. Libri: فتح البيان في مقاصد القرآن “Fet’hul bejan fi mekasidil-Kur’an”, i Shejh Muhamed Hasan Hanit;
3. Libri: المصحف المفسر “El-Mus’haf el-mufesser”, i autorit, gjegjësisht eruditit Ferid Vexhdi; dhe:
4. Libri: قاموس قرآني “Kamus Kur’anij”, i Shejh Hasan Muhammed Musa.

Ndonjëherë përdorte tefsirin e madh مفاتيح الغيب “Mefatihul-gajbi” të Imam Fahrudin Raziut dhe librin تفسير القرآن العظيم “Tefsirul-Kur’anil-adhim” të Imam Ibn Kethirit. Krahas kësaj literature, hoxhë Sherif Ahmeti (Zoti e mëshiroftë!) ka përdorur edhe literaturë tjetër, por pa i theksuar titujt.⁸¹¹

Kjo ishte literatura që e kishte përdorur hoxhë Sherif Ahmeti (Zoti e mëshiroftë!) dhe që e kishte theksuar vetë ai në tefsirin e tij. Arsyeja që e kishte shtyrë hoxhën të mbështetet në këtë literaturë, e jo edhe në tituj tjerë ishte se autorët e tefsireve të tillë, gjatë tefsirit të librit të Zotit të Madhërishëm ishin bashkëkohorë dhe ishin përqëndruar në zbulimin e koncepteve, aspekteve, mësimave dhe këshillave shoqërore, etike e ekonomike, si dhe në zbërthimin e problemeve bashkëkohore nga prizma e Kur’anit dhe Sunnetit.

Edhe hoxhë Sherif Ahmeti ka përdorur të njëjtën metodë në tefsirin e tij, dhe për këtë shkak e konsideroj si prijës të drejtimit dhe doktrinës shoqërore ndër shqiptarët.

Këtu dëshiroj të theksoj një vështrim kritik të rëndësishëm metodologjik, gjegjësisht faktin se hoxha (Zoti e mëshiroftë) e bënte lexuesin të nënkuptojë se ai ka përdorur edhe literaturë tjetër, përpos asaj që e kishte potencuar në hyrje.

⁸¹¹ Shiko tefsirin e hoxhë Sherif Ahmetit, f. 750.

Por pas kontrollimit dhe analizës të kësaj çështje, vërejmë qartë se burimet të cilat i ka përmendur në hyrje, në realitet ishin burime të komentuesve prej të cilëve supozon se ka transmetuar citate, ndërsa në fakt hoxha ynë, mufesiri Haxhi Sherif Ahmeti nuk ka transmetuar asgjë prej tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë, por në mënyrë të tërthortë, si dhe mos përmendja e numrit të faqes dhe të vëllimit të literaturës së shfrytëzuar nga vet autori, konfirmon bindjen dhe mendimit tonë.

Do të kishte qenë më mirë për të (Zoti e mëshiroftë!), sikur të ishte më besnik dhe më i përpiktë ndaj metodologjisë shkencore, dhe t'i theksonte burimet prej të cilëve ka transmetuar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej tyre, dhe burimet që ka transmetuar në mënyrë të tërthortë. Kjo metodologji e ndjekur nga hoxha dhe mufesiri ynë (Zoti e mëshiroftë!), bën që lexuesit të përfitojnë bindje se ai është mbështetur në burime të tilla, por në fakt dhe realisht ai nuk i ka konsultuar fare, si psh., Tefsiri i Zemahsheriut, tefsiri i Kurtubiut, tefsiri i Ebu Su'udit, tefsiri El-Bahrul-Muhit, tefsiri i Taberiut dhe tefsiri i Sejjid Kutubit,⁸¹² pastaj hadithet e vërteta pejgamberike, gjashtë librat e hadithit, Musnedin e Imam Ahmedit,⁸¹³ librat e shkencave të Kur'anit, librat e derogimit dhe te abrogimit, librat e rrëfimeve mbi pejgamberët dhe historisë, librat e biografisë së Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), librat e usuli-fikhut,⁸¹⁴ librat e ndryshme shkencore bashkëkohore, gjurmët dhe fjalët e sahabëve r.a.⁸¹⁵ dhe gjurmët e imamëve të mëdhenj si Imam Shafi'u etj.⁸¹⁶

II. METODA DHE MËNYRA E HOXHË SHERIF AHMETIT NË TEFSIR

Gjatë studimit dhe leximit tim të këtij tefsiri të thukët, vërejtja se ai (Zoti e mëshiroftë!), gjatë tefsirit të Kur'anit, ka praktikuar metodën dhe mënyrën vijuese:

- Thekson numrat e ajeteve dhe emrat e sureve mekase dhe atyre medinase.

⁸¹² Shih tefsirin e tij në faqet 153, 172, 222, 257, 385, 408, 419, 558, 570, 584.

⁸¹³ Po aty, fq. 440.

⁸¹⁴ Po aty, fq. 115.

⁸¹⁵ Po aty, fq. 184, 212.

⁸¹⁶ Po aty, fq. 559.

- Thekson tematikat dhe titujt e sureve, p.sh., siç vepron në tefsirin e sures “El-Fatiha”.⁸¹⁷
- Thekson kuptimin e përgjithshëm të ajeteve, pa u ndalur në çdo ajet për koment dhe mjaftohet vetëm me përkthimin në pjesën e epërme të faqes.⁸¹⁸
- Ndonjëherë i thekson vlerat e sures, dhe atë duke argumentuar me libra të Sunnetit dhe dy Sahihët.⁸¹⁹
- Për çdo sure përcakton hyrje të përshtatshme dhe në mënyrë të rezymesë i thekson tematikat që i shqyrton sureja, por jo sipas kronologjisë së tyre që i përmend vetë sureja.⁸²⁰
- Bën sqarimin dhe komentimin e disa fjalëve kur’anore që kanë më shumë kuptime, si dhe tregon dallimin në mes tyre dhe fjalëve të ngjashme, si p.sh., “El-hamdu”, “esh-shukru” dhe “el-med’hu”, الحمد – الشكر – المدح dhe në këtë kontekst tregon kuptimin etimologjik dhe terminologjik të fjalëve, si dhe përcakton kuptimin e synuar ose të preferuar të ajetit.⁸²¹
- I thekson në detaje kuptimet e fjalëve dhe burimet e fjalëve të tilla gramatikore, si dhe ndonjëherë i thekson kuptimet e ngjashme, duke u mbështetur në ajetet e ngjashme nga suret e tjera, vetëm me numra pa i përmendur ajetet. Ai po ashtu konfirmon domethëniet e llojllojshme të fjalëve.⁸²²
- I thekson çështjet morfologjike dhe sintaksore që kanë të bëjnë me ajetin përkatës, dhe atë në formë shumë të thuktë.⁸²³
- Ndonjëherë i thekson çështjet e besimit, dhe i seleksionon idetë që janë më afër Ehli Sunnetit dhe xhematit.⁸²⁴
- Ndonjëherë e komenton Kur’anin pa i theksuar ajetet e tilla, por vetëm numrat e tyre,⁸²⁵ por këtë metodë nuk e ka aplikuar këtë çdo herë, ashtu siç shprehet vetë në hyrje.

⁸¹⁷ Po aty, fq. 26.

⁸¹⁸ Po aty, fq. 10, 40.

⁸¹⁹ Po aty fq. 26.

⁸²⁰ Po aty, fq. 29.

⁸²¹ Po aty, fq. 27, 31.

⁸²² Po aty, fq. 27, 28.

⁸²³ Po aty, fq. 265-549.

⁸²⁴ Po aty, fq. 28, 272.

⁸²⁵ Po aty, fq. 28, 210, 236, 262.

- I transmeton mendimet e komentuesve rreth një tematike, ashtu siç i thekson edhe mendimet e Zemahsheriut, Ibn Tejmijes dhe Ibn Kethirit rreth shkronjave të ndara alfabetike që ndodhen në fillim të sureve kur'anore,⁸²⁶ por pa e informuar lexuesin për numrat e faqeve dhe vëllimeve të literaturës së shfrytëzuar.
- Sqaron kuptimet e disa terminologjive fetare, të cilat mund të jenë të pakuptimta për lexuesit, si p.sh., fjalët: Sexhde, Iblis, Xhennet, Beni-Israil, bid'at, etj.⁸²⁷
- I thekson israiliatet në tefsirin e tij, por në mënyrë shumë të shkurtër, si p.sh., ngjarjen e Faraonit kur ky kishte parë ëndërr se ka për t'u lindur një fëmijë nga Beni-Israilët dhe ky fëmijë do ta shkatërrojë. Ai po ashtu i përmend edhe emrat e fëmijëve të zotëriut tonë Nuhit a.s. dhe emrin e bashkëshortes së tij, kur u fundos në ujë.⁸²⁸
- Gjatë tefsirit të ajeteve ndonjëherë bën krahasime mes Sheriatit tonë dhe shariateve të mëparshme, duke treguar pikat identike dhe ato diferenciale në mes tyre, si p.sh., rrëfimi i ngjarjes së vrasjes të Beni-Israilët, kur Musai a.s. urdhëron të presin një lopë dhe ta rrahin vrasësin. Në rast të tillë vrasësi privohet nga e drejta e trashëgimisë dhe ky rregull ekziston edhe në Sheriatin tonë edhe në sheriatin e Musait a.s.⁸²⁹
- I thekson shkaqet e shpalljes, herë në gjuhën e komentuesve dhe herë në gjuhën e tij, pa përmendur burimin.⁸³⁰
- Ndonjëherë në mënyrë të rezymesë thekson abrogimin dhe derogimin.⁸³¹
- Ndonjëherë argumenton me hadith kudsij dhe hadithe pejgamberike nga Sahihu i Buhariut, Sahihu i Muslimit dhe gjashtë librat tjerë,⁸³² por pa praktikuar një metodë të njëjtë në transmetimin e haditheve, ngase herë thekson burimin e mbështetur e herë jo.⁸³³

⁸²⁶ Po aty, fq. 31, 59.

⁸²⁷ Po aty, fq. 38, 48, 265.

⁸²⁸ Po aty, fq. 38, 265, 378.

⁸²⁹ Po aty, fq. 41, 43.

⁸³⁰ Po aty, fq. 45, 79.

⁸³¹ Po aty, fq. 47.

⁸³² Po aty, fq. 48, 440

⁸³³ Po aty, fq. 54, 79, 106, 128, 130, 132

- Zhvillon polemikë me eternalistët dhe natyralistët, si dhe i shqyrton shkurtimisht qëndrimet e tyre ndaj ringjalljes.⁸³⁴
- I kritikon hebrenjtë që kundër veti tërhoqën hidhërimin dhe të krishterët e devijuar, dhe se më mirë do të ishte për ata sikur të praktikonin këtë fe, sepse Islami është fe që Zoti ua ka shpallur robërve të vet, e jo ujin apo vajin me të cilët e lyejnë trupin hebrenjtë dhe të krishterët.⁸³⁵
- I korrigjon disa koncepte të gabuara të disa njerëzve dhe tregon të vërtetën rreth tyre, pastaj flet për të vërtetën e Xhenetit, përshkrimeve dhe begatit të Xhenetit dhe thotë se të vërtetën e Xhenetit nuk e njeh askush përveç Zotit të Madhërishëm. Ai po ashtu shqyrton të vërtetën e jetës së shehidit dhe thotë se ata janë të gjallë te Zoti i tyre dhe ushqehen, por pa u thelluar në mënyrën dhe formën e jetës së tyre. Sipas tij, gabim është të mendohet se trupat e tyre nuk prishen dhe nuk kalben, ngase Zoti i Madhëruar thotë:

(﴿يُرْزُقُونَ رَبَّهُمْ عِنْدَ أَحْيَاءٍ بَلِّ أَمْوَاتًا ۚ اللَّهُ سَبِيلٌ فِي قُتُلُوا الَّذِينَ تَحْسَبْنَ وَلَا﴾)

[آل عمران: 169]

⁸³⁶ “Të gjallë te Zoti i tyre” e jo te ju, ose ashtu siç kuptoni ju, o ju njerëz.

- Në tefsirin e tij përqendrohet në marrjen e këshillave dhe mësimave, si dhe në nxjerrjen e parimeve të përgjithshme juridike dhe morale, dhe i tregon aspektet shoqërore e fetare të ajetit, si p.sh., në komentimin e tij që i bën ajetit, i cili ka të bëjë me hakmarrjen “el-kisas”,⁸³⁷ ku thotë (Zoti e mëshiroftë!): “Shumë njerëz menduan se kjo masë është shumë e ashpër për kohën tonë të qytetëruar. Një mendim i tillë i gabuar dhe një filosofi e tillë e verbër ka bërë që kriminaliteti në ekonomi të jetë gjithnjë më i madh, e në anën tjetër dënimi me burg ka bërë që të mbushen burgjet me vjedhës, plaçkitës, rrëmbyes, dhunues etj. Një prerje e dorës, shëron një qytet”.⁸³⁸

⁸³⁴ Po aty, fq. 48

⁸³⁵ Po aty, fq. 51.

⁸³⁶ Po aty, fq. 53, 295.

⁸³⁷ Po aty, fq. 58, 59, 60, 62

⁸³⁸ Po aty, fq. 148

- Nuk i thekson parametrat dhe çështjet juridike që diktohen nga ajeti, por mjaftohet vetëm me udhëzimin e lexuesit në burimet juridike që merren me këtë çështje. Sikur kinse ka dashur të thotë, parimet juridike janë pjesë e fikhut e jo të tefsirit, dhe kjo vërehet qartë në ajetet e haxhit dhe umres.⁸³⁹
- I aplikon rregullat e usulit në tefsirin e tij dhe sipas tyre i sqaron edhe domethëniet e ajeteve.⁸⁴⁰
- I potencon karakteristikat e përgjithshme të Islamit, bukurinë dhe madhërinë e tij, pastaj faktin se Islami nuk i detyron njerëzit në fë e parime me dhunë. Ai po ashtu thotë se Islami është fe e tërësishme dhe nuk mund të ndahet në pjesë.⁸⁴¹
- Asnjëherë nuk i thekson në tefsirin e tij dialektet (kiraetet) e leximeve të Kur'anit.⁸⁴²
- I tregon sëmundjet e shoqërisë dhe shërimin e tyre me Kur'anin Fisnik. Ai po ashtu konfirmon faktin se Kur'ani përqendrohet në formimin e shoqërisë së shëndoshë, dhe atë në bazë të formimit të lidhjeve ligjore martesore, dhe se lumturia e çiftit martesor varet nga feja e njëjtë, ngase sikur të kishin fe të ndryshme, lidhja mes tyre do të ishte e shkurtër dhe jostabile.⁸⁴³

⁸³⁹ Po aty, fq. 59, 60, 61, 81

⁸⁴⁰ Po aty, fq. 63.

⁸⁴¹ Po aty, fq. 63, 64.

⁸⁴² Siç duket, shqiptarët nuk janë interesuar as në të kaluarën e as në të tashmen për këtë art dhe për këtë dituri në shkencën e Tefsirit, ngase nuk ka pasur personalitete shkencorë dhe ekspertë të kualifikuar të kësaj fushe. Urtësia e Krijuesit të Madhërisë ka dashur që ky art shkencor kur'anor të paraqitet në sferën shkencore shqiptare për herë të parë në kohën bashkëkohore, konkretisht pas diplomimit të dy studentëve shqiptarë nga Kosova në Fakultetin e Kur'anit Fisnik dhe Studimeve Islame, në Universiteti Islamik në Medinen e Ndritshme, në vitin 1994/95. Këta dy studentë janë:

1. Robi i dobët dhe nevojtar për mëshirën e Zotit, gjegjësisht autori i këtij punimi dhe i diplomuari dhe i specializuar në lexim, (قراءات القرآن) (kiraet) me zinxhir (sened) (السند المتصل إلى رسول الله صلى الله عليه وسلم) të ndërlidhur deri te Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), në bazë të transmetimit të Imamit Hafs nga Imam Asimi, sipas metodës dhe versionit të Imam Shatibiut; dhe:

2. Vëllai dhe profesori i nderuar hfz. Safet Hoxha (Zoti e bekoftë!), mësimdhënës i lëndës së leximit të Kur'anit Fisnik (Kiraetit) në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë dhe në Medresenë e mesme "Alaudin" dega ne Prizreni. Profesori hfz. Safet Hoxha nuk pati fatin të diplomoj dhe të specializoj me sened të ndërlidhur deri te Pejgamberi a.s. Falënderimi i takon Zotit si në fillim ashtu edhe në mbarim!

⁸⁴³ Po aty, fq. 66, 70, 73.

- I thekson qëllimet e parimeve të Sheriatit, si p.sh., qëllimi i martesës është mbrojtja nga prostitucioni dhe ruajtja e llojit njerëzor, etj.⁸⁴⁴
- Bën krahasime në mes ideve dhe mjaftohet vetëm me mendimin e preferuar, si p.sh: Kur tregon ngjarjen e krijimit të Ademit dhe Havës a.s. mjaftohet vetëm me atë që potencohet në Kur'an, gjegjësisht me të dhënat kur'anore se origjina e njerëzve rrjedh nga Ademi a.s. dhe se Hava është krijuar po nga e njëjta origjinë.⁸⁴⁵
- Nuk i analizon doktrinat e sekteve akaidologjike, si dhe nuk zgjerohet në çështjet dhe problematikat e akaidit.⁸⁴⁶
- Ndonjëherë përdorë metaforën, dhe kjo qartë vërehet në komentimin e ajetit:

(﴿ اَلْمِهَادُ وَيَسَّ جَهَنَّمَ اِلَى وَتُحْشَرُونَ سَتُغْلَبُونَ كَفَرُوا لِلَّذِينَ قُل ﴾)

آل عمران: 12]

“Thuaju atyre që nuk besuan: Do të jeni të mposhtur (në këtë jetë) dhe do të hidhen në Xhehenem. Sa i shëmtuar është ai djep (*shtrat*)”. (Ali Imran, 12).

Në këtë kontekst, ai thotë: “Vendi i tyre në Xhehenem është trajtuar si djep, e ka për qëllim t’i njoftojë kundërshtarët mendjemëdhenj se do të jenë aq të paafët, aq të dobët, sa që i përngjajnë foshnjës që nuk ka kurrfarë aftësie, por të tjerët e vejnë aty ku të duan”.⁸⁴⁷

- Në tefsirin e sures “El-Kadr”, kur shpjegon fjalën e Zotit të Madhërishëm “Ne të zbritëm atë (Kur’anin)”, (إِنَّا أَنْزَلْنَاهُ) thotë se kjo është në alegori (mexhazi-mursel), ngase zbritja është veti e trupave fizikë, e Kur’ani nuk është i tillë, por bartja e tij prej Levhi-Mahfudhit në qiell te dynjasë, prej së larti poshtë i ngjanë lëshimit të një trupi fizik”.⁸⁴⁸
- Në fund të përkthimit dhe të tefsirit të sures, ripërsëritë fjalët e tij në gjysmë faqe, i tregon tematikat që i përmban sureja dhe i sqaron synimet e Kur’anit, përmes sures konkrete, gjegjësisht përfitimin e zemrave të robërve për ta njohur Krijuesin në bazë

⁸⁴⁴ Po aty, fq. 66

⁸⁴⁵ Po aty, fq. 109.

⁸⁴⁶ Po aty.

⁸⁴⁷ Po aty, fq. 82.

⁸⁴⁸ Po aty, fq. 724.

të vështirimit të krijesave dhe gjallesave. Kur'ani kërkon prej njerëzve që ta lexojnë Kur'anin e shkruar në fleta pastaj të lexojnë dhe përsiatin rreth këtij Libri të dukshëm, gjegjësisht rreth gjithësisë dhe në mes tyre do të vërejmë përputhshmëri dhe harmoni të madhe.⁸⁴⁹

- Flet për shërimin e çështjeve aktuale shoqërore në mënyrë shumë të thuktë, dhe atë duke deduktuar këshilla e mësimi nga ajetet. Ai (Zoti e mëshiroftë!), po ashtu shqyrton çështjen e zbulimit të trupit, si për meshkujt ashtu edhe për femrat, dhe në këtë kontekst thotë se këto janë mashtrime nga shejtani dhe se nuk trajtohen si çështje të qytetërimit e as të përparimit.⁸⁵⁰
- Nuk mbështetet në mendime dhe koncepte anormale dhe anomali, dhe kurrë nuk del jashtë fjalëve të pjesës dërmuese të dijetarëve dhe pranon atë që e preferuan, dhe për këtë gjithësesi meriton fjalë miradije (Zoti e mëshiroftë!).⁸⁵¹
- Ndonjëherë harmonizon kuptimet e ajeteve me ajetet, të cilët sipërfaqësisht duken se janë kontradiktorë, me qëllim që ta zhdukë moskuptimin dhe kundërthënien.⁸⁵²
- Tregon interesim të madh ndaj këshillave dhe mësimëve që mund të nxirren nga rrëfimet kur'anore.⁸⁵³
- Ndonjëherë formon lidhje në mes fshehtësisë së ajeteve me zbulimet e reja, për ta bindur trurin e njeriut mbi fuqinë dhe Madhështinë e Zotit të Madhërishëm, dhe kjo vërehet në tefsirin e ajetit kur'anor:

[النحل : 8] ﴿ تَعْلَمُونَ لَا مَا وَخَلُقَ وَزِينَةً لِّتَرْكَبُوهَا وَالْحَمِيرَ وَالْبِغَالَ وَالْحَيْلَ ﴾

“Edhe kuajt (i krijoi) edhe mushkat edhe gomarët, për t’ju hipur atyre dhe si stoli, e Ai krijon (për hipje) çka ju (tash) nuk dini”, (En-Nahlu, 8). Në këtë kontekst ai thotë: “Krijon edhe çka ju nuk dini”- u thotë Kur'ani atyre të asaj kohe, pra pati për qëllim t’i japë shenjë mendjes, se mjetet për hipje do të jenë edhe të tjera, sikur që po i shohim

⁸⁴⁹ Po aty, fq. 107.

⁸⁵⁰ Po aty, fq. 189.

⁸⁵¹ Po aty, fq. 211.

⁸⁵² Po aty, fq. 221, 222

⁸⁵³ Po aty, fq. 272, 277, 279

tash mjetet transportuese dhe të mos thotë ndokush: Të parët e mi u shërbyen me kuaj, me gomerë, me mushka, etj.⁸⁵⁴

- Tregon mbi fshehtësitë e ajeteve kur'anore që vijnë me fjalë dhe forma të ndryshme, si p.sh., fjalët: “mendojnë”, “kuptojnë”, “kujtojnë”. Nga kjo nënkuptohet se pa meditim të thellë mbi fenomenet natyrore, nuk përfitohet rezultati i kërkuar.⁸⁵⁵
- Nuk i komenton ajetet nga aspekti shkencor, dhe nëse vjen diçka e tillë, ai mbështetet në mendimet e ekspertëve, si p.sh., çështjet që kanë të bëjnë me kodrat dhe detet. Ai i kritikon ata që i komentojnë ajetet kur'anore sipas epsheve dhe ambicieve të tyre, pa u mbështetur në të dhëna të vërtetuara shkencore.⁸⁵⁶
- Përdor shembuj racionalë dhe shkencorë, për konfirmimin e ringjalljes gjatë tefsirit të ajeteve që kanë të bëjnë me bimët, kafshët e njeriun.⁸⁵⁷
- I kritikon ata që mohojnë përdorimin e Sunnetit, ixhmail dhe të kijasit si argumente, edhe atë konkretisht në komentimin e ajetit kur'anor:

شَدِيدُ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ وَاتَّقُوا فَانْتَهُوا عَنْهُ نَهَكُمْ وَمَا فَخَذُوهُ الرَّسُولُ ءَاتَكُمْ وَمَا

([الحشر: 7] ﴿٧﴾ الْعِقَابِ)

“Çka t’ju jep Pejgamberi, atë merrni, e çka t’ju ndalojë përmbajuni dhe kini frikë Allahun, se Allahu është ndëshkues i ashpër”. (El-Hashr, 7), duke thënë se me këtë ajet konfirmohet argumentimi me Sunnet.

Argumentimin me ixhma e vërteton me ajetin kur'anor:

تَوَلَّهِ الْمُؤْمِنِينَ سَبِيلَ غَيْرٍ وَيَتَّبِعِ الْهُدَىٰ لَهُ تَبَيَّنَ مَا بَعْدَ مِنَ الرَّسُولِ يُشَاقِقِ وَمَنْ

([النساء : 115] ﴿١١٥﴾ مَصِيرًا وَسَاءَتْ جَهَنَّمُ وَنُصْلَهُ تَوَلَّى مَا

“Kush i kundërvihet të Dërguarit, pasi që i është bërë e qartë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve...” (En-Nisa, 115).

Argumentimin me kijas po ashtu e vërteton me ajetin kur'anor:

⁸⁵⁴ Po aty, fq. 312.

⁸⁵⁵ Po aty, fq. 313.

⁸⁵⁶ Po aty, 618-619

⁸⁵⁷ Po aty, fq. 319

([الحشر : 2] ﴿الْأَبْصَارُ يَتَأُولَىٰ فَاَعْتَبِرُوا﴾)

“Pra, merrni përvojë, o ju të zotët e mendjes!” (El-Hashr, 2).⁸⁵⁸

- Kur flet për shkronjat e ndara, thotë (Zoti e mëshiroftë!), se janë simbole, ashtu siç mendonin edhe disa dijetarë të tjerë. Ai po ashtu thotë se ka edhe mendime tjera rreth këtyre çështjeve.⁸⁵⁹
- Metoda e tij (Zoti e mëshiroftë!), në tefsirin dhe te’vilin e ajeteve që kanë të bëjnë me Emrat dhe Cilësitë-Atributet e Allahut të Madhërishëm (*El Esmau ves Sifat*), është variabile; herë konfirmon (*bën ithbat*), ashtu siç janë të theksuara në Kur’an, herë komenton (*bën te’vijl*), dhe herë nuk tregon ndonjë qëndrim të qartë në komentim ose konfirmim (*la ithbat ve la te’vijl*).

Nga ekspozesa jonë e këtyre shembujve, që vijojnë kuptojmë më së miri metodën e tij në këtë çështje të rëndësishme akaidologjike. Këto shembuj të ilustruar janë për argumentim, e jo përmbledhje e tërësishme.

NJË: SHEMBUJ KONFIRMIMI:

* Në komentimin e ajetit kur’anor:

مَبْسُوطَتَانِ يَدَاهُ بَلَّ قَالُوا بِمَا وَلُعِنُوا أَيَدِيَهُمْ غُلَّتْ مَغْلُولَةً اللَّهُ يَدُ الْيَهُودِ وَقَالَتْ

([المائدة : 64] ﴿يَشَاءُ كَيْفَ يَنْفِقُ﴾)

“Jehuditë thanë: “Dora e Allahut është e shtrënguar!” Qofshin të shtanguar duart e tyre dhe qofshin të mallkuar, pse thanë atë. Jo, duart e Tij janë të shkira”. (El-Maide, 64), vërejmë se ai (Zoti e mëshiroftë!) në përkthimin e këtij ajeti, konfirmon cilësinë e dy Duarve të Zotit të Madhërishëm, ashtu siç theksohen në ajet pa kurrfarë devijimi,⁸⁶⁰ ndryshimi apo intervenimi.

* Në përkthimin dhe në komentimin e ajetit kur’anor:

⁸⁵⁸ Po aty, fq. 322.

⁸⁵⁹ Po aty, fq. 361.

⁸⁶⁰ Po aty, fq. 151; shih Tefsirin e Taberiut, vëll. 4, f. 639, ku theksohen disa mendime ose opsione rreth tefsirit të këtij ajeti, disa prej tyre konfirmojnë cilësinë e dorës ose dy duarve të Zotit të Madhërishëm, kurse sipas disa të tjerëve, fjala “**dorë**” komentohet si pushtet, begati, dhunti etj.

([الفتح: 10] أَيْدِيَهُمْ فَوْقَ اللَّهِ يَدُ اللَّهِ يُبَايِعُونَ إِنَّمَا يُبَايِعُونَكَ الَّذِينَ إِنَّ)

“Ata që të zotohen ty, në të vërtetë, ata i zotohen Allahut, se dora e Allahut është mbi duart e tyre”. (El-Fet’hu, 10); Hoxha (Zoti e mëshiroftë!) konfirmon cilësinë “dorë” gjatë përkthimit dhe komentimit në gjuhën shqipe.⁸⁶¹

* Në komentimin e ajetit kur’anor:

([الذاريات: 47] لَمُوسِعُونَ وَإِنَّا بِأَيْدِي بَنِينَهَا وَالسَّمَاءِ)

“Ne, me forcën Tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë” (Edh-Dharijat, 47), kur e përkthen tekstualisht thotë se “Ne, me forcën tone e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë.”⁸⁶²

Ky ajet kur’anor, edhe pse në strukturën e tij përmendet fjala (أَيْدِ), (duart), shumësi i fjalës (يَدِ), (dora), kuptimi më i saktë i tij, sipas komentuesve të Kur’anit, gjeneratës së hershme dhe asaj bashkëkohore, pikërisht në këtë vend dhe në këtë sure-nënkupton: (Forca dhe Fuqia e Allahut), dhe fjala (أَيْدِ) (duart)- sipas hoxhës dhe komentuesit tonë (Zoti e mëshiroftë!) është përkthyer dhe komentuar në mënyrë shumë precize dhe të saktë, ashtu sikur e kanë komentuar komentuesit e mëdhenj, të hershmit dhe ata bashkëkohorë.⁸⁶³

⁸⁶¹ Po aty, fq. 589. Sipas Imam Taberit (Zoti e mëshiroftë!), në vëll. 3, f. 338, ekzistojnë dy mendime rreth kësaj çështjeje: Konfirmimi i Cilësisë së Dorës së Zotit të Madhërishëm pa ndonjë komentim, dhe komentimi i fjalës “dorë” si “Fuqi”.

⁸⁶² Po aty, f. 603-604; Ibn Kethiri, në komentimin e këtij ajeti: “*me duart tona*”, thotë: “*me fuqi*”, dhe të këtij mendimi janë edhe Ibn Abasi, Muxhahidi, Katade, Eth-Theuri dhe të tjerë. Shiko tefsirin e tij, vëll. 4, f. 303. Edhe Taberiu thotë se “ne themi ashtu siç e komentojnë edhe të tjerët, si p.sh., Ibn Abasi kur flet për ajetin “ *وَالسَّمَاءِ بَنِينَهَا بِأَيْدِ وَ إِنَّا لَمُوسِعُونَ*” thotë: “*me fuqi*”. Shih tefsirin e tij, vëll. 11, f. 472. Sipas Imam Begaviut, në tefsirin e ajetit “ *وَالسَّمَاءِ بَنِينَهَا بِأَيْدِ وَ إِنَّا لَمُوسِعُونَ*”, nënkuptohet: “*me fuqi dhe me forcë*” shih vëll. 1, f. 379.

⁸⁶³ Po aty, f. 603-604; Ibn Kethiri, në komentimin e këtij ajeti: “*me duart tona*”, thotë: “*me fuqi*”, dhe të këtij mendimi janë edhe Ibn Abasi, Muxhahidi, Katade, Eth-Theuri dhe të tjerë. Shiko tefsirin e tij, vëll. 4, f. 303. Edhe Taberiu thotë se “ne themi ashtu siç e komentojnë edhe të tjerët, si p.sh., Ibn Abasi kur flet për ajetin “ *وَالسَّمَاءِ بَنِينَهَا بِأَيْدِ وَ إِنَّا لَمُوسِعُونَ*” thotë: “*me fuqi*”. Shih tefsirin e tij, vëll. 11, f. 472. Sipas Imam Begaviut, në tefsirin e ajetit të lartepërmendur, nënkuptohet: “*me fuqi dhe me forcë*” shih vëll. 1, f. 379.

* Në komentimin e ajeteve që flasin për shikimin e Zotit të Madhërishëm në Ditën e Kijametit, ai (Zoti e mëshiroftë!) thotë se dijetarët kanë disa qëndrime rreth kësaj çështje, dhe më e preferuara dhe më e saktë është thënia se besimtarët do ta shohin Zotin e Madhërishëm, dhe se ky është edhe qëndrimi i dijetarëve të Ehli Sunnetit dhe xhematit.⁸⁶⁴

* Në tefsirin dhe sqarimin e ajetit kur'anor:

[طه:39] ([عَيْنِي عَلَىٰ وَلْتَصْنَعْ)

tekstualisht kështu thotë: “E që të edukoheshe nën mbikëqyrjen Time” (Taha, 39), d.m.th., fjala: (عَيْنِي), (Syri im), është përkthyer dhe komentuar me : (Kujdes, mbikëqyrje, edukim) etj. Edhe ky përkthim dhe ky komentim është shumë i saktë dhe shumë preciz. Komentuesit e mëdhenj të Kur'anit, ata të hershmit dhe këta të më vonshmit, e kanë komentuar po në këtë mënyrë, ashtu siç e ka përkthyer edhe hoxha dhe komentuesi ynë Haxhi Sherif Ahmeti (Zoti e mëshiroftë!).⁸⁶⁵

* Në komentimin e ajetit kur'anor:

[القلم:42] (سَاقٍ عَنِ يُكْشَفُ يَوْمَ)

“(Përkujto) Ditën kur ashpërsohet çështja deri në kulm (në Kijamet)”. (El-Kalem, 42), vërejmë se hoxha dhe komentuesi ynë e përkthen dhe komenton fjalën “السَّاقِ” që d.m.th.: (Ashti i pulpit te këmbës) si: “ashpërsim deri në kulm”, (që në realitet edhe kjo fjalë është Cilësi dhe Atribut i Allahut të Madhërishëm). Edhe në këtë rast hoxha dhe komentuesi ynë (Zoti e mëshiroftë!), e ka përkthyer dhe e ka komentuar në mënyrë shumë të saktë dhe precize, tamam ashtu siç e kanë komentuar edhe komentues të hershëm dhe këta të më vonshmit.⁸⁶⁶

⁸⁶⁴ Po aty, f. 175, 204, 684.

⁸⁶⁵ Po aty, f. 362; Imam Muhammed ibn Ali Sheukani në komentimin e ajetit “وَلْتَصْنَعْ عَيْنِي”, thotë: “të edukohet e të ushqehet nën mbikëqyrjen Time” Shih tefsirin e tij, vëll. 3, f. 521; Sipas Ibn Kethirit, ajeti “وَلْتَصْنَعْ عَيْنِي”, Ebu Umran El-Xhuveni thotë se d.m.th.: “edukohet me ndihmën e Zotit”, ndërsa sipas Katades, d.m.th.: “ushqehet me ndihmën Time”, ndërsa sipas Muammer ibn Muthennait, ajeti “وَلْتَصْنَعْ عَيْنِي” nënkupton: “mbikëqyrjen Time dhe kujdesin Tim...”; shih tefsirin e Ibn Kethirit vëll. 3, f. 199.

⁸⁶⁶ Po aty, f. 663, 665; Ibn Kethiri komenton ajetin “يَوْمَ يُكْشَفُ عَنِ سَاقٍ”, nënkupton: “Ditën e Kijametit dhe ndryshimet, tërmetet, problemet, sprovat dhe çështjet e mëdha”. Nga Ikrimë thuhet se ka transmetuar nga Ibën Abasi se, “يَوْمَ يُكْشَفُ عَنِ سَاقٍ” nënkupton:

* Në përkthimin dhe në komentimin e ajetit kur'anor:

[طه: 41] (لِنَفْسِي وَأَصْطَنَعْتُكَ)

“Dhe Unë të zgjedha ty për shpalljen time” (Taha, 41), ai thotë se “Unë të zgjedha ty për shpalljen time”. Edhe në këtë ajet kur'anor është përmendur një Cilësi dhe atribut prej Atributeve të Allahut të Madhërishëm, dhe ajo është fjala (نَفْسِي), (për Mua, për Vetën time), por hoxha dhe komentuesi ynë (Allahu e mëshiroftë!) e ka përkthyer dhe e ka komentuar ashtu siç e kanë komentuar edhe komentuesit e tjerë, të hershmit dhe ata të më vonshmit.⁸⁶⁷

* Në tefsirin dhe në përkthimin e ajetit kur'anor:

أَحْكُمُ لَهُ وَجْهَهُ إِلَّا هَالِكُ شَيْءٍ كُلُّهُ إِلَّا إِلَهَ لَا آخَرَ إِلَهًا اللَّهُ مَعَ تَدْعُ وَلَا
[القصص: 88] (تَرْجِعُونَ وَإِلَيْهِ)

“Çdo send zhduket e Ai jo. Vetëm Atij i takon gjykimi dhe tek Ai do të kthehem” (Kasas, 88), hoxhë Sherif Ahmeti (Zoti e mëshiroftë!) komenton duke qartësuar se çdo gjë do të zhduket përveç Zotit të Madhërishëm, ngase Ai është i Përhershëm dhe Eternal. Edhe në këtë ajet është përmendur një Cilësi dhe Atribut i Allahut të Madhërishëm, e ajo është fjala (الوجه). Edhe në këtë vend përkthimi dhe komentimi i mufesirit tonë Haxhi Sherif Ahmeti ka qenë i saktë dhe preciz, dhe ky ajet është komentuar po në atë mënyrë siç e kanë interpretuar ata të hershmit dhe këta të vonshmit.⁸⁶⁸

⁸⁶⁷ Po aty, f. 362; Në tefsirin e Ibn Kethirit, vëll. 3, f. 207 thuhet se me ajetin “واصطنعتك لِنَفْسِي” nënkuptohet “të zgjedha për shpalljen Time dhe të lëvizësh sipas dëshirës dhe vullnetit Tim”; vëll. 1, f. 274

⁸⁶⁸ Po aty, fq. 452: Ibn Kethiri thotë: “Fjala e Tij: “كل شيء هالك إلا وجهه”, rrëfen se Ai është i Përhershëm, Eternal i Gjallë, i Fuqishëm dhe i vdes krijesat, por Vetë nuk vdes, dhe në këtë kontekst, Zoti i Madhërishëm thotë:

(كُلُّ مَنْ عَلَيْهَا فَانٍ وَيَبْقَى وَجْهُ رَبِّكَ ذُو الْجَلَالِ وَالْإِكْرَامِ) [الرحمن: 27-26]

* Në mënyrën e tefsirit të “istivasë”, (استوى), herë konfirmon e herë komenton. Në tefsirin e ajetit kur'anor:

عَلَى أَسْتَوَى ثُمَّ أَيَّامٍ سِتَّةٍ فِي وَالْأَرْضِ السَّمَوَاتِ خَلَقَ الَّذِي اللَّهُ رَبُّكُمْ إِنَّ

([الأعراف: 54] الْعَرْشِ)

“Vërtetë, Zoti juaj, Allahu është Ai që krijoi qiejt e tokën brenda gjashtë ditësh, pastaj qëndroi mbi Arshin” (Al’raf, 54), ai tekstualisht përmend “istivanë”, pa ndonjë intervenim, ndryshim apo ndërrim.⁸⁶⁹ Në këtë kontekst, ai thotë: “Qëndrimin e Zotit mbi Arshin duhet besuar bindshëm e pa kurrfarë komentimi”.⁸⁷⁰

Prandaj në këtë rast ai (Zoti e mëshiroftë!) e konfirmon këtë Cilësi të Allahut të Madhërishëm, pa ndonjë ndryshim apo devijim, ashtu siç e kanë komentuar interpretuesit e hershëm (*Selefus-Salihi*), prandaj ky është mendimi i saktë dhe ai qëndrim që çdo musliman duhet të mbajë, përkatësisht të ketë këtë qëndrim, kur është në pyetje kjo çështje mjaft e rëndësishme e besimit.

Pra, siç duket, hoxha është shumë i qartë në qëndrimin e tij ndaj çështjes së “ istivasë mbi Arshin ” në këtë ajet dhe në këtë vend të tefsirit të tij, pa komentuar apo intervenuar fare, bile tekstualisht e përdorë termin ashtu siç theksohet në ajet.⁸⁷¹

* Në komentin e ajetit të “istivasë” në suren Junus, 3, thotë:

الْعَرْشِ عَلَى أَسْتَوَى ثُمَّ أَيَّامٍ سِتَّةٍ فِي وَالْأَرْضِ السَّمَوَاتِ خَلَقَ الَّذِي اللَّهُ رَبُّكُمْ إِنَّ

([يونس: 3])

“Ai nuk pati as nuk ka nevojë për vend, por pasi krijoi gjithësinë, qëndroi mbi Arshin. Para krijimit të gjithësisë, nuk pati nevojë për vend,

dhe këtu rrëfen pikërisht për Vetveten”. Kështu në “Sahih” transmetohet nga Ebu Seleme, ky nga Ebu Hurejrja, se Pejgamberi (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: “*Fjala më e përshtatshme është ajo e poetit Lebid: (ألا كل شيء ما خلا)*”⁸⁶⁹ Pra, çdo gjë përveç Zotit është e “pavlefshme”; vëll. 3, fq. 533.

⁸⁶⁹ Po aty, fq. 192.

⁸⁷⁰ Po aty, fq. 193.

⁸⁷¹ Ibrahim Salim Ibn Hasan, “Kadijetul-te’vili fil-Kur’anil-Kerimi bejnel-gulati vel-mu’tedilin”; Bejrut, Daru Kutejbe, bot. 1, fq. 1993.

nuk pati nevojë as pas krijimit; Po përse atëherë tha: “Qëndron mbi Arsh?” Kjo është punë e Tij dhe e askujt tjetër!”.⁸⁷²

DY: SHEMBUJ NGA THËNIET KOMENTUESE TË CILËSIVE TË ALLAHUT TË MADHËRISHËM, DHE RASTE TË PAKUPTIMTA

Në këto shembuj vijues, do te vërejmë se hoxha dhe komentuesi ynë (Zoti e mëshiroftë!), në pjesën dërmuese të këtyre ajeteve e përkthen dhe komenton frazën (استوى) me : “mbizotërim”- që përshtatet në arabisht me frazën (استولى), komentim ky që nuk është i pranuar te dijetarët e gjeneratës së hershme, dhe që është larg realitetit. Menhexhi dhe tradita e dijetarëve të hershëm (Selefus- Salih) në këto ajete që kanë të bëjnë me metafizikën dhe Cilësitë e Allahut të Madhërishëm, ka qenë që ata mos t’i komentojnë dhe fare mos t’u japin kuptim, por t’i besojnë ashtu si janë të zbritura në Kur’an, duke ia mbështetur kuptimin e saktë të këtyre ajeteve, vetëm Allahut të Madhërishëm, ngase Ai është i Vetmi është që di se çka ka nënkuptuar me këtë ajet (استوى), ashtu siç është transmetuar nga Imam Maliku, i cili, kur është pyetur për këtë çështje është përgjigjur: “Istivaja është diçka e ditur, por realiteti është i paditur, ndërsa pyetja rreth saj është bidat”.

(الاستواء معلوم و كيف مجهول و السؤال عنه بدعة).

Haxhi Sherifi (Zoti e mëshiroftë!) në këtë çështje delikate nuk ka ndjekur një metodologji specifike, dhe nuk ka pasur qëndrim të prerë. Herë e ka komentuar Istivanë me: Mbizotërim, (استولى), herë e ka ndjekur Menhexhin dhe traditën e Selefus Salihit, dhe e ka lërë ashtu si është shpallur, dhe shpesh-herë edhe ka bërë lëshime, nuk ka dhënë komente fare rreth Arshit apo Istivasë. Në këto shembuj vijues do ta kristalizojmë këtë çështje në mënyrë më precize:

* Në komentimin e “Istiva-së” në suren Er Ra’d, ajeti 2, ai (Zoti e mëshiroftë!) thotë:

[الرعد: 2] اَلْعَرْشُ عَلَى اَسْتَوًى ثُمَّ تَرَوْنَهَا عَمَدٍ بَغِيرِ السَّمَوَاتِ رَفَعَ الَّذِى اَللَّهُ

“Ai mbizotëroi Arshin.” Hoxha e ka lëshuar komentimin e fjalën “El-Istiva” në këtë ajet dhe nuk e ka përkthyer apo komentuar fare.⁸⁷³

⁸⁷² Po aty, fq. 245-246.

⁸⁷³ Po aty, fq. 289-290.

* Ai (Zoti e mëshiroftë!), po ashtu e ka anashkaluar përkthimin dhe komentimin e fjalës “*El-Istiva*” tërësisht në ajetin kur’anor:

([طه 5] اَسْتَوَىٰ الْعَرْشَ عَلَى الرَّحْمٰنِ)

“(E Ai është) Mëshiruesi që krijoi tokën dhe qiejt e lartë”. (Taha, 5), dhe kështu, siç u theksua më lartë e përkthen ajetin kur’anor, dhe siç vërehet qartë ai nuk e ka përmendur fare fjalën “*El-Istiva*”.

Në komentimin e këtij ajeti, thotë: “që krijoi gjithçka dhe prej Fronit të Vet udhëheq me gjithçka”.⁸⁷⁴

Pra, vërehet qartë se në këto fjalë ka pakuptimshmëri dhe paqartësi rreth çështjes së “*Istiva-së*”, dhe rreth qëndrimit të komentuesit ndaj kësaj problematike të rëndësishme në besimin tonë.

* Po ashtu edhe në përkthimin e fjalës “*El-Istiva*” në suren, El Furkan, ajeti 59, ai e shpjegon:

اَلْعَرْشَ عَلَى اَسْتَوَىٰ ثُمَّ اَيَّامٍ سِتَّةٍ فِي بَيْنَهُمَا وَمَا وَالْاَرْضَ السَّمَوَاتِ خَلَقَ الَّذِي

([الفرقان: 59])

“E pastaj mbizotëroi Arshin” dhe siç vërehet qartë edhe këtu, hoxhë Sherif Ahmeti (Zoti e mëshiroftë!), nuk e ka shqyrtuar fare këtë term, por përkundrazi ka dhënë kuptim të devijuar.⁸⁷⁵

* Po ashtu vërejmë se ai (Zoti e mëshiroftë!), në suren Sexhde, ajeti 4, سِتَّةٍ فِي بَيْنَهُمَا وَمَا وَالْاَرْضَ السَّمَوَاتِ خَلَقَ الَّذِي اللهُ

([السجدة: 4] اَلْعَرْشَ عَلَى اَسْتَوَىٰ ثُمَّ اَيَّامٍ

termin “*El-Istiva*” e ka shpjeguar ashtu siç e kishte shpjeguar edhe më parë me frazën: “E pastaj mbizotëroi “*Arshin*”; Ai përsëri e komenton dhe thotë: “Që mbizotëroi gjithësinë”.⁸⁷⁶

* Ai (Zoti e mëshiroftë!), përdorë të njëjtën frazë edhe në përkthimin e tij të ajetit të 4 të sures Hadid dhe thotë:

⁸⁷⁴ Shih tefsirin e hoxhë Sherif Ahmetit, fq. 359, 369.

⁸⁷⁵ Po aty, fq. 417-418.

⁸⁷⁶ Po aty, fq. 475-476.

(﴿الْعَرْشِ عَلَى أَسْتَوَى ثَمَّ أَيَّامٍ سِتَّةٍ فِي وَالْأَرْضِ السَّمَوَاتِ خَلَقَ الَّذِي هُوَ﴾)

[الحديد: 4]

“Pastaj mbisundoi Arshin, gjegjësisht, Ai mbisundoi Arshin pasi krijoi qiejt dhe tokën”. Në tefsirin e këtij ajeti, nuk komenton fare fjalën “El-Istiva”.⁸⁷⁷

Kjo çështje e komplikuar akaidologjike dhe shkencore, ka preokupuar mendjen e shumë dijetarëve si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen, dhe nëse do të përpiqeshim të verifikojmë apo realizojmë studimin e kësaj çështjeje metafizike, vërejmë se zemra anon dhe është më e qetë me qëndrimin e doktrinës së “*Selefi-salihit*”, e cila nuk shpjegon ajetet e tilla dhe i pranon ashtu siç janë shpallur. Kjo doktrinë e mbron qëndrimin e tillë me argumente të fuqishme.⁸⁷⁸

TRE: SHEMBUIJ NGA SYNIMET PËRFUNDIMTARE DHE SHOQËRORE TË TEFSIRIT TË HOXHË SHERIF AHMETIT

- URTËSIA E NDËRRIMIT TË LËKURAVE TË BANORËVE TË XHEHENNEMIT:

Hoxhë Sherif Ahmeti (Zoti e mëshiroftë!), kur komenton ajetin kur'anor:

﴿جُلُودًا بَدَلْنَاهُمْ جُلُودَهُمْ نَضْجَتْ كُلَّمَا نَارًا نُصَلِّهِمْ سَوَّافَ بَيَّاتِنَا كَفَرُوا الَّذِينَ إِنَّ﴾)

([النساء: 59] ﴿حَكِيمًا عَزِيزًا كَانَ اللَّهُ إِنَّ الْعَذَابَ لِيَذُوقُوا غَيْرَهَا﴾)

⁸⁷⁷ Po aty, fq. 625.

⁸⁷⁸ E shqyrtova këtë çështje në disertacionin tim të doktoraturës në gjuhën arabe në mënyrë të zgjeruar, dhe kush dëshiron më tepër të dhëna, le të shfletojë faqet 268-293 rreth kësaj çështje të rëndësishme akaidologjike dhe rreth çështjes së Emrave e Cilësive. Shih Ebu Hanife, En-Nu'man ibn Thabit ibn Zittij El-Haz-zaz El-Kufij, “*Esh-sherhul-mujesseru alel-fikhejni El-Ebsat vel-Ek-ber el-mensubejni ila Ebi Hanife*”; pjesa e dytë: “*Rivajetu Ebi Muti'ë El-Belhij an Ebi Hanife*”; recensoi dr. Muhammed ibn Abdurrahman El-Hamis, Axhman, Mektebetul-Furkan, bot. 1, 1999, f. 159.

Bel-Kasim El-Gali, “*Ebu Mensur El-Maturidi, Hajatuhu ve ara'uhu el-akdijje*”; f. 179, transmetuar nga Shejh Zade, Nudhumul Feraid ve xhem'ul-fevaid, Feride, 14, fq. 22-23; Ebu Mensur El-Maturidij, “*Et-Teuhid*”; f. 74; Ibn Tejmiije, “*Mexhmu'atul-fetava*”; vëll. 4, fq. 1-2.

“Është e vërtetë se ata që mohuan argumentet Tona, do t’i hedhim në zjarr. Sa herë që u digjen lëkurat atyre, Ne ndërrojmë lëkura të tjera që të shijojnë dënimin. Allahu është i Plotfuqishëm, i Drejtë” (En Nisa, 56), thotë:

*“Xhehenemlinjve do t’u përtërihet lëkura e trupit sa herë që të digjet ajo. Përtëritja e lëkurës jep të kuptohet se vetëm Zoti ka fuqi të ndëshkojë kriminelin për çdo krim. Njerëzit këtë nuk mund ta bëjnë, pse për njëqind e sa krime e dënojnë me mbytje një herë!? Përmendet “djegia” e lëkurës, ngase dhembja më e ndjeshme është në lëkurë”.*⁸⁷⁹

- URTËSIA E XHIHADIT SIPAS TIJ:

“Sa herë që në Kur’an përmendet lufta, mbytja, së bashku me to përmendet fjala në rrugën ose për rrugën e Allahut, me çka kuptohet se lufta nuk ka për qëllim okupimin e vendit të huaj, nuk ka për qëllim prenë e luftës ose diçka tjetër, por ka për qëllim vetëm lirinë për besimin e drejtë, për zbatimin e lirë të fjalës së Zotit të Madhërishëm”.

*“Lufta në rrugën e Allahut nuk është humbje, sepse ai që mbytet është dëshmorë, kurse ai që shpëton e ka ndihmuar përhapjen e drejtësisë, andaj edhe ai do të ketë shpërblim të madh”.*⁸⁸⁰

- QËNDRIMI I TIJ NDAJ ZBATIMIT TË DËNIMEVE:

*“Dënimi për vjedhje është prerja e dorës. Shumë njerëz menduan se kjo masë është shumë e ashpër për kohën tonë të qytetëruar. Një mendim i tillë i gabuar dhe një filosofi e tillë e verbër, ka bërë që kriminaliteti në ekonomi të jetë gjithnjë më i madh, e në anën tjetër, dënimi me burg ka bërë që të mbushen burgjet me vjedhës, plaçkitës, rrëmbyes, dhunues, etj. Një prerje e dorës shëron një qytet”.*⁸⁸¹

- QËNDRIMI I TIJ NDAJ MARTESËS DHE KURORËZIMIT TË PËRKOHSHËM (EL-MUT’A):

“Gjithashtu është e ndaluar rreptësisht martesë e përkohshme për një sasi mjetesh materiale, sepse martesë nuk ka për qëllim vetëm anën

⁸⁷⁹ Shih tefsirin në formë të rezymesë të hoxhë Sherif Ahmetit, f. 120.

⁸⁸⁰ Po aty, fq. 60 dhe 123.

⁸⁸¹ Po aty, fq. 148.

fizike dhe epshore, por edhe anën njerëzore e bashkëshortore të singertë, që do të jetë burim i një edukimi të shëndoshë të brezit të ardhshëm”.⁸⁸²

“Qëllimet e martesës janë të krijohet rrjedhë e shëndoshë, e mirë dhe të ketë dashuri në mes dy palëve, e jo vetëm ushqimin e epsheve. Gjithashtu edhe martesë e përkohshme për një sasi mjetesh është e ndaluar”.⁸⁸³

- QËNDRIMI I TIJ NDAJ KAMATËS:

“Kjo praktikë (kamata) është rreptësisht e ndaluar në Islam, sepse pasanikët e kanë për detyrë t’i ndihmojnë nevojtarët në përmirësimin e gjendjes së tyre të vështirë, e jo t’i shtypin e t’ua keqësojnë gjendjen edhe më shumë”.⁸⁸⁴

“Është i ndaluar shfrytëzimi i pasurisë pa djersë, siç është vjedhja, mashtrimi, plaçkitja, kamata, etj.”⁸⁸⁵

- MËKATET SIPAS MENDIMIT TË HOXHËS DHE KOMENTATORIT:

“Mëkati i vogël ose i madh konsiderohet në bazë të pasojave që shkakton ai”.⁸⁸⁶

“Allahu nuk i do kryelartët, pse të tillët nuk respektojnë asnjë parim njerëzor, siç janë: Adhurimi ndaj Zotit, sjellja e mirë ndaj prindërve, të afërmeve, jetimëve, etj. Gjithashtu nuk i pranon veprat formale që kanë për qëllim lavdërimin”.⁸⁸⁷

“Zullumqarët do të zhduken, herët a vonë, ashtu sikurse u zhdukën idhujtarët e Mekës. Çdo popull që bën zullum, ai ka për t’u zhdukur”.⁸⁸⁸

⁸⁸² Po aty, fq. 115.

⁸⁸³ Po aty, fq. 115.

⁸⁸⁴ Po aty, fq. 78, 98.

⁸⁸⁵ Po aty, fq. 116.

⁸⁸⁶ Po aty, fq. 116.

⁸⁸⁷ Po aty, fq. 117.

⁸⁸⁸ Po aty, fq. 167.

- QËNDRIMI I TIJ NDAJ TEFSIRIT SHKENCOR:

Qëndrimin e tij ndaj tefsirit shkencor e kuptova gjatë leximit të hulumtimeve dhe artikujve të tij, që i ka publikuar në revistat islame shqiptare të cilat i boton Bashkësia Islame e Kosovës.⁸⁸⁹ Mendimi i tij (Zoti e mëshiroftë!), rreth kësaj çështje mund të jepet në formë të përmbledhur kështu:

“Duhet të jemi të kujdesshëm dhe të përpiktë në këtë çështje, ngase shkenca çdo ditë është në ndryshim e sipër. Po ashtu nuk lejohet që ta komentojmë Kur’anin, ose t’i obligojmë dijetarët që të vërtetojnë zbulimet shkencore me ajete kur’anore”.

“Së pari obligohemi të vërtetojmë se zbulimet e tilla a janë të vërteta apo hipoteza, dhe së dyti, Kur’ani Fisnik nuk është libër i gjeografisë, kimisë ose mjekësisë... por është Libër i udhëzimit dhe besimit që përmban në vete disa shenja nga shkencat bashkëkohore”.⁸⁹⁰

⁸⁸⁹ Dijetarët i potencojnë disa rregulla dhe kushte që duhet të respektohen në këtë lloj tefsiri, si p.sh.:

1: Hulumtimet e tilla të mos e mbulojnë qëllimin parësor të Kur’anit që ka të bëjë me udhëzimin e njerezise dhe mrekullinë e tij hyjnore (El Hidajtu ve El I'xhaz);

2: Nuk është gabim nëse komentuesi argumenton me zbulime dhe të vërteta shkencore për ta pasuruar më tepër domethënien e tekstit kur’anor, por ama me kusht që zbulimet e tilla të jenë brenda shpirtit të tekstit dhe qëllimeve të Sheriatit islamik;

3: Zbulimet e tilla të përdoren për të vërtetuar edhe më shumë madhërinë e ajetit kur’anor;

4: Që të mos fitojmë kompleks dhe dobësi shpirtërore e të themi para njerëzve se çdo gjë e re konfirmon mrekullinë e Kur’anit, me qëllim që të besojnë në Kur’an; dhe:

5: Kur’ani është shpallur për të realizuar lumturinë tonë në këtë botë dhe në botën tjetër.

Këtë çështje e kanë shqyrtuar hollësisht në disertacionin tim të doktoraturës në gjuhën arabe, dhe kush dëshiron të dhëna më të gjëra rreth saj, le t’i lexojë faqet 221-236. (Kreu mbi vlerësimin e metodës shkencore në tefsir). Muhamed Adil Ebu El-Hajn, **“Ixhtihadat fit-tefsiril-ilmij fil-Kur’anil-Kerim”**, Kajro, 1988; Merku Delta lit-tiba’ti, isportenxh, bot. 1; Ahmed Umer Ebu Haxher 1991, **“Et-tefsirul-ilmij lil-Kur’ani fil-mijzan”**; Bejrut, 1991; Daru Kutejbe lit-tiba’ati ven-neshri, bot. 1.

⁸⁹⁰ Shih revistën islame **“Edukata islame”**, botuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Prishtinë, Kosovë në gjuhën shqipe, Nr. 46-47, fq. 3-8, botuar në vitin 1986. Hoxha dhe komentuesi Haxhi Sherif Ahmeti ka bërë disa komentime në një seri të vazhdueshme në revistën e sipërpërmendur në numrat: 33-3, 1982, fq. 3-8, dhe 30-32 me titull: **“Burimi i besimit, Islamit dhe marrëdhënieve njerëzore”**; 37-38, botuar në vitin 1984, fq. 3-8, 37-44 në ajetin:

- QËNDRIMI I TIJ NDAJ MAGJISË (Sihrit):

Qëndrimi i tij ndaj magjisë vërehet në fjalët e tij, kur thotë: “Nëse mungon vullneti i Zotit, magjia nuk ka kurrfarë efekti, andaj nuk duhet besuar në efektin e saj. Magjia nuk është ndonjë qenësi reale, ndonjë e vërtetë ekzistenciale, ajo është vetëm një truk mashtrimi”.⁸⁹¹

- QËNDRIMI I TIJ NDAJ ABROGIMIT:

Qëndrimi i tij ndaj abrogimit vërehet në fjalët e tij: “Shumica dërmuese e dijetarëve islamë janë të mendimit se në Kur’an ka abrogim të dispozitave, të civateve. Disa të tjerë nuk e pranojnë mundësinë e pezullimit të ndonjë dispozite a teksti të Kur’anit, dhe mendojnë se fjala është për pezullimin e dispozitave në shpalljet e mëparshme”.⁸⁹²

- QËNDRIMI I TIJ NDAJ RISISË (BID’ATIT):

Qëndrimi i tij ndaj risisë vërehet në fjalët e tij: “Çdo risi në fe apo në adhurim që nuk ka bazë në Sheriat, është e mallkuar dhe e urryer, e nëse ka bazë në Sheriat, atëherë pranohet dhe lavdërohet”.⁸⁹³

- QËNDRIMI I TIJ NDAJ AKUZIMIT TË MUSLIMANËVE PËR “KUFËR”(TEKFIRIT):

Qëndrimi i tij ndaj akuzimit të muslimanëve për kufër (*tekfir*) vërehet në fjalët e tij: “Të gjithë muslimanët kanë një kible, dhe të gjithë kudo që gjenden, gjatë lutjeve i kthehen asaj. Derisa të gjithë janë të koncentruar në një pikë, në një kible, është rreptësisht e ndaluar që një ithtari të kibles t’i thuhet jobesimtar, kafir”.⁸⁹⁴

(لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ) [الأحزاب: 21]

“Dhe në pejgamberin e Zotit kemi shembull të mirë”, 41-42, viti 1985, fq. 60-68, ajetet 201-286 nga ajetet 156-200 nga sureja Ali Imran.

⁸⁹¹ Po aty, fq. 46.

⁸⁹² Po aty, fq. 47; Punimi më i mirë që kam hasur në kohën bashkëkohore rreth kësaj çështje, është ai i prof. dr. Xhemal Ebu Ferka El-Husejnij: “En-Nebiju El-Hatem-hel vuxhide ve men jekunu?“, Qendra e Qytetërimit Arab, Kajro, bot. 1, 203; 91-100.

⁸⁹³ Po aty, fq. 47.

⁸⁹⁴ Po aty, fq. 53.

- QËNDRIMI I TIJ NDAJ IMITIMIT TE VERBËR (TAKLIDIT):

Qëndrimi i tij ndaj imitimit të verbër (*taklidit*), vërehet në fjalët e tij: “Të imitosh në mënyrë të verbër traditat e të parëve, kur ato janë të dëmshme, është gabim i madh. Kështu vepruan idhujtarët. Ata nuk pranuan faktet e sakta, as këshillat e dobishme, por shkuan pas mësimëve të shejtanit, i cili gjithnjë mëson mbrapsht. Trashëgimi i traditave të të parëve që janë në dobi të njeriut, patjetër duhet ruajtur dhe respektuar”.⁸⁹⁵

- QËNDRIMI I TIJ NDAJ APLIKIMIT TE SUNNETIT:

Qëndrimi i tij ndaj aplikimit të Sunnetit vërehet në fjalët: “Dashuria e Zotit nuk arrihet ndryshe, por vetëm duke i dëgjuar dhe duke i respektuar të dërguarit e Tij, sepse ata janë të zgjedhur e të dalluar dhe gëzojnë vend të lartë tek Zoti...”.⁸⁹⁶

- QËNDRIMI I TIJ NDAJ ARSIMIMIT TË FEMRËS:

Në një artikull të botuar në një burim tjetër me titull “Islami dhe arsimimi i femrës”, hoxha dhe komentuesi thotë: “Islami nuk ndalon emancipimin dhe arsimimin e gruas, përkundrazi, arsimimi i saj ringjall Sunnetin e Pejgamberit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe sahabëve të tij të respektuar, ngase nëpërmes emancipimit dhe arsimimit lufton injorancën dhe fshinë analfabetizmin, që konsiderohet armiku më i ashpër i Islamit. Islami kërkon prej muslimanëve që të profesionalizohen në të gjithë lëmenjtë e shkencës, qofshin ato fetare a shkencore, pa kurrfarë përjashtimi, si për meshkujt ashtu edhe për femrat, dhe për këtë shkak, Zoti e mësoi Muhammedin që të kërkojë më shumë dituri, dhe në këtë kontekst, Zoti i Madhërishëm thotë: “*Dhe thuaj: O Zoti im, shtoma diturinë!*” (Taha, 114). S’ka dallim në mes fesë dhe kësaj bote, ashtu siç vepronin të krishterët në kohën e dekadencës së errët në Evropë. Çdo shkencë i shërben fesë ose botës, materialisht apo shpirtërisht, e shpie popullin në liri, përparim dhe e nxjerr nga kthetrat e kolonizatorit, dhe pikërisht kjo kërkohet nga aspekti i Kur’anit. Shkenca s’ka nënshtetësi e as nacionalizëm, nuk i takon një grupi apo elite të posaçme të njerëzve,

⁸⁹⁵ Po aty, fq. 56.

⁸⁹⁶ Po aty, fq. 86.

por është pronë e të gjithëve, njësoj si për meshkujt ashtu edhe për femrat”.⁸⁹⁷

- QËNDRIMI I TIJ NDAJ RREZIKUT NGA HEBRENJTË:

Hoxha dhe komentuesi e kishte kuptuar fort mirë rrezikun nga hebreujt gjatë historisë njerëzore, gjegjësisht qysh nga koha e Musait a.s. e deri më sot, dhe kjo vërehet mjaft qartë dhe haptazi në tefsirin e tij. Ai e përshkruan popullin hebre si njerëz të këqinj, tradhtarë, vënës të kurtheve, vrasës dhe mashtrues. Pra, siç duket, të gjitha këto cilësi negative të hebreujve, hoxhë Sherif Ahmeti i ka vënë para lexuesit shqiptar.⁸⁹⁸

KATËR: DISA VËREJTJE METODOLOGJIKE MBI TEFSIRIN, SUGJERIME, FALËNDERIM, PËRFUNDIM

Objektiviteti dhe besnikëria shkencore na detyrojnë që t’i japim disa vërejtje dhe vështrime, të cilat i arritëm gjatë studimit dhe leximit tonë të tefsirit të tij të thuktë dhe tejte të vlefshëm:

A. VËREJTJET METODOLOGJIKE

1. Lexuesi nuk mund të përqëndrohet dhe as të bëjë ndonjë dallim në mes kuptimeve të ajeteve të përkthyer, dhe ajeteve të komentuar në mënyrë të përgjithshme dhe të thuktë në fund të faqes, ngase ekziston ndarje dhe ndërprerje në mes kuptimeve të ajeteve të përkthyer, dhe në mes kuptimeve të komentuar.

Komentimi apo domethënia e ajeteve ekzistojnë në fillim të faqes, kurse në fund jo, dhe pas një faqe e gjysmë, pason komentimi i ajeteve të mëparshëm, dhe sipas mendimit tim, ky është çrregullim teknik dhe për këtë aspak nuk ka faj komentuesi dhe hoxha ynë i çmuar Haxhi Sherif Ahmeti (Zoti e mëshiroftë!).

2. Çështja tjetër shkencore me rëndësi, që meriton studim dhe analizë të veçantë nga studiuesit e tjerë, janë lëshimet e hoxhës, e që unë në këtë studim i kam theksuar vetëm dy shembuj, ngase kemi hasur në raste ku mungojnë kuptimet e disa pjesëve të ajetit, si dhe është dhënë

⁸⁹⁷ Më gjerësisht shih librin e hoxhës dhe komentuesit “**Komente dhe mendime islame**”; fq. 351-354.

⁸⁹⁸ Shih tefsirin e tij në faqet: 84, 142, 149, 151.

kuptim tërësisht i kundërt dhe i gabuar në përkthimin e hoxhës (Zoti e mëshirohtë!). P.sh.: Shiko komentin e ajetit 25 të përkthyer në suren En-Nisa në f. 114 të tefsirit, ku do të vëresh se ai tërësisht e ka fshirë domethënien e ajetit kur'anor:

غَيْرِ مُحْصَنَةٍ بِالْمَعْرُوفِ أَجُورَهُنَّ وَأَتَوْهُنَّ أَهْلَهُنَّ بِإِذْنٍ فَانْكَحُوهُنَّ)

([النساء: 25] أَخْذَانِ مُتَّخِذَاتٍ وَلَا مُسْفِحَتٍ)

dhe në përkthim thotë krejtësisht diçka tjetër: “jo prostitute të hapta apo të fshehta”?! , ndërsa në fakt këtu ajeti bën fjalë për vajzat që zënë ose kanë dashnorë ilegalë, shokë, dhe anasjelltas.

3. Ndërsa në suren El-Maide, ajetin 5,

إِذَا قَبِلْتُمْ مِنَ الْكِتَابِ أَوْ تَوَأَدْتُمُ الَّذِينَ مِنَ الْوَحْشَةِ الْمُؤْمِنِينَ وَالْمُحْصَنَاتِ

([المائدة: 5] أَخْذَانِ مُتَّخِذَى وَلَا مُسْفِحِينَ غَيْرِ مُحْصَنِينَ أَجُورَهُنَّ أَتَيْتُمُوهُنَّ)

[المائدة: 5]

(و لا متخذي أخدان) fjalën “خُذْنِ” e përkthen në mënyrë shumë të drejtë dhe të saktë, në f. 140, ku thotë: “E jo imoralitetin dhe jo si dashnore ilegale”.

B. PËRFUNDIM, KËSHILLA DHE FJALË MIRADIJE

Falënderoj Zotin e Madhërishëm, me begatitë e të Cilët plotësohen të mirat dhe realizohen synimet! Salavatet dhe paqja gjithnjë qofshin mbi krijesën më të respektuar, zotëriun dhe pejgamberin tonë, Muhammedin, mbi Familjen e tij, sahabët e tij të mirë dhe bashkëshortet e tyre të pastra, tërësisht paçin shpëtim!

I falënderohem Zotit që më mundësoi të studioj këtë tefsir të thuktë dhe të zbardhi e ekspozoj metodën e autorit të tij (Zoti e mëshirohtë!). Ky tefsir dallohet me metodë të këndshme, atraktive dhe me terminologji të rrjedhshme e të lehtë. Autori (Zoti e mëshirohtë!) ishte mjaft i qartë në tefsirin e tij, në ekspozimin e mësimave të dobishme, në sqarimin e kuptimeve të ajeteve dhe në tregimin e qëllimeve të Kur'anit Fisnik.

Pa mëdyshje që në këtë çështje i ka ndihmuar përvoja edukative një kohë bukur të gjatë në gjuhën shqipe, dhe s'do mend që kjo i ka

ndihmuar që të përfitojë njohuri të shumta, si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë arabe. Ka qenë jashtëzakonisht elokuent dhe i pangarkuar në fjalë, ndaj dhe secili që lexon tefsirin e tij, sa vjen e i bëhet atraktiv dhe s'mund të largohet për shkak të mënyrës së këndshme në metodë dhe rrjedhshmërisë në tekste.

Hoxha (Zoti e mëshiroftë!) kishte moral dhe edukatë të lartë gjatë korrespondencës së tij me idetë e kundërta, ishte larg fanatizmit, ngarkesës dhe epsheve, ngase e ndiqte vetëm të vërtetën dhe argumentin e saktë.⁸⁹⁹

Përfitova shumë gjatë kalimit të kohës sime me këtë tefsir, u njoftova me idetë e hoxhës dhe komentuesit për së afërmi, ngase ishte ithtar i doktrinës së Ehli-Sunnetit dhe xhematit në përgjithësi, përpos në disa çështje akaidologjike, si psh.: Qëndrimi i tij ndaj magjisë, dhe i komentimi i tij i disa ajeteve që kanë të bëjnë me *Istivanë*, gjegjësisht, komentimi i tij që i bën ajetit “...*pastaj qëndroi mbi Arshin..*”; etj. S'ka dyshim se kjo mangësi, është pjesë e cilësive të njeriut, ndërsa përkryerja absolute i takon vetëm Allahut të Madhërishëm.

Arsyeja- Allahu e di më së miri - që e ka shtyrë mufesirin tonë për një koment të tillë të ajeteve të Atributeve të Allahut të Madhërishëm, mbase mund të jetë ajo se muslimanët e Ballkanit në çështjet akaidologjike i përkasin shkollës juridike Maturidite, ndërsa ne çështje të Fikhut i përkasin shkollës juridike Hanefite.

S'ka dyshim se kjo mangësi, është pjesë e cilësive të njeriut, ndërsa përkryerja absolute i takon vetëm Allahut të Madhërishëm, dhe këto vërejtje, fare nuk e ulin vlerën shkencore të hoxhës dhe komentuesit tonë të çmuar Haxhi Sherif Ahmetit, përkundrazi. Ai, gjithashtu ka edhe një dyzinë artikujsh të tjerë në tefsir, të cilat i ka botuar në numrat e njëpasnjëshëm në revista të ndryshme në gjuhën shqipe, që botoheshin nga Bashkësia Islame e Kosovës.⁹⁰⁰

Uroj dhe lus Zotin e Madhërishëm që ta mbulojë me mëshirën e Tij, ta shtijë në Xhennet dhe ta shpërblejë sa më mirë për kontributin e dhënë për Islamin dhe muslimanët, ngase vetëm Zoti i Madhërishëm mund të shpërblejë në këtë mënyrë!

⁸⁹⁹ Shih tërë tefsirin e tij dhe do të bindesh në këtë të vërtetë.

⁹⁰⁰ Shih revistën vjetore: “**Takvim-kalendar**”, botimi i Bashkësisë Islame në Prishtinë-Kosovë, 1984, fq. 36-47, 103-111; Numrin e vitit 1986, fq. 55-67; Numrin e vitit 1987, fq. 50-60. Më gjerësisht mbi idetë dhe aktivitetet e hoxhës dhe komentuesit Haxhi sherif Ahmeti (Zoti e mëshiroftë!) shih librin e tij “**Komente dhe mendime islame**”; bot. 1, 1995, Prishtinë-Kosovë, fq. 82-90, 340-344 dhe 351-354.

Gjithashtu nuk kam fjalë se si ta falënderoj Zotin e Madhërishëm, i Cili ma dha mundësinë që ta përfundoj këtë hulumtim. Fjalët në këtë rast janë të pakta, dhe kurrë nuk mund ta shprehin falënderimin ndaj Tij...

Po ashtu ky hulumtim nuk do të ishte në këtë formë, sikur të mos ishin sugjerimet dhe propozimet e vlefshme gjuhësore dhe tematike nga dijetarët, profesorët dhe kolegët e mi të çmuar e të respektuar, posaçërisht prof. Dr. Hikmet Beshir Jasini, profesor i shkencës së tefsirit në Fakultetin e Kur'anit Fisnik, në Universitetin Islamik në Medinë; Prof. dr. Muhamed Baxha'man, profesor i hadithit dhe akaidit në Universitetin Taibah në Medinë; Prof. dr. Muhamed Abdulkadir Hennadi, profesor i gjuhës arabe në Universitetin Taibah në Medinë; Prof. dr. Xhemajl Husejn Ebu Ferha, profesor i akaidit dhe religjioneve në Universitetin Taibah në Medinë; Prof. dr. Ejmen Sejjid Sajjad, profesor i gjuhës arabe në Universitetin Taibah në Medinë. Pra, të gjithë këtyre sinjerisht iu falënderohem për mundin dhe ndihmën që ma dhanë, duke uruar: Zoti i shpërbleftë me shpërblimet e Tij të pakufijshme!

Në fund, ftoj vëllezërit e mi dijetarë dhe hulumtues shqiptarë, ulema e mendimtarë mendjemprenhtë, mbrojtës të akides së Ehli Sunnetit dhe xhematit, e qëllimmirë, që të përpiqen seriozisht, kuptohet në saje të mundësive, për përhapjen e mesazhit të Kur'anit në mesin e mbarë njerëzve.


Gjithashtu ftoj edhe dëshiruesit e mëshirës së Zotit të Madhërishëm, ekspertët dhe njohësit e realitetit fetar, shoqëror e politik të shqiptarëve, në mbarë trojet etnike shqiptare dhe në diasporë e më gjerë, që të bëjnë një projekt më të madh e më të përhershëm shkencor, dhe të përpilojnë një tefsir tjetër më të gjerë dhe më të thellë se ky që është para nesh në gjuhën shqipe.

Padyshim që ky projekt mund të realizohet vetëm me një aktivitet dhe punë kolektive, ngase nga puna kolektive mund të evitohen gabimet dhe lëshimet shkencore.

Salavatet e Allahut të Madhërishëm gjithnjë qofshin mbi zotëriun dhe pejgamberin tonë, Muhammedin dhe mbi Familjen e tij!

Lutja jonë e fundit do të ishte: "Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botërave!

Prof. Dr. Hfz.Hajredin Hoxha, ka lindur me 01.10.1968 ne Prizren- Kosove. Rrjedh prej nje familje mesatare dhe me kulture te lashte fetare. Pasi qe kreu shkollen fillore ne vendlindje, me inspirimin e prindërve vazhdoi shkollimin e mesem gjashtë vjeçar ne Damask te Sirise 1983-1989, ku edhe diplomoi dhe u be hafiz i Kur'anit. Diplomoi ne Fakultetin e Kur'anit dhe Studimeve Islame ne Universitetin Islamik të Medinës,1990-1994. Studimet pos diplomike te Magjistratures në shkencen e Tefsirit mbaroi në Universitetin Islamik Ndërkombëtar, Kuala Lumpur - Malajzi, 1997-2000, ku edhe u be Doktor i Filozofisë (PH.D) në Tefsir 2000-2003. Ligjëroi ne shkencat Kur'anore dhe Islame në te njejtin Universitet katër vite. Zhvillon nje aktivitet te gjere pedagogjik, fetar, social dhe shkencore ne Univerzitetin nderkombetar ne Malajzi, ne Universitetin Taibah ne Medine, ne Kosove, ne Bahrein, ne Kuvajt etj. Posedon nje numer bukur te madh te diplomave dhe certifikatave te aftësisë ne sferat e ndryshme pedagogjike, fetare dhe shkencore, ku ne mes tjerash vecohet edhe me Diplomën për specializimin në leximin e Kuranit sipas versionit të Al-Imam Hafs nga Al-Imam Asim, me Senedin – Zinxhirin e Artë, që simbolizon vargun e lexuesve të besueshëm dhe profesional, te hafizeve dhe kurrave, linja e të cilëve shkon deri tek Pejgamberi a.s. Është pjesëmarrës aktiv neper konferenca dhe seminare ndërkombëtare me kumtesa ne fusha te ndryshme fetare, historike, kulturore dhe pedagogjike. Ka nje eksperience administrative disa vjeqare. Eshte anëtar i komisionit për interpretimin dhe komentimin e Kuranit, ne webfaqen: <http://www.tafsir.org>, dhe anëtar i Shoqatës Shkencore Saudite për interpretimin e Kur'anin dhe Shekncave Kur'anore. Lëndët që i ka ligjëruar: **Kulturë Islame, Tefsir, Tefsir tematik, Sijreh, Tilavet, Shkencat e Kuranit, Bazat Islame, Studime Kur'anore** etj.. Ka publikuar një sere punimesh, përkthimesh dhe artikujsh ne gjuhen arabe, angleze dhe shqipe ne disa shkencore te shtypit te perditshem e periodik ne Boten Arabe. Del para lexuesve me keto monografi mbi jeten dhe veprat e dijetareve dhe teologeve me eminente shqiptare bashkëkohor ne fushen e interpretimit dhe komentimit te Kur'anit, respektivisht Tefsirit. Perpos specializimit dhe dedikimit te tij ne fushen e tefsirit dhe shkencave Kur'anore, eshte i dhanun edhe ne fusha tjera te islamizimit te shkencave humane dhe te historisë shqiptare; asaj antike dhe moderne, ne qeshtjet dhe problemet kulturore, etike, dhe morale te rinise, si dhe aktiv ne eliminimin dhe luftimin e mendimeve dhe qendrimeve ekstreme



religjioze dhe historike. Aktualisht ka gradën e dc.dr. dhe ligjëron lenden e ***Shkencave Kur'anore*** dhe te ***Kulturës Islame*** me nivele te ndryshme, pranë Universitetit Taibah, ne El Medinetul Muneveretu, Arabia Saudite përplot pesë vite.

Email: drhafezi68@yahoo.co.uk

Website: www.drhajredinhoxha.net